



TITULLI ORIGINAL
O'NUN MUHTEŞEM AHLÂKI

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Albert Halili


FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Shkurt 2022, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

وَأَنْتَ لَعَلَّكَ أَنْتَ خَلْفَةُ عَظِيمٍ

"(Pa dyshim) se ti ke moral madhështor!" (Kalem, 4)



MORALI I TIJ MADHËSHTOR

Osman Nuri TOPBASHI





PREZANTIM

AI ËSHTË MORALI I TIJ!..

Falënderimet dhe lavdet e pafundme i takojnë Allahut Një e të Vetëm!

Përshëndetjet dhe salavatet e pafundme i takojnë Profetit tonë të nderuar ﷺ!

Ai Profet që;

- Me urdhrin e Allahut, është “dëshmia e besimit” tonë.
- Besimi ynë i shenjtë.
- Vetë jeta jonë.

Prandaj;

- Ai është dashuria jonë me e shtrenjtë, të cilën nuk lejojmë të preket as me pupël.
- Është kauza jonë e pavdekshme.
- Shpresa, shërimi dhe mëshira për ne në të dyja botët.

Ata që e kuptojnë;

Janë umeti i vërtetë i Muhamedit ﷺ, që në saje të dashurisë ndaj tij, kanë nderin të jenë sahabë në kohën e tij dhe vëllezër të tij në këtë kohë.

Ndërsa ata që nuk e kuptojnë;

Nuk janë gjë tjetër veçse indiferentë të privuar prej tij.

Kurse ata që zgjasin gjuhën ndaj tij dhe sunetit të tij;

Janë vetëm disa të mjerë që luajnë me besimin e tyre dhe humbasin kuptimin e vërtetë të Dëshmisë së Teuhidit. Sado të ditur të jenë, ata janë shembuj të injorancës.

Natyrisht:

Nuk e kupton Profetin ﷺ, ai që pa të jeton,

E, nuk e jeton dot fenë e vërtetë, ai që Ebu Xhehlin pason!

Natyrisht:

Ai është një rob dhe profet i tillë,

Që kush e refuzon, Allahun ka refuzuar; le ta dijë!

Kjo është e vërteta absolute për të jetuar një jetë në rrugë të drejtë, ashtu siç e kërkon Allahu i Madhëruar, dhe për të arritur lumturinë e të dyja botëve.

Për rrjedhojë, sytë tanë duhet të shohin vazhdimisht nga ai Profet mëshire, të cilin Allahu i Madhëruar na e ka dërguar si “usve-i hasene”; shembullin më të bukur dhe modelin më të përsosur për t’u ndjekur.

Por ky shikim, nuk duhet të jetë thjesht si vështrimi i një fotografie, sepse një shikim i tillë, nuk mund të shohë asgjë.

Është e domosdoshme që ai të shihet me syrin e dashurisë dhe urtësisë, me qëllim që të arrijmë të takohemi me të.

E në fakt, shumë shikime të përcipta e qorrazi, sado të rrinë e ta shohin, ato përsëri nuk do të mund ta perceptojnë atë. Kjo, sepse të shohësh në kuptimin e vërtetë, nuk mund të arrihet vetëm duke parë rrobën e një shpirti sublim.

Siç dihet;

Edhe pse Ebu Xhehli e shikonte përditë të Dërguarin e Allahut ﷺ, ai nuk arriti ta shihte atë ashtu siç duhet, qoftë edhe njëherë të vetme. Arsyeja është e qartë; shikimet indiferente të Ebu Xhehilit ishin të verbra ndaj të vërtetave të atij Profeti madhështor.

Përkundër kësaj;

Ebu Bekri ؓ, e ndiente Profetin ﷺ, edhe kur nuk ishte pranë tij, sepse ai (Profeti), ishte i hapur dhe i qartë si hëna katërmbëdhjetshe për sytë dhe shikimin e tij të dashuruar pas tij.

Domethënë;

Kur themi të shohim atë, nënkuptojmë një shikim që i ngre të gjitha perdet dhe shekujt; një shikim që sheh besimin, urtësinë, sinqeritetin dhe pasionin e tij. Kush i sheh këto, ka parë edhe atë. Po ashtu, duhet të shohim edhe virtytet e tij të larta për të cilat ka nevojë i gjithë njerëzimi deri në kiamet; duhet të shohim se ai është “mëshirë për botët”; duhet të shohim gjerësinë e dhembshurisë së tij dhe adhurimet e shumta që ai i ka realizuar ditë e natë, secili në e vlerën e një miraxhi të veçantë. Me pak fjalë, duhet të shohim moralin e tij shembullor dhe madhështor!

Mirëpo;

Për shkak se kjo botë është një vend i nevojave të shumta, sytë hutohen para dritareve dhe perdeve të panumërta që ka përballë. Ata nuk mund t'i shohin madhësitë e vërteta dhe të përjetshme, sepse mahniten pas shkëlqimeve të përkohshme. Ndonjëherë nuk arrijnë t'i shohin për shkak të pakujdesisë, e ndonjëherë prej pamundësisë. Ndonjëherë, nuk arrijnë t'i shohin të vërtetat sublime për shkak se janë zhytur së tepërmi në kënaqësitë dhe dëshirat e përkohshme të kësaj bote.

Edhe pse po afron kiameti, edhe pse janë hapur portat e Xhehenemit dhe Xhenetit, njeriu indiferent nuk arrin të shohë; edhe pse i gjithë universi po bën përgatitjet e fundit për shpërthimin e madh dhe për përjetësinë që do të vijë pas tij. Nuk arrin ta shohë edhe pse jeta dhe vdekja, ringjallja dhe llogaria, shpërblimi i përjetshëm dhe dënimi i pafund janë një vendim hyjnor i pandryshueshëm.

Sepse;

Shqetësimet e pafundme të kësaj bote të përkohshme, dalin vazhdimisht para këtyre të vërtetave sublime dhe thonë:

- Rregullo njëherë këto punë!

Dhe pas shumë e shumë përpjekjesh, prapë të bëjnë presion:

- Zgjidhi edhe këto probleme, se të tjerat kollaj!

Dhe këto vazhdojnë e përsëriten pafund:

- Mirë bota tjetër, por shih e plotëso njëherë nevojat e kësaj bote!

Ndërsa doktorët u thonë të sëmurëve:

- Ke nevojë për këto vitamina dhe këto ilaçe!

Politikanët nga ana tjetër, si zakonisht, thonë:

- Ka nevojë emergjente për këto apo ato paketa ekonomike!

Kurse arsimtarët natë e ditë shprehin nevojat e tyre:

- Ka nevojë për ide dhe plane të reja!

Po ashtu edhe biznesmenët rrinë e kujtojnë vazhdimisht:

- Njerëzi kanë shumë nevoja, që duhet t'i plotësojmë!

Me pak fjalë;

Në çdo çështje dhe në çdo vend të kësaj bote, nevojat janë të pafundme. E çuditshme është se, aty ku ka padrejtësi, dhunë dhe luftë, nevojat janë ndryshe, e aty ku njerëzit plasin nga rehatia e komoditeti, janë shumë më ndryshe.

Mirëpo;

Të gjitha nevojat, shekuj me radhë janë duke hakërruar në mënyrë metaforike, të gjitha njëzëri, vetëm një të vërtetë. Për ata që arrijnë të dëgjojnë, vajtimi i të gjitha nevojave është komplet ndryshe dhe një e vërtetë e vetme.

Dhe ajo është:

- O njerëzim! Ju nuk keni nevojë për ne, por për atë, Muhamed Mustafanë ﷺ dhe moralin e tij madhështor!

Sepse;

Nëse nuk është marrë shembull prej tij, edhe mëshira mund të rezultojë më e keqe se dhuna. Pa të, edhe dhembshuria kthehet në krimin më të rëndë, e madje, paraqitet sikur të ishte mirësia më e përsosur.

Dhe kjo, tregon se;

Besimi, mëshira, shërimi, zgjidhjet, fitimet dhe e gjithë jeta bëhet ideale vetëm nëse ndiqet shembulli dhe morali i tij madhështor.

Nuk duhet harruar se:

Ai ishte që e shpëtoj njerëzimin, të vuajturit, vajzat e vogla që varroseshin të gjalla, të pashpresët, jetimët dhe të vetmuarit nga kthetrat e pashpirtshme të epokës së injorancës.

Nuk duhet harruar se:

Edhe sot, zgjidhjet e vërteta të problemeve të botës Islame, nuk janë sistemet e huaja perëndimore apo fuqitë e mëdha ekonomike. Po ashtu, as rruga për të vënë në shina brezat e humbur, nuk janë aspak rrugicat e huaja, korridoret e rrezikshme të internetit dhe skenat e mbushur plot kurthe.

Zgjidhja është vetëm ndjekja e tij me besnikëri!

Ashtu si dje, edhe sot, edhe nesër, e vetmja rrugëzgjidhje për ne si njerëzim, është gjithmonë i Dërguari i Allahut ﷺ, sepse faktori kyç që e shndërroi epokën e injorancës në një epokë lumturie, është pikërisht morali i tij madhështor.

Një moral i lartë që është si një Kuran i gjallë...

Një moral që e kënaq Allahun...

Një moral që e shndërron Xhehenemin në Xhenet...

Një moral që i shtron në rrugë të drejtë edhe zullumqarët më të pabindur dhe i shkul prej zemrave edhe egërsitë më të tmerrshme, duke vendosur në to dhembshurinë më të thellë. Një moral që lufton dhe eliminon çdo lloj terrori; që i kthen të këqijat në të mira dhe armiqësitë në miqësi. Një moral që e mbush gjithë botën me mirësi dhe bukuri, drejtësi dhe mëshirë. Një moral që i përfaqëson të gjithë kontinentet dhe

njerëzit me udhëzim. Një moral që e ka mbushur historinë Islame me çlirime legjendare dhe fitore të bekuara. Një moral që e ka mbushur tokën me virtytet e personalitetit dhe karakterit më të bukur.

Morali i tij madhështor...

E vetmja e vërtetë që i duhet çdo zemre, çdo shtëpie dhe çdo brezi!

O Allah i Madhëruar!

Na e bëj të mundur të gjithëve të përfitojmë nga morali madhështor i Profetit tonë ﷺ! Na bëj një popull që do t'ia zbardh faqen atij në të dyja botët, të lidhur me gjithë shpirt pas tij dhe që në çdo situatë shfaqin durim, karakter, besnikëri, trimëri dhe sakrificë në rrugën e drejtë!

Amin!

Muhammed Ali ESHMELI



PARAFJALË

BËSNIKËRIA JONË NDAJ PROFETIT ﷺ, ËSHTË TË JETOJMË NË GJURMËT E TIJ!

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar...

Ai na bëri umetin e robit të Tij të dashur dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit ﷺ. Ndërsa moralin e tij madhështor, e bëri shembullin më të bukur për ne.

Selamet dhe salavatet e panumërta qofshin për Profetin tonë ﷺ...

Sepse Profeti ynë ﷺ, ka jetuar moralin më të veçantë dhe më madhështor.

Nisur nga kjo;

Detyra jonë si umeti i tij;

Është besnikëria ndaj tij.

Dhe kjo besnikëri, nuk është gjë tjetër veçse një jetë në gjurmët e tij.

Si jetoi ai?

Çfarë morali kishte?

Përgjigja e kësaj, nuk janë fjalët tona të mjera, por vetë ai...

Ai është një personalitet shembullor dhe i pashoq, të cilin e edukoi Vetë Allahu i Madhëruar. Ai e pajisi atë me “dije të dobishme”, të cilën ia mësoi popullit të vet. Ai i mësoi ta përdorë mendjen në përputhje me shpalljen hyjnore dhe e stërviti në “meditim” në mënyrë që çdo shikim dhe vepër e tij, të ishte çelës i besimit.

Ai ishte “zotëria i të gjithë profetëve”, që zotëronte një zgjuarsis dhe intuitë të jashtëzakonshme. Po ashtu, ai u mësoi “urtësinë dhe largpamësinë” edhe shokëve dhe popullit të tij.

Fjala dhe vepra, dora dhe gjuha, zemra dhe trupi i tij ishin gjithmonë në harmoni me njëra-tjetrën. Ai posedonte nivelin më të lartë të cilësive profetike, si “sidk, emanet dhe ismet”. Me këtë drejtësi dhe besnikëri, ai predikoi gjithmonë një “Mendim Botëror Islam”, që gjallëroi çdo fazë të jetës së besimtarëve, duke u dhënë atyre vetëdijen e “gjuhës, fesë dhe historisë”.

Së pari, ai u mësoi sahabëve besimin monoteist/teuhidin dhe akaidin. Më pas i stërviti të ishin të qëndrueshëm në besim; u dha “moralin e besimit”.

Ai jetoi dhe u mësoi të tjerëve “falënderimin dhe mirënjohjen” ndaj Allahut të Madhëruar, i Cili na ka dhuruar besimin së bashku me mirësitë e pafundme materiale dhe shpirtërore.

Ai na mësoi të falënderojmë për çdo mirësi, madje edhe për hijen e një peme. Ndërsa falënderimi për mirësinë e besimit, është ta jetojmë Islamin dhe t’i ndihmojmë edhe të tjerët në këtë çështje.

Për shkak se edhe posedimi, edhe mungesa e mirësive është sprovë, Profeti ﷺ, ka jetuar me “durim dhe qëndresë në rrugë të drejtë”. Ai i ka buzëqeshur çdolloj vështirësi dhe vuajtjeje me vetëdijen se, “jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër”. Gjatë kthimit prej udhëtimit të vështirë në Taif, emocioni që i dha udhëzimi në rrugë të drejtë edhe vetëm i një skllavi, e bëri atë të harrojë çdolloj vuajtje që kishte kaluar. Po ashtu, edhe gëzimi që i dha ngopja e vetëm njërit prej sahabëve të suffes, e bëri atë të harronte urinë e vet. Kjo, sepse mëshira e tij, ishte aq e madhe, sa e bënte të harronte edhe hallet e veta.

Sepse;

Ai ﷺ, ishte maja në çdo çështje. Ai e arriti edhe majën e “Modestisë dhe Përruljes”. Ai edhe veten e prezantonte si Abduhu ue Resuluhu / Robi dhe i Dërguari i Allahut. E gjithë kjo, sepse ai jetonte çdo çast me vetëdijen se ishte një rob i dobët përballë Allahut.

Ai jetoi “Besnikërinë”. Ai i mësoi njerëzimit konceptin e vërtetë të së drejtës. Ai foli dhe zbatoi të drejtën e Allahut dhe të drejtën e njeriut. Madje, për të treguar rëndësinë e “Drejtësisë”, tregoi shpinën e vet dhe tha: “Kujt i kam rënë, le të vijë të më bjerë!”

Veçoria dalluese e “Familjes Ideale dhe Shoqërisë së Devotshme”, është “Kafshata Hallall”. Profeti ﷺ, e ka jetuar bukurinë e fitimit hallall me djersën e ballit. Ai ka jetuar i “Kënaqur, i Mbështetur tek Allahut dhe i Panevojshëm për të tjerët”, duke u mjaftuar me hallallin dhe duke dhuruar gjithmonë prej asaj që i vinte si furnizim nga Allahu.

Sepse;

“Mëshira e tij”, përfshinte botët. Ai përhapri mëshirë jo vetëm për myslimanët apo njerëzimin, por për të gjitha krijesat; përfshi kafshët dhe bimët.

“Bujaria e tij”, ishte më e begatë dhe më gjithëpërfshirëse se erërat. Ai ishte bujar edhe në kamje, edhe në skamje.

Vetëdija e tij e “Vëllazërisë”, ishte e veçantë dhe e pashoqe.

Një tregues tjetër i jashtëzakonshëm i moralit të tij madhështor, ishte fakti se ai jo vetëm jetonte në këtë mënyrë, por i bënte edhe të tjerët të jetonin me këto virtyte dhe parime. Profeti ﷺ, ishte “Pastruesi dhe Edukuesi i Sahabëve dhe Umetit të tij”. Ky ishte një pastrim dhe një edukim i atillë, saqë “Qytetërimi që themeloi ai”, ishte një qytetërim i virtyteve më të larta. Një qytetërim i mbushur me edukatë, delikatesë dhe elegancë... Një qytetërim ku duke filluar prej Kalifit, e deri tek individi më i thjeshtë i shoqërisë, të gjithë bartin “Vetëdijen e Përgjegjësisë”... Një qytetërim ku të gjithë kujdesen për njëri-tjetrin...

Ky qytetërim;

Ishte “Mrekullia e Edukimit” të Profetit tonë ﷺ.

Ky qytetërim;

Ishte produkti i “Eliminimit të injorancës dhe i ndërtimit të njeriut”. Ishte rezultat i ndjeshmërisë ndaj urdhërimit për të mirë dhe pengimit nga e keqja në rrugën e “Udhëzimit dhe Kumtimit”.

Në atë qytetërim, gjetën paqe njerëzit e çdo statusi shoqëror, madje edhe kafshët. Po ashtu gjetën paqe edhe shkretëtirat që ishin kthyer në pellgje gjaku.

Paqja që solli ai, përfshiu gjithçka.

“Vlerësimi i ditës dhe i jetës” nga ana e Profetit tonë ﷺ, ishte një tablo e veçantë e moralit të tij madhështor. Njëzetekatër orët e tij, ishin në shërbim të Allahut dhe të popullit. Pra, dita e tij ishte e mbushur me përpjekjet për të jetuar fenë dhe për ta përhapur atë. Ai ishte vazhdimisht “Në shërbim të Allahut” pa bërë asnjë ditë të vetme pushim dhe e mësoi popullin e tij se; vetëm kjo ishte “Një jetë në paqe”, sepse buzëqeshja më e bukur e jetës së tij, ishte kur i shihte sahabët e vet të falnin namaz krahë për krahë. Ndërsa koha kur ai pushonte, ishte ajo kur ai i fitonte zemrën e dikujt. Pra, ai pushonte e çlodhej vetëm me bamirësi.

Ashtu si ai, edhe sahabët e tij nuk u lodhën kurrë dhe nuk pushuan asnjëherë kur shkuan në të katër anët botës; në Kinë, Semerkand, Afrikë, etj. Të gjithë bënë përpjekje të jetonin si ai hap pas hapi në rrugën e tij. Me një dashuri dhe pasion të papërshkrueshëm, ata përhapën në të gjitha vendet ku shkelën, udhëzimin dhe drejtësinë, dhembshurinë dhe mëshirën, shkurtimisht, moralin e tij madhështor.

Në të njëjtën mënyrë;

Edhe pasi Profeti ynë ﷺ, shkoi tek Allahu i Madhëruar, sahabët, prijësit e drejtë dhe të gjithë besimtarët e devotshëm që erdhën pas tyre, ecën në rrugën e tij duke i ndjekur me kujdes gjurmët e tij. Ashtu si pasqyrat që reflektojnë dritën e diellit, edhe ata përhapën dritë në të gjithë shekujt.

Për rrjedhojë, edhe ne sot, si besimtarë, e kemi për detyrë të përpiqemi me aq sa kemi mundësi të jetojmë dhe përhapim moralin madhështor të Profetit tonë ﷺ, sepse fatkeqësisht, në kohën tonë po zhvillohen shumë veprimtari që e tradhtojnë amanetin e tij ﷺ.

Amaneti i tij, janë;

Islami...

Kurani dhe Suneti i tij...

Në Hutben e tij të Lamtumirës, i Dërguari i Allahut ﷺ, është shprehur:

“Po ju lë (amanet) dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni. Ato janë: Libri i Allahut, Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Tij...” (Shih. Muvatta, Kader, 3.)

Siç tregon nëna jonë Aisha ﷺ, morali madhështor i Profetit tonë ﷺ, ishte vetë Kurani Fisnik.

Kurani është një mrekulli e artit hyjnor e shfaqur në fjalë. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, është mrekullia e artit hyjnor e mishëruar tek njerëzit.

Personaliteti njerëzor si besimtar i devotshëm, i mirë dhe i sinqertë, të cilin predikon Kurani, përfaqësohet nga Profeti ynë ﷺ, në formën më sublime. Besimi, veprat e bukura, jeta dhe morali i jashtëzakonshëm i Profetit tonë ﷺ, është harta e

lumturisë së përjetshme që ka predikuar dhe ka kërkuar Kurani Fisnik...

Historia është dëshmitare se;

Në saje të “Moralit të tij madhështor”, ne u lartësuar në këtë botë, si në nder ashtu edhe në dinjitet. Në saje të tij përhapëm drejtësinë dhe të drejtën në gjithë botën. Madje, edhe vetë jomyslimanët u mahnitën me drejtësinë e Islamit. Kështu, ne arritëm të ndërtonim qytetërimin në të cilin ishte mishëruar mëshira dhe dhembshuria.

Mirëpo;

Kur u larguam nga morali madhështor i Profetit tonë ﷺ... Kur lëshuam pe në pasionin për të jetuar dhe përhapur Islamit, edhe fitoret e kësaj bote dolën nga duart e myslimanëve.

Por disa e interpretuan gabim edhe këtë gjendje. Edhe pse ne mbetëm mbrapa për shkak se nuk u kapëm fort pas “Moralit të tij Madhështor” dhe nuk i dolëm për zot Profetit ﷺ, u përhap një botëkuptim komplet i kundërt... Disa qarqe filluan të akuzonin Islamit për këtë prapambetje dhe i dhanë start një fenomeni të quajtur Islamofobi. Përkundër kësaj, filluan të ngrenë lart mendjen dhe moralin e shëmtuar perëndimor.

Megjithatë, edhe pse ata e sulmuan Islamit nga të gjitha anët, nuk mundën ta shuanin atë. Prandaj, këtë herë filluan përpjekjet për ta zbrazur atë, me qëllim që ta kthenin në një lloj zarfi bosh, siç vepruan me krishterimin.

Nëse prej Islamit nxirrni akiden e paprekshme monoteiste, adhurimin e sinqertë, ligjet që janë kufijtë e Allahut, kumtimin e fesë, urdhërimin në të mirë dhe pengimin nga e keqja, nuk do të mbetet vetëm se një tabelë boshe ku shkruhet Islam.

Mirëpo, për të realizuar këto, duhej largonin pengesat që kishin para, siç është jurisprudenca/fikhu Islam, medhhebet/shkollat juridike, të cilat i refuzuan dhe sunetin autentik të Profetit ﷺ, të cilin e përbaltën me shpifje dhe mbollën në të dyshim e pasiguri. Sa i përket Kuranit; për shkak se nuk mund ta refuzonin dot, u përpoqën të abrogonin ligjin e tij, duke ia shtrembëruar kuptimet me anë të interpretimeve pabaza.

Po në këtë kuadër duhen konsideruar edhe disa tentativa në ditët tona, të cilat promovojnë armiqësinë ndaj sunetit profetik, historicizmin e Kuranit, dialogun ndërjetar dhe fenomenin e “Islamit të moderuar”, që në fakt nuk është gjë tjetër, veçse një lëvizje tinëzare që synon zbrazjen e brendësisë së Islamit.

Edhe kur Profeti ynë ﷺ, filloi të kumtojë Islamin, populli i tij i paditur e kundërshtoi atë, sepse Islami përfshin gjithë jetën e njeriut. Duke predikuar për botën tjetër, Islami na kujton se do të merremi në llogari nga Zoti i Madhëruar për çdo veprim që bëjmë... Islami jo vetëm e ndalon haramin, por i mbyll edhe rrugët që shkojnë për tek ai... Po ashtu, Islami nuk e lejon as egoizmin, koprracinë, dhunën dhe padrejtësinë...

Pra, edhe në atë kohë, kundërshtarët u përpoqën ta zbraznin brendësinë e Islamit, duke propozuar një fe që i toleron idhujt, nuk predikon botën tjetër, nuk urdhëron për të mirë dhe nuk ndalon nga e keqja. Mirëpo, as Allahu, e as Profeti ynë ﷺ, nuk mund të pranonin diçka të tillë.

Abdulehad Daud Efendi shprehet kështu në lidhje me faktin se si është zbrazur brendësia e fesë së krishterë:

“Në vend të synetit/rrethprerjes, u vendos pagëzimi. Vendin e namazit e zuri mesha. Ndërsa agjërimi u zëvendësua me një

lloj pehrizi, pra, me braktisjen e vetëm disa ushqimeve të caktuara.”

Normalisht, krishterimi i pranon si të shenjtë edhe libra e zbritur që prej kohës së Musait ﷺ. Mirëpo, ligjet e tyre i refuzojnë. Ata thonë:

“Jepi Çezarit atë që i takon Çezarit”

Pra, caktimi i ligjeve i takon mbretërve. Në këtë mënyrë, doli në pah një fe e boshatisur përbrenda dhe e burgosur vetëm brenda ndërgjegjes së njeriut.

Të njëjtat kurthe ia janë ngritur edhe Islamit...

Për këtë arsye, ne e kemi për borxh të kuptojmë dhe të tregojmë se sa mirësi e madhe është besimi dhe vetë i Dërguari i Allahut ﷺ. Allahu i Madhëruar urdhëron:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...”
(en-Nisa, 80)

Rruga e drejtë, për të cilën lutemi çdo namaz, është rruga që shkon drejt Allahut. Dhe, udhërrëfyesi i asaj rruge është pikërisht i Dërguari i Allahut ﷺ.

Duhet të dimë se;

Pabesia ndaj të Dërguarit të Allahut, është një pabesi e madhe.

Nuk duhet të harrojmë se:

Të njohësh, të lexosh, të jetosh dhe të përhapësh “moralin e tij madhështor”, është besnikëri ndaj tij; është besnikëri ndaj Allahut të Madhëruar, i Cili e dërgoi atë si mëshirë për botët dhe në një farë mënyre, është falënderim për këtë mirësi të madhe.

Nisur nga kjo;

I lutem Allahut të Madhëruar të na e pranojë këtë vepër si një hap modest drejt kësaj besnikërie dhe këtij falënderimi!

Zoti ynë i Madhëruar!

Na pajis me moralin madhështor të Profetit tonë ﷺ, në çdo aspekt! Na e bëj të mundur të jetojmë dhe përhapim gjatë gjithë jetës sonë sunetin e tij autentik dhe na bëj prej popullit të tij fatlum që përpiqet vazhdimisht me vullnet dhe dëshirë!

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH
Janar 2018 / Rebiulahir 1439
Sanxhaktepe / Stamboll

MORALI I TIJ MADHËSHTOR



DIJA E DOBISHME

Allahu i Madhëruar urdhëron:

"...Thuaj: «O Zoti im, shtoma diturinë!.." (Taha, 114)

Dobia e dijës, është meditimi që të shpie në devotshmëri;

Është drithërima që lind frikën ndaj Allahut;

Është aftësia që sjell përkushtimin.

Dobia e dijës, është faktori që e afron robin tek Allahut;

Është frymëzimi shpirtëror, përspirtshmëria.



DIJA E DOBISHME

MËSUESI UMMI¹

Allahu i Madhëruar i drejtohet Profetit tonë ﷺ, duke cilësuar me këto fjalë;

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“(Pa dyshim) se ti ke moral madhështor!” (Kalem, 4)

Ku e mësoi Profeti ynë ﷺ, këtë moral kaq të lartë?

Vetëm prej Zotit të tij! Sepse vetë Profeti ﷺ, shprehet:

“*Mua më edukoi Zoti im me një edukatë të bukur.*” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, I, 12.)

Ai nuk mori edukim as nga babai i vet, të cilin nuk e pa kurrë, as prej nënës së tij sa qe fëmijë, e as prej ndonjë mësuesi apo ndonjë shkolle tjetër.

1. **Ummi:** Dikush që nuk ka mësuar shkrim e lexim, por që, jo domosdoshmërisht nuk zotëron dije apo urtësi të tjera. Një person analfabet mund të ketë njohuri shumë të mira në fusha të ndryshme. Madje, edhe më tepër se shumë njerëz që dinë shkrim e lexim. Pra, një person që nuk di të shkruajë e të lexojë mund të jetë aq i ditur, sa mund të jetë i paditur edhe dikush që di të shkruajë e të lexojë.

Profeti ynë i dashur ﷺ, ishte ummi; nuk dinte shkrim e lexim. Një prej shkaqeve që ai nuk kishte mësuar shkrim e lexim, është edhe urtësia hyjnore, që synonte ta pengonte atë të ndikohej nga diçka tjetër. Në fakt, atë kohë, numri i atyre që dinin shkrim e lexim në Mekë, ishte shumë i ulët, sepse nuk kishte as shkollë ku mund të arsimohej. Madje, edhe shumica e poetëve nuk dinin shkrim e lexim. Aftësitë e tyre në poezi, ata i shfaqnin në formën e improvizimeve. Po ashtu, nuk kishte as bibliotekë ku mund të merrje dije apo informacion. Shkurtimisht, përveç disa gojëdhënave e legjendave që dëgjoheshin në vendet ku shkohej për tregti, nuk kishte burime të tjera informacioni. Në përgjithësi, kultura fetare ishte e njëjtë, sepse shoqëria e atëhershme arabe, ishte shumë larg prej mësimave monoteiste të Ibrahimit ﷺ dhe Ismailit ﷺ dhe ishin zhytur në një injorancë dhe idhujtari shumë të thellë.

Mirëpo, ajo zemër me moral të veçantë dhe natyrë të pastër që i kishte falur Allahu, u bë zemra ku zbriti edhe Kurani Fisnik. Në zemrën e Profetit ﷺ, u shfaqën urtësitë dhe dija e së vërtetës dhe njohjes së Allahut.

Ai Profet analfabet, i cili u dërgua si mëshirë për botët, arriti të ndërtojë një qytetërim virtytesh prej një shoqërie injorante dhe idhujtare. Ai edukoi njerëz me zemra të ngurta, që mund t'i merrnin jetën edhe fëmijës së tyre dhe i shndërroi ata në njerëz me zemra aq të buta, saqë nuk mund t'i bënin keq as edhe një milingone.

Ai Profet analfabet që u dërgua si mëshirë për botët, arriti të ndërtojë një qytetërim virtytesh prej një shoqërie injorante dhe idhujtare. Ai edukoi njerëz me zemra të ngurta që mund t'i merrnin jetën edhe fëmijës së tyre dhe i shndërroi ata në njerëz me zemra aq të buta, saqë nuk mund t'i bënin keq as edhe një milingone.



Shkollat e jurisprudencës, të cilat u krijuan nga pasuesit e tij në një kohë të shkurtër, tejkaluan maja, të cilat mendja njerëzore nuk do mund t'i arrinte në qindra vjet. Ligjvënësit e famshëm si Soloni dhe Hammurabi, nuk mund të konsideroheshin as çirakë përballë gjenialitetit të Ebu Hanifes!..

Në shoqërinë që ndërtoi ai, i pasuri e konsideronte veten si përgjegjës ndaj të varfrit. Aq, sa në disa kohë dhe vende, nuk mund të gjeje asnjë të varfër për t'i dhënë zekatin apo lëmoshën.

Kalifët që ndoqën rrugën e Profetit tonë ﷺ, kishin një ndjenjë aq të madhe përgjegjësie ndaj popullit, saqë netëve shëtitnin me ushqime në kurriz duke kërkuar për nevojtarët.

Ndërsa dijetarët e devotshëm që u bënë trashëgimtarët e tij, e kumtuan Islamin duke e jetuar vetë në mënyrën më të mirë dhe duke e predikuar kudo. Në këtë mënyrë, ata edukuan breza të tërë dhe ndriçuan horizontet.

Suksesi i jashtëzakonshëm i Profetit ﷺ, është vërtetuar nga shkenca e statistikës dhe është pohuar nga shkenca e historisë.

LIDERI MË I MADH

Shkencëtari amerikan Michael HART në vitin 1979 përgatiti një studim me anë të kompjuterit. Qëllimi ishte të zgjidhte 100 personalitetet më të mëdha të të gjitha kohërave dhe t'i radhiste ato.

*Shkollat e jurisprudencës,
të cilat u krijuan nga
nxënësit e tij në një kohë
të shkurtër, tejkaluan
majat të cilat mendja
njerëzore nuk do mund
t'i arrinte në qindra vjet.
Ligjvënësit e famshëm si
Soloni dhe Hammurabi,
nuk mund të
konsideroheshin as çirakë
përballë gjenialitetit të
Ebu Hanifes!..*



Kështu që, shkroi në kompjuter aftësitë, përpjekjet, veprat dhe sukseset e njerëzve të mëdhenj të cilët kanë lënë gjurmë në histori. Në fund të këtij studimi, i cili zgjati për disa muaj, programi kompjuterik zgjodhi emrin më të madh në bazë të të dhënave të regjistruara në memorien e tij. Emri i përzgjedhur në mënyrë objektive nga kompjuteri ishte Muhamedi ﷺ.

Pas këtij studimi, revista franceze Le Point, e shpalli Muhamedin ﷺ, “Njeriun e Vitit” 1979. Kur gazetata e datës 29 Dhjetor 1979 bënë këtë lajm, si arsyetim të këtij përfundimi shkruan:

“Megjithëse Muhamedi jetoi mes viteve 571- 632, ndikimi i tij në botë po rritet si ortek dhe me miliona njerëz po ecin ende në rrugën që ka treguar ai.” (Revista Zafer 97/3-8.)

Ai u mësoi njerëzve dijen që të çon drejt lumturisë në të dyja botët. Nuk u mësoi fjalë të kota, njohuri dhe dije të padobishme, por dije të dobishme në saje të të cilave do të mbi-zotëronin në të dyja botët.



*Për dijen e dobishme,
Aliu ﷺ, ka thënë:*

*“Bëhem skllav i atij që
më mëson një shkronjë.”*

*Jo disa dije të thjeshta
që i njej gjithkush, por
dijet që të mësojnë
njohjen e Allahut.*

DIJA E DOBISHME

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik urdhëron:

“...Thuaj: «O Zoti im, shtoma diturisë!..»” (Tâhâ, 114)

Ndërkohë që Profeti ﷺ, i lutej Allahut të Madhëruar që t’i shtonte dijen e dobishme, kërkonte edhe mbrojtjen e Tij nga dija e padobishme.

Cila është dobia e dijes?

Dobia e dijes, është meditimimi që të shpie në devotshmëri. Është drithërima që lind frikën ndaj Allahut. Është aftësia që sjell përkushtimin. Dobia e dijes, është faktori që e afron robin tek Allahut. Është frymëzimi shpirtëror, përsheptshmëria.

Pikërisht për një dije të tillë, Aliu عليه السلام, ka thënë:

“Bëhem skllav i atij që më mëson një shkronjë.”

Jo disa dije të thjeshta që i njeh gjithkush, por dijet që të mësojnë njohjen e Allahut. Kjo është dija që mori Halid Bagdadi prej Abdullah Dehleviut dhe të cilën e përhapri gjithandej. Padyshim se, kjo është edhe dija që ka marrë Mevlana prej Shemsi Tebrizit. Madje, kur ishte duke përmbledhur jetën e vet, lidhur me gjendjen e tij kur ishte në majë të dijeve në Medresenë e Selçukëve, Mevlana tha: “isha i papjekur”. Kur arriti të kuptojë urtësitë e shfaqjeve hyjnore dhe të lexonte të fshehtat hyjnore, duke shfletuar faqet e librit të gjithësisë, tha: “u poqa”. Por, kur u shkri në dashurinë për Allahun, atëherë tha: “u dogja”. Dhe, pas kësaj, lidhur me Profetin tonë صلى الله عليه وسلم, ka thënë:

“Për sa kohë që ky shpirt të jetë në këtë trup, unë jam robi, skllavi i Kuranit dhe pluhuri i rrugës së Muhamed Muhtarit صلى الله عليه وسلم...”

Domethënë; nëse dija nuk ka arritur në zemër dhe nuk e ka çuar të zotin drejt frikës ndaj Allahut, edhe pse në teori ai mund të quhet dijetar, në të vërtetë, ai nuk konsiderohet i tillë. E çfarë është një dije e tillë, përveçse huti dhe indiferencë?



Në shoqërinë që ndërtoi ai, i pasuri e konsideronte veten si përgjegjës ndaj të varfrit. Aq, sa në disa kohë dhe vende nuk mund të gjeje asnjë të varfër për t'i dhënë zekatin apo lëmshën. Kalifët që ndoqën rrugën e Profetit tonë صلى الله عليه وسلم, kishin një ndjenjë aq të madhe përgjegjësie ndaj popullit, saqë netëve shëtitnin me ushqime në kurriz duke kërkuar për nevojtarët.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (Fatir, 28.)

E, ndërkohë që është kështu për dijet fetare, lidhur me ata që merren vetëm me dituritë e shkencave të kësaj bote, Imam Gazaliu shprehet:

“Biri im! Turp për ty nëse nuk i përvetësuar dijet në fushën e kelamit, logjikës, letërsisë, poezisë, gjuhës, etj.! E çfarë përfitove tjetër, përveçse e çove dëm jetën që të ka dhënë Allahu për të adhuruar Atë?!”

Kurse Rumi shprehet:

“Ata që janë dijetarë vetëm të dijeve ekzoterike (dhahiri), njohin vetëm hollësitë e dijeve përkatësi si, geometria, astronomia, mjekësia, filozofia, etj. I dinë, por këto janë dituri të kësaj bote të përkohshme që vjen e ikën sa hap e mbyll sytë. Këto nuk ia tregojnë njeriut rrugën që shkon drejt miraxhit, deri në qiellin e shtatë.”

Mevlana ka thënë:
“Të hutuarit e robëruar nga egoja e tyre, nuk mund ta dinë rrugën e Allahut dhe cakun ku të çon ajo rrugë! Njohuritë në lidhje me rrugën e Allahut, i zotërojnë vetëm njerëzit e zemrës; me zemrën, e jo me mendjen e tyre!”



“Të hutuarit e robëruar nga egoja e tyre, nuk mund ta dinë rrugën e Allahut dhe cakun ku të çon ajo rrugë! Njohuritë në lidhje me rrugën e Allahut, i zotërojnë vetëm njerëzit e zemrës; me zemrën, e jo me mendjen e tyre!”

Të privuarit nga dija e dobishme, pra, nga pjekuria shpirtërore në dije, le të mësojnë sa të duan, e çfarë të duan, ata nuk do ta kuptojnë kurrë rrugëtimin drejt Al-

lahut, që është edhe e vërteta më e madhe. Në ajetin kuranor thuhet:

“...ata që kanë punuar e janë rraskapitur (e kanë çuar jetën dëm në punë të padobishme).” (Gashije, 3.)

Dija mund të japë fryte të mira për të zotin, vetëm nëse zbret prej veshit e mendjes, dhe përpunohet në zemër. Vetëm një dije e tillë mund ta çojë njeriun nga arti tek artisti, prej shkaktari tek shkaktari, e ta zbukurojë atë me vepra të bukura dhe frikë ndaj Allahut.

KUR BËHET FJALË PËR ARSIMIM

Në ditët tona, kur bëhet fjalë për arsim, si rezultat i botëkuptimit të mangët, na vjen në mendje vetëm arsimi që realizohet me dëshirën për të fituar një profesion dhe për të arritur një post apo pozitë. Prindërit përpiqen me gjithë shpirt që t’u sigurojnë fëmijëve të tyre një botë më të mirë. Madje, për hir të kësaj, ata e hedhin fenë në plan të dytë duke thënë; “ç’të bëjmë, jemi të detyruar!” dhe i vendosin fëmijët e tyre në ambiente që e helmojnë një mysliman në mendim, besim dhe jetesë. Madje, duke qenë të gatshëm të paguajnë edhe shuma të majme.

Ngatërrimi i vlerës së dijes dhe arsimit në fenë tonë, është një gabim shumë i madh, sepse dija që është farz/e obliguar, është ajo dije që e përgatit njeriun për të dyja botët në të njëjtën kohë dhe e afron atë tek Allahu i Madhëruar.

Nëse edhe dituritë e kësaj bote bëhen shkak i meditimit të robit, dhe ai meditim e shton vetëdijen dhe devotshmërinë,

Të privuarit nga dija e dobishme, pra, nga pjekuria shpirtërore në dije, le të mësojnë sa të duan e çfarë të duan, ata nuk do ta kuptojnë kurrë rrugëtimin drejt Allahut, që është edhe e vërteta më e madhe. Në ajetin Kuranor thuhet: “...që kanë punuar e janë rraskapitur (e kanë çuar jetën dëm në punë të padobishme).” (Gashije, 3.)



atëherë ato dije janë me të vërtetë të dobishme dhe e përgatisin robin për lumturinë e përjetshme. Mirëpo, për realizimin e një gjëje të tillë, kushtet në të cilat do të merret ajo dije, duhet të jenë të përshtatshme me qëllimin. Pra; është e detyrueshme të jenë në përputhje me parimet Islame.

Nëse nevoja për dijet e kësaj bote kundërshtojnë nevojat e përgatitjes për botën tjetër, padyshim që një besimtar, duhet të bëjë një zgjedhje në favor të jetës së përjetshme.

Sepse;

Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!

Dhe, diploma e vërtetë që do të merret, është dëshmia e besimit në frymën e fundit. Kjo është diploma më e rëndësishme për të cilën duhet të përpiqet një besimtar. Sigurisht që, edhe diplomat në fushat e tjera të dijes janë të rëndësishme. Por, të preferosh vetëm arritjet në dituritë që do të lehtësojnë jetën në

këtë botë, duke i lënë pas dore ato që do ta lehtësojnë jetën në botën tjetër, nuk është aspak një veprim i zgjuar.

Edhe kur synohet arsimimi në dituritë fetare, qëllimi nuk duhet të jetë thjesht ana e jashtme e tyre, por ana e brendshme; dobia që kanë ato; ajo që përjetohet në harmoni me ndjenjat dhe veprat, sepse thelbi i dijeve Islame, është devotshmëria ndaj Allahut dhe besnikëria ndaj Profetit ﷺ.

Për këtë arsye edhe Imam Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë), e refuzoi postin e gjykatësit të Bagdadit, që ishte edhe pos-

Diploma e vërtetë që do të merret, është dëshmia e besimit në frymën e fundit. Kjo është diploma më e rëndësishme për të cilën duhet të përpiqet një besimtar.



ti më i lartë pas Kalifit. Ai e dinte mirë se vendimet e tij do të shtrembëroheshin dhe do të bëheshin mashë e punëve të pista nga ana e drejtuesve në pushtet.

Nisur nga kjo, nëse një person nuk e posedon personalitetin dhe devotshmërinë që kishte Ebu Hanifja, atij nuk do t'i bëjë dobi dija e tij, qoftë edhe nëse është në rangun e Ebu Hanifes. Dhe, dija e padobishme, vetëm sa e lidh atë me jetën e kësaj bote, duke u kthyer në një helm për zemrën e tij.

Kurse dija e dobishme, në saje të një meditimi të shëndetshëm, përforcon besimin dhe vulos akiden me vepra të sinqerta dhe të mira. Nëse dija nuk i ka këto dobi, as besimi nuk zë vend në zemër. Ai lëkundet me pëshpëritjen e parë të shejtanit. Ata që sikurse Shejtani, Karuni dhe Salebe, devijuan nga rruga e Allahut pasi kishin besuar, nuk ishin aspak të paditur. Përkundrazi, ishin nga personat më të ditur. Por, atyre nuk u bëri dobi dija, sepse ajo nuk ndikoi për mirë në zemrat e tyre. Ajo ishte një dije që u shtoi kryeneçësinë dhe mendjemadhësinë. Dhe, ata që zotërojnë një dije të tillë, ashtu siç devijojnë veten e tyre, devijojnë edhe shumë të tjerë pas tyre.

Dituria është si një thikë me dy presa. Bota ka njohur shumë njerëz tiranë, të cilët i kanë shfrytëzuar dituritë e kësaj bote për të shtuar edhe më tepër mizoritë e tyre. Njerëz të tillë, janë shënuar në histori si armiqtë dhe turpi i njerëzimit. Dituritë që përdorën ata për të ndërtuar kulla me kafkat e njerëzve, i sollën katastrofën edhe njerëzimit, edhe vetë atyre.

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِشْرَةَ عَشْرَةَ

*Nëse nevoja për
dijet e kësaj bote
kundërshtojnë nevojat
e përgatitjes për botën
tjetër, padyshim se një
besimtar, duhet të bëjë
një zgjedhje në favor
të jetës së përjetshme,
sepse jeta e vërtetë,
është ajo e botës tjetër.*

Nga ana tjetër, ata që arritën ta përpunonin dijen e tyre me besim dhe devotshmëri ndaj Allahut, u bënë miqtë e vërtetë të të gjithë njerëzimit, duke jetuar në zemrat e tyre edhe pasi ndërruan jetë.

Ebu'l Hasan Harakani, thotë:

“Fitnen që shkaktojnë dy lloj njerëzish, nuk e shkakton as shejtani; prandaj ik prej tyre: Njëri është sufisti i paditur dhe tjetri është dijetari që nuk e ka arritur devotshmërinë dhe është mposhtur nga lakmia për këtë botë.”

Këta lloj njerëzish e shtrembërojnë të vërtetën sipas intereseve të veta. Dijen e bëjnë mashë të padrejtësive, dhe interpretimet e tyre ndjekin rrugën e devijuar. Kurse dijetarët e vërtetë, që zotërojnë devotshmëri dhe karakter, e mbajnë dhe e ngrenë lart të vërtetën edhe në dëm të vetes së tyre.

Dy shembuj të njohur:



Devotshmëria është kusht për të fituar vlerë tek Allahut i Madhëruar. Ndërsa dija, është një domosdoshmëri për të mësuar se cila prej sjelljeve është më e përshtatshme për devotshmërinë. Çdo gjë ka aspektin e saj të dukshëm dhe një urtësi. Burimi i të gjitha dijeve ekzoterike dhe ezoterike, është Allahu i Madhëruar, i Cili ka zbritur Kurandin në zemrën e Profetit tonë ﷺ.

Siç e dimë, Ebu Hanifja e refuzoi propozimin për gjykatës të Bagdadit, që i bëri kalifi Ebu Xhafer Mansur, sepse ai e dinte që grada e tij e dijës, do të përdorej si mbështetje për veprimet jolegjitime të kalifit. Nëse do ta pranonte, do të ishte rehat në këtë botë, por do t'i shkatërrohej bota tjetër. Prandaj, ai preferoi të qëndronte më mirë në burg, duke thënë; *“Më mirë preferoj burgun, sesa të jap vendime të padrejta!”*

Ndërsa Ahmed bin Hanbeli, u dhunua nga tiranët e devijuar që kishin shtë-

në pushtetin në dorë dhe iu bë presion që të thoshte se “Kurani është i krijuar”. Por, për shkak se nuk e pranonte një gjë të tillë, preferoi më mirë burgun, sesa të lëshonte pe nga e vërteta.

A do t’i mbronte dija nga devijimi, nëse këta dijetarë nuk do të zotëronin devotshmëri!?

Për rrjedhojë, nëse çështja është e tillë edhe në fushën e dijeve fetare, duhet të kuptojmë mirë se, arsimimi që bëhet vetëm me qëllimin e arritjes së gradave në jetën e kësaj bote, nuk do t’i sjellë asnjë dobi shpirtërore njeriut. Pra, ky nuk duhet të jetë qëllimi i vërtetë i diturisë...



Profeti ynë ﷺ, për të na treguar nivelin e dijeve të tij, thotë:

“...Beto hem në Allah, se sikur t’i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë!..” (Ibn Maxhe, Zuhd, 19.)

Dhe, një prej cilësive të tij dalluese ndërkohë që zotëronte këtë nivel të lartë dijeje, ishte botëkuptimi i modestisë.

ARSIMIMI I VËRTETË

Në bisedat që zhvillonte, i nderuari Sami Efendiu, shprehej se; dituria e vërtetë, është të ndjesh në zemër fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Madhëruar. Madje, mirësinë e kësaj diturie, e shprehte sa herë që kishte mundësi. Një ditë, një person që kishte ardhur për ta vizituar, dëshironte të merrte duanë e hoxhës së nderuar dhe në të njëjtën kohë, ta njihte atë edhe me nipërit e vet. Kur hynë brenda, u përshëndetën me selam dhe, duke ia prezantuar nipërit e vet, i tha:

-I nderuar! Këta djem kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Dëshirojmë të marrim edhe duanë tuaj!

Mirëpo, i nderuari Sami Efendiu, me një buzëqeshje shumë domethënëse, tha:

-Edhe unë i varfri jam diplomuar në Daru'l-Funun/Universitet. Por arsimi i vërtetë, është «marifetullahu» (njohja e Allahut)!

Në ditët tona, kur materializmi, kapitalizmi dhe globalizimi kanë shtuar ambiciet e kësaj bote dhe zemrat janë ndotur së tepërmi, edhe qytetërimi po kuptohet në mënyrë të gabuar. Risitë që janë arritur në saje të zhvillimit industrial, perceptohen si qytetërim. Por, t'i mbash shpresat tek makineritë, është një dobësi shumë e madhe, sepse ato janë vetëm copë hekuri pashpirt. Ndërsa atë që bëhet rob i tyre, e shkatërrojnë në batakun e mendjemadhësisë, mburrjes dhe padrejtësisë.

Vlera e njeriut tek Allahu, nuk matet me pasurinë që ai zotëron në këtë botë; fisnikërinë, pushtetin, zgjuarsinë apo mendjen ku depoziton diturinë. I vetmi kriter vlerësues për njeriun, është devotshmëria ndaj Allahut.

*Urtësitë dhe dijet
e panumërta që
zotërojnë të gjithë
dijetarët në luginën
e fjalës, janë vetëm
një grimcë
e vogël urtësie
nga i Dërguari
i Allahut ﷺ.*



MISTERI QË I JEP VLERË NJERIUT: DEVOTSHMËRIA

Historia e mëposhtme do ta shpjegojë shumë bukur këtë çështje:

Në tregun e Medinës u soll një skllav i fuqishëm, i cili kishte pranuar Islamin. Ata që e donin për vete ishin të shumtë. Por skllavi thoshte:

- Kam një kusht për atë që do të më blejë.

Njëri nga ata që kërkonte ta blinte, pyeti:

- Ç'është ky kusht?

Skllavi tha:

-Të mos më ndalojë që të fal namazin farz pas Resulullahut ﷺ.

Njeriu që pyeti, e pranoi kushtin dhe e bleu skllavin. Resulullahu ﷺ, e shihte gjithmonë këtë skllav, në namazet farz. Mirëpo, një ditë nuk e pa dhe për këtë pyeti zotërinë e tij:

- Ku është skllavi yt?

Sahabiu tha:

- O Resulullah! Atë e kanë kapur ethet.

Resulullahu ﷺ, i thotë shokëve të tij:

- Ngrihuni të shkojmë e ta vizitojmë.

U ngritën dhe shkuan së bashku tek skllavi dhe i uruan shërim të shpejtë. Disa ditë më vonë, Resulullahu ﷺ, e pyet përsëri zotërinë e skllavit:

- Si është gjendja e skllavit tënd?

Sahabiu përgjigjet:

- O i Dërguar i Allahut, atij i është afruar vdekja.

Për këtë arsye, Resulullahu ﷺ, u ngrit dhe shkoi tek skllavi duke qenë se ai ishte në momentet e fundi të jetës. Kur skllavi vdiq, Resulullahu ﷺ, mori përsipër që, larjen, qefinosjen dhe varrosjen ta bënte vetë personalisht.



Shpresa e vetme e shpëtimit në këtë kohë kur mbizotëron e keqja dhe padrejtësia, është qëndrimi në rrugën e drejtë me anë të dijes dhe devotshmërisë Islame që na ka mësuar i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili, pjesëtarët e umetit të tij që do të jetojnë në kohën e fundit, i ka quajtur "vëllezërit e mi".

Sahabët e nderuar u çuditën shumë nga ky veprim. Në atë moment muhaxhirët thanë:

“Ne kemi lënë atdheun, pasurinë e familjen tonë dhe kemi ardhur deri këtu, por asnjëri prej nesh nuk ka parë më shumë respekt prej Resulullahut ﷺ, se sa ky skllav; as në jetë, as në sëmundje dhe as në vdekje.”

Ndërsa ensarët mendonin:

“Ne e strehuam Resulullahun ﷺ, e ndihmuam dhe e mbështetëm Atë me pasurinë tonë, mirëpo ai pëlqeu më tepër një skllav etiopas sesa neve”. (Uahidi, fq. 41-412.)

Pikërisht për këtë arsye është zbritur edhe ajeti 13 i sures Huxhurat.

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقِيكُمْ

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...”
(Huxhurat, 13)

Nga kjo kuptohet qartë se; devotshmëria është kusht për të fituar vlerë tek Allahut i Madhëruar. Ndërsa dija, është një domosdoshmëri për të mësuar se cila prej sjelljeve është më e përshtatshme për devotshmërinë.

Çdo gjë ka aspektin e saj të dukshëm dhe një urtësi. Burimi i të gjitha dijeve ekzoterike dhe ezoterike, është Allahu i Madhëruar, i Cili ka zbritur Kuranin në zemrën e Profetit tonë ﷺ. Ndërsa vetë Profeti ynë ﷺ, e përvetësoi dhe e zbatoi



Për të qenë i pastër si pika e shiut, në një kohë kur lulëzon injoranca dhe bota është ndotur së tepërmi, duhet të zotërosh një devotshmëri e cila gëzon ekuilibrin mes zemrës dhe trupit. Në Kuran urdhërohet:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقِيكُمْ

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...”

Kuranin në mënyrën më të përsosur. Aq sa u bë Kuran i gjallë që ecte mbi tokë. Prandaj, jeta e tij e bekuar, është vetë rru- ga e drejtë që do të na çojë të gjithëve në lumturinë e të dyja botëve. Vetëm në saje të një diturie të shoqëruar me devotshmëri ndaj Allahut, mund t'i përngjajmë të Dërguarit të Allahut dhe të arrijmë lumturinë e rrugës së drejtë.

Domethënë; një besimtar duhet të pajiset me dituri dhe të jetë gjithmonë në gjurmët e Profetit tonë ﷺ, në çdo fazë të jetës së vet. Kështu, ai do të bëhet një njeri i përkryer dhe i afërt me Allahun. E, kush bëhet njeri i afërt me Allahun, edhe Ai do ta ndihmojë atë. Këtë të vërtetë, e kuptojmë më mirë kur shohim dijetarët e vërtetë, siç janë imamët e medhhebeve, muhadithët, mufessirët, etj., të cilët Allahu i ka bërë të përjetshëm në zemrat e besimtarëve të vërtetë, deri në ditën e kiametit. Kjo do të thotë se njerëzit kanë shumë nevojë për diturinë dhe këshillat e urta të këtyre personaliteteve të lartë.

Në saje të këtyre dijetarëve, ummeti Islam ka kapërcyer shumë probleme të vështira. Ata që kanë pasuar këta dijetarë dhe udhëheqës shpirtërorë, nuk kanë devijuar kurrë nga rru- ga e drejtë.

Sot, në botën e globalizuar, kur e keqja është shtuar në çdo fushë të jetës, ne jemi të detyruar të edukojmë veten dhe fëmijët tanë me dije dhe devotshmëri.

Dituria është si një thikë me dy presa. Bota ka njohur shumë njerëz tiranë, të cilët i kanë shfrytëzuar dituritë e kësaj bote për të shtuar edhe më tepër mizoritë e tyre. Njerëz të tillë, janë shënuar në histori si armiq të dhe turpi i njerëzimit. Dituritë që përdoren ata për të ndërtuar kulla me kafkat e njerëzve, u sollën katastrofën dhe njerëzimit, edhe vetë atyre.



DITURIA DHE DEVOTSHMËRIA ISLAME...

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:


Ummeti im i ngjan shiut, që nuk dihet se cila pjesë është më e mirë; fillimi apo fundi i tij.” (Tirmidhi, Edeb, 81/2869)

Sahabët e nderuar, ishin fillimi i atij shiu. Ata u pastruan nga ndotjet e periudhës së injorancës në saje të dijes dhe devotshmërisë Islame me të cilat i edukoi i Dërguari i Allahut ﷺ. Në këtë mënyrë, ashtu si bulëzat e shiut, ata shkuan tek Zoti i tyre me zemër të pastër.

Edhe sot në ditët tona po përjetohej një periudhë e ngjashme me atë të injorancës para Islame. Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Unë jam profeti i pas ikindisë!” (Ibn-i Kethir Tefsiri, XII/6549; shih. Buhari, Enbiya, 50, Teuhid, 31)

Qielli mbi ne, është po i njëjti qiell që në të shkuarën ka derdhur shkatërrim dhe vuajtje për ata që e kanë mohuar Allahun gjatë gjithë historisë njerëzore. Po ashtu, edhe dielli sipër nesh, është i njëjti diell që dikur ka ndriçuar sarajet e tiranëve si Faraoni, Hamani, Karuni Nemrudi, etj., e që më pas lindi përsëri me madhësi mbi rrënojat e tyre.



Nga kjo, kuptojmë se edhe vetë ardhja e tij, është një shenjë e kiametit. Për më tepër, pas tij ka kaluar edhe një periudhë kohore prej afro 1500 vitesh. Madje, tashmë kanë filluar të shfaqen edhe disa shenja të kiametit të cilat citohen në hadithet e tij lidhur me këtë çështje.

Për të qenë i pastër si pika e shiut, në një kohë kur lulëzon injoranca dhe bota është ndotur së tepërmi, duhet të zotërosh një devotshmëri e cila gëzon ekuilibrin mes zemrës dhe trupit. Shpresa e vetme e shpëtimit në këtë kohë kur mbi-zotëron e keqja dhe padrejtësia, është

qëndrimi në rrugën e drejtë me anë të dijes dhe devotshmërisë Islame që na ka mësuar i Dërguari i Allahut ﷺ. Profeti ynë ﷺ, pjesëtarët e umetit të tij që do të jetojnë në kohën e fundit, i ka quajtur “vëllezërit e mi”, gjë e cila është një nder i madh për ne nëse e meritojmë atë. Prandaj, ne duhet të edukojmë edhe veten edhe fëmijët tanë në një mënyrë të atillë, që të mund të bëhemi vëllezërit e tij për të cilët e ka marrë malli.

E ARDHMJA JONË

Rinia është treguesi më i qartë i të ardhmes së një kombi. Rinia e çdo periudhe jeton në përputhje me karakterin e vet, në një botë të veçantë emocionesh, ku mund të shpenzojë edhe energjitë e veta.

Për këtë arsye, çdo komb merr formë sipas botës shpirtërore dhe intelektuale të rinisë. Nëse rinia e një kombi e harxhon energjinë për mirë, e ardhmja e atij kombi është e ndritur. Mirëpo, në të kundërtën, nëse energjinë e harxhojnë në gjëra boshe, atëherë e ardhmja e atij kombi është e zymtë.

Dituria është e obliguar/farz në çdo moshë; por koha më frytdhënëse e dijes, është rinia... Prandaj, shpenzimi i rinisë vetëm në arsimimin për të arritur mirësitë e kësaj bote, është një shpërdorim shumë i madh...

Konsiderimi i edukimit shpirtëror si pengesë për edukimin në dijet e kësaj bote, duke e lënë atë mënjanë dhe duke e braktisur, është një përgjegjësi shumë rëndë. Po ashtu, t'i kon-

*“Duhet ndjerë
dhembshuri për
hallin që shfaqet
me dobësimin e
besimit, sepse ai hall
nuk ka zgjidhje!”*

Rumi



siderosh të mjaftueshme mësimet fetare që bëhen gjatë verës për disa javë në një xhami, ndërkohë që për arsimimin në dijet e kësaj bote sakrifikon vite të tëra dhe pasuri të madhe, është një gabim shumë i rëndë!

Krahas këtyre, duhet thyer edhe mentaliteti se devotshmëria dhe fetaria është diçka vetëm për të moshuarit. Në të vërtetë, devotshmëria duhet të jetë cilësia e çdo myslimani që prej moshës së pjekurisë. Fëmijët tanë duhen edukuar mirë me dije dhe devotshmëri Islame, sidomos në kohën e rinisë, kur gjaku vlon në maksimum.

Sepse;

Ndjekja e rrugës së drejtë, është e vetmja derë shpëtimi, paqeje, lumturie dhe mëshire për birin e njeriut. Pasimi i

rrugës së ndritur të Profetit tonë ﷺ, na shpie drejt një jete të mbushur me virtyte të larta dhe na bën të kuptojmë më mirë enigmën e të qenit një Kuran i gjallë. Një dije dhe arsim, të cilin e lexon zemra, e jo vetëm syri dhe mendja... Ky është arsimimi më madhështor dhe më cilësor. Me këtë edukim u pajisën edhe sahabët e nderuar, të cilët u përhapën në të gjithë botën dhe i treguan asaj bukuritë dhe mesazhet sublime të Islamit.

Për rrjedhojë, edhe sot, bota pret të njëjtin shërbim nga ne...

Një shërbim ku kërkohet vetëm kënaqësia e Allahut dhe ku nuk bëhet asnjë dallim mes zemrave, kur tregohet dashuri dhe mëshirë; pra, një shërbim sikur

*Zemrat që shohin,
dëgjojnë dhe ndjejnë,
nuk shohin gjë tjetër
përveç manifestimeve të
fuqisë dhe madhësisë
hyjnore në këtë gjithësi.
Sa keq për ata që nuk
mund të flasin me
trëndafilat, zambakët,
e bilbilat dhe nuk e
kuptojnë gjuhën e
gjendjes së tyre që në
këtë botë!*



dielli që ndriçon çdo errësirë dhe ngroh çdokënd.

Një shërbim që synon mjekimin e zemrave të plagosura dhe fshirjen e lotëve nga sytë e përlotur...

Një shërbim që i hap krahët të vuajturit dhe që nuk e lëndon nevojtarin...

Një shërbim që nxit dashurinë e krijesave për hir të Krijuesit dhe i përfshin të gjitha në mëshirën e vet...

Me pak fjalë; një shërbim që e konsideron si shkallë të afrimit me Krijuesin shërbimin ndaj krijesave.

Dhe, zemrat që do të shërbejnë në këtë rrugë, kanë nevojë për dijen dhe devotshmërinë Islame...

I lutemi Allahut të na e bëjë të mundur këtë shërbim neve dhe të gjithë brezave të rinj!..

Allahu na zbukuroftë me dije të dobishme dhe devotshmëri. Allahu na ruajt nga dijet e padobishme, injoranca dhe devijimi!

O Allah! Na ruaj nga ndotja e kësaj fund-kohe dhe na bëjë prej robërve fatlumë që arrijnë të takohen me Profetin ﷺ, në burimin e Keutherit, me zemër të pastër si bulëzat e shiut!

Amin!..

Sa keq për ata që janë plotësisht indiferent ndaj manifestimeve të cilësive "el-Bari" dhe "el-Musauuir", të Allahut të Madhëruar dhe për ato zemra të mefshta që nuk ndjejnë asgjë prej gjuhës së heshtur të erërave, përrenjve dhe maleve!..





MEDITIMI

Çdo gjë, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, tregon manifestimin e madhështisë dhe fuqisë hyjnore. Zija Pasha, e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Në çdo flet të librit të këtij universi, janë shënuar me mijëra mësimë prej manifestimeve të dijes dhe urtësisë hyjnore. O Zot! Sa shkollë e mirë është ky univers për ata që zhyten në oqeanin e meditimit dhe për ata të cilët marrin mësim duke soditur vitrinat hyjnore!”



MEDITIMI

BINDJA NDAJ TIJ, ËSHTË BINDJE NDAJ ALLAHUT

Në një ajet fisnik urdhërohet:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

Bindja ndaj Profetit ﷺ, është bindje ndaj Allahut të Madhëruar!

Sepse ai, është usue-i hasene/shembulli më i bukur për çdo gjë; ai është dërguar për t'i mësuar të gjithë njerëzimit, me fjalë dhe me vepra, devotshmërinë më të bukur, moralin më madhështor dhe sjelljet më të virtytshme.

Ai është shembull për gjithë njerëzimin në lidhje me jetën familjare, punën, shoqërinë dhe qeverisjen...

Ashtu siç është Kurani mrekulli e fjalës, ashtu edhe ai është mrekulli njerëzore; shembulli më i bukur!..

Kush dëshiron të mësojë sekretin e jetës ideale familjare, le të shohë familjen e tij...

Ata që kërkojnë shoqërinë ideale, le të shohin shoqërinë e epokës së lumturisë që ndërtoi ai...

Pra, çdo njeri, nga i vogli deri tek më i madhi, mund t'i zgjidhë problemet e jetës së vetë duke marrë shembull prej jetës Profetit tonë ﷺ.

Zoti ynë i Madhëruar dëshiron që;

Kur pranojmë Islamin dhe themi, «لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ» La ilahe – S'ka zot”, t'i eliminojmë të gjitha dëshirat e ulëta të egos.

Dhe kur themi, «إِلَّا اللَّهُ» Il-lallah – përveç Allahut”, të shfaqim cilësitë e bukura në zemra tona, në mënyrë që zemra të jetë vendi i Allahut.

Më pas, duke thënë «مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ» Muhamedun Resulullah – Muhamedi është i Dërguari i Allahut”, të plotësojmë besimin tonë, duke e njohur Profetin ﷺ, me gjithë zemër dhe duke e pasuar sunitin e tij.


Nëse dëshirojmë të fitojmë vlerë tek Allahut, duhet ta mbajmë në zemër Profetin tonë ﷺ, të pajisemi me moralin e tij dhe të jetojmë në rrugën e tij.

Për tokën në këmbët e trëndafilin, është një fatmirësi shumë e madhe që të laget vazhdimisht me vesën që bie prej petaleve të tij, duke marrë njëkohësisht edhe aromën e tij.



ZEMRA JONË DUHET TË MBUSHET ME DASHURINË NDAJ TIJ

Nëse do ta shprehim në mënyrë metaforike; kur flasim për trëndafilin, nuk kemi për qëllim as rrënjën, as kërcellin, as gjembin dhe as gjethen, por vetëm trëndafilin. Gjethja e ka për nder të jetë bashkë me trëndafilin. Ndërsa për kërcellin është një mirësi e madhe t'i shërbejë atij. Po ashtu, edhe për tokën në këmbët e trëndafilit, është një fatmirësi shumë e madhe që të laget vazhdimisht me vesën që bie prej petaleve të tij, duke marrë njëkohësisht edhe aromën e tij.



Sa bukur shprehet poeti i njohur Sadi Shirazi në veprën e tij Gylistani:

Një ditë, një prej miqve të mi më dha një copë balte me aromë të mirë (për pastrim) në hamam. E unë e pyeta baltën me aromë të këndshme:

“Ah moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...”

Balta i tha:

“Unë nuk jam as misk, e as amber, por veçse një copë tokë; por gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafili dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin vjen prej atij trëndafili...”

Ndërsa Rumi shprehet kështu:

“O njeri indiferent! Shiko mrekullitë e Musait dhe Ahmedit. Si u bë bastuni gjarpër dhe si fitoi urtësi trungu i hurmës, e rënkoj?”

“Profeti Muhamed ﷺ, e ledhatoi trungun Hannane, që rënkonte për shkak se mbeti larg prej tij. Ti o njeri, nuk je më poshtë se një pemë! Bëhu edhe ti si trungu Hannane dhe rënko prej ndarjes!..”

Rënko, sepse edhe ai iu përgjërua Allahut të Madhëruar për ty, duke thënë: “Umeti, umeti/populli im, populli im...”!

Padyshim se njeriu, i cili është “ahsen-i takuim/krijesa më e mirë”, duhet ta dijë vlerën e Profetit ﷺ, që është “usue-i hasene/shembulli më i bukur”, duhet ta kuptojë atë dhe të rënkojë e të digjet për t’iu afruar atij, sepse kjo e bën atë të dallohet nga krijesat e tjera. Dhe për ta shprehur këtë, Rumi ka thënë:

“Druri digjet, e bëhet hi; zemra digjet, e fiton devotshmëri.”

Prej një trungu të vdekur që ka humbur gjallërinë, nuk pritet asgjë. Njeriu indiferent ekziston për Xhehenemin. Mirëpo një besimtar me zemër të gjallë, me sy të hapur drejt të vërtetave shpirtërore dhe me veshët në shërbim të së vërtetës dhe të mirës, arrin të shpëtojë prej papjekurisë dhe fillon të piqet në saje të të vërtetave që ka kuptuar. E më në fund ai digjet. Tashmë, ai është një shpirt i pjekur, tek i cili fillojnë të qartësohen shumë mistere dhe urtësi hyjnore. Rumi e përkufizon këtë me tri faza:



Kur pranojmë Islamin dhe

themi; « لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ »

La ilahe – S’ka zot”, t’i eliminojmë të gjitha dëshirat e ulëta të egos.

Dhe kur themi

« إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاغِبُونَ »

– përveç Allahut”, të shfaqim cilësitë e bukura në zemra tona, në mënyrë që zemra të jetë vendi i Allahut.

“Isha i papjekur, u poqa, u dogja!”

Natyrisht se djegia e tij nuk është si djegia e një druri që bëhet shkrumb e hi. Por një djegie që e bën rob të atillë, sa të meritojë lëvdatën «نِعْمَ الْعَبْدُ» robi më i mirë”. Një djegie që të bashkon me të dashurin dhe përfundimi i së cilës është Xheneti. Njësoj si djegia e fluturave të natës në zjarr.

SI FLUTURA E NATËS

Poeti dhe mendimtari i madh Muhammed Ikbal, përdor një përngjasim në lidhje me ata që qëndrojnë larg e në errësirë dhe ata që rendin drejt dritës e bëhen dritë duke u djegur me dashuri:

“Një natë, në bibliotekën time dëgjova që një molë i tha kështu një fluturë nate:

«Unë zura vend brenda librave të Ibn Sinas dhe kam parë librat e Farabiut. (Shëtita midis rreshtave të thatë që nuk dinin të mbaronin dhe shkronjave të zbehta në ato rreshta, duke i brejtur ato. Në këtë mënyrë, shëtita rrugë më rrugë e sokak më sokak në qytetin e Farabiut, të cilin ai e quan “el-Medinetu’l Fadëla”). Mirëpo, nuk arrita ta kuptoj dot filozofinë e kësaj jete dhe u bëra udhëtari i dëshpëruar i sokakëve të frikshëm e pakrye. Nuk kam një diell, që të më ndriçojë ditët!..»

Si përgjigje ndaj kësaj ankese të molës, flutura e natës i tregoi asaj krahët e saj të djegur:



«Shiko!»- i tha: «Unë dogja krahët për këtë dashuri.» Pastaj vazhdoi e tha:

«Ato që e bëjnë jetën më të gjallë, janë përpjekjet dhe dashuritë. Ndërsa ajo që i jep krahë jetës është ashku!..»

Në këtë mënyrë, duke i treguar molës krahët e saj të djegur, flutura donte t'i thoshte:

“Shpëtoje veten nga shkatërrimi në sokakët pakrye të kësaj filozofie! Pajisu me ashkun, dashurinë dhe frymëzimin prej detit shpirtëror dhe hapi krahët drejt takimit hyjnor!..”

“Druri digjet, e bëhet hi; zemra digjet, e fiton devotshmëri.” Njeriu indiferent ekziston për Xhehenemin. Mirëpo një besimtar me zemër të gjallë, me sy të hapur drejt të vërtetave shpirtërore dhe me veshët në shërbim të së vërtetës dhe të mirës, arrin të shpëtojë prej papjekurisë dhe fillon të piqet në saje të të vërtetave që ka kuptuar. E më në fund ai digjet. Tashmë, ai është një shpirt i pjekur, tek i cili fillojnë të qartësohen shumë mistere dhe urtësi hyjnore. Rumi u përkufizon këtë me tri faza: “Isha i papjekur, u poqa, u dogja!”



Në këtë shembull, dijetarët që nuk e përjetojnë dijen e tyre, nuk e zbatojnë atë dhe janë larg sinqeritetit dhe devotshmërisë, përngjasohen me molën. Ndërsa zemrat e dashuruara me pasion që digjen me devotshmëri dhe frikë-respekt ndaj Allahut dhe të cilat punojnë me dijen e tyre, përngjasohen me fluturën e natës.

Shembulli më i bukur i atyre fluturave të natës që rënkonin nga frika se mos ndaheshin prej të Dërguarit të Allahut, është Theubani ﷺ.

Një ditë, Theubani ﷺ, erdhi tek Profeti ﷺ, i cili vuri re se ai ishte shumë i mërzhitur dhe i dëshpëruar. Për këtë arsye, e pyeti:

- Si e ke hallin o Theuban? Theubani ﷺ, filloi të tregonte me gjithë shpirt:

- Nëna, babai dhe kjo jeta ime të qofshin falë o i Dërguar i Allahut! Kur gjen-dem bashkë me ju, ndihem në botë tjetër. Kur shkoj në shtëpi digjem nga mal-li. Çdo çast që kaloj larg dritës suaj më duket një ndarje më vete... E kur në këtë botë ndodh kështu, kam frikë si do të jetë halli im në botën tjetër. Atje ju do të qëndroni bashkë me profetët e tjerë. Ndërsa unë nuk dihet se ku do të jem e ku do të përplasem! Mbi të gjitha, nëse nuk arrij të hyjë në Xhenet, atëherë do të privohem plotësisht prej takimit me ju! Kjo gjendje më djeg e më shkruvbon o i Dërguari i Allahut!

Profeti ﷺ, heshti për pak çaste dhe pastaj tha:

“O Theuban! Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 165.)

Mbase Theubani ﷺ, nuk kishte qoftë edhe një pemë të mbjellë në këtë botë. Mirëpo ai ishte njeriu më i pasur në botë, sepse ai kishte arritur të fshehtën e dashurisë së Profetit ﷺ, dhe të qenit bashkë me të. Kur e krahasojmë veten tonë me Theubanin ﷺ, duhet të pyesim veten, “vallë po ne ku ndodhemi me këtë dashuri? Sa na shqetëson frika se mos biem larg prej tij në botën tjetër?”

Kur e shohim nga jashtë një pyll, për ne shpreh bukurinë e një pikturë. Por kur afroresh, sheh bukurinë e çdo peme, luleje dhe fruti. E nuk mbaron me kaq, por fillon të ndjesh aromat e këndshme, të dëgjosh cicërimat e zogjve dhe të shijosh frutat e ndryshme.

Shoqëritë nuk mund të arrijnë shpëtimin me shpirtin e pedantëve të cilët rrinë mbi librat me kapakë të errët të filozofisë që kanë mbetur në raftet e pluhurosur të bibliotekave.

Ai që do ta shpjerë njeriun në lumturinë dhe shpëtimin e vërtetë, është shpirti i të devotshmëve që kanë arritur urtësinë dhe përsosmërinë duke u brumosur me kulturën e Kuranit dhe Sunetit.



Pikërisht kështu e njohën edhe Sahabët profetin ﷺ; pra, jo nga larg, por nga afër. Ata qëndruan vazhdimisht me të dhe secili prej tyre mori prej dritës dhe u pajis me moralin e tij sipas aftësive vetjake. Ata që e donin Profetin ﷺ, si Theubani ﷺ, ishin të gatshëm të sakrifikonin çdo gjë për të qenë afër tij.

ME DASHURINË PËR PROFETIN ﷺ

Edhe pse ishte kadiu i Bursës, Mahmud (v. 1628), kaloi në dergjahun e Uftades faza të ngjashme për të arritur gradën e hiçit. Ai shiti mëlçi bagëtish në rrugët e qytetit duke qenë i veshur me rrobën e gjykatësit. Pas përpjekjeve të shumta për të shuar unin, krenarinë dhe mendjemadhësinë, ai fitoi titullin Aziz Mahmud Hydaji, i cili i respektua nga mbretërit dhe padishahët e kohës.

Në të njëjtën mënyrë edhe Halid Bagdadi (v.1827), në një kohë kur të tjerët e thërrisnin “Dielli i Diejve”, shkoi në dergjahun e Abdullah Dehleviut (v. 1824). Por shejh Dehleviu nuk doli për ta pritur atë as deri tek dera. Nuk e lejoji atë të hipte në kursin apo mihrabin e dergjahut. Fillimisht, për t’ia thyer unin dhe për t’ia mësuar atij vetëdijen e të qenit një hiç, e ngarkoi me detyrën e pastrimit të tualeteve. Kështu, Mevlana Halidi, ia filloi punës pa u mburrur aspak me diturinë e vet. Ai shërbeu për muaj me rresht duke nxjerrë ujë prej pusit dhe duke e bartur atë me kova druri si peshore, që shkaktonin plagë në supet e tij. Mirëpo, pas këtyre shërbimeve, mësuesi i tij u interesua për të personalisht dhe e

*A nuk është qefini
rroba më fisnike
e tregut të kësaj
jete, që i anulon të
gjitha shit-blerjet
e përkohshme të
kësaj bote?*



edukoi atë brenda një kohe të shkurtër. Pasi e plotësoi edukimin shpirtëror, mësuesi e ngarkoi me detyrë dhe e dërgoi në vendlindje. Madje, kur ishte duke e për-cjellë, eci bashkë me të për disa kilometra jashtë qytetit dhe tha:

“Ai mori çdo gjë që kisha në gjoks.”

Pasimi me dashuri i Profetit tonë ﷺ, bëhet shkak i dashurisë dhe faljes hyjnore. Dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, të bën zemërbutë, me ndjenja të thella dhe të aftëson në përjetimet shpirtërore. Poeti i madh Fuzuli ishte pajisur me dituri aq të thella në lidhje me historinë e Resulullahut ﷺ, sa në çdo gjë shihte vetëm atë; madje edhe në rrjedhën e ujit:

“Uji rrjedh për të arritur dheun e shkelur nga Resulullahu ﷺ, çdo çast, pa u ndalur, si një ashik endacak, duke përplasar kokën gurë më gurë.”

Një tjetër i dashuruar me Profetin ﷺ, M. Es'ad Erbili, e ka shprehur kështu zjarrin përvëlues të dashurisë që ndjente për Profetin:

*Nga shfaqja e bukurisë sate, o i dashuri im, pranvera digjet flakë!
Trëndafili, bilbili, zymbyli, tokë e gjemba digjen flakë!
Rrezet e bukurisë tënde i djezin tërë të dashuruarit;
Gjuha digjet, gjoksi digjet; këta dy sy të lotuar digjen flakë!*

Edhe i nderuari Ahmedi Jesevi ishte i dashuruar pas Profetit ﷺ. Për shkak se Profeti ﷺ, ndërroi jetë në moshën 63

*Qiejt nuk derdhën
lot për zullumqarët e
shkatërruar. Zemrat
nuk rënkuajnë aspak
dhe për ta nuk qau
askush. Përkundrazi,
me psherëtimat dhe
mallkimet e të shtypurve,
ata u zhdukën në koshin
e plehrave të historisë.
Aty ku mbretëronin ata,
tashmë gëzojnë bufët
dhe qentë.*



vjeçare, kur arriti këtë moshë, edhe ai hoqi dorë nga jeta mbi tokë dhe u mbyll në një vend që i përngjante varrit, duke kaluar aty dhjetë vitet e fundit të jetës së tij si asket.

Një shembull tjetër i kësaj gjendjeje, është edhe dijetari i madh i hadithit, Imam Nevevi (Allahu e mëshiroftë!). Edhe ai mundohej ta ndiqte Profetin ﷺ, me aq përpikëri, sa që gjatë gjithë jetës së tij nuk ka ngrënë kurrë shalqi (bostan), vetëm sepse nuk e dinte se si e kishte ngrënë Profeti ﷺ dhe kishte frikë se mos vepronte ndryshe.

Të gjitha këto shembuj, tregojnë arsimimin shpirtëror; atë me zemër, e jo thjesht atë me mendje. Nuk është mirë që dikush t'i imitojë ata, sepse kjo gjendje e tyre buronte nga zemra dhe përjetohej me sinqeritet të veçantë. Dashuria e tyre u shfaq në sakrificë dhe sakrifica e tyre u solli fitoren.

Vehb bin Kabshe ﷺ, shkoi në Kinë. Nuk u lodh, nuk përtoi... Vëllai i Ibn Abasit shkoi në Semerkand dhe në të njëjtën mënyrë, as ai nuk shfaqti lodhje dhe mërzë. Dashuria për të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe entuziazmi për të arritur përgëzimin e tij, ishte motivimi që e bëri Halid bin Zejd Ebu Ejub el-Ensarin ﷺ, të marrë pjesë në fushatat për çlirimin e Stambollit në moshën tetëdhjetë vjeçare.

Ata nuk patën frikë nga xhelatët, armiqtë dhe tiranët. Frika e tyre e vetme, ishte privimi prej dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, sepse për ta, ky ishte dështimi më i madh në këtë botë.

Dashuria për të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe entuziazmi për të arritur përgëzimin e tij, ishte motivimi që e bëri Halid bin Zejd Ebu Ejub el-Ensarin ﷺ, të marrë pjesë në fushatat për çlirimin e Stambollit në moshën tetëdhjetë vjeçare.



TË NDJESH PROFETIN ﷺ!

Kur ishte duke shkuar në Mevlevihanen e Gallatës, Jaman Dede ishte mbështetur pas një muri në një gjendje të këputur dhe pafuqi. Aty e pa një prej nxënësve të tij, i cili e pyet:

- Me sa duket nuk ndjeheni mirë profesor. A dëshironi t'ju shpie tek doktori?

Jaman Dede i hedh një shikim të thellë nxënësit të tij dhe i thotë:

- Jo mor bir, nuk jam sëmure! Vetëm se kur kujtoj Profetin tonë ﷺ dhe mendoj karakterin dhe personalitetin e tij madhështor e të veçantë, më kaplon një frikë dhe këputem i tëri. Më humbet fuqia dhe nuk qëndroj dot në këmbë.

Ja si i shpreh ndjenjat e tij Jaman Dede në këto vargje të bukura:


*Edhe sikur të mbetem pa ujë,
edhe sikur të jap shpirt në shkretëtirat e djegura,
dhimbje nuk ndjej.*

*Në prehrin e vullkaneve që djegin,
në oqeane, lagështirë nuk ndiej.*

*Sikur zjarri të bjerë nga qielli dhe unë ta prek,
gjë nuk ndiej.*

Më gëzo me bukurinë tënde se u dogja, o i Dërguar!..

Sulltan Javuz Selimi po kthehej nga fushata e Sirisë dhe Egjiptit, që zgjati dy vjet dhe u bënë skenë e shumë betejave të rëndësishme, ku korrën fitore dhe suksese të mëdha. Kur ar-



Sahabët që dërguan letrat e Profetit ﷺ, te mbretërit e kohës, nuk patën frikë nga xhelatët, armiqtë dhe tiranët. Frika e tyre e vetme, ishte privimi prej dashurisë së Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, sepse për ta, kjo ishte dështimi më i madh në këtë botë.

riti në Uskudar, ishte koha e ikindisë. Sapo e mori vesh se populli i Stambollit do t'i bënte një pritje shumë entuziaste, sulltan Selimi i tha lalës Hasan Khan:

“Unë do të hyj në Stamboll pasi të jetë errur dhe të jenë zbrazur rrugët, me qëllim që duartrokitjet e njerëzve, kurorat e fitores dhe komplimentet të mos na bëjnë krenarë e mendjemëdhenj!”

Kur erdhi mbrëmja dhe ra errësira, ai hyri në qytet fshehtas dhe pa ceremoni. Ky sulltan i madh, e kishte kuptuar rëndësi-

në dhe vlerën që kishte pasimi dhe qëndrimi me njerëzit e devotshëm të Allahut dhe për këtë, është shprehur me këto vargje:

Padishahu i botës të jesh, grindje e kotë paska qenë,


Të bëhesh sundimtar i botës, qenka një luftë e kotë;

Të bëhesh skllav i një veliu, është më e madhja gjë në botë!..

Kur Sulltan Javuz Selimi u sëmur nga një sëmundje e keqe e quajtur “antraks” dhe po dergjej në shtratin e vdekjes, për t'i treguar se tashmë nuk kishin ngelur shumë gjëra për të bërë, Hasan Xhani i tha:

- I nderuar! Tashmë është koha për të qenë bashkë me Allahun.

Mirëpo, sulltani ia kthen menjëherë me këto fjalë:



Një tablo besimi nga Epoka e Lumturisë: Një sahabi, për të provuar besnikërinë e një çobani që takoi, i propozoi diçka që bie ndesh me moralin Islam, duke i thënë: “Kush do të shohë?”. Mirëpo, ai çoban i zgjuar, u dridh nga frika e Allahut përballë këtij propozimi të pandershëm dhe, duke ngritur gishtin nga qielli, tha: “A nuk shikon Allahu? Mendo pak, ku është Allahu?”

- Me kë ke pandehur se kemi qenë deri tani, o Hasan Xhan?

Më pas, sulltani i kërkon ndihmësit të tij t'i këndojë suren Jasin, dhe aty jep edhe frymën e tij të fundit, i qetësuar shpirtërisht.

Kush i edukoi këta njerëz të lartë? Në cilën shkollë diplomuan këto personalitete shembullore?

NXËNËS TË VEÇANTË

Një sahabi, për të provuar besnikërinë e një çobani që takoi, i propozoi diçka që bie ndesh me moralin Islam, duke i thënë; “Kush do të shohë?”. Mirëpo, ai çoban i zgjuar, u dridh nga frika e Allahut përballë këtij propozimi të pandershëm dhe, duke ngritur gishtin nga qielli, tha:

“A nuk shikon Allahu? Mendo pak, ku është Allahu?”

Në të njëjtën mënyrë, edhe një shërbyes i jepte racionin e vet ditor të ushqimit një qeni të uritur dhe, kur u pyet se pse vepronte ashtu, ai përgjigjet:

“Edhe mua, edhe atë na ka krijuar i njëjti Zot! Ai është i huaj këtu. Duket që ka ardhur nga larg, prandaj s'më bëri zemra ta lija të uritur.”

Le të mendojmë:

Në cilin universitet janë arsimuar këta njerëz? Çfarë masteri apo doktore kanë bërë?

Një shërbyes i jepte racionin e vet ditor të ushqimit një qeni të uritur dhe, kur u pyet se pse vepronte ashtu, ai përgjigjet:

“Edhe mua, edhe atë na ka krijuar i njëjti Zot! Ai është i huaj këtu. Duket që ka ardhur nga larg, prandaj s'më bëri zemra ta shihja të uritur.”



Natyrisht që janë arsimuar në shkollën e profetike. Pra, këtë pjekuri shpirtërore, e kanë arritur në saje të dashurisë dhe pasimit me përpikëri të Profetit tonë ﷺ.

Ata e vunë nën këmbë krenarinë, egoizmin, koprracinë dhe injorancën dhe e ngritën lart modestinë, sakrificën dhe bujarinë.

Ja pra arsimimi i vërtetë...

Kur e krahasojmë veten me Theubain ﷺ dhe të dashuruarit e tjerë pas Profetit ﷺ, vallë në çfarë niveli është dashuria jonë? Sa na frikëson ideja se mund të jemi larg Profetit ﷺ, në botën tjetër?

Nëse ne e njohim sot Profetin ﷺ, edhe ai do të na njohë nesër në ditën e mahsherit (tubimit). Nëse jemi aq të pjekur për ta parë atë, edhe ai do të na shohë. Nëse e dëgjojmë dhe i vëmë veshin, edhe ai do t'i dëgjojë përgjërimet tona. Shkurtimeisht, t'i bindemi atij, në mënyrë që të fitojmë ndërmjetësimin e tij në ditën e gjykimit, siç urdhërohet edhe në ajetin Kuranor:

“...Që edhe Profeti të jetë dëshmitar për ju!” (Bekare, 143)

Allahu i Madhëruar, urdhëron:

إِقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

«Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!» (Alak, 1)

- Moj bijë, hidhi pak ujë qumështit që kemi për të shitur nesër!

- Nënë, a nuk e ka ndaluar kalifi që të mos i përziejmë qumështit ujë?”

- Moj bijë, e ku do ta marrë vesh kalifi në këtë orë të natës se po i hedhim ujë qumështit?

- Moj nënë! Ta zëmë se kalifi nuk sheh, po Allahu, as Ai nuk sheh?

Omeri ﷺ, i cili po inspektonte qytetin si Kalif, i dëgjoji këto fjalë dhe e mori atë si nuse për të birin. Ja pra, edhe Omer ibn Abdulaziz, i cili konsiderohet si një prej kalifëve të drejtë, është nipi i kësaj gruaje të devotshme.



Kur të Dërguarit të Allahut ﷺ, iu shpall ky urdhër, ai ishte vetmuar në shpellën Hira, në gjendje meditimi. Dome thënë, Muhamedi ﷺ, zemra e të cilit ishte ngushtuar aq shumë për shkak të padrejtësive dhe të këqijave të periudhës së injorancës, tërhiqej në vetmi me pak furnizime dhe, duke shikuar Qaben nga lart, thellohej në meditim për t'u qetësuar disi shpirtërisht.

Me anë të urdhrit të parë hyjnor, “Lexo me emrin e Zotit tënd që krijon!”, njeriu ngarkohet me detyrën e leximit dhe meditimit, sepse në saj të tyre, ai do të kuptojë besimin, adhurimin, moralin dhe çdo gjë tjetër...

*Le të mendojmë:
Në historinë tonë kemi shumë njerëzi të jashtëzakonshëm, që kanë treguar virtyte të mëdha dhe kanë sakrifikuar shumë. Në cilin universitet janë arsimuar këta njerëz? Çfarë masteri apo doktore kanë bërë? Natyrisht që janë arsimuar në shkollën e profetike.*



MEDITIMI; ÇELËSI I BESIMIT

Njeriu posedon tre ndihmës për të medituar:

- Thelbi, esenca e vet njeriut...
- Fjala e Allahut, Kurani Fisnik...
- Shkolla e universitetit, që është edhe libri i gjithësisë...

Njeriut i është dhënë mendja për të kuptuar dhe medituar mbi enigmat dhe urtësitë hyjnore.

Në fakt, i gjithë universi përbëhet prej manifestimeve të formulave të cilësive hyjnore. Në këtë kuptim, universi është si një pllakë xhami, së cilës nuk i është vendosur ende formula kimike, që do ta kthejë atë në një pasqyrë. Kur njeriu, i cili është krijuar

si një formulë hyjnore/enigmë që do t'i japë asaj pllake xhami cilësinë e pasqyrës, e plotëson atë dhe e sheh me syrin e meditim, ajo (gjithësia) shndërrohet në një pasqyrë të plotë për njeriun. Në këtë pasqyrë, njeriu sheh dhe njih dobësinë dhe esencën e vet. Në saje të këtij meditimi: “*Kush njih veten, njih Zotin e tij.*”

Po ashtu, Allahu i Madhëruar ia mësoi Ademit ﷺ, “të gjitha emrat”. Biri i njeriut, në saje të këtyre dijeve dhe cilësive që i ka falur Allahu, do të jetë dëshmitari i Zotit në tokë dhe nën udhëzimin e Librit të Gjithësisë, Kuranit Fisnik, do të përpiqet të lexojë misteret dhe urtësitë në veten e tij. Kjo përpjekje, do ta bëjë atë të përparojë në njohjen e Allahut.

*Një faqe
mësimdhënëse prej
librit të gjithësisë:*

*Pemët janë krijuar për
ne. Pushojmë nën hijen
e tyre dhe hamë prej
frutave të tyre. Ndërsa
prej trungut të tyre
bëjmë sende prej druri.
Pemët pastrojnë ajrin,
duke marrë dyoksidin
e karbonit dhe duke
na dhënë oksigjenin.
Për këtë arsye, ato
cilësohen si mushkëritë
e tokës. Allahu i
Madhëruar urdhëron:
“...A nuk po mendoni?”*

(Saffat, 138.)



BOTA E PËRBËRË PREJ FJALËVE: KURANI

Gjithësia, është si një lloj komentimi i detajuar i mrekullisë së Kuranit Fisnik. Domethënë, Kurani Fisnik është një univers i përbërë prej fjalëve, ndërsa universi është një Kuran pa fjalë.

Kurani Fisnik, është mrekullia kryesore e Profetit të fundit, Muhamedit ﷺ, deri në Ditën e Kiametit. Ndërkohë që libri e mëparshëm hyjnorë kanë pësuar ndryshime rrënjësore, Kurani ka gëzuar mbrojtjen hyjnore.

Kurani Fisnik, me diksionin e mrekullueshëm hyjnor, me butësinë dhe madhështinë e veçantë në poetikën e tij, me thellësinë dhe pasurinë e pafund të kup-

timeve të tij, me oratorinë dhe elokuençën e tij të përsosur, me shërimin që u jep përmbajtja e tij të gjitha problemeve individuale, familjare, sociale, ekonomike dhe politike të njeriut dhe shoqërisë, me lajmet që sjell prej të fshehtës dhe me nxjerrjen në pah që para shumë shekujsh të të vërtetave shkencore dhe të krijimit, të cilat njeriu i ka zbuluar këmbadoras, është një mrekulli e jashtëzakonshme deri në Ditën e Kiametit.

Po ashtu, edhe në soditjen në pasqyrën e zemrës së gjithësisë dhe ngjarjeve, shihet i njëjti dallim në kuptim dhe vetëdije. Se sa është pastruar pasqyra e zemrës prej papastërtive të gjynaheve dhe harameve dhe se sa është ndriçuar ajo me besim, devotshmëri dhe sinqeritet, këtë do ta tregojnë manifestimet që pasqyrohen në të.

Besimtari, ajetet e Kuranit Fisnik mund t'i meditojë aq sa është edhe devotshmëria në zemrën e tij. Shumë njerëz që ulen para të njëjtit Kuran, mund të përfitojnë prej tij në nivele të ndryshme. Mirëpo, ata, që zemrat e tyre i kanë të kyçura, nuk mund të përfitojnë asgjë nga Kurani. Në një ajet fisnik urdhërohet:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَىٰ قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!” (Muhammed, 24)

Kurani Fisnik e fton gjithmonë njeriun të meditojë, të logjikojë dhe të mendojë mbi madhësitinë hyjnore dhe fundin e vet:

*Pemët na ofrojnë
qetësi dhe pamje
shumë të bukura me
ngjyrat jeshile dhe
lulet e stinës. Le të
mendojmë pak! Nëse
nuk do të ekzistonin
pemët, kushedi se sa
e thatë, e shkretë dhe
e privuar prej qetësisë
do të ishte kjo botë!*



A NUK LOGJIKONI?

أَفَلَا تَعْقِلُونَ “A nuk logjikoni?”

أَفَلَا تَذَكَّرُونَ “A nuk mendoni?”

أَفَلَا تُبْصِرُونَ “A nuk shikoni?”

أَفَلَا تَتَفَكَّرُونَ “A nuk meditoni?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, e këndonte Kuranin fisnik me seriozitet, shkoqur dhe me një kujdes shumë të madh. Ai meditonte mbi kuptimet e ajeteve, dhe urdhrat e tyre i zbatonte menjëherë në jetën e vet. Kur arrinte tek ajetet që flasin për madhërimin e

Allahut, ai e përmendte Allahun me fjalët “Subhanallah!”. Kur arrinte tek ajetet që përmbajnë lutje, ai i përgjerohej Allahut. Ndërsa kur këndonte ajetet që flasin për strehimin tek Allahu, ai menjëherë kërkonte strehim tek Ai.

Ndonjëherë, ai fokusohet aq shumë në një ajet fisnik, sa që meditonte mbi atë ajet dhe lutej deri në mëngjes.

Profeti ﷺ, nxirrte mësim prej çdo gjëje që shihte dhe i drejtohej Zotit me falënderim e mirënjohje. Po ashtu, edhe ne duhet të vërejmë madhësitinë hyjnore në çdo gjë që shohim dhe të përpiqemi të marrim ushqimin shpirtëror të botës sonë të ndjenjave dhe të mendjes. Çfarëdo që të shohë një mysliman; qoftë Diellin, Hënën, atmosferën, krijimin e vet, të parët e vet, fëmijët e vet dhe çdo gjë tjetër, duhet t'i lexojë me syrin e zemrës mesazhet hyjnore që i jepen me anë të këtyre mirësive.

Nëse shiu do të ishte i kripur si uji i deti, apo të ishte me sodë, me acid apo i pistë, si do të ishte halli ynë!? Në suren Uakia, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Nëse duam, Ne e bëjmë atë (ujin) të njelmët, andaj përse nuk falënderoni!?” (Uakia, 70.) Prandaj, ne duhet të meditojmë mbi mirësitë e pafundme që kemi, duke filluar prej atyre më të thjeshtave.



Ai duhet të jetë i vetëdijshëm se prej nga dhe si ka ardhur, si vazhdon të jetojë, kush ia ka dhënë fytyrën dhe pamjen, kush ia ka caktuar jetëgjatësinë, për ku është duke shkuar, se jeta dhe gjithësia nuk janë pa urtësi dhe se asgjë nuk është krijuar kot dhe pa kuptim. Ai duhet të mendojë se nuk është lënë pa përgjegjësi dhe të njohë gjithmonë fuqinë dhe madhësinë hyjnore. Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar e përshkruan kështu meditimën e besimtarëve:

“Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) «O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.»” (Al-i Imran, 191)

Meditimi, të bën të mendosh mirësitë dhe të kujton llogarinë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

ثُمَّ لَسْأَلَنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Kur u zbrit ky ajet fisnik, një sahab shumë i varfër e nevojtar, u ngrit në këmbë dhe pyeti:

“(O i Dërguar i Allahut!) A kam unë ndonjë mirësi (për të cilën do të jap llogari)?”

*Le të mendojmë përsëri:
Allahu i Madhëruar na ofron fruta dhe perime të ndryshme në vjeshtë, dimër, pranverë dhe verë.
Fruta sipas kohës në të nxehtë dhe në të ftohtë.
Ai nuk ofron shalqi në dimër dhe portokall në verë. Mirësitë të ndryshme në Ekuador dhe në pole. Secila prej tyre është një ekspozitë e veçantë madhësie, një peizazh i ndryshëm dhe një koleksion i jashtëzakonshëm mrekullish.*



Profeti ﷺ, iu përgjigj shkurtimisht:

“Hija, dy nallanet dhe uji i ftohtë.” (shih. Sujuti, VIII, 619.)

Le të meditojmë pak me çelësin e kësaj përgjigjeje të Profetit ﷺ:

Pemët janë krijuar për ne; pushojmë nën hijen e tyre dhe hamë prej frutave të tyre. Ndërsa prej trungut të tyre bëjmë sende prej druri. Pemët pastrojnë ajrin, duke marrë dioksidin e karbonit dhe duke na dhënë oksigjenin. Për këtë arsye, ato cilësohen si mushkëritë e tokës. Përveç këtyre, ato na ofrojnë qetësi dhe pamje shumë të bukura me ngjyrat jeshile dhe lulet e stinës. Le të mendojmë pak! Nëse nuk do të ekzistonin

pemët, kushedi se sa e thatë, e shkretë dhe e privuar prej qetësisë do të ishte kjo botë!

Krijesat e tjera nuk mund të veshin qoftë një këpucë edhe nëse dëshirojnë. Mirëpo, në saje të aftësive që na ka dhënë Allahu i Madhëruar dhe në saje të lëkurave dhe materialeve të tjera të krijesave që Ai na ka vënë në shërbim, ne mund të prodhojmë lloj-lloj këpucësh sipas nevojave tona. Në këtë mënyrë, ne mund të mbrohemi prej të nxehtit, të ftohtit, gurëve, gjembave dhe papastërtive. A falënderojmë për këto?

Nëse shiu do të ishte i kripur si uji i deti, apo të ishte me sodë, me acid apo i pistë, si do të ishte halli ynë!?

Në suren Uakia, Allahu i Madhëruar urdhëron:

Shejh Sadi: Nëse të vdekurit do mund të flisnin, do të thoshin duke qarë:

*«O njeri i gjallë!
Përmende Allahun sa të punon ende gjuha! Koha jonë na kaloi në indiferencë, e ti mos u bëj si ne!
Stolisi frymëmarrjet e tua të numëruara me përmendjen e Zotit dhe konsideroje si mundësi këtë jetë!...»*



“Nëse duam, Ne e bëjmë atë (ujin) të njelmët, andaj përse nuk falënderoni?!” (Uakia, 70.)

Ne duhet të meditojmë mbi mirësitë e pafundme që kemi, duke filluar prej atyre më të thjeshtave. Nëse mirësitë vlerësohen me falënderim dhe mirënjohje në rrugë të Allahut, edhe dhënia e llogarisë së tyre do të jetë po aq e lehtë. Prandaj, ne duhet të meditojmë rreth gjithësisë me çdo mirësi që ka ajo.

SHKOLLA E UNIVERSIT

Çdo gjë, që prej grimcës më të vogël e deri tek trupi më i madh, tregon manifestimin e madhësisë dhe fuqisë hyjnore. Zija Pasha, e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Në çdo flet të librit të këtij universi, janë shënuar me mijëra mësimë prej manifestimeve të dijes dhe urtësisë hyjnore. O Zot! Sa shkollë e mirë është ky univers për ata që zhyten në oqeanin e meditimit dhe për ata të cilët marrin mësim duke soditur vitrinat hyjnore!”

Shkencëtarët mendojnë se; që nga krijimi i universit kanë kaluar rreth 13 miliardë vite. Ndërsa ekzistenca e njeriut, ka filluar në pjesën e fundit të kësaj hapësire të madhe kohore.

Gazaliu: “Biri im! Tani mendo sikur ke vdekur, por të kanë kthyer prapë në këtë botë. Atëherë, sot mos iu afro kursesi gjynahut dhe gjërave të kota dhe kursesi mos e shpenzo kot qoftë edhe një çast të vetëm, sepse çdo frymëmarrje është një dhunti e paçmueshme!”

Siç thotë edhe sulltan Sulejman Kanuni: Mes njerëzve s'ka gjë më të dëshiruar se pushteti, Por ai s'vlen në këtë botë as sa një gramë shëndeti!..

حَاوِ اِيْحِيْدَةَ مَعْنِيْزِ نَسِيْرِ يَوْقِ دَوْلَتِ كَبِيْ
اَوْ مَلِيْرِ دَوْلَتِ جِهَانِدَابِ نَفْسِ صَوِيْبِيْ



Allahu i Madhëruar, dëshiron që ne të meditojmë mbi këtë fakt. Për rrjedhojë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Vallë, a nuk ka kaluar një periudhë kohore, kur njeriu nuk ka qenë genie e denjë për t’u përmendur?!” (Insan, 1)

Njeriu nuk ekzistonte as si emër, e as si formë. Mirëpo, Allahu e përgatiti këtë botë për të dhe, me qëllim që njeriu të ketë mirësi të shumta për të medituar, arti hyjnor shpërtheu veçanërisht në këtë planet të vogël. Njeriu që mediton mbi këto, e kupton se sa pa-suri të madhe meditimi i ka falur Allahu i Madhëruar.

Kur njeriu mediton edhe për shkakun e këtyre mundësive të mëdha, ai duhet të falënderojë edhe njëherë. Kjo, sepse krijimi i njëmijenjë mundësive dhe hallkave të njëpasnjëshme, nxjerr në pah mirësinë e meditimit, i cili është çelësi i besimit dhe adhurimit që do ta shpëtojnë njeriun dhe njëra prej ndihmave më të mëdha të Allahut ndaj robërve të Tij.

UDHËZUESI YNË NË MEDITIM

Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Nuk ka adhurim tjetër si meditimi!”

(Bejhaki, Shuab, IV, 157)

Ndonjëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigjej pyetjeve të sahabëve duke i bërë ata të meditojnë. Ebu Rezin رضي الله عنه, tregon:

Zemra e tij dëshironte që umeti i tij të kishte takua...

Zemra e tij dëshironte që i gjithë njerëzimi do të udhëzohej.

Zemra e tij dëshironte të bëhej ilaç për problemet e të varfërve, të shtypurve, jetimëve dhe të vetmuarve.

Sepse zemra e tij, e cila është mëshirë për botët, ishte e madhe po aq sa bota. I gjithë krijimi ishte në thellësinë e asaj zemre. Lum ata që i lidhën zemrat e tyre në zemrën e Profetit ﷺ!...



Një ditë e pyeta të Dërguarin e Allahut ﷺ:

“O i Dërguari i Allahut! Si i ringjall Allahu i Madhëruar krijesat? A ka ndonjë shembull të kësaj në këtë botë?” Profeti ﷺ, u përgjigj:

“A ke kaluar ndonjëherë në kohën e thatësirës në luginën ku jeton populli yt? Më pas a ke kaluar përsëri në kohën e verës kur çdo anë është e gjelbëruar?”

“Sigurisht!” – u përgjigja unë.

“Ja pra, ky është shembulli se si e kryen Allahu ringjalljen. Kështu do t’i ringjallë Allahu edhe të vdekurit!” - tha ai ﷺ. (Ahmed, IV, 11.)

Allahu i Madhëruar na bëftë edhe neve prej atyre që lexojnë Kuranin dhe e sodisin gjithësinë duke medituuar mbi to. Allahu i dhëntë meditimit dhe ndjenjave të zemrave tona pjesë prej frymëzimit shpirtëror të Profetit ﷺ!

Amin!..



“...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Enfal, 1.)





FETANET, FIRASET DHE BASIRET

Një person që qëndron buzë detit, mund të shohë vetëm sipërfaqen e detit deri në horizont. Kurse një zhytës i zoti, mund të zhytet në atë det dhe të shohë pamje madhështore brenda tij. Kështu edhe zemrat e besimtarëve; në saje të devotshmërisë, ata mund të thellohen në Kuranin Fisnik. Edhe pse të gjithë lexojnë Kuran para së njëjtës rahle, gjithsecili përfiton prej Kuranit sipas nivelit shpirtëror që zotëron. Kuptimet e Kuranit, i shpalosen robit aq sa ai është i afërt me Allahun.



FETANET, FIQASËT dhe BASIRET

AFTËSIA PERCEPTUESE DHE INTELIGJENCA PROFETIKE

Si rrjedhojë e mëshirës së Tij, Allahu i Madhëruar i ka dërguar njerëzimit profetë që do ta udhëzonin atë në rrugën e drejtë. Një prej cilësive të përbashkëta të këtyre të dërguarve të ndritur, është “fetanet”-i.

Fetanet, do të thotë të zotërosh nivelin më të lartë të inteligjencës dhe mendjemprehtësisë. Po ashtu, ai që e gëzon këtë cilësi, ka memorie të fortë, perceptim të lartë, logjikë të fuqishme dhe aftësi bindëse të jashtëzakonshme.

Fetanet-i nuk është zgjuarsia dhe logjikë e thatë, por një nivel perceptimi përtej gjenialitetit. Është shfaqja e intelektit dhe zgjuarsisë në një mendje të lidhur me zemrën. Një zgjuarsia e tillë, është e domosdoshme për çdo profet, që të mund të zbatojë në mënyrë të përpiktë dhe të përkryer detyrën e predikimit të fesë. Në të kundërt, nuk mund t’u sjellin argumente

të forta atyre tek të cilët janë dërguar dhe nuk mund t'i bindin apo t'i bëjnë të heshtin ata që kundërshtojnë.

MENDJEMPREHTËSIA E PROFETIT IBRAHIM ﷺ

Ibrahimi ﷺ, ishte i vetëm në luftën e tij të besimit dhe monoteizmit. E megjithatë, në saje të zgjuarsisë dhe urtësisë së tij të jashtëzakonshme, ai arriti t'ua mbyllë gojët edhe popullit, edhe vetë mbretit, Nemrudit.

Një ditë feste, kur populli ishte duke u argëtuar, ai shkoi në tempull dhe theu të gjithë idhujt, përveç atij më të madhit, të cilit i vari edhe sëpatën në qafë. Kur populli u kthye dhe pa ç'kishte ndodhur, i kërkuan menjëherë llogari Ibrahimit ﷺ:

“Kush i ka poshtëruar kështu idhujt tanë?”

Ibrahimi ﷺ, u bëri me shenjë nga idhulli më i madh dhe u tha:

“Pyetini atë; ai duhet ta ketë bërë!”

Në këtë mënyrë, populli idhujtar e pranoi faktin se idhujt s'kishin mundësi të flisnin dhe ishin të pafuqishëm për të mbrojtur veten e tyre. Megjithatë, kokëfortësia dhe injoranca i kishte verbuar së tepërmi. Prandaj, ata nuk e lanë me kaq, por u ankuan tek mbreti. Kur mbreti Nemrud e thirri Ibrahimin ﷺ, mes tyre u zhvillua ky diskutim, që tregohet edhe në Kuranin Fisnik:

*Aliu ﷺ, i ka
këshilluar:*

*“Në këshillin tuaj
mos pranoni në
asnjë mënyrë këta
tre persona:*

- 1. Koprracin, 2.
Frikacakun, 3.
Lakmitarin...”*



“A nuk ke dëgjuar ti për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahimimi i tha:

«Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje» - ai u përgjigj:

«Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje». Ibrahimimi pastaj i tha:

«Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!»

Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqberës.” (Bekare, 258.)

Profeti ynë, Muhamedi ﷺ, është zotëria i të gjithë profetëve. Madhështia e moralit të tij, është shpallur nga Vetë Allahu i Madhëruar. Po ashtu, edhe zgjuarsia dhe mendjemprehtësia e tij janë të nivelit më të lartë.

ZGJIDHJA QË NDALOI LUFTËN

Profeti ynë ﷺ, e kishte treguar mendjemprehtësinë dhe urtësinë e tij që para se t’i vinte shpallja nga Allahu i Madhëruar. Në kohën kur populli i Mekës ishte duke rindërtuar Qaben, mes tyre lindi një mosmarrëveshje në çështjen se; cili prej fiseve do ta kishte nderin ta vendoste “Haxheri Esuedin”, pra Gurin e Zi, në qoshen e vet. Çdonjëri prej fiseve të Mekës dëshironte ta kishte vetë këtë nder. Por, asnjë përpjekje për mirëkuptim nuk ia arriti ta zgjidhte këtë problem në mënyrë paqësore. Për rrjedhojë, puna shkoi deri aty sa që u ngritën shpatat dhe nga çasti në çast pritej të derdhej gjaku. Mirëpo, dikush u hodh e tha:

“Bëni kujdes ndaj këtyre tre personave:

- Kopranci ju largon nga bamirësia, duke ju frikësuar me vështirësitë dhe problemet që mund të shfaqen në të ardhmen.

- Frikacaku ju dobëson guximin dhe vullnetin për punë të mëdha.

- Ndërsa lakmitari ju zbukuron lakminë dhe ju nxit në padrejtësi.”



“Meqë nuk arrijmë ta zgjidhim dot mes nesh këtë problem. Atëherë le të biem dakord, që t’ia lemë gjykimin njeriut të parë që do të vijë nga kodra Safa nesër në mëngjes.”


Kur të gjithë ishin duke pritur, u pa të afrohej Muhamedi ﷺ. Në fytyrat e të gjithëve u shfaq një buzëqeshje e ëmbël, sepse të gjithë kishin besim tek urtësia dhe zgjuarsia e tij.

Sapo e mësoi ku qëndronte çështja, Muhamedi ﷺ, e gjeti zgjidhjen, duke i bërë të gjitha palët në konflikt, ortakë në vendosjen e Gurit të Zi në qoshen e vet. Ai zgjodhi nga një përfaqësues për çdo fis, hoqi pelerinën dhe e hapi në tokë. Më pas, e vendosi Gurin e Zi mbi pelerinë dhe i tha përfaqësuesve të fiseve që ta kapnin dhe ta ngrinin pelerinën nga një cep. Kur e afruan në vendin e duhur, Muhamedi ﷺ, e mori gurin dhe e vendosi në vendin e vet. Kështu, në saje të zgjuarsisë dhe mendjemprehtësisë së tij, u parandalua një konflikt i përgjakshëm.

I Dërguari i Allahut ﷺ, deri në kohën që u ngarkua me detyrën e profetësisë, e siguronte jetesën me punën e çobanit, tregtisë, etj. Mirëpo, pasi i erdhi shpallja hyjnore, kreu me sukses shumë detyra të rëndësishme në pozitat e një komandanti ushtarak, kryetari shteti, gjykatësi, mësuesi, etj. Dhe, të gjitha këto, i arriti vetëm në saje të mirësisë dhe mëshirës së Allahut, i Cili e edukoi atë dhe i dhuroi dhunti të tilla si, zgjuarsia, urtësia dhe mendjemprehtësia. Kjo, sepse ai do të ishte modeli i vetëm i përsosur për të gjithë njerëzimin deri në ditën e kiametit.

Gjatë emigrimit për në Medinë, Profeti ﷺ, u përpoq t’u ikte idhujtarëve që i ishin

Sa më larg devotshmërisë, aq më i trashë bëhet njeriu. Budallallëku është e kundërta e zgjuarsisë, gjë e cila nënkupton privimin nga urtësia dhe mos kuptimin e superioritetit të botës tjetër ndaj kësaj bote. Një nga treguesit e budallallëkut në ditët tona, është edhe veshja e rrobave mbi të cilat shkruhen gjëra që shprehin kundërshtim ndaj Zotit, kuptime të ulëta dhe jo morale.



vënë pas, duke ecur në drejtim të kundërt me Medinën dhe u strehua në një shpellë në malin Seur. Në të njëjtën mënyrë, edhe pas disa vitesh, kur u nis për të çliruar Mekën, nuk ia tregoi askujt planin e udhëtimit dhe, përsëri u nis në drejtim të kundërt me Mekën, me qëllim që të parandalonte armikun nga përgatitjet për luftë.

Po ashtu, në Marrëveshjen e Hudejbijes u morën vendime të cilat në fillim nuk arritën t'i kuptonin as sahabët me mendjemprehtësi më të madhe, si Omeri dhe Aliu ؑ. Mirëpo, me anë të asaj marrëveshjeje, i Dërguari i Allahut ﷺ, arriti të largonte të gjitha pengesat përballë thirrjes Islame dhe për rrjedhojë, brenda një kohe të shkurtër, njerëzit filluan të hynin në fenë e Allahut grupe-grupe.

Besimtarë duhet të nxjerrin mësimë prej kësaj cilësie profetike:

FIRASETI/INTUITA E BESIMTARIT

Besimtari duhet të marrë shembull prej cilësisë fet Janet (mendjemprehtësisë) që gëzojnë profetët dhe duhet ta përdorë mirësinë e mendjes në mënyrën më frytdhënëse. Ai duhet të dijë mirë se çfarë të thotë e të veprojë në çdo kohë dhe vend. Kjo është e lidhur me zhvillimin e tij shpirtëror.

Për shembull; metoda që ndoqi Xhafer Tajari ؑ, kur mbreti i Etiopisë i kërkoi t'i fliste rreth Islamit, është një shembull shumë i bukur për të treguar zgjuarsinë dhe intuitën e një besimtari:



Omeri ؓ, ka thënë:
*“Robit mos i shikoni
 namazin që fal dhe
 agjërimin që mban!
 Shikoni nëse thotë të
 vërtetën kur flet, e ruan
 amanetin kur i besohet
 diçka dhe a bën kujdes
 ndaj hallallit dhe
 haramit në çështjet e
 kësaj bote!”*

Kur Nexhashiu, i cili ishte krishterë, i kërkoi Xhafer Tajarit ﷺ, t'i lexonte disa ajete nga Kurani, ai nuk i lexoi suren Kafirun, që shpreh sfidë ndaj mohuesve, por suren Merjem në të cilën bëhet fjalë me mburrje për Isain ﷺ dhe nënën e tij. Atëherë, Nexhashiu i cili i dëgjoji me përshpirtshmëri ajetet kuranore të shqiptuara nga Xhaferi, me lot ndër sy tha:

“Pa dyshim se, këto që dëgjova, janë nga i njëjti burim drite me ato që ka sjellë Isai!”

Dhe, sipas disa transmetimeve, pas një farë kohe, u nderua me Islam. (Ibni Hisham, I, 358-360.)

Një shembull tjetër i zgjuarsisë dhe intuitës, është edhe rasti i Mus'ab bin Umejrit ﷺ, të cilin Profeti ﷺ, e kishte dërguar në Medinë para emigrimit. Kur iu afrova dikush që synonte ta vriste, ai i tha:

“A s'po ulesh pak të dëgjosh ç'kam për të thënë? Ti je njeri i mençur; po të pëlqyen fjalët e mia, i pranon; po s'të pëlqyen, nuk i pranon!”

Barbaros Hajredin Pasha ishte mbizotëruesi i Afrikës së Veriut, i cili për hir të idealit të themelimit dhe vazhdimësisë së uniteti Islam, ia fali vendin e tij Sulltan Sulejman Kanunit, duke e bërë atë pjesë të kalifatit Islam. Pas kësaj, ai shërbeu me aftësi të papara si Komandanti i Forcave Detare Osmane, duke hequr dorë nga sulltanati i Afrikës së Veriut.



Në këtë mënyrë, ai arrinte të qetësonte palën tjetër dhe t'u fitonte zemrat njerëzve, duke mbjellë edhe farën e udhëzimit tek ta.

METODA E KUMTIMIT

Të respektosh radhën e çështjeve primare, të mos e thuash të parën atë që duhet ta thuash të fundit, të flasësh në bazë të botëkuptimit të njerëzve, të qëndrosh larg nxitimit dhe të veprosh me kujdes, tregon urtësinë, intuitën dhe zgjuarsinë e një personi.

Kumtimi i fesë, i realizuar me një metodë larg urtësisë dhe intuitës, në vend që të afrojë njerëzit, i largon ata. Për shembull, këtë e tregon hapur këshilla që i Dërguari i Allahut i dha Muadh bin Xhebelit ﷺ, kur po e niste në Jemen për të kumtuar fenë:

“Pa dyshim, ti po shkon në një vend me popullsi të përbërë nga të krishterë dhe jahudi.”

(Pra, njihi njerëzit dhe mbaje parasysh këtë në metodën e kumtimit.)

“Ftoji ata të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut.”

(Është e nevojshme të fillohet nga çështja e besimit. T’i flasësh për vepra të mira dikujt që nuk e ka zemrën të mbushur me besim, është e nxituar dhe e pakuptimtë.)

“Po qe se binden për këtë, bëjua të ditur se Allahu i urdhëron të falin namaz pesë herë në ditë.”

(Si fillim folu për adhurimet trupore, sepse njerëzit janë më dyshues në çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë. Namazi e forcon besimin e njeriut dhe e shton bindjen dhe dorëzimin në çështje të tjera.)

“Po të binden e ta pranojnë këtë, thuaju se është bërë detyrim për ta zekati, që të merret nga të pasurit dhe t’u jepet të varfërve. Po t’u bindën edhe për këtë, mos ua merr mallrat më të çmuara dhe ruaju nga mallkimi i viktimës, sepse mes mallkimit të tij dhe Allahut nuk ka perde!” (Buhari, Zekat, 41, 63; Muslim, Iman, 29-31.)

*Barbaros Hajredin
Pasha zgjodhi të bëhet
Komandanti i Forcave
Detare Osmane dhe në
saje të sakrificës së tij të
pashoqe, myslimanët e
atyre vendeve jetuan të
qetë dhe të sigurt nga
padrejtësitë që po u bëhen
që prej shpërbërjes së
Perandorisë Osmane.*



MENDJA NËN EDUKIMIN E SHPALLJES

Kur Profetit ﷺ, ia lavdëruan dikë, ai tha:

“Si e ka mendjen?”

Ndërsa Allahu i Madhëruar, në ajetet fisnike shpeshherë na fton ne, robërit e Tij, drejt meditimit me shprehjet:

“A nuk logjikoni?..”

“A nuk kuptoni?..”

“Për të medituar...”

“Mbase mendoheni...”

“Merrni mësim!..”

Kurani Fisnik të zgjeron botëkuptimin, të thëllon meditimin, të mpreh zgjuarsinë dhe të qartëson largpamësinë. Për rrjedhojë, duke aluduar në mendjen e cila ka gjetur vlerën e vërtetë nën dritën e shpalljes, Kurani Fisnik përdor gjashtëmbëdhjetë herë shprehjen; “Ulu’l-elbab / të zotët e mendjes”. Pra, i është drejtuar atyre dhe ka shpallur ajete që flasin për krijimin, të cilat mund t’i kuptojnë vetëm ata.

Edukimi i mendjes nën dritën e shpalljes, është një prej detyrave profetike. Në Kuranin Fisnik, detyrat e profetëve janë radhitur në këtë formë:

- Kumtimi i ajeteve të Allahut të Madhëruar.

Mëshira e Allahut është e pafundme. Mirëpo, Ai kërkon prej nesh një “teube të pastër”; një teube të sigurtë, plot pendesë dhe të vërtetuar me vepra të mira. Ai urdhëron:

“...dhe të mos ju mashtrorë shejtani për Allahun!” (Fatir, 5.)



- Pastrimi i botës së brendshme të njerëzve.

- Mësimi i Librit dhe urtësisë.

Libri është Kurani, ndërsa urtësia, është ana e fshehtë e ndodhive. Nëse këto mësohen nën edukimin profetik, i japin robit thellësi në ndjenja. Dhe, një prej treguesve të këtij thellimi, është intuita. Pra, cilësia e perceptimit të ndodhive para se të ndodhin. Në një hadith fisnik thuhet:

“Ruajuni intuitës së besimtarit! Sepse ai shikon me dritën e Allahut.” (Tirmidhi, Tefsir, 15/3127)

Por, për të arritur këtë gradë, zemra e besimtarit duhet përparojë në devotshmëri. Në Kurandin Fisnik urdhërohet:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيَعْلَمَ اللَّهُ

“..kini frikë Allahun! Allahu ju mëson ju (atë që nuk e dini); Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Bekare, 282)

Ndërsa në një ajet tjetër, urdhërohet:

“O ju që besuat! Nëse keni frikë Allahun, Ai do të vërë udhëzimin (në zemrat tuaja) ta dalloni të vërtetën prej të pavërtetës...” (Enfal, 29.)

Një person që qëndron buzë detit, mund të shohë vetëm sipërfaqen e detit deri në horizont. Kurse një zhytës i zoti, mund të zhytet në atë det dhe të shohë pamje madhështore brenda tij. Kështu edhe zemrat e besimtarëve; në saje të de-

Patjetër që Allahu është falës, por, për një teube të pranueshme është kusht:

- Një pendim i thellë.

- Devotshmëria e palëkundur.

- Fshirja e gjynaheve me anë të veprave të mira.



votshmërisë, ata mund të thellohen në Kuranin Fisnik. Edhe pse të gjithë lexojnë Kuran para së njëjtës rahle, gjithsecili përfiton prej Kuranit sipas nivelit shpirtëror që zotëron. Kup-timet e Kuranit, i shpalosen robit aq sa ai është i afërt me Alla-hun.

Historia jonë e lavdishme është e mbushur me shembuj të jashtëzakonshëm urtësie që kanë shfaqur besimtarët e thell-uar në devotshmëri dhe ndjenja shpirtërore. Ja disa prej tyre:

GJENIALITETI I FATIHUT

Çlirimi i Kostandinopojës dhe meritimi i përgëzimit profe-tik, ka qenë ëndrra e çdo sundimtari mysliman për shumë she-kuj. Për këtë arsye, Kostandinopoja është rrethuar dhe sulmuar disa herë, por pa arritur sukses në marrjen e tij. Pas shumë përpjekjeve dhe strategjive, Mehmedi i II, gjeti një mënyrë sa të

pazakontë, aq edhe gjeniale për të kapër-cyer ngushticën e Bririt të Artë, që atëherë ishte e mbrojtur me zinxhirë të pathye-shëm. Ai i barti anijet nëpër tokë, kapërceu kodrat dhe zbriti në pjesën e brendshme të ngushticës. Në saje të kësaj strategjie dhe të topave të fuqishëm që i kishte zhvillu-ar vetë personalisht, Mehmedi i II arriti të gjunjëzojë bizantinët, të cilët fshiheshin pas mureve të fortë të Kostandinopojës.

Këmbëngulja dhe zgjuarsia e Mehmed Fatihut, nuk spikaste vetëm në fushën ush-tarake. Në kohën e tij, shoqëria ishte në një nivel të lartë të mëshirës, vëllazërisë dhe drejtësisë. Dhe, ajo që i fali osmanëve

“Dashuria ndaj atij që e meriton dhe urrejtja ndaj atij që e ka hak”, është kusht i besimit. Ndjenja e dashurisë ndaj një armiku të fesë, i cili meriton të urrehet, e dobëson besimin. Kjo tregohet më së miri në suren Tebbet.



mundësinë e vazhdimit të çlirimeve për shekuj me radhë, ishte pikërisht drejtësia që ata shfaqën në çdo fushë të jetës. Një dëshmi tjetër e zgjuarsisë dhe urtësisë së osmanëve, është edhe planifikimi i disa projekteve të cilat do të realizoheshin shekuj më vonë:

PROJEKTET E SË ARDHMES

Sokullu Mehmed Pasha, ka përgatitur projekte të kanaleve të mëdha që ishin shumë të përparuara për kohën:

1. Lidhja e Detit të Zi dhe atij Kaspik duke bashkuar lumenjtë Don dhe Vollga.

Synimet e këtij projekti, ishin këto:

- Dërgimi i flotës detare osmane në detin Kaspik për të mbrojtur popullsinë myslimane, e në mënyrë të veçantë haxhilerët, nga rreziku Rus dhe Pers.

- Lidhja e Perandorisë Osmane me Azinë e Mesme në mënyrë më të fuqishme.

- Gjallërimi i Rrugës së Mëndafshit.

(Ky projekt u realizua nga ana e Rusisë në vitet 1950)

2. Lidhja me njëra-tjetrën e Gjirit të Izmitit-Izmitit-Sapanxhës dhe Sakarjas, duke bashkuar Marmaranë me Detin e Zi, në mënyrë që të mbrohet tregtia e Stambollit. Kjo, sepse atë kohë, transporti i lëndës së drurit që përdorej për ndërtimin e anijeve dhe ngrohje nga ana e popullatës, kishte kosto shumë të lartë.

“Njeri i mençur është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes. Ndërsa njeri i dobët, është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe pa arsye (pa kurrfarë merite), shpreson se Allahu do t’ia falë.” (Tirmidhi, Kiamet, 25. Shih. Ibn Maxhe, Zuhd, 31.)



3. Kanali i Suezi. Lidhja e Detit Mesdhe me Oqeanin Indian duke bashkuar Detin e Kuq me atë të Mesdheut. Në këtë mënyrë, shkuarja në ndihmë të myslimanëve të Indisë, Aqes, Indonezisë dhe zonave përreth, do të ishte më e shpejtë. Krahas kësaj, synohej edhe rigjallërimi i Udhës së Erëzave, e cila e kishte humbur rëndësinë për shkak të zbulimeve të reja gjeografike. (Ky projekt është realizuar më 1896 me lejen e Perandorisë Osmane.)

Zhvillimi i këtyre projekteve në kushtet e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, është një tablo e rëndësishme që tregon largpamësinë e të parëve tanë. Por për fat të keq, edhe pse janë hedhur hapa serioz për realizimin e tyre, si pasojë e ndërhyrjeve dashakeqe dhe dritëshkurtër të disa personave, këto projekte mbetën të porealizuara.

Një nga arritjet që tregojnë largpamësinë e osmanëve, është edhe ky:

Pasimi verbërisht ia tyre që i kundërshtojnë këto dy shtylla kryesore, qofshin këta individë apo institucione, nuk ka të bëjë me sinqeritetin dhe dorëzimin, por me dobësinë e besimit.



Në çdo vend që Perandoria Osmane arriti të hyjë, u formuan lagje me myslimanë të sjellë nga zonat e Anadollit dhe u ndërtuan xhami nga ku përhapej zëri i ezanëve.

Këtë veçori të osmanëve, poeti i famshëm Nexhip Fazëll, e ka shprehur me këto fjalë:

“Ushtria që lë pas kube të shndritshme”

Në këtë mënyrë, banorët vendas të atyre zonave fillojnë të njihen me Islamin dhe ata që janë myslimanë lidhen edhe më fort.

LARGPAMËSIA NË ABDIKIM

Shpesh, gjenialiteti dhe zgjuarsia përdoren në shërbim të interesave vetjake. Mirëpo, në historinë Islame njohim tre heronj të mëdhenj abdikimi, të cilët në saje të sakrificës që kanë treguar, janë bërë shembull i një largpamësie dhe urtësie të jashtëzakonshme:

- Hasan ibn Ali عليه السلام, u zgjodh si kalifi i pestë, pas babait të vet, Aliut عليه السلام. Por, përballë tij gjendej Muavija عليه السلام, i cili pretendonte për postin e kalifit. Si pasojë e ngjarjeve që rrodhën, Hasani عليه السلام, i shkroi një letër Muavijes, me anë të së cilës e njoftonte se kishte hequr dorë nga posti i kalifit me qëllim që të mos derdhej gjak dhe të vendosej paqja mes myslimanëve.

- Sulltan Javuz Selimi kishte dalë në fushatën ushtarake drejt lindjes me qëllim që të siguronte unitetin Islam dhe të merrte flamurin e Kalifatit Islam në mënyrë të pakontestueshme. Gjatë kësaj fushate, ai mposhti sulltanatet e Safevive dhe të Memlukëve dhe shtiri në dorë të drejtën e kalifatit. Ndërsa Idris Bitlisi së bashku me fiset që kryesonte, iu dorëzuan pa luftë Sulltan Javuz Selimit, duke deklaruar bindjen ndaj kalifatit. Në këtë mënyrë, duke hequr dorë nga administrimi i pavarur, u bë forcë e idealit të unitetit Islam.

- Barbaros Hajreddin Pasha ishte mbizotëruesi i Afrikës së Veriut, i cili për hir të idealit të themelimit dhe vazhdimësisë së uniteti Islam, ia fali vendin e tij Sulltan Sulejman Kanunit, duke e bërë atë pjesë të kalifatit Islam. Pas kësaj, ai shërbeu me aftësi të papara si Komandant i Forcave Detare



*Në Hutben e
Lamtumirës, i
Dërguari i Allahut
ﷺ, deklaroi se na ka
lënë amanet dy gjëra
që do të na ruajnë
neve, umetin e tij, nga
devijimi. Këto janë;
“Kurani dhe Suneti”.*

Osmane, duke hequr dorë nga sulltanati i Afrikës së Veriut. Në saje të sakrificës së tij të pashoqe, myslimanët e atyre vendeve jetuan të qetë dhe të sigurt nga padrejtësitë që tashmë po u bëhen që prej shpërbërjes së Perandorisë Osmane.

Madje, në saje të drejtësisë dhe mëshirës që përhapën myslimanët, përfituan edhe hebrenjtë e Spanjës, të cilët u përndoqën pamëshirë nga sundimtarët spanjollë dhe kisha katolike. Atyre u erdhi në ndihmë pikërisht Barbaros Hajreddin Pasha me anijet e flotës Osmane, duke i shpëtuar dhe duke i vendosur në Stamboll, ku u pritën dashamirësisht nga popullata myslimane. Me parimin e shikimit të krijesave me syrin e mëshirës së Krijuesit, myslimanët ndanë me ta të gjitha mirësitë që kishin, duke u treguar atyre se sa sublim dhe burim mëshire është Islami.

Edhe Sulltan Sulejman Kanuni ka qenë njeri shumë largpamës. Në kohën e tij, në Evropë ekzistonte një koalicion

i fuqishëm kryqtar, që përbëhej kryesisht nga Francezët, Spanjollët dhe Gjermanët. Në këtë situatë, Sulltan Kanuni i njohu Francës disa privilegje tregtare, duke e ndarë atë nga të tjerët dhe duke e marrë nën mbrojtjen e Perandorisë Osmane. Ndërsa në Gjermani mbështeti Martin Lutherin dhe ndjekësit e tij. Me përhapjen e protestantizmit, u ndanë nga Gjermania edhe vendet katolike si Italia dhe Spanja. Në këtë mënyrë, u zvogëluar së tepërmi edhe ndikimi i papës në Evropë. Si rezultat i kësaj politike strategjike të Sulltan Sulejmanit, u thyer edhe koalicioni i fuqishëm kryqtar i Evropës.

*Dorëzimi
nuk tregohet ndaj
fjalëve, sjelljeve,
urdhrave dhe porosive
që kundërshtojnë
qartë ligjet e Islamit.
Parimi Islam është:
"S'ka bindje ndaj
krijesave në çështje ku
kundërshtohet Allahu!"
(Muslim, Imaret, 39.)*



Shekuj më vonë;

Kur, si pasojë e rënies së devotshmërisë dhe sinqeritetit, humbi edhe virtyti i largpamësisë, Perandoria Osmane u copëtua në duart e njerëzve të paaftë. Për rrjedhojë, myslimanët e sotëm të mbetur pambrojtje në katër anët e botës, si Palestinë, Arakan, Siri, Kashmir, etj., vuajnë në mënyrë të vazhdueshme dhunën dhe persekutimin e sunduesve të tyre.

Siç kuptohet qartë edhe nga këto fakte;

Sa më larg devotshmërisë, aq më i trashë bëhet njeriu. Budallallëku është e kundërta e zgjuarsisë, gjë e cila nënkupton privimin nga urtësia dhe mos kuptimin e superioritetit të botës tjetër ndaj kësaj bote.

Një nga treguesit e budallallëkut në ditët tona, është edhe veshja e rrobave mbi të cilat shkruhen gjëra që shprehin kundërshtim ndaj Zotit, kuptime të ulëta dhe jo morale. Kjo do të thotë të anashkalosh mendjen dhe logjikën e shëndoshë, e të ndjekësh verbërisht modën që ka përgatitur dikush.

MENDJA E SHËNDOSHË

“Mendja” për të cilën bëhet fjalë në Kuran dhe hadithe, nuk duhet ngatërruar me mendjen “racionaliste”, që shekujt e fundit po përdoret për të mohuar të vërtetat metafizike.

Feja ka edhe aspektin që i drejtohet mendjes dhe logjikës, por edhe aspektin që i drejtohet koncepteve dhe të vërtetave përtej mendjes, ndaj të cilave mendja duhet të dorëzohet.

Të mashtrohesh, është tregues mendjelehtësie, gjë e cila nuk i ka aspak hije një myslimani. Profetët udhëzues për njerëzimin, gëzonin cilësitë, “sidk/ të sinqertë” dhe “fetanet/ mendjemprehtë”. Për rrjedhojë, edhe një mysliman që i pason ata, duhet të jetë mençur dhe i zgjuar.



Islam, do të thotë dorëzim dhe parapranim. Nëse dikush beson vetëm pasi t'i jenë treguar të gjitha shpjegimet dhe urtësitë logjike, ky nuk quhet dorëzim. E në fakt, edhe besimi në momentin e vdekjes, atëherë kur të gjitha perdet të jenë larguar, nuk ka më asnjë vlerë për njeriun.

Kushtet e besimit; pra ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij, melekët, librat hyjnorë, profetët, bota tjetër dhe caktimi hyjnor, duhen besuar në mënyrë të prerë dhe të sigurt. Dyshimi në këto çështje, nuk ka të bëjë as me mendjen, e as me logjikën.

Në fakt;

Urtësia më e madhe, është deshifrimi i enigmës së të ardhmes. Në një hadith fisnik thuhet:

“Njeri i mençur është ai që e kontrollon vetveten dhe punon për jetën pas vdekjes. Ndërsa njeri i dobët, është ai që ndjek dëshirat e epshit të vet dhe pa arsye (pa kurrfarë merite), shpreson se Allahu do t’ia falë.” (Tirmidhi, Kiamet, 25. Shih. Ibni Maxhe, Zuhd, 31.)



“Ruajuni intuitës së besimtarit!

Sepse ai shikon me dritën e Allahut.”
(Tirmidhi, Tefsir, 15/3127)

Ndërsa në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...dhe të mos ju mashtrojë shejtani për Allahun!” (Fatir, 5.)

Patjetër që Allahu është falës, por, për një teube të pranueshme është kusht:

- Një pendim i thellë.
- Devotshmëria e palëkundur.

- Fshirja e gjynaheve me anë të veprave të mira.

ME DORËZIMIN NUK DUHET ABUZUAR

Nga ana tjetër, dorëzimi bëhet vetëm ndaj parimeve të vendosura nga Kurani dhe Suneti autentik i Profetit tonë ﷺ. Në fakt, edhe ndjekësit e feve apo sekteve të ndryshme të devijuara dhe manipuluar nga dora e njeriut tregojnë dorëzim ndaj parimeve të besimeve të tyre, por ky është një besim plotësisht i verbër, i cili bëhet vetëm për traditë dhe pranohet pa u vlerësuar në baza dhe argumente të vërteta.

Ja si i përgjigjet Kurani Fisnik kundërshtimeve të idhujtarëve:

“Kur u thuhet: «Ejani në atë që ka zbritur Allahu dhe ejani te i Dërguari!» -ata thonë:

«Neve na mjafton rruga që kemi gjetur nga etërit tanë.» - edhe pse etërit e tyre nuk kanë ditur asgjë e as nuk kanë qenë në udhën e vërtetë?!” (Maide, 104)

Shkurtimisht, Allahu i Madhëruar i urdhëron robërit e vet që ta përdorin mendjen e tyre në përputhje me shpalljen hyjnore të lidhur pas zemrës besimtare.



*Botëkuptimi i tasavufit:
Islami nuk kërkon
shfaqjen e hireve trupore,
por hireve shpirtërore.
Pra, ai nuk synon dukjen,
famën dhe postin, por
kuptimin e dobësisë
përballë Allahut dhe
dorëzimi i shpirtit ndaj
dëshirave hyjnore.*

Thuhet:

مَنْ عَرَفَ نَفْسَهُ
فَقَدْ عَرَفَ رَبَّهُ

*“Kush njeh veten,
njeh Zotin e tij.”*

BESIMTARI NUK MASHTROHET

Të mashtrohesh, është tregues mendjehetësie, gjë e cila nuk i ka aspak hije një myslimani. Profetët udhëzues për njerëzimin, gëzonin cilësitë, “*siddk/të sinqertë*” dhe “*fetanet/mendjemprehtë*”. Për rrjedhojë, edhe një mysliman që i pason ata, duhet të jetë i mençur dhe i zgjuar.

Dorëzimi nuk tregohet ndaj fjalëve, sjelljeve, urdhrave dhe porosive që kundërshtojnë qartë ligjet e Islamit. Parimi Islam është:

“*S’ka bindje ndaj krijesave në çështje ku kundërshtohet Allahu!*” (Muslim, Imaret, 39.)

Në kohën tonë, disa njerëz me qëllime të këqija, po abuzojnë me ndjenjat fetare të myslimanëve, duke u bërë shkak që Islami dhe myslimanët të bëhen objekt bisedash negative në gjuhët e injorantëve.

Në Hutben e Lamtumurës, i Dërguari i Allahut ﷺ, deklaroi se na ka lënë amanet dy gjëra që do të na ruajnë neve, umetin e tij, nga devijimi. Këto janë; “Kurani dhe Suneti”.

RRUGA E KURANIT DHE SUNETIT

Pasimi verbërisht ia tyre që i kundërshtojnë këto dy shtylla kryesore, qofshin këta individë apo institucione, nuk ka të bëjë me sinqeritetin dhe dorëzimin, por me dobësinë e besimit. Omeri رضي الله عنه, i cili kishte arritur nivel të lart mendimi dhe largpamësie nën edukimin profetik, ka thënë:

“Kurrë nuk keni për ta arritur mirësinë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!..”
(Al-i Imran, 92.)

“Rohit mos i shikoni namazin që fal dhe agjërimin që mban! Shikoni nëse thotë të vërtetën kur flet, a e ruan amanetin kur i besohet diçka dhe a bën kujdes ndaj hallallit dhe haramit në çështjet e kësaj bote!”

(Bejhaki, Kubra, VI, 288; Shuab, IV, 230, 326.)

Këto parime dhe kritere janë si pasqyra që tregojnë nivelin shpirtëror të namazit që fal një njeri. Edhe pse nga jashtë, namazi i tij mund të duket i përsosur, ajo që ka me të vërtetë rëndësi, është niveli i përkushtimit dhe sinqeritetit në zemrën e tij. Prandaj, sjelljet e njeriut në çështje që kanë të bëjnë me interesat e tij, e tregojnë më mirë nivelin shpirtëror të zemrës së tij.

Kur Omeri رضي الله عنه, dëgjoji dikë që lavdëronte dikë tjetër, e pyeti atë në lidhje me këto tri gjëra:

1. A ke qenë fqinj i tij?
2. A ke udhëtuar me të?
3. A ke bërë tregti më të?

Kur personi tha se nuk kishte bërë asnjë prej tyre, Omeri رضي الله عنه, tha:

“Atëherë mos e lavdëroni, sepse ju nuk e njihni atë siç duhet!”

KËSHILLA TË URTA

Aliu رضي الله عنه, i ka këshilluar guvernatorët e vet me këto fjalë:

“Në këshillin tuaj mos pranoni në asnjë mënyrë këta tre persona:

Sahabët që kanë jetuar bashkë me Profetin ﷺ dhe janë përpjekur ta imitojnë atë në çdo aspekt, nuk janë mbytur asnjëherë në pyetje të tilla si, “A është kusht? A mund të mos e bëjmë? etj...” Ata kanë vrapuar gjithmonë nga një mirësi në tjetrën.



Koprracin, frikacakun dhe lakmitarin.

Koprraci ju largon nga bamirësia, duke ju frikësuar me vështirësitë dhe problemet që mund të shfaqen në të ardhmen. Frikacaku ju dobëson guximin dhe vullnetin për punë të mëdha. Ndërsa lakmitari jua zbukuron lakminë dhe ju nxit në padrejtësi.”

Po ashtu, edhe njerëzit e devotshëm e kanë udhëzuar popullin me anë të këshillave të tyre të urta dhe të mençura. Një nga këta njerëz të urtë e të devotshëm është shejh Edebali, i cili njihet edhe si frymëzuesi shpirtëror i themelimit të Perandorisë Osmane. Ja disa nga këshillat e tij plot urtësi:

“Mos harro, se ata që ndodhen lart (udhëheqësit), nuk janë më të sigurt se ata që ndodhen poshtë (populli)!”

“Bëhu fjalë hapur! Mos e merr çdo fjalë mbi vete! Po pe gjëra, të cilat është më e dobishme, madje e nevojshme të fshihen, mos i thuaj; po i dite, mos i trego! Mos shko në atë vend ku të duan, aq shpesh sa të bëhesh i mërztitshëm, se të tronditen dashuria dhe konsiderata!..”

*Mevlana thotë:
“I varfëri është pasqyra e bujarëve.
Kujdes, mos e turbullo atë duke thënë fjalë fyese përballë pasqyrës!”*



“Të të vijë më keq për këta tre persona: Për dietarin mes injorantëve, për atë që ka qenë i pasur dhe është varfëruar dhe për atë që e ka humbur konsideratën ndër-sa ka qenë i respektuar!”

“Fitorja më e madhe është ta njohësh vetveten. Njeriu është armik i vetvetes! Por kur e njeh vetveten, bëhet mik i vetvetes!”

Si përfundim, le ta mbyllim këtë temë me këtë lutje të Profetit tonë ﷺ:

“O Allah! Jepi dritë zemrës sime, syrit tim dhe veshit tim. Ma ndriço të djathtën dhe të majtën time, të sipërmen dhe të poshtmen, përball meje dhe pas meje dhe më bëj komplet dritë! (Në një transmetim tjetër zënë vend edhe këto shprehje): Më ndriço damarët e mi, mishin, gjakun, flokët dhe fytyrën time!” (Buhari, Deauat, 9; Muslim, Musafirin, 181.)

Amin!



Rumiu thotë:
“Manifestimi i bujarisë së Allahut, del në pah tek të varfrit, të cilët kërkojnë prej bujarëve dhe ua qajnë hallet e veta. Dhe në këtë mënyrë, ata përgatitin rrugët e lumturisë për të pasurit fisnikë.”





SIDK, EMANET dhe ISMET

Gjatë gjithë jetë së vet, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ka folur asnjë fjalë të pavërtetë, qoftë edhe me shaka. Singëriteti dhe besnikëria e tij njihej shumë mirë nga kurejshët, mes të cilëve u rrit dhe u edukua. Për rrjedhojë, kur ai e pyeti popullin e vet: "A do të më besonit, nëse ju them se pas këtij mali po afrohet një ushtri?"

Ata thanë: "Sigurisht që besojmë, sepse ne nuk kemi dëshmuar asnjëherë që ti të kesh gënjyer!"

Për këtë arsye, populli i tij e admironte personalitetin dhe karakterin e Profetit tonë ﷺ.



SIDK, EMANET dhe ISMET

MIRËSIA E MADHE

Allahu i Madhëruar na ka dhuruar mirësi të panumërta. Por, mirësia më e madhe hyjnore ndaj nesh, është se na ka bërë besimtarë dhe umetin e të Dërguarit të Tij, Muhammedit ﷺ. Në Kuranin Fisnik, kjo e vërtetë shprehet kështu:

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre...” (Al-i Imran, 164.)

Ai ﷺ, është një mirësi aq e madhe, saqë edhe mirësitë e tjera marrin kuptim vetëm bashkë me të. Ekzistenca jonë, krijimi ynë si qenie njerëzore, mendja, shëndeti dhe mirësi të tjera të Allahut, manifestohen vetëm në këtë botë. Dhe, nëse nuk do të ekzistonte lumturia në botën tjetër, këto mirësi do të merrnin fund, ndërkohë që do të na kërkohesh llogari edhe për to. Falënderimi për mirësitë, mund të realizohet vetëm në saje të vetëdijes së besimit. Po ashtu, edhe përdorimi i atyre mirë-

sive në rrugë të drejtë mund të arrihet vetëm në saje të këtij besimi. Pra, një jetë e stolisur me besim dhe vepra të mira, ndërton jetën tonë të vërtetë; atë të botës tjetër.

Ndërsa udhëzuesi, mësuesi dhe prijësi i kësaj detyre të vështirë, është Profeti ynë ﷺ. Ai është dërguar si mëshirë për botët. Ai është shembulli më i bukur dhe më i përkryer për njerëzimin. Allahu i Madhëruar urdhëron:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن
كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekulueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21)

Këto dy ajete na mësojnë vlerën e Profetit tonë ﷺ, si një mirësi e madhe që e gëzojmë ne si umet. Nëse një besimtar arrin të meditojë rreth madhësisë së mirësive që gëzon, do të bëjë më tepër përpjekje për të përfutur prej asaj mirësie dhe për ta konsideruar atë si diçka shumë të shtrenjtë.



Allahu i Madhëruar na ka dhuruar mirësi të panumërta. Por, mirësia më e madhe hyjnore ndaj nesh, është se na ka bërë besimtarë dhe umetin e të Dërguarit të Tij, Muhammedit ﷺ.

INDIFERENCA NDAJ TIJ ËSHTË HUMBJE

Ka'b bin Uxhre رضي الله عنه, tregon:

“I Dërguari Allahut ﷺ, na kërkoi të mblidheshim përreth minberit prej nga fliste ai. Kështu, ne u ulëm të gjithë së bashku para tij. Ai u ngjit një shkallë dhe tha:

«Amin!»

Ngjiti edhe një shkallë dhe tha prapë:

«Amin!»

U ngjit edhe një shkallë tjetër dhe tha përsëri:

«Amin!»

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, zbriti nga minberi, e pyetëm:

«O Dërguar Allahut, sot dëgjuam prej jush diçka që s'e kemi dëgjuar ndonjëherë tjetër!»

Ai na tha:

«Kur isha në minber, në shkallën e parë, më erdhi Xhebraili e më tha:

“Qoftë larg mëshirës ai që e arrin Ramazanin dhe nuk i falen gjynahet!” Unë thashë Amin!. Kur u ngjita në shkallën e dytë më tha:

“Qoftë larg mëshirës ai, pranë të cilit përmendet emri yt, e nuk dërgon salavatet për ty!” Unë prapë thashë: Amin!

Kur u ngjita në shkallën e tretë më tha:

“Qoftë larg mëshirës ai që nuk mund ta fitojë Xhenetin kur nëna dhe babai i tij, ose njëri prej tyre, arrin pleqërinë pranë tij (duke i kënaqur ata)!” Unë thashë! Amin!» (Hakim Mustedrek, IV 170.)



Ndërsa poeti Kemal Edip, e shpreh kështu humbjen e atyre që tregohen indiferent ndaj Profetit tonë ﷺ:

*Mjerë, mjerë për të pakujdesshmit,
Mjafton mjerimi i të dy botëve për neglizhentët!..*

I lutemi Allahut mos të na bëjë neglizhentë në asnjërën prej këtyre tri çështjeve: O Allah! Na e bëj të mundur ta arrijmë Ramazanin dhe të përfitojmë prej faljes dhe mëshirës hyjnore në atë muaj! O Allah! Na e bëj të mundur ta kuptojmë siç duhet vlerën e Profetit tonë, ta pasojmë rrugën e tij dhe ta kujtojmë atë me salavatet!

Allahu i Madhëruar, çdo cilësi të Profetit ﷺ, e ka bërë udhëzim dhe shembull të përkryer për të gjithë umetin Islam. Ai e ka lavdëruar sinqeritetin, besnikërinë, pastërtinë shpirtërore, orientimin dhe moralin e tij të lartë. Po ashtu, Allahu i ka ruajtur zemrën, mendjen dhe gjuhën e tij nga çdo e keqe.

Me qëllim që ne ta kuptojmë sa më mirë vlerën e të qenit umeti i tij, Allahu i Madhëruar e ka lavdëruar Profetin tonë ﷺ, në shumë ajete të Kuranit Fisnik.

Kur nënën tonë Aishen رَضِيَ اللهُ عَنْهَا, e pyesnin pas vdekjes së Profetit ﷺ, në lidhje me moralin e tij, ajo përgjigjej duke thënë:

“Moralin e tij ishte Kurani.” (shih. Muslim, Musafirin, 139.)

ZGJERIMI I KRAHARORIT

• Allahu e pastroi zemrën e Profetit tonë ﷺ dhe urdhëroi:



*Për njeriun është
thuaje e pamundur
ta kuptojë
plotësisht vlerën
dhe madhëstini
e Profetit tonë ﷺ,
sepse kjo është përtej
fuqisë së mendimit
njerëzor.*

أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ

“A nuk ta hapëm/zgjeruam Ne kraharorin tënd?” (Inshirah, 1)

Sipas transmetimeve, Allahu i Madhëruar i ka bërë Profetit tonë tri operacione shpirtërore të zemrës; njëherë në fëmijërinë e tij, njëherë para profetësisë dhe një herë tjetër para ngjarjes së miraxhit. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar ia ka pastruar zemrën Profetit ﷺ, nga çdolloj ndjenje negative dhe ia ka mbushur me urtësi dhe ndjenja sublime, duke ia zgjeruar kraharorin/zemrën.

- Po ashtu, Allahu ia ka pastruar mendjen dhe ka urdhëruar:

مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَىٰ

“Shoku juaj (Muhammedi) nuk u shmang (nuk devijoi) dhe nuk i besoi së shtrembrës!..” (Nexhm, 2)

Profeti ynë ﷺ, e ka urryer idhujtarinë dhe mohimin e Zotit edhe para se t’i zbriste shpallja hyjnore. Për rrjedhojë, ai ka qëndruar gjithmonë larg këtyre veprimeve të ulëta. Siç e dimë, profetët zotërojnë cilësinë e fetanetit; pra mendjemprehtësi dhe inteligjencë të jashtëzakonshme. Këtë mendjemprehtësi, Profeti ynë ﷺ, e ka gëzuar gjatë gjithë jetës. Por pasi u ngarkua me detyrën e profetësisë, zgjuarsia e tij u gërshetua me dritën e shpalljes hyjnore dhe u bë një kandil ndriçues për të gjithë ata qëzonin mendje të shëndoshë dhe pasuan rrugën e tij. Në saje të kësaj drite, u hapën sytë dhe mendjet ndaj urtësive hyjnore dhe njerëzit shpëtuan prej vorbullave të filozofive shterpë e feve të prishura.



- Allahu i Madhëruar ia pastroi shikimin dhe urdhëroi:

مَا رَأَى الْبَصْرُ وَمَا طَعَى

“Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën.”

(Nexhm, 17)

Profeti ynë ﷺ, u nderua nga Allahu i Madhëruar duke u ngritur në miraxh. Ai përshkoi shtatë qiejt, pa Xhenetin, Xhehenemin dhe shkoi deri në Sidre-i Munteha. Por të gjitha këto privilegje që gëzoi, nuk e ndryshuan aspak cilësinë e tij, “rob dhe profet i Allahut”. Përkundrazi, ai u kthye në tokë dhe vazhdoi përsëri jetën e tij plot vuajtje e vështirësi.

Prandaj, kur bëhet fjalë për hadithet dhe porositë e tij, ne i umeti i tij, duhet të mos e harrojmë asnjëherë një të vërtetë:


Sytë e tij kanë parë përtej horizontit... kanë parë Xhenetin dhe Xhehenemin. Për fat të keq, sot, disa mendjelehtë i konsiderojnë porositë e Profetit tonë ﷺ, të kufizuara për shekullin e

shtatë. Mirëpo, Profeti ynë ﷺ, na ka bërë të ditur të gjitha sprovat dhe vështirësitë që do të kalojë umeti i tij deri në ditën e kiametit. E në fakt, sot po vërtetohen një nga një të gjitha shenjat e kiametit për të cilat na ka paralajmëruar ai. Ja një lajm i vërtetë:

“Është e afërt koha kur popujt e huaj do t’ju sulmojnë si egërsirat e uritura drejt ushqimit.” E pyetën:

“A është kjo për shkak se do te jemi pak, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha:

“Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Alla-



hu do të nxjerrë frikën prej jush nga zemrat e armiqve tuaj, e do të fusë dobësinë në zemrat tuaja?”

“Ç’është dobësia, o i Dërguari i Allahut?” - u pyet.

“*Dashuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja!*” - tha ai.” (Ebu Daud, Melahim, 5/4297; Ahmed, V, 278.)

Dhe me të vërtetë që, sot, gjendja e botës Islame është pikërisht e njëjtë me atë që përshkruhet në hadith. Ndërsa zgjidhja e vetme e kësaj gjendjeje të mjeruar, është pasimi më përpikëri i të Dërguarit të Allahut ﷺ.

SHEMBULLI MË I VEÇANTË I ZEMRËS SË PASTËR

• Allahu i Madhëruar e pastroi zemrën e Profetit tonë ﷺ dhe urdhëroi:


مَا كَذَبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَى

“Zemra e tij nuk e mohoi atë që pa me sy.” (Nexhm, 11)

Zemra e tij ishte çdo çast me Allahun e Madhëruar. Aq sa ai thoshte:

“*Sytë e mi fllenë, por zemra jo (vazhdon të përmendë Allahun).*” (Buhari, Tehexhxhud, 16.)

Zemra e tij, ishte shembulli i zemrës më të pastër. Zemra e tij nuk kishte vend për ndjenja negative. Ai nuk ushqueu



Për fat të keq, sot, disa mendjelehtë i konsiderojnë porositë e Profetit tonë ﷺ, të kufizuara për shekullin e shtatë. Mirëpo, Profeti ynë ﷺ, na ka bërë të ditur të gjitha sprovat dhe vështirësitë që të kalojë umeti i tij deri në ditën e kiametit. E në fakt, sot po vërtetohen një nga një të gjitha shenjat e kiametit për të cilat na ka paralajmëruar ai.

urrejtje ndaj askujt që i ka bërë padrejtësi atij dhe të afërmve të tij, por përherë ka zgjedhur rrugën e faljes, e jo të hakmarrjes, edhe pse ka pasur mundësi. Si rezultat i këtij karakteri madhështor që zotëronte, shumë prej armiqve të tij pranuan Islamin dhe i thanë, “ti je një vëlla i mrekullueshëm”.

Zemra e tij që rrihte me dashurinë hyjnore, tregoi dhembshuri ndaj të gjitha krijesave, përfshi bimët dhe gurët. E sidomos për umetin e vet. Lidhur me këtë Profeti ynë ﷺ, është shprehur:

“Jeta ime është në dobinë tuaj; ju flisni me mua dhe njoftoheni (me shpalljen hyjnore dhe ligjet). Por edhe vdekja ime është në dobinë tuaj. Punët tuaja më tregohen edhe mua. Kur shoh një punë të mirë, falënderoj Allahun, e kur shoh një punë të keqe, i kërkoj falje Atij për ju.” (Hejthemi, IX, 24.)

Ata që kanë përfituar prej frymëzimit të tij shpirtëror, u bënë muhaxhirë dhe ensarë. Por edhe ne mund të bartim shpresën për të qenë vëllezërit e tij të fund-kohës, aq sa përfitojmë prej frymëzimit të tij shpirtëror.

- Allahu i Madhëruar e ka pastruar emrin/famën e tij dhe urdhëroi:

وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ

“Ne, ta lartësuam emrin, famën tënde.” (Inshirah, 4)

Allahu i Madhëruar, emrin e Profetit tonë ﷺ, e ka përmendur pas emrit të Vet madhështor në “Dëshminë Islame”. Ai ishte i Dërguari i Allahut dhe gëzonte një



Zemra e tij ishte çdo çast me Allahun e Madhëruar. Aq sa thoshte:

“Sytë e mi flenë, por zemra jo (vazhdon të përmendë Allahun)”


(Buhari, Tehexhxhud, 16.)

nivel të lartë, ashtu si i ka hije Dërguesit të tij, Zotit të Gjithësisë. Mësuesi i tij ishte Vetë Allahu i Madhëruar, i Cili e edukoi atë në mënyrën më të përsosur.

▪ Nuk ishte parë e dëgjuar ndonjëherë që Muhamedi ﷺ, të merrej me poezi apo të predikonte. Po ashtu, nuk ishte dëgjuar asnjëherë të fliste për historitë e profetëve dhe popujve të shkuar, për ditën e kiametit, Xhenetin apo Xhehenemin. Ai bënte një jetë brenda një morali të lartë e të veçantë vetëm për të. Mirëpo, kur ai u kthye nga shpella e Hiras me detyrën hyjnore mbi shpatulla, kishte ndryshuar plotësisht.

Kur filloi të predikonte fjalët e Zotit, e gjithë Arabia pësoi një tronditje të jashtëzakonshme. Elokuenca dhe oratoria e tij e mrekullueshme i magjepsi të gjithë. Të gjitha konkurset në poezi, letërsi dhe oratori u braktisën. Prej asaj kohe, asnjë poet nuk kishte më guxim të ekspozonte poezitë e tij fituese në muret e Qabes.

▪ Profeti ynë ﷺ, më parë nuk ka qenë as edukues. Ashtu siç nuk kishte marrë mësim prej ndokujt para detyrës së profetësisë, ai nuk i kishte dhënë as mësim ndokujt. Allahu i Madhëruar e kishte edukuar që të bëhej një mësuesi i atillë, që të ndikonte në gjithë qenien e nxënësve të tij, sahabëve të nderuar, të cilët më pas u përhapën në gjithë botën. Për rrjedhojë, Fjala e shenjtë e Allahut dhe tradita e bekuar e Profetit tonë ﷺ, kanë arritur



Zemra e tij, ishte shembulli i zemrës më të pastër. Zemra e tij nuk kishte vend për ndjenja negative. Ai nuk ushqeu urrejtje ndaj askujt që i ka bërë padrejtësi atij dhe të afërmve të tij, por përherë ka zgjedhur rrugën e faljes, e jo të hakmarrjes, edhe pse ka pasur mundësi. Si rezultat i këtij karakteri madhështor që zotëronte, shumë prej armiqve të tij pranuan Islamin dhe i thanë, “ti je një vëlla i mrekullueshëm”.

deri në ditët tona në mënyrë autentike nëpërmjet mijëra dije-tarëve dhe nxënësve të dijes të fushave të ndryshme të shkencave Islame, si fikh, Tefsir, hadith, etj.

■ Po ashtu, para profetësisë, Profeti ynë ﷺ, nuk kishte treguar as aftësi komanduese. Ai nuk kishte as edukim dhe as përvojë ushtarake në këtë fushë. Mirëpo, për shkak se ishte edukuar nga Vetë Zoti i gjithësisë, ai shfaqti aftësi të mrekullueshme edhe në fushën ushtarake si një komandant që përveç guximit dhe trimërisë, zotëronte edhe durimin dhe mëshirën. Aq, sa edhe njerëzit më trima në fushëbetejë, si Aliu ﷺ, strehoheshin pas tij në çaste të vështira. Po ashtu, ai ishte aq i mëshirshëm, sa që në betejën e Bedrit i lejoi edhe armiqtë e vet të pinin ujë një ditë para betejës.

Profeti ynë ﷺ, pas betejës së Bedrit, për nëntë vite e çliroi të gjithë Arabinë me forca të pakta e të kufizuara. Edhe ata që e pasuan atë, me forca të pakta e të kufizuara mposhtën perandoritë Bizantine dhe Perse, që ishin dy superfuqitë më të mëdha të asaj periudhe.

■ I Dërguari i Allahut ﷺ, më parë nuk ka kryer as ndonjë detyrë në administrimin e shoqërisë. Ai nuk kishte bërë asnjë punë administrative, përveç kullotjes së bagëtive në fëmijëri. Por me qytet-shtetin që themeloi në Medinë, hodhi themelet e një qytetërimi të madh, Qytetërimin Islam.

Ai ﷺ, periudhën e injorancës e transformoi në një epokë lumturie. Falë misionit të tij profetik 23 vjeçar, mori fund

*Sa e përfaqësojmë
Islamit ne si
myslimanë? Sa e
pasojmë ne umeti i tij
moralin madhështor
të Profetit tonë ﷺ? Le
të pyesim veten:
Çfarë kishte në
zemrën e Profetit
ﷺ dhe çfarë ka në
zemrën tonë? Sa e
ndejmë veten bashkë
me të Dërguarin e
Allahut ﷺ, gjatë jetës
sonë?*




edhe terrori që kishte pushtuar gjithë zonën. Ai i shpëtoi të gjitha krijesat nga ligësitë e zullumqarëve. Falë tij gjetën paqe edhe shkretëtirat, që ishin shndërruar në dete gjaku nën kthetrat e kusarëve, duke u shndërruar në Xhenete. Sa bukur e shpreh Mehmet Akif Ersoj këtë gjendje:

U ringjall i dobëti, e drejta e të cilit ishte vetëm shtypja,

Vdiq padrejtësia, fundi i së cilës as që mendohej...

■ I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ishte as jurist. Ai nuk kishte asnjë përvojë në çështjet e drejtësisë. Por ai u edukua nga Zoti i gjithësisë në atë mënyrë që, Hutbja e tij e Lamtumirës u bë “Deklarata e të Drejtave Njerëzore”, më e përsosur dhe më e veçantë; kushtetuta e pandryshueshme Islame. Juristët mblidhen dhe shkruajnë kushtetuta, por, për një kohë të shkurtër, fillojnë të shfaqen mangësitë, dhe në këtë mënyrë, detyrohen të bëjnë ndryshime të vazhdueshme. Kurse kushtetuta e Profetit ﷺ nuk ka nevojë për asnjë ndryshim deri në ditën e gjykimit.

E vërteta sublime dhe drejtësia madhështore që i solli Profeti ﷺ botës, u vlerësua dhe mori lëvdata edhe prej mendimtarëve jomyslimanë. Njëri ndër themeluesit ideologjikë të Revolucionit Francez, filozofi Lafajet, më 1789, para shpalljes së “Deklaratës së të drejtave të njeriut”, kishte studiuar dhe shqyrtuar me kujdes dhe përpikëri të gjitha sistemet juridike. Duke parë lartësinë dhe epërsinë e të drejtës Islame, vlerësimin dhe admirimin e tij ndaj Profetit ﷺ, e shprehu kështu:




*Më tepër se fjalët,
njerëzit shohin veprat
dhe sjelljet tona.
A shohin ata
në veprat tona
reflektimin e moralit
të Profeti ﷺ?*

“O Muhamed! Atë që ti ke sjellë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë në një shkallë të paarritshme!..”

Ndërsa historiani francez Lamartine, do ta shprehte kështu madhësitinë dhe gjenialitetin e Profetit tonë ﷺ:

“Në qoftë se madhështia e qëllimit, pamundësia e mjeteve dhe pafundësia e rezultateve të arritura, do të ishin tri kritere për të matur gjenialitetin njerëzor, atëherë kush do të guxonte të përqaste njerëzit më të mëdhenj të kohëve moderne me figurën e Muhamedit?”



Profeti ynë ﷺ, nuk ka qenë mësues para se të bëhej profet. Ashtu siç nuk kishte marrë mësim prej ndokujt para detyrës së profetësisë, a nuk i kishte dhënë as mësim ndokujt. Por Allahu i Madhëruar e kishte edukuar që të bëhej një mësuesi i atillë, që të ndikonte në gjithë qenien e nxënësve të tij, sahabëve të nderuar, të cilët më pas u përhapën në gjithë botën.

Po ashtu, në vitin 1979 u përgatit një studim statistikor me anë të kompjuterit. Qëllimi ishte të zgjidheshin 100 personalitetet më të mëdha të të gjitha kohërave dhe t'i radhisnin ato. Në kompjuter u cakatuan aftësitë, përpjekjet, veprat dhe sukseset e njerëzve të mëdhenj të cilët kanë lënë gjurmë në histori. Në fund të këtij studimi, i cili zgjati për disa muaj, programi kompjuterik zgjodhi fituesin në bazë të të dhënave të regjistruara në memorien e tij. Emri i përzgjedhur në mënyrë objektive nga kompjuteri ishte Muhamedi ﷺ.

- Allahu i Madhëruar e pastroi Profetin tonë ﷺ, nga gjynahet dhe gabimet e mëparshme, sado të vogla të kenë qenë. Po ashtu, Ai ia lehtësoi edhe përgjegjësinë e rëndë të detyrës së profetësisë dhe urdhëroi:

وَوَضَعْنَا عَنْكَ وِزْرَكَ الَّذِي أَنْقَضَ ظَهْرَكَ

“Dhe ta hoqëm barrën, e cila ta rëndonte tepër kurrizin.” (Inshirah, 2-3)

Allahu i Madhëruar, të gjithë profetët i ka zgjedhur prej robërve të Tij më të pastër dhe më të veçantë. Prandaj, Ai i ka ruajtur ata prej gjynaheve të mëdha dhe veprave të shëmtuara. Jeta e Profetit tonë ﷺ, gjatë 40 viteve para profetësisë, ishte si një fletë libri e pastër që nuk ka qoftë edhe një njollë të vogël. Për rrjedhojë, edhe pse pas profetësisë u sulmua shumë nga mohuesit, askush nuk kishte ç’i thoshte në lidhje me të kaluarën. Këtë të vërtetë e tregon shumë bukur edhe fakti që kur Ebu Sufjani, i cili ishte ende një mohues dhe armik i Profetit tonë ﷺ, u mor në pyetje nga perandori Herakli në lidhje me Profetin ﷺ, dha këto përgjigje:

- Herakliu: “A ka qenë gënjeshtar para kësaj (pretendimit për profet)?”


- Ebu Sufjani: “Jo.”

- Herakliu: “A e thyen fjalën e dhënë?”

- Ebu Sufjani: “Jo!”...

Mesazhi që marrim ne nga kjo, është:

Sa e përfaqësojmë Islamin ne si myslimanë? Sa e pasojmë ne, umeti i tij, moralin madhështor të Profetit tonë ﷺ? Më tepër se fjalët, njerëzit shohin veprat dhe sjelljet tona. A shohin ata në veprat tona reflektimin e moralit të Profeti ﷺ?



Fjala e shenjtë e Allahut dhe tradita e bekuar e Profetit tonë ﷺ, kanë arritur deri në ditët tona në mënyrë autentike nëpërmjet mijëra dijetarëve dhe nxënësve të dijes të fushave të ndryshme të shkencave Islame, si fikh, Tefsir, hadith, etj.

EDUKIMI HYJNOR

• Allahu i Madhëruar e ka pastruar edhe edukimin e tij. Ai na ka bërë të ditur se ato që predikonte Profeti ynë ﷺ, i kanë ardhur nga instanca të larta hyjnore:

عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَىٰ

“Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhebraili).” (Nexhm, 5)

Kur Profeti ynë ﷺ, deklaroi se ishte i Dërguari i Allahut, ata që nuk deshën ta pranenin këtë të vërtetë, filluan të shpifnin dhe të mohonin. Edhe pse ata e njihnin mirë mendjemprehtësinë dhe pjekurinë e tij, ata i thanë “mexhnun/i çmendur”. Edhe pse e dini se deri më atëherë nuk ishte marrë asnjëherë me poezi, ata i thanë, “poet”. Por, kur mbetën pafjalë përballë elokuencës së Kuranit, ata thanë, “ia ka mësuar ndokush!”

Mirëpo, ai Profet që nuk dinte shkrim e këndim, kishte si mësues vetëm Allahun e Madhëruar, gjë të cilën vetë Profeti ynë ﷺ, e ka shprehur me këto fjalë:

أَدَّبَنِي رَبِّي فَأَحْسَنَ تَأْدِيبِي

“Mua më edukoi Zoti. Sa edukim të përsosur më dha Ai!” (Sujuti, I, 12)

Si rezultat i prirjes së imitimit dhe reflektimit, njeriu ndikohet nga shumë persona që zënë vend në jetën e tij, duke filluar nga prindërit, të afërmit, fqinjët, mësuesit, etj. Mirëpo, Profeti ynë ﷺ, lindi jetim nga

Para profetësisë, Profeti ynë ﷺ, nuk kishte treguar as aftësi komanduese. Ai nuk kishte as edukim dhe as përvojë ushtarake në këtë fushë. Mirëpo, për shkak se ishte edukuar nga Vetë Zoti i gjithësisë, ai shfaqti aftësi të mrekullueshme edhe në fushën ushtarake si një komandant që përveç guximit dhe trimërisë, zotëronte edhe durimin dhe mëshirën. Aq sa edhe njerëzit më trima në fushëbetejë, si Aliu ﷺ, strehoheshin pas tij në çaste të vështira. Po ashtu, ai ishte aq i mëshirshëm sa që në betejën e Bedrit i lejoi edhe armiqtë e vet të pinin ujë një ditë para betejës.



babai, shkoi në kurbet tek nëna e qumështit dhe, në moshën 6 vjeç mbeti edhe pa nënë. Në këtë mënyrë, ai është rritur nën kujdesin e Zotit, pa ndikim të fortë nga ndonjë person i caktuar. Krahas kësaj, ai nuk dinte as shkrim e këndim, gjë që e ka ruajtur edhe nga ndikimi i librave të feve të tjera. Çështje e drejta, atë periudhë në Mekë nuk kishte ndonjë kulturë shkrimi të përhapur.

Të gjitha këto, na tregojnë se çdo gjë që dilte nga zemra e Profetit tonë ﷺ, ishin si rezultat i edukimit hyjnor.

Në të njëjtën mënyrë, edhe ne duhet ta ndërtojmë personalitetin tonë duke marrë shembull personalitetin e tij madhështor, sepse ai ﷺ, është i vetmi kriter që na çon drejt kënaqësisë hyjnore. Dihet se, mesazhet e profetëve të shkuar janë tjetërsuar; fjalët e tyre kanë humbur dhe janë përzierë me të pavërteta. Kurse jeta e Profetit tonë ﷺ, fjalët dhe veprat e tij -në mënyrë të veçantë pas shpalljes-, janë mbajtur shënim në mënyrë të përsosur. Pra, kush e pason me përpikëri Profetin tonë ﷺ, ai e çon drejt Allahut të Madhëruar.

Një dijetar Islam, rëndësinë e lidhjes pas sunetit, e shpreh me një shembull:

“Shkëputja e njeriut nga sunetet e Profetit tonë ﷺ, një nga një, i ngjan këputjes së fijeve të litarit një nga një. Litari i plotë, është shumë i fortë. Por nëse këputet fije-fije, forca e tij humbet. Pra, edhe largimi i suneteve një nga një prej jetës sonë, -Allahu na ruajt-të!- e bën jetën tonë të përjetshme të varur në një fije pambuku.”

Profeti ynë ﷺ, pas betejës së Bedrit, për nëntë vite e çliroi të gjithë Arabinë me forca të pakta e të kufizuara. Edhe ata që e pasuan atë, me forca të pakta e të kufizuara mposhtën perandoritë Bizantine dhe Perse, që ishin dy superfuqitë më të mëdha të asaj periudhe.



GJUHA E SË VËRTETËS

- Allahu i Madhëruar e pastroi gjuhën e tij dhe urdhëroi:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ

“Ai nuk flet sipas qejfit të vet!” (Nexhm, 3)

Gjatë gjithë jetë së vet, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ka folur asnjë fjalë të pavërtetë, qoftë edhe me shaka. Singëriteti dhe besnikëria e tij njihej shumë mirë nga kurejshët, mes të cilëve u rrit dhe u edukua. Për rrjedhojë, kur ai e pyeti popullin e vet:

“A do të më besonit, nëse ju them se pas këtij mali po afrohet një ushtri?”

Thanë: “Sigurisht që besojmë, sepse ne nuk kemi dëshmuar asnjëherë që ti të kesh gënjer!”

Për këtë arsye, populli i tij e admironte personalitetin dhe karakterin e Profetit tonë ﷺ.

Në kohën kur Profeti ynë ﷺ, do të dilte në udhëtimin e emigrimit drejt Medinës nën një rrezik të madh për jetën, në shtëpinë e tij kishte ende disa mallra që idhujtarët ia kishin lënë në ruajtje. Pra, edhe vetë armiqtë e tij kishin besim tek ndershmëria e tij. Madje, ata e thërrisnin “Muhammedu’l- Emin / Muhamed i besueshmi”. E ndonjëherë e thërrisnin direkt, “el-Emin”, ose “es-Sadik”.



I Dërguari i Allahut ﷺ, më parë nuk pati marrë as ndonjë detyrë në administrimin e shoqërisë. Ai nuk kishte bërë asnjë punë administrative, përveç kullotjes së bagëtive në fëmijëri. Por me qytetshitetin që themeloi në Medinë, hodhi themelet e një qytetërimi të madh, Qytetërimin Islam.

Për rrjedhojë, edhe ne, si ummeti i tij, duhet të flasim me gjuhën që na mëson Kurani Fisnik:

قَوْلًا كَرِيمًا (kaulen kerima): **Fjalë të bukura dhe të mira ndaj prindërve.** (shih. Isra, 23.)

قَوْلًا مَيْسُورًا (kaulen mejsura): **Fjalë të lehta ndaj të skamurit.** (Shih. Isra, 28.)

قَوْلًا مَعْرُوفًا (kaulen marufa): **Fjalë dashamirëse ndaj jetimëve dhe nevojtarëve.** (shih. Nisa, 5, 8.)

قَوْلًا لَيِّنًا (kaulen lejina): **Fjalë të buta edhe ndaj zullumqarrit.** (shih. TaHa, 44.)

MËSHIRË E PASHOQE

• Allahu i Madhëruar e pastroi butësinë, mëshirën dhe ndërgjegjen e tij dhe urdhëroi:

بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُفٌ رَحِيمٌ

“...është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128)

Në fakt, “Rauf dhe Rrahim”, janë dy prej emrave të bukur të Allahut, të cilët Allahu nuk i ka përdorur për asnjë profet tjetër, përveç Profetit tonë ﷺ.

Mëshira është fryti i besimit. Një zemër e pastruar prej ndjenjave negative, duhet të zbukurohet me cilësi të bukura si

وَأَرْسَلْنَاكَ إِلَّا حِزْبًا لِّلْعَالَمِينَ

Ai ﷺ, periudhën e injorancës e transformoi në një epokë lumturie. Falë misionit të tij profetik 23 vjeçar, mori fund edhe terrori që kishte pushtuar gjithë zonën. Ai i shpëtoi të gjitha krijesat nga ligësitë e zullumqarëve. Falë tij gjetën paqe edhe shkretëtirat, që ishin shndërruar në dete gjaku nën kthetrat e kusarëve, duke u shndërruar në Xhenete. Sa bukur e shpreh Mehmet Akif Ersoj këtë gjendje:

U ringjall i dobëti, e drejta e të cilit ishte vetëm shtypja,
Vdiq padrejtësia, fundi i së cilës as që mendohej...

dashuria, mëshira, dhembshuria, sakrifica dhe durimi. Dhe, në këtë çështje, shembulli ynë është i Dërguari i Allahut ﷺ, i cili thotë:


“Unë jam më afër besimtarit se sa ai ndaj vetes së tij. Nëse vdes dikush, pasuria që lë pas u takon trashëgimtarëve, por, nëse lë borxh, atëherë ai borxh më përket mua për ta shlyer. E, nëse lë pas jetim, mbrojtja dhe kujdesi ndaj tyre është detyra ime.”

(Muslim, Xhuma, 43.)

Ai përpiquej me vetëmohim që çdo individ i umetit të vet të shpëtonte nga fatkeqësitë dhe të arrinte lumturinë në të dyja botët. Sidomos për shpëtimin në botën tjetër. Adij bin Hatim رضي الله عنه, tregon:

“Kur u bëra mysliman, pashë se fytyra e të Dërguarit të Allahut shkëlqeu me një gëzim të madh!”

(Ahmed, IV, 378.)



I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ishte as jurist. Ai nuk kishte asnjë përvojë në çështjet e drejtësisë. Por ai u edukua nga Zoti i gjithësisë në atë mënyrë që, Hutbja e tij e Lamtumirës u bë “Deklarata e të Drejtave Njerëzore”, më e përsosur dhe më e veçantë, kushtetuta e pandryshueshme Islame.

Ky ishte një gëzim aq i madh, sa që edhe pranimit i Islamit nga një skllav me emrin Addas, e kishte shuar hidhërimin dhe dhimbjet që i kishin shkaktuar refuzimi dhe gurëzimi në Taif. Për të shpëtuar qoftë edhe një person nga zjarri, Profeti ynë ﷺ, e vazhdoi predikimin dhe kumtimin e fesë me dashuri dhe entuziazëm të madh për 13 vjet rresht, pa u mërzi-tur dhe pa u lodhur, pavarësisht talljeve, ofendimeve dhe kërcënimeve të idhujtarëve.

Profeti ynë ﷺ, ka dëshiruar shumë që edhe umeti i vet të bëhen njerëz të mëshirës. Prandaj ka thënë:

“Besimtarët ngjasojnë me një trup të vetëm në dashurinë, në dhembshurinë dhe ruajtjen që tregojnë për njëri-tjetrin. Kur një organ i trupit është i sëmurë, edhe organet e tjera të trupit rrinë pa gjumë dhe i zë temperatura e lartë.” (Buhari, Edeb 27; Muslim, Birr 66.)

I PALËKUNDSHËM NË RRUGË TË DREJTË

• Allahu i Madhëruar e ka pastruar edhe orientimin e tij dhe ka urdhëruar:

عَلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ


“Në të vërtetë ti je në rrugë të drejtë.” (Jasin, 4)

وَإِنَّكَ لَتَهْدِي إِلَىٰ صِرَاطٍ مُّسْتَقِيمٍ

“Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë.” (Shura, 52)

Në suren Fatiha, Allahu ka vendosur një ajet, të cilin saherë që ne e këndojmë, i lutemi Atij për orientimin në rrugë të drejtë. Ky orientim duhet të jetë besimi i shëndosh, vepra e sinqertë dhe morali i bukur. Për rrjedhojë, Profeti ynë ﷺ, është shembulli më i përsosur i orientimit në rrugën e drejtë. Jeta e tij është e mbushur me vuajtje dhe vështirësitë. Mirëpo, Profeti ynë ﷺ, është bërë shembull i pashoq në durim, dorëzim ndaj caktimit, devotshmëri dhe virtyte të larta. Aq, sa edhe kur u gurëzua nga banorët e Taifit, i është lutur Allahut të Madhëruar me këto fjalë:

“O Allah! Fuqia ime është dobësuar, jam pa rrugëzgjidhje dhe i përçmuar në sytë e popullit. O Mëshiruesi i Mëshiruesve! Nëse nuk Je i zemëruar me mua, nuk dua t’ia di për vuajtjet dhe



I Dërguari i Allahut ﷺ, ishte i pavarur nga kjo botë. Mëshira dhe dhembshuria që ndjente për umetin e vet, e bënte të harronte urinë.

vështirësitë që po kaloj! O Zot! Udhëzoje popullin tim; ata nuk e dinë. O Zot! Kërkoj faljen Tënde, derisa Ti të jesh i kënaqur..."

(Ibn-i Hisham, II, 29-30; Hejthemi, VI, 35.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ndryshoi, as kur jetonte në skamje, e as kur i erdhën pasuritë dhe plaçka e luftës. Kur s'ka pasur, lidhte edhe gurë në bark nga uria, e kur ka pasur me bollëk, ai gjithmonë e ka falur çfarëdo që i ka ardhur, duke mbajtur për vete vetëm aq sa i mjaftonte për të jetuar. Nëna jonë Aisha ؓ, e shpreh me këto fjalë jetesën tejet të thjeshtë të tij dhe të familjes së tij:

"Që prej ditës kur erdhën në Medinë e deri kur ai ndërroi jetë (Profeti), familja e Muhamedit ﷺ, nuk është ngopur asnjëherë me bukë gruri tri net me radhë." (Muslim, Zuhd, 20.)

Sipas një transmetimi tjetër, nëna jonë Aisha ؓ, e vazhdon kështu fjalën e vet:

"Po të donim, mund të ngopeshim."

(Pra kjo uri nuk ishte nga skamja. Neve na vinin dhurata dhe plaçkë lufte.)

Por i Dërguari i Allahut përmbushte fillimisht nevojat e vëllezërve të tij besimtarë. (Kështu, sa herë na dhurohej diçka e ndanim për vëllezërit tanë.)" (Bejhaki, Shuab, III/62 [1396].)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ishte i pavarur nga kjo botë. Mëshira dhe dhembshuria që ndjente për umetin e vet, e bënte të harronte urinë.

Kur u gurëzua në Taif, aq sa iu gjakosën edhe këmbët, ai nuk e humbi vullnetin për



të thirrur në rrugë të Allahut. Po ashtu, edhe kur u kthye në Mekë si triumfues, nuk hyri aty me mburrje e krenari, por tregoi një përulësi dhe modesti të jashtëzakonshme, duke qëndruar i kërrusur si në sexhde mbi devenë e tij. Pra, sprovat e shumta dhe të vështira që kanë lënë në klasë shumë njerëz të shquar, vetëm sa e kanë soditur nivelin e lartë të personalitetit të Profetit tonë ﷺ.

RUAJTJA E PJEKURISË SHPIRTËRORE TË FITUAR GJATË RAMAZANIT

Allahu i Madhëruar urdhëron:

«فَاسْتَقِمَّ كَمَا أَمَرْتُ»

“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!..” (Hud, 112)

Ruajtja dhe mos humbja e gjendjes shpirtërore të fituar gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, është vetë rruga e drejtë që kërkohet prej nesh. Pra, vazhdimi pandërprerje i veprave të mira dhe adhurimeve që fillojnë bashkë me Ramazanin, janë pikërisht rruga e drejtë që synojmë. Po ashtu, edhe ruajtja e teubeve që bëhen gjatë Ramazanit dhe mos rënia përsëri në të njëjtat gjynahe e gabime, është rruga e drejtë.

E rëndësishme, është që të arrijmë ta vazhdojmë gjendjen tonë shpirtërore të Ramazanit përgjatë gjithë jetës. Lidhur me këtë çështje, Mualla bin Fadl ka thënë:



Të njohësh dhe të flasësh për Profetin ﷺ, të lexosh dhe të mësosh përmendësh porosinë e tij, duhet të jetë një shkallë drejt afimit me të, me trup dhe me shpirt.

“Të parët tanë të mirë, gjashtë muaj i luteshin Allahut që t’u jepte jetë deri në Ramazan. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, i luteshin që t’u pranohej Ramazani që kaluan.” (Kiuamu’s-Sunne, et-Tergib ue’t-Terhib, II, 354.)

Egoja dhe shejtani përpiqen t’i afrohen me joshje njeriut që sapo ka dalë nga muaji i Ramazanit. Ata e nxisin në vetëbesim duke i kujtuar veprat e mira që ka bërë dhe përpiqen ta devijojnë atë nga vazhdimësia në rrugën e drejtë. Mirëpo, nuk duhet harruar se; vdekja mund të vijë në çdo çast dhe ne jemi urdhëruar të mos devijojmë nga rruga e drejtë dhe devotshmëria sa të jemi gjallë. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Si të jetoni, ashtu do të vdisni; si të vdisni, ashtu do të ringjalleni.” (Munavi, Fejdul-Kadir, V, 663.)

Nëse gjatë baticave dhe zbaticave të jetës ecet tepër me zigzage, ka rrezik që vdekja të na kapë gafil. Sa e frikshme do të ishte nëse do ta jepnim shpirtin në një moment kur jemi duke vepruar gjynahe!

Osmani ﷺ, ka thënë:


“Besimtari i vërtetë ka gjashtë lloj frikash:

1- Frika se mos Allahu Teala mund t’ia marrë besimin.

2- Frika se mos melekët shkruajnë gjërat që mund ta poshtërojnë atë ditën e kiametit.

3- Frika se mos shejtani i mallkuar ia çon dëm veprat e tij.

4- Frika se mos meleku i vdekjes, Azraili ia merr shpirtin në befasi, në ndonjë moment neglizhence ndaj Allahut Teala.



5- *Frika e mburrjes me këtë botë dhe e neglizhimit të ahiretit.*


6- *Frika se mos humbet shumë në preokupimin me fëmijët e gruan dhe nuk preokupohet mjaftueshëm me përkujtimin e Allahut Teala.”*

Nëse ruhet orientimi në rrugë të drejtë, pas një vdekjeje të bukur dhe të mirë, gëzohet një jetë e re, e lumtur dhe fatlume. Dhe ky është bajrami më i bukur. Bajrami që vjen pas një Ramazani të bekuar, të kaluar në devotshmëri dhe në përputhje me kënaqësinë e Allahut, është si gëzimi i marrjes së një diplome.

Që të dy bajramet janë dhuruar si shpërblime për besimtarët. Bajrami i Fitrit është shpërblimi i një programi adhurimesh i pasuruar me agjërime, sadaka, namaze vullnetare dhe lexim Kurani. Ndërsa Bajrami i Kurbanit, është një shpërblim hyjnor në këmbim të dorëzimit dhe sakrificës së besimtarëve. Dhe, bajramet e përjetuara me këtë vetëdije, duhet të gjallërohen me kryerjen e detyrave ndaj të afërmeve dhe vëllezërve të fesë. Gjatë gëzimeve ka gjithmonë solidaritet. Prandaj, gëzimi ynë gjatë bajrameve, duhet të kalojë në solidaritet me vëllezërit. Nëse gjatë këtyre bajrameve gëzojmë njerëzit e familjes, të afërmit, fqinjët, të varfrit, të vetmuarit, jetimët dhe të pashpresët, atëherë do gëzojmë edhe bajramet në të dyja botët.

• Allahu i Madhëruar e ka pastruar plotësisht moralin dhe natyrën e Profetit tonë ﷺ dhe ka urdhëruar:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ



“(Pa dyshim) se ti ke moral madhështor!” (Kalem, 4)

Ai që përpiket të tregojë cilësitë dhe vlerën e Profetit tonë ﷺ, nuk bën gjë tjetër veçse lartëson vlerën e vet, sepse vlerën e Profetit ﷺ, e ka lartësuar Vetë Allahut i Madhëruar. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë sahabi poet, Hasan bin Thabiti رضي الله عنه:

“Unë nuk lavdërova Muhamedin ﷺ, me fjalët e mia, por fjalët e mia i lavdërova dhe i zbukurova me Muhamedin ﷺ.”

Të njohësh dhe të flasësh për Profetin ﷺ, të lexosh dhe të mësosh përmendësh porositë e tij, duhet të jetë një shkallë drejt afrimit me të, me trup dhe me shpirt, sepse Profeti ynë ﷺ, thotë:

الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ


“Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.)

Mësimi i këtyre virtyteve të tij të veçanta vetëm për ta admiruar, nuk është e mjaftueshme. Ne duhet ta ndjekim atë dhe të jetojmë çdo çast të jetës sonë me kriteret që solli ai, duke vënë në jetë sunetin e tij.

Lum ata që e pasojnë Profetin tonë ﷺ dhe ecin gjithmonë në rrugën e drejtë që na ka treguar ai dhe pranohen në grupin e atyre të cilët ai i ka quajtur “vëllezërit e mi”!..

Na e bëj të mundur o Allah!..

O Allah! Na pastro nga ndjenjat me të cilat nuk janë të kënaqura zemrat tona. Na bëj prej atyre që arrijnë të zotërojnë zemër



të pastër duke pasuar të Dërguarin Tënd
fisnik ﷺ dhe prej atyre që arrijnë të fitojnë
mirësitë e Xhenetit dhe bukurinë Tëndel!..

Amin!..

A decorative frame with a yellow border and Islamic calligraphy in red and green at the top and bottom. Inside the frame, at the top, is a photograph of two wooden bowls filled with dates on a wooden surface. Below the image is a text block in Albanian, followed by a citation.

Abdullah Ibni Mes'ud
ﷺ, tregon:
"Tek ne,
reflektoheshin gjendje
të tilla prej Profetit
ﷺ, saqë dëgjonim
edhe dhikrin e
kafshatave të bukës
që kapërdnim."
(Buhari, Menakib, 25.)

MORALI I TIJ MADHËSHTOR



BOTËKUPIMI ISLAM

Ai që nuk e njeh gjuhën e nënës me thellësitë fetare dhe historike, do të përballet me rrezikun e tjetërsimit, edhe nëse njeh shumë gjuhë të huaja. Po ashtu, ai që nuk e ndërton karakterin dhe personalitetin në bazë të Kuranit dhe Sunetit, do të mbetet i mjeruar në të dyja botët në çdo aspekt të jetës.



BOTËKUPËTIMI ISLAM

MBROJTJA E IDENTITETIT

Feja e vërtetë tek Allahu, është Islami. Profeti ynë ﷺ, e ka kumtuar Islamin si thirrja e fundit hyjnore drejtuar gjithë njerëzimit. Prandaj, individi dhe shoqëria myslimane, duhet të jetoj brenda kulturës dhe identitetit Islam.

Themelet e kulturës përbëhen nga tri elemente:

Feja, gjuha dhe historia.

Thelbi i kulturës, është vetëdija e fetare, gjuhësore dhe historike. Këto janë shtyllat kryesore të ndërtesës së kulturës, mbi të cilat qëndrojnë në këmbë dhe vazhdojnë ekzistencën individët dhe shoqëritë.

Islami përfshin çdo fazë të jetës. Ai i jep përgjigje çdo pyetjeje për të realizuar qëllimin e arritjes së lumturisë në të dyja botët. Dhe, mes të gjitha përgjigjeve, nuk mund të gjesh as edhe një kontradiktë. Islami ka sistem dhe disiplinë. Ai është më

i përsosuri i të përsosurve. Ai përgatit dhe realizon lumturinë e të dy botëve për besimtarët e devotshëm.

Në ditët tona; në injorancën moderne që ka bërë që të harrohet bota tjetër, ekziston një botëkuptim fetar “i vakët” që përbëhet vetëm nga parime morale të burgosura në ndërgjegje dhe në vend-adhurime. Po ashtu, janë shfaqur edhe botëkuptime absurde si “deizmi” që është larg ligjeve dhe gjykimeve hyjnore, dhe “historicizmi” që është një lloj injorance e cila pretendon të nxjerrë në pension gjykimet e fesë.

Ndërsa Islami, që është feja e vërtetë, nuk mjaftohet vetëm me sistemimin e jetës fetare të besimtarëve, por njëkohësisht vë rregull edhe në jetën e tyre në mënyrën më të bukur dhe me kriteret më ideale, duke filluar prej individit, deri tek familja, shoqëria, jeta private e publike; prej ushqimit, tek ekonomia dhe në çdo fushë tjetër të jetës. Pra, Islami posedon udhëzime dhe vendime në lidhje me të gjitha aktivitetet njerëzore.

Islami përfshin çdo fazë të jetës. Ai i jep përgjigje çdo pyetjeje për të realizuar qëllimin e arritjes së lumturisë në të dy botët. Dhe mes të gjitha përgjigjeve nuk mund të gjesh as edhe një kontradiktë.



Feja është një sistem ligjesh dhe rregullash që i jep paqe shpirtërore njeriut në këtë botë dhe i hap rrugën e lumturisë së përjetshme në botën tjetër.

Kurani Fisnik është burimi kryesor i kulturës së vërtetë dhe origjinale. Dijet që përmban Kurani, mund të përmbledhen në këto pesë tema kryesore:

KULTURA E KURANIT

1. Shkenca e gjykimeve juridike:

- Mëson parimet lidhur me besimin.

- Njofton me gjykimet që lidhen me adhurimet.

- Shpjegon cilësitë negative që të largojnë nga Allahu; haramet e dukshme dhe të fshehta.

- Radhit gjykimet e nevojshme për përmirësimin e shoqërisë, pra farzet (obligimet) e dukshme dhe të fshehta.

- Predikon parimet e përgjithshme të së drejtës në çështjet ekonomike dhe financiare.

- Ndërton gjykimet në lidhje me familjen.

- Vendos ligjet që kanë të bëjnë me luftën.

- Përcakton ligjet në lidhje me robërit e luftës.

- I jep qetësi mendjes me anë të dorëzimit ndaj temave që predikon shpallja hyjnore dhe zhvillon zemrën.

2. Shkenca e dialogut:

I jep përgjigje pretendimeve që nuk përputhen me besimin monoteist dhe shpalos pavlefshmërinë e të kotës dhe të prishurës.

3. Ajetet në lidhje me botën:

Përkujtojnë mirësitë e Allahut dhe nxisin në meditimin rreth tyre. Po ashtu, të vetëdijesojnë ndaj artit të Allahut në botën tonë të brendshme dhe të jashtme, duke na ndihmuar të arrijmë tek Artisti nëpërmjet artit, tek Shkaktari nëpërmjet pasojës.



Ndërsa Islami, që është feja e vërtetë, është më i përsosuri i të përsosurve. Ai përgatit dhe realizon lumturinë e të dy botëve për besimtarët e devotshëm.

4. Morali i historive:

Tregon dhe shpjegon urtësitë e Allahut në historinë njerëzore, historitë e profetëve, skenat mësimdhënëse prej ithtarëve të librit (jahuditë dhe të krishterët) dhe fatkeqësitë që pësuan popujt e devijuar si Sodoma dhe Gomorra, me qëllim që njerëzimi të marrë mësim. Po ashtu, Kurani është edhe burimi më i rëndësishëm i historisë së Profetit ﷺ, i cili është shembulli më i mirë për ne.

5. Njohuritë në lidhje me vdekjen dhe përtej saj

Na njofton me fazat e vdekjes dhe çka vjen përtej saj. Na përgatit për jetën e përjetshme, e cila është edhe jeta e vërtetë, dhe na njeh me mënyrat për t'u miqësuar me Allahun e Madhëruar, me qëllim që të çlirohemi nga frika dhe hidhërimi në ditët e vështira në botën tjetër.

Të gjitha këto që përmendëm, formojnë “Kulturën e Kuranit”, që është kultura më e përsosur dhe më madhështore. Ashtu siç ka ndriçuar të djeshmen dhe të sotshmen e njerëzimit, edhe nesër, i vetmi botëkuptim që do ta udhëzojë njerëzimin është Islami. Ndërsa udhëheqësi i vetëm i kësaj kulture, në të gjitha fushat e jetës, është Profeti Muhamed ﷺ. Gjithashtu, ata që e kanë mësuar më mirë e më bukur këtë kulturë prej Profetit ﷺ, janë sahabët dhe dijetarët.

*Paralajmërim
profetik: “Allahu
të dhëntë mirësi o
Muadh! E çfarë tjetër
përveç gjuhës së tyre
i zvarrit njerëzit për
fytyre në xhehenem?..”*

(Hakim, IV, 319/7774.)



Islami nuk është thjeshtë një ideologji, por zotëron një botëkuptim mbi të gjitha ideologjitë. Ai është i vërtetë, i përsosur

dhe i fal individit e shoqërisë lumturinë e të dyja botëve.

Çdo qytetërim formon modelin e vet njerëzor. Qytetërimi ynë është qytetërimi i Kuranit dhe Sunetit. Nisur nga kjo, mund të themi se periudha e Hulefa-i Rashidin, ajo e Omer bin Abdulazizit dhe tre shekujt e parë të Osmanëve, kur botën e sundonte botëkuptimi Islam, kanë qenë periudhat më të mira të historisë njerëzore.

RËNDËSIA E GJUHËS

Feja kuptohet dhe shprehet me anë të gjuhës. Të gjitha fletët dhe librat hyjnorë i janë shpallur njeriut me gjuhë të qartë. E, në mënyrë të veçantë Kurani Fisnik, i cili është mrekullia e Profetit tonë ﷺ, që do të vazhdojë deri në ditën e kiametit dhe mbrojtja e të cilit është garantuar nga Vetë Allahu i Madhëruar.

Para se të zbriste Kurani, arabëve u ishte dhënë një prirje e veçantë në aspektin gjuhësor, gjë që luajti rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhës arabe. Aq, sa letërsia dhe oratoria arritën kulmin dhe çdo vit organizoheshin panaire letrare. Në një periudhë kur gjuhët e tjera ecnin ende këmbadoras, gjuha arabe kishte arritur majat.

Në këto kushte, u zbrit edhe Kurani Fisnik. Kurani, i cili i përkiste plotësisht Allahut, si në kuptim, ashtu edhe në fjalë, i bëri memecë të gjithë poetët dhe letrarët më të fortë, të cilët ishin njerëzit më kompetentë të kësaj gjuhe që kishte ar-



“...Kush i beson Allahut dhe ditës së gjykimit, ose të flasë fjalë të mira ose të heshtë. Të mos flasë fjalë të këqija! Përfitoni duke thënë fjalë të mira dhe arrini paqen dhe qetësinë duke mos thënë fjalë të këqija”.

(Hakim, IV, 319/7774.)

ritur majat në elokuencë dhe retorikë. Kurani Fisnik i sfidoi të gjithë duke thënë: “...le të sjellin një libër të ngjashëm me të!..” (shih. Tur, 34) Por askush nuk guxoi ta pranonte këtë sfidë.

Madje, edhe popujt e tjerë që u nderuan me Islam, morën nga arabishtja konceptet fetare, duke pasuruar kështu thesarin e gjuhëve të tyre. Nga kjo gjuhë e Kuranit dhe Sunetit, ata morën në mënyrë të veçantë konceptet abstrakte dhe metafizike.

Fjala vjen, Turqit e hershëm kanë qenë shamanistë. Në gjuhën e tyre thuajse s’ka pasur fare fjalë për konceptet metafizike. Kur u udhëzuan në Islam, u shfaq edhe nevoja për një gjë të tillë. E, natyrisht që këtë nevojë, e plotësuan duke gërshtuar gjuhën e tyre me fjalët dhe konceptet e arabishtes, që është edhe

gjuha e Kuranit dhe dijeve Islame. Në këtë mënyrë, me qëllim që ta përfshin Islamin në çdo fushë të jetës, ata e rindërtuan gjuhën e tyre me anë të Kuranit. Për shembull; thuajse të gjitha fjalët që përdoren në suren e parë të Kuranit, suren el-Fatiha, janë bërë pjesë e gjuhës turke: *İsim, hamd, Rab, alem, Rahman, Rahim, (rahmet), malik (mülk, emlak, melik, memleket), yevm, (yevmiye), din, ibadet, (mabed, abid, mabud), hidayet, sırat, müstakim, (istikamet), nimet, gayri, gazap dhe dalalet...*



Popujt që u nderuan me Islam, arritën paqe dhe fitore të mëdha për aq kohë sa qëndruan në rrugën e kulturës së Kuranit dhe Sunetit. Por, kur ata u larguan nga Islami, filloi rënia dhe dështimi.

Të gjitha këto fjalë bëhen familjare për ata që lexojnë dhe dëgjojnë suren el-Fatiha. Pra, çdo turk që këndon suren Fatiha, e kupton atë dhe në të njëjtën kohë, në

gjuhën e përditshme përdor shpesh fjalë prej Kuranit Fisnik.

Të vërteta e fesë, duhen shprehur në gjuhën më të bukur, sepse feja jonë bazohet në predikim dhe urdhërimin e së mirës dhe pengimit nga e keqja, që në Kuranin Fisnik përmenden në 11 vende:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ
وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ ...

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun!..” (Al-i Imran, 110)

Kjo është e mundur vetëm në saje të fjalës dhe veprës, pra, të predikimit dhe zbatimit. Elementi më i rëndësishëm në lidhje me gjuhën, është që çdo fjalë të jetë moralisht e drejtë dhe e bukur. I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka mësuar shumë bukur sahabët në lidhje me këtë çështje:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte duke udhëtuar mbi devenë e tij, ndërkohë që shokët e tij ecnin përpara. Muadh bin Xhebeli رضي الله عنه, pyeti:

- O i Dërguari i Allahut! Nëse nuk ju bezdis, a më lejoni të vij pranë jush?

Me t’i dhënë leje Profeti ﷺ, Muadhi رضي الله عنه tha:

- Të qoftë falë jeta ime o i Dërguari i Allahut! I lutem Allahut që të na e marri shpirtin para teje. Qoftë larg, por nëse t’i ndërron jetë para nesh, çfarë adhurimesh të bëjmë pas teje?



Kultura më e përsosur dhe më madhështore është ajo e Kuranit. Ashtu siç ka ndriçuar të djeshmen dhe të sotshmen e njerëzimit, edhe nesër i vetmi botëkuptim që do ta udhëzojë njerëzimin është Islami.

Profeti ﷺ, nuk iu përgjigj kësaj pyetje. Por Muadhi ﷺ, pyeti përsëri:

- A të bëjmë xhihad në rrugën e Allahut?

Atëherë, Profeti ﷺ, urdhëroi e tha:

- *“Xhihadi në rrugën e Allahut është gjë e bukur, por për njerëzit ka diçka më të mirë se ai”*.

- Të agjërosh dhe të japësh zekat apo jo? - tha Muadhi ﷺ.

- *“Edhe të agjërosh dhe të japësh zekat është gjë e bukur”*. - tha Profeti ﷺ.

Pas kësaj Muadhi ﷺ, përmendi të gjitha të mirat që mund të bëjë njeriu. Por i Dërguari i Allahut ﷺ, vazhdonte të thoshte:

“Për njerëzit ka diçka më të mirë se ajo”.

Më në fund Muadhi ﷺ, pyeti:

- Të qofshin falë jeta e babait dhe nënës sime. Çfarë është më e mirë për njeriun?

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Nëse nuk flet diçka të mirë, le të heshtë!”

- A do të japim llogari edhe për ato që flasim? pyeti Muadhi ﷺ. Profeti ﷺ, duke e rrahur lehtë gjurin e Muadhit, tha:

“Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! E çfarë tjetër përveç gjuhës së tyre i zvarrit njerëzit për fytyre në xhehenem? Kush

Udhëheqësi i vetëm i kulturës Islame në të gjitha fushat e jetës, është Profeti ﷺ. Gjithashtu, ata që e kanë mësuar më mirë e më bukur këtë kulturë prej Profetit ﷺ, janë sahabët dhe dijetarët.



i beson Allahut dhe ditës së gjykimit, ose të flasë fjalë të mira ose të heshtë. Të mos flasë fjalë të këqija! Përfitoni duke thënë fjalë të mira dhe arrini paqen dhe qetësinë duke mos thënë fjalë të këqija”. (Hakim, IV, 319/7774.)

Islami kërkon delikatesë dhe edukatë të veçantë prej besimtarit. Lidhur me edukatën dhe delikatesën në të folur, Allahu i Madhëruar i ka përcaktuar disa rregulla, të cilat po i përsërisim edhe njëherë:

KERIM, MARIF, LEJJIN...

Allahu na urdhëron të themi: **قَوْلًا كَرِيمًا** (kaulen kerima), pra fjalë të buta dhe përgëzuese ndaj prindërve dhe të mos u themi madje as “of”. (shih. Isra, 23)

Nëse nuk kemi diçka për t’i dhënë të varfërve dhe të mjerëve, Kurani na urdhëron që të paktën t’u themi: **قَوْلًا مَيْسُورًا** (kaulen mejsura), pra fjalë dashamirëse të cilat u qetësojnë shpirtin dhe i ngushëllojnë. (shih. Isra, 28)

Ai, përsëri na urdhëron që ndaj jetimëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje, si të ishin zogj krahë thyer, ndaj të afërmve dhe të vetmuarve, të themi: **قَوْلًا مَعْرُوفًا** (kaulen ma’rufa), Pra, fjalë të bukura dhe të ëmbla. (shih. Nisa, 5, 8)

Edhe për ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, Kurani na urdhëron të themi: **قَوْلًا مَعْرُوفًا** (kaulen ma’rufa), pa i fajësuar dhe pa u bërë shkas ngatërresash dhe keqkuptimesh. (shih. Ahzab, 32)

Islami nuk është thjeshtë një ideologji, por zotëron një botëkuptim mbi të gjitha ideologjitë, i cili është i vërtetë, i përsosur dhe i fal individit e shoqërisë lumturinë e të dyja botëve.



Ndërsa për të zbutur zemrat e zullumqarëve, Kurani na urdhëron të themi: **قَوْلًا لَّيِّنًا** (kaulen lejjina), pra fjalë të buta.

(shih. TaHa, 44)

Ebu Kursafe رضي الله عنه, na e tregon shumë bukur se, sa të mreku-llueshme ishin kriteret dhe parimet e gjuhës që përdorte Profeti ynë i nderuar ﷺ:

Unë, nëna dhe tezja ime shkuam tek Resulullahu ﷺ. Pa-si i dhamë besën dhe u ndamë prej tij, nëna dhe tezja ime më thanë:

“Biri im, nuk kemi parë ndonjëherë si ky njeri! Nuk dimë të ketë njeri tjetër me fytyrë më të bukur, me rroba më të pastra dhe me fjalë më të buta se të tijat. Prej gojës së tij të bekuar si-kur përhapej dritë.” (Hejthemi, VIII, 279-280.)

Shkurtimisht, besimtari duhet ta edukojë gjuhën e tij nën dritën e këtyre kriterëve hyjnore dhe nuk duhet ta harrojë kur-rë urdhrin e Allahut të Madhëruar:

“...Do t’u thoni fjalë të mira njerëz-ve!..” (Bekare, 83.)


Përdorimi i gjuhës/fjalës është art që varet nga gjendja e zemrës. Në një ajet fisnik urdhërohet:

عَلَّمَهُ الْبَيَانَ

“(Rrahmani) i ka mësuar atij të folu-rit e qartë.” (Rahman, 4)

Synimi i kësaj mirësie hyjnore, është që të flitet e drejta dhe të përmendet Al-lahu. Këtë të vërtetë e shpjegon shumë bukur kjo ndodhi:

Periudha e Hulefa-i Rashidin, ajo e Omer bin Abdulazizit dhe tre shekujt e parë të Osmanëve, kur botën e sundonte botëkuptimi Islam, kanë qenë periudhat më të mira të historisë njerëzore.



Ibrahim bin Ed'hemi kishte larë gojën e një pijaneci, i cili mbante erë të ndyrë. Kur u pyet se pse e bëri këtë, ai tha:

- Nëse do t'ia kisha lënë ashtu, me erë të keqe dhe të pistë gjuhën dhe gojën e tij, të cilat janë krijuar për të falënderuar Allahun e Madhëruar, do të ishte mungesë respekti...

Kur pijaneci erdhi në vete, i thanë:

Zahidi nga Horasani, Ibrahim bin Ed'hemi të ka larë gojën...

Zemra e pijanecit, që u turpërua nga kjo ndodhi, u zgjua nga gjumi i shkujdesjes dhe tha:

- Atëherë edhe unë u pendova!...

Arsyeja që Ibrahim bin Ed'hemi, u bë shkak i këtij udhëzimi, bëri që Allahu, t'i flasë në ëndërr, duke e përgëzuar me këto fjalë:

- Ti e pastrove gojën e tij për Ne! Prandaj edhe Ne e pas-truam zemrën e tij për ty!..

Elementi i tretë e kulturës, është:

HISTORIA

Historia është shkenca që analizon ngjarjet me anë të shkaqeve dhe përfundimeve. Në të njëjtën kohë, në kuadër të elementeve të gjuhës dhe fesë, historia mund të analizojë shkaqet dhe përfundimet e ngjarjeve që përjeton njerëzimi, me qëllim që të përcaktojë ligjet hyjnore. Kjo, sepse ashtu si

Aty mbaron e shkuara, mbaron kombi, mbaron njeriu, mbaron arsyeja. Sepse kombi, nga një aspekt, është i përbërë prej historisë. Nëse e largoni atë nga vlerat shpirtërore dhe vetëdija e historisë, pas mbetet vetëm një tufë njerëzish.



individit, edhe shoqëritë dhe popujt kanë kaderin/caktimin e tyre hyjnor, i cili përcaktohet nga ligjet hyjnore. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete...” (Ra’d, 11)

“Kështu u ndodhi edhe ithtarëve të Faraonit dhe atyre që kanë qenë para tyre. Ata i mohuan shpalljet e Allahut dhe Ai i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre.

Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm dhe ndëshkon ashpër.

Kjo ndodh se Allahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”
(Enfal, 52-53)



Në kohën tonë, kur shpenzohet kohë e gjatë dhe shuma të mëdha për arsimim, këto tre elementë duhet të përbëjnë edukimin kryesor që do t’u jepet brezave të rinj, sepse ata janë tre mbrojtësit e kulturës dhe identitetit kombëtar.

Nga kjo pikëpamje;

Historia është memoria e një populli dhe përmbledhja e eksperiencave kombëtare.

Një e treta e Kuranit Fisnik përbëhet nga historitë e profetëve dhe tregimet mësimdhënëse. E thënë ndryshe, historia e popujve të shpëtuar dhe atyre të shka-tërruar.

Nëse popujt e shkuar analizohen me shkaqet dhe përfundimet e tyre, ata bëhen si një pusullë për të ardhmen. Për këtë arsye është thënë se, “historia

përsëritet”. Duke u nisur nga kjo thënie, poeti i mirënjohur Mehmed Akif Ersoj, bën thirrje që të marrim mësim prej historisë:

Historia përsëritet, thonë;

A do të përsëritej, nëse mësim do ishte marrë!?

Nëse i hedhim një sy historisë, në të kaluarën e arabëve të kohës së injorancës, tek të cilët u shpall Islami, në një krah qëndrojnë popujt e shkatërruar për shkak të arrogancës dhe padrejtësive që bënin, si Adi dhe Themudi, ndërsa në krahun tjetër qëndrojnë njerëz me personalitet të lartë, prej të cilëve duhet marrë shembull, si Ibrahim عليه السلام dhe djali i tij Ismaili عليه السلام. Ajo histori e shenjtë kishte kujtimet e veta, si Qabja, Arafati, etj. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

مَلَّةَ أَبِيكُمْ إِبْرَاهِيمَ

“...Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit!..” (Haxhxh, 78)

Popujt që u nderuan me Islam, arritën paqe dhe fitore të mëdha, për aq kohë sa qëndruan në rrugën e kulturës së Kuranit dhe Sunetit. Por, kur ata u larguan nga Islami, filloi rënia dhe dështimi.

Për këtë arsye, rinia Islame, bashkë me fenë e vërtetë dhe gjuhën, duhet të mësojë shumë mirë edhe historinë e vet, të mbushur me mësim.



*Një njeri i urtë
thotë:*

*“Është e habitshme
se; kur një njeri
vdes, ai jep llogari
për gjithë pasurinë
e vet, edhe pse
tashmë nuk e
gëzon më atë.”*

KY ËSHTË ARSIMIMI I VËRTETË!..

Për këtë arsye, aty ku mbaron e shkuara, mbaron kombi, mbaron njeriu, mbaron arsyeja. Sepse kombi, nga një aspekt, është i përbërë prej historisë. Nëse e largoni atë nga vlerat shpirtërore dhe vetëdija e historisë, pas, mbetet vetëm një tufë njerëzish.

Por brezat që u këndojnë fëmijëve të tyre historinë e lavdishme dhe triumfet e mëdha si ninulla, jo për t'i vënë në gjumë, por për t'u zgjuar shpirtin dhe vetëdijen, do ta ruajnë besimin, kombin dhe të gjitha vlerat materialo-shpirtërore të tyre.

Në kohën tonë, kur shpenzohet kohë e gjatë dhe shuma të mëdha për arsimim, këto tre elementë duhet të përbëjnë edukimin kryesor që do t'u jepet brezave të rinj, sepse ata janë tre mbrojtësit e kulturës dhe identitetit kombëtar.

*Allahu na
urdhëron të themi;*

قَوْلًا كَرِيمًا

*kaulen kerima",
pra fjalë të buta
dhe përgëzuese ndaj
prindërve dhe të mos
u themi madje as
"of". (shih. Isra, 23.)*



Një i ri që nuk e njeh gjuhën e nënës me thellësitë fetare dhe historike, do të përballlet me rrezikun e tjetërsimit, edhe nëse njeh gjuhë të huaja. Po ashtu, ai që nuk e ndërton karakterin dhe personalitetin në Kuran dhe Sunet, do të mbetet i mjeruar në të dyja botët në çdo aspekt të jetës.

I lutemi Zoti tonë që të na e bëjë të mundur ruajtjen e gjuhës, kulturës Kur'anore dhe identitetit tonë Islam. Allahu na forcoftë mendjet që të marrim mësim prej historisë dhe marrim shembull prej të parëve tanë të devotshëm e syptrem-

bur, që u përpoqën gjithë jetën për të ngritur dhe përhapur fenë e Allahut të Madhëruar.

Amin!..




Ndaj jetimëve, të cilët kanë nevojë për mbrojtje si të ishin zogj krahë thyer, ndaj të afërmeve dhe të vetmuarve duhet të themi:

قَوْلًا مَّعْرُوفًا

*kaulen ma'rufa".
Pra, fjalë të bukura
dhe të ëmbla.*

(shih. Nisa, 5, 8.)





MORALI I BESIMIT dhe RAMAZANI I BEKUAR

Ka dy lloje trashëgimish:

- **Trashëgimia materiale:** Pasuria që ndahet sipas kritereve që ka përcaktuar Allahu.
- **Trashëgimia shpirtërore:** Morali, edukata dhe personaliteti Islam që na lënë prindërit.



MORALI I BESIMIT dhe RAMAZANI I BEKUAR

NJERËZIT PRANË PROFETIT ﷺ.

I Dërguari i Allahut ﷺ, është shembulli më i bukur dhe më i përsosur për ne. Po ashtu, edhe sahabët, të cilët u edukuan në duart e tij ﷺ dhe dëshmuan hap pas hapi zbritjen e Kuranit dhe predikimin e Islamit, janë brezi më shembullor për ne. Ata do të jetë modeli më i mirë i një shoqërie ideale deri në ditën e kiametit... Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Teube, 100)

Pra, rruga e vetme për të arritur kënaqësinë e Allahut dhe lumturinë e të dyja botëve, është pasimi i Profetit tonë ﷺ dhe

sahabëve të tij të nderuar. Për rrjedhojë, njohja e tyre, është një domosdoshmëri për ne. Ne duhet t'i pasojmë ata në të njëjtat virtyte me të cilat na i prezanton Vetë Allahu i Madhëruar.

Në ajetin e fundit të sures Fet'h, Allahu na njeh me sahabët dhe na bën të ditura parimet më të rëndësishme të jetës individuale dhe shoqërore. Le ta analizojmë pak këtë ajet madhështor:

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve...”

Allahu i Lartësuar, si cilësi të parë të atyre që gjenden pranë të Dërguarit të Tij ﷺ, na tregon faktin se ata janë: “Të ashpër ndaj jobesimtarëve”.

Ky qëndrim, është një domosdoshmëri e besimit, sepse edhe një besimtar me besimin më të dobët në zemrën e tij, duhet ta urrejë një vepër me të cilën nuk është i kënaqur Allahu.

*Një njeri i urtë
thotë:*

*“Është e habitshme
se; kur një njeri
vdes, ai jep llogari
për gjithë pasurinë
e vet, edhe pse
tashmë nuk e gëzon
më atë.”*

Tregues i besimit, është “dashuria ndaj atij që e meriton dhe urrejtja ndaj atij që e ka hak”. Sahabët kanë kaluar sprovat të shumta në këtë çështje. Në një kohë kur “lidhja e gjakut” ishte shumë e rëndësishme dhe e fortë, ata mësuan “të duan dhe të urrejnë vetëm për hir të Allahut”. Ata nuk pasuan prindërit apo shoqërinë që i largonte nga Allahu, por Profetin e Allahut ﷺ. Besimtarët pa mbështetje, iu nënshtruan torturave të rënda. P.sh; Bila-

li dhe Habbabi رضي الله عنه, u shtypën me gurë të rëndë nën diellin përvëlues. Megjithatë, ata nuk hoqën dorë dhe nuk lëshuan pe nga besimi i tyre. Ndërsa shumë të tjerë, si Jasiri dhe bashkëshortja e tij Thumeje رضي الله عنها, ia dorëzuan shpirtin Allahut dhe e mbrojtën besimin e tyre monoteist.

Periudha e Mekës, ishte koha e këtij edukimi të fortë dhe të palëkundur. Në fakt, në këtë periudhë dolën pak sahabë, por ishin të veçantë dhe të fort në besim. Kështu, themelet e forta të shoqërisë së parë Islame, u hodhën në këtë periudhë vuajtjesh dhe vështirësish.

Historia e monoteizmit është e mbushur me shembuj heronjsh, të cilët nuk kanë lëshuar pe në besimin e tyre në një Zot të vetëm. Ja disa shembuj:

HERONJTË E MONOTEIZMIT

Faraoni kishte mbledhur magjistarët më të zotë të vendit me qëllim që të mposhtnin mrekullitë e Musait عليه السلام dhe u kishte premtuar atyre shumë pasuri. Dita e caktuar erdhi dhe me ndihmën e Allahut, Musai عليه السلام, triumfoi mbi magjitë e tyre. Aty, magjistarët e kuptuan se mrekullia që shfaqti Musai عليه السلام, nuk ishte magji, po diçka hyjnore. Për këtë arsye, ata ranë menjëherë në sexhde dhe thanë:

“Ne i besuam Zotit të botëve!” (A'raf, 121)

Omer bin Abdulazizit i thanë:
“Do të ishte mirë që fëmijëve t'u linit si trashëgimi ndonjë të ardhur nga buxheti i shtetit!” Ai u përgjigj:
“Nëse fëmijët e mi që do të lë pas bëhen prej njerëzve të devotshëm, nuk kam frikë se ata do të bien në vështirësi. Por nëse ata bëhen mendjelehtë dhe jo të devotshëm, atëherë s'ka ç'tu lë njerëzve të tillë.”



Faraoni gati sa nuk u çmend përballë këtyre fjalëve dhe filloi t'i kërcënonte me jetë. Mirëpo, magjistarët nuk iu nënshtruan aspak kërcënimeve të faraonit. Edhe pse ai u tha se do t'ua priste krahët e këmbët dhe do t'i vriste me tortura, ata iu përgjigjën:

“...Gjyko si të duash; ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bo-te!” (TaHa, 72)

Më pas, për të mos u mposhtur nga dhimbjet e torturave, ata iu lutën Allahut duke thënë:

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَقَّنَا مُسْلِمِينَ

“...O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!” (Araf, 126)

Ata i kishte përfshirë aq shumë entuziazmi i besimit, sa që nuk e çonin fare nëpër mend t'i luteshin Allahut duke thënë,

“aman o Zot na shpëto nga torturat dhe vdekja!”. Dukej sikur ata e kishin marrë parasysh këtë sakrificë në këmbim të së vërtetës së madhe që u erdhi pas një jete të zhytur në mohim dhe gjynahe. Për rrjedhojë, edhe dëshira e tyre e fundit ishte që të vdisnin si myslimanë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe pasuesit e parë të Isait ﷺ, që ishin besimtarë të devotshëm, e mbrojtën besimin e tyre mes dhëmbëve të luanëve nëpër arenat Romake.

Po ashtu, një grup tjetër që vjen në krye të heronjve të cilët e kanë jetuar besi-

Ne duhet të shqetësohemi për pasardhësit tanë. Kjo lutje e bukur e Ibrahimit ﷺ, e shpjegon më së miri shqetësimin që duhet të kemi për brezat e ardhshëm:

“O Zot më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që falin namaz...”

(Ibrahim, 40.)



min me dashuri dhe sakrificë, janë besimtarët e hedhur në zjarr të gjallë, “Ashabu Uhdud”.

Ndërsa Habibi Nexhar u martirizua ndërkohë që përpiquej për udhëzimin e popullit të vet. Në momentin që po jepte shpirt, iu shfaqën mirësitë e Allahut dhe, në vend që të zemërohej me popullin, ndjeu keqardhje për ta duke thënë:

“..Ah sikur ta dinte populli im se Zoti më fali dhe më dhuroi shumë mirësi!”

(Jasin, 26-27)

Duke u bazuar në këto shembuj të mrekullueshëm, edhe ne sot si myslimanë, duhet të pajisemi me një besim të fortë e të palëkundur, me qëllim që të jemi të qëndrueshëm përballë atyre që duan të cenojnë Islamin dhe Fjalën e Allahut. Ne duhet të ushqejmë dashuri dhe tolerancë ndaj besimtarëve dhe të mirës, e të qëndrojmë larg mohuesve dhe së keqes.

Virtyti i dytë i sahabëve:

SOLIDARITETI

رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ

“(Ata) janë të mëshirshëm mes njëri-tjetrit.” (Fet’h, 29)

Mes myslimanëve, duhet të ekzistojnë një lidhje e fortë shpirtërore dhe një solidaritet shembullor, sepse çdo mysliman është përgjegjës për vëllain e vet.

Namazi është kulmi i adhurimeve individuale. Nëse namazi falet siç duhet, të gjitha adhurimet e tjera shkojnë mirë. Namazi e ndalon njeriun nga e keqja dhe shturja. Për tu lënë fëmijëve tanë një trashëgimi të mirë shpirtërore dhe materiale, duhet t'i japim rëndësi të madhe mësimit të Kuranit.



Me të vajtur në Medinë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i bëri sahabët vëllezër të njëri-tjetrit. Ensarët u hapën dyert muhaxhirëve dhe ndanë me ta të gjithë pasurinë. Ndërsa muhaxhirët nga ana e tyre, treguan burrëri dhe nuk u bënë barrë për vëllezërit ensarë, por, çdo gjë e pranuan në këmbim të punës. Sa moral i bukur është ky! Njëri dëshiron të japë, ndërsa tjetri nuk e lakmon atë që i ofrohet.

Allahu i Madhëruar kërkoi një solidaritet njerëzor prej njerëzve që ishin pranë Profetit ﷺ, gjë e cila arrihet vetëm në saje të mëshirës që zë rrënjë në zemrat e tyre.

Nëse dikush dëshiron të shohë se në çfarë niveli është namazi i tij, le të shohë veten! Sa mëshirë, bujari, altruizëm dhe takva ka në zemrën tuaj si pasqyrim i moralit të mirë? Apo mos vallë keni cilësi të këqija si koprracia, shpërdorimi, smira, zilia etj.? Këto janë pasqyrat më të pastra që tregojnë nivelin e namazit dhe adhurimit të një personi.

Allahu i Madhëruar, më së shumti na e prezanton Vetën si “Rahman dhe Rrahim”. Pra na afrohet me mëshirë. Po ashtu, edhe Profetin ﷺ, e ka cilësuar si “Rauf dhe Rrahim”; një profet i mëshirës:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ
حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُوفٌ رَّحِيمٌ

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128)

Për rrjedhojë;

Edhe robërit e Zotit tonë Rahman e Rrahim dhe umeti i Profetit, që është dërguar si mëshirë për botët, duhet të jenë



“njerëz të mëshirës”. Pra, myslimani duhet të jetë një njeri prej zemrës së të cilit rrjedh gjithmonë mëshirë dhe butësi.

Mëshira është cilësia dalluese e një besimari. Besimi duhet të zërë vend në zemër në mënyrë të atillë, sa që besimtari të jetë shumë i mëshirshëm ndaj vëllait të vet, i lidhur pas tij dhe me qëndrim të palëkundur ndaj mohuesve të Allahut të Madhëruar. Në këtë kuadër, edhe surja Tebbet na mëson urrejtjen ndaj atij që e meriton të urrehet. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse nëse nuk urrehet ai që meriton të urrehet, do të cenohet dashuria ndaj atij që e meriton të duhet.

Lidhur me këtë çështje, historia e Andaluzisë, është një shembull shumë i hidhur për ne, prej të cilit duhet të marrim mësim.

Kur myslimanët me në krye Tarik Bin Zijadin morën Andaluzinë, ishin vetëm 7 mijë ushtarë me rroba të arnuara, kundër ushtrisë spanjolle prej 95 mijë ushtarësh. Ata triumfuan në këtë betejë vendimtare dhe për tre shekuj ruajtën rrugën e drejtë. Më pas, myslimanët filluan të ndaheshin në fise dhe principata, duke shkatërruar shpirtin e vëllazërisë. Ata u përçanë si pasojë e konflikteve mes vetes për shkaqe egoiste dhe, për fat të keq, shumë herë me radhë i patën thirrur në ndihmë të krishterët në luftën vëllavrasëse me njëri-tjetrin. Në kundërshtim me frymën e Kuranit, ata qenë përçarë e copëtuar duke merituar, fundin e hidhur të miqësisë me krishterët kundër njëri-tjetrit.

Në Kuran urdhërohet:

“...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (Ankebut, 45.)

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm e veprojnë vetëm sa për sy e faqe (para botës)” (Maun, 4-6.)

Pra, namazi është një tregues i rëndësishëm i nivelit tonë shpirtëror.



Kur ata e humbën mbizotërimin dhe mirësitë e atij vendi, mbreti i Spanjës Ferdinandi dhe gruaja e tij Izabela, ndër morën një fushatë dhune kundër myslimanëve, një pjesë të të cilëve i detyruan të pranonin krishterimin, e pjesën tjetër i dëbuan nga Andaluzia. Ata që nuk pranuan të bëheshin të krishterë, iu shitën piratëve, të cilët i morën dhe i dërguan në Afrikë. Madje, gjatë udhëtimit, shumë prej myslimanëve u hodhën në det nga ana e piratëve.

Ndërkohë që Andaluzia po rrënohej, sundimtari i fundit i Granadës, Muhamed Ebu Abdullahu, i cili po ikte së bashku me nënën e vet pasi ua kishte dorëzuar vendin armiqve, qëndroi pak në kodrën Padul, vështroi për të fundit herë Granadën dhe pallatin el-Hamra, atë mrekulli të artit islam, që po digjeshin në flakë dhe, në mënyrë të pavullnetshme, u ngashërua dhe nisi të qajë. Atëherë, e ëma, vetullngrysur, i tha këto fjalë historike:

Problemet psikologjike që shohim sot, në kohën e sahabëve ishin thuajse të panjohura. Ata përjetuan vështirësi dhe prova të shumta, por asnjëherë nuk ranë në depresion, sepse ata mësuuan si të ishin të kënaqur me Allahun.



“Qaj, o mendjelehtë, qaj! Tani qaj si gratë për këtë vend të bekuar që nuk mund ta mbrosh si burrat!..”

Në një anë qëndron triumfi i afrimit me Allahun, e në anën tjetër qëndron përfundimi i hidhur i largimit prej Tij!..

Sahabët e nderuar zotëronin një moral besimi të përjetuar me pasion. Prandaj, ata ishin në solidaritet të vazhdueshëm me njëri-tjetrin.

Virtyti i tretë i sahabëve, ishte:

NAMAZI

تَرَاهُمْ رُكَّعًا سُجَّدًا

“I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde.” (Fet’h, 29)

Kulmi i adhurimeve individuale, është namazi, që është edhe adhurimi i parë farz. Pamja, përkufizimi dhe gjëja më e bukur e sahabëve të të Dërguarit të Allahut ﷺ, ishte kryerja e këtij adhurimi brenda një harmonie shpirt-trup.

Këtë namaz, ata e falnin me xhemat. Sa tablo e bukur i një harmonie shoqërore është namazi që falet me xhemat dhe rreshta të përkryer! I gjithë xhemati aty, e kuptojnë gjendjen, gëzimin dhe hallin e njëri-tjetrit nga fytyrat e tyre dhe përjetojnë pikën më kulmore të vëllazërisë.

Veçanërisht, rukuja dhe sexhdeja janë shprehja më e bukur e nënshtimit, e perceptimit të të qenët asgjë para Allahut të Madhëruar dhe e bindjes pa hezitim ndaj Tij. Besimtarët, të cilët janë të ashpër kundrejt armiqve të Islamit dhe të mëshirshëm ndërmjet njëri-tjetrit, shfaqin edhe një edukatë dhe madhërim të plotë në audiencën e Allahut.

“...Ata do t’i shohësh duke bërë ruku dhe duke rënë në sexhde...”

Gjendja e tyre në ruku dhe sexhde, përhapte një gjendje të veçantë shpirtërore. Dhe ky është modeli më i bukur shpirtëror për të bërë “një mijë sexhde me një përkushtim të plotë”.



Ata jetuan me dëshirën për qenë shokët e Profetit të Allahut ﷺ dhe për të plotësuar çdo kërkesë të tij. Madje, edhe shqetësimi i tyre më i madh, ishte të qenit bashkë me të Dërguarin e Allahun në botën tjetër.


Krahas namazeve farz, besimtari rend drejt audiencës së Zotit me namaz vullnetar, kurdo që të gjejë mundësi, pikërisht siç bënte Profeti i Tij ﷺ. Ai i zbukuron me namaz kohët e zakonshme, si koha para agimit, koha e paradites dhe pas akshamit. Ai fal namaz në çdo rast, si namazi i nevojës, i istihares, i falënderimit, i përshëndetjes së abdesit, i përshëndetjes së xhamisë dhe i eklipsit të hënës e të diellit. Kështu, ai kërkon ndihmë nga Allahu me namaz, flet me Zotin nëpërmjet namazit dhe merr rrugë drejt miraxhit, sepse Allahu Teala ka thënë:

“Bëj sexhde dhe afrohu!” (Alak, 19)

Besimi i besimtarit forcohet me namaz, me Kuranin që këndon në namaz, me sexhdet, me qëndrimin në këmbë dhe me rukutë gjatë namazit. Një namaz i tillë, që përhap frymëzim shpirtëror dhe kënaq zemrën. Ajo që ia heq e para urinë shpirtit, është sexhdeja e sinqertë para Allahut. Ky namaz e mbron besimtarin nga gjynahet dhe veprat e shëmtuara. Ky namaz, që i jep zemrës entuziazëm dhe përkushtim, është i vazhdueshëm.

Për rrjedhojë;

Në namazet e besimtarëve dhe në të gjithë jetën e tyre, mbizotëron gjendja e lutjes dhe përgjërimit. Kjo, sepse ata e kanë kuptuar shumë mirë se Allahu i Madhëruar nuk u jep rëndësi robërve që nuk kanë lutje dhe përgjërime.



Sahabët vrapuan në punë të mira dhe virtyte të larta me shqetësimin se, “vallë a do të mund të jem fqinji i Profetit ﷺ, në botën tjetër?” Po ashtu, ata kërkuan sinqeritetin në veprat e tyre.

TË DORËZUAR SHPIRTËRISHT

يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانًا

“...duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut...”

Esenca e të gjitha përpjekjeve të të Dërguarit të Allahut ﷺ, dhe sahabëve të tij, ishte fitimi i kënaqësisë së Allahut. Kënaqësia e Tij, ishte mirësia më e madhe. Dhe, ata gjithmonë kërkuan virtytin, si shkak që i shpinte te kjo mirësi.

Caktimi i takon Allahut. Prandaj, ata jetuan të kënaqur dhe të dorëzuar ndaj këtij caktimi. Sahabët, për hir të mbrojtjes së besimit, të përkushtimit ndaj Allahut dhe qëndrimit pranë Profetit ﷺ, janë përballuar me sprova dhe vështirësi të shumta. Megjithatë, për çdo urdhëresë, thanë:


«سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا / Dëgjuam dhe bindemi!»

Sa bukur e përmbledh Omer bin Abdulazizi këtë gjendje dorëzimi shpirtëror:

“Ajo që më gëzon më shumë në këtë jetë, është caktimi në lidhje me mua... Pritja me kënaqësi e çdo gjëje që më ndodh, në mënyrë që të jetë në përputhje me kënaqësinë e Allahut.”

Ja pra, kjo është ajo që kërkohet;

Të tregosh durim dhe dorëzim me kënaqësi shpirtërore ndaj të gjitha baticave dhe zbaticave të jetës, në saje të gjendjes shpirtërore që fitohet prej namazeve.



Besimtari duhet të jetojë duke qenë i kënaqur me atë i është caktuar nga Allahu, sepse askush nuk e di të fshehtë. Në ato gjëra që i vijnë rëndë egos, mund të fshihen gjëra të dobishme për të.

Nëse dikujt prej sahabëve i jepej pasuri, ai i jepte hakun asaj pasurie, duke dhuruar tepricën e saj. Ai e shihte pasurinë si diçka që i është lënë amanet nga Allahu i Madhëruar. Nga kjo pikëpamje, shpërdorimi dhe koprracia, ishte një stil jete që ata nuk e njihnin fare. Ata ishin të vetëdijsëm për faktin se, kjo botë është kalimtare dhe se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër.

Po ashtu, nëse dikujt prej sahabëve i binte për pjesë varfëria, ai jetonte me durim dhe i kënaqur me caktimin e Allahut. Por, edhe pse jetonte në skamje, ai dinte si të përjetonte entuziazmin e dhurimit të pasurisë në rrugë të Allahut. Ai punonte sipas mundësisë dhe dhuronte prej atij pak fitimi që

merrte. Ai i shtonte edhe një tas ujë më tepër supës së vetë dhe nuk linte pa ndihmuar fqinjin e tij. Kur sëmurej, nuk rebelohej asnjëherë, e kur gëzonte shëndet, falënderonte Allahun dhe të gjithë energjinë e vet e shpenzonte në rrugën e Tij.

Problemet psikologjike që shohim sot, në kohën e sahabëve ishin thuajse të panjohura. Ata përjetuan vështirësi dhe prova të shumta, por asnjëherë nuk ranë në depresion, sepse ata mësuan si të ishin të kënaqur me Allahun. Ata jetuan me dëshirën për qenë shokët e Profetit të Allahut ﷺ dhe për të plotësuar çdo kërk-

*Sa afër të
Dërguarit të
Allahut ﷺ, jemi
ne? Sa prej cilësive
të njerëzve pranë
të Dërguarit të
Allahut ﷺ, të
sahabëve, kemi
ne?*



esë të tij. Madje, edhe shqetësimi i tyre më i madh, ishte të qenit bashkë me të Dërguarin e Allahun në botën tjetër. Parimi i jetës së tyre ishte ky hadith fisnik:

“Njeriu do të jetë me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96)

Ata e kishin kuptuar mirë se;

Në botën tjetër do të ishin bashkë me atë që e kanë dashur më së shumti në këtë jetë.

Për këtë arsye, ata vrapuan në punë të mira dhe virtyte të larta me shqetësimin se, “vallë a do të mund të jem fqinji i Profetit ﷺ, në botën tjetër?” Po ashtu, ata kërkuan sinqeritetin në veprat e tyre, sepse Allahu i Madhëruar, nuk ka thënë:


«أَكْفَرُ عَمَلًا / punë më të shumta», por «أَحْسَنُ عَمَلًا / punë më të mira. (Mulk, 2)

Veprat e sinqerta që bëhen me devotshmëri dhe përkushtim, reflektohen edhe në pamjen e besimtarit. Pra, devotshmëria në zemrën e tij, duket si dritë në fytyrën e tij:

ATA DALLOHEN NGA SHENJA E SEXHDES

سَيَمَاهُمْ فِي وُجُوهِهِمْ مِنْ أَثَرِ السُّجُودِ ذَلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَةِ

“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat...” (Fet’h, 29.)



Sa të fortë e kemi besimin dhe moralin e besimi tonë? Sa larg janë zemrat, mendjet dhe veprat tona nga mendimet dhe publikimet e femohuese, nga modat dhe reklammat e shëmtuara?

Kur shohim një gonxhe trëndafili, na mbushet shpirti me gëzim dhe paqe. Kështu edhe fytyra e një besimtari, duhet të përhapë dritë dhe gëzim.

Pasi i numëron cilësitë individuale të besimtarëve pranë Profetit ﷺ, Allahu i Madhëruar i tregon edhe cilësitë e tyre shoqërore me anë të një shembulli që përmendet edhe në Ungjill:

SI DRITHI

وَمَثَلُهُمْ فِي الْإِنْجِيلِ كَزَرْعٍ أَخْرَجَ شَطْئَهُ فَآزَرَهُ فَاسْتَغْلَظَ فَاسْتَوَىٰ
عَلَىٰ سَوْقِهِ يُعْجِبُ الزُّرَّاعَ لِيَغِيظَ بِهِمُ الْكُفَّارَ

“...Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t’i zemërojë mohuesit...”

*Në ç’gjendje është
mëshira jonë ndaj
vëllezërve tanë të fesë?
A mund të bëhemi
edhe ensarët ndaj
vëllezërve tanë që ikin
prej luftës, prej skamjes
dhe padrejtësive në
vendin e tyre?*



Kulmi i adhurimeve me aspekt shoqëror, është shërbimi. Besimtari, i cili arrijn gradë të lartë shpirtërore me anë të adhurimeve individuale, mposht veset e këqija, zhvillon aftësitë shpirtërore, tregon kënaqësi ndaj caktimit të Zotit dhe gëzon dritën e sexhdes në fytyrën e tij, tashmë është një njeri që bëhet shkak i udhëzimit për të tjerët.

Ashtu si dielli, që nuk di çdo të thotë të mos ngrohë e të mos ndriçojë, edhe besimtari bëhet dritë dhe shkak udhëzi-

mi përreth. Ashtu si uji, që avullon dhe pasi pastrohet plotësisht, zbret përsëri në tokë si mëshirë, edhe ata që kanë arritur pjekurinë e besimit, që pastrojnë egon e tyre në garën për adhurime dhe virtyte, bëhen besimtarë, nga zemrat e të cilëve rrjedh mëshirë. Dhe, pikërisht këto zemra që janë det mëshire, marrin përsipër edhe detyrën e fitimit të zemrave.

Për këtë arsye, edhe Profeti ynë ﷺ, u kujdes në mënyrë të veçantë për nxënësit e vet. Ai punoi sistematikisht me sahabët e suffes dhe i edukoi mirë të rinjtë e talentuar. Pasi i Dërguari i Allahut ﷺ, ndërroi jetë, sahabët që edukoi ai, e bartën udhëzimin Islam në katër anët e botës... deri në Kinë, Kajravan, Afrikë e Kostandinopojë. Të njëjtën përpjekje, me të njëjtat ideale, e vazhduan edhe të parët tanë Osmanë. Ja disa shembuj madhështorë:

Osman Gazi, i drejtohet me këto fjalët birit të tij, Orhan Gazit:

“Kauza jonë nuk është një çështje e zbrazët dhe thjesht pushim i botës, por lartësimi i Fjalës (fesë) së Allahut! Pra, gëzoma shpirtin duke mos e braktisur xhihadin, luftën në rrugën e Allahut!”

Po ashtu, edhe Sulltan Murati; kur u plagos për vdekje në luftën e Kosovës, në frymën e fundi tha këto fjalë:

“Unë i isha lutur Allahut që, nëse fitorja e Islamit varet nga martirizimi im, atëherë ma bëjë të mundur të bie dëshmor. Pra, lutja ime u pranua. Falënderimi dhe lavdia i takon Allahut!”

A ndikon namazi në shpirtin tonë? A arrijmë ta bartim me sinqeritet fisnikërinë e namazit? Sa përkushtim ka në zemrat tona dhe sa reflektohet ajo në fytyrat tona?



E gjithë kjo, sepse ata ishin edukuar dhe zhvilluar në rrugën dhe parimet e personaliteteve të veçantë që edukoi i Dërguari i Allahut ﷺ.

Siç është shprehur edhe Imam Karafi, “*edhe sikur i Dërguari i Zotit ﷺ, të mos kishte asnjë mrekulli tjetër, do të mjaftonin sahabët e edukuar nga ai, si argumenti më i madh i profecisë së tij.*”

Siç e përmendëm më lart, në ajetin kuranor, edukimi është ngjasuar me kultivimin e drithërave. Kjo, sepse edukimi i njeriu, shkallë-shkallë, i ngjan rritjes së bimëve. Për shembull, kur Allahu flet për edukimin e nënës sonë, Merjemes, në Bejtul-Makdis, urdhëron:

فَتَقَبَّلَهَا رَبُّهَا بِقَبُولٍ حَسَنٍ وَأَنْبَتَهَا نَبَاتًا حَسَنًا

“Zoti e pranoi atë (Merjemen) në mënyrën më të bukur, e bëri që të rritet si një bimë e mirë...” (Al-i Imran, 37)



Në çfarë niveli është dashuria, pasioni dhe sakrifica jonë në shërbimin ndaj fesë, besimit dhe Kuranit?

Shërbimet shoqërore, janë si fara që hidhen në të ardhmen. Ja sa bukur e shpreh poeti Nexhip Fazëll rëndësinë e përpjekjes së edukimit të brezave, pa e humbur shpresën:

“Hidhe farën! E nëse nuk mbin, turp të ketë ajo tokë!”

Një kopshtar, duhet të përpiqet që fara të cilën e mbjell në tokë, të mos shkoj dëm. Nëse një kopshtar nuk kujdeset për tokën e vet, farat që ai mbjell, do të bëhen ushqim për minjtë dhe pulat. Kopshtari duhet të bëjë kujdes që bimët e tij të mar-

rin diellin dhe ujin e nevojshëm dhe t'i ruajë ato nga dëmtuesit. Vetëm kështu ato fara mund të bëhen filiza, të forcohen dhe të lartësohen mbi trupat e tyre.

Forcimi i trupit, përfaqëson forcimin e strukturës shpirtërore të nxënësit dhe forcën e tij ndaj rreziqeve të jashtme e të brendshme. Një filiz i dobët, shkatërrohet menjëherë me një erë të lehtë apo rrjedhë uji. Por, nëse bima hedh rrënjë thellë në tokë dhe formon trung të trashë, ajo përsoset. Kështu, edhe besimi i një myslimani duhet të jetë i fortë; ai duhet të rezistojë ndaj të gjitha rreziqeve të brendshme e të jashtme, si egoja, shejtani, shoqëria e keqe, etj.

Në të njëjtën kohë, bima është edhe elastike. Gjatë katastrofave natyrore, siç janë erërat e forta, bimët mund të përkulen. Kështu, edhe besimtarët janë durimtarë dhe vazhdojnë të jenë të devotshëm. Por ka edhe si disa lloj bimësh siç janë pishat, të cilat nuk përkulen, dhe në fund thyhen e shkatërrohen.

Brezat e edukuar mirë, i çmendin mohuesit e Allahut, sepse këta janë armiq të besimit në botën tjetër; i janë të nënshtruar ndaj dëshirave të egos së tyre dhe dëshirojnë të jetojnë vetëm një jetë të pavetëdijshme dhe larg parimeve morale. Ndërkohë, çdo individ i edukuar me parime fetare e morale, do t'i kujtojë atyre të vërteta hyjnore.

Krahas kësaj, ata që do ta bartin në të ardhmen kauzën Islame, janë pikërisht të rinjtë. Armiqtë e Islamit, nuk mer-



*Sa e dëshirojmë
dhe sa përpiqemi
në edukimin e
vetes dhe brezave
të ardhshëm që
të jemi "njerëz
mëshire" i umetit
të Profetit të
mëshirës?*

ren tepër me myslimanët e moshuar. Por të rinjtë e pastër që mësojnë fenë dhe Kuranin nëpër institucionet e dijes, janë shqetësim i madh për ta. Siç e dimë edhe nga historia Islame, atentati i parë që iu bë të ardhmes së myslimanëve, ishin masakrat e Rexhit dhe Bir'i Maune. Prandaj, Allahu na e kujton këtë armiçësi dhe na fton të marrim masat e duhura.

Një kopshtar e do shumë kopshtin e vet. Toka e zezë, atij i duket smerald. Atë e kënaq shumë puna, qoftë edhe i kërrusur mbi tokë nën diellin e nxehtë. E në fakt, vetëm me një pasion të tillë mund të realizohet edhe shërbimi në rrugën e fesë. Dashuria lind sakrificën, ndërsa sakrifica bëhet shkak i ndihmës hyjnore dhe suksesit.

Profeti ynë ﷺ, u mësonte sahabëve Kuranin me dashuri, edhe pse në bark kishte lidhur gurë për të shtypur ndjenjën e urisë. Në këtë gjendje, ai arriti t'i edukojë dhe t'i pastrojë ata në mënyrën më të bukur. Ndërsa ata, falë kësaj dashurie dhe sakrifice të Profetit ﷺ, vrapuan në katër anët e botës me pasion dhe vetëmohim, duke u bërë udhëheqësit e çlirimeve të zemrave.

Prandaj, ne nuk duhet të harrojmë kurrë se edukimi i fëmijëve tanë në përputhje me parimet e Kuranit, është detyra jonë më e rëndësishme. Kjo, sepse njeriu mund t'i lërë fëmijëve vetëm dy lloj trashëgimish:

- Trashëgiminë materiale: pasurinë që ndahet sipas kritereve që ka përcaktuar Allahu.

Allahu Teala ka thënë: "Bëj sexhde dhe afrohu!" (Alak, 19.) Besimi i besimtarit forcohet me namaz, me Kuranin që këndon në namaz, me sexhdet, me qëndrimin në këmbë dhe me rukutë gjatë namazit.



•Trashëgiminë shpirtërore: moralin, edukatën dhe personaliteti Islam që na lënë prindërit.

Nëse trashëgimia shpirtërore është e shëndoshë, atëherë, pasardhësit, edhe trashëgiminë materiale e përdorin siç duhet, duke u kthyer në sadaka të pandërprerë për prindërit e tyre. Por nëse privohen nga trashëgimia shpirtërore, atëherë nuk dihet si do ta përdorin trashëgiminë materiale; ndoshta do ta përdorin në rrugë të këqija duke e shndërruar në një barrë edhe për prindërit në botën tjetër.

Një njeri i urtë thotë:

“Është e habitshme se; kur një njeri vdes, ai jep llogari për gjithë pasurinë e vet, edhe pse tashmë nuk e gëzon më atë.”

Prandaj besimtari duhet të tregojë kujdes në dy pika për sa i përket trashëgimisë:

E para; duhet ta fitojë në rrugë hallall, në mënyrë që trashëgimia e tij të jetë hallall.

E dyta; duhet t'i lërë fëmijëve trashëgiminë më të çmuar, që është devotshmëria dhe morali i lartë.

Për këtë arsye;

Ne duhet të shqetësohemi për pasardhësit tanë. Kjo lutje e bukur e Ibrahimit عليه السلام, e shpjegon më së miri shqetësimin që duhet të kemi për brezat e ardhshëm:

“O Zot më bëj mua dhe pasardhësit e mi prej atyre që fallin namaz...” (Ibrahim, 40)

Një namaz i tillë, që përhap frymëzim shpirtëror dhe kënaq zemrën. Ajo që ia heq e para urinë shpirtit, është sexhdeja e singertë para Allahut.



Namazi është kulmi i adhurimeve individuale. Nëse namazi falet siç duhet, të gjitha adhurimet e tjera shkojnë mirë. Namazi e ndalon njeriun nga e keqja dhe shthurja. Për tu lënë fëmijëve tanë një trashëgimi të mirë shpirtërore e materiale, duhet t'i japim rëndësi të madhe mësimit të Kuranit.

Ajeti 29 i sures Fet'h, mbaron me lajmin e mirë të shpërblimit të përpjekjeve në botën tjetër:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
مِنْهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا

“...Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.” (Fet'h, 29)

Lum si ata!..

Ata që do ta bartin në të ardhmen kauzën Islame, janë pikërisht të rinjtë. Armiqtë e Islamit, nuk merren tepër me myslimanët e moshuar. Por të rinjtë e pastër që mësojnë fenë dhe Kuranin nëpër institucionet e dijes, janë shqetësim i madh për ta.



PO GJENDJA JONË?

Le t'i kërkojmë tek vetja jonë të gjitha këto mesazhe të këtij ajeti. Sa afër të Dërguarit të Allahut ﷺ, jemi ne? Sa prej cilësive të njerëzve pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, të sahabëve, kemi ne?

Sa të fortë e kemi besimin dhe moralin e besimi tonë?

Sa larg janë zemrat, mendjet dhe veprat tona nga mendimet dhe publikimet e femohuese, nga modat dhe reklamat e shëmtuara?

Në ç'gjendje është mëshira jonë ndaj vëllezërve tanë të fesë?

A ndikon namazi në shpirtin tonë? A arrijmë ta bartim me sinqeritet fisnikërinë e namazit? Sa përkushtim ka në zemrat tona dhe sa reflektohet ajo në fytyrat tona?

Në ç'gjendje jemi në garën e virtyteve?

Sa pikë mund t'i japim vetes në çështjen e të qenit të kënaqur me Allahun?

A lutemi vazhdimisht?

Në çfarë niveli është dashuria, pasioni dhe sakrifica jonë në shërbimin ndaj fesë, besimit dhe Kuranit?

Sa e dëshirojmë dhe sa përpiqemi në edukimin e vetes dhe brezave të ardhshëm, në mënyrë që të jemi “njerëzit e mëshirës” së umetit të Profetit të mëshirës?

ÇFARË NIVELI KANË RAMAZANET TONA?

Ramazani i bekuar është një mëshirë e veçantë që na është falur... Por, sa arrijmë ta shfrytëzojmë këtë muaj të begatë, në të cilën mëshira rrjedh si lum?

Sa afër Profetit tonë ﷺ, ndjehemi ne gjatë Ramazanit?

A përgatitemi ne dy muaj para se të vijë Ramazani, ashtu siç na ka këshilluar i Dërguari i Allahut ﷺ?



Ashtu si uji që avullon dhe pasi pastrohet plotësisht, zbret përsëri në tokë si mëshirë, edhe ata që kanë arritur pjekurinë e besimit, që pastrojnë egon e tyre në garën për adhurime dhe virtyte, bëhen besimtarë, nga zemrat e të cilëve rrjedh mëshirë.

A e shfrytëzojmë këtë sezon, në të cilin duhet qëndruar edhe larg gjërave hallall, për të edukuar egon dhe për të ushqyer shpirtin tonë, apo e çojmë dëm me grykësi dhe dëfrim?

Profeti ynë ﷺ, i cili ishte më bujari i bujarëve, gjatë Ramazanit bëhej edhe më tepër bujar. Po ne, a jemi bujar si Profeti ynë ﷺ, edhe në kamje, edhe në skamje?

Ne duhet ta kuptojmë mirë Ramazanin!..

Ramazanin duhet ta shohim si diçka të veçantë, tek i cili duhet mbledhur e gjithë vëmendja... Ashtu siç veprojmë për çështje të ndryshme të përbashkëta shoqërore apo profesionale, ku mblidhemi nëpër salla të mëdha, bëjmë seminare dhe diskutojmë duke u fokusuar vetëm në çështjet që na interesojnë, pa u marrë me gjëra të tjera...

Ky fokusim është një nevojë shumë e rëndësishme, të cilin

e ndiejmë edhe në çështje të kësaj bote. Prandaj, çështja jonë më e rëndësishme në devotshmërinë ndaj Allahut dhe përgatitjen për botën tjetër, është fokusimi në adhurime brenda një muaji që na ka falur Zoti ynë i Madhëruar.

Një sezon përmbajtjeje edhe nga hallallet gjatë ditës... Syfyre që të nxisin nevojën për t'u zgjuar gjatë natës për adhurime... Mundësia për të rinovuar marrëveshjen me Kuranin... Shoqërizimi me besimtarët me anë të iftareve, sadakave, zekateve, fitreve dhe bamirësive të ndryshme dhe solidarizimi me mëshirë ndaj të afërmeve... E, sipas mundësisë, të bësh itikaf dhe umre...

Përherë duhet të mendojmë: Vallë, po të isha pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, në këto çaste, a do të buzëqeshte me gjendjen time? Apo mos vallë do të mërzhitej?

Dhe shpërblimi për të gjitha këto vepra është:

NATA E KADRIT...

Nata e Kadrit është treguesi më i bukur i vlerës së lartë që gëzon Profeti ynë ﷺ, tek Allahu i Madhëruar. Allahu e do aq shumë Profetin tonë ﷺ, sa që i ka falur shpërblimin e njëmijë muajve brenda një nate.

Prandaj, edhe ne duhet të falënderojmë për mirësinë e të qenit umeti i Muhamedit ﷺ, duke pasuar gjurmët e tij. Ne nuk duhet ta turpërojmë atë ﷺ, në ditën e tubimit, sepse ai ka thënë:

“Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76)

Sipas transmetimeve, Profetit tonë ﷺ, i prezantohen edhe veprat që bëjmë në këtë botë:


“Jeta ime është në dobinë tuaj: ju flisni me mua dhe njoftoheni (me shpalljen hyjnore dhe ligjet).

►Por, edhe vdekja ime është në dobinë tuaj:

Punët tuaja më tregohen edhe mua.

•Kur shoh një punë të mirë, falënderoj Allahun, e kur shoh një punë të keqe, i kërkoj falje Atij për ju.” (Hejthemi, IX, 24)

Po ashtu, në një hadith tjetër thuhet:



Prandaj, edhe ne duhet të falënderojmë për mirësinë e të qenit umeti i Muhamedit ﷺ, duke pasuar gjurmët e tij. Ne nuk do ta turpërojmë atë ﷺ, në ditën e tubimit, sepse ai ka thënë: “Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

“Veprat tuaja u tregohen të vdekurve prej të afërmve dhe fafesisit tuaj. Nëse veprat tuaja janë të mira, ata gëzohen. Por, nëse nuk janë të mira, ata luten duke thënë: «O Allah! Mos ua merr shpirtin pa i udhëzuar edhe ata ashtu siç na udhëzove neve!»” (Ahmed, III, 164; Taberani, Kebir, IV, 129/3887)

Ndërsa në Kuranin Fisnik, na bëhet e ditur se Profeti ﷺ, do të jetë dëshmitar për ne:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një popull mesatar (shembullor), që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” (Bekare, 143)

Për rrjedhojë, ne duhet të mendojmë:

Vallë, po të isha pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, në këto çaste, a do të buzëqeshte me gjendjen time? Apo mos vallë do të mërzitej?

Mevlana ka thënë: “Shumica e fatkeqësive u kanë ardhur profetëve, sepse vetëm puna për udhëzimin e të pagdhendurve është një fatkeqësi më vete.”



Nëse falë këtij shqetësimi arrijmë të bëhemi nxënësit që nuk e hidhërojnë Profetin tonë ﷺ dhe ummeti që nuk e nxin faqen e tij të bekuar, në botën tjetër do të gëzojmë mirësi dhe shpërblime të mëdha. Në ajetin 62 të sures Junus, urdhërohet:

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Padyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”

Po ashtu, duhet të mendojmë edhe se:


Vëllezërit tanë, që ishin së bashku me ne Ramazanin e fundit, këtë Ramazan

nuk janë më. E, mbase ky Ramazan mund të jetë i fundit edhe për ne.

Prandaj, i lutemi Allahut të Madhëruar të na falë entuziazmin e Ramazanit të bekuar! Allahu në bëftë një ummet të mbarë që ndodhet afër Profetit ﷺ, me zemër dhe me vepra!

Allahu i dhëntë adhurimeve tona individuale dhe shoqërore frymëzimin shpirtëror të sahabëve dhe na i pranofte të gjitha në mënyrën më të bukur!

Amin!..



MORALI I TIJ MADHËSHTOR



LAVDI DHE FALËNDERIMI

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8) *Kur u zbrit ky ajet fisnik, një sahab shumë i varfër e nevojtar, u ngrit në këmbë dhe pyeti:*

“(O i Dërguar i Allahut!) A kam unë ndonjë mirësi (për të cilën do të jap llogari)?”

Profeti ﷺ, iu përgjigj shkurtimisht:

“Hija, dy nallanet dhe uji i ftohtë.” (shih. Sujuti, VIII, 619)

“Nëse duam, Ne e bëjmë atë (ujin) të njelmët!..”

(Uakia, 70)



LAVDI dhe FALËNDERIMI

KRITERI I PRANIMIT

E përcollëm edhe një tjetër Ramazan të begatë. Përjetuam një sezon të mbushur me mëshirë dhe falje nga Allahu i Madhëruar. Ky ishte sezoni i mundësisë më të madhe për t'u afruar me Allahun. Një sezon për të bërë një jetë modeste, për t'u pastruar nga cilësitë negative. Sezoni i pajisjes me moralin Profetik. Për t'iu përgjigjur Zoti tonë të Madhëruar, i Cili urdhëron se: “Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër...” (Bekare, 186.) ne u përpoqëm të përparojmë drejt Atij me adhurime, agjërime, teravih, lexim Kurani, me fitre, me zekat dhe bamirësi.

Tani, pyetja në zemrën tonë është:

A janë pranuar tek Allahu përpjekjet tona për ta gjallëruar Ramazanin?

Jahja bin Muadh رضي الله عنه, i cili na ka dhënë edhe kriteret në këtë çështje, ka thënë:

“Nëse në zemrën e tij, njeriu ka dëshirë të bëjë gjynah, edhe pse kërkon falje me gjuhë, dhe i kthehet gjynahut pas Ramazanit, ta dijë se agjërimi i tij është refuzuar dhe dera e pranimit i është përplasur në fytyrë!”

Ndërsa Mirza Mazhar Xhani Xhanan ka thënë:

“Nëse Ramazani kalohet zgjuar me dhikr, kjo gjendje e bukur vazhdon edhe në pjesën tjetër të vitit. Nëse gjatë këtij muaji bëhet ndonjë gabim apo tregohet plogështi, gjurmët e kësaj ndihet gjatë gjithë vitit.”


Domethënë, prova e pranimit të adhurimeve tona gjatë Ramazanit, është gjendja jonë pas Ramazanit.

Nuk duhet harruar se;

Të biesh përsëri në gabime, gjynahe dhe plogështi pas një Ramazani të kaluar me adhurime, i ngjan braktisjes me grykë hapur të një thesi të mbushur me mirësi. Çdo gjë që është mbledhur, derdhet, dhe në fund nuk mbetet asgjë.

Një tjetër dështim i Ramazanit, është ndjenja e mendjemadhësisë dhe mburrjes me adhurimet e bëra. Pra, t’ia atribuosh vetes çdo gjë duke shfaqur mendjemadhësi.

Edhe pse Ibrahim عليه السلام, ishte profet i Allahut, i ruajtur nga gabimet dhe kishte arritur gradën “Halilullah / Mik i Allahut”, ai nuk u mbështet në asgjë që kishte bërë vetë dhe u lut kështu:



Falënderimi duhet të jetë një përpjekje e pandërprerë, sepse sado që të falënderojmë për mirësitë e panumërta të Allahut të Madhëruar, përsëri nuk do të mund ta lajmë borxhin tonë të falënderimit.

وَلَا تُخْزِنِي يَوْمَ يُبْعَثُونَ

“...dhe mos më turpëro në Ditën kur do të ringjallen njerëzit.” (Shuara, 87)

Urdhri për devotshmëri, vlen deri në frymën e fundit. Caktimi hyjnor në lidhje me njeriun, merr për bazë frymën e fundit. Prandaj, nuk ka rrugë tjetër, përveçse të përpiqemi të japim frymën e fundit si myslimanë, mes frikës dhe shpresës, dhe vazhdimit në rrugën e devotshmërisë, pa u treguar të shkujdesur qoftë edhe për një çast.

I Dërguari i Allahut ﷺ, duke qenë një shembull i pashoq për ne, i është lutur Allahut me këto fjalë:

“O Zoti im! Mos më lër në dorë të vetes sime, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë!..” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, v. I, fq. 58)

Sepse;

Ka momente që mund të bëhen shkak i fitimeve të mëdha, por ka edhe momente që bëhen shkak i humbjeve të mëdha.

I vetmi shpëtim, është të përpiqesh të sigurosh që zemra të jetë bashkë me Allahun, sepse në një ajet fisnik urdhërohet:

أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

“..Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”

(Ra’id, 28)

الشُّكُورُ

Edhe vetë falënderimi, është një mirësi për të cilën duhet falënderuar. Më pas vjen falënderimi për atë falënderim, e kështu me radhë deri në pafundësi. Pra, robi është me të vërtetë i pamundur ta kryejë falënderimin e vërtetë ndaj mirësive të Zotit. Për këtë arsye, edhe vetë profetët kanë jetuar vazhdimisht duke i kërkuar falje Allahut të Madhëruar.

Kuptimi i dhikrit, që është përmendje e Allahut, nënkupton edhe Kuranin Fisnik. Pra, përkujtimi i Allahut duke u angazhuar me Kuranin, duke e përjetuar dhe duke e zbatuar atë, është qetësi për zemrat. Kjo, sepse Kurani është edhe shërim, edhe mëshirë, që janë dy mirësitë hyjnore për të cilat ka nevojë çdo rob dhe çdo zemër. Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَنُزِّلَ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...” (Isra, 82)

Me pak fjalë, qetësia e zemrës, është e lidhur fort me përmendjen e Allahut të Madhëruar në atmosferën e mëshirës dhe shërimit Kuranor.

Nisur nga kjo, e gjithë çështja është;

VAZHDIMI I GJENDJES SË RAMAZANIT

Kushedi sa gëzohemi për një dhuratë të kësaj bote! Por, sa gëzohemi dhe sa falënderojmë ne për mirësinë e besimit dhe të qenit umeti i Muhamedit ﷺ, falë të cilave do të fitojmë lumturinë e përjetshme në botën tjetër?



Natyrisht, nuk është aspak e lehtë të jetosh çdo ditë të vitit i angazhuar si në Ramazan; nuk është e lehtë të agjërosh çdo ditë, të falësh çdo natë teravih, të jetosh vazhdimisht në itikaf, etj. Por, mbase kjo nuk është e vetmja gjë që kërkohet...

Në fakt, është e mundur që shpirtin e Ramazanit, ta përhapin dhe ta përjetojnë deri në vitin tjetër, gjë e cila është e domosdoshme për arritjen e suksesit në botën tjetër:

Nëse ne arrijmë ta zbatojmë parimin themelor të agjërimit në të gjitha vaktet e ushqimit, duke u ruajtur nga grykësia dhe shpërdorimi, atëherë vazhdojmë të jetojmë me shpirtin e Ramazanit. Po ashtu, nëse jemi vigjilent dhe ruhem ndaj të dyshimtave dhe veprave të papëlqyeshme, siç ruhem edhe nga hallalli gjatë agjërimit, tek ne do të vazhdojë të jetojë vetëdija e Ramazanit.

Nëse arrijmë që vullnetin e shkuarjes në xhami për teravih ta bartim gjatë gjithë vitit për të shkuar në namazet me xhemat, mund t'i ruajmë ato që fitojmë gjatë Ramazanit. Nëse vigjilencën e zemrës që kemi në syfyr gjatë Ramazanit, arrijmë ta përhapim në të gjitha kohët para agimit, dhe sikur t'ia dimë vlerën çdo nate, ashtu siç kërkohet natën e Kadrit, i gjithë viti do të kalojë me begatinë e Ramazanit.

Nëse mund ta zgjerojmë entuziazmin e dhënies së zekatit dhe sadakave gjatë Ramazanit edhe në muajt e tjerë, e të jetojmë gjithmonë si njerëz bujarë, të mëshirshëm dhe sakrifikues, nuk do ta humbim kurrë Ramazanin.

Këto pra janë edhe treguesit e një Ramazani të përjetuar në mënyrën e duhur.

Krahas këtyre, Ramazani na ka dhënë edhe disa cilësi morale dhe, nëse ne arrijmë ta përjetojmë Ramazanin gjatë gjithë vitit, do të arrijmë t'i ruajmë edhe këto cilësi të bukura.

Sa shembull i bukur është kjo ndodhi:

ثُمَّ لَتُسْئَلُنَّ يَوْمَئِذٍ
عَنِ النَّعِيمِ

*"Pastaj, atë Ditë,
do të pyeteni për
kënaqësitë (e kësaj
bote)!" (Tekathur, 8.)*

*Llogaria e zekatit
është një të dyzetat.
Po mirësitë që na ka
dhuruar Allahu neve?*



ÇFARË NA MBETI PREJ RAMAZANIT?

Një ditë, arkitekti shpirtëror i Pakistanit, Muhamed Ikballi, vizitoi haxhilerët që ishin kthyer nga Medina dhe u drejtoi një pyetje që ekspozonte horizontin e tij shpirtëror prej besimtarit të vërtetë:

“E vizituat Medine Muneveren! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medinës? Dhuratat materiale që keni sjellë, takijet, tesbihët e sexhadet, pas ca kohësh do të vjetërsohen, do të vyshken dhe do të marrin fund. Prandaj, a na keni sjellë nga dhuratat e Medinës që nuk fishken kurrë, e që i japin jetë shpirttrave?..


A ka mes dhuratave tuaja, dorëzim dhe besnikëri si të

Ebu Bekrit ﷺ, drejtësi si ajo e Omerit ﷺ, ndjenjë turpi dhe bujari si të Osmanit ﷺ, klimë shpirtërore dhe zjarr xhahadi si të Aliut ﷺ? A do të mund t’i falni botës Islame, që sot përpëlitet mes mijëra halleve, emocionet e Epokës së Lumturisë?”

Kështu, edhe ne duhet ta pyesim veten tonë pas Ramazanit:

Ramazani erdhi e iku. Çfarë ka mbetur në zemrat tona? Çfarë na kanë lënë pas këto ditë të bekuara? Prej cila veseve të këqija na ka shpëtuar dhe cilat virtyte na ka dhënë? Nëse kemi pasur ndonjë përmirësim, a e kemi vazhduar atë edhe pas Ramazanit, apo mbeti veç në atë muaj?

Të biesh përsëri në gabime, gjynahe dhe plogështi pas një Ramazani të kaluar me adhurime, i ngjan braktisjes me grykë hapur të një thesi të mbushur. Çdo gjë që është mbledhur derdhet dhe në fund nuk mbetet asgjë.



Nëse ata që përpiqen ta përjetojnë siç duhet kohën e begatë të Ramazanit, mundohen të arrijnë kënaqësinë e Allahut dhe të fitojnë cilësi me të cilat do të kënaqet Ai, i gjithë viti do të ketë vlerën e Ramazanit për ta. Çdo natë e gjallëruar, do të na bëjë të arrijmë edhe Natën e madhe të Kadrit.

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar i fton besimtarë të kërkojnë falje në kohën para agimit:

وَالْمُسْتَغْفِرِينَ بِالْأَسْحَارِ

“(Mirësitë e xhenetit dhe kënaqësia e Allahut janë për ata) **...që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.**” (Al-i Imran, 17)

Lidhur me këtë çështje, Mualla bin Fadl ka thënë:

“Të parët tanë të mirë, gjashtë muaj i luteshin Allahut që t’u jepte jetë deri në Ramazan. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, i luteshin që t’u pranohej Ramazani që kaluan.” (Kiuamu’s-Sunne, et-Tergib ue’t-Terhib, II, 354.)

Cilat janë mirësitë e Ramazanit për të cilat ne duhet të përgjrohemi për muaj të tërë që të mos i humbasim?

Ramazani është stina në të cilën mund t’i ngajmë më së shumti të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai është mundësia për t’i ngjarë atij në adhurime, moral, vepra, edukatë dhe virtyte të tjera, sepse Profeti ynë ﷺ, është shembulli më i bukur për ne.

Një tjetër dështim i Ramazanit, është ndjenja e mendjemadhësisë dhe mburrjes me adhurimet e bëra. Pra, t’ia atribuosh vetes çdo gjë duke shfaqur mendjemadhësi.



Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur të pajisemi me moralin profetik dhe ta përjetojmë Ramazanin me atë pjekuri shpirtërore.

Allahu i drejtohet Profetit tonë ﷺ me këto fjalë:

وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“(Pa dyshim) se ti ke moral madhështor.” (Kalem, 4)

LAVDI DHE FALËNDERIMI I TIJ

Ajeti i parë i sures Fatiha, të cilën e lexojmë në çdo rekat të namazit, na mëson “hamdin/lavdin”:

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Lavdi i takon Allahut, Zotit të botëve!”

Ndërsa në një ajet tjetër urdhërohet:

“...Lutja e fundit e tyre është: “Lavdi i qoftë Allahut, Zotit të botëve!” (Junus, 10)

Lavdim në fillim dhe në fund...

E vetmja qenie që e meriton lavdin dhe falënderimin në kuptimin e plotë, është Allahu i Madhëruar, sepse Ai është “Hamid”. Të gjitha falënderimet dhe lavdet e krijesave janë për Të. Gjuhët dhe zemrat duhet të përmendin, të përkujtojnë dhe të falënderojnë Atë.

Mirza Mazhar
ka thënë:

“Nëse Ramazani kalohet zgjuar me dhikr, kjo gjendje e bukur vazhdon edhe në pjesën tjetër të vitit. Nëse gjatë këtij muaji bëhet ndonjë gabim apo tregohet plogështi, gjurmët e kësaj ndihet gjatë gjithë vitit.”



Po ashtu, edhe Profeti ynë ﷺ, emri i bekuar i të cilit vjen prej rrënjës “hamd” dhe është quajtur me emrat Muhammed, Mahmud, (shumë i lavdëruar), Ahmed dhe Hamid (shumë falënderues), e falënderonte përherë Allahun e Madhëruar. Të gjitha hutbet dhe fjalimet i fillonte me falënderim ndaj Allahut. Krahas kësaj, edhe për të gjitha mirësitë dhe veprimtaritë e tjera ditore përmendte dhe falënderonte Allahun e Madhëruar.

ABD-I SHEKUR

Nëna jonë Aisha ؓ, tregon:

“Një natë, i Dërguari i Allahut ﷺ, më tha:

«Nëse më lejon, dëshiroj të ngrihem e të adhuroj Zotin tim!»

Unë thashë:

«Për Allahun, unë dua shumë të jem bashkë me ty, por e dua më shumë atë që të gëzon ty!»

Më pas, ai u ngrit, mori abdes, qëndroi në namaz dhe qau aq shumë, sa lotët i lagën mjekrën e bekuar, rrobën, e madje edhe vendin ku binte në sexhde. Ai vazhdoi në këtë gjendje derisa u gdhi dhe erdhi Bilali ؓ, për të thirrur ezanin e sabahut.

Kur e pa të Dërguarin e Allahut ﷺ, duke qarë, e pyeti:

«O i Dërguari i Allahut! Përse qani, ndërkohë që juve ju janë falur të gjitha gjynahet e shkuara e të ardhme?» Profeti ﷺ, i tha:

*Prova e pranimit
të adhurimeve
tona gjatë
Ramazanit, është
gjendja jonë pas
Ramazanit.*



«A të mos jem një rob që e falënderon shumë Zotin e vet? Për Allahun, sonte më zbriti një ajet i tillë, që mjerë ata të cilët e lexojnë dhe nuk meditojnë mbi të!» Më pas, ai këndoi këtë ajet:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të zotët e mendjes, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) «O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit!»” (Al-i Imran, 190-191)(Ibni Hibban, II, 386; Alusi, Ruhul-Meani, IV, 157.)

Njëri prej kuptimeve të Hamdit, është “shukri”, falënderimi apo mirënjohja. Të falënderosh Allahun ashtu siç duhet për mirësitë që ka dhënë, është e pamundur, por, nëse e falënderojmë aq sa kemi mundësi, Allahu e pranon atë të paktën tonë dhe kënaqet nga ne.

Ne gëzojmë mirësi të pafundme shpirtërore e materiale, për të cilat, në Kurran thuhet se do të japim llogari:

ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Profeti ynë ﷺ, jetonte përherë duke menduar për llogarinë që do të jepej për mirësitë. Ndjenjën e tij të falënderimit dhe mirënjohjes ndaj Allahut, Ebu Hurejre رضي الله عنه, na e tregon me këto fjalë:

Cili është falënderimi për mirësinë e Islamit? Ta përcjellësh atë tek ata që nuk e njohin... Nëse nuk përpiqemi ta jetojmë dhe ta mbajmë gjallë Islamin e pastër, do të jemi mosmirënjohës ndaj kësaj mirësie.



EDHE PËR HALLALLIN KA LLOGARI!

I Dërguari i Allahut ﷺ, doli një ditë, -apo një natë- kur edhe Ebu Bekri dhe Omeri رضي الله عنهما, kishin dalë. Profeti ﷺ, tha:

“Ç’ju shtyu të dilni nga shtëpitë tuaja në këtë kohë?” Ata thanë:

“Uria, o i Dërguari i Allahut!” Profeti tha:

“Për atë në dorën e të Cilit është shpirti im, edhe mua më ka nxjerrë (prej shtëpisë) ajo që ju ka nxjerrë juve. Ngrihuni!”

Ata u ngritën me të dhe shkuan tek njëri prej ensarëve. Mirëpo ai nuk ishte në shtëpi. Kur gruaja (e ensarit) pa të Dërguarin e Allahut ﷺ, tha:

“Mirë se vini, urdhëroni!”

“Ku është filani (i zoti i shtëpisë)?” – pyeti i Dërguari i Allahut ﷺ.

“Ka shkuar të kërkojë ujë të pijshëm për ne.” – u përgjigj ajo.

Atë çast erdhi ensari, i cili pasi pa të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe dy shokët e tij, tha:

“Falënderimi i qoftë Allahut, sot askush nuk ka mysafirë më të nderuar se unë!”

Pastaj shkoi dhe u kthye me një varg hurmash të njoma dhe të pjekura. Ai tha:

*Për treguar
falënderimin dhe
mirënjohjen e tyre
ndaj mirësisë së
Islamit, sahabët
shkuan deri
në Kajravan,
Semerkand, Kinë,
etj...*



“Urdhëroni, hani!” - dhe mori thikën në dorë. I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“Kujdes, mos e prek (mos e prej) atë që millet dhe jep qumësht!”

Pastaj (ensari) preu për ta një dele. Ata hëngrën nga mishi i deles, nga kalaveshi me hurma të llojlojshme dhe pinë ujë.

Pasi hëngrën dhe pinë, i Dërguari i Allahut ﷺ i tha Ebu Bekrit dhe Omerit رَضِيَ اللهُ عَنْهُمَا: *“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, se Ditën e Gjykimit do të pyeteni për këtë begati. Uria ju nxori nga shtëpia dhe nuk u kthyet derisa arritët këtë begati.”* (Muslim, Eshribe, 140.)

Kur u zbrit ajeti 8 i sures Tekathur, një sahab shumë i varfër e nevojtar, u ngrit në këmbë dhe pyeti:

“(O i Dërguar i Allahut!) A kam unë ndonjë mirësi (për të cilën do të jap llogari)?”

*Mualla bin Fadl
tregon:*

“Të parët tanë të mirë, gjashtë muaj i luteshin Allahut që t’u jepte jetë deri në Ramazan. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, i luteshin që t’u pranohej Ramazani që kaluan.”



Profeti ﷺ, iu përgjigj shkurtimisht:

“Hija, dy nallanet dhe uji i ftohtë.” (shih.

Sujuti, VIII, 619.)

Pra, edhe hija e një peme, prej së cilës përfitohet, është një mirësi që Allahu e ka krijuar për ty... Një mirësi për të cilën duhet të falënderohet...

Uji që pimë, frutat që hamë, ushqimet prej perimeve dhe kafshëve dhe çdo send prej të cilit përfitojmë... shëndeti, jeta, familja... mirësi të pafundme për të cilat duhet të falënderojmë një nga një...

Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“A e shihni ujin që pini?

Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim?

لَوْ نَشَاءُ جَعَلْنَاهُ أُجَاجًا فَلَوْلَا تَشْكُرُونَ

Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?!

A e shihni zjarrin që e ndizni?

Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?!

Ne e kemi bërë atë përkujtues (të zjarrit të Xhehenemit) dhe, që t’u sjellë dobi nevojtarëve,

Prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!”
(Uakia, 68-74.)

Mirësitë e Allahut nuk mund të numërohen. Ato nuk janë vetëm materiale, sepse Ai na ka dhënë edhe shumë mirësi shpirtërore, duke filluar që prej udhëzimit në rrugën e drejtë...

MIRËSITË SHPIRTËRORE

Përherë duhet të mendojmë:

Erdhëm në këtë botë pa paguar asnjë çmim, jemi krijuar si njerëz vetëm falë mirësisë hyjnore, na është dhënë mirësia e të qenit umeti i Muhamedit ﷺ dhe populli i Kuranit.



*Rumiu ka thënë:
“Kush shkon në
haxh, le të përpiqet
të takohet me Zotin
e Qabes. Nëse ia
arrijnë kësaj, për
të çdo vend është
i mbushur me
mirësitë e Qabes.”*

Të gjitha këto, janë mirësi për të cilat është e pamundur të falënderohet siç duhet.

Kushedi sa gëzohemi për një dhuratë të kësaj bote! Por, sa gëzohemi dhe sa falënderojmë ne për mirësinë e besimit dhe të qenit umeti i Muhamedit ﷺ, falë të cilave do të fitojmë lumturinë e përjetshme në botën tjetër?

Edhe vetë Ramazani ishte një sofër shpirtërore, një mirësi e mrekullueshme hyjnore, për të cilën duhet të falënderojmë me patjetër. Dhe, falënderimi i kësaj, është që ne të vazhdojmë në rrugën e drejtë edhe pas tij.

Cili është falënderimi për mirësinë e Islamit?

Përcjellja e tij tek ata që nuk e njohin atë.

Për treguar falënderimin dhe mirënjohjen e tyre ndaj mirësisë së Islamit, sahabët shkuan deri në Kajravan, Semerkand, Kinë, etj...

Prandaj, nëse ne nuk përpiqemi të përhapim bukurinë e Islamit, nuk do të arrijmë ta përmbushim siç duhet falënderimin ndaj kësaj mirësie.

Por, edhe gjatë kësaj përpjekjeje për të kryer këtë detyrë kaq të rëndësishme, duhet të bëjmë kujdes në edukatën dhe metodën që përdorim:

Një herë, Resulullahu ﷺ, dërgoi një grup sahabësh për ekspeditë që në mëngjes herët. Njëri prej tyre mbeti pas dhe, familjes së vetë i tha:

*Mos falënderimi
tregon mungesë
mirënjohjeje,
ndjenjash dhe
ndërgjegjeje.
E Allahu i
Madhëruar, nuk
i dëshiron kurrë
këto cilësi tek
një besimtar të
cilin e ka ftuar në
Xhenetin e Tij.*



“Unë mbeta pas me qëllim që ta fal namazin e drekës bashkë me të Dërguarin e Allahut, ta përshëndes dhe të ndahem me të. Po ashtu dëshiroj që ai të bëjë edhe dua për mua, që ajo të jetë ndërmjetësuesi im Ditën e Kiametit!”

Pasi fali namazin me Profetin, ai iu drejtua atij dhe e përshëndeti. I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“A e di se sa të kanë kaluar shokët?”

Sahabiu iu përgjigj:

“Po, më kanë kaluar aq sa distanca e një udhëtimi prej në mëngjes herët!”

Atëherë, Resulullahu ﷺ, i tha:

“Betohem në Atë që ka shpirtin tim në duar, se ata ta kanë kaluar ty në virtyte aq sa distanca mes lindjes dhe perëndimit.”
(Ahmed, III, 438.)

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti ﷺ, ka kthyer këtë përgjigje:

“Sikur të dhurosh gjithçka ka mbi Tokë, nuk mund të arrish virtytin që kanë arritur ata duke dalë që në mëngjes herët.” (Tirmidhi, Xhuma, 28/527; Ahmed, I, 256; Bejhaki, III, 187.)

Po ashtu, edhe tre myslimanë që nuk morën pjesë në fushatën e Tebukut, pavarësisht se nuk ishin dyfytyrësh, me urdhrin e Profetit ﷺ, u përjashtuan nga shoqëria Islame për pesëdhjetë ditë, derisa erdhi falja e Allahut. Për më tepër, këta ishin prej sahabëve që kishin marrë pjesë në të gjitha betejat e zhvilluara deri atëherë...



“...Nëse më falënderoni, do t’ua shtoj të mirat. Nëse më përbuzni, pa dyshim që dënimi Im është shumë i ashpër!”

(Ibrahim, 7.)

Kjo do të thotë se; po të tregohet neglizhencë qoftë edhe njëherë të vetme ndaj detyrave të rëndësishme, falë të cilave shfaqet edhe falënderimi për mirësitë e Allahut, kjo përbën një përgjegjësi të madhe, që të çon në një kufi të rrezikshëm.

Sepse:

Falënderimi, nënkupton kënaqësinë e robit ndaj mirësive që i fal Allahu dhe devotshmërinë e tij të sinqertë duke respektuar me fjalë dhe vepra urdhrat dhe detyrat që i ka ngarkuar Allahu i Madhëruar. Kjo, tregon se falënderim, do të thotë të njohësh pronarin e vërtetë të mirësisë.

“Falënderim, do të thotë të shohësh atë që të jep mirësinë, jo thjesht mirësinë.” (Imam Shibli)

Megjithatë, për t’u bërë një rob që falënderon ashtu siç duhet, nuk mjafton vetëm të dish se mirësitë që të jepen janë nga Allahu dhe ta shprehësh këtë me gojë. Por, është e domosdoshme t’i kryejmë siç duhet adhurimet dhe sjelljet e mira ndaj Zotit tonë.

Lidhur me këtë çështje, Bishr Hafi shprehet:

“Falënderimi i atij që falënderon vetëm me organin e gjuhës, është i pamjaftueshëm, sepse falënderimi i syrit, është që kur të shohë diçka të mirë, të marrë mësim dhe urtësi, e kur të shohë një të keqe, të largohet prej saj. Falënderimi i veshit, është që kur të dëgjojë një të mirë, ta mësojë përmendësh, e kur të dëgjojë një të keqe, ta harrojë atë. Falënderimi i duarve, është që me to të mos kapë asgjë që nuk është e drejtë e tyre. Falënderimi i stomakut, është të ushqe-

Falënderim do të thotë të njohësh pronarin e vërtetë të mirësive. Imam Shibli thotë: “Falënderim do të thotë të shohësh atë që të ka dhënë mirësinë, jo vetë mirësinë.”



het me hallall. Falënderimi i mendjes dhe i zemrës, është të jenë të mbushura me dije dhe urtësi. Ndërsa falënderimi i këmbëve, është të mos shkojnë askund tjetër përveçse në të mirë. Kush vepron kështu, bëhet me të vërtetë prej falënderuesve.”

Falënderimi duhet të jetë një përpjekje e pandërprerë, sepse sado që të falënderojmë për mirësitë e panumërta të Allahut të Madhëruar, përsëri nuk do të mund ta lajmë borxhin tonë të falënderimit. Kjo, sepse edhe vetë falënderimi, është një mirësi për të cilën duhet falënderuar. Më pas vjen falënderimi për atë falënderim, e kështu me radhë deri në pafundësi. Pra, robi është me të vërtetë i pamundur ta kryejë falënderimin e vërtetë ndaj mirësive të Zotit. Për këtë arsye, edhe vetë profetët kanë jetuar vazhdimisht duke i kërkuar falje Allahut të Madhëruar. Pikërisht për këtë, edhe Kurani Fisnik shprehet duke na kujtuar se:

وَقَلِيلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّكُورُ

“...Megjithatë, pak nga robërit e Mi janë falënderues.”

(Sebe, 13)

Kurse gjendja e mos falënderimit, është diçka që Allahu nuk e pëlqen. Ajo bëhet shkak i humbjes së mirësive që na ka falur Ai. Po ashtu, në Kuranin Fisnik Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...Nëse më falënderoni, do t’ua shtoj të mirat. Nëse më përbuzni, pa dyshim që dënimi Im është shumë i ashpër!”

(Ibrahim, 7)

Edhe Ebu Dherri رضي الله عنه, ishte prej sahabëve të varfër. Por Profeti صلى الله عليه وسلم, e ka këshilluar duke i thënë: “O Eba Dherr! Shtoji pak më tepër ujë supës tënde dhe kujdesu edhe për fqinjin tënd!”

(Muslim, Birr, 142.)



Mos falënderimi tregon mungesë mirënjohjeje, ndjenjash dhe ndërgjegjeje. E, Allahu i Madhëruar, nuk i dëshiron kurrë këto cilësi tek një besimtar të cilin e ka ftuar në Xhenetin e Tij.

I lutemi Allahut të Madhëruar të na zbukurojë me sunitin e të dashurit të Vet ﷺ dhe të na pajisë me moralin e tij madhështor. Allahu na bëftë prej robërve falënderues, të cilët tregojnë mirënjohje dhe falënderim në çdo situatë!


Amin!..



*I nderuari Musa
Efendiu, hapte
fletoren e shënimeve
dhe tregonte:*

*“Ky është zekati im,
ndërsa kjo është
sadakaja...” Mirë
është që ato të
shkruhen kështu, me
qëllim që njeriu të
mos mendojë se ka
dhënë shumë.*





DURIMI dhe ORINETIMI

Durimi, është aftësia për të qenë përherë mik me Allahun, duke treguar pëlqim ndaj çdo caktimi hyjnor. Është ruajtja e qetësisë ndaj ndodhive që shkaktojnë dhimbje, duke u strehuar tek Allahu... Të jesh i vetëdijshëm se çdo gjë është provë që vjen prej Tij dhe të përpiqesh të arrish shpërblimin e premtuar prej tyre. Ndërsa ankesat dhe qarjet, nuk bëjnë gjë tjetër veçse i shtojnë edhe më tepër dëmet dhe humbjet.



DURIMI dhe ORINETIMI

DITURIA EKZOTERIKE/DHAHIRI DHE EZOTERIKE/BATINI

Urdhrat e fesë sonë përmbledhen në dy tema kryesore:

- **Tadhim li emril-lah:** Të tregosh respekt dhe nënshtrim në zbatimin e urdhrave të Allahut.
- **Shefkat ala halkil-lah:** Të mëshirosh të gjitha krijesat për hir të Krijuesit.

E para përmban dijet ekzoterike, të cilat merren nga mësuesit, librat dhe shkolla.

E dyta përmban dijet ezoterike, të cilat merren nga bota jonë e brendshme dhe kanë të bëjnë me devotshmërinë. Pra, një besimtar, nuk mund ta marrë këtë dije nga mësuesit apo librat. Ai mund ta arrijë këtë dije vetëm në saje të zhvillimit shpirtëror, gjë e cila vjen si rezultat i sinqeritetit dhe devotshmërisë. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيَعْلَمُ اللَّهُ

“...Ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju (atë që nuk e dini); Allahu është i Dijshëm për çdo gjë...” (Bekare, 282)

Të devotshmit i udhëzon edhe Kurani Fisnik. Në një ajet urdhërohet:

هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

“...Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (Bekare, 2)

Ja pra, pikërisht ky është edhe arsimimi dhe edukimi i vërtetë; njohja e Allahut me zemër. Mirëpo, për këtë është i domosdoshëm edhe edukimi ekzoterik/dhahiri.

Siç e kemi shprehur edhe më herët, lidhur me këtë fakt, Ebu'l Hasan Harakani, ka thënë:

“Fitnen që shkaktojnë dy lloj njerëzish, nuk e shkakton as shejtani, prandaj ik prej tyre! Njëri është sufisti i paditur dhe tjetri është dijetari që nuk e ka arritur devotshmërinë dhe është mposhtur nga lakmia për këtë botë.”



Omeri رضي الله عنه, ka thënë:

“Ato që e tronditin Islamin janë:

- Rrëshqitja e këmbës së dijetarit (të cilit i dobësohet besimi për shkak të ndonjë interesi personal)
- Dhënia e fetvave nga imamët e devijuar...”

Domethënë që; një dijetar, i cili nuk e zotëron në zemër “njohjen e Allahut”, mund të përfshihet nga lakmitë e egos dhe të shkaktojë dëme dhe fitne të mëdha.

Nga ana tjetër, edhe një sufist/mistik që nuk i njeh mirë dijet ekzoterike, si pasojë e metodave të gabuara, mund të bëjë më tepër dëm se sa dobi.

Nisur nga kjo, është e domosdoshme që ekzoterikja dhe ezoterikja të gërshetohen së bashku.

Një ditë, Omeri رضي الله عنه, i thotë Ziyad bin Hudejres رضي الله عنه:

“A e di se çfarë e rrënon Islamin?”

Kur Ziyadi tha se nuk e dinte, Omeri رضي الله عنه, vazhdoi e tha:

“Ato që e tronditin Islamin janë:

- Rrëshqitja e këmbës së dijetarit,
- Debati i hipokritit duke përdorur Kuranin;
- Dhënia e fetvave nga imamët e devijuar...” (shih. Darimi, Mukaddime, 23)

Që të tria këto, vijnë si rezultat i largimit nga shpirtërorja. Feja jonë duhet të mësohet dhe zbatohet patjetër me gërshtimin e dijeve dhahiri dhe batini, sepse kështu veproi edhe Profeti ynë صلى الله عليه وسلم, kur edukoi sahabët në shkollën e suffes. Lidhur me edukimin shpirtëror që jepte i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, Abdullah Ibni Mes’ud رضي الله عنه, tregon:

“Tek ne, reflektoheshin gjendje të tilla prej Profetit (a.s), saqë dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave të bukës që kapërdinim.” (Buhari, Menakib, 25.)

Ndërsa treguesi i përkryerjes së dijeve ekzoterike dhe ezoterike, është dobia që shfaqet prej tyre, gjë e cila vërtetohet në shtimin e devotshmërisë dhe frikës ndaj Allahut të atij që i zotëron ato dije. Pra, rruga që ndjek ai njeri.



Omeri رضي الله عنه, thotë: *“Një tjetër çështje që e trondit Islamin, është:*

- Debati i hipokritit duke përdorur Kuranin (duke u përpjekur të sjellë argumente prej tij për të mbrojtur idetë e tij të devijuara).

ORIENTIMI

Në këtë botë sprovash, në jetën e njeriut ndodhin ulje dhe ngritje. Nëse përballë këtyre, në botë e brendshme të njeriut ndodhin përkulje dhe përplasje, do të thotë se ai ka dështuar në sprovën e orientimit. Por, nëse përballë të gjitha kushteve të ndryshueshme të jetës dhe fatit, ai arrin të qëndrojë në vijën e porosive të Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, do të thotë se ai ka arritur në gradën e të jetuarit në rrugën e drejtë, që është edhe grada më e çmuar.

Për të arritur pjekurinë e duhur shpirtërore, duhen studiuar këto dy dije:

- E para përmban dijet ekzoterike, të cilat merren nga mësuesit, librat dhe shkolla.
- E dyta përmban dijet ezoterike, të cilat merren nga bota jonë e brendshme dhe kanë të bëjnë me devotshmërinë, pastrimin e egos dhe të zemrës.

Gazaliu thotë: “Pastrimi shpirtëror dhe dëgjimi, janë të domosdoshme në marrjen e dijes” Pa pastrim dhe bindje, dituria nuk kthehet në urtësi.



Pikërisht për këtë arsye, edhe miqtë e Allahut e kanë quajtur mrekulli të madhe “qëndrimin në rrugë të drejtë”.

Pas Ramazanit të bekuar, që është një dhuratë e madhe hyjnore, përjetohet një sprovë e vërtetë orientimi; ruajtja apo humbja e fitime të arritura gjatë tij.

Nuk duhet harruar se;

Ramazani dhe kohët e tjera të bekuara, nuk janë thjesht kohë për adhurime sezonale. Ato janë kohë që na ndihmojnë të përforcojmë dhe vërtetojmë botën tonë shpirtërore në rrugën e duhur për gjatë gjithë jetës.

Mualla bin Fadl tregon:

“Të parët tanë të mirë, gjashtë muaj i luteshin Allahut që t’u jepte jetë deri në Ramazan. Ndërsa gjashtë muajt e tjerë, i

luteshin që t'u pranohej Ramazani që kaluan." (Kiuamu's-Sunne, et-Tergib ue't-Terhib, II, 354.)

Ajo që e tregon më së miri se a është pranuar apo jo Ramazani i një robi, është vazhdimi ose jo i së njëjtës gjendje të Ramazanit edhe pas tij.

Shejtani i mallkuar, me qëllim që t'ia shtrembërojë orientimin robit, i afrohet atij me lloj-lloj intrigash dhe e nxit duke i thënë:

"Ke bërë shumë adhurime. Tani ka ardhur koha të shikosh pak edhe këtë botë. Mos u shqetëso, se Allahu është Falës e Mëshirues. Vjen prapë Ramazani tjetër dhe do kesh mundësi të bësh më shumë adhurime. Por tani jeto jetën!.. Bëj edhe pak qejf në këtë botë!.."

Mirëpo, edhe një devijim shumë i vogël në orientim, zmadhohet me kalimin e kohës dhe pas disa hapash, njeriu sheh se ndodhet shumë larg qëllimit të tij të vërtetë.

Zoti ynë i Madhëruar, në suren Fatiha, na fton përherë të lutemi për orientimin në rrugën e drejtë:

إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

"Na udhëzo në rrugën e drejtë!"

E, rruga e drejtë, është ajo që shkon drejt Allahut të Madhëruar dhe me të cilën Ai ka lëvduar Profetin tonë ﷺ:

إِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَ عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

Dija ezoterike arrihet me anë të devotshmërisë dhe rezultati i saj është urtësia. Një besimtar, nuk mund ta marrë këtë dije nga mësuesit apo librat. Ai mund ta arrijë këtë dije vetëm në saje të zhvillimit shpirtëror, gjë e cila vjen si rezultat i sinqeritetit dhe devotshmërisë.



“Padyshim se ti je prej të dërguarve dhe në rrugë të drejtë.” (Jasin, 3-4)

Rruga e drejtë, është vetë Profeti ynë ﷺ; tradita e tij, morali madhështor dhe cilësitë e tij shembullore. Nga kjo pikëpamje, ne duhet të respektojmë ligjet e Allahut duke jetuar me përpikëri në rrugën e Profetit tonë ﷺ.

Ajo që duhet të kemi kujdes që në fillim, është që urdhrat dhe ndalesat e Allahut t'i zbatojmë me gjithë shpirt, sepse pa ligjet e Allahut, nuk ka as devotshmëri.

Ne duhet të bëjmë kujdes që kryerja e adhurimeve fizike e materiale, si namazi, agjërimi, sadakaja, etj., të jetë në harmoni me trupin dhe shpirtin. Më pas, duhet të përpiqemi të zhvillojmë veten tonë me adhurimet shpirtërore si mëshira, modestia, ndershmëria, etj. Në saje të këtyre, duhet të mundohemi të qëndrojmë në rrugën e drejtë të Profetit tonë ﷺ; të bëhemi njerëz me shpirt të ndjeshëm dhe të butë; të jemi besimtarë që e jetojnë Islamin dhe arrijnë të kryejnë edhe detyrën e tyre të besimit, që është urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat.


Dhe, ruajtja e orientimit në rrugë të drejtë dhe ndjekja e Profetit tonë ﷺ, me devotshmëri, ka shpërblim shumë të madh. Madje, robërve të devotshëm që ruajnë orientimin në rrugë të drejtë, Allahu i Madhëruar u dërgon melekë në këtë botë dhe në botën tjetër që t'i ndihmojnë në atë rrugë. Lidhur me këtë në Kuranin Fisnik urdhërohet:

Ne duhet të bëjmë kujdes që kryerja e adhurimeve fizike e materiale, si namazi, agjërimi, sadakaja, etj., të jetë në harmoni me trupin dhe shpirtin. Më pas, duhet të përpiqemi të zhvillojmë veten tonë me adhurimet shpirtërore si mëshira, modestia, ndershmëria, etj.



“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbrezin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.»” (Fussilet, 30.)

Nga elementet që e tronditin orientimin e besimtarit, është edhe mungesa e durimit; nxitimi dhe paqëndrueshmëria përballë joshjeve të kësaj bote. Për këtë arsye, një nga gjërat më të domosdoshme në fushën ezoterike, është durimi.



DURIMI

Siç transmetohet, i Dërguari i Allahut ﷺ, durimin e ka përkufizuar në këtë mënyrë:

“*Durimi është tre llojesh:*

- *Durimi ndaj fatkeqësive,*
- *Durimi në devotshmëri (ndaj Allahut) dhe*
- *Durimi ndaj gjynaheve (largohet prej tyre)...”* (shih. Sujuti,

el-Xhamiu’s-Sagir, II, 42; Dejlami, II, 416)

Durimi në bindje dhe adhurim: Vazhdimi në adhurime me përkushtim të thellë deri sa të vijë vdekja. Humbja e vetëdijes dhe ndjeshmërisë ndaj adhurimeve kur përfundon sezoni shpirtëror i Ramazanit, e në mënyrë të veçantë, shfaqja e dobësisë në durim përball kësaj bote, shkakton një padurim dhe humbje orientimi të hidhur, që përfundon me dështim.

Madje, kjo mund të çojë edhe në humbjen e shpërblimeve të fituara më herë.

Kryesorja në devotshmëri, është vazhdimësia e saj përgjatë gjithë jetës. Ashtu siç nuk është e mundur të bësh një gjellë në zjarrin e kashtës, ashtu edhe përpjekjet e pa vazhdueshme për devotshmëri, nuk mund të sjellin pjekuri në zemër. Mbi të gjitha, Allahu i Madhëruar nuk e pëlqen një devotshmëri të tillë të paqëndrueshme, me ulje dhe ngritje të shpeshta. Në një hadith fisnik thuhet:

“Vepra më e dashur tek Allahu i Madhëruar, është ajo që bëhet vazhdimisht, qoftë edhe e pakët.” (Muslim, Musafirin, 218; Ahmed, VI, 61)

Për këtë arsye, një prej sekreteve të qëndrimit në rrugë të drejtë, është edhe përvetësimi i vetëdijes dhe parimit, “e pakët por e vazhdueshme”. Pra, nuk duhet të lejohet asnjë zbrazëtirë ku mund të ndërhyjë shejtani i mallkuar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْجِعْ

“Kur të çlirohesh (nga një punë), përpigu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8)

Ndërsa Mevlana ka thënë:

“Treguesi i pranimit të një adhurimi, është që pas tij të fillosh menjëherë një adhurim tjetër, duke vrapuar në mirësi njëra pas tjetrës.”

Kur Profeti ynë ﷺ, u gurëzua nga populli i paditur i Taifit, ai tha:

“...Nëse nuk Je i zemëruar me mua, nuk dua t’ia di për vuajtjet dhe belatë që po heq!..”



Po ashtu, një tjetër gradë e durimit, është durimi ndaj fatkeqësive, gjë që tregon qetësinë e zemrës ndaj caktimit hyjnor.

DORËZIMI NDAJ CAKTIMIT HYJNOR


Durimi ndaj fatkeqësive, është përballimi me qetësi shpirtërore dhe dorëzim i caktimit hyjnor. Kjo kërkon një pjekuri shpirtërore të nivelit të lartë. Shembujt të tillë madhështorë i gjejmë edhe në jetën Profetit tonë ﷺ dhe të sahabëve të tij.

Jeta e të Dërguarit të Allahut ﷺ, ka qenë si një rreth vuajtjesh. Ai lindi jetim dhe u rrit larg vendit të vet. Gjashtë prej fëmijëve i varrosi me duart e veta. Ndërkohë, gjatë kryerjes së detyrës së profetësisë, u përballë me vështirësi të shumta. E megjithatë, ai jetoi gjithmonë i dorëzuar ndaj pëlqimit të Allahut. Kur u gurëzua nga populli i paditur i Taifit, ai tha:

“...Nëse nuk Je i zemëruar me mua, nuk dua t’ia di për vuajtjet dhe belatë që po heq!..” (shih. Ibn-i Hisham, II, 29-30; Hejthemi, VI, 35.)

Po ashtu, edhe sahabët u treguan shumë durimtarë ndaj vuajtjeve dhe vështirësive në rrugën e Allahut. Aq, sa edhe rëniën dëshmor në këtë rrugë, e konsideronin si një fat shumë të madh. Ata i përballuan me durim dhe qetësi shpirtërore të gjitha vështirësitë e jetës, duke filluar prej skamjes, vështirësitë dhe vuajtjet që u shkaktounin idhujtarët.

Sepse;



Kjo botë u zvogëlua në sytë e sahabëve, ndërsa bota tjetër u bë pikësnyimi i tyre i vetëm. Për shkak se ata dëshironin shumë të afroreshin me Allahun, vështirësitë e kësaj bote ishin asgjë në sytë e tyre. Pra, asnjë vështirësi nuk i pengoi ata të afrohen me Allahun. Pasioni dhe dëshira e tyre në këtë aspekt u bë aq e mprehtë, saqë jetuan gjithmonë të dorëzuar dhe të kënaqur ndaj Allahut të Madhëruar. Ata as u lëkundën dhe as devijuan nga rruga e drejtë.

Le t'i përmendim këtu disa prej këtyre shembujve:

S'MUND TË GJEJË QETËSI PA E PARË ATË!

Ditën e Uhudit, Medina u lëkund me një lajm të hidhur. Me t'u thënë se “Muhamedi u vra!”, në qytet shpërthyen klithmat, dhe kuja u ngrit në qiell! Madje, zonja Sumejra nga en-sarët, megjithëse kishte marrë lajmin e vdekjes së dy djemve, babait, burrit dhe vëllait, më parë pyeti për gjendjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ:

- A i ka ndodhur gjë atij?

Sahabët iu përgjigjën:

- Lavdi Zotit, është mirë! Ashtu siç dëshiron edhe ti, ai është gjallë!

- Tregomani ku është, ta shoh dhe të më qetësohet zemra! – tha zonja Sumejra.

Kur ia treguan se ku ndodhej, i shkoi menjëherë pranë, e kapi pas kindit të rrobës dhe i tha:

- Të qofshin falë nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut! Po qe ti gjallë, nuk



shqetësohem për gjë tjetër! (Uakidi, I, 292; Hejthemi, VI, 115.)

Madhësia e dashurisë matet me sakrificën që bëhet për atë që dashuron. Kush dashuron, jep jetën për atë që do dhe nuk mendon aspak se po sakrifikon ndonjë gjë.

Për këtë arsye, edhe njerëzit e devotshëm, saherë që përballeshin me ndodhi ndaj të cilave duhet të tregonin durim, në vend që të duronin nga e keqja, ata e konsideronin atë si mundësi për t'u afruar me Allahun dhe për të fituar shpërblime prej Tij.

Gjatë një lufte, Aliu ﷺ, kishte marrë plagë, dhe në trup i ishte ngulur një shigjetë. Sado që u munduan, nuk mundën ta nxirrnin, sepse dhimbjet ishin të mëdha.

- Përpiquni ta nxirrni kur të fal namaz, - tha ai.

Ashtu bënë dhe shigjetën e nxorën lehtësisht gjatë faljes së namazit. Kur dha selam i pyeti.

- Çfarë bëtë?

- E nxorëm shigjetën, - iu përgjigjën.

Pra, Aliu ﷺ, ishte aq i përkushtuar në namaz, sa që nuk i ndjente as dhimbjet që i shkaktonte plaga e marrë.

Lidhur me pasionin dhe kënaqësinë që ndjehet gjatë këtij namazi, Mevlana shprehet:



“Merr abdes në atë mënyrë, që të mos priset kurrë! Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë! Të dashuruarit nuk i mjaftojnë pesë kohë namaz. Ai dëshiron pesëqind mijë kohë. A mund të dëshirojë i dashuruari i vërtetë mbarimin e takimit!?”

Në veprën “Vefajat”, Ibni Halikan na përcjell këtë ndodhi:

MUNDËSI SHPËRBLIMI

Urve bin Zubejri (Allahu e mëshiroftë), bashkë me djalin e tij, Muhamedin, shkuan për vizitë në Sham tek kalifi Velid bin Abdulmeliku. Kur arritën atje, djali i tij hyri në stallë për t’u kujdesur për kafshët. Mirëpo, një nga kuajt e goditi keq dhe ai vdiq në vend.

Nuk kishte kaluar shumë nga ky aksident i hidhur, kur vetë Urves iu bë këmba gangrenë. Ndërkohë, kalifi Velid bin Abdulmelik e mori vesh këtë dhe i thotë se duhet t’i pritej këmba, përndryshe, gangrena do t’i përhapej në të gjithë trupin e do të vdiste.

I qetë shpirtërisht, Urve i dorëzohet caktimit të Allahut. Kështu, thirret menjëherë doktori për t’i prerë këmbën. Para se të fillonte, doktori thotë se operacioni do të ishte shumë i dhimbshëm, prandaj ishte mirë që pacienti të vihej nën narkozë. Për këtë arsye, ai i thotë Urves:

“Zotëri! Nëse na lejoni, do t’ju japim ca verë, me qëllim që të mos ndieni dhimbje gjatë operacionit.” Mirëpo, Urve e pa habitshëm fytyrën e doktorit dhe tha:

*Durimi ndaj
ndodhive të
hidhura dhe
strehimi tek
Allahu, është
cilësi e njerëzve të
devotshëm.*



“Unë nuk e përdor kurrë atë që Allahu e ka shpallur haram, qoftë edhe për të shpëtuar nga sëmundja!”

Pasi mori këtë përgjigje të prerë, kësaj here doktori i tha:

“Zotëri, atëherë nëse pranoni do t’ju japim një ilaç që do t’ju vërë në gjumë.” Por Urve kundërshtoi përsëri dhe tha:

“Edhe nuk do ta ndjejë dhimbjen kur të më pritet një gjymtyrë, edhe do të kërkojë shpërblim nga Zoti!? Nuk mund ta pranojë diçka të tillë!”

Pas kësaj, në dhomë hynë disa veta.:

“Kush janë këta? Përse kanë ardhur?” – Pyeti ai.

“Zotëri! Në këtë operacion dhimbjet bëhen të padurueshme. Prandaj, këta kanë ardhur për t’ju mbajtur.” -Tha doktori.

“InshaAllah do të bëj durim dhe nuk do t’ju nxjerr vështirësi!” -Tha Urve, dhe i përcolli ata që erdhën duke i falënderuar.

Pas kësaj, doktori filloi operacionin. Urve bin Zubejr رضي الله عنه, tregoi një durim të jashtëzakonshëm deri në fund të operacionit dhe i mbështetur fort tek Allahu, përsëriste vazhdimisht fjalët:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ / La ilahe il-llahu uallahu Ekber

Pas operacionit, plaga u vulos me vaj ulliri të nxehur. Në ato momente, Urves i ra të fikët nga dhimbjet e mëdha.

Durimi është një thesar shumë i çmuar në botën e brendshme të njeriut. Ai është një mburojë e sigurt që e ruan të zotin edhe nga kamja, edhe nga skamja, edhe nga fatkeqësia, edhe nga mirësia.



Kur u përmend, fshiu djersët në fytyrë dhe këndoi këtë ajet fisnik:

“...(me të vërtetë që) jemi lodhur nga ky udhëtimi ynë.”

(Kehf, 62)

Më pas, kur e pa këmbën e vet në duart e doktorit, e mori atë, e vështroi dhe tha:

“Betohem në Atë që të ka bërë të më bartësh, se ti nuk ke ikur asnjëherë në haram dhe as që je drejtuar për atje.” (Ibn-i Hallikan, Vefajat, Beyrut 1900, III, 255-257.)

PASION SHPIRTËROR

Ky është një pasion shpirtëror; mposhtja e materiales nga shpirtërorja, e fizikës nga metafizika!..

Një oficer pensionist që ka qenë komandant dhe është plagosur në luftën e Çanakalesë, tregon këto ngjarje nga kujtimet e veta:

Lidhur me pasionin dhe kënaqësinë që ndjehet gjatë namazit, Mevlana shprehet:

“Merr abdes në atë mënyrë, që të mos prishet kurrë! Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë!..”



“...pashë rreshter Aliun. Në fytyrën që i ishte zverdhur dyllë, i lexohej një vuarjtje e rëndë. Pa mu dhënë rasti ta pyesja se ç’kishte, ai vetë ma tregoi krahun që fliste për gjithçka. U drodha i tmerruar! Krahu i majtë që i kishte marrë një goditje katër gishta mbi bërryl, i varej i mbajtur vetëm nga një copë lëkure. Rreshter Aliu përpiquej ta mposhte dhimbjen duke shtrënguar fort dhëmbët. Ma zgjati thikën e xhepit që e mbante në dorën e djathtë, dhe më tha:

“Prema këtë, o komandant!”

Kjo fjali tri-katër fjalësh shprehte një dëshirë të tillë të fortë, një detyrim të tillë, saqë unë, në mënyrë krejt të pavullnetshme, e mora thikën dhe e ndava krahun që tundej i varur pas lëkure! Ndërkohë që po kryerja këtë detyrë, që të rrëqethte e t'i ngrinte qimet përpjetë, përpiqesha t'i jepja zemër duke i thënë:

“Mos u dëshpëro, rreshter Aliu, Allahu t'i dhëntë shëndet trupit!”

Pa kaluar shumë, rreshter Aliu e flijoi edhe trupin për vatanin dhe, duke i mbyllur sytë e duke e larë vendin përreth me gjak, thoshte:

“Të rrojë vatani! Allahu mos na ndaftë nga besimi! Jeta m'i qoftë falë vatanit!”

Kjo gjendje, arrihet atëherë kur dashuria dhe pasioni për Allahun të bën t'i harrosh të gjitha dhimbjet...

Kur Sulltan Muradi i I hyri në fushën e Kosovës më 8 gusht 1389, u përball me një ushtri dyfish më të madhe se të vetën dhe iu lut Allahut me këto fjalë:

“...O Zoti im! Mos i lër këta ushtarë besimtarë të shkatërrohen në dorën e jobesimtarëve!.. Jepu atyre një fitore, që të festojnë të gjithë besimtarët! Nëse do, kurhani i asaj dite feste le të jetë robi Yt Muradi!..”

*Mevlana ka thënë:
“Të dashuruarit nuk
i mjaftojnë pesë
kohë namaz. Ai
dëshiron pesëqind
mijë kohë. A
mund të dëshirojë
i dashuruari i
vërtetë mbarimin e
takimit!?”*



Dhe me të vërtetë që, atë ditë, Allahu u fali një fitore madhështore dhe kurhani asaj feste triumfi u bë pikërisht Sul-tan Muradi.

ZBUKURIMI I VDEKJES

Këto skena martirizimi, në të njëjtën kohë janë edhe gjendje të zbukurimit të vdekjes. Të shpëtosh prej perceptimit tmer-rues të vdekjes dhe të ecësh me dashuri drejt martirizimit, është e mundur vetëm në saje të përfshirjes së zemrës në një atmosferë pasioni dhe dashurie. Ndërsa kjo mund të arrihet duke eliminuar dëshirat e egos dhe duke kuptuar të fshehtë e “vdekjes para se të vijë vdekja”. Pra, nëse robi arrin të ketë sukses në pastrimin e zemrës dhe të egos sa është gjallë, të gjitha vuajtjet dhe dhimbjet që shkakton kjo botë, e humbasin ndikimin e tyre tek ai.

Në këtë botë sprovash, do të ketë patjetër sprovë të durimit si pasojë e caktimit hyjnor. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: «Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!»”
(Bekare, 155-156.)

Ndërsa momenti më i çmuar i durimit, është çasti i parë kur përballësh me fatkeqësinë. Pra, durimi duhet të tregohet në momentin e parë, sepse kjo përbën edhe kulmin e durimit.



Kur magjistarët e Faraonit iu dorëzuan udhëzimit hyjnor përballë mrekullive të Musait السَّيِّدِ, ranë menjëherë në sexhde. Faraoni gati sa nuk u çmend nga kjo dhe filloi t'i kërcënonte ata:

“(Faraoni) tha: «Çfarë?! Ju e besuat atë, para se t’ju jap leje unë?! Në të vërtetë, ai është mjeshtri juaj, që ju ka mësuar magjitë. Unë do t’jua këpus duart dhe këmbët tuaja të këmbëra dhe do t’ju var në trungjet e hurmave. Ju do ta merrni vesh, me siguri, se cili prej nesh është më i ashpër dhe më ngulmues në ndëshkim.»” (TaHa, 71.)

Në fillim, Faraoni u kishte premtuar magjistarëve pasuri të mëdha. Mirëpo, ata i refuzuan mirësitë e kësaj bote dhe nuk u trembën as nga torturat më çnjerëzore. Ata iu drejtuan Faraonit dhe i thanë:

“..Gjyko si të duash; ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote!” (TaHa, 72.)

“Ne, me siguri, do të kthehemi tek Zoti ynë!” (Araf, 125.)

Ndërkohë që Faraoni po i torturonte rëndë, duke u prerë këmbë e duar, ata, me ankthin se mos po humbasin besimin e tyre, iu lutën Zotit që t’ua pranonte këtë besim.

“..Zoti ynë! Na dhuro durim të mjaftueshëm dhe na merr shpirtin si myslimanë!” (Araf 126.)

Nisur nga kjo, mund të thuhet se: Durimi, është aftësia për të qenë përherë mik me Allahun, duke treguar pëlqim ndaj çdo caktimi hyjnor; është t’i besosh këtij urdhri hyjnor:



“...Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini!” (Bekare, 216.)

Ruajtja e qetësisë ndaj ndodhive që shkaktojnë dhimbje, duke u strehuar tek Allahu, vetëdija se çdo gjë është sprovë që vjen prej Tij dhe përpjekja për të arritur shpërblimin e premtuar, mund të realizohet vetëm nga njerëzit e devotshëm. Ndërsa ankesat dhe qarjet, nuk bëjnë gjë tjetër veçse i shtojnë edhe më tepër dëmet dhe humbjet.

Durimi është një thesar shumë i çmuar në botën e brendshme të njeriut. Ai është një mburojë e sigurt që e ruan të zotin edhe nga kamja, edhe nga skamja, edhe nga fatkeqësia, edhe nga mirësia.

MBUROJA PROFETIKE

Durimi është një mburojë me të cilën janë pajisur të gjithë profetët dhe ia kanë këshilluar popujve të tyre.

Jakubi عليه السلام, tregoi durim të mirë ndaj dhimbjes që i shkaktoi humbja e djalit të tij dashur, Jusufit عليه السلام. Në mënyrë të veçantë, durimi i profetit Ejub عليه السلام, është legjendar... Ai humbi pasurinë, fëmijët dhe shëndetin. Mirëpo, kurrë nuk e humbi besimin në Allahun dhe nuk u ankua.

Njëherë, bashkëshortja e tij, zonja Rahime, i thotë:

“Ti je profet dhe lutja jote pranohet. Pra, lutu që të shërohesh!”

“Durimi...
i hidhur dynja,
i ëmbël
në ahiret!”

صبرك صويك سلامت
صبرك صويك سلامت

Ndërsa Ejjubi عليه السلام, tha:

“Allahu më dha tetëdhjetë vjet shëndet të mirë. Ndërsa sëmundja ime nuk i ka mbushur ende tetëdhjetë vjet. Unë po vuaj veç prej disa vitesh. Më vjen turp të kërkoj shëndet prej Allahut të Madhëruar!”

Mirëpo, kur sëmundja e tij filloi ta pengonte nga kryerja e adhurimeve me shpirt të qetë, atëherë iu lut Allahut duke thënë:

“Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Enbija, 83.)

Më pas, Allahu i Madhëruar i dha shërimin me anë të një uji që nxori nga toka.

Padurimi të çon drejt mosbindjes dhe devijimit nga rruga e drejtë. Dhe kjo, është errësira e gjynaheve të mbushura me kurthe. Profeti ynë ﷺ, shprehet:

“...Durimi është ndriçues...” (shih. Muslim, Taharet, 1.)

Pra, ai ndriçon të dyja botët e njeriut.

Fundi i durimit është shpëtim.

Allahu mos na lëntë në errësirën e veseve dhe indiferencës dhe na ndriçoftë gjithmonë me dritën e udhëzimit, orientimit në rrugë të drejtë dhe durimit!..

O Allah!..



*“(O Profet)
përgëzoji të
duruarit, të cilët,
kur i godet ndonjë
fatkeqësi thonë:
« Të Allahut jemi
dhe vetëm tek Ai
do të kthehemi! »”*


(Bekare, 155-156.)

Na bëj prej atyre që i dorëzohen caktimit Tënd, janë durimtarë në bindje dhe rrugë të drejtë dhe që rrinë larg ve-seve dhe indiferencës!..

O Allah!..

Na bëj prej robërve të Tu durimtar që janë në rrugë të drejtë dhe i ke përgëzuar me Xhenet, ku do të priten me se-lamet e melekëve të Tu!..

Amin!..



"E çuditshme është çështja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është mirësi për të dhe kjo është e tillë vetëm për të. Nëse besimtarit i ndodh një gëzim, ai falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi. E nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), dhe po ashtu, edhe kjo i sjell dobi."

(Muslim, Zuhd, 64.)



MODESTIA dhe PËRULJA

Ditën e çlirimit të Mekës, tek i Dërguari i Allahut ﷺ kishte ardhur një person, i cili duke u dridhur nga frika, tha:

“O i Dërguar i Allahut! Më tregoni Islamin!” Kur e pa në këtë gjendje, i Dërguari i Allahut ﷺ iu drejtua me butësi dhe ëmbëlsi, duke treguar një modesti dhe përulësi të jashtëzakonshme dhe i tha:

“Qetësohu vëlla! Unë nuk jam as mbret, as sundimtar! Unë jam biri i një gruaje nga fisi i Kurejshëve, që ushqej me mish të tharë në diell!..” (Ibn Maxhe, Et’ime, 30.)



MODESTIA dhe PËRULJA

MORALI I TIJ ISHTE MORALI I KURANIT

Kur nënën tonë Aishen رضي الله عنها, e pyesnin pas vdekjes së Profetit صلى الله عليه وسلم, në lidhje me moralin e tij, ajo përgjigjej duke thënë:

“Moralin e tij ishte Kurani.” (shih. Muslim, Musafirin, 139.)

Në Kuranin Fisnik, besimtari përkufizohet me këto fjalë:

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...” (Furkan, 63)

Profeti ynë صلى الله عليه وسلم, që ishte robi më i virtytshëm, më i plotësuar dhe më i përkryer, ashtu siç gëzonte të gjitha virtytet morale, kishte edhe një modesti të pashoqe.

Ai nuk mburrej kurrë për devotshmërinë dhe moralin e lartë që zotëronte. Kur ishte i detyruar të shprehte mirësitë që i kishte dhënë Allahu, thoshte me përulje të madhe: “La fahre / s’ka mburrje!” (Tirmidhi, Menakib, 1; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 37; Ahmed, I, 5, 281.)

Edhe pse Profeti ynë ﷺ, gëzonte faljen hyjnore për të shkuarën dhe të ardhmen, ai vazhdoi të falënderonte dhe t'i lutej Allahut pa pushim, duke i kaluar netët me namaz derisa i ënjteshin këmbët.

Edhe mënyra e jetesës së tij ishte shumë modeste:

Edhe pse ai arriti mundësi të mëdha në një kohë shumë të shkurtër dhe kishte shokë të atillë, që për një dëshirë të tij jepnin jo vetëm pasurinë, por edhe jetën e tyre, Profeti ynë ﷺ, nuk u dha pas mirësive të kësaj bote, por vazhdoi të bënte jetën modeste që kishte bërë gjithmonë. Ai vazhdoi të jetonte në dhomën e tij prej qerpiçi si më parë. Fjeti mbi një shilte të mbushur me gjethe hurmash. Veshi rroba të thjeshta. Madje, ai jetoi një jetë edhe më të varfër se njeriu më i varfër.

Ai ishte modest edhe në marrëdhënie me njerëzit:

Pavarësisht gradave të larta që gëzonte, si tek Allahu, ashtu edhe në shoqëri, ai vazhdoi si gjithmonë të interesohej personalisht me njerëzit në nevojë. Madje, falë dhembshurisë dhe mëshirës së madhe, ai i mbrojti edhe më shumë ata.

Ditën e çlirimit të Mekës, nuk hyri në qytet me pompozitetin e një komandanti triumfues, por i përkulur mbi devenë e vet si në sexhde. Madje, kur një person i erdhi duke u dridhur nga frika dhe tha:

“O i Dërguar i Allahut! Më tregoni Is-lamin!” I Dërguari i Allahut ﷺ iu drejtua me butësi dhe ëmbëlsi, duke treguar një modesti dhe përulësi të jashtëzakonshme dhe i tha:

Mevlana ka thënë:

“Shpata pret qafën e kryelartit. Ndërsa hijen nuk është e zonja ta presë asnjë shpatë, sepse është shtrirë përtokë, e është bërë njësh me të.”



“Qetësohu vëlla! Unë nuk jam as mbret, as sundimtar! Unë jam biri i një gruaje nga fisi i Kurejshëve, që ushqehet me mish të tharë në diell!..” (Ibn Maxhe, E’ime, 30.)

Modesti, është vetëdija e robit për roberinë e vet ndaj Allahut.

Emrat e bukur të Allahut të Madhëruar i takojnë vetëm Atij. Ndërsa besimtarët e kanë për detyrë të nënshtrohen para Madhështisë së Tij dhe, në vend që të thonë, “unë”, duhet të thonë gjithmonë “Ti o Zot!”, sepse:

“...Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë.” (Nisa, 36.)

Një ditë, me qëllim që t’u mësonte shokëve të vet modestinë dhe përluljen, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“...Dijeni se; askush nuk do të shpëtojë në saje të punëve të tij.”

Sahabët e pranishëm, pyetën me habi:

“As ju nuk mund të shpëtoni, o i Dërguar i Allahut?” Profeti ynë ﷺ, u përgjigj:

“Po, as unë nuk mund të shpëtoj. Përveçse, nëse Allahu më fal me mëshirën dhe bujarinë e Tij!.. Nëse nuk më mbështjell mirësia, mëshira dhe falja e Tij, as unë nuk mund të hyj në Xhenet! Veprat e mia nuk mund të më shpëtojnë!..” (Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikin, 71-72; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 20; Darimi, Rikak, 24.)

Për rrjedhojë;

*Mevlana ka thënë:
“Vështro me vëmendje
dhe shiko! A bëhen
hijet shtrira shënjestër
e shigjetave? Kurse
njeriu që ngre kryet
lart dhe mburret,
kthehet në pikë qitjeje
për shigjetat, të cilat e
bëjnë shosh të mjerin
dhe e asgjësojnë.”*




GJITHÇKA DUHET T'IA ATRIBUOJMË ATIJ

Çdo mirësi që gëzon, besimtari duhet t'ia atribuojë Allahut të Madhëruar, e jo vetes të tij. Allahu i Madhëruar ia ka mësuar këtë të vërtetë të Dërguarit të Vet ﷺ dhe sahabëve në dy fitore. Njëherë pas fitores madhështore në betejën e Bedrit, kur Allahu i Madhëruar zbriti këtë ajet:

“(O i Dërguar!) (Atë ditë) nuk i vratë ju ata, por i vrau Allahu. Edhe kur qëlllove, nuk qëlllove ti, por Allahu! Dhe këtë (e bëri) për t'i vënë besimtarët para një prove të madhe! Pa dyshim, Allahu dëgjon dhe di!” (Enfal, 17.)

E herën tjetër, pas çlirimit të Mekës, kur u zbrit ky urdhër hyjnor në suren Nasr:

“Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës) dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.” (Nasr, 1-3.)



Profeti ynë ﷺ, nuk mburrej kurrë për devotshmërinë dhe moralin e lartë që zotëronte. Kur ishte i detyruar të shprehte mirësitë që i kishte dhënë Allahu, thoshte me përlujtë të madhe: “La fahre / s’ka mburrje!” (Tirmidhi, Menakib, 1.)

Pra, pas triumfit urdhërohet kërkim i faljes...

Sepse;

Edhe kur robi e përfundon me sukses një detyrë, nuk mund të jetë i sigurt nëse është pranuar apo jo nga Allahu. Si pasojë e faktorit njerëzor, me shumë mundësi në atë detyrë janë shfaqur edhe mangësi. E në fakt, askush nuk mund të pretendojë se mund ta kryejë njëqind për qind detyrën e devotshmërisë ndaj Allahut, sepse në Kuran urdhërohet:

“...Edhe nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t’i numëroni dot...” (Ibrahim, 34.)

Ndërsa mirësia më e madhe e Tij, është udhëzimi në rrugë të drejtë, sepse në të ndodhet lumturia e të dyja botëve.

Prandaj;

Ne duhet të strehohemi përherë në mëshirën dhe faljen e Tij dhe t’i përgjrohemi Atij me lot në sy që t’i pranojë adhurimet dhe lutjet tona.

Nëse njeriu ia atribuon vetes arritjet materiale dhe shpirtërore, kjo është një fatkeqësi e madhe, sepse kjo tregon se ai nuk e ka kuptuar se:

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ الْعَلِيِّ الْعَظِيمِ

“Nuk ka fuqi dhe forcë përveç Allahut të Lartë e Madhështor!”

Besimtarët, ashtu siç janë të vetëdijshtëm ndaj dobësisë së tyre përballë Allahu të Madhëruar, kanë për detyrë të jenë të përlulur dhe të mëshirshëm edhe përballë vëllezërve të tyre myslimanë në marrëdhëniet njerëzore.

Krenaria është një ndjenjë në zemër, që reflektohet në gjeste, mimikë, veshje, etj. Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ditën e kiametit, Allahu nuk ka për t’ia parë fytyrën atij që tërheq zvarrë rrobën e tij duke u mburrur.” (Buhari, Libas, 1; Muslim, Libas, 42.)

Në Kuranin Fisnik,
besimtari përkufizohet
me këto fjalë:

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ
يَمْسُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا

“Robërit e të
Gjithëmëshirshmit janë
ata që ecin thjesht nëpër
Tokë...” (Furkan, 63.)



Kurse veshja e bukur dhe e rregullt pa pasur qëllim mburrjeje dhe krekosjeje, nuk përfshihet nga ky paralajmërim profetik. Në fakt, besimtari duhet të jetë i pastër, i thjeshtë dhe të bëjë kujdes në zemrën e vet.

Si rrjedhojë e natyrës, njeriu ka cilësinë për të qenë rob i diçkaje. Ai që nuk i bëhet rob Zotit të vet, në një farë mënyre bëhet rob i shejtanit, i pushtetit, i idhujve të ndryshëm, i parasë, i interesit, i pozitës, etj. Kurse ai që i bëhet rob Allahut, çlirohet nga të gjitha këto gjendje të ulëta dhe aspak dinjitoze për qenien njerëzore dhe arrin lirinë e vërtetë. Në këtë gradë, njeriu njeh veten e tij.

Dituria ekziston që njeriu t'i kuptojë këto të vërteta. Kjo është edhe dija e vërtetë. Mirëpo, ata që mburren e krenohen aq sa t'ia atribuojnë edhe dijen vetes, pësojnë një dështim të hidhur. Poeti Junus Emre shprehet:

*Dituri do të thotë të njohësh,
Dituri do të thotë të njohësh veten.
Nëse veten s'e njeh,
Studio sa të duash!..*

TË NJOHËSH VETEN

Arsimimi i vërtetë, e bën njeriun të njohë veten. E duke njohur veten, ai përparon në rrugën e njohjes së Zotit të vet. Më pas, ai fillon të admirojë fuqinë dhe madhësitinë e Allahut, kupton dobësinë e vet dhe e përdor meditimin si një çelës besimi.

Kush janë ata që zotërojnë një dije kaq fisnike?

Mevlana ka thënë: "Të jesh mendjemadh, të mburrësh e të të hyjë vetja në qejf, është si t'i vësh zjarrin druve. Si mund të shkosh tek zjarri dhe hidhesh vetë në të?"



Edhe pse këta persona që do të japim shembull nuk gëzojnë grada apo tituj shkencorë, ata janë nxënësit më të përkryer dhe më të suksesshëm të Profetit tonë ﷺ:

Ishte natë. Siç e kishte bërë zakon, kalifi Omer رضي الله عنه, po shëtiste nëpër rrugët dhe rrugicat e Medinës, kur, papritur ndali. Zonja e shtëpisë pranë së cilës po kalonte, po thoshte:

“Moj bijë, hidhi pak ujë qumështit që kemi për të shitur nesër!”

Kurse vajza ia ktheu:

“Nënë, a nuk ka thënë kalifi që të mos i përziejmë qumështit ujë, a nuk e ka ndaluar ai një gjë të tillë?”

Duke iu kundërvënë ashpër të bijës, e ëma i tha:

“Moj bijë, e ku do ta marrë vesh kalifi në këtë orë të natës se po i hedhim ujë qumështit?”

Mirëpo, vajza që e kishte zemrën të gjallë prej frikë-respektit ndaj Allahut, përsëri s’e pranoi dredhinë e nënës për t’i hedhur ujë qumështit:

“Moj nënë! Ta zëmë se kalifi nuk sheh; po Allahu, as Ai nuk sheh? Ta fshehësh këtë hile nga njerëzit, është e lehtë, por, a është e mundur ta fshehësh nga Allahu, Krijuesi i Gjithësisë, i Cili sheh dhe di gjithçka?”

Përgjigjja me një ndjenjë frike të thellë ndaj Allahut, që ajo vajzë me zemër të mbushur plot me të vërteta hyjnore, i dha të ëmës, e preku thellë kalifin Omer رضي الله عنه! Udhëheqësi i myslimanëve, duke e konsideruar atë vajzë jo si një njeri të thjeshtë,



Emrat e bukur të Allahut të Madhëruar i takojnë vetëm Atij. Ndërsa besimtarët e kanë për detyrë të nënshtrihen para Madhëstisë së Tij dhe në vend që të thonë, “unë”, duhet të thonë gjithmonë “Ti o Zot!”

bijë e shitëses së qumështit, por si një mirësi me një devotshmëri të veçantë që kishte në zemër, e mori atë si nuse për të birin. Ja pra, edhe Omer ibn Abdulaziz, i cili konsiderohet si një prej kalifëve të drejtë, është nipi i kësaj gruaje të devotshme. (Shih. Ibnu'l-Xheuzi, Sifatus-Safve, II, 203 - 204.)

Ajo vajzë ishte një njeri që e njihte veten e kishte kuptuar robërinë ndaj Allahut dhe kishte arritur edukimin e vërtetë që dëshiron Allahu i Madhëruar.

BUJARI E PASHOQE

Abdullah bin Xhaferri ﷺ, përgjatë një udhëtimi, kaloi nga një bahçe me hurma. Bahçevani ishte një rob i zi, të cilit i kishin sjellë tri bukë. Ndërkohë, erdhi një qen dhe robi ia hodhi atij njërën prej tri bukëve. Kur qeni e hëngri bukën, robi ia hodhi edhe tjetrën. Pasi e hëngri edhe atë, robi ia hodhi edhe bukën e fundit që i kishte mbetur.



*“...Në të vërtetë,
Allahu nuk i do
njerëzit arrogantë
e mburravecë.”*

(Nisa, 36.)

Pastaj mes Abdullah bin Xhaferri ﷺ dhe robit, u zhvillua kjo bisedë:

- Çfarë pagese merr ti?
- Ja, këto tri bukë që shikon!
- Po atëherë përse ia hodhe të gjitha qenit?
- Nga këto anë nuk ka fare qenë. Ky qen duhet të ketë ardhur nga larg. Prandaj nuk ma bëri zemra ta lija të uritur.
- Po ti çfarë do të hash sot?
- Do të duroj! Hakun tim të sotshëm ia dhashë kësaj krijese të uritur të Zotit.

Atë çast, Abdullahu ﷺ, e admiroi këtë moral të lartë dhe tha:

- Subhanallah! Pastaj thonë se unë jam shumë bujar. Ndërkohë, ky rob pas-ka qenë më bujar se unë!”

Më pas, Abdullahu e bleu bahçen e hurmave bashkë me robin dhe, robit i fali lirinë bashkë me bahçen e hurmave. (Gazali, Kimjaji Saadet, përkth. A. Faruk Mejani, Stamboll 1977, fq. 467.)

Ja pra, kjo gjendje është një prej degëve të arsimit të vërtetë. T’i shohësh krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit. Ai që ka krijuar të gjitha krijesat, është i njëjti Zot. Ai Zot që ia ka lënë njeriut nën kujdes të gjitha krijesat. Prandaj, nëse njeriu është i vetëdijshëm për këtë dhe i shpërndan në këtë mënyrë mirësitë që i ka dhënë Allahu, ai ka arritur një arsimim aq të lartë, saqë do të fitojë përjetësinë. Ky është arsimimi i Xheneetit.

Një tjetër prej virtyteve të rëndësishme të miqve të Allahut, është ruajtja e ekuilibrit të devotshmërisë përballë kushteve të ndryshueshme të jetës. Kjo ishte modestia e prijësit të të gjithë besimtarëve, Omerit ﷺ:

Një ditë, Ahnef bin Kajs ﷺ, shkoi të vizitonte Omerin ﷺ, bashkë me disa njerëz të rëndësishëm ndër arabët.

Kur arriti, e gjeti atë duke vrapuar, teksa fundin e rrobës së tij e kishte lidhur në brez. Kur Omeri ﷺ, e pa Ahnefin ﷺ, i tha:



Nëse ne e njohim sot Profetin ﷺ, edhe ai do të na njohë nesër në ditën e mahsherit (tubimit). Nëse jemi aq të pjekur për ta parë atë, edhe ai do të na shohë. Nëse e dëgjojmë dhe i vëmë veshin, edhe ai do t'i dëgjojë përgjërimet tona.

“Eja më ndihmo! Ka ikur një deve e shtetit. Ti e di se sa njerëz kanë të drejta mbi këtë deve.”

Në ato momente njëri nga të pranishmit tha:

“Përse e shqetëson kaq shumë veten? A nuk bën të urdhërosh një shërbyes për të kapur devenë?” Omer رضي الله عنه, u përgjigj:

“A ka shërbyes më të mirë se sa unë!?” (Shibli Numani, Butun Yonleriyle Hazreti Omer ve Devlet Idaresi, Perkth. Talib Jashar Alp, Stamboll, pa dt., fq. 384-385, 395.)

Ajo zemër e pastër, nuk i atribuonte asgjë vetes, edhe pse gjendej në një gradë shumë të lartë. Tek ai reflektohej vetëm përgjegjësia ndaj detyrës dhe mësimi i një përpjekjeje prej sklavi.

Qytetërimi ynë, që mori formë në duart e këtyre personaliteteve të veçantë, të cilët ishin monumente modestie, nxori edhe shumë heronj që e njihnin veten dhe detyrën e tyre. Historia jonë është e mbushur me personalitete, të cilët bëheshin luanë përballë armikut, ishin të përulur para Allahut dhe të dhembshur e modestë para besimtarëve.

*Çdo mirësi
që zotëron,
njeriu duhet
t'ia atribuojë
Allahut, e jo
vetes së tij.*



Për shembull, Arkitekt Sinani, veprat e të cilit sot i sodisim me ëndje, zotëronte një modesti të pashoqe. Edhe pse ishte autori i shumë veprave të famshme arkitekture, ai nuk mburrej dhe nuk krenohet kurrë. Kur përfundoi ndërtimin e Xhamisë Selimije, atij iu propozua që t'ia shënonin emrin në epigraf. Mirëpo, ai e refuzoi këtë nder duke thënë:

“E kush jam unë që të shënoj emrin tim në shtëpinë e Allahut!..”

Doktori francez A. Brayer, i cili ka jetuar për një kohë të gjatë në Stamboll dhe ka vëzhguar me kujdes jetën shoqërore osmane, ka bërë këto evidentime:

NJË POPULL QË NUK E NJEH MBURRJEN DHE MENDJEMADHËSINË

“Si rezultat i ndjenjës së turpfit, tek turqit myslimanë pothuajse janë zhdukur mendjemadhësia dhe mburrja, sepse mendjemadhësia dhe mburrja janë veti negative që Islami i ka ndaluar rreptësishtë. Në Islam urdhërohet:

“Kurrë mos ec mbi tokë me madhështi, e mos ua kthe shpinën njerëzve për shkak të mburrjes!”


“Allahu e urren atë që është mendjemadh dhe mburravec!”

“Tregohu i thjesht në sjellje dhe fol me zë të ulët!”

“Mendjemadhësia vjen prej injorancës, dijetari kurrë nuk mburret!”

“Modestia i jep fisnikëri njeriut.”

Si rrjedhojë e kësaj, pavarësisht seriozitetit dhe fisnikërisë në ecjen e njeriut osman, tek ai nuk sheh kurrë mendjemadhësi dhe krekosje. Në lëvizjet e duarve dhe krahëve të tyre nuk është ndjerë kurrë pretendim force dhe zotërimi. Në shërbimet e tyre ka lehtësi dhe ëmbëlsi.”



*Mes frikës dhe shpresës:
Nëse do të thuhej: “Vetëm një person do të hyjë në xhehenem”, besimtari duhet të frikësohet se: “mos vallë jam unë ai”. E nëse do të thuhej: “Vetëm një person do të hyjë në xhenet”, atëherë ai duhet të mbushet me shpresë, “mos vallë jam unë ai”.*

Botëkuptimi i modestisë në shoqërinë Osmane, vërehej tek të gjithë, që nga njeriu më i thjeshtë, e deri te padishahu. Sulltanët Osmanë kishin urdhëruar ushtarët e tyre me pagesë që gjatë ceremonisë përshëndetëse të xhumasë, të thoshin në kor:

“Mos u mburr o padishah, Allahu është më i madh se ti!..”

Po ashtu, edhe Sulltan Mehmet Fatihu, i cili hapi një epokë të re me çlirimin madhështor të Stambollit, të cilin prej shekujsh nuk e kishin arritur as komandantët më me famë, i firmoste dokumentet shtetërore me vulën e tij ku shkruhet, “robi i dobët”. Ndërsa në një rast kur Sulltan Mehmed Fatihu doli në gjyq me një arkitekt të krishterë, u ul si gjithë të tjerët në karrigen e të akuzuarit. Madje kur gjykatësi, Hëzër Beu, i dërgoi thirrjen e gjyqit, nuk iu drejtua me fjalët: “Sulltani biri i Sulltanit, Fitimtari, Babai i Çlirimit, Muhamed Han-i Thani”, siç i drejtoheshin zakonisht, por i tha: “Mehmedi i biri i Muratit, thirreni në gjyq në filan orë”. Kjo ndodhi tregon edhe drejtësinë e zbatuar nga gjykatësi, por edhe respektin dhe përuljen përballë drejtësisë që shfaqti një nga sunduesit më të plotfuqishëm të kohës.

Ndërsa përfaqësuesit më të veçantë dhe të sinqertë të modestisë dhe përuljes, kanë qenë përherë njerëzit e devotshëm, të cilët i ka marrë shembull edhe shoqëria.

Bahauddin Nakshibendi, në vitet e para të edukimit të tij shpirtëror, u shërbeu njerëzve të sëmurë e të mjerë dhe kafshëve pa zot e të plagosura. Madje, ai shërbeu shtatë vjet rresht, duke pastru-

Rumi:

“A gjelbëron një gur në stinën e pranverës? Bëhu modest si toka, që prej teje të dalin trëndafila dhe lule shumëgjyrëshe!..”



ar rrugët nga ku kalonin njerëzit. Për të shprehur gjendjen e tij të “hiçit”, që kishte arritur kulmin në shpirtin e tij, thotë:

*Bota është grurë, e unë kashtë
Bota është e mirë, e unë i keq...*

Po ashtu, edhe Junus Emre, i cili dyzet vjet me radhë barti dru për teqenë, duke dashur të shprehë se i besonte vetëm faljes dhe mëshirës hyjnore dhe jo veprave të veta, thotë:

*Nuk kam as dije as bindje, as fuqi, e as takat,
Prandaj unë ndihmën Tënde pres o Zot!*

Ndërsa në një prej poezive të tij, ku Junusi e thërret veten Junus i varfër, Dervish Junusi, Junusi i pashpresë, ai shpreh një modesti dhe përrulje të jashtëzakonshme duke thënë:

BËHU DHE!..

O Junus i varfër mos u bëj mendjemadh para miqve të Allahut, por bëhu dhe!

A s'ë di që prej dheut mbijnë shumë trëndafila, e shumë trëndafilishte janë gjelbëruar në gjirin e tokës mëmë.

Gjallesat që shëtisin mbi tokë, e shkelin dhe hedhin aty të gjitha papastërtitë. Mirëpo, toka, me një modesti të jashtëzakonshme, i pastron të gjitha këto papastërti, e më pas, çel bimë me bukuri të ndryshme dhe i ushqen të gjitha gjallesat që shëtisin mbi të. Ja pra, edhe shpirti i një besimtari të sinqertë, duhet të bëhet si një tokë e begatshme. Ata që fitojnë

Shpirti i një besimtari të sinqertë, duhet të jetë si tokë e begatshme; të gjitha bukuritë e shpirtit të tij duhet të reflektohen si një poezi e natyrshme tek të gjithë njerëzit, e madje tek të gjitha krijesat e tjera.



këtë gradë, i eliminojnë të gjitha papastërtitë si toka dhe arrijnë përkryerjen. Kështu, ata bëhen njerëz të zemrës të mbushur me njëmijenjë virtyte si toka.

E në fakt, modestia si toka, i fal virtyte të zotit, ia pjek devotshmërinë dhe ia zbukuron moralin. Njeriu i përlur, është bujar. Njeriu bujar, është i mëshirshëm. Njeriu i mëshirshëm, është entuziast në shërbimin ndaj krijesave. Këto janë mënyrat më të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala. Njeriu që është larg modestisë, është i privuar nga të gjitha këto bukuri.

Gjëja më e keqe sot, është ndërgjegjja e ashpërsuar me padrejtësi e padronëve tiranë që udhëheqin botën. Kjo ndërgjegje e errët, ku mëshira s'ka fuqi, po i kthen njerëzit në skllevër modernë dhe vendet e varfra në plehërishte njerëzore.

Historia është dëshmitare se, vendet, në tokën e të cilave nuk mbillet më fara e mëshirës dhe padronët e tyre me shpirt të mjerë, gjithmonë e kanë kthyer botën në një moçal padrejtësish.

E në fakt, vlerën e tij të vërtetë, njeriut ia fal vetëm devotshmëria dhe modestia ndaj Allahut të Madhëruar. Në një hadith fisnik thuhet:

“Allahu e lartëson atë që tregohet modest dhe i përlur për hir të Tij.” (Muslim, Birr, 69.)

Sot, edhe bota Islame është larg dinjiteti dhe nderit Islam, e rënë në një gjendje të ulët e të përçmuar. Në vend të besimtarëve që e duan krijesën për hir të Krijuesit, tolerantë, modest, durimtarë dhe fjalëmbël, po ndërtohet një lloj njeriu i ashpër, i ngurtë, ftohës, largues, arro-

Arkitekt Sinani ishte njeri shumë modest. Kur përfundoi ndërtimin e Xhamisë Selimije, atij iu propozua që t'ia shënonin emrin në epigraf. Mirëpo, ai e refuzoi këtë nder duke thënë: “E kush jam unë që të shënoj emrin tim në shtëpinë e Allahut!”



gant dhe prej të cilit nuk ndjehen të sigurt myslimanët e tjerë. Dihet se ky lloj njeriu po përgatitet në mënyrë të veçantë prej disa shekujsh nën mbikëqyrjen e perëndimit.

Megjithatë, mënyra për ta arritur përsëri nderin dhe dinjitetin Islam, është pasimi i moralit madhështor të Profetit tonë ﷺ dhe vënia e tij në jetë. Pasqyrimi i ëmbëlsisë së Islamit dhe përjetimi i vëllazërisë që e gërsheton fenë tonë me mëshirën dhe modestinë dhe që ndan e solidarizohet me bujari, është detyra e çdo myslimani.

I lutemi Allahut të Madhëruar të na japë të gjithëve sukses në këtë detyrë, të mos na lërë asnjë çast në dorë të vetes sonë dhe të na bëjë prej robërve të sinqertë e modestë. Allahu na bëftë ne dhe pasardhësit tanë robër të devotshëm e të përlulur ndaj Tij, një ummet pasues i Profetit ﷺ dhe myslimanë modestë dhe të mëshirshëm ndaj besimtarëve!

Amin!..



*Kur Kalifi Omer رضي الله عنه,
po vraponte pas një
deveje që kishte ikur
nga tufat e shtetit,
i thanë: "A nuk bën
të urdhërosh një rob
për të kapur devenë?"
Omer رضي الله عنه, u përgjigj: "A
ka rob më të mirë se
sa unë?"*



BESNIKËRIA

Para së gjithash, njeriu duhet të jetë besnik ndaj Zotit të tij, gjë që bëhet e mundur vetëm duke i respektuar urdhrat e Tij.

Pika më e rëndësishme e besnikërisë, është respektimi i fjalës që kemi dhënë në botën e shpirtave, kur Allahu na krijoi dhe na tha:

“A nuk jam Unë Zoti juaj?”, e ne u përgjigjëm:

“Po, dëshmojmë se Ti je!” (Araf, 172.)



BESNIKËRIA

PËRKRYEJA E BESIMIT ARRIHET ME MORAL

Një nga qëllimet më të mëdha të fesë sonë madhështore, është zbukurimi me moral të bukur i botës së brendshme dhe të jashtme të besimtarëve.

Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Më i miri prej besimtarëve nga aspekti i besimit është ai që ka moralin më të lartë.” (Ahmed, II, 250.)

Përkryerja e besimit arrihet me moral të bukur...

Lidhur me moralin e Profetit tonë ﷺ, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“(Pa dyshim) se ti ke moral madhështor!” (Kalem, 4.)

Surja në të cilën ndodhet ky ajet, është zbritur në vitin e tretë të profetësisë.

Për rrjedhojë;

Kur morali i Profetit tonë ﷺ, u vërtetua dhe u lavdërua nga Vetë Allahu i Madhëruar, prej Kuranit Fisnik ishte zbrit-

ur vetëm një pjesë e vogël. Pra, morali i tij ishte i përsosur dhe madhështor edhe para profetësisë dhe shpalljes së Kuranit, sepse atë e kishte edukuar Vetë Allahu i Madhëruar. Kur zbri-ti Kurani, morali i tij i përfshiu të gjithë dhe ai u bë mëshirë për botët.

Kurani Fisnik u gdhend në zemrën e tij. Kështu, morali i tij madhështor arriti kulmin e çdo morali njerëzor. Allahu i Madhëruar betohet vetëm në jetën e tij duke thënë: «لَعَمْرُكَ» për jetën tënde!» (shih. Hixhr, 72.)

Mbi këtë moral madhështor u ndërtuan edhe parimet e besimit, adhurimit, veprave dhe gjykimeve. Një nga elementët më të rëndësishëm dhe më gjithëpërfshirës të moralit të bukur, është edhe besnikëria.

BESNIKËRIA: NJË VIRTYT I LARTË

Si një cilësi e profetëve, miqve të Allahut dhe njerëzve të virtytshëm, besnikëria është një virtyt shpirtëror që e kurorëzon jetën njerëzore në nivelin më të lartë. Kjo ndjenjë e lartë, është një kriter i vlerës që i jepet atyre që njerëzit i duan. Ata që nuk e posedojnë ndjenjën e besnikërisë, janë njerëz egoistë që mendojnë vetëm veten, kënaqësinë dhe interesin vetjak.

Ndër të tjera, besnikëri do të thotë edhe të mbash fjalën dhe të çosh në vend zotimet. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Dhe përmbushni zotimet (mbajeni fjalën e dhënë). Me të vërtetë ju do të jeni përgjegjës për zotimet.” (Isra, 34.)

Cilësia dalluese e miqësisë është besnikëria. Allahu i Madhëruar, mikut të Vet i fal mirësi të pafundme në të dyja botët.



“(Ata) të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve që kanë.” (Mu’minun, 8.)

Për shkak se besnikëria është një nga virtytet më të larta, me këtë cilësi i lavdëron edhe Allahu i Madhëruar të dërguarit e Vet. Për shembull, Ibrahimin عليه السلام, e ka lavdëruar me fjalët:

“Ibrahimi, i cili i qëndroi fjalës.” (Nexhm, 37.)

CILËSIA DALLUESE E MIQËSISË

Ibrahimi عليه السلام, kaloi sprovat e pasurisë, jetës dhe fëmijëve dhe arriti të gëzojë gradën “Halilullah / Mik i Allahut”. Në luftën e monoteizmit, ai theu idhujt e popullit të vet, duke ua provuar se sa të dobët ishin idhujt e tyre. Për pasojë, u vendos që ai të ndëshkohej duke u hedhur në zjarr. Madje, ai e refuzoi edhe ndihmën e melekëve të Allahut, duke pranuar kështu të hidhet në zjarr me një dorëzim të plotë. Për rrjedhojë, me urdhrin e Allahut të Madhëruar, Mikut të tij, zjarri u kthye në bahçe.

Allahu i Madhëruar i kishte dhuruar Ibrahimit عليه السلام, pasuri dhe tufa të mëdha bagëtish. Xhibrili عليه السلام, i vajti në formë njeriu dhe i kërkoi diçka prej tyre. Ndërsa Ibrahim عليه السلام, ia fali të gjitha vetëm me kusht që të përmendte tri herë Zotin. Kur Xhibrili عليه السلام, ia prezantoi veten, miku i Allahut, Ibrahim عليه السلام, nuk hoqi dorë prej marrëveshjes dhe të gjithë pasurinë e fali në rrugë të Allahut.

Një herë tjetër, ai pa në ëndërr sikur po flijonte të birin. Kur ëndrra u përsërit tri herë, ai u bind se ky ishte një urdhër hy-



Në udhëtimin drejt botës tjetër, pra në frymën e fundit, në varr, në ringjallje, në llogari, në urën e siratit dhe stacione të tjera, Allahu u dërgon melekët e Vet miqve të Tij dhe i merr nën mbrojtje.
Në Kuranin Fisnik urdhërohet: “Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.”
(Junus, 62.)

jnor. Po ashtu, edhe djali tij, Ismaili ﷺ, iu dorëzua vullnetit hyjnor për t'u flijuar. Mirëpo, në saje të mëshirës së Allahut, thika nuk preu...

Kështu, duke kaluar me sukses prej këtyre tri sprovave të vështira, Ibrahim ﷺ, gëzoi gradën "Halilullah".

Ndër shpërblimet që Ibrahim ﷺ, mori nga Allahu i Madhëruar, ishin:

- Profeti i fundit, Muhamedi ﷺ, erdhi prej gjakut të tij.
- Bajrami i Kurbanit u bë kujtim i bukur i dorëzimit të tyre për të gjithë besimtarët deri në kiamet.
- Përkujtimi i Ibrahimit ﷺ, me salavatet në fund të çdo namazi të umetit të Muhamedit ﷺ, deri në ditën e fundit.

Cilësia dalluese e miqësisë është besnikëria.

Allahu i Madhëruar, mikut të Vet i fal mirësi të pafundme në të dyja botët. Në mënyrë të veçantë, në udhëtimin drejt botës tjetër; në frymën e fundit, në varr, në ringjallje, në llogari, në urën e siratit dhe stacione të tjera, Allahu u dërgon atyre melekët e Tij dhe i merr nën mbrojtje. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar.” (Junus, 62.)

Kushti dhe treguesi i miqësisë me Allahun, është që robi t'ia kushtojë Atij gjithë qenien e vet. Atyre që ia kushtojnë jetën,

Në Kuranin Fisnik urdhërohet: “Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht Allahut një hua të mirë, që Ai pastaj t'ia kthejë shumëfish?! Veç kësaj, për atë do të ketë shpërblim fisnik.”

(Hadid, 11.)



pasurinë dhe fëmijët rrugës së Allahut, Zoti ua pranon këto si: «فَرَصًا حَسَنًا»: borxh i mirë” dhe në botën tjetër ua shpërblen shumëfish. E kush mund të jetë më Besnik dhe më Bujar se Allahu i Madhëruar?

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kush është ai, që do t’i japë vullnetarisht Allahut një hua të mirë, që Ai pastaj t’ia kthejë shumëfish?! Veç kësaj, për atë do të ketë shpërblim fisnik.” (Hadid, 11.)

Një tjetër përfaqësues i sakrificave në rrugën e Allahut, është adhurimi i kurbanit. Në saje të këtij adhurimi, edhe pse vetëm njëherë në vit, ne kemi mundësinë të gostitim të varfrit dhe nevojtarët e lagjes, qytetit, vendi dhe botës sonë. Në të këtij adhurimi, na jepet mundësia e realizimit të detyrave ndaj vëllezërve tanë besimtarë dhe e përjetimit të një bajrami të vërtetë.

Allahu na i pranofte të gjitha adhurimet e kurbanet dhe i bëftë ato shkaqe të afrimit me Të! Mirëpo, që adhurimet tona të pranohen, është kusht që të plotësohet siç duhet edhe aspekti shpirtëror.

KURBANI: BESNIKËRIA MË E BUKUR

Mevlana thotë:

“Mos bëj kurban hijen e dhisë!..”

Domethënë; Bajrami i Kurbanit nuk duhet të konsiderohet thjesht si festë “e mishit dhe qebapit”. Nuk duhet harruar se;

Atyre që ia kushtojnë jetën, pasurinë dhe fëmijët rrugës së Allahut, Zoti ua pranon këto si: «فَرَصًا حَسَنًا»: borxh i mirë» dhe në botën tjetër ua shpërblen shumëfish. E kush mund të jetë më Besnik dhe më Bujar se Allahu i Madhëruar?



e rëndësishme tek kurbanit, nuk është as mishi, as gjaku, por devotshmëria. Kafshët e kurbanit duhen trajtuar me mëshirë, sepse ky është adhurim që duhet bërë me dashuri dhe respekt ndaj Allahut dhe krijesave të Tij.

Bajrami i Kurbanit, është njëkohësisht edhe koha e kryerjes së adhurimit të haxhit. Ky adhurim i mbushur me kujtimet e Ibrahimit عليه السلام, gruas së tij Haxherit dhe djalit të tij Ismailit عليه السلام, është edhe adhurimi i fundit i urdhëruar. Pra, haxhi kërkon një besimtar të përkryer në kuptimin e plotë të fjalës. Nëse meditojmë pak, do të shohim se adhurimi i haxhit na mëson këto urtësi:

- Të veshim ihramin me vetëdijen se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër.
- Të jemi delikat dhe të kujdesshëm, aq sa të mos e këpusim qoftë edhe një fije bari.

- Të qëndrojmë larg sjelljeve dhe fjalëve të këqija, debatit dhe gjynaheve.

- Të gurëzojmë shejtanin, jo vetëm në Mina, në mënyrë simbolike, por duke thënë shpesh “eudhu billahi min’esh-shetjani’r-rraxhim, bismil-lahi’r-Rrahmani’r-Rrahim” dhe duke bërë vepra të mira.

Shejtani e sulmon njeriun pa pushim dhe përpiqet të bëhet ortak i tij në fëmijë dhe pasuri. Ai ruan momentet më të volitshme dhe sapo gjen çastin kur njeriu është i dobët, e nxit atë në dyshime dhe punë të këqija. Prandaj, është e nevojshme që shejtani të gurëzohet në çdo çast të jetës dhe të kërkohet ndihma e Allahut

*Kushti dhe
treguesi i miqësisë
me Allahun,
është që robi
t’ia kushtojë Atij
gjithë qenien e
vet.*



prej së keqes së tij, sepse ai është shumë mosmirënjohës dhe i pabesë ndaj Zotit...

Pabesia është një gjynah shumë i rëndë. Ndërsa besnikëria është një shpërblim i pafund. Në një ajet të Kuranit Fisnik urdhërohet:

“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre! Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj Allahut, Ai do t’i japë atij shpërblim të madh.” (Fet’h, 10.)

Besnikëri, është përpjekja jonë për tu përgjigjur me dashuri dhe sakrificë ndaj atyre që kanë të drejta mbi ne.

TË DREJTAT MBI NE

Jeta e njeriut vazhdon me njëmijenjë borxhe në formë të drejtash, të cilat fillojnë pa ardhur ende në jetë, e vazhdojnë edhe pas vdekjes. Për shembull, nëna e mban atë nëntë muaj në bark, duke vuajtur dhimbjet dhe vështirësitë e barrës dhe lindjes. Prandaj, ai fëmijë, duhet të ndjejë mirënjohje ndaj nënës së tij dhe të jetojë me ndjenjën e falënderimit. Kjo është një nga të drejtat që ka nëna mbi fëmijën. Por, mbi njeriun nuk rëndojnë vetëm të drejtat e nënës. Atij i mblidhen edhe shumë e shumë të drejta prej njerëzve të tjerë, si babai, vëllezërit, të afërmit, mësuesit, fqinjët, vartësit, punëdhënësit, klientët etj.

Madje, edhe kur vdes, njeriut i mblidhen shumë të drejta njerëzore, duke filluar prej atij që ia lan trupin, e qefinos, i bart tabutin, e varros, etj.

Kur u pyet se pse bënte adhurime gjatë gjithë natës ndërkohë që i ishin falur të gjitha gjynahet e kaluara dhe të ardhme, Profeti ynë ﷺ, u përgjigj: “A të mos jem një rob falënderues?” (shih. Ibni Hibban, II, 386.)



Pra;

Prej djepit deri në varr, neve na mblidhen me mijëra të drejta njerëzore. Prandaj, besnikëria dhe mirënjohja ndaj këtyre, është një borxh njerëzor.

Por, e drejta më e madhe që rëndon mbi supet tona, është ajo e Allahut të Madhëruar.

BESNIKËRIA NDAJ ALLAHUT TË MADHËRUAR

Para së gjithash, njeriu duhet të jetë besnik ndaj Zotit të tij, gjë që bëhet e mundur vetëm duke i respektuar urdhrat e Tij.

Pika më e rëndësishme e besnikërisë, është respektimi i fjalës që kemi dhënë në botën e shpirtave, kur Allahu na krijoi dhe na tha:

“A nuk jam Unë Zoti juaj?”, e ne u përgjigjëm:

“Po, dëshmojmë se Ti je!” (Araf, 172.)

Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Mos u bëni si ata që harruan Allahun dhe Allahu bëri që ata të harrojnë vetveten! Të tillët janë njerëz të devijuar.” (Hashr, 19.)

Të mos e harrosh Allahun, do të thotë ta përmendësh Atë dhe t’i përgjerohesh Atij përherë, të jesh i vetëdijsëm që ndodhesh nën vëzhgimin e pandërprerë të kamerave hyjnore dhe të jetosh me ndjenjën e mirënjohjes dhe falënderimit ndaj Tij për gjithçka që të ka falur.

Shejtani ta gurëzojmë, por jo vetëm në Mina, në mënyrë simbolike, por duke thënë sa më shpesh “eudhu billahi mine’sh-shetjani’r-raxhim, bismil-lahi’r-Rahmani’r-Rrahim” dhe duke bërë vepra të mira.



Shfaqjet më të bukura të besnikërisë ndaj Allahut, i gjejmë në jetën e të Dërguarit të Tij ﷺ. Kur u pyet se pse bënte adhurime gjatë gjithë natës ndërkohë që i ishin falur të gjitha gjynahet e kaluara dhe të ardhme, ai u përgjigj:

“A të mos jem një rob falënderues?”
(shih. Ibni Hibban, II, 386.)

Pas besnikërisë ndaj Allahut, borxhi ynë më i madh, është ndaj të Dërguarit të Tij ﷺ.


Ai ﷺ, që;

Iu lut e iu përgjërua gjithmonë Allahut për popullin e vet, duke thënë; “Ummeti!.. Ummeti!..”. Ashtu siç i kaloi tërë jeta në vuajtje për umetin e vet, Profeti ynë ﷺ, do të vazhdojë të lutet për të deri kur t’i fryhet Surit në ditën e kiametit.

Prandaj, besnikëria ndaj Profetit ﷺ, e cila do të fillojë duke u thelluar në dashurinë ndaj tij ﷺ, është e mundur me zbatimin e Sunetit profetik. Besnikëria ndaj tij tregohet duke e kujtuar vazhdimisht me salavate dhe selame, duke pasuar traditën e tij dhe duke u larguar nga çdo sjellje, veprim apo fjalë që atij nuk do t’i pëlqente. Duhet të mos harrojmë se në hutben e lamtumirës, Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

Në kohën tonë, janë shfaqur njerëz që kanë treguar pabesi të madhe ndaj Profetit tonë ﷺ, duke tentuar të përçmojnë ha-



dithet e tij, me qëllim që të nxjerrin sunetin e tij nga të qenit argument në gjykimet fetare.

Për fat të keq, shekujt e fundit, mendimet e dëmshme dhe të helmatisura që janë prodhim i përpjekjeve të veçanta të misionarëve dhe orientalistëve të cilët ushqejnë armiqësi ndaj Islamit, janë përhapur në botën Islame si shkëndija zjarri që e bëjnë pluhur e hi besimin.

Në vitet kur kemi qenë ende në shkollë, hapi i parë i këtyre helmeve të huaja, filloi duke tentuar të refuzojnë dhe rrënojnë medhhebet.

Mirëpo, medhhebet janë tërësia e mendimeve dhe gjykimëve të dijetarëve tanë kompetentë, të cilat janë nxjerrë nga Kurani dhe hadithet profetike. Për shekuj me radhë, umeti Islam ka rënë dakord në ndjekjen e katër medhhebeve ndër shumë të tjerë. Në fakt, kushdo që refuzon medhhebet, në njëfarë mënyre tenton të themelojë medhhebin e vet. Në këtë

mënyrë, mund të lindin botëkuptime fetare për çdo individ. Për rrjedhojë, janë shfaqur shumë hoxhallarë me dije të mangëta, të cilët hedhin mendimet e tyre në çështje të ndryshme fetare duke thënë, “për mendimin tim”.

Pasi u hap shtegu i refuzimit të medhhebeve, dëmi u zgjerua edhe më shumë dhe, si hap i dytë, u vu në shënjestër suneti profetik. Në këtë mënyrë, filloi të shfaqej një sëmundje zemre, e cila refuzon fjalët e bekuara të Profetit tonë ﷺ, duke pretenduar se shumica e hadithëve janë të shpikur, ose duke thënë, “na mjafton Kurani”.

*Shteti Osman,
ishte një shtet ku të
gjithë besimtarët,
nga sulltani e deri
tek individit më i
thjeshtë, shquheshin
nga dashuria për
Profetin ﷺ.*



Sa pabesi e madhe!

Mirëpo, Allahu i Madhëruar, ka deklaruar qartë se bindja ndaj Profetit ﷺ, konsiderohet si bindje ndaj Vetë Atij:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

Ndërsa në shumë ajete të tjera, menjëherë pas bindjes ndaj Allahut, është përmendur bindja ndaj Profetit ﷺ:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ
وَلَا تُبْطِلُوا أَعْمَالَكُمْ

“O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!” (Muhammed, 33)

Ndërsa hapi i tretë i shkatërrimit të fesë, është tentimi për t'i bërë ajetet e Kuranit të pavlefshme, duke i etiketuar si “historike”. Kjo nënkupton pensionimin e gjykimeve të Kuranit, të cilat bien ndesh me mendimin e prishur filozofik të stilit të jetesës perëndimore.

Mirëpo, Islami nuk është një fe që ka ardhur vetëm për një popull apo vetëm për një periudhë të caktuar. Islami është feja e vërtetë që i është dërguar tërë njerëzimit deri në kiamet.

Të gjitha këto devijime, janë fitne të fundkohës.

I Dërguari i Allahut ﷺ, në Hutben e Lamtumirës na ka porositur me këto fjalë:

“Po ju lë (amanet) dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni. Ato janë:



Nuk ka as edhe një sulltan osman që kur i vinte posta nga Medina, ta ketë lexuar pa marrë më parë abdest, pa e puthur dhe pa u ngritur në këmbë.

- *Libri i Allahut, Kurani Fisnik*

- *Dhe Suneti i të Dërguarit të Tij...*” (Shih. Muvatta, Kader, 3.)

Rruga e drejtë, është ajo që shkon drejt Allahut të Madhëruar. Ndërsa udhëzuesi i asaj rruge është i Dërguari i Tij ﷺ. Prandaj, pabesia ndaj të Dërguarit të Allahut, është pabesia më e madhe.

Ne ndjejmë nevojën të falënderojmë qoftë edhe dikë që na jep një gotë ujë. E në fakt, ka shumë heronj me emër e paemër që bëhen shkak i mirësive që zotërojmë sot, ndaj të cilëve duhet të ndjejmë mirënjohje dhe besnikëri.

Për rrjedhojë;

Çdo besimtar duhet të jetë i mbushur me ndjenja mirënjohjeje dhe besnikërie ndaj të mëdhenjve të fesë, dijetarëve dhe miqve të Allahut, sepse ata na kanë përcjellë me sakrificë dhe besnikëri urdhrat dhe ndalesat hyjnore, hadithet dhe moralin profetik.

Jeta e Profetit tonë ﷺ, është e mbushur me shfaqje të pashoqe të besnikërisë:

Në moshën gjashtëvjeçare, Muhamedi i vogël ﷺ, shkoi në Medinë bashkë me nënën e tij, që të vizitonte varrin e babait. Gjatë rrugës së kthimit, në fshatin Eba, nëna e tij ndërroi jetë. Kështu, duke ngelur jetim edhe nga nëna, Muhamedi i vogël ﷺ, u kthye në Mekë me dadon e vet, Ummu Ejmenen (r.anha).

Më vonë, gjatë gjithë jetës së vet, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka vizituar shpesh dadon e tij Ummu Ejmenen (r.a),

*Kur Osman Gazi
nxori monedhën e
parë, mbi të kishte
shkruar emrin e
nderuar të Profetit
tonë ﷺ.*



të cilën e quante “Nënë!”. Madje, ai e përmendte shpesh atë duke thënë: “Nëna pas nënës sime! Ajo është i vetmi njeri që ka mbetur gjallë nga familja ime!” Në këtë mënyrë, Profeti ﷺ, shfaqte respektin dhe dashurinë që kishte për të. (Shih. Ibn Esir, Us-du'l-Gabe, VII, 304-305; Ibn Sa'd, VIII, 223.)

BESNIKËRIA NDAJ TË AFËRMVE NGA NËNA E QUMËSHTIT

Në luftën e Hunejnit që korrur një fitore e madhe dhe, përveç plaçkës së luftës, ishin zënë edhe shumë robër. Ndërkohë, Profeti ﷺ, u njoftua se në mes të robërve ishte edhe motra e tij e qumështit, Shejma. Për këtë arsye, ai dha urdhër që t’ia sillnin menjëherë aty. Kur ajo erdhi, ai nxori rrobën e tij dhe e shtroi përdhe që ajo të ulej. Ai tregoi besnikëri të madhe ndaj motrës së qumështit, me të cilën ishte rritur në shkretëtirë. Ai u soll me butësi ndaj saj dhe i tha:

“Mirë se erdhe!”

Aty kujtuan ditët e kaluara dhe iu mbushën sytë me lot. Më pas, Profeti ﷺ, e pyeti për nënën dhe babanë e saj. Ndërsa Shejma i tha se ata kishin ndërruar jetë. I Dërguari i Allahut e pyeti edhe për të afërmit e tjerë, e pastaj tha:

“Nëse dëshiron, qëndro tek unë me dashuri dhe respekt! E nëse jo, të jap mall dhe të dërgoj te fisi yt! Për ty e bëj edhe këtë!” Shejma tha:

Një nga punët e para që Sulltan Mehmed Fatihu realizoi pas çlirimit të Stambollit, ishte gjetja e varrit të humbur të sahabit Ebu Ejub el-Ensarit (r.a.), me ndihmën e mësuesit të tij Akshemsedinit, dhe ndërtimi i një xhamie pranë tij.



“Më jep mall dhe më dërgo te njerëzit e mi!”

Pas kësaj, ajo pranoi Islamin dhe u bë myslimane. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, i dha Shejmës dhe pjesëtarëve të familjes së saj që ishin gjallë, deve dhe bagëti të tjera. Po ashtu, Shejmës i dha edhe një rob dhe një robinë, të cilët Shejma i martoi me njëri-tjetrin. (Ibn Hisham, IV, 101; Vakidi, III, 913.)

Pas njëfarë kohe, Profeti ynë i nderuar ﷺ, lajmëroi se u kishte falur lirinë robërve që ishin prej të afërmve të tij të qumështit, të cilët u kishin rënë për pjesë e atij dhe bijve të Abdulmutalibit. Ndërsa sahabëve u tha:


“Kush prej jush kënaqet duke i gëzuar vëllezërit e tij, duke i liruuar robërit pa shpërblim dhe me dëshirë, le të veprojë kështu! Kush nuk dëshiron t’i japë pa shpërblim robërit që i kanë rënë në pjesë, ne do t’ua paguajmë nga ganimeti i parë që do të na e japë Allahu. Ai që do, mund të veprojë edhe kështu!”

Kështu, duke shfaqur një shembull të madh virtyti, sahabët e nderuar thanë:

“Edhe ne ia kemi dhuruar robërit tanë Profetit të Allahut!” (Buhari, Megazi, 54; Ibn Hisham, IV, 134-135.)

Kështu, atë ditë Hevazinit iu kthyen me mijëra robër luftime pa kërkuar asnjë shpërblim. Për shkak të ndjenjës së besnikërisë që kishte i Dërguari i Allahut ﷺ, me mijëra njerëz u udhëzuan, fituan besimin dhe lirinë.

Falë këtij qëndrimi të Profetit ﷺ, edhe sahabët e nderuar e mësuan besnikërinë dhe njerëzillëkun.



Një nga personalitetet që Profeti ﷺ, nuk e harroi kurrë dhe tregoi gjithmonë respekt dhe besnikëri për të, ishte edhe bashkëshortja e tij e parë, nëna e besimtarëve, Hadixhja (r.anha).

BESNIKËRI E PASHOQE

Nëna jonë Aisha (r.anha), e tregon kështu besnikërinë që kishte Profeti ynë ﷺ, ndaj nënës sonë Hadixhes (r.anha):

“Për asnjërin nga gratë e Profetit tonë të nderuar nuk kam qenë xheloze sa kam qenë për Hadixhen. Për më tepër, atë nuk e kisha parë fare. I Dërguari i Allahut ﷺ, e kujtonte shpesh atë. Kur priste një dele dhe shpërndante mishin e saj, në përgjithësi u dërgonte edhe miqve të Hadixhes. Nganjëherë, nuk rezistojta dot dhe i thosha të Dërguarit të Allahut:

“Sikur në këtë botë nuk ka grua tjetër përveç Hadixhes!”

Mirëpo, Profeti ﷺ, i numëronte veçoritë e saj dhe thoshte:


“Ajo ishte kështu, kështu...” dhe “Fëmijët e mi janë nga ajo.”

(Buhari, Menakibu'l-Ensar, 20; Muslim, Fedailu's-Sahabe, 74-76.)

Megjithatë, besnikëria dhe mirënjohja e Profetit tonë ﷺ, nuk ishte vetëm ndaj të afërmve dhe miqve, por edhe ndaj të gjithë sahabëve dhe popullit të vet.

BESNIKËRIA NDAJ ENSARËVE

I Dërguari i Allahut ﷺ, e çliroi Mekën tetë vjet pasi ishte detyruar të emigronte prej aty, ku edhe qëndroi për pesë-



mbëdhjetë ditë. Kjo bëri që disa nga ensarët të shqetësoheshin se; vallë a do të kthehej përsëri Profeti ﷺ, në Medinë, apo jo!?

Allahu Teala i kishte dhënë çlirimin e vendit të begatë dhe të shenjtë në të cilin ai ishte lindur dhe rritur. Kur ishte duke u lutur në kodrën Safa, Profeti ﷺ, e ndjeu shqetësimin e ensarëve të nderuar dhe, pasi mbaroi lutjen, shkoi te ata dhe i pyeti:

“Për çfarë po flisni?”

Sapo ata ia shprehën shqetësimin e tyre, i Dërguari i Allahut ﷺ, shfaqti një shembull të madh besnikërie, duke u thënë:

“O ensarë! Strehohem tek Allahu nga veprimi i diçkaje të tillë!.. Unë jam shpërngulur në vendin tuaj, jeta ime është jeta juaj dhe vdekja ime do të jetë pranë jush!”



Osmanët e kanë konsideruar si jo të hijshme ta linin qytetin e Profetit tonë ﷺ, në dorën e një guvernatori të thjeshtë. Prandaj, qeveritarin që kanë caktuar në Medinë, nuk e kanë quajtur “Vali”, por “Kujdestari i Medinës”.

Pas këtyre fjalëve, ensarët u qetësuan.

(Muslim, Xhihad, 84, 86; Ahmed, II, 538.)

Kështu, Profeti ﷺ, nuk i la të hidhëruar medinasit, të cilët e mbështetën me gjithë zemër atë dhe muhaxhirët e tjerë. Sa besnikëri e pashoqe!..

BESNIKËRIA NDAJ UMETIT

Përfshirja e ndjenjës së besnikërisë, duhet të jetë e gjerë ashtu si zemra e besimtarit. Në mënyrë të veçantë, është e domosdoshme që në zemër të zërë vend besnikëria ndaj miqve dhe vëllezërve të fesë.

Në zemrën e gjerë të Profetit tonë ﷺ, kishte besnikëri dhe mirënjohje të madhe edhe ndaj sahabëve. Për shembull, në Xhaminë e Profetit ﷺ, ishte një besimtar zezak që shërbente në pastrimin e xhamisë. Mirëpo një ditë, Profeti ynë ﷺ, nuk e pa dhe u bë merak për të. Ai pyeti shokët se ku ndodhej dhe ata i thanë se kishte ndërruar jetë. Për këtë arsye, Profeti ynë ﷺ, i cili ishte një monument besnikërie, tha:

“A nuk duhej të më kishit lajmëruar? Më tregoni varrin e tij!”


Pastaj, shkoi te varri i tij, i fali namazin e xhenazes dhe u lut për të. (Buhari, Xhenaz, 67)

Po ashtu, edhe besnikëria ndaj të parëve, të vdekurve dhe të gjallëve tanë, ndaj atdheut dhe të gjitha amaneteve të popullit, është prej cilësive të një karakteri dhe personaliteti të fortë. Pra, besnikëria është virtyt i besimtarit. Ndërsa pabesia është ves i hipokritit.

Ja disa shembuj të mirënjohjes dhe besnikërisë ndaj nënës:
Abdurrahman Xhami ka thënë:

“E si mos e dua nënën; ajo për një kohë më ka mbajtur në trupin e saj, pastaj për një kohë të gjatë më ka mbajtur në prehër dhe, derisa vdiq më mbajti në cepin e mëshirës së zemrës së saj. A mund të ketë ndonjë gjë më të keqe sesa të mos e respektosh atë?!..”

Babai dhe mësuesi ynë Musa Efendi (Allahu e mëshiroftë), ndër të dashurit e tij njihej si “Sahibu’l-Vefa”. Disa nga ndjen-



Me mendimin se do të ishte mungesë respekti ndaj vendit të Profetit ﷺ, prej kohës së Sulltan Javuz Selimit, e deri në kohën e Sulltan Abdulazizit, nuk janë vendosur flamurë në as Meke, e as në Medine.

jat e pafundme të besnikërisë së Musa Efendisë, po jua përcjellim edhe juve:

Ai prekej shumë kur shihte njerëz të vetmuar dhe të moshuar, të braktisur në mënyrë të pabesë nga shoqëria, ballë për ballë me vuajtjet e tyre, dhe thoshte:

“Këta të vetmuar duhet t’i marrim në shtëpinë tonë, por ne nuk kemi mundësi për këtë. Atëherë duhet të ndërtojmë një strehë për ta.”

Kështu, bashkë me disa të afërm të vet, ai arriti të realizonte këtë mendim të bukur.

Herë-herë, ai i vizitonte të vetmuarit dhe interesohej nga afër për nevojat e tyre. Zemra e tij shtrihej deri tek macet në kopsht. Ai i trajtonte me mëshirë dhe i emërtonte sipas cilësive të tyre.

Pas pesëdhjetë e pesë vjetësh, ai e kishte kërkuar personalisht një infermiere që më ka shërbyer mua kur kam qenë ende në djep. Kur e kishte gjetur, e kishte nderuar me tëra të mirat.

*Mevlana ka thënë:
“Të gjitha çështjet, si
dashuria dhe miqësia,
janë të lidhura me
besnikërinë dhe kërkojnë
gjithmonë njerëz
besnikë. Këto nuk i
afrohen kurrë një
zemre jo besnike.”*



Veçanërisht besnikëria që kishte për mësuesin e tij Sami Efendiun, ishte bërë legjendë. Vendi i parë që vizitonte në ditët e festave, ishte shtëpia e Sami Efendiut. Edhe kurbanët e parë i priste për të. Ishte kryesisht ai, i cili bëhej shkak që shpirtit të tij t’i lexoheshin hatme. Po ashtu, hatmet që lexoheshin çdo vit për profesorin e tij, nga ana e atyre që e donin, ia gëzonin shumë zemrën e tij besnike.

Një prej emrave të bukur të Allahut të Madhëruar, është edhe, “esh-Shekur”, që tregon se Allahu i Madhëruar, i shpërblen

shumëfish robërit e Vet, edhe për një ve-
për të vogël dhe nuk i lë kurrë pa shpër-
blim. Mirësitë që Allahu u ka premtu-
ar robërve të Vet, janë mijëra herë më të
mëdha se veprat që bëjnë ata, sepse Ai
është më Bujari i bujarëve.

Kështu, edhe ne besimtarët duhet të
frymëzohemi nga këto cilësi të bukura
hyjnore dhe të jemi besnikë si Profeti ﷺ
dhe robërit e devotshëm të Allahut. Në
botën tjetër nuk duhet të shkojmë me të
drejtat e të tjerëve mbi supe, por me lutjet
e tyre të mira.

Le t'i lutemi Allahut të Madhëruar me
këtë dua që bëhet gjatë tavafit:

**O Zot! Ka shumë të drejta mes Teje dhe meje që më du-
het t'u jap hakun. Po kështu edhe mes meje dhe robërve të
Tu.**

**O Allah! Falmi të drejtat e Tua që rëndojnë mbi mua.
Ndërsa barrën e të drejtave të krijesave të Tua hiqe prej meje
me mëshirën Tënde!**

Amin!..



*Mevlana ka thënë:
"O bylbyl! A është
me vend të flasësh
pareshtur për vuajtjet?
Nëse shpirti yt është
vërtetë i lidhur me të
dashurin, atëherë hapi
sytë dhe falëndero,
fol për besnikërinë!
Lëre gjembin, fol për
trëndafilin!.."*





PËRHAPJA E DREJTËSISË DHE SË VËRTETËS

Edhe pse ditët e fundi të jetës ishte shumë i pafuqishëm, Profeti ynë ﷺ, doli prej shtëpisë dhe shkoi në xhami ku iu drejtua sahabëve me këto fjalë:

“O shokët mi! Nëse kam marrë pa dashje prej pasurisë së ndonjërit prej jush, ja ku është pasuria ime, le të vijë ta marrë!.. Nëse e kam goditur dikë në shpinë padrejtësisht, ja ku është shpina ime; të vijë të më godasë!..”

(shih. Ahmed, III, 400.)



PËRHPARJA E DREJTËSISË DHE SË VËRTETËS

LAJMI I MADH

Feja e vërtetë tek Allahu, është Islami.

Me zbritjen e mesazhit të fundit hyjnor, Kuranin Fisnik dhe dërgimin e profetit të fundit, Muhamedin ﷺ, Islami e nxori njerëzimin nga errësirat e injorancës, në dritën e udhëzimit; e shpëtoi nga kthetrat e dhunës dhe egërsisë dhe e futi në gjirin e mëshirshëm të drejtësisë.

Cilësia më e spikatur e shoqërisë së injorancës, është harresa ose mospranimi i botës tjetër. Pra, i jetës së vërtetë pas vdekjes. Sipas njerëzve të asaj periudhe, jeta e kësaj bote është vetëm një vend argëtimi dhe gare për sa më shumë pasuri dhe fëmijë, dhe s'ka asnjë qëllim e urtësi tjetër.

Për shkak se nuk i besonin botës tjetër, njerëzit e asaj periudhe nuk mendonin se do të jepnin llogari për veprat e tyre.

Ata, as që e imagjinonin se një ditë do të nxirreshin para një Gjykate Supreme për të gjitha të drejtat që kanë shkelur. Po ashtu, as që ia kishin idenë se do të përballeshin me peshoren hyjnore, që do të përcaktonte nëse veprat e tyre ishin të mira apo të këqija. Për rrjedhojë, ata e çonin jetën dëm mes humbjes, mizorisë dhe padrejtësive, duke jetuar mbi tokë si kafshët, e madje edhe më të ulët se ato.

Për këtë shkak, edhe përmbajtja e ajeteve të para që iu zbritën Profetit tonë ﷺ, gdhendën në mendjet e njerëzve çështjen e kiametit dhe botës tjetër.

Ndër urdhrat e parë të predikimit të fesë që i erdhën Profetit tonë ﷺ, ishte: «أَنْذِرُوا: Paralajmëro!..» Për këtë arsye, Profeti ynë ﷺ, iu drejtua vajzës së vet, të afërmve dhe bashkëqytetarëve të tij me këto fjalë:

“O benu Abdushems! O benu Kab ibn Luej! Ruajeni veten nga zjarri i xhehenemit!

O benu Abdumenafl! Ruajeni veten nga zjarri i xhehenemit!

O benu Hashim! Ruajeni veten nga zjarri i xhehenemit!

O benu Abdulmutalib! Ruajeni veten nga zjarri i xhehenemit!

Oj Fatime! Ruaje veten nga zjarri i xhehenemit! Unë nuk kam fuqi t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut. Por për shkak të lidhjes farefisnore që kemi, unë nuk do ti pres marrëdhëniet që kam me ju!” (Muslim, Iman 348, 351, Buhari, Tefsiru sure 26/2; Tirmidhi, Tefsiru sure 27/2; Nesai, Vesaja.)

Kur Profeti ynë ﷺ, ishte duke u ndarë nga kjo botë, tha: “Kujdes namazin dhe kini frikë Allahun në lidhje me ata që keni nën vete!”

(Ebu Daud, Edeb, 123-124/5156.)



Po ashtu, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Unë po ju lajmëroj juve se para keni një ditë ndëshkimi të rëndë, ku do të ndëshkohen ata që nuk i besojnë Allahut! Unë jam dërguar për t’ju ruajtur juve nga ai ndëshkim i hidhur!

O Kurejshë! Pozita ime në mesin tuaj është si njeriu, i cili e dallon armikun dhe, duke pasur frikë se mos i shkakton dëm familjes së vet, vrapon menjëherë për ta lajmëruar.

O Kurejshë! Ju do të vdisni ashtu siç bini në gjumë dhe do të ringjallen ashtu siç zgjoheni prej gjumi. Pa dyshim, pasi të ngriheni prej varri, do të dilni para Allahut dhe do të jepni llogari për çdo veprim tuajin në këtë botë. Si përfundim, do të merrni shpërblimin e punëve të mira e të dobishme dhe të adhurimeve, si dhe ndëshkimin e hidhur të punëve tuaja të këqija. Shpërblimi është një Xhenet i amshuar. Ndërsa ndëshkimi është një Xhehenem i përjetshëm!” (Buhari, Tefsir, 26; Muslim, Iman, 348-355; Ahmed, I, 281-307; Ibni Sa‘d, I, 74, 200; Belazuri, I, 119; Semira ez-Zajid, I, 357-359.)

Islami kritikoi ashpër abuzimin e idhujtarëve ndaj jetimëve, koprracinë dhe dashurinë e tyre për pasurinë dhe jetën e kësaj bote dhe u predikoi drejtësinë, botën tjetër, kiametin, gjykimin, llogarinë, etj. Për rrjedhojë, mohuesit u shqetësuan shumë prej kësaj. Të frikësuar jashtë mase për këto të vërteta që lajmëroi i Dërguari i Allahut ﷺ, thanë: “Lajm i madh”. Prej asaj dite, jeta e ndërtuar mbi egon dhe injorancën e tyre filloi të tronditej. Ajetet e para të sures Nebe, e përshkruajnë kështu këtë situatë të tmerrshme:

عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ عَنِ النَّبَاِ الْعَظِيمِ الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ

Nevojtaret, të pafuqishmit dhe jetimët ishin gjithmonë nën kujdesin e tij dhe të atyre që ecën në gjurmët e tij...



“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh, rreth të cilit ata kanë kundërshtime.” (Nebe’, 1-3.)

BOTA TJETËR: JETA E VËRTETË

Profeti ynë ﷺ, i cili erdhi për t’i kujtuar njerëzimit botën tjetër, jetoi gjithmonë i buzëqeshur, por i shqetësuar për jetën e umetit të vet në botën tjetër. Zemra e tij rrihte me dhembshuri për shpëtimin e umetit të tij në botën tjetër. Për rrjedhojë, në momentet dhe kohët më të vështira, ai i ngushëllonte shokët e vet duke u mësuar se synimi i vërtetë i kësaj jete, nuk është kjo botë, por bota tjetër:

“Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!” (Buhari, Xhihad, 110.)

Kur Omeri رضي الله عنه, shihte jetën e thjeshtë të Profetit ﷺ dhe i kujtoheshe se në ç’luks e mirëqenie jetonin mbretërit pers dhe perandorët bizantinë, hidhërohej e mërzitej. Mirëpo, i Dërguari i Allahut ﷺ, e qetësonte atë duke i thënë:

“Mos qaj, o Omer! A nuk dëshiron që kjo botë me të gjitha begatitë dhe shijet e saj të jetë e tyre, kurse ahireti të jetë i yni!?” (Ahmed, II, 298.)

Me pak fjalë, Profeti ynë ﷺ, ua kishte mësuar mirë shokëve të vet se kjo botë është vetëm një vend i përkohshëm. Prandaj, edhe Ebu Dherri رضي الله عنه, thoshte:

“Pasha Allahun! Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, u shpërngul për në botën e përtejme, na la në një gjendje të atillë që, nëse edhe një zog rrihte krahët në qiell, na ku-

Ebu Dherri رضي الله عنه, thoshte: “Pasha Allahun! Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, u shpërngul për në botën e përtejme, na la në një gjendje të tillë që, nëse edhe një zog rrihte krahët në qiell, na kujtonte një hadith të tij, sepse ai na pati thënë: «Juve ju është shpjeguar çdo gjë që ju afron drejt Xheneti dhe ju largon nga Xhehenemi!»”
(Ahmed, V, 153, 162.)



jtonte një hadith të tij, sepse ai na pati thënë: «Juve ju është shpjeguar çdo gjë që ju afron drejt Xheneti dhe ju largon nga Xhehenemi!» (Ahmed, V, 153, 162; Hejthemi, VI-II, 263.)

BOTA TJETËR, DO TË THOTË “PESHORE”

Padyshim se shtimi i veprave të mira është shumë i domosdoshëm për atë ditë kur do të peshohen të mirat dhe të këqijat. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na e përshkruan kështu një prej skenave në botën tjetër:

وَهُمْ يَصْطَرِحُونَ فِيهَا رَبَّنَا أَخْرِجْنَا نَعْمَلْ صَالِحًا غَيْرَ
الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ أَوْ لَمْ نُعْمَرْكُمْ مَا يَتَذَكَّرُ فِيهِ مَنْ تَذَكَّرَ
وَجَاءَكُمْ النَّذِيرُ فَذُوقُوا فَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ نَصِيرٍ


“Atje, ata do të thërrasin: «O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë!»”

(Atyre do t’u thuhet:) “Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!»” (Fatir, 37)

Për rrjedhojë, mënyra e vetme për të mos rënë në këtë gjendje, është angazhimi me vepra të mira e sinqerta që në këtë botë. Pra, të përgatitesh për botën tjetër me adhurime dhe vepra të mira...

Zemra e Profetit tonë ﷺ, rrihte me dhembshuri për shpëtimin e umetit të tij në botën tjetër. Për rrjedhojë, në momentet dhe kohët më të vështira, ai i ngushëllonte shokët e vet duke u mësuar se synimi i vërtetë i kësaj jete, nuk është kjo botë, por bota tjetër: “Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!”

(Buhari, Xhihad, 110.)



Profeti ynë ﷺ, ndihej në siklet kur i mbetej qoftë edhe pak para në xhep. Prandaj, ai e jepte menjëherë si sadaka. Po ashtu, ai i ftonte edhe shokët e vet të vepronin të njëjtën gjë:

“O njerëz! Sa të jeni gjallë, përgatituni për jetën tuaj në botën tjetër. Padyshim, secili nga ju ka për të vdekur, e ka për ta lënë tufën pa çoban.

Pastaj, Allahu, pa përkthyes e ndërmjetës, do t’ju pyesë:

«A nuk të erdhi i Dërguari Im e t’i bëri të ditura urdhrat e mia? Unë të dhashë ty mall e pasuri, të bëra shumë të mira e favore. Po ti, ç’solle për vete?»

Çdo njeri, para një pyetjeje të tillë, do të shohë majtas e djathtas e nuk do të shohë gjë. E, kur të shohë para, do të shohë Xhehenemin...

Atëherë, zgjohuni! Kush të jetë i zoti për të bërë një të mirë qoftë edhe sa një gjysmë hurme e të shpëtojë nga zjarri, le ta bëjë! Kush nuk ka mundësi as për kaq, të paktën të thotë një fjalë të mirë, sepse për një të mirë, jepet sevap dhjetëfish deri në shtatëqind fish.

Paqja, mëshira dhe begatia e Allahut qofshin mbi ju!” (Ibni Hisham, I, 118-119; Bejhaki, Delail, II, 524.)

Edhe nëse do të bëhet bamirësi si përgatitje për botën tjetër, është kusht që fitimi të jetë hallall... Ashtu siç është e rëndësishme se si shpenzohet, në të njëjtën mënyrë është e rëndësishme dhe se si fitohet... sepse;



Sulltan Ahmedi i I, çdo mëngjes shkruante bukur dhe me respekt të madh emrin “Muhamed” dhe e vendoste mes palave të çallmës në kokën e vet.

BOTA TJETËR DO TË THOTË “LLOGARI”

Profeti ynë ﷺ, ka jetuar dhe na ka mësuar me vetëdijen se; në botën tjetër do të jepet llogari për çdo mirësi. Po ashtu, ai ka treguar përpikëri të jashtëzakonshme edhe në çështjen dënimit të harmit dhe llogarisë së hallallit. Gjatë gjithë jetës, Profeti ynë ﷺ, ka treguar kujdes shumë të madh në lidhje me të drejtat e krijesave, gjë të cilën e ka vërtetuar edhe në ditët e fundit të jetës së vet, kur edhe pse i sëmurë e i pafuqishëm, ai shkoi në xhami dhe iu drejtua myslimanëve me këto fjalë:

“O shokët mi! Nëse kam marrë pa dashje prej pasurisë së ndonjërit prej jush, ja ku është pasuria ime, le të vijë ta marrë!.. Nëse e kam goditur dikë në shpinë padrejtësisht, ja ku është shpina ime, të vijë të më godasë!..” (shih. Ahmed, III, 400.)

Po ashtu, në hadithin e fundit që është dëgjuar prej Profetit tonë ﷺ, kur ai ishte duke u ndarë nga kjo botë, thuhet:

“Kujdes namazin dhe kini frikë Allahun në lidhje me ata që keni nën vete!” (Ebu Daud, Edeb, 123-124/5156; Ibn-i Maxhe, Uesaja, 1.)

Nevojtarët, të pafuqishmit dhe jetimët ishin gjithmonë nën kujdesin e tij dhe të atyre që ecën në gjurmët e tij...

Ai ﷺ, gjatë gjithë jetës së tij profetike prej 23 vitesh, ka përhapur përherë drejtësinë dhe të vërtetën.

نوله تا جرم کبی باشمده کتورسم دائم
قدم پاکنی اول حضرت شاه سلک

Kur Omeri ﷺ, shihte jetën e thjeshtë të Profetit ﷺ dhe i kujtoheshe se në ç’luks e mirëqenie jetonin mbretërit pers dhe perandorët bizantinë, hidhërohej e mërzitej. Mirëpo, i Dërguari i Allahut ﷺ, e qetësonte atë duke i thënë: “Mos qaj, o Omer! A nuk dëshiron që kjo botë me të gjitha begatitë dhe shijet të jetë e tyre, kurse ahireti të jetë i yni!?” (Ahmed, II, 298.)

Ai na mësoi se; gruaja, e cila deri atëherë nuk konsiderohej as si njeri, së cilës i grabitej trashëgimia dhe trajtohej si mall, është një njeri që ka të drejtat e saj në pasuri dhe trashëgimi, një rol të rëndësishëm në familje e shoqëri dhe në të njëjtën kohë, është një nënë nën këmbët e së cilës qëndron Xheneti.

Po ashtu, Profeti ﷺ, na mësoi se; fëmijët vajza, për të cilat deri atëherë askush nuk gëzohej kur lindnin, janë mirësi që do t'i çojnë prindërit e tyre në Xhenet.

Krahas kësaj, Profeti ﷺ, u ktheu të drejtat jetimëve, të moshuarve, të dobëtëve, skamnorëve dhe të gjithë pjesës nevojtare të shoqërisë. Madje, për të luftuar skllavërinë, e cila ka qenë një domosdoshmëri e ligjit të luftës, ai ka predikuar dhe zbatuar praktika në favor të lirit të tyre. Po ashtu, nga njëra anë, pronarëve të skllavëve u vuri kusht që t'i ushqenin dhe t'i vishnin skllavërit e tyre njësoj siç ushqeheshin dhe visheshin vet, e nga ana tjetër, i bëri të ndjenin përgjegjësinë e madhe që kishin ndaj tyre, duke i nxitur që t'i lironin. Për të nxitur sa më shumë lirim të skllavëve Profeti ﷺ, u mësoi njerëzve se; falë lirit të tyre, mund të fitonin shpërblime të shumta nga Allahu dhe t'u faleshin shumë gjynahë. Si rrjedhojë, një nga sahabët që ka liruar mbi një mijë skllavë, ishte edhe Abdullah Ibn Omeri رضي الله عنه.

*Jaman Dede:
"Kur kujtoj Profetin
tonë ﷺ dhe mendoj
karakterin dhe
personalitetin e tij
madhështor e të veçantë,
më kaplon një frikë
dhe këputem i tëri. Më
humbet fuqia dhe nuk
qëndroj dot në këmbë."*



Profeti ynë ﷺ, nuk mbronte vetëm të drejtat e njerëzve, por edhe ato të kafshëve dhe bimëve. Ai mbrojti të drejtën e një qeni nënë që ushqente këlyshët e vet me gji, të drejtën e zogjve që dikush u prishi follenë, të drejtën e milingonave, të drejtën e devesë që keqtrajtohej dhe keqpërdorej me mbingarkesë, etj.

BOTA TJETËR DO TË THOTË “DREJTËSI”

Në sytë e tij ﷺ, njerëzit ishin të barabartë si dhëmbët e një krehri. Ai i ndaloi njerëzit të pretendonin përparësi dhe superioritet në bazë të sojit, fisit, pasurisë apo ngjyrës së lëkurës:

“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij!..”
(Huxhurat, 13.)

Ai personalitet i veçantë që zotëronte një moral madhështor, nuk zemërohej kurrë për veten e tij. Por, përballë shkeljes së interesave të popullit, përpiquej me seriozitet derisa e drejta të vihej në vend. Ai qetësohej vetëm atëherë kur e drejta shkante tek i zoti. Ky shembull mjafton për ta vërtetuar këtë fakt:

Në kohën e Profetit ﷺ, një nga gratë e fisit Beni Mahzum kreu një vjedhje. Në bazë të sheriatit (ligjit Islam), duhej t’i pritej dora. Mirëpo të afërmit e saj, filluan të kërkonin dikë që të ndërhynte tek Profeti ﷺ, me qëllim që asaj të mos i pritej dora.

Më në fund, vendosën të dërgojnë Usame ibn Zejdin, i cili ishte një nga sahabët më të dashur të Profetit ﷺ. Usame shkoi tek Profeti ﷺ dhe i kërkoi që ta falte gruan që kishte vjedhur. Mirëpo, Profetit të Allahut ﷺ, i ndryshoi çehreja e fytyrës së tij të bekuar përballë kësaj kërkesë dhe, me një shikim qortues, e pyeti Usamen ﷺ, të cilin e donte aq shumë:

“Ti po ndërmjetëson që të mos zbatohet një nga dënimet që ka vendosur Allahu?”



Kurani Fisnik të zgjeron botëkuptimin, të thëllon meditimin, të mpreh zgjuarsinë dhe të qartëson largpamësinë. Për rrjedhojë, duke aluduar në mendjen e cila ka gjetur vlerën e vërtetë nën dritën e shpalljes, Kurani Fisnik përdor gjashtëmbëdhjetë herë shprehjen; “Ulu’-elbab / të zotët e mendjes”.

Kur Usame رضي الله عنه, e pa se sa u mërzi Profeti ﷺ, u bë pishman dhe, duke i kërkuar falje, tha:

“O i Dërguar i Allahut! Bëj dua që të më falet (ky gjynah)!”
(shih. Buhari, Megazi, 53; Nesai, Kat’u’s-Sarik, 6, VIII, 72-74.)

Pastaj, Profeti ﷺ, u ngrit në këmbë dhe iu drejtua njerëzve duke thënë:

“Për këtë arsye u shkatërruan popujt para jush. Nëse dikush prej fisnikëve apo njerëzve me pozitë bënte vjedhje, e lëshonin, por nëse vidhte dikush që ishte i dobët e panjeri, ata menjëherë e dënonin. Betohem në Allahun se nëse bija e Muhamedit, Fatimja, do të vidhte, patjetër që edhe asaj do t’ia prisja dorën!” (Buhari, Enbija 54, Megazi 53, Hudud 11, 12; Muslim, Hudud 8, 9.)

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush, ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është vlerësuesi më i drejtë për ata. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë!..”
(Nisa, 135.)

Ebu Bekri رضي الله عنه, e ndiente Profetin ﷺ, edhe kur nuk ishte pranë tij, sepse ai (Profeti), ishte i hapur dhe i qartë si hëna katërmbëdhjeshë për sytë dhe shikimin e tij të dashuruar pas tij.



Po ashtu, edhe shokët, sahabët e Profetit tonë ﷺ, u bënë shembuj të mrekullueshëm të drejtësisë.

DREJTËSI E PASHOQE

Pas fitores së Hajberit, Profeti ﷺ, dërgoi atje Abdullah ibn Reuahan رضي الله عنه, që të mbledhte taksat. Abdullahu رضي الله عنه, llogariste

me përpikëri të madhe sasinë e hurmave që duhej dhënë dhe vilte taksën. Mirëpo, hebrenjtë që shfrytëzonin tokën e Hajberit, i shqetësoi kjo përpikëri e Abdullahut ﷺ, në llogaritjen e taksës. Prandaj, njëherë mblodhën disa stoli të grave dhe i thanë:

- Këto janë tuat! Por gjatë llogaritjes së taksës vepro në favorin tonë dhe mbylle njërin sy për ne!

- Për Allahun! Urrejtja që kam ndaj jush për shkak të shumë veprave tuaja të këqija, nuk më pengon të sillem me drejtësi ndaj jush! Por, kjo që po më ofroni është ryshfet, dhe ryshfeti është haram. Ne nuk e hamë atë!

Pas kësaj, hebrenjtë, të cilët e kuptuan se nuk mund ta bindnin dot Abdullahun ﷺ, filluan ta lavdëronin atë duke thënë:

“Ja, me këtë drejtësi qëndrojnë në këmbë dhe me rregull edhe qiejt e toka!” (Muvatta, Musakat, 2.)

Po ashtu, për shkak të kësaj drejtësie, edhe Omeri ﷺ, u bë i njohur me emrin, “Adl / i Drejti”.

Edhe brezat e tjerë pas sahabëve, të cilët i pasuan ata në mirësi, ka dhënë shembuj të mrekullueshëm në drejtësi dhe përgjegjësi ndaj detyrës.

Një prej shembujve të virtytshëm që e pasqyron më së miri drejtësinë dhe vetëdijen ndaj amanetit në përgjegjësinë që bartte, është edhe Omer bin Abdulazizi, i cili në Historinë Islame konsiderohet si kalifi i pestë i drejtë. Ja si tregon bashkëshortja e tij, Fatimja:

Në kohën e Osmanëve organizohej një karvan i veçantë, që dërgohej në Medinë. Para se të hynte në qytet, karvani qëndronte në një vend afër saj, përgatiteshin për atmosferën shpirtërore të Medinës dhe shkonin të kryenin vizitën e tyre tek varri i të Dërguarit të Allahut ﷺ, me respekt dhe nderim të madh.



“Një ditë, shkova pranë tij dhe e gjeta të ulur në mesxhid me dorë të mbështetur mbi ballë, ku qante pa pushim, e lotët i lagnin faqet.

E pyeta se çfarë kishte?

Ktheu kokën lehtë dhe tha:


«Fatime! Kam marrë mbi vete barrën më të madhe të këtij umeti. Ka njerëz që janë të uritur, të varfër, të sëmurë, nevojtar, jetimë, gra të veja, njerëz që iu është bërë padrejtësi, robër lufte në vendet armike, të moshuar dhe shumë të tjerë të cilët kur i mendoj më shtyp presioni i barrës së madhe që kam mbi vete. Ndërgjegjja nuk më gjen qetësi. Si do të përgjigjem unë nëse Allahu më merr në llogari në ditën e gjykimit dhe nëse Profeti ﷺ, më qorton për këtë?!.» (Ibn-i Kethir, el-Bidaje, IX, 208.)

Ata përherë vepruan me shqetësimin për llogarinë në botën tjetër. Duke kujtuar urdhrin e Profetit ﷺ, që tha: “*Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..*” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.), ata u përpoqën vazhdimisht që ta gëzonin Profetin ﷺ.

Kjo ndodhi e kohës së Sulltan Mehmet Fatihut, i cili realizoi përgëzimin profetik të çlirimit të Stambollit, është shumë e veçantë dhe domethënëse:

NJË SULLTAN NË GJYKATË

Pas marrjes së Stambollit, sulltan Mehmeti II pati urdhëruar t’i pritej dora një arkitekti të krishterë, i cili e kishte kryer detyrën në kundërshtim me urdhrin e tij.



Për shkak se kjo botë është një vend i nevojave të shumta, sytë hutohen para dritareve dhe perdeve të panumërta që ka përballë. Ata nuk mund t’i shohin madhësitë e vërteta dhe të përvetshme, sepse mahniten pas shkëlqimeve të përkohshme.

Ndërkaq, gjykatës i Stambollit ishte Hëzër Beu, shoku dhe miku më i afërt i Mehmetit II dhe i emëruar prej tij në këtë detyrë.

Arkitekti të cilit i ishte prerë dora, shkoi te gjykatësi Hëzër Beu dhe u ankua kundër sulltanit.

Atë kohë, mënyra apelative ndaj personit të sulltan Mehmetit II ishte kështu:

“es-Sultan ibnu’s-Sultan el-Gazi Ebu’l-Feth MUHAMMED Han-ı Sani” (Sulltani i biri i Sulltanit, Gaziu Ngadhënjimtari, Mehmeti i Famshëm).

Mirëpo, Hëzër Beu i dërgoi një ftesë gjyqi të thjeshtë si për një qytetar të zakonshëm, me këtë tekst:

“Mehmeti i biri i Muradit, ejani në gjykatë në këtë orë!..”

Ditën kur do të zhvillohej seanca gjyqësore, sulltan Mehmeti II shkoi në gjykatë i vetëm, pa suitë dhe ceremoni, si një qytetar i thjeshtë dhe u ul në karrigen e të pandehurit. Hëzër Beu zuri vendin e ve dhe seanca filloi.

Në gjykatë; gjykatësi përfaqësonte drejtësinë, prandaj rrinte ulur. Kurse të tjerët, ngriheshin në këmbë kur flisnin. Mirëpo, kur Sulltan Mehmeti II nuk u ngrit në këmbë për të folur, gjykatësi ia tërhoqi vërejtjen:

“Këtu ndodhesh si i pandehur, ngrihu në këmbë!”

Sulltani u ngrit në këmbë dhe ashtu iu përgjigj pyetjeve të gjykatësit. Në përfundim të seancës, gjykatësi e shpalli sullta-



*Edhe pse po afron
kiameti, edhe pse
janë hapur portat
e Xhehenemit dhe
Xhenetit, njeriu
indiferent nuk arrin
të shohë; edhe pse i
gjithë universi po bën
përgatitjet e fundit për
shpërthimin e madh
dhe për përjetësinë që
do të vijë pas tij.*

nin fajtor, kurse arkitektin e krishterë, të pafajshëm. Më pas, këndoi ajetin kuranor mbi ndëshkimin e njëvlershëm (kisas). Duke u mbështetur mbi konkluzionin e ajetit në fjalë, gjykatësi vendosi që sulltani të dënohej po me atë mënyrë që kishte kryer faj; pra, t'i pritej dora!

Sovrani i cili kishte nënshtruar botën, duke e pritur vendimin me qetësi dhe nënshtrim, tha:

“Vendimi i takon ligjit të Zotit!”

Duke u prekur jashtëzakonisht nga kjo skenë e një drejtësie të lartë, arkitekti i krishterë tha me sytë tërë lot:

“Heq dorë nga e drejta ime, kërkoj vetëm dëmshpërblim!”

Pasi seanca e gjykimit përfundoi në këtë mënyrë të pëlqyeshme, sulltani i tha kështu Hëzër Beut:

“Të përgëzoj që u frikësove nga Allahu, e jo nga unë!”

Atë çast, gjykatësi Hëzër Beu nxori nga poshtë minderit ku rrinte, një topuz dhe i tha:

“Po të mos e pranoje vendimin që dhashë, do të të godisja në kokë me këtë topuz!”

Edhe sulltani, si përgjigje ndaj kësaj, i tregoi shpatën që e kishte fshehur nën kaftan dhe i tha:

“Edhe unë, po qe se nuk do të vendosje me drejtësi, do të ta prisja kokën me këtë!”

Javuz Sulltan Selimi i solli amanetet e shenjta në Stamboll dhe emëroi 40 hafizë që t'u qëndronin pranë. Hafizët këndonin Kuran me radhë e në mënyrë të pandërprerë pranë amaneteve të shenjta.



Përveç dëmshpërblimit, sulltan Mehmeti II i dhuroi arkitektit të krishterë një shtëpi nga pasuria e vet personale. Për këtë arsye, arkitekti i krishterë tha:

“Nuk ka në botë drejtësi të tillë! Nga ky çast e tutje, unë jam mysliman!” - Dhe u bë mysliman duke thënë Fjalën e Dëshmisë Islame!

Falë kësaj drejtësie, Osmanët u bënë një nga dinastitë më jetëgjata në historinë njerëzore. Për shkak se siguronin rendin dhe drejtësinë në vendet që çlironin, shumë vende e popuj i ftonin vetë Osmanët që t'i qeverisnin. Për rrjedhojë, duke eliminuar feudalët dhe guvernatorët tiranë, Osmanët sollën njerëzinë e vërtetë dhe lirinë e shumë popujve. Për shembull, në Poloni ishte bërë shumë e njohur shprehja:

“Ky vend nuk e gëzon lirinë dhe pavarësinë pa pirë ujë kuajt e osmanëve në lumin Visla!”

Filozofi i shquar i Revolucionit Francez, Lafajet, edhe pse ishte jomysliman, pohoi me ndërgjegje të pastër madhështinë e Profetit tonë ﷺ, duke thënë:

“O njeri i madh! Askush nuk ka mundur ta përhapë të vërtetën dhe drejtësinë siç i ke përhapur ti!”

Ndërsa shkrimtari anglez Thomas Carlyle thotë:

“Asnjë mbret që shëtiti me kurorë në kokë, nuk është respektuar dhe nderuar në këtë botë aq sa Muhamedi, i cili edhe rrobën e tij e arnonte vet.”

Shkrimtari anglez Thomas Carlyle thotë:

“Asnjë mbret që shëtiti me kurorë në kokë, nuk është respektuar dhe nderuar në këtë botë aq sa Muhamedi, i cili arnonte rrobën e vet.”



PO SOT?

Sot mbizotëron përsëri botëkuptimi i periudhës së injorancës. Pra, nëse analizohen shoqëritë e periudhave të injorancës në të cilat janë dërguar profetët, do të shihet se shumica e shoqërive e kanë mohuar botën tjetër. Kështu ishte edhe periudha e injorancës së cilës i dha fund Islami. E njëjta gjë po përrjetohet edhe sot...

Programet e helmatisura të televizioneve, që e bëjnë shoqërinë e sotme të jetë e prirë vetëm ndaj materiales dhe e mbajnë larg prej së vërtetës së botës tjetër, duke i injektuar ndjenja negative; korridoret e pista në të cilat interneti i përplas njerëzit; reklamat dhe modat e ndryshme, e helmojnë strukturën shpirtërore të njeriut dhe e bëjnë si një robot. Ky botëkuptim materialist e kapitalist, e shkatërron plotësisht ekuilibrin e jetës së kësaj bote... Një botë e jetuar pa mendimin për botën tjetër, e përmbys njerëzimin dhe e çon drejt shkatërrimit.

Prej nga erdhe në këtë botë? Përse u krijove? Ç'është kjo botë? Në pronën e kujt po jeton? Për ku je duke shkuar?



Një botë pa mendimin e botës tjetër... një plehërishte njerëzore që nuk mendon për llogarinë... një tablo ku të fortit shtypin të dobëtit dhe një mizori ku atë që mbetet poshtë nuk e mëshiron askush... Një batak imoraliteti që nuk e çan kokën për “peshoren” në ditën e gjykim-it... një paturpësi që ia skuq fytyrën librit të veprave...

Një qorrsokak devijimi që nuk beson në urën e siratit...

Një mendjelehtësi që nuk do t'ia dijë për Xhenetin;

Një indiferencë që e ka harruar Xhehenemin...

Sepse kjo ecuri, të çon drejt Xhehenemit...

Prej nga erdhe në këtë botë? Përse u krijove? Çështje kjo botë? Në pronën e kujt po jeton? Për ku je duke shkuar?

Të jetosh pa menduar mbi këto pyetje dhe pa iu përgjigjur atyre, tregon një mendjehetësi shumë të madhe!..

Një mendjehetësi që shfaq vetëm ai që e zhyt kokën në rërë dhe mendon se ka shpëtuar prej rrezikut... sepse;

Ka botë tjetër!.. Ka llogari!.. Ka peshore!.. Ka gjykatë supreme!.. Ka urë sirati!.. Ka dënim dhe shpërblim, Xhehenem dhe Xhenet!..

Po të mos ishin këto, ardhja në këtë botë nuk do të kishte asnjë kuptim. Edhe një person me zgjuarsinë më të rëndomtë mund të mendojë e të thotë:

Kemi ardhur, por nga? Po shkojmë, por për ku?

Të jetojmë në këtë botë duke e konsideruar atë si arën e botës tjetër, siç vepron edhe Profeti ynë ﷺ, është mënyra e vetme për t'i kthyer të dyja botët në një kopsht Xheneti.

Drita e udhëzimit që mund ta eliminojë botëkuptimin e injorancës së ditëve tona, mund të shfaqet vetëm nëse ndjekim moralin dhe drejtësinë profetike.

Allahu i Madhëruar na dhëntë sukses!

Të jetosh pa menduar mbi këto pyetje dhe pa iu përgjigjur atyre, tregon një mendjehetësi shumë të madhe!..



O Allah! Mos na bëj prej atyre, shqetësimi më i madh i të cilëve është kjo botë!.. Mos na largo kurrë prej së drejtës dhe drejtësisë, të vërtetës dhe mirësisë!.. Na bëj prej atyre që do t'u zbardhet fytyra në botën tjetër!..

Amin!..



*Një mendjelehtësi
që shfaq vetëm ai
që e zhyt kokën në
rërë dhe mendon
se ka shpëtuar prej
rrezikut...*





FAMILJA IDEALE DHE SHOQËRIA E DEVOTSHME

Gratë sahabe në Epokën e Lumturisë, i pyesnin me entuziazëm burrat e tyre:

“Cili ajet zbriti sot? Çfarë mësuat nga bisedat e Profetit ﷺ? Na i mësoni edhe neve?”

Ndërsa fëmijët e tyre i nxisnin me këmbëngulje që të merrnin pjesë në tubimet e Profetit ﷺ.

Nëse dëshirojmë fëmijë të mbarë e të devotshëm, është e domosdoshme të jemi prindër të mbarë e të devotshëm. Prindërit që ia arrijnë kësaj, meritojnë falënderim të përjetshëm.



FAMILJA IDEALE DHE SHOQËRIA E DEVOTSHME

TRASHËGIMIA SHOQËRORE

Jeta e kësaj bote, është një shkollë provimi e përgatitur për njeriun me qëllim që të fitojë botën tjetër. Mirëpo, nënshtrimi i çdo njeriu ndaj këtij provimi apo prove të kësaj bote, ndodh në mënyrë të ndërthurur me jetët e të gjithë njerëzve të tjerë. Kjo, sepse Allahu i ka bërë njerëzit nevojtarë ndaj njëri-tjetrit. Ai e ka krijuar njeriun si qenie shoqërore, që jeton mes familjes, të afërmve, shokëve, fqinjëve, etj.

Njeriu ka marrëdhënie të forta ndikuese me njerëzit e shoqërisë ku jeton dhe, ashtu siç merr trashëgimi nga prindërit për shkak të gjakut, ashtu merr edhe trashëgiminë shoqërore. Nëse ky unitet është zhvilluar duke u shndërruar në dashuri, familjaritet dhe afërsi, ndikimi rritet edhe më shumë, si në aspektin pozitiv, ashtu edhe në atë negativ. Populli e shpreh këtë duke thënë:

“Sheh rrushi rrushin e piqet!”

“Më thuaj me kë rri, të të them cili je!”

“Para se të blesh shtëpi, shiko kë ke fqinj!”

Për këtë arsye, për një besimtar është shumë e rëndësishme se me kë shoqërohet në këtë botë, që është vendi ku fitohet ose humbet lumturia e botës tjetër.

Kur sahabët e pyesnin të Dërguarin e Allahut ﷺ, se a do ta shihnin atë në Xhenet dhe me kë do të ishin në botën tjetër, ai ﷺ, u përgjigjej thjesht dhe në mënyrë shumë domethënëse:

“Njeriu do të jetë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.)

E në fakt, njeriu merr prej moralit të atij që do dhe pasion, bën atë që bën ai dhe kalon një jetë në unitet mendor dhe shpirtëror me të. Ai e rregullon personalitetin dhe jetën e vet sipas personalitetit të atij të cilin e admiron. Për rrjedhojë, edhe në botën tjetër do të trajtohet në mënyrë të njëjtë me atë që do.

Një mik i sinqertë, e nxit njeriun në ndjenja të larta shpirtërore, vepra të mira dhe të sinqerta. Kurse një shok i keq dhe një shoqëri gjynahqare, e shtyjnë njeriun drejt dëshirave të ulëta egoiste, gjynaheve dhe sjelljeve të këqija. Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na përshekruan një skenë të tillë në Kuranin Fisnik:

*Imam Gazaliu
thotë:*

*“Biri im! Nëse
ka diçka për të
cilën duhet të
bësh kujdes të
jashtëzakonshëm,
është çështja se me
kë shoqërohesh...”*



POTHUAJSE!

“Ata do t’i qasen njëri-tjetrit e do të bisedojnë. Dhe njëri prej tyre do të thotë: «Unë kam pasur një shok, i cili më thoshte:

“Vallë, edhe ti je nga ata që besojnë se, kur të vdesim e të bëhemi eshtra e pluhur, do të japim llogari vërtet?!” - A

doni ta shikoni (atë që më qortonte për shkak të besimit tim)?»

Dhe ai do të shikojë poshtë dhe do ta shohë atë në mes të Zjarrit flakërues e do t'i thotë:

«Për Allahun! Pothuajse më shkatërrrove edhe mua. Po të mos ishte dhuntia e Zotit tim, edhe unë do të isha në zjarr (bashkë me ty)». (Saffat, 50-57.)

Shprehja, “**dhuntia e Zotit tim**”, në Tefsir është shpjeguar si, udhëzim, besim, rrugë e drejtë dhe ruajtje nga shoqëria e keqe, që i ka falur Allahu i Madhëruar. (shih. Hajjan, el-Bahru'l-Muhit, es-Saffat, 57.)

Ndërsa në suren Muddeththir, tregohet se:

Banorët e Xhenetit do t'i pyesin ata të Xhehenemit:

“Çfarë ju ka sjellë në Sekar?”

Ata do të përgjigjen: “Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit.

Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mononim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja.” (Muddeththir, 42-47.)

Domethënë se;

Një nga shkaqet që do ta çojë njeriun në Xhehenem dhe do ta shkatërrojë atë, është qëndrimi me gjynahqarët.

Gazaliu: “Dije mirë se, një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjë të mirë një mollë të prishur midis tyre. Mirëpo, kjo mollë e prishur, mund t'i prishë edhe të tjerat. Për këtë arsye, qëndro gjithmonë me njerëzit e mirë!”



Në fakt, në ditët tona, një pjesë e mirë e programeve televizive, të faqeve të internetit, të stileve të jetesës, reklamave, etj., e bëjnë njeriun të harrojë botën tjetër dhe dobësojnë personalitetin dhe karakterin e tij, duke synuar ta bëjnë atë robin e kësaj bote.

Për këtë arsye;

Në suren Fatiha, ne e përsërisim së paku dyzetë herë në ditë lutjen:

“Allahu ka dhënë si shembull për ata që nuk besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit.

Ato ishin të martuara me dy nga robërit Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan ata. Prandaj, ata nuk mund t'i mbrojnë aspak nga Allahu (Ditën e Gjykimit) e atyre të djave do t'u thuhet: «Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!»”

(Tahrim, 10.)

Ja pra, ky është fundi i shoqërimet me njerëzit e prishur.



“(O Allah!) Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi, e jo në të atyre që kanë shkakuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!” (Fatiha, 6-7.)

Pra;

I vetmi strehim dhe shpëtim për ne, është Allahu i Madhëruar. Ai është mburoja jonë kundër sherrit të të këqijve, cytjeve të shejtanëve prej njerëzve dhe xhinëve dhe ndëshkimit e shkatërrimit që shkaktojnë gjynahqarët.

E në fakt, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

«فِرُّوا إِلَى اللَّهِ / Ikni drejt Allahut!..»

(Dharijat, 50)

Ikni, largohuni prej të gjitha gabimeve, gjynaheve dhe të këqijave, drejt Allahut të Madhëruar!

Për të na treguar rrugën e shpëtimit, Zoti ynë i Madhëruar na këshillon qëndrimin me ata, të cilëve u ka dhënë mirësi, të sinqertit dhe besnikët:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَكُونُوا مَعَ الصَّادِقِينَ

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë/ besnikë (në fjalë dhe në vepra)!” (Tevbe, 119)

Po të shihet me vëmendje; në këtë ajet, Zoti nuk u ka thënë robërve të Tij, **“bëhuni besnikë”**, por, për ta mbrojtur takvanë (devocionin), u ka thënë **“rrini me besnikët”**. Sepse hapi i parë që do të hidhet në rrugën për t’u bërë besnik, është bashkimi, shoqërimi dhe ndenja me besnikët. Domethënë, krijimi dhe përjetimi i një afërsie konfidenciale me ta.

Në një ajet fisnik urdhërohet:


MOS QËNDRONI BASHKË!

“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër! E, nëse djalli të bën të harrosh;

فَلَا تَقْعُدْ بَعْدَ الذِّكْرِى مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ

sapo të përmendesh, mos rri me keqbërësit!” (En’ám, 68)

Ndërsa në një ajet tjetër që ka të bëjë me të njëjtën çështje, pasi ndalohet qëndrimi dhe shoqërimi me mohuesit dhe hipokritët, bëhet ky paralajmërim:



“...përndryshe do të ishit si ata!..” (Nisa, 140)

I Dërguari i Allahut ﷺ, i edukoi sahabët me zemrën dhe fjalën e tij. Ai i mblidhte sahabët në shtëpinë e Erkamit, në Mekë, dhe i mësonte ata. Po ashtu, edhe Xhamia e Profetit ﷺ, në Medinë, u bë vendi më i rëndësishëm ku besimtarët mblidheshin dhe përfitonin prej frymëzimit shpirtëror të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Në saje të kohëve të namazit dhe mundësive të tjera, sahabët fituan pjekuri shpirtërore nga bisedat e Profetit ﷺ. Ndërsa ata që ishin të detyruar të merreshin me punë e me tregti, morën pjesë në bisedat e Profetit ﷺ, duke zëvendësuar me radhë shokët e tyre.

*Banorët e Xhenetit
do t'i pyesin ata të
Xhehenemit:*

*“Çfarë ju ka sjellë në
Sekar?”*

Ata do të përgjigjen:

*“Nuk ishim nga ata
që falnin namaz dhe
as prej atyre që i
ushqenin të varfrit. Ne
lëshoheshim në biseda
të kota me llafazanët
dhe mohonim Ditën
e Llogarisë, derisa
na erdhi vdekja.”*

(Muddeththir, 42-47.)



Edhe gratë sahabe i kritikonin fëmijët e tyre për sa kohë ata nuk takoheshin me të Dërguarin e Zotit ﷺ. Nëna e Hudhejjes ﷺ, e kishte kritikuar atë, ngaqë nuk e kishte takuar Profetin ﷺ, për disa ditë. Ja si e tregon vetë ai këtë ngjarje:

- Kur je takuar për herë të fundit me Profetin ﷺ? – më pyeti nëna.

- Kam ca ditë që nuk e kam takuar – iu përgjigja.

Atëherë, ajo u nevríkos shumë dhe më bërtiti.

- Mos u nxeh! Po shkoj menjëherë te Profeti ﷺ, do të fal namazin e akshamit me të dhe do t'i kërkojë falje për ne të dy. – i thashë unë. (Tirmidhi, Menakib, 30\3781, Ahmed, V, 391-392.)

Nëna të tilla, të devotshme, meritojnë mirënjohje të përjetshme. Siç e mësojmë edhe nga hadithet profetike, Xheneti qëndron nën këmbët e këtyre nënave. Nëse dëshirojmë fëmijë të mbarë e të devotshëm, është e domosdoshme të jemi prindër të mbarë e të devotshëm.

Gratë sahabe në Epokën e Lumturisë, i pyesnin me entuziazëm burrat e tyre:

“Cili ajet zbriti sot? Çfarë mësuat nga bisedat e Profetit ﷺ? Na i mësoni edhe neve?”

Kështu;

Ata njerëz, të cilët në periudhën e injorancës bënë jetë gjysmë të egër, në kundërshtim me natyrën njerëzore, pasi u nderuan me Islam, në saje të qëndrimit me të Dërguarin e Allahut ﷺ, jetuan në atmosferën e dashurisë së madhe bashkë me të, morën pjesë prej moralit të tij madhështor dhe u bënë prej njerëzve më të virtytshëm në botë. Për rrjedhojë, epoka më e virtytshme, u bë ajo në të cilën jetuan Profeti ﷺ dhe sahabët e tij. Dhe, ajo që i nxori ata njerëz nga errësirat e thella të injorancës, në dritën e qytetërimit të virtyteve, ishte pikërisht qëndrimi i tyre me Profetin tonë ﷺ.

Kur ata dëgjonin Profetin ﷺ, qëndronin me një edukatë dhe qetësi të atillë, sikur të kishin një zog mbi kokë dhe kishin frikë se mos trembej e ikte. (Shih. Buhari, Xhihad, 37; Ebu Davud, Tib 1, Sunet 24; Nesai, Xhenaiz, 81; Ibni Maxhe, Xhenaiz, 37.) Ata arritën pjekurin shpirtërore në saje të pasionit për të plotësuar çdo dëshirë të

Sot, një besimtar duhet ta pyesë veten çdo moment: Me kë je? Me kë është bota e zemrës tënde, ndjenjat dhe mendimet e tua, morali dhe sjelljet e tua? Me të kujt ngjajnë ato? Me kë jemi në veprimtaritë e ndryshme gjatë jetës së përditshme?



Profetit ﷺ. Aq, sa në çdo betejë i qëndruan përreth si flutura dhe e mbrojtën me jetët e tyre.

Dashuria, sinqeriteti, përpjekja dhe sakrifica që shfaqën ata në qëndrimin me Profetin ﷺ, u bë legjendë që përcillet brez pas brezi. Kjo, sepse ata nuk ngurruan të paguanin çfarëdolloj çmimi për të qenë bashkë me të, qoftë në luftë e qoftë në paqe.

Për shembull;

Në betejën e Uhudit, kur myslimanët e humbën kontrollin e luftës, një pjesë sahabësh prej muhaxhirëve dhe ensarëve, e rrethuan të Dërguarin e Allahut ﷺ, të cilin e donin më shumë se jetën e tyre dhe i dhanë fjalën Allahut se do të binin dëshmorë përpara të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“Fytyra ime është mburojë përpara fytyrës tënde, trupi im të qoftë falë! Paqja e Allahut qoftë gjithmonë mbi Ty! Kurrë nuk ndahemi nga Ti o i Dërguari i Allahut!”


Pastaj, luftuan deri në fund. (Ibn Sa'd, II, 46; Vakidi, I, 240.)

Në të njëjtën mënyrë, edhe vetë i Dërguari i Allahut ﷺ, i ka porositur sahabët e tij të qëndronin larg gjynahqarëve.

EDHE PAS SHUMË SHEKUJSH!

Gjatë fushatës së Tebukut, Profeti ﷺ, së bashku me sahabët e tij vendosën

Besnikëria ndaj Profetit ﷺ, e cila do të fillojë duke u thelluar në dashurinë ndaj tij ﷺ, është e mundur me zbatimin e Sunetit profetik. Besnikëria ndaj tij tregohet duke e kujtuar vazhdimisht me salavate dhe selame, duke pasuar traditën e tij dhe duke u larguar nga çdo sjellje, veprim apo fjalë që atij nuk do t'i pëlqente.



të fushonin në një zonë ku njëherë e një kohë kishte jetuar populli i Themudit. Sahabët morën ujë prej puseve të atij vendi për të kryer nevojat e veta. Po ashtu, me këtë ujë gatuan edhe brumë për bukë. Mirëpo, Profeti ﷺ, i urdhëroi ata t'i derdhnin enët me ujë dhe t'ua jepnin deveve brumin e gatuar. Më pas, u tha të merrnin ujë nga pusi ku kishte pirë deveja e Profetit Salih ﷺ. (shih. Buhari, Enbija, 17; Muslim, Zuhd, 40.)

Kjo, sepse Profeti ﷺ, nuk donte që myslimanët të ndikoheshin negativisht prej vendit ku para shumë shekujsh ishte shfaqur ndëshkimi hyjnor.

Njëherë tjetër, gjatë kryerjes së Haxhit të Lamtumirës, Profeti ﷺ, luginën e quajtur Batn-i Muhassir mes Minasë dhe Muzdefiles, e kaloi me shpejtësi. Shokët e pyetën të habitur:

“O i Dërguari i Allahut, ç'ndodhi që u nxitove?”

Profeti ﷺ, iu përgjigj:

“Në këtë vend Zoti pati dërguar shpendët Ebabel dhe e pati ndëshkuar gjer në asgjësim ushtrinë e elefantëve të Ebrehesë. Prandaj, unë shpejtova që të mos na bjerë pjesë nga ai mallkim!..” (Nevevi, Sherhu Muslim, XVIII, 111; Ibni Kajjim, II, 255-256.)

Ky ndikim, i ngjan atomit, që kur shpërthen përhap radiacion. Bazuar në gjendjen, ky radiacion mund të jetë i dobishëm ose i dëmshëm. Ai nuk shihet me sy, por ndikimi i tij është real. Kështu është edhe ndikimi i shfaqjeve hyjnore të mëshirës apo ndëshkimit që është realizuar në një vend.

Për fat të keq, shekujt e fundit, mendimet e dëmshme dhe të helmatisura që janë prodhim i përpjekjeve të veçanta të misionarëve dhe orientalistëve të cilët ushqejnë armiqësi ndaj Islamit, janë përhapur në botën Islame si shkëndija zjarri që bëjnë hi besimin.



Kush viziton Qaben, Ravzan, Arafatin apo Uhudi dhe ia hap zemrën atyre vendeve, tek ai reflektohen frymëzime të larta shpirtërore. E kundërta e kësaj, është kur vizitohen vendet që janë ndëshkuar nga dora hyjnore, si Deti i Vdekur, ku mendohet se ka jetuar populli i Lutit, Sodoma dhe Gomorre, Pompei, etj. Ato vende i japin njeriut një ndikim negativ dhe ia ngushtojnë zemrën e shpirtin.

Për rrjedhojë, përderisa edhe vendi ku është kryer një e keqe ndikon kaq shumë tek njeriu, atëherë duhet llogaritur mirë se sa ndikim të madh mund të ketë shoqërimi drejtpërsëdrejti me njerëzit që i kryejnë ato të këqija!

Ndikimin që ka fjala dhe ambienti, e kanë provuar me anë të një eskperimenti nxënësit e një kursi të Kuranit, të cilët në të njëjtën ditë kanë mbjellë dy lule të njëjta në dy vazo. Njërës vazo i vendosën etiketë me fjalë të bukura dhe i lexonin Kuran dhe fjalë të mira, kurse tjetrës i vendosën etiketë me fjalë të këqija dhe muzikë të shfrenuar. Si përfundim lulja që kishte etiketë me fjalë të bukura dhe iu lexua Kurani, çeli lule të reja, kurse lulja tjetër, të cilës i ishte vendosur muzikë e shfrenuar, u vyshk dhe u tha. Pra, ndikimi është një fenomen që nuk ndodh vetëm midis njerëzve, por edhe midis bimëve...

Çdo besimtar duhet të jetë i mbushur me ndjenja mirënjohjeje dhe besnikërie ndaj të mëdhenjve të fesë, dijetarëve dhe miqve të Allahut, sepse ata na kanë përcjellë me sakrificë dhe besnikëri urdhrat dhe ndalesat hyjnore dhe hadithet dhe moralin profetik.



Për fat të keq, edhe shoqëria e sotme, është bërë si ajo e periudhës së injorancës. Kjo kohë është e mbushur plot me trazira e fitne... Bota po bëhet përherë e më shumë pragmatiste dhe egoiste. Mëshira po humbet dhe ndërgjegjet po shuhet.

Nderi dhe namusi janë nën këmbë. Në shumë vende ka shpërthyer sëmundja e popullit të Lutit. Ekranet, interneti, moda dhe reklamat, po e përhapin gjynahun dhe të keqen në çdo vend shumëfish më shpejt se në të kaluarën. Thuajse të gjitha shoqëritë, përfshi edhe ato myslimane, janë nën ndikimin e qytetërimit perëndimor të bazuar në kënaqësitë e pashmangshme të egos.

Në ditët tona ekzistojnë të gjitha llojet e gjynaheve që i kanë shkatërruar popujt e mëhershëm, si arroganca dhe tërbimi i popujve të Adit dhe Themudit, tiranitë e Nemrudit dhe Faraonit, imoraliteti i popullit të Lutit, mashtrimet dhe hilet tregtare të popullit të Medjenit dhe Ejkes, etj. E megjithatë Allahu i Madhëruar nuk do ta shkatërrojë njerëzimin në mënyrë masive.

Sepse;

Njëra prej lutjeve që Profeti ynë ﷺ, ka bërë për umeitin e tij, është që të mos shkatërrohej masivisht nga Allahu i Madhëruar. (shih. Muslim, Fiten, 20) Por, e vetmja rrugëzgjdhje në këtë kohë, është:

SHOQËRIMI ME BESNIKËT

Sot, një besimtar duhet ta pyesë veten çdo moment:

Me kë je?



Me kë është bota e zemrës tënde, ndjenjat dhe mendimet e tua, morali dhe sjelljet e tua? Me të kujt ngjajnë ato?

Me kë jemi ne në veprimtaritë e ndryshme gjatë jetës së përditshme? Me kë jemi kur rrimë para televizionit apo internetit?

Për sa kohë që nuk i bëjmë këto llogari, nuk do të mund të ruhemi asnjëherë nga ndikimi i indiferencës dhe devijimit që sulmon nga të gjitha anët si radiacion.

Ky ndikim i përpunon në atë mënyrë zemrat indiferente, saqë një person i pasionuar pas rrymave të modës, humbet ndjenjat më të natyrshme të shijeve dhe estetikës dhe kthehet në një robot të telekomanduar. Për hir të modës dhe trendit, ata mund të kryejnë çdolloj paturpësie dhe ta shkelin me këmbë dinjitetin e tyre njerëzor, duke u kthyer kështu në skllevër të pavetëdijshëm të atyre që i komandojnë.

Nuk duhet harruar se;

Nëse një mysliman nuk arrin të ndërtojë një ambient të përshtatshëm për fëmijët e tij, atëherë ai duhet të largohet prej aty, sepse jeta familjare, edukimi dhe puna duhet të rregullohen duke respektuar parimin e “qëndrimit me besnikët”.

Të ankohesh vazhdimisht për problemet e kohës dhe të shoqërisë dhe të shfaqësh dobësi duke thënë, “s’kemi ç’të bëjmë!”, nuk përshtatet me botëkuptimin e një myslimani të vërtetë.

*Personaliteti
njerëzor besimtar,
i devotshëm,
i mirë dhe i
singertë, të cilin
predikon Kurani,
përfaqësohet nga
Profeti ynë ﷺ, në
formën më sublime.*



Allahu i Madhëruar dëshiron që ne të ndihemi përgjegjës për rrjedhën e ngjarjeve përreth nesh. Ai na urdhëron që në fillim të përmirësojmë veten, e më pas me anë të urdhërimit për punë të mira e ndalimit nga të këqijat, të përpiqemi në përmirësimin e familjes, rrethit dhe shoqërisë sonë. Po ashtu, Allahu dëshiron që ne të jemi prijës edhe në devotshmëri. Në Kuranin Fisnik, na mësohet një lutje e bukur, që konsiderohet si lutja e njerëzve besnikë:

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ
وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“..O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prekje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!..” (Furkan, 74)

Shoqëria përbëhet nga familjet, e familjet nga individët. Nëse individët janë njerëz të mirë e të devotshëm, edhe shoqëria do të jetë e mirë dhe e devotshme. Për edukimin e një brezi të mbarë, ka nevojë për nëna të mira e të devotshme.

Si pasojë e dhembshurisë së natyrshme për fëmijët e tyre, prindërit dëshirojnë të ndërtojnë lumturinë e tyre në të dyja botët. Mirëpo, prindërit e zgjuar dhe të devotshëm, më parë mendojnë për lumturinë e fëmijëve të tyre në botën tjetër, sepse kjo botë është e përkohshme dhe jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër. Nëse ata arrijnë t’u sigurojnë atyre botën tjetër, automatikisht do t’i kenë siguruar edhe këtë botë, ku do të jetojnë të qetë në mendje dhe në shpirt.

عَلَّمَ سَوَاءَ

*Të njohësh, të lexosh,
të jetosh dhe të
përhapësh “moralin e
tij madhështor”, është
besnikëri ndaj tij; është
besnikëri ndaj Allahut
të Madhëruar, i Cili e
dërgoi atë si mëshirë
për botët dhe në një
farë mënyre, është
falënderim për këtë
mirësi të madhe.*

Njëherë, veziri i thotë Omer bin Abdulazizit:

“O prijës i myslimanëve! Shihet qartë se paga që merri nga Bejtu’l-mal, nuk ju mjafton. Urdhëroni të merret më shumë në mënyrë që të kursehen dhe t’i përdorin fëmijët dhe nipërit e tu pasi ju të ndërroni jetë!”

Mirëpo, Omer bin Abdulazizi i dha këtë përgjigje shumë domethënëse:

«Nëse fëmijët e mi që do të lë pas bëhen prej njerëzve të devotshëm, nuk kam frikë se ata do të bien në vështirësi, sepse në Kuran thuhet:

«Në të vërtetë, Mbrojtësi im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të devotshmit.» (A’raf, 196)

Unë nuk shqetësohem për vështirësitë që ata do të hasin në të ardhmen, pasi Allahu i Madhëruar të jetë kujdestari dhe mbrojtësi i tyre!

Por nëse ata bëhen mendjelehtë dhe jo të devotshëm, atëherë, për njerëzit e tillë në Kuranin Fisnik, thuhet:

«Mos ua jepni pasurinë tuaj njerëzve mendjelehtë...» (Nisa, 5)

Atëherë, si mund ta kundërshtoj këtë urdhër hyjnor dhe të mbledh pasuri për fëmijët e mi, nëse ata bëhen mendjelehtë!?” (Ebu’l-Ula Mardin, Huzur Dersleri, Istanbul 1966, II-III, 769-770)

Dobia e dijes, është meditimi që të shpie në devotshmëri. Është drithërima që lind frikën ndaj Allahut. Është aftësia që sjell përkushtimin. Dobia e dijes, është faktori që e afron robin tek Allahut.



Fëmijët që rriten me furnizimin hall-all, edukatën e bukur të baballarëve të tyre të devotshëm dhe lutjet e porositë e nënave të tyre, ata nuk i shkaktojnë shoqërisë asnjë të keqe. Për rrjedhojë, sa më shumë të shtohen besnikët, të devotshmit dhe të mirët në shoqëri, aq më shumë shtohet edhe paqja dhe lumturia e asaj shoqërie.

Nëse analizojmë historinë, do të shohim se:

PËRMIRËSIMI I SHOQËRISË ARRIHET ME ANË TË INDIVIDËVE TË DEVOTSHËM...

Prej sojit të Omerit رضي الله عنه, i cili vlerësoi dhe mori si nuse për të birin vajzën e devotshme që i tha të ëmës: “Edhe pse nuk na sheh kalifi, na sheh Allahu!”, kanë lindur njerëz të devotshëm si Omer bin Abdulazizi. Për rrjedhojë, shoqërisë iu rrit mirëqenia dhe dhurimi për hir të Allahut iu bë shumë i dashur. Si rezultat i kësaj, kishte raste kur guvernatorët i shkruanin qendrës se, “në qytet nuk kishte mbetur asnjë i varfër që mund t’i jepej zekati” dhe kërkonin një zgjidhje për shpërndarjen e zekatit të mbledhur. Atëherë, ato para shpenzoheshin për të liruar robërit.

Nëse krahasojmë të sotmen me të kaluarën, do të shohim se sot janë shtuar së tepërmi problemet psikologjike në jetën individuale dhe problemet ekonomike në jetën familjare. Prandaj, nuk është e çuditshme që shkaqet e këtyre t’i kërkojmë në parimin e shoqërimit me besnikët dhe largimit nga gjynahqarët.

Mevlana: “Për sa kohë që ky shpirt të jetë në këtë trup, unë jam robi, skllavi i Kuranit dhe pluhuri i rrugës së Muhamed Muhtarit صلى الله عليه وسلم...”



Dijetari Xhafer bin Sulejman رحمته الله, e tregonte kështu se ç'kishte fituar nga ndenja dhe shoqërimi me njerëzit e mirë:

“Kur ndjeja ngurtësim në zemër, ngrihesha dhe shkoja menjëherë te Muhammed bin Vasi, merrja pjesë në kuvendin e tij dhe e shihja në fytyrë. Kështu, ngurtësimi i zemrës më kalonte, brenda vetes më vinte entuziazmi i adhurimit, përtesa më largohet dhe me atë gëzim bëja një javë adhurim!”

Nisur nga kjo, ashtu siç prishen shoqëritë nga ndikimi i njerëzve gjynahqarë e të këqij, ashtu përmirësohen edhe nga ndikimi i njerëzve të devotshëm e të mirë.

Për shembull, ata që e nxorën përsëri popullin nga errësitat dhe vorbullat e trendit të imitimit dhe admirimit të kulturës së huaj, ishin njerëzit e devotshëm si Mahmud Sami Ramazanoğlu. Ata shëtiten Anadollin qytet më qytet e fshat më fshat duke i ftuar njerëzit drejt udhëzimit, devotshmërisë dhe sinqeritetit. Në një periudhë kur predikimi i Islamit ishte thujse një ndalesë politike, ata i udhëzuan njerëzit me të cilin qëndronin me gjuhën e trupit dhe të heshtjes.

Ai bëri shumë kujdes në çështjen e kafshatës hallall. Megjithëse mbaroi me nota të shkëlqyera fakultetin e Juridikut, ai nuk e përdori këtë profesion për të siguruar jetesën, sepse kishte frikë nga gjynahet që mund të merrte në sistemin e kohës. Po ashtu, edhe pse vinte nga një familje pasur, ai nuk u mbështet në pasurinë e familjes, por e siguroi jetesën duke punuar si llogaritar.

Nëse dija nuk ka arritur në zemër dhe nuk e ka çuar të zotin drejt frikës ndaj Allahut, edhe pse në teori ai mund të quhet dijetar, në të vërtetë, ai nuk konsiderohet i tillë. E çfarë është një dije e tillë, përveçse huti dhe indiferencë?



Me pak fjalë, ai ishte shembull i mirë në mëshirë, dhembshuri, delikatesë, besnikëri, bujari, kujdes, thjeshtësi, meditim, durim, përpjekje fetare, vullnet, qëndresë në rrugë të drejtë dhe pranim të caktimit të Allahut me gjithë zemër.

Në mënyrë të veçantë, në modesti dhe përulësi...

Kur shkoni për vizitë në shtëpinë e tij bashkë me babanë tim të ndjerë, Musa Efendinë, i nderuari Sami Ramazanoğlu tregohej shumë i zellshëm që të na shërbente personalisht në sofër dhe të na mbante peshqirin pas marrjes së abdesit.

Po ashtu, ai ishte shumë i kujdesshëm në qëndrimin larg atyre që ka ndaluar Allahu dhe dëmeve të tyre shpirtërore. Ai këshillonte shpesh që të mos kalohej asnjëherë nga rrugët ku mbizotëronin bizneset me kamatë dhe pije alkoolike.

Gjatë bisedave të tij, ai shprehej se dija e vërtetë është njohja e Allahut të Madhëruar, duke na e kujtuar përherë nderin e zotërimit të kësaj dijeje.

Për shkak të rëndësisë që ka, po e përsërisim edhe njëherë këtë kujtim të tij:

ARSIMIMI I VËRTETË

Një ditë, një person që kishte ardhur për ta vizituar, dëshironte të merrte duanë e hoxhës së nderuar dhe në të njëjtën



kohë, ta njihte atë edhe me nipërit e vet. Kur hynë brenda, u përshëndetën me selam dhe, duke ia prezantuar nipërit e vet, i tha:

“I nderuar! Këta djem kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Dëshirojmë të marrim edhe duanë tuaj!”

Mirëpo, i nderuari Sami Efendiu, me një buzëqeshje shumë domethënëse, tha:

“Edhe unë i varfri jam diplomuar në Daru’l-Funun/Universitet. Por arsimi i vërtetë, është «marifetullahu / njohja e Allahut!»”

Arsimimi në dijet e tjera, është i vlefshëm, aq sa ato bëhen ndihmëse në arritjen e dijes së vërtetë. Pra, nëse ato e kryejnë e detyrën e bartjes së mendimit prej pasojës tek shkaku apo prej artit tek artisti, vetëm atëherë ato janë dije të dobishme. Përndryshe, ato nuk kanë asnjë dobi në përgatitjen e njeriut për botën tjetër. Madje, ndonjëherë të çojnë edhe drejt gjynaheve dhe dështimeve.

Ne besojmë se shoqëritë mund të arrijnë paqen dhe lumturinë atëherë kur individët e saj tregojnë respekt shpirtëror ndaj Kuranit Fisnik dhe e zbatojnë atë. Përndryshe, nëse njerëzit i kthejnë shpinën Kuranit, nuk e respektojnë dhe tregohen të pabindur ndaj urdhrave dhe ndalesave hyjnore, herët a vonë, shoqëria e tyre do të bjerë në kolaps.

Dija mund të japë fryte të mira për të zotin, vetëm nëse zbret prej veshit e mendjes dhe përpunohet në zemër. Vetëm një dije e tillë mund ta çojë njeriun nga arti tek artisti, prej shkaktari tek shkaktari dhe ta zbukurojë atë me vepra të bukura dhe frikë ndaj Allahut.



Pra, edhe sot, shpëtimi i vetëm prej së keqes së rrugëve dhe të ekrameve, është rëndësia që i jepet Kuranit Fisnik.

Për të ndërtuar një shoqëri të devotshme, është e domosdoshme që fëmijët tanë t'i edukojmë nën dritën e Kuranit dhe Sunetit profetik. Një shembull i bukur i përpjekjeve në këtë drejtim, është edhe puna e Sami Efendisë, i cili në një kohë kur mësimi i fesë konsiderohej i jashtëligjshëm, ai shëtiste me fshat më fshat mbi karroca me kuaj për të predikuar dhe mësuar fenë e Allahut të Madhëruar.

Po sot, kur ne gëzojmë mundësi të mëdha, në ç'nivel është përpjekja jonë në këtë drejtim?

Le të pyesim edhe njëherë?

ME KË SHOQËROHEN FËMIJËT TANË?

Nëse fëmijët tanë shoqërohen me Kuranin Fisnik dhe me Sunetin profetik, atëherë lum si ne!

Nëse fëmijët tanë janë me mësues të devotshëm dhe besnikë, me shokë dhe miq të mbarë, ata do të jenë mëshirë në të dyja botët për prindërit e tyre, sepse ata janë si sada-ka e pandërprerë, që do të vazhdojnë t'u sjellin shpërblime prindërve edhe pas vdekjes...

Por, nëse fëmijët nuk edukohen të jenë të mbarë e të devotshëm, nëse në këtë çështje tregohet neglizhencë dhe indiferecë, këta fëmijë mund të jenë fatkeqësia e tyre si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.



Për këtë arsye, jemi të detyruar të tregojmë kujdes ndaj fëmijëve tanë dhe rrethit të tyre. Dhe, në të njëjtën kohë, duhet të vendosim rregull edhe në jetën tonë, edhe në jetën e tyre, duke i dhënë rëndësi qëndrimit më të shumtë me ta.

Në një nga këshillat e tij, Imam Gazaliu thotë:

“Biri im! Nëse ka diçka për të cilën duhet të bësh kujdes të jashtëzakonshëm, është çështja se me kë shoqërohesh. Dije mirë se, një shportë me mollë të mira, nuk mund ta bëjë të mirë një mollë të prishur midis tyre. Mirëpo, kjo mollë e prishur, mund t’i prishë edhe të tjerat. Për këtë arsye, qëndro gjithmonë me njerëzit e mirë!”

Si frymëzimi që jep qëndrimi me të devotshmit, ashtu edhe indiferenca që të shkakton qëndrimi me gjynahqarët, nuk janë të dukshme. Për këtë arsye, bëhen edhe shumë gabime në kuptimin e së vërtetës. Mirëpo, ashtu siç ndodh në çdo çështje, kur rritet kujdesi në çështjen e shoqërimit me të sinqertët dhe largimit prej gjynahqarëve, shtohen edhe detajet e kriterëve dhe shfaqen shumë gjëra që jo të gjithë mund t’i vënë re. Një shembull i kësaj, është edhe kjo ndodhi mbresëlënëse:

Gratë sahabë në Epokën e Lumturisë, i pyesnin me entuziazëm burrat e tyre: “Cili ajet zbriti sot? Çfarë mësuat nga bisedat e Profetit ﷺ? Na i mësoni edhe neve?”



Baba Sejfiu, ishte një prej admiruesve të Sami Efendisë. Ai ishte i devotshëm dhe kishte urtësi shpirtërore. Ai banonte në Topkapë. Një ditë, ai shkoi në Erenkoj për të vizituar Sami Efendinë. Mirëpo, sapo hyri në shtëpinë e tij, i ra të fikët. Personi që po e priste për ta shoqëruar tek Sami Efendia, i shqetësuar jashtë mase, pasi e solli në vete duke i hedhur ujë, i tha:

“Po thërrasim menjëherë një doktor!”

Mirëpo, Baba Sejfiu, ashtu i këputur si ishte, ndërhyri e tha:

“Jo mor bir! Mos e thërrisni doktorin. Gjendja ime s’ka të bëjë me asnjë sëmundje fizike. Njerëzit gjynahqarë që rastisa rrugës prej Topkapës e deri në Er-enkoj, ma shqetësuan shpirtin. Kur hyra në këtë derë të pastër dhe ndjeva frymëzimin shpirtëror në këtë ambient, zemra ime s’duroi dot më. Edhe pak dhe do të vijë në vete prej begatisë së kësaj atmosfere shpirtërore dhe kujdesit të njeriut të zemrave, Sami Efendisë.”

Kjo ishte gjendja e Stambollit të para 60-70 viteve. Po të krahasohet me gjendjen sotme?!

Sa bukur e ka shprehur Profeti ﷺ, rëndësinë e qëndrimit me të sinqertët dhe ruajtjes nga përzierja me gjynahqarët:

“Shembulli i shokut të mirë dhe atij të keq është si ai që bart aromë të mirë me atë që punon si farkëtar. Mbartësi i aromës së mirë ose do të dhurojë një aromë të mirë, ose do t’ia blesh, ose atij do t’i vijë aromë e mirë. Ndërsa farkëtari, ose do të djegë rrobat, ose do të ngjisë erën e keqe.” (Buhari, Buju, 38)

Po ashtu, me dobi është ta përsëritim edhe njëherë këtë tregim të Sadiut:

Një ditë, një prej miqve të mi më dha një copë balte me aromë të mirë (për pastrim) në hamam. E unë e pyeta baltën me aromë të këndshme:

Shoqëritë mund të arrijnë paqen dhe lumturinë atëherë kur individët e saj tregojnë respekt shpirtëror ndaj Kuranit Fisnik dhe e zbatojnë atë. Përndryshe, nëse njerëzit i kthejnë shpinën Kuranit, nuk e respektojnë dhe tregohen të pabindur ndaj urdhrave dhe ndalesave hyjnore, herët a vonë, shoqëria e tyre do të bjerë në kolaps.



“Ah moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...”

Balta i tha:

“Unë nuk jam as misk, e as amber, por veçse një copë tokë; por gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafili dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin vjen prej atij trëndafili...”

Trëndafili është simboli i Profetit ﷺ. Prandaj, gjëja më e rëndësishme që duhet të mësojë njeriu në shkollën e kësaj jete të përkohshme, është të njohë atë mbret të trëndafilave dhe të përfitojë prej aromës së atij trëndafili të bekuar dhe prej ndje-

sive të tij shpirtërore. Aq sa përfitohet prej vesës së atij trëndafili të trëndafilave, aq fitohet edhe bukuri, butësi e urtësi.

Nga ana tjetër;

Një tjetër pikë që duhet pasur kujdes në lidhje me shoqërimin me të devotshmit, është uniteti i zemrave.

UNITETI I ZEMRAVE ËSHTË KUSHT

Sadi Shirazi e shpreh kështu virtytin e të ndenjurit me njerëzit e sinqertë, si dhe të kundërtën e kësaj, që është një e ardhme fatkeqe:



*I nderuari Imam
Maliku ka thënë:*

*“Sa herë që unë
mësoja përmendësh
një hadith, babai më
jepte një dhuratë. Por
erdhi një kohë që edhe
nëse babai im nuk më
jepte dhuratë, mësimi
përmendësh i haditheve
u kthye në një kënaqësi
për mua.”*

“Kitmiri, qeni i As’habu’l-Kehfit, për shkak se qëndroi me të sinqertët, fitoi një nder aq të madh, sa fama e tij përmendet edhe në Kuran. (shih. Kehf, 18.) Ndërsa gruaja e Nuhut dhe e Lutit (alejhima’s-selam) hynë në Xhehenem për shkak se qëndruan me ata që nuk i zbatonin urdhrat e Allahut.” (shih. Tahrim, 10)

Në fakt, gratë e profetëve Lut dhe Nuh, në dukje ishin bashkë me burrat e tyre që ishin profetë, pra njerëzit më të devotshëm ndaj Allahut. Mirëpo, zemrat e tyre ishin bashkë me gjynahqarët dhe mohuesit. Për rrjedhojë, edhe gjykimi ndaj tyre u vendos në bazë të gjendjes së zemrave që kishin dhe iu tha:


“Hyni në Xhehenem!”

Po ashtu, edhe Asija ishte gruaja e Faraonit. Por besimi dhe devotshmëria e saj ndaj Zotit të vërtetë, e ruajti atë nga ndikimi negativ i Faraonit, sepse zemra e saj ishte bashkë me Musain عليه السلام dhe besimtarët e tjerë.

Mesazhi që duhet të marrim prej këtyre shembujve, është se ne duhet të shoqërohemi të gjithë së bashku me të devotshmit, si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Ne duhet të përpiqemi të vendosim në zemrat e fëmijëve tanë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij عليه السلام.

I nderuari Imam Maliku ka thënë:

“Sa herë që unë mësoja përmendësh një hadith, babai më jepte një dhuratë. Por erdhi një kohë që edhe nëse babai im



Pas namazit të ikindisë, Abdullah Ibn Mubarek i thoshte shpesh xhematit: “Po shkoj të bisedoj me Profetin tonë ﷺ.” Kështu shprehej ai kur shkonte të lexonte hadithe, ose të zhvillonte mësimin e hadithit me nxënësit e tij.

nuk më jepte dhuratë, mësimi përmendësh i haditheve u kthye në një kënaqësi për mua.”

Kështu, Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë), falë metodës së edukimit dhe dashurisë që i injektoi babai i vet, arriti të bëhej një prej Imamëve më të famshëm, themelues i një shkolle juridike dhe autori i veprës së famshme me hadithe autentikë, Muvatta-n, e cila do t'i mbetet trashëgim gjithë umetit Islam deri në ditën e kiametit, si sadaka e pandërprerë.

Abdullah Ibn Mubarek, ka qenë një njeri shumë i devotshëm dhe i dashuruar me Profetin ﷺ. Saherë, pas namazit të ikindisë, i thoshte xhematit: “Po shkoj të bisedoj me Profetin tonë ﷺ.”

Kështu shprehej ai kur shkonte të lexonte hadithe, ose kur zhvillonte mësimin e hadithit me nxënësit e tij.

Pra;

Jetëshkrimin e Profetit tonë ﷺ dhe hadithet e tij, duhet t'i lexojmë me një përkushtim të thellë shpirtëror. Ne duhet t'i lexojmë ato me një pjekuri të tillë shpirtërore, që Allahu i Madhëruar të na falë edhe neve frymëzim shpirtëror sikur të jemi duke kuvenduar me Profetin ﷺ.

I lutemi Allahut të Madhëruar të na fusë në rrugën e atyre të cilëve u ka dhënë mirësi. O Allah! Na bashko ne dhe pasardhësit tanë, me zemër dhe me shpirt, me profetët, besnikët, dëshmorët dhe të devotshmit!..

*“(O i Dashuri Im!)
Nëse shmangesh
nga ata (kur nuk ke
asgjë për të dhënë),
duke shpresuar
në mëshirën e
Zotit tënd; Atëherë
thuaju atyre
ndonjë fjalë të
butë.” (Isra, 28.)*



O Allah! Na bëj pjesë e grupit fatlum që do të jenë bashkë me Profetin ﷺ, në Xhenetin Ala nën Flamurin e Falënderimit!..

Amin!..



Trashëgimia më e veshme që prindërit mund t'u lënë fëmijëve, është personaliteti Islam dhe morali i bukur, që në të njëjtën kohë është edhe një prej detyrave më të shenjta.



MORALI I TIJ MADHËSHTOR



KAFSHATA HALLALL

Çdo kafshatë mbart me vete dosjet e së shkuarës.

A është fituar ajo kafshatë në mënyrë haram apo hallall?

A është dhënë zekati asaj kafshate? A kanë pasur të drejtë trashëgimtarët në të? Në çfarë gjendje shpirtërore ka qenë personi që ka përgatitur ushqimin?

Sepse të gjitha këto ndikojnë në gjendjen shpirtërore të atij që e ha. Nëse ushqimi është hallall, jep ndikim pozitiv në gjendjen shpirtërore të personit. Në të kundërt, e ngarkon personin me energji negative...



KAFSHATA HALLALL

DY ÇËSHTJE QË NDIKOJNË NË PERSONALITETIN E NJERIUT

Në këtë botë, njeriu është në sprovë përgjatë gjithë jetës së vet. Nëse ai ka sukses brenda këtij afati që i është dhënë deri në frymën e fundit, në jetën tjetër pas kësaj, do të shpërblehet me Xhenet. Përndryshe, do të pësojë një dënim shumë të dhembshëm.

Ajo që kërkohet nga njeriu, është një besim i sinqertë, devotshmëri në rrugë të drejtë dhe moral i bukur. Gjendja e njeriut në këto çështje, pasqyron zemrën e tij. Pra, besimi i sinqertë në zemrën tij, reflektohet në veprat e tij të mira, fjalët e drejta dhe të dobishme dhe morali i bukur.

Prandaj, t'i japësh rëndësi zemrës, do të thotë të përpiqesh ta bësh atë të përputhet me kënaqësinë hyjnore.

Çështë ajo që përcakton pjekurinë e zemrës?

Miqtë e Allahut, që janë edhe edukues zemrash, kanë nënvizuar dy elemente që ndikojnë në personalitetin dhe karakterin e njeriut:

- Shoku
- Furnizimi/Rrizku

Allahu i Madhëruar është e vetmia qenie që nuk ka shokë, ortakë apo të ngjashëm. Ai është Një dhe i vetëm. Kurse të gjitha qeniet e tjera, Allahu i ka krijuar të ngjashme dhe të nevojshme për njëra-tjetrën. Kështu, edhe njeriu është një qenie shoqërore, e cila nuk e duron dot vetminë. Për rrjedhojë, ai ndikohet edhe nga njerëzit me të cilët krijon afërsi dhe familjaritet. Ky ndikim është studiuar edhe nga shkencëtarët, të cilët kanë vërtetuar se njeriu ndikohet edhe në mënyrë të pavullnetshme nga njerëzit me të cilët jeton, krijon familjaritet apo i respekton. Neuronet e pasqyrimin në tru, imitojnë sjelljet e të tjerëve dhe i injektojnë ato në personalitetin e njeriut. Në këtë mënyrë, njeriu mund të përvetësojë cilësitë negative ose pozitive të atij me të cilin shoqërohet.

*Mevlana ka thënë:
"Këtë mëngjes, mu
ndërpre frymëzimi.
Kështu e kuptova se
në trupin tim kanë
hyrë disa kafshata të
dyshimta.*



Pasuria materiale e njeriut, merr formë sipas trashëgimisë gjenetike natyrore, prej sojit të tij. Në këtë mënyrë dalin në pah cilësitë e tij fizike, si ngjyra e syve, e flokëve, e lëkurës, etj. Këto cilësi nuk trashëgohen vetëm prej prindërve, por prej të gjithë paraardhësve. Për rrjedhojë, edhe vëllezërit binjakë nuk janë asnjëherë plotësisht të njëjtë me njëri-tjetrin.

Në të njëjtën mënyrë, që kur njeriu ngjizet në mitrën e nënës, tek ai fillojnë

të ndikojnë gjendjet shpirtërore të prindërve, ushqimi që hanë ata dhe zakonet e tyre.

Krahas këtyre, ekziston edhe trashëgimia shoqërore. Çdo fëmijë, mëson nga prindërit dhe shoqëria përreth gjuhën, sjelljet, zakonet dhe stilin e jetesës, të cilat i bën pjesë të jetës së vet me anë të imitimit.

Për këtë arsye, duke aluduar në ndikimin që njeriu merr nga njerëzit me të cilët shoqërohet, në një ajet fisnik urdhërohet:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë/besnikë (në fjalë dhe në vepra)!” (Teube, 119)

Nisur nga kjo, është e domosdoshme që besimtari të bëjë kujdes që të krijojë afërsi dhe familjaritet me njerëzit me të cilët dëshiron të jetë edhe në botën tjetër.

Sa i përket temës sonë, që është ndikimi i ushqimit:

Njeriu është një qenie që ka nevojë të hajë. Trupi i tij ka nevojë për proteina, vitamina dhe minerale që të mbahet gjallë. Nga ky aspekt, njeriu është i njëjtë me krijesat e tjera.

Kurse dallimi mes tyre është se;

Krijesat e tjera, janë të lira në sigurimin e këtyre nevojave. Kurse njeriu është i kufizuar dhe ka përgjegjësi. Pra, krijesat e tjera e mbushin barkun sipas natyrës së tyre pa u kujdesur

Mevlana: “Dija, urtësia, dashuria dhe mëshira, lindin nga kafshata e hallallit. Nëse prej një kafshate vjen gafleti/indiferenca, dije se ajo kafshatë është e dyshimtë ose haram!”



nëse ajo që hanë është hallall apo haram, e drejtë apo e padrejtë. Dikush ha bar, e dikush ushqehet edhe me cofëtina. Kurse njeriu, i cili është krijesa më e nderuar e Allahut, ka përgjegjësinë që të ushqehet me gjëra të pastra dhe hallall. Po ashtu, ai duhet të tregohet i përmbajtur edhe në lidhje me ato që ka mundësi të hajë. Krahas kësaj, ashtu si ai që pasi ha ushqime të pista, me mikrobe apo të helmatisura, sëmuret, e madje edhe vdes, edhe ai që ha ushqime haram, të dyshimta dhe të ndotura në aspektin shpirtëror, pëson dëme të mëdha në zemër. Kjo, sepse kur njeriu ha një lloj ushqimi, cilësitë shpirtërore të atij ushqimi kalojnë në personalitetin dhe karakterin e tij.

Ashtu siç përhap radiacion atomi kur ndahet, ashtu është edhe energjia që del nga zemra. Ashtu siç ekzistojnë rrezet e dobishme që nuk shihen me sy dhe prej tyre ka përfitime në fusha të ndryshme, si mjekësia, teknologjia, etj., ashtu ekzistojnë edhe rrezet e dëmshme që e dëmtojnë rëndë njeriun dhe natyrën. Pra, në saje të këtyre shembujve është shumë e lehtë ta kuptojmë ndikimin shpirtëror të shoqërisë dhe ushqimit.

Çdo kafshatë mbart me vete dosjet e së shkuarës.

A është fituar ajo kafshatë në mënyrë haram apo hallall?

A është dhënë zekati asaj kafshate? A kanë pasur të drejtë trashëgimtarët në të? Në çfarë gjendje shpirtërore ka qenë personi që ka përgatitur ushqimin?

Sepse të gjithë këto ndikojnë në gjendjen shpirtërore të atij që e ha. Nëse ushqimi është hallall, jep ndikim pozitiv

Emir Kulali shprehet:

“Nëse kafshatën e bukës dhe rrobën që vishni e nuk e keni hallall, nuk do t’ia arrini qëllimit edhe sikur ta kaloni gjithë natën me adhurim dhe t’ju hollohet beli nga uria derisa t’i ngjajë një teli violine!”



në gjendjen shpirtërore të personit. Në të kundërt, e ngarkon personin me energji negative...

Nuk duhet harruar se; një kafshë që theret në emër të idhujve, është haram për ne. Po ashtu, edhe ajo që theret nga një ateist është haram. Pra, besimi dhe qëllimi i atij që e pret kafshën, e bën të pangrënshëm edhe mishin që në dukje është shumë i pastër. Në mënyrë të njëjtë, edhe gjendja shpirtërore e atij që përgatit një ushqim, transmetohen tek ai ushqim. Për rrjedhojë, në varësi të gjendjes së atij që e përgatit ushqimin, edhe tek ai që e ha atë, shfaqen gjendje të njëjta. Ky ndikim ndodh jashtë vullnetit të atij që e ha atë ushqim.

Sehl bin Abdullah Tusteri (Allahu e mëshiroftë) thotë:

“Organet që ushqehen me haram, kundërshtojnë urdhrat hyjnor. Kurse organet që ushqehen me hallall, i binden urdhërova hyjnorë dhe janë të prira për bamirësi.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, i cili është shembulli më i mirë për ne në çdo çështje, është i tillë edhe në lidhje me kujdesin ndaj cilësisë haram apo hallall të ushqimit. Ai ka treguar kujdes ndaj kafshatës haram edhe në kohën e injorancës, para se t'i vinte shpallja. Kështu, njëherë, kur u ftua në një sofër në kohën e injorancës, ai nuk e hëngri mishin e servirur, sepse e dinte që ai ishte prerë për hir të idhujve. (Shih. Buhari, Menakibul-Ensar, 24; Zebaih, 16.)

Ndërsa pas shpalljes, shembuj të tillë të pashoq gjen me shumicë. Një natë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte shtrirë në

“Stomaku i njeriut që ha ushqim hallall, është si një hauz ku mbliidhet ujë i pastër.

Prej këtij hauzi rrjedh ujë i pastër përreth dhe falë tij rriten lulet dhe pemët japin fruta.”



shtrat, por nuk kishte fjetur dot deri në mëngjes. Kur e pyetën për shkakun e kësaj, ai tha:

“Kur po përgatitja shtratin, gjeta një hurmë përtokë dhe e vura në gojë. Mirëpo, më pas mu kujtua se në shtëpinë tonë (ndonjëherë) gjenden edhe hurma për sadaka dhe zekat. «Po sikur kjo hurmë të jetë prej atyre!» - mendova deri në mëngjes dhe, për shkak të kësaj u përpëlita sa majtas-djathtas në shtrat e nuk më hyri gjumë në sy.” (Ahmed, II, 193; Hakim, el-Mustedrek, 2/17.)

Një ditë tjetër, nipi i Profetit ﷺ, Hasani, që atëherë ishte i vogël, vuri në gojë një hurmë prej atyre që ishin sadaka. Në atë moment, i Dërguari i Allahut ﷺ, ia nxori menjëherë nga goja dhe u përpoq që ai të mësonte rëndësinë e kafshatës hallall edhe pse ai ishte i vogël.

Njëherë tjetër, kur Resulullahu ﷺ, po kthehej nga një xhenaze që e kishte varrosur, erdhi shërbëtori i një gruaje dhe e ftoi në shtëpi. Profeti ﷺ, iu përgjigj ftesës bashkë me sahabët. U soll ushqimi dhe i Dërguari i Allahut ﷺ, zgjati dorën për të marrë. Më pas, të gjithë ata që ndodheshin në sofër filluan të hanin. Mirëpo, ata vunë re se Resulullahu ﷺ, po e mbante kafshatën në gojë dhe nuk po e gëlltiste. Më pas tha:

“Ky është një mish deleje, që është marrë pa lejen e të zotit!”

Për këtë arsye e lajmëruan menjëherë gruan, e cila erdhi dhe u shpjegoi çështjen:

“O Resulullah! Për të blerë këtë dele, dërgova një njeri në Baki, por nuk arriti të merrte gjë. Fqinji im kishte blerë një dele.

Sami Efendiu ka thënë: “Kushti i parë që njeriut t'i pranohet lutja, është përmirësimi i botës së zemrës me ushqim hallall. Ndërsa kushti i fundit, është sinqeriteti dhe qetësia e zemrës. Pra, orientimi nga Allahu ashtu siç duhet.”



Unë i çova fjalë dhe ia kërkoja atë dele kundrejt çmimit. Mirëpo, për shkak se fqinjin nuk e gjetëm në shtëpi, unë lajmërova gruan e tij, e cila ma dha delen.”

Resulullahu ﷺ, që po dëgjonte këtë ngjarje, tha:

“Jepua ta hanë robërit e luftës!” (Ebu Davud, Buju, 3/3332; Ahmed, V, 293.)

Një nga treguesit e kujdesit ndaj hallallit, është edhe përmbajtja nga ushqimi. Pra të mos e lejosh veten të biesh në grykësi, të mendosh për të tjerët dhe të dhurosh për hir të Allahut...

Tek sahabët e nderuar, u zhvillua një botëkuptim i ri në lidhje me Allahun, gjithësinë dhe veten. Qëllimi i vetëm i tyre ishte t’i ngjanin Resulullahut ﷺ, sikur po vështronin diellin në një pasqyrë të vogël. Ata ishin të përmbajtur. Konsumi i tepërt, grykësia, luksi dhe ekstravaganca ishin një stil jete që mjedisi dhe shoqëria e sahabëve nuk e njihnin. Tek ta u zhvillua botëkuptimi: “Nesër konaku i këtij nefsit do të jetë varri.”

Kjo, sepse edhe teprimi në ushqim dhe pije përtej nevojës, është shpërdorim dhe pengesë që të ndalon të mendosh për nevojtarët dhe dhurimin. Për këtë arsye, jeta e atyre që dëshiruan t’i ngjanin Profetit tonë ﷺ, kaloi përherë duke dhuruar në rrugë të Allahut.

Nëna jonë Aisha ؓ, thotë:

“Që prej ditës kur erdhën në Medinë e deri kur ai ndërroi jetë (Profeti), familja e Muhamedit ﷺ, nuk është ngopur asnjëherë me bukë gruri tri net me radhë.” (Muslim, Zuhd, 20.)

Sami Efendiu ka thënë:
“Nëse kafshata që vihet në gojë nuk është hallall, është e vështirë që ai njeri të jetë i sigurtë, i qetë në shpirt dhe t’i drejtohet Allahut duke e braktisur çdo gjë tjetër.”



Sipas një transmetimi tjetër, nëna jonë Aishe رضي الله عنها, e vazhdon kështu fjalën e vet:

“Po të donim, mund të ngopeshim.”

(Pra kjo uri nuk ishte nga skamja. Neve na vinin dhurata dhe plaçkë lufte.)

“Por i Dërguari i Allahut përmbushte fillimisht nevojat e vëllezërve të tij besimtarë. (Kështu, sa herë na dhurohej diçka, e ndanim për vëllezërit tanë.)” (Bejhaki, Shuab, III/62 1396.)

Ashtu siç e predikoi fenë duke e jetuar, Profeti ynë ﷺ, i ndaloi njerëzit nga harami dhe i ftoi drejt hallallit edhe me fjalët e tij të bekuara:

“O njerëz! Frikësojuni Allahut ashtu siç i ka hije Atij dhe kërkojeni furnizimin/rrizkun në rrugë hallall!”

Sehl bin Abdullah

Tusteri thotë:

“Organet që ushqehen me haram, kundërshtojnë urdhrat hyjnor. Kurse organet që ushqehen me hallall, i binden urdhërova hyjnorë dhe janë të prira për bamirësi.”



Askush nuk do të vdesë pa e marrë rrizkun (që i ka caktuar Allahu).

Prandaj frikësojuni Allahut ashtu siç i ka hije Atij dhe kërkojeni furnizimin/rrizkun në rrugë hallall!

Merrni atë që është hallall dhe lëreni atë që është haram!” (Ibn Maxhe, Tixharet, 2.)

Sa'd bin ebi Uakkas رضي الله عنه, pyeti në lidhje me mënyrat e pranimit të duave. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, iu përgjigj:

“Bëj kujdes që ato që ha të jenë hallall, me qëllim që të pranohen lutjet!” (Taberani, el-Mu'xhemu'l-Eusat, VI, 310.)

EDHE SIKUR TA DI QË DO TË VDES!..

Ebu Bekri رضي الله عنه kishte një shërbyes, i cili punonte, fitonte dhe, një pjesë të fitimeve i sillte në shtëpi. Kështu, edhe Ebu Bekri رضي الله عنه, hante prej gjërave që i sillte ai. Një ditë prej ditësh, shërbyesi i solli Ebu Bekrit رضي الله عنه, gjëra për të ngrënë dhe ai filloi të hante. Në një moment, shërbyesi e pyeti:

- A e di se ç'po ha?

- Jo! Pa na e thuaj ti! - tha Ebu Bekri رضي الله عنه.

Atëherë shërbyesi tha:

- Në kohën e injorancës (paganizmit), megjithëse nuk dija të shtija fall, i pata hedhur fall një burri duke e mashtruar. Sot u takuam me të. Si shpërblim, ai më dha këtë ushqim nga i cili po ha ti tani!

Ebu Bekri futi menjëherë gishtat në fyt dhe nxori jashtë gjithçka që kishte ngrënë! (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 26.)

Sipas një varianti tjetër të këtij rrëfimi, shërbyesi i tha:

- Pse gjithë ky mundim për një kafshatë?

Ebu Bekri رضي الله عنه, iu përgjigj:

“Do ta nxirrja këtë kafshatë edhe sikur ta dija se kishte për të më dalë shpirti bashkë me të!” (Ahmed b. Abdullah et-Taberi, er-Ri-jadu'n-Nadra, II, 140-141.)

Shejh Nakshibendi i jepte shumë rëndësi kujdesit ndaj ushqimit hallall. Ai e prodhonte vetë ushqimin prej produkteve bujqësore.

Ai bënte shumë kujdes që, gjatë punës bujqësore, kafshët, toka, fara, uji dhe të gjitha materialet e tjera, të ishin hallall. Për këtë arsye, shumë dijetarë frekuentonin kuvendet e tij me qëllim që të përfitonin prej frymëzimit shpirtëror të ushqimit të tij hallall.



Këtë kujdes e kishin të gjithë sahabët, që për ne janë si yjet në qiell. Një ditë, kalifit Omer رضي الله عنه, iu servir një gotë qumësht, të cilën pasi e piu, pyeti atë që ia solli:

- Prej nga vjen ky qumësht?

- Isha tek burimi në filan vend. Çobanët kishin sjellë de-
vetë e zekatit për t'u dhënë ujë dhe ma mbushën enën e ujit me
qumësht. Ky është prej atij qumështi.

Sapo e dëgjoji këtë fjalë, Omeri رضي الله عنه, futi menjëherë gishtin
në fyt dhe e nxori qumështin që kishte pirë. (Muvatta, Zekat, 31.)

Madje, ata dëshironin të largonin menjëherë prej vetes ed-

he grimcën më të vogël të haramit që u
ishte ngjitur, sepse harami është pengesë
për çdo zhvillim dhe përfitim shpirtëror.
Kurse kafshata hallall, çon në përparim
dhe çlirim shpirtëror. Për rrjedhojë, edhe
pas fitoreve të të parëve tanë, qëndron ku-
jdesi që ata kanë treguar në këtë çështje.

Kur Sulltan Javuz Selim Hani po
shkonte në fushatën e Egjiptit, e fushoi
ushtrinë në Gebze, në një vend që ishte
përplot me vreshta dhe bahçe. Mirëpo,
para se të niseshin përsëri, Sulltan Javuz
Selimin e shqetësonte një mendim:

“Vallë, mos ndokush prej ushtarëve të
mi ka këputur rrush ose mollë pa lejen e
të zotit?!..”

Për këtë arsye, ai thirri Again e Jeniçe-
rëve dhe e urdhëroi:

*Ja si shprehet Baki Billah
në lidhje me ushqimin:
“Nuk duhet të mjaftohemi
me ushqimin e pakët, por
duhet t'i japim rëndësi
edhe gjendjes hallall të
druve, ujit dhe enëve
me të cilat përgatitet ai
ushqim. Përveç këtyre, ai
që e përgatit ushqimin,
duhet të jetë i vetëdijshëm
se ndodhet para Allahut.
Kjo, sepse prej ushqimit
që përgatitet pa pasur
kujdes në këto çështje,
del një tym i tillë, që i
mbyll të gjitha kanalet e
frymëzimit shpirtëror.”*



“Aga, ky është fermani (urdhri) im! Të kontrollohen të gjitha çantat e jeniçerëve, kalorësve dhe këmbësoresë! Nëse në çantën e dikujt prej tyre gjendet rrush apo mollë, silleni menjëherë para meje!”

Agai i Jeniçerëve veproi menjëherë dhe i kontrolloi të gjitha çantat. Më pas, doli para sulltanit dhe i tha:

“Sulltan! Nuk gjeta asnjë vesh rrush apo mollë të këputur!..”

Javuzi u gëzua shumë nga ky lajm. Dukej sikur ishte çliruar nga ndonjë ngarkesë. Më pas hapi duart dhe falënderoi Allahun duke thënë:

“O Allah! Qofsh pafundësisht i falënderuar dhe i lavdëruar, sepse Ti më ke falur një ushtri që nuk ha prej haramit!..”

Pastaj i drejtohet Agait dhe i thotë:

“Nëse ushtarët e mi do të kishin këputur ndonjë frut pa leje, do të kisha hequr dorë nga fushata e Egjiptit, sepse vendet nuk mund të çlirohen me një ushtri që ha prej haramit!..”

Kafshata hallall bëhet shkak i triumfeve dhe i udhëzimeve në rrugën e Allahut... Njësoj si në këtë shembull:

UDHËZIMI FALË KUJDESIT NDAJ HALLALLIT

Respektimi i të drejtave njerëzore, edhe nëse është kundër interesit personal, është një nga virtytet e larta që e bëjnë të admirueshëm personalitetin njerëzor. Ky kujdes i jashtëzakon-



*Jusuf Hemedani,
nuk hante asnjëherë pa
e përmendur Allahun
dhe thoshte: “Të hash
një kafshatë, do të
thotë të mbjellësh një
farë. Prandaj, është e
domosdoshme që fara
të hidhet në mënyrë
të vetëdijshme dhe me
frymëzim shpirtëror,
që ai ushqim të kthehet
në bindje!”*

shëm që tregojnë personalitet që e jetojnë Islamin në mënyrë të përpiktë, bëhet shkak i udhëzimit të shumë njerëzve.

Babai im i ndjerë Musa Efendi, rëndësinë dhe begatinë e fitimit hallall në tregti dhe të mos përzjerjes së tij me haram, e shpjegonte me këtë ndodhi:

“Kishim një komshi, i cili në fillim ishte jomysliman, por më vonë pranoi Islamin. Një ditë, kur e pyeta se si ishte udhëzuar, ai më tha:

«U bëra mysliman në saje të moralit të bukur tregtar të Molla Rebi-ut, të cilin e kisha fqinj të arës në Axhibadem. Molla Rebiu ishte një person që e siguronte jetesën duke shitur qumësht. Një mbrëmje erdhi tek ne dhe na tha:

Kaderi i parasë:

Ashtu si çdo gjë, edhe paraja ka kaderin e vet. Të gjithë mendojnë se janë vetë ata që i përdorin paratë. Mirëpo, kryesisht vullneti është i parasë, jo pronarit të saj. Me fjalë të tjera, cilësia shpirtërore e parave i jep drejtim personalitetit të njeriut, sepse paraja është si gjarpri; ajo del nga e njëjta vrimë së ka hyrë.



- Urdhëroni, ky qumështi është juaji!

Unë u habita:

- Si ka mundësi? Unë nuk kam kërkuar qumësht nga ju!

Ai njeri i ndjeshëm dhe i mirësjellshëm më tha:

- Unë vura re se njëra nga bagëtitë e mia kishte hyrë në kopshtin tuaj dhe po kulloste pa dijeninë time. Prandaj ky qumësht është juaji! Por jo vetëm kaq. Unë do të vazhdoj t'juaj sjell qumështin e bagëtisë gjersa bari që ka ngrënë te ju t'i dalë plotësisht jashtë trupit!..

Unë ia prita:

- Çështë ajo fjalë komshi? E çfarë hëngri? Bar! I qoftë hallall!..

Por, Molla Rebiu s'u bind! Ai nguli këmbë në të vetën dhe tha:

- Jo, jo, gjë që s'bëhet! Qumështi i saj është haku juaj!..

Kështu, ai vazhdoi të na sjellë qumësht derisa kafshës i mbaroi cikli i tretjes së ushqimit.

Ja pra, sjellja e atij njeriu të bekuar më preku jashtë mase. Si rezultat, kjo m'i largoi perdet e padijes dhe indiferencës mbi sytë e mi dhe brenda meje lindi dielli i udhëzimit! Thashë me vete:

Feja e një njeriu me një moral kaq të lartë, pa dyshim që është një fe e lartë! Nuk mund të dyshohet mbi vërtetësinë e një feje që edukon njerëz të tillë kaq delikatë, të drejtë, të përkryer e të pastër!

Më pas shqiptova Dëshminë Islame dhe u bëra mysliman!»

Të gjitha këto, janë shembujt më të sinqertë dhe më të gjallë të cilësisë së devotshmërisë, pra, të largimit prej haramit dhe të dyshimtave. Kjo cilësi që reflektohet prej Profetit tonë ﷺ, është edhe cilësia e pandashme e miqve të Allahut.

Ja si shprehet Baki Billah në lidhje me ushqimin:

“Nuk duhet të mjaftohemi me ushqimin e pakët, por duhet t'i japim rëndësi edhe gjendjes hallall të druve, ujit dhe enëve me të cilat përgatitet ai ushqim. Përveç këtyre, ai që e përgatit ush-

Nëse paraja është fituar në rrugë haram, edhe shpenzimi i saj do të jetë në të njëjtën rrugë. Po ashtu, e njëjta gjë ndodh edhe nëse është fituar në rrugë të dyshimta. Por, nëse është fituar në rrugë hallall, paraja bëhet shkak i mirësive dhe begatave të shumta.



qimin, duhet të jetë i vetëdijshëm se ndodhet para Allahut. Kjo, sepse prej ushqimit që përgatitet pa pasur kujdes në këto çështje, del një tym i tillë, që i mbyll të gjitha kanalet e frymëzimit shpirtëror.”

Siç shihet, përveç kriterit hallall-haram të ushqimit, në gjendjen shpirtërore të njeriut, në veprat dhe në adhurimet e tij, ndikon edhe atmosfera shpirtërore me të cilën janë gatuar ato. Kjo gjë e tregon qartë qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj ushqimeve. Mevlana ka thënë:

“Këtë mëngjes, mu ndërpre frymëzimi. Kështu e kuptova se në trupin tim kanë hyrë disa kafshata të dyshimta. Dija, urtësia, dashuria dhe mëshira, lindin nga kafshata e hallallit. Nëse prej një kafshate vjen gafleti/indiferenca, dije se ajo kafshatë është e dyshimtë ose haram!”

Zhvillimi i industrisë, përveç përfitimeve të saj materiale, rrit në mënyrë të vazhdueshme edhe indiferencën e njerëzve ndaj fesë. Komoditeti dhe luksi e largojnë njeriun nga mendimi për botën tjetër. Televizioni, interneti, reklamat dhe moda po i bëjnë njerëzit si robotë. Si rezultat i këtyre, po i lihet lamtumira dashurisë dhe urtësisë.



Ndërsa Jusuf Hemedani, nuk hante asnjëherë pa e përmendur Allahun dhe thoshte:

“Të hash një kafshatë, do të thotë të mbjellësh një farë. Prandaj, është e domosdoshme që fara të hidhet në mënyrë të vetëdijshme dhe me frymëzim shpirtëror, që ai ushqim të kthehet në bindje!”

Po ashtu, edhe Shejh Nakshibendi i jepte shumë rëndësi kujdesit ndaj ushqimit hallall. Ai e prodhonte vetë ushqimin prej produkteve bujqësore. Ai bënte shumë kujdes që, gjatë punës bujqësore, kafshët, toka, fara, uji dhe të gjitha materialet e tjera, të ishin hallall. Për

këtë arsye, shumë dietarë frekuentonin kuvendet e tij me qëllim që të përfitonin prej frymëzimit shpirtëror të ushqimit të tij hallall.

Një ditë, i gjendur në zonën e quajtur Gadivetë, i sollën ca ushqim për të ngrënë. Nakshibendiu e refuzoi duke u shprehur:

“Nuk është e përshtatshme të konsumojmë këtë ushqim, sepse është gatuar me zemërim. Personi që ka situr miellin, që ka gatuar e pjekur brumin, ka qenë i zemëruar.”


Po ashtu, edhe Sami Efendiu, e shprehte kështu rëndësinë e kafshatës hallall në jetën e adhurimit:

“Kushti i parë që njeriut t’i pranohet lutja, është përmirësimi i botës së zemrës me ushqim hallall. Ndërsa kushti i fundit, është sinqeriteti dhe qetësia e zemrës. Pra, orientimi nga Allahu ashtu siç duhet. Nëse kafshata që vihet në gojë nuk është hallall, është e vështirë që ai njeri të jetë i sinqertë, i qetë në shpirt dhe t’i drejtohet Allahut duke e braktisur çdo gjë tjetër.”

“Ashtu siç është e rëndësishme që t’i kushtohet vëmendje fitimit në rrugë hallall, ashtu duhet qëndruar edhe larg ushqimit të dyshimtë. Është shumë e domosdoshme t’i jepet rëndësi gjendjes hallall të ushqimit, duke u ruajtur nga ngrënia nëpër vende të pasigurta.”

ËSHTË KUSHT

Sipas një hadithi fisnik, adhurimi i bërë pasi ke ngrënë ushqim haram, i ngjan namazit pa abdest. Pra, nëse nuk je



E vetmja frymë shpirtërore që mund të na shpëtojë, është trashëgimia e shenjtë e Hiras, Seurit dhe Hutbes së Lamtumirës:

1. Lexo me emrin e Zotit tënd Krijues!..
2. Mos u hidhëro; Allahu është me ne!
3. Kurani dhe Suneti...

pastruar dhe nuk ke marrë abdes, sado namaz të falësh, është e kot. E njëjtë me këtë, edhe adhurimet e një trupi të mbushur me ushqim haram, nuk pranohen tek Allahu i Madhëruar. Një shembull i kësaj është edhe ky:

Kur përfundoi ndërtimi i Xhamisë Sulejmanije dhe kompleksit të saj, Sulltan Sulejman Kanuni i mblodhi të gjithë, që nga arkitekti deri tek punëtori më i thjeshtë dhe u tha:

“O vëllezër në fe! Kjo xhami u përfundua me lejen e Allahut. Nëse gabimisht, ndokush prej jush nuk e ka marr rrogën, le të vijë ta marrë! Mundet që ai të mos jetë i pranishëm. Prandaj ju lutem juve që jeni të pranishëm, t’i lajmëroni ata që nuk janë, që të vijnë ta marrin të drejtën e tyre prej nesh!”

Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar, është i pastër dhe pranon vetëm të pastërit. Atë që ua ka urdhëruar profetëve, ua ka urdhëruar edhe besimtarëve. Allahu i ka urdhëruar profetët:

*Abdullah ibn Omeri
ﷺ, ka thënë: “Nëse nuk
shmangeni nga haramet
dhe gjërat e dyshimta,
Allahu nuk do t’jua
pranojë adhurimet,
edhe nëse dobësoheni e
kërruseni si hark duke
falur namaz, edhe
nëse treti e bëheni si
gozdë duke agjëruar!”*



“O të Dërguar! Hani prej gjërave të pastra dhe hallall dhe bëni punë të mira!” (Mu’minun, 51.)

Po kështu, edhe besimtarët:

“O ju që keni besuar! Nga furnizimi që ju kemi dhënë, hani atë që është e pastër!” (Bekare, 172.)

Ka prej atyre që luftojnë për një kohë të gjatë në rrugën e Allahut. Pastaj, me trup të rraskapitur, kokë e këmbë të pluhurosur, ngrenë duart drejt qiellit dhe lutën:

«O Zot! O Zot!» Mirëpo ata kanë ngrënë e kanë pirë haram. Por, si mund të pranohet lutja e njerëzve të tillë?» (Muslim, Zekat, 65.)

Të gjitha adhurimet dhe mirësitë, duhet të bëhen me pasuri hallall, sepse përfitimi shpirtëror prej këtyre adhurimeve, arrihet vetëm në saje të ushqimit hallall me të cilin ushqehet trupi. Ky hadith fisnik, na e shpjegon shumë qartë rëndësinë e pasurisë hallall në kryerjen e adhurimit të haxhit:

“Kush e viziton këtë Shtëpi (Qaben) me paratë që i ka fituar në mënyrë të ndaluar, ka devijuar nga nënshtrimi ndaj Allahut. Kur një njeri i tillë vendos të bëjë haxhin, të veshë ihramin, të hipë e të lëvizë devenë e tij dhe të thotë: “Lebbejk Allahumme lebbejk”, nga lart i vjen një zë që i thotë:

«Për ty nuk ka as lebbejk e as sa’dejk! Sepse ti e ke fitimin haram, furnizimin haram dhe kafshën haram. Kthehu mbrapsht pa marrë asnjë sevap! Mërzitu ngaqë do përballesh me diçka që nuk do të pëlqejë!»...” (Hejthemi, III, 209-210.)

Faktin që tek Allahu nuk pranohet kurrë pasuria e fituar në mënyrë haram, e shpreh shumë bukur kjo ndodhi e përjetuar në kohën e Profetit tonë ﷺ:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Allahu Fuqiptotë dhe i Madhëruar ju ka bërë haram adhurimin e idhujve, pirjen e alkoolit dhe përçmimin e (njerëzve) për shkak të prejardhjes së tyre. Kini kujdes, sepse me të vërtetë

“Padyshim se hallalli dhe harami janë të qartë. Midis këtyre të dyjave ka disa gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, ka ruajtur fenë dhe nderin e vet...”

(Buhari, Iman, 39.)



është mallkuar ai që e pi alkoolin, ai që e prodhon, ai që ua servir atyre që e pinë, ai që e shet dhe ai që ushqehet me paratë (e alkoolit).”

Nisur nga këto fjalë, një beduin u ngrit në këmbë, shkoi te i Dërguari i Allahut, ﷺ, dhe e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! Unë më parë kam qenë një tregtar që shisja alkool, prej të cilit kam mbledhur një sasi pasurie. Nëse tani e harxhoj këtë pasuri në rrugën e bindjes ndaj Allahut, a ka dobi për mua?”

Profeti ﷺ, i tha:

“Edhe nëse e harxhon atë pasuri për haxh, xhihad apo lëmshë, te Allahu nuk ka vlerë as sa një krah i mushkonjës, sepse Allahu pranon vetëm atë që është e pastër.”

Në të shkuarën, nëpër restorante, ushqimet nuk ekspozoheshin në vitrinë, por mbuloheshin me perde, me qëllim nëse kalonte ndonjë i varfër, të mos ndihej keq për faktin se nuk kishte mundësi për atë ushqim.



Nisur nga kjo ngjarje, Allahu Teala zbriti këtë ajet fisnik për ta vërtetuar fjalën e të Dërguarit të Tij, ﷺ:

“Thuaj: “Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes. Prandaj kijeni frikë Allahun, o njerëz me intelekt, me qëllim që të shpëtoni.” (Maide, 100.) (Uahidi, Esbabu Nuzul, fq. 212-213; Kivamu’s-sunne, et-Tergib ue’t-terhib, II, 96/1235)

Të urtët kanë thënë:

“Nëse dëshiron të dish se në ç’mënyrë e ke fituar pasurinë shiko se ku shpenzohet ajo!”

Kjo, sepse paraja është si gjarpri, i cili del nga e njëjta vrimë që ka hyrë. Pra, paraja e fituar në rrugë haram, shkon përsëri në ambientet haram, edhe nëse dhurohet për hir të Zotit. Këtë fakt e tregojnë shumë bukur kjo ndodhi:

Një prej nxënësve të Ebu Abbas Nihavendin, që merrej me tregti, e pyeti atë se kujt duhej t'ia jete zekatin.

“Jepja atij që të thotë zemra!” – iu përgjigj ai.

Pasi largohet nga mësuesi i tij, nxënësi takon në rrugë një lypsar të verbër. Atij i vjen keq për të, nxjerr nga xhepi një qese me florinj dhe ia jep si zekat. Lypësi i verbër, pasi e kontrollon mirë qesen dhe bindet se ajo është plot e përplot, largohet gjithë gëzim prej aty. Të nesërmen e asaj dite, nxënësi në fjalë kalon në të njëjtën rrugë dhe sheh se i verbëri i djeshëm, të cilin i kishte dhënë zekatin ishte duke folur me një shok të tij, i cili ishte gjithashtu i verbër. Nga biseda që po bënin dy shokët e verbër, atij i zuri veshi këto fjali:

“Dje, një njeri fisnik më dhuroi një qese plot me florinj. Kurse unë shkova në pijetore dhe piva për qejfin tim...”

Kjo gjë e mërziti shumë nxënësin. Ai shkoi menjëherë tek Ebu Abbasi. Sapo arriti atje, ende pa filluar t'ia sqarojë mësuesit të vet meselenë, Ebu Abbasi kërkoi prej tij që t'ia dhuronte personit të parë që do të haste në rrugë një shumë parash, të cilën e kish fituar nga shitja e një qylafi.

Nxënësi largohet menjëherë për të kryer detyrën që i la mësuesi. Ashtu siç qe porositur, shumë e parave ia dhuroi

*“...Tregohuni
vigilentë! Në trup
ndodhet një copë
mishi, e cila nëse
është e mirë, i gjithë
trupi është mirë.
Por, nëse ajo është e
prishur, i gjithë trupi
prishet. Bëni kujdes!
Ajo (copë mishi)
është zemra.”* (Buhari,
Iman, 39.)



njeriut të parë që takoi në rrugë. Më pas, u bë kurioz dhe filloi ta ndjekë atë nga pas. Burri në fjalë hyri në një rrënojë aty afër. Nxori nga rrobat e tij një thëllëzë të ngordhur dhe e la aty. Teksa ai po largohej prej aty, nxënësi i doli përpara dhe e pyeti:

- O njeri! Më thuaj çfarë po ndodh, pashë hatrin e Zotit! Çfarë është kjo thëllëzë e ngordhur që sapo hodhe këtu?

Kur pa përballë njeriun që pak më parë i kishte dhuruar shumën e parave, burri tha me zërin që i dridhej nga emocionet:

- Tash shtatë ditë nuk kam mundur të siguroj kurrfarë ushqimi për fëmijët e mi. Unë dhe gruaja po e duronim urinë, por fëmijët nuk ishin në gjendje të duronin më!.. Megjithatë, s'më bëhej të dilja për të lypur. Duke u sjellë andej këndeje me gjithë këtë shqetësim, gjeta në rrugë këtë thëllëzë të ngordhur. Në pamundësi për të siguruar ndonjë ushqim tjetër, mendova ta çoja në shtëpi këtë shpend të ngordhur prej ditësh. Ndërkohë,

po i lutesha Allahut me gjithë shpirt: "O Zoti im, më ndihmo të dal nga kjo gjendje kaq e vështirë!". Pastaj, para syve të mi u shfaqe ti. Unë e falënderova Zotin me të gjithë forcën e shpirtit dhe e flaka atë shpend të ngordhur që do ta hanim të detyruar. Tani do të shkoj në pazar dhe do t'i blej familjes diçka për të ngrënë me atë shumë parash që më dhurove ti.

Shumë i çuditur nga kjo situatë, nxënësi vrapoi drejt mësuesit të tij shpirtëror. Kur nxënësi arriti te Ebu Abbasi, ky i fundit nuk i dha fare kohë të shpjegohej, por i tha:

"Do të vijë një kohë e tillë që, njeriut nuk do t'i interesojë aspak nëse pasurinë e ka fituar hallall apo haram!" (Buhari, Buju, 7, 23.) E, për fat të keq, duket sikur ajo kohë ka ardhur tashmë...



“O biri im! Nga e gjithë kjo histori, unë po kuptoj se gjatë punës tënde ti nuk paske treguar kujdes të veçantë ndaj gjërave të dyshimta ose gjërave haram. Kështu që, edhe pse ti u përpoqe të zgjidhje të varfrin, zekati yt shkoi për konsum vere. Gjërat, ashtu siç fitohen, po ashtu edhe largohen nga dora jonë. Urtësia, e cila bëri të mundur që ajo shumë parash të arrinte te i varfëri i vërtetë, qëndron në faktin se ato para ishin krejt hallall...”

Ndërsa Abdullah ibn Omeri رضي الله عنه, në lidhje rëndësinë e kafshatës hallall, na e tërheq vëmendjen me këto fjalë:

“Nëse nuk shmangeni nga haramet dhe gjërat e dyshimta, Allahu nuk do t’jua pranojë adhurimet, edhe nëse dobësoheni e kërruseni si hark duke falur namaz, edhe nëse treteni e bëheni si gozhdë duke agjëruar!”

Po ashtu, edhe Emir Kulali, shpreh të njëjtën të vërtetë me këto fjalë:

“Nëse kafshatën e bukës dhe rrobën që vishni e nuk e keni hallall, nuk do t’ia arrini qëllimit edhe sikur ta kaloni gjithë natën me adhurim dhe t’ju hollohet beli nga uria derisa t’i ngjajë një teli violine!”

“Që zemra, gjuha dhe trupi të jenë të pastër, varet nga kafshata hallall. Dijeni mirë këtë! Stomaku i njeriut që ha ushqim hallall, është si një hauz ku mbledhet ujë i pastër. Prej këtij hauzi rrjedh ujë i pastër përreth dhe falë tij rriten lulet dhe pemët japin fruta.”

Kafshata haram është pengesë për çdo zhvillim dhe përfitim shpirtëror. Kurse kafshata hallall, çon në përparim dhe çlirim shpirtëror.



ËSHTË E DETYRUESHME TË LARGOHEMI EDHE PREJ TË DYSHIMTAVE

Në fenë tonë, haramet dhe hallallet janë bërë të qarta! Megjithatë, ka edhe shumë situata kur diçka, që në dukje është hallall, mund të ketë disa anë të dyshimta. Prandaj, nëse njeriu nuk ruhet prej të dyshimtave, s'mund të rrijë mjaftueshëm larg harameve.

Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Padyshim se hallalli dhe harami janë të qartë. Midis këtyre të dyjave ka disa gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë.

Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, ka ruajtur fenë dhe nderin e vet. Ndërsa ai që zhytet në gjëra të dyshimta, bie në haram. Nëse çobani i kullot bagëtitë afër një vendi të mbrojtur (ku është e ndaluar të hyhet), ato mund të hyjnë aty në çdo moment.

Dërguari i Allahut ﷺ,
ka thënë: “Allahu i
Madhëruar, është i pastër
dhe pranon vetëm të
pastrit. Atë që ua ka
urdhëruar profetëve,
ua ka urdhëruar edhe
besimtarëve. Allahu i ka
urdhëruar profetët: “O të
Dërguar! Hani prej gjërave
të pastra dhe hallall
dhe bëni punë të mira!”
(Mu'minun, 51.)



Dijeni se çdo sundimtar ka një vend të mbrojtur (vetëm për veten). Bëni kujdes! Vendi i mbrojtur i Allahut janë gjërat që ai ka bërë haram.

Tregohuni vigjilentë! Në trup ndodhet një copë mishi, e cila nëse është e mirë, i gjithë trupi është mirë. Por, nëse ajo është e prishur, i gjithë trupi prishet. Bëni kujdes! Ajo (copë mishi) është zemra.” (Buhari, Iman, 39, Muslim, Musakat, 2996.)

Fakti që Profeti ynë ﷺ, flet për zemrën menjëherë pas paralajmërimit për

vigjilencë ndaj “gjërave të dyshimta”, është shumë domethënës; një zemër me besim të shëndoshë, e pacenuar nga haramet dhe të dyshimtat, shqetësohet nga gjërat e dyshimta dhe të paqarta. Për këtë arsye, në një hadith fisnik thuhet:

“Edhe nëse të japin fetva, ti shih zemrën tënde (dëgjo zërin e ndërgjegjes)!”
(Ahmed, IV, 194.)

Nëse njeriu i mbyll zërin ndërgjegjes, e verbon zemrën dhe bie në gjëra të dyshimta, rënia e tij në haram nuk është e largët. Në një hadith fisnik, tregohet për gjendjen e njerëzve në kohën afër kiame-tit:

“Do të vijë një kohë e tillë që, njeriut nuk do t’i interesojë aspak nëse pasurinë e ka fituar hallall apo haram!” (Buhari, Buju, 7, 23.)

E, për fat të keq, ajo kohë duket sikur ka ardhur, sepse;

Në kohën tonë, sidomos në fushën e trashëgimisë është shfaqur një pakënaqësi ndaj caktimit të Allahut të Madhëruar. Prandaj, në këtë çështje duhet të bëjmë kujdes nga përfitimi haram dhe padrejtësia ndaj të tjerëve, sepse në vazhdim të ajeteve që sqarojnë çështjen e trashëgimisë, gjenden paralajmërimi të rënda hyjnore:

“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14)

*Dua profetike:
“O Allah! M’i bëj
të mjaftueshme
ato që më ke bërë
hallall dhe më ruaj
nga ato që ke bërë
haram!.. Më bëj të
panevojshëm ndaj të
tjerëve përveç Teje!”*

(Tirmidhi, Dua, 110.)



KOHA AFËR KIAMETIT

Përzierja e haramit në fitim dhe ushqim, shkatërron si këtë botë, ashtu edhe botën tjetër. Individët, familja dhe shoqëria, si pasojë e ndikimit negativ të ushqimit haram dhe të dyshimtë, po humbasin cilësitë e humanizmit dhe po zhyten përherë e më tepër në errësitat e egoizmit. Indiferenca, hutia, arroganca dhe pasivizimi që po rritet brez pas brezi, vjen si rezultat i moskujdesit ndaj ushqimit me të cilin ushqejmë fëmijët tanë. Vrasjet, dhuna, imoraliteti, arroganca, koprracia, zemër ngurtësia, etj., janë të gjitha sëmundje shpirtërore dhe, shkak i tyre janë ushqimet haram dhe të dyshimta që hyjnë në trup si viruse apo mikrobe, duke shkatërruar zemrat tona.

Mirëpo, në të kaluarën tonë të ndritur, shohim edhe shembuj të atillë ku, krahas kujdesit ndaj kafshatës hallall, janë mar-

rë masa që edhe ushqimi hallall të mos ekspozohet në sytë e atyre që nuk kanë, me qëllim që të mos u hyhet në hak. Për shembull, nëpër restorante ushqimet nuk ekspozoheshin në vitrinë, por mbuloheshin me perde, me qëllim që nëse kalonte ndonjë i varfër, të mos ndihej keq për faktin se nuk kishte mundësi për atë ushqim.

Në shtëpitë ku hyjnë produkte të kultivuara pa hile, të blera me para hallall, të peshuara me sinqeritet, të përgatitura me bismillah, me dua dhe zemër të qetë, u japin frymëzim dhe energji shpirtërore atyre që i konsumojnë.

Mirëpo, në ditët tona mbizotëron një tablo shumë e zymtë. Sot është harruar ha-

Ushqimet e përgatitura pa përmendur emrin e Allahut dhe të mbushura me lloj-lloj kimikatesh, po e fusin zemrën e njerëzve në një vorbull ku po humbasin karakterin, mendimin dhe shëndetin...



ku i syrit dhe aty ku shiten ushqime, gëlojnë reklamata joshëse dhe konkurruese që tërheqin sytë e të gjithëve. Vitrinat e mbushura me ushqime, ekspozohen pa u shqetësuar fare për ndjenjat e nevojtarëve, të uriturve, jetimëve dhe të dobëtëve.

Po ashtu, problemet psikologjike që në të kaluarën kanë qenë të pakta, sot po shtohen dita ditës. Aq, sa edhe njerëzit e pasur dhe të zhytur në luks, po përjetojnë stres dhe depresion si pasojë e humbjes së jetës shpirtërore...

Nga një anë shtohet grykësia, e në anën tjetër uria...

Nga një anë shtohet shpërdorimi, e në anën tjetër koprracia...

Ushqimet e përgatitura pa përmendur emrin e Allahut dhe të mbushura me lloj-lloj kimikatesh, po e fusin zemrën e njerëzve në një vorbull ku po humbasin karakterin, mendimin dhe shëndetin...

Të gjithë e dimë se për shkak të çmimit të lirë, mishi dhe produktet e derrit po përzihen gjithmonë e më shumë në ushqimet tona. Por, çështje më e keqja, shumë prodhues nuk e deklarojnë saktësisht përmbajtjen e ushqimeve. Për rrjedhojë, myslimanët duhet të bëjnë shumë kujdes në këtë çështje dhe nuk duhet të blejnë asnjë artikull që nuk ka të paktën certifikatën "hallall".

Ashtu si ushqimi, edhe fitimi po përzihet përditë e më tepër me haramin dhe të dyshimtat. Interesi bankar ka hyrë në portofolin e njerëzve në saje të kartave të kreditit. Kumari po kon-

Ashtu si ushqimi, edhe fitimi është po përzihet përditë e më tepër me haramin dhe të dyshimtat. Interesi bankar ka hyrë në portofolin e njerëzve në saje të kartave të kreditit. Kumari po konsiderohet thjesht një lojë. Sytë janë bërë të papërgjegjshëm dhe përzjerja gjinore është shtuar në çdo fushë...



siderohet thjesht një lojë. Sytë janë bërë të papërgjegjshëm dhe përzierja gjinore është shtuar në çdo fushë...

Dhe, mënyra e vetme për të shpëtuar prej kësaj, është përsëri Profeti ynë ﷺ...

RRUGËZGJIDHJA: KAPJA PAS SUNETIT TË TIJ...

T'i ngajmë atij në çdo fushë të jetës; në kujdesin ndaj haremit dhe hallallit, në vetëmjaftueshmëri, në dhurim, në solidaritet, në moral dhe bindje ndaj Allahut...


Të lutemi si ai:

“O Allah! M’i bëj të mjaftueshme ato që më ke bërë hallall dhe më ruaj nga ato që ke bërë haram!.. Më bëj të panevojshëm ndaj të tjerëve përveç Teje!” (Tirmidhi, Dua, 110.)

Amin!..



Çdo besimtar, është përgjegjës për besimtarët e tjerë. Ai është përgjegjës edhe për predikimin e Islamit me fjalë dhe vepra dhe për ndërtimin e institucioneve të nevojshme për shoqërinë Islame, si xhamitë, shkollat, spitalet, etj.





MBËSHTETJA TEK ALLAHU DHE VETËMJAFTUESHMËRIA

Profeti ynë ﷺ, na paralajmëron me këto fjalë:

“...Betohem në Allahun se, unë nuk kam frikë nga varfëria për ju. Unë kam frikë se bota do t’ju shtrohet para, ashtu siç u është shtruar atyre përpara jush, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe, bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.”

(Buhari, Rikak, 7, Xhizje, 1; Muslim, Zuhd, 6.)



MBËSHTETJA TEK ALLAHU dhe VETËMJAFTUESHMËRIA

KËRKO VETËM PREJ ALLAHUT!

Ai që e ka krijuar njeriun, e ka furnizuar dhe i ka siguruar çdolloj nevoje materiale dhe shpirtërore, është Allahu i Madhëruar. Ashtu si të gjitha krijesave të Tij, Zoti ia ka garantuar furnizimin edhe njeriut. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (Ankebut, 60)

Për shembull, foshnjat nuk mund ta sigurojnë vetë furnizimin e tyre. Por Allahu i furnizon ato me anë të prindërve të tyre. Në të njëjtën mënyrë ndodh edhe në botën e kafshëve.

Shkurt, furnizimi i çdo gjallese i takon Allahut!

Por pavarësisht këtyre të vërtetave, njeriu, i cili ka ardhur i zhveshur në këtë botë dhe do të ikë i veshur vetëm me qefin, shqetësohet jashtë mase për rrizkun e vet. Dhe, shkak i këtij shqetësimi pavend, është pëshpërimita e egos së vet.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”

(Kaf, 16.)

Bota e brendshme e njeriut që nuk arrin ta zgjidhë problemin e egos së vet, është e mbushur me vesvese, shqetësime dhe pandehma në këtë çështje. Njeriu i dobët që kaplohet nga këto shqetësime, afatin e jetës që i është dhënë për të fituar botën tjetër, e shpenzon për të arritur gjëra të përkohshme. Për shkak të materializmit, shumë njerëz braktisin parimet e tyre morale e shpirtërore. Ky është një vetëmashtrim shumë i hidhur. Madje është budallallëk, sepse kjo i ngjan atij që heq dorë nga deti për të fituar ca pika ujë.

Kjo botë është një vend sprove për njeriun. Mirëpo, njeriu, i cili është krijuar i dobët dhe prirë pas dëshirave të egos dhe interesit vetjak, mashtrohet pas kënaqësive të përkohshme të kësaj bote dhe shkatëron lumturinë e botës tjetër.

Bota e brendshme e njeriut që nuk arrin ta zgjidhë problemin e egos së vet, është e mbushur me vesvese, shqetësime dhe pandehma në këtë çështje. Këtë fakt, Sadi Shirazi e shpreh me këto fjalë: “Njeriu; një pikë gjak, mijëra shqetësime”



Me qëllim që ta paralajmërojë njerëzimin ndaj këtij gabimi të rëndë, Allahu i Madhëruar ka dërguar libra dhe profetë. Një e treta e Fjalës së fundit hyjnore, Kuranit, flet për botën tjetër dhe e fton njerëzimin të zgjedhë ahiretin, të ruhet nga Xhehenemi dhe të përgatitet për Xhenetin.

Kështu, edhe profetët dhe njerëzit e devotshëm kanë treguar me shembullin e tyre personal faktin që bota tjetër është më e rëndësishme se kjo botë.

Për shembull, edhe Sulejmani عليه السلام, i cili arriti një sundim që nuk e ka gëzuar dhe

nuk do ta gëzojë askush në këtë botë, nuk u lidh me zemër pas kësaj bote. Ai nuk e harroi për asnjë çast nevojën për Allahun dhe veten e ka konsideruar të varfër. Kur ngrihej në mëngjes, shkonte tek të varfrit e nevojtarët, ulej me ta me modesti të madhe dhe thoshte:

“I varfri i ka hije të varfrit.”

Njëherë, Sulejmani عليه السلام, po kalonte në një vend me ushtrinë e vet, të përbërë prej njerëzve, xhinëve dhe shpendëve. Kur arriti në Luginën e milingonave, një prej tyre, e vuri re ushtrinë e Sulejmanit عليه السلام dhe u thirri milingonave të tjera:

“..O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!” (Neml,18)

Sulejmani عليه السلام, i cili e njihte gjuhën e kafshëve, i dëgjoji këto fjalë dhe tha:

“Jo, pushteti im është i përkohshëm! Edhe jeta ime e kësaj bote është e kufizuar. Ndërsa lumturia hyjnore që i sjell dikujt Kelime-i Teuhid, është e pafund!”

SHEMBULLI MË I LARTË

Edhe Profeti ynë ﷺ, ashtu si për çdo çështje, është shembulli më i lartë në lidhje me mbështetjen tek Allahu dhe vetëmjaftueshmërinë. Gjatë gjithë jetës së vet, ai nuk u dha asnjëherë pas kësaj bote dhe mirësive të saj. Lidhur me këtë, Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

بِوَفَاءِ اللَّهِ
وَحُكْمِ الْيَمِينِ

*“Ne e kemi
krijuar njeriun
dhe, Ne e dimë
ç’i pëshpërit atij
shpirti i vet. Ne
jemi më pranë tij
se damari i qafës
së vet.”*

(Kaf, 16.)

“Unë nuk kam asnjë lidhje me këtë botë. Puna ime në këtë botë është si udhëtari që ndalon nën hijen e një peme dhe pastaj vazhdon rrugën”. (Tirmidhi, Zuhd, 44.)

Ai nuk e ka kaluar asnjëherë sasinë minimale të mjaftueshme për të jetuar. Për rrjedhojë, e përsërisim edhe njëherë, që ta ngulisim në mendje atë që nëna jonë Aisha رضي الله عنها, ka thënë lidhur me këtë:

“Që prej ditës kur erdhën në Medinë e deri kur ai ndërroi jetë (Profeti), familja e Muhamedit صلى الله عليه وسلم, nuk është ngopur asnjëherë me bukë gruri tri net me radhë.” (Muslim, Zuhd, 20.)

Sipas një transmetimi tjetër, nëna jonë Aisha رضي الله عنها, e vazhdon kështu fjalën e vet:

“Po të donim, mund të ngopeshim.”

(Pra kjo uri nuk ishte nga skamja. Neve na vinin dhurata dhe plaçkë lufte.)

Profeti ynë صلى الله عليه وسلم, ka thënë: Unë nuk kam asnjë lidhje me këtë botë. Puna ime në këtë botë është si udhëtari që ndalon nën hijen e një peme dhe pastaj vazhdon rrugën”.

(Tirmidhi, Zuhd, 44.)



Por i Dërguari i Allahut përmbushte fillimisht nevojat e vëllezërve të tij besimtarë. (Kështu, sa herë na dhurohej diçka e ndanim për vëllezërit tanë.)” (Bejhaki, Shuab, III/62 [1396].)

E në fakt, ëmbëlsia dhe kënaqësia që i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, përjetonte duke dhuruar dhe ndarë mirësitë me të tjerët, e bënte të harronte edhe urinë dhe hallet e veta.

Kur Omeri رضي الله عنه, shihte jetën e thjeshtë të Profetit صلى الله عليه وسلم dhe i kujtoheshe se në ç’luks e mirëqenie jetonin mbretërit pers dhe perandorët bizantinë, hidhërohej e mër-

zitej. Mirëpo, i Dërguari i Allahut ﷺ, e qetësonte atë duke i thënë:

“Mos qaj, o Omer! A nuk dëshiron që kjo botë me të gjitha begatitë dhe shijet të jetë e tyre, kurse ahireti të jetë i yni!?”
(Ahmed, II, 298.)

Para se t'i vinte shpallja hyjnore, Profeti ynë ﷺ, ka punuar si çoban dhe është marrë me tregti, duke e siguruar vetë jetën në mënyrë të ndershme, pa ia zgjatur dorën askujt. Madje, edhe gruaja e tij e ardhshme, nëna jonë Hadixhe ؓ, e admironte për karakterin dhe ndershmërinë e tij të jashtëzakonshme që shfaqte gjatë veprimtarive tregtare. Për këtë arsye, më vonë ajo i propozoi vetë për martesë.

Edhe pse Profeti ﷺ, kalonte ditë të vështira duke lidhur edhe gurë në bark për shkak të urisë, ai nuk hoqi dorë nga të qenit i kënaqur dhe i vetëmjaftueshëm me çka i kishte dhënë Allahu i Madhëruar. Madje, edhe pse shpesh i vinin plaçkë lufte dhe mirësi të tjera si sadaka, ai u ndante ato menjëherë të varfërve, nxënësve të sufes dhe njerëzve që dëshironte t'u ngrohte zemrën ndaj Islamit.

Në ditë e fundit të jetës, Profeti ynë ﷺ, e urdhëroi nënën tonë, Aishen ؓ, që t'i ndante edhe ato pak para që i kishin mbetur në xhep. Por, për shkak të telashit dhe hidhërimit gjatë atyre ditëve të vështira të sëmundjes së Profetit ﷺ, ajo e kishte harruar këtë porosi. Sapo e mësoi këtë, Profeti ﷺ, ndërhyri

Gjatë një udhëtimi, Resulullahu ﷺ, qëndroi në një vend për të falur namaz. Në fillim po ecte drejt vendit ku do të falte namaz, pastaj u kthye pas. Sahabët e pyetën:

“O Resulullah, ku po shkoni?”

“Do lidh devenë time.”

Sahabët i thanë:

“E bëjmë ne, mos u mundoni. E lidhim ne devenë për ju!”

Profeti ﷺ, tha:

“Unë e di që ju mund ta bëni edhe punën time, por mua nuk më pëlqen të jem më i privilegjuar se ju, sepse Allahu i Lartësuar nuk e do robin që privilegjet mes shokësh.”

(Kastallani, Mevahibu'l-Ledunnije, Egjipt 1281, I, 385.)



menjëherë, i dha dhënë sadaka ato pak para dhe ishte qetësuar shpirtërisht.

Po ashtu, edhe sahabët e vet, i mësonte dhe i porosiste të punonin, të fitonin prej hallallit dhe të mos ia shtrinin dorën askujt në jetën e tyre:

DJERSA E BALLIT

“Nëse dikush nga ju merr litarin dhe shkon në mal, bën një barrë dru, e sjell dhe e shet; e për rrjedhojë, Allahu ia mbron nderin, kjo është më e dobishme dhe më e mbarë për të, sesa të lypë diçka nga njerëzit, pavarësisht se i japin apo jo!” (Buhari, Zekat, 50-53; Nesai, Zekat, 85.)

Feja jonë i ka dhënë rëndësi të madhe karakterit dhe personalitetit njerëzor. Prandaj, myslimanit nuk i ka hije t’u shtrijë dorën njerëzve dhe të lypë prej tyre. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Më erdhi Xhibrili ﷺ dhe më tha:

«O Muhammed! Jeto sa të duash, por një ditë patjetër do të vdesësh. Duaj kë të duash, por patjetër do të ndahesh prej tij. Puno me çfarë të duash, por vetëm shpërblimin e saj do të marrësh.

Dije se, nderi i besimtarit, është në qëndrimin në këmbë natën (në faljen ne namazit të natës), ndërsa dinjiteti i tij, është në të qenit e tij i panevojshëm për të tjerët!»” (Hakim, IV, 360-361/7921.)

Këtu duhet të shprehim edhe një fakt:

Ndërkohë që feja jonë i këshillon të varfrit, duke u thënë; “mos u shtrini dorën të tjerëve përveç Allahut!”, të pasurit i urdhëron: “Kërko dhe gjej nevojtarët e vërtetë!”



NGA NJË KRITER PËR TË DYJA PALËT

Ndërkohë që feja jonë i këshillon të varfrit, duke u thënë; “mos u shtrini dorën të tjerëve përveç Allahut!”, të pasurit i urdhëron: “Kërko dhe gjej nevojtarët e vërtetë!”

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273.)

Ky është kriteri: Nevojitari nuk do e shfaqë veten dhe do të mbështetet tek Allahut. Ndërsa besimtari i pasur, duhet ta kuptojë gjendjen e vëllait të vet nga pamja e jashtme dhe duhet ta ndihmojë atë pa ia cenuar dinjitetin.

Porosia për të mos e shfaqur gjendjen e tyre, është për shkak që nevojitari të forcojë tevekulin/mbështetjen tek Allahu dhe të mos i shkelet dinjiteti njerëzor. Por nga ana tjetër, Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar besimtarët të kujdesen për njëri-tjetrin. Si rezultat i kësaj, Allahu ka urdhëruar çdo besimtar të pasur t’i japë të drejtën që u takon të varfërve.

Mbështetja tek Allahut, që tregon nevojitari, nuk duhet të bëhet shkak i neglizhencës së të pasurit. Po ashtu, as dëshira

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.”
(Bekare, 273.)



e të pasurit për të dhuruar, nuk duhet ta shtyjë të varfrin drejt pangopësisë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, përherë i këshillonte sahabët të tregoheshin të vetëmjaftueshëm duke u mbështetur tek Allahu. Një shembull i bukur i këtij fakti, është edhe kjo ndodhi:

Ebu Said رضي الله عنه, ishte nga sahabët që lidhnin gurë në bark kur vuanin për shkak të urisë. Nëna e tij i tha:

“Ngrihu! Shko te i Dërguari i Allahut dhe kërko diçka nga Ai. Filani ka shkuar te i Dërguari i Allahut dhe ai e ka ndihmuar. Edhe filanin që ka shkuar, e ka ndihmuar po ashtu. Shko edhe ti, ndoshta kthehesh me ndonjë të mirë!”

Ebu Said رضي الله عنه, i tha nënës:

“Prit pak, le të përpiqemi të kërkojmë diçka vet; nëse nuk gjejmë do të shkoj.”

Megjithatë, të gjitha kërkimet dhe munda i shkuan kot. Për këtë arsye, duke mos pasur asnjë rrugëzgjdhje, vendosi të shkojë te Profeti ﷺ. Kur hyri tek ai, e gjeti duke mbajtur hutbe dhe filloi të dëgjojë. I Dërguari i Allahut ﷺ, në hutben e tij po thoshte:

“Atë që shfaq istigna dhe e ruan nderin e tij, Allahu do ta bëjë që të mos ketë nevojë për botën...”

Pasi dëgjoji këto fjalë, Ebu Saidi رضي الله عنه, nuk guxoi t'i kërkonte gjë të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe u kthye në shtëpi duarbosh. Vetë ai e përshkruan kështu gjendjen e tij të mëvonshme:

I Dërguari

i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Më erdhi Xhibrili عليه السلام dhe më tha: «O Muhammed! Jeto sa të duash, por një ditë patjetër do të vdesësh.

Duaj kë të duash, por patjetër do të ndahesh prej tij. Puno me çfarë të duash, por vetëm shpërblimin e saj do të marrësh...”

(Hakim, IV, 360-361/7921.)



“Kur u ktheva në shtëpi pa mundur t’i kërkoja diçka Profetit ﷺ, Allahu na dërgoi rrizkun tonë. Punët tona u rregulluan aq mirë, saqë asnjë prej ensarëve nuk ishte më i pasur se ne.” (Shih. Ahmed, III, 449.)

Ashtu si në këtë shembull, i Dërguari i Allahut ﷺ, u tërhiqte vëmendjen sahabëve edhe në lidhje me lakminë ndaj kësaj bote:

ALLAHU TË DASHTË!

“Mos u lidh shpirtërisht me këtë botë, që të dojë Allahu dhe mos lakmo ato që zotërojnë të tjerët, që të duan njerëzit!” (Ibn Maxhe, Zuhd, 1.)

Profeti ynë ﷺ, e dinte se, falë ndihmës së Allahut dhe entuziazmit të mesazhit të fundit hyjnor që solli, sahabët dhe brezat që do t’i pasonin do të përhapeshin edhe në pjesë të tjera të botës. Këtë, ai e kishte deklaruar edhe në ditët e vështira të betejës së Hendekut. Por krahas kësaj, ai ua tërhoqi vëmendjen sahabëve edhe në lidhje me pasurinë që do të fitonin:

“Vërtet kjo botë është e ëmbël dhe tërheqëse. Allahu ju ka bërë mëkëmbës në të dhe ju vëzhgon se si do veproni. Prandaj ruajuni (mashtrimin të) kësaj bote..” (Muslim, Dhikr, 99. Shih. Tirmidhi, Fiten, 26; Ibni Maxhe, Fiten, 19.)

“...Betohem në Allahun se, unë nuk kam frikë nga varfëria për ju. Unë kam frikë se bota do të shtrohet para jush, ashtu siç u është shtruar atyre përpara jush, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.” (Buhari, Rikak, 7; Muslim, Zuhd, 6.)

*“Xhibrili më tha:
...Dije se, nderi i
besimtarit, është në
qëndrimin në këmbë
natën (në faljen në
namazit të natës),
ndërsa dinjiteti i tij,
është në të qenit e tij
i panevojshëm
për të tjerët!»”*

(Hakim, IV, 360-361/7921.)



Kështu, ngjarjet dhe trazirat që pasuan Epokën e Lumturisë, treguan se sa të drejtë kishte Profeti ynë ﷺ, në shqetësimet e veta.

Feja jonë na porosit me kriterin e mesatares dhe përmbytjes në çdo çështje. Për rrjedhojë, ne duhet t'i japim rëndësi kësaj bote, aq sa ajo e meriton dhe nuk duhet ta angazhojmë zemrën tonë me të, më shumë se sa duhet. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” (Ankebut, 64.)

Bota është asgjë në sytë e atyre që lidhen me zemër pas këtyre urdhëresave hyjnore, sepse dëshira e tyre e vetme është kënaqësia e Allahut. Sa bukur shprehet Junus Emre:

As kamjes s'i gëzohem,

As skamjes s'i hidhërohem,

Me dashurinë ndaj Teje ngushëllohem,

Sepse mua Ti më duhesh, Ti!

Jahja bin Muadh ﷺ thotë:

“I dituri, në të djathtë mban ahiretin, e në të majtë dynjanë, ndërsa zemrën e ka të kthyer nga Zoti. Tashmë, atë nuk mund ta preokupojë asgjë tjetër përveç Allahut.”

Mevlana në veprën e tij “Mesnevi” shprehet:

“Dynja, do të thotë të jesh indiferent ndaj Allahut, e jo të zotërosh para, veshje të bukura, gra dhe fëmijë! Çdo gjë që të bën ta harrosh Allahun, është dynjaja jote!”

Jahja bin Muadh ﷺ
thotë: I dituri, në të
djathtë mban ahiretin,
e në të majtë dynjanë,
ndërsa zemrën e ka të
kthyer nga Zoti. Tashmë
atë nuk mund ta
preokupojë asgjë tjetër
përveç Allahut.”



ZEMRAT E NGOPURA ME DYNJANË

Profeti ynë ﷺ dhe shokët e tij të nderuar, shfaqën shembujt më të bukur të istigna-së. Ensarët, ia dhuruan gjysmën e pasurisë vëllezërve të tyre muhaxhirë; ndërsa muhaxhirët, duke u treguar të panevojshëm për atë pasuri, kërkuan vetëm diçka në këmbim të punës që do të bënin.

Ebu Bekri ﷺ, rrogën që ia dhanë pa kërkesën e tij për shërbimin në detyrën e kalifit, ia ktheu thesarit të shtetit me anë të një testamenti që kishte lënë.

Në kohën kur Omeri ﷺ, ishte kalif dhe shteti i Islam u zgjerua shumë, pranoi të merrte një pagë minimale nga thesari i shtetit, me të cilën mbijetonte me vështirësi. Ata që nuk e njihnin, nuk arrinin ta dallonin kalifin në mesin e të tjerëve, sepse ai ishte shumë modest.

Paria e sahabëve nuk e duruan këtë gjendje dhe kërkuan t'ia rrisnin pagën kalifit. Por e kishin të vështirë që këtë çështje ta ndanin direkt me Omerin ﷺ, prandaj shkuan tek bashkëshortja e Profetit ﷺ, e cila në të njëjtën kohë ishte edhe e bija e Omerit, pra tek nëna jonë Hafsa ﷺ, dhe i kërkuan të shkonte tek babai i saj me propozimin që kishin menduar. Kështu, Hafsa ﷺ, e ndau me të atin këtë propozim.

Mirëpo, Omeri ﷺ, i cili kishte qenë dëshmitar i ditëve aq të vështira për Resulullahun ﷺ, në të cilat ai nuk gjente as edhe një hurmë për të shuar urinë, e pyeti vajzën e tij Hafsa ﷺ:

Mevlana:
"Dynja, do të thotë
të jesh indiferent
ndaj Allahut, e jo të
zotërosh para, veshje
të bukura, gra dhe
fëmijë! Çdo gjë që
të bën ta harrosh
Allahun, është
dynjaja jote!"



- O bija ime! A e di se si ushqehet dhe vishej Profeti ﷺ?

- Aq sa t'i mjaftonte! - iu përgjigj Hafsa ؓ.

Atëherë, Omeri ؓ, iu drejtua vajzës së tij të dashur duke i thënë:

“Dy miqtë (Profeti dhe Ebu Bekri) dhe unë ngajmë me udhëtarët e së njëjtës rrugë. I pari nga ne (Profeti) arriti në destinacion. Tjetri, pra Ebu Bekri, duke ecur në të njëjtën rrugë e arriti të parin. Unë, si i treti i tyre, përpiqem të arrij shokët e mi. Në qoftë se nisem me shumë ngarkesë, nuk do të mund t'i arrij ata! Apo mos vallë ti nuk dëshiron që unë të jem i treti i kësaj rruge?” (Shehbenderzade Ahmet Hilmi, Tarih-i Islam V. I, s 367.)

MADJE EDHE SULLTANËT

Edhe sulltanët që ndoqën rrugën e ndritur të Profetit ﷺ, kanë shfaqur shembuj të tillë istignaje dhe modestie.

Kur Omer Bin Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë), u zgjodh kalif, i kërkoi gruas t'ia dhuronte të gjitha xhevahiret e veta thesarit të shtetit. Ajo, jo vetëm që pranoi ta bënte këtë, por edhe kur i shoqi vdiq dhe asaj i propozuan për t'ia kthyer ato xhevahire, ajo u shpreh se ato i kishte dhënë me gjithë zemër.

Po ashtu, edhe sulltani i fundit i dinastisë Osmane, Vahiduddin Hani, kur u detyrua të hiqte dorë nga fronin e sulltanit, të linte vendlindjen dhe të shkonte në kurbet, la pas shumë stoli të çmuara që i takonin dinastisë Osmane. Ai mori

Profeti ﷺ, nuk e ka kaluar asnjëherë sasinë minimale të mjaftueshme për të jetuar. lidhur me këtë Aishja ؓ: “Që prej ditës kur erdhën në Medinë e deri kur ai ndërroi jetë (Profeti), familja e Muhamedit ﷺ, nuk është ngopur asnjëherë me bukë gruri tri net me radhë.” (Muslim, Zuhd, 20.)



me vete vetëm një sasi pasurie që mund t'i mjaftonte për një apo dy vjet familjes së tij të madhe dhe nuk i preku stolitë dhe sendet me vlerë që ishin të lehta në bartje, por të çmuara në vlerë. Atë kohë, të afërmit i thanë:

“Kjo pasuri i takon të parëve tuaj, sepse janë dhuruar të gjitha nga sundimtarët e huaj. Pra, kjo është pasuria juaj. Të paktën merrni diçka për të plotësuar nevojat e jetesës suaj?”

Mirëpo, ai u përgjigj kështu:

“E vërtetë! Ne nuk i japim llogari askujt për këtë pasuri, sepse është e jona. Por, nëse të parët tanë nuk do të ishin sundimtarët e këtij populli, askush nuk do t’ua falte atyre këto pasuri? Për rrjedhojë, edhe populli im ka pjesën e vet në këto stoli dhe sende me vlerë. Prandaj, unë mund ta pranoj këtë tradhti ndaj popullit tim!”

Më vonë, kushtet e kohës, e detyruan sulltan Vahiduddinin të strehohej në qytetin SanRemo të Italisë. Aty, një mbret italian, të cilin sulltani e kishte pritur miqësisht kur ishte veçse një princ në Stamboll, dëshironte ta ndihmonte në mënyrë bujare. Mirëpo, sulltani nuk e pranoi këtë propozim duke thënë:

“Edhe pse ndodhitë dhe situata në vendin tim më kanë larguar nga fronti përkohësisht apo edhe përjetësisht, unë ende bart titullin e Kalifit. Për rrjedhojë, jam edhe prijësi i të gjithë myslimanëve. Prandaj, ky titull nuk më lejon të pranoj propozimin për ndihmë nga një person që nuk është i fesë sime.”

*Ebu Talha ؓ,
tregon: “Një ditë,
kur shkova tek
Profeti ﷺ, e pashë
që ishte kërrusur
dhe për ta mbajtur
belin drejt, kishte
lidhur dy gurë
në bark. Në këtë
gjendje, ai u jepte
mësim Kurani
sahabëve të suffes.”*

*(Ebu Nuajm,
Hilje, I, 342.)*



Në të njëjtën mënyrë, ai refuzoi edhe shumë propozime për komoditet dhe pasuri nga ana e atyre që dëshironin të abuzonin me postin e kalifit, pavarësisht se ishte në një pozitë shumë të vështirë ekonomike.

Më në fund, kur ndërroi jetë sulltani i fundit i kësaj dinastie, e cila i shërbeu Islamit për shtatë shekuj, për shkak të borxhit që u kishte dyqaneve dhe frutoreve në SanRemo, atij ia konfiskuan edhe arkivolin.

Trupi i tij u nxor nga dera e pasme e shtëpisë dhe, duke e hipur në një anije, u dërgua në Siri, ku u varros afër xhamisë së sulltan Selimit. Ndërsa borxhet e tij u paguan nga të afërmit.

THESARI PAZOT

Një herë e një kohë, një burrë bleu një arë. Kur po lëronte arën, gjeti një qyp me florinj. Sapo pa qypin menjëherë ia çoi të zotit të parë.

- Merri këto flori, sepse unë nga ti nuk bleva florinj, por arën. – i tha.

Ndërsa njeriu që i shiti arën e kundërshtoi:

- Unë të shita arën me të gjitha çfarë kishte brenda. Këto janë e drejta jote. Merri florinj.

Mirëpo, ata nuk arritën të merreshin vesh në këtë pikë, edhe pse diskutuan gjatë. Ndaj vendosën që ta çonin çështjen tek gjykatësi.

Profeti ﷺ, nxirrte mësim prej çdo gjëje që shihte dhe i drejtohej Zotit me falënderim e mirënjohje. Po ashtu, edhe ne duhet të vërejmë madhësitinë hyjnore në çdo gjë që shohim dhe të përpiqemi të marrim ushqimin shpirtëror të botës sonë të ndjenjave dhe të mendjes.



Gjykatësi, pasi i dëgjoi që të dy, tha:

- A keni fëmijë?

- Kam një djalë. – tha ai që kishte blerë arën.

- Unë kam një vajzë. - tha ai që kishte shitur arën.

Atëherë, gjykatësi vendosi:

- Martojini fëmijët me njëri-tjetrin. Një pjesë të florinjve jepuni atyre, një pjesë mbani për vete dhe një pjesë harxhojini për hir të Allahu.

Ata kanë qenë njerëz, që pasurinë dhe mundësitë, i kanë konsideruar si diçka me të cilat mund të fitonin botën tjetër. Për këtë arsye, çdo mundësi që u vinte në dorë, ata e përdornin për t'i ardhur në ndihmë nevojtarëve përreth.

Njëherë, një sekretar i paradhomës, jo besnik i Abdulhamidit të II, tregon në kujtimet e tij këtë ngjarje mbresëlënëse:

“Ishte mbrëmje. Në paradhomë gjendesha vetëm unë, si sekretar i turnit. Pata përgatitur listën e letrave, telegrameve, raporteve dhe projektligjeve. Sapo do të hyja tek sulltanit, erdhi një telegram. Ishte një telegram drejtuar sulltanit nga njëri prej nëpunësve të Postë-Telegrafit të Lalelisë...

Në telegram, nëpunësi i gjorë e njoftonte sulltanin se e shoqja do të bënte lindje atë natë, se mjekët e kishin paralajmëruar që lindja do të ishte e rrezikshme dhe se ai vetë nuk kishte asnjë mundësi për të bërë diçka, prandaj po kërkonte mbështetje nga sulltani...



Kur Sulltan

Abdulazizi dergjej në shtrat nga sëmundja dhe u lajmërua se kishte ardhur një letër nga Medina e ndritur, kërkoi ndihmën e dy personave për t'u çuar në këmbë. Më pas, e dëgjoi leximin e letrës në këmbë, sepse e perceptonte letrën si të ardhur nga miqtë e Resulullahut ﷺ, nga qytetarët e Medinës së ndritur.

Duke mos e parë si diçka me vlerë për t'u shënuar, unë s'e futa telegramin në fjalë në listën që do t'ia paraqisja sulltanit. Por kur dola para tij, siç e kishte zakon, pasi i shqyrtoi të gjitha çështjet veç e veç, Padishahu më pyeti:

- A ka ndonjë gjë tjetër?

- Nuk ka ndonjë gjë me rëndësi për t'u shënuar, imzot! – Iu përgjigja unë.

Por sulltani nguli këmbë:

- Thuamë edhe atë që ti s'e quan me rëndësi për t'u shënuar!

Atëherë, unë i fola për telegramin në fjalë dhe ia bëra të ditur se nuk e kisha futur në listë, duke menduar se s'ishte diçka për t'u marrë në konsideratë.

I hidhëruar, sulltani më urdhëroi:

- Sillmani menjëherë!

Ia çova telegramin i turbulluar. Sulltani e lexoi me vëmendje. Pastaj, ndryshe nga ç'e kisha menduar unë, e thirri menjëherë mjekun e Pallatit dhe, duke mu drejtuar mua, urdhëroi:

“Shkoni menjëherë bashkë në Laleli dhe bëni ndërhyrjen e duhur për gruan e gjorë që do të lindë!”

Sipas urdhrit të sulltanit, shkuam në shtëpinë e nëpunësit të postës. Kur u kthyem nga spitali, pasi e kishim kryer detyrën gjer në fund, pothuaj ishte në



“Vërtet kjo botë është e ëmbël dhe tërheqëse. Allahu ju ka bërë mëkëmbës në të dhe ju vëzhgon se si do veproni. Prandaj ruajuni (mashtimit të) kësaj bote..”

(Muslim, Dhikr, 99.)

të zbardhur. Sulltani, i cili që na ndjeu se po hynim në pallat, nga zhurma e portës, e largoi perden e dritares dhe na e bëri me dorë që të ngjiteshim tek ai. Dritat e dhomës së tij vazhdonin të ishin ndezur. Domethënë, ai s'kishte rënë fare për të fjetur, por ishte marrë me falje dhe lutje gjer në mëngjes!

Hymë tek ai. Më pyeti për rezultatin dhe unë ia tregova siç ishte:

“Sulltani im, lindja u bë me shumë vështirësi. Por, lavdi Zotit, me përpjekjet e mjekëve specialistë, e sëmura shpëtoi. Ajo lindi një djalë që ia vunë emrin Abdulhamid. Dhe gjer në mëngjes u lutën me lot në sy për shkëlqesinë tuaj, që të keni jetë të gjatë dhe fat të lumtur!..”

Sundimtari i madh, kujdestari i popullit, i cili na dëgjoji në këmbë, tha “elhamdulillah, lavdëruar dhe falënderuar qoftë Allahu” dhe, duke kaluar pas një të ndare të posaçme, fali dy rekat namaz falënderimi.”

Këta janë shembujt e njeriut me zemër të butë, të ndjeshme dhe të mëshirshme, që ka nxjerrë qytetërimi Islam. Një shembull tjetër, është edhe Abdulhamidi i I, të cilit kur i erdhi i lajmi se armiku kishte shtënë në dorë kalanë Ozi, me hidhërim të thellë, tha:

“Sa keq! Bijtë e mi ushtarë dhe populli im janë masakruar!”

Më pas, nga hidhërimi i madh që ndjeu për popullin e vet, ai u paralizua dhe vdiq.



Sulltanët Osmanë, e konsideronin veten si shërbyes të dy vendeve të shenjta, Mekës dhe Medinës. Madje, ata paguanin nga pasuria personale rrogat e pastruesve të këtyre vendeve të shenjta.


Asnjë sulltan Osman nuk i ka lexuar letrat që vinin nga Medina, pa marrë më parë abdest, pa e puthur dhe pa u ngritur në këmbë.

Kur Sulltan Abdulazizi dergjej në shtrat nga sëmundja dhe u lajmërua se kishte ardhur një letër nga Medina e ndritur, kërkoi ndihmën e dy personave për t'u çuar në këmbë. Më pas, e dëgjoi leximin e letrës në këmbë, sepse e perceptonte letrën si të ardhur nga miqtë e Resulullahut ﷺ, nga qytetarët e Medinës së ndritur.

Kur sulltanët zotëronin këtë pjekuri shpirtërore, edhe gjendja shpirtërore e popullit ishte në një nivel të lartë. Ja një kujtim i bukur që e shpreh shumë qartë horizontin e dhurimit të Osmanëve:

Në kohën e mbretit Fajsal, ministri i Haxhit Hasan Kutbi, vinte për të takuar babanë tim, Musa Efendinë. Një herë, kur po rikonstruktoheshin dhe zgjeroheshin dy xhamitë e shenjta, ai erdhi përsëri për vizitë tek Musa Efendiu. Me këtë rast, babai i thotë:

- Sa mirë që Ravza po hapet! Myslimanët do të jenë më rahat. Po bëhet një punë e pastër dhe e rregullt.



Pasi u mendua pak, Hasan Kutbi tha:

- Sikur ta dinit; sa përqind e mundësive dhe parave shpenzohen për bamirësi, e sa për shpërdorim?!. Përdorimi i parasë është art më vete. Këtë art, e kam vënë re tek Osmanët. Ata, ditën ta përdorin mirë paranë dhe patën sukses në këtë, duke e përdorur paranë si kapital për botën tjetër. Ende sot e kësaj dite qëndrojnë në këmbë xhamitë, medresetë, çezmat dhe spitalet që ndërtuan ata...

NJË SHOQËRI E MBUSHUR ME QETËSI

Gurët e lëmoshës, janë shumë të njohur në historinë tonë. Ato ishin vendosur nga gjyshërit tanë në disa lagje të Stambollit të vjetër, për të mos thyer zemrën e atyre që nuk mund të kërkonin asgjë për shkak të nderit dhe turpfit dhe për të mos i detyruar të lypnin. Me qëllim që banorët e atyre vendeve të jepnin lëmoshë në mënyrë që, “çfarë jep dora e djathtë të mos e dijë e majta”, ata i linin lëmoshat e tyre mes errësirës së natës në këta gurë mbi të cilët ishte gdhendur një zgavër. Kështu, të varfrit e virtytshëm dhe të ndershëm të lagjes, merrnin aq para sa kishin nevojë, ndërsa të tjerat nuk i preknin. Madje, ata që kishin turp të kërkonin, edhe pse kishin nevojë, vinin e merrnin para nga gurët në orët e vona të natës aq sa kishin nevojë.

Delikatesa dhe mirësjellja në shoqërinë Osmane kishte arritur shkallën kulminante. Në dritaret e shtëpive ku kishte ndon-

Trashëgimia e të parëve tanë, ishte një xhami ku do të kryenin adhurimet besimtarët, një mensë ku do të hanin të uriturit dhe një shkollë ku do të edukoheshin brezat e rinj, etj... Kjo është trashëgimi e vërtetë dhe e dobishme.



jë të sëmure, vendosej një trëndafil i kuq, që fëmijët të mos luanin aty afër e të mos shqetësonin të sëmurin me lojërat e tyre. Gjithashtu edhe që shitësit ambulant të mos bërtisnin për të shitur mallrat e tyre kur kalonin pranë këtyre shtëpive. Po ashtu, për të ruajtur edhe dinjitetin njerëzor të të sëmurëve mendorë, atyre nuk u thuhej, “të çmendur”, por në lidhje me ta përdornin shprehjen “të nderuarit e dobët”.

Kjo mëshirë nuk ishte vetëm për njerëzit, por edhe botën e kafshëve. Nëpër çezma bëheshin vende të posaçme për kafshët e rrugëve, ku ato mund të pinin ujë, ndërsa muret e xhamive zbukuroheshin me shtëpiza për zogjtë.

Kështu, edhe ne duhet të kemi shqetësim dhe synim të njëjtë si të parët tanë, që të lemë pas trashëgimi të dobishme, siç janë institucionet që edukojnë njerëz të ditur e të devotshëm. Kjo trashëgimi, do të jetë shkak i ndriçimit në jetën e errët të varrit dhe mëshirë në botën tjetër!..



I gjithë shqetësimi dhe synimi i të parëve tanë, ishte të linin pas një trashëgimi të bukur, që nuk do t'u mbetej vetëm fëmijëve, por do të bëhej shkak edhe për përfitimin e lutjeve për veten e tyre.

Kjo trashëgimi; ishte një xhami ku do të kryenin adhurimet besimtarët, një mensë ku do të hanin të uriturit dhe një shkollë ku do të edukoheshin brezat e rinj, etj... Kjo është trashëgimia e vërtetë dhe e dobishme.

Kështu, edhe ne duhet të kemi shqetësim dhe synim të njëjtë si të parët tanë, që të lemë pas trashëgimi të dobishme, siç janë institucionet që edukojnë njerëz të ditur e të devotshëm. Kjo trashëgimi, do të jetë shkak i ndriçimit në jetën e errët të varrit dhe mëshirë në botën tjetër!..

Të gjitha këto shembuj, tregojnë se një zemër e pastruar, është fruti i një shpirti të orientuar tek Allahu, që ka arritur paqen duke përmendur Zotin e vet.

Të këqijat lulëzojnë prej nefsit emmare/egoja që nxit të keqen. Sëmundjet, si lakmia, smira, koprracia, keqdashja, egoizmi dhe mendjemadhësia, që ndotin botën e brendshme të njeriut, e çojnë njeriun në sjellje të këqija. Kur pastrohet bota e brendshme, kapesh pas devotshmërisë dhe në zemër zë vend vetëdija se ndodhesh nën vëzhgimin hyjnor; ndjenjat qartësohen, në vend të gjembave çelin trëndafila dhe fillojnë të shfaqen cilësitë e bukura, mëshira, falja, durimi, butësia dhe mirësia.

“O rrotullues i zemrave! Forcoje zemrën time në fenë Tënde.” (Tirmidhi, Kader, 7.)

O Allah! Na ruaj nga vorbulla e dëshirave të egos dhe rregulloi ndjenjat e zemrës sonë në përputhje me kënaqësinë Tënde!..

O Allah! Na e bëj të mundur të përfitojmë prej moralit madhështor të Muhamedit (a.s.) dhe të marrim frymëzimin shpirtëror prej tij!..

Amin!..



“Shembulli i shokut të mirë dhe atij të keq është si ai që bart aromë të mirë me atë që punon si farkëtar. Mbartësi i aromës së mirë ose do të dhurojë një aromë të mirë, ose do t’ia blesh, ose atij do t’i vijë aromë e mirë. Ndërsa farkëtari, ose do të djegë rrobat, ose do të ngjisë erën e keqe.”

(Buhari, Buju, 38.)





DHEMBSHURIA dhe MËSHIRA

Ai ﷺ, ishte mëshirë. Krahë mëshire për zogun nënë që donin ta ndanin nga të vegjlit e saj...

Mëshirë për qenin që ushqente këlyshët e vet, edhe kur ai ﷺ, ishte në krye të një ushtrie të madhe...

Mëshirë për një sorkadhe të vetmuar...

Mëshirë për të gjitha krijesat...

E sidomos një mëshirë e veçantë për ne, umetin e vet, ndaj të cilëve ishte shumë i kujdesshëm...



DHEMBSHURIA dhe MËSHIRA

أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

Çdo gjë, është vepra e mëshirës madhështore të Allahut, i Cili është Mëshiruesi i mëshiruesve!..

Çdo krijesë, prej thërrmijës më të vogël, e deri tek trupi më i madh, është e stolisur me urtësitë dhe misteret më madhështore...

Çdo gjë është si një ekspozitë hyjnore e zbukuruar me shfaqjet më madhështore të fuqisë së Krijuesit...

E krahas këtyre; shfaqja madhështore e mëshirës së Tij hyjnore në ekuilibrin ekologjik të botës, duke i furnizuar të gjitha krijesat me mirësi të panumërta...

Allahu i Madhëruar, dëshiron që një besimtar të meditojë mbi madhësinë hyjnore, rregullin e mrekullueshëm në gjithësi dhe urtësinë që përmban, duke e pasuar këtë meditim me përlulje, respekt dhe devotshmëri.

Falë kësaj largpamësie shpirtërore, njeriu e kupton se:

Edhe ato që ne mendojmë se janë të këqija, janë të mbushura me mistere dhe urtësi të mëshirës. Kur të ngushton, gjen mëshirën e paralajmërimit dhe vërejtjes dhe kur të zgjeron, gjen mëshirën e përgëzimit dhe rehatisë. Edhe durimi është mëshirë, edhe mirënjohja...

Një prej fakteve më të rëndësishme të mëshirës së Allahut ndaj njerëzve, është që krahas mendjes dhe vetëdijes, u ka falur edhe profetë. Lidhur me Profetin tonë ﷺ, umeti i të cilit kemi nderin të jemi edhe ne, Allahu i Madhëruar ka thënë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“Ne të dërguam ty vetëm si mëshirë për botët.” (Enbija, 107)

AI ﷺ ËSHTË MËSHIRË PËR BOTËT

Botët janë të shumta dhe të ndryshme...

Dhe Profeti ynë ﷺ, është mëshirë për të gjitha ato...

Ai ﷺ, është mëshirë edhe për botën e ngurtë e të pajetë, edhe për botën e bimëve...

Ai ﷺ, me përkëdheljen e tij, ishte mëshirë edhe për trungun e hurmës që rënkonte nga malli për të...

Profeti ynë ﷺ, ishte ai, që dje e shpëtoj njerëzimin, të vuajturit, vajzat e vogla që varroseshin të gjalla, të pashpresët, jetimët dhe të vetmuarit nga kthetrat e pashpirtshme të epokës së injorancës.



Me shprehjen e tij, “Uhudi na do ne dhe ne e duam Uhudin..”, ai ﷺ, ishte mëshirë për gurët dhe malet... Mëshirë edhe për degën e pemës që u shkul me rrënjë...

Ai ﷺ, ishte mëshirë edhe për botën e milingonave... Kur pa një fole të djegur milingonash, nga shpirti i doli një rënkim: “Kush mund ta dënojë kështu një krijesë të Allahut!..”

Ai ﷺ, ishte krahë mëshire për zogun nënë që donin ta ndanin nga të vegjlit e saj...

Mëshirë dhe strehë për devetë e ngarkuara përtej takatit, të lëna pakujdesje, të uritura dhe të etura...

Kur pa dikë që po e tërhiqte delen e tij prej veshi, ndërhyri menjëherë dhe nga mëshira që kishte, i tha: “Lëshoje veshin e kafshës dhe kape nga qafa!” (shih. Ibn Maxhe, Zebaih, 3.)

Mëshirë aq e madhe, sa këshillonte me ngulm që; gjatë mjeljes së kafshëve, të laheshin duart, të priteshin thonjtë dhe t’u lihej qumësht edhe të vegjëlve të tyre...

Mëshirë për qenin që ushqente këlyshët e vet, edhe kur ai ﷺ, ishte në krye të një ushtrie të madhe...

Mëshirë për një sorkadhe të vetmuar...

Mëshirë për të gjitha krijesat...

E sidomos një mëshirë e veçantë për ne, umetin e vet, ndaj të cilëve ishte shumë i kujdesshëm...

Sepse Zoti, me mëshirën e Tij të pafundme, i tha atij:

Sot, zgjidhjet e vërteta të problemeve të botës Islame, nuk janë sistemet e huaja perëndimore apo fuqitë e mëdha ekonomike. Po ashtu, as rruga për të vënë në shina brezat e humbur, nuk janë aspak rrugicat e huaja, korridoret e rrezikshme të internetit dhe skenat e mbushur plot kurthe. Zgjidhja është vetëm ndjekja me besnikëri e Profetit tonë ﷺ!



“Dhe bëhu më i afërt ndaj besimtarëve që të pasojnë!”

(Shuara, 215.)

Allahu i Madhëruar, duke e cilësuar Profetin tonë ﷺ, si “Nebijju’r-Rahme / Profeti i mëshirës”, urdhëron:

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128.)

MËSHIRË PËR TË GJITHË

Mëshira ndaj fëmijëve. Kur një beduin e pa Profetin ﷺ, të puthte nipat e vet, u habit dhe i tha:

- Domethënë, ju i puthkeni fëmijët!
Ne nuk i puthim asnjëherë...

Profeti ynë ﷺ, ia ktheu menjëherë në çast duke i thënë:

“Çfarë mund të bëj unë nëse Allahu Teala ta ka shkukur dhe ta ka marrë mëshirën nga zemra! Ai që nuk mëshiron, nuk mëshirohet!” (Buhari, Edeb, 18; Muslim, Fedail, 65.)

Po ashtu, njëherë tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Vlerësojini fëmijët tuaj dhe edukojini mirë ata!” (Ibn Maxhe, Edeb, 3.)

Ai ishte mëshirë dhe ndihmë për vajzat e gjora që deri dje varroseshin të gjalla... Ndërsa sot, ai është mëshirë me anë

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...”

(Al-i Imran, 110.)



të parimeve mëshiruese që solli për të ndaluar abortimin e fëmijëve që në bark të nënës...

Mëshirë për gruan, e cila është përçmuar vazhdimisht gjatë gjithë historisë, duke i dhënë asaj vendin që i takon në familje dhe shoqëri:

“Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me bashkëshorten e tij dhe ka moralin më të bukur.” (Tirmidhi, Rada, 11/1162.)

Po ashtu, ai i dha vlerën që i takon edhe institucionit të mëmësisë, duke deklaruar se; *“Xheneti është nën këmbët e nënës.”* (Sujuti, I, 125.)

Ai ﷺ, ishte mëshirë edhe për fqinjin, për të drejtat e cilit porosiste edhe sahabët më të varfër, si Ebu Dherrin رضي الله عنه, duke i thënë:

“O Eba Dherr! Shtoji pak më tepër ujë supës tënde dhe kujdesu edhe për fqinjin tënd!” (Muslim, Birr, 142.)

Mëshirë për gjithë njerëzimin, duke dërguar sahabët e vet në katër anët e botës me misionin e udhëzimit në rrugën e drejtë.

Mëshirë për të dobëtit e të varfrit, duke i vënë ata në qendër të vëmendjes së të pasurve:

“Sillmëni të dobëtit, sepse vetëm falë tyre (lutjeve dhe begatisë) ndihmoheni dhe furnizoheni!” (Buhari, Xhihad, 76.)

“Allahu e ndihmon këtë popull për shkak të duave, namazeve dhe sinqeritetit të të dobëtëve.” (Nesai, Xhihad, 43.)



Çobani e lëshon tufën e tij në kullotë, e mban të pushojë dhe e ushqen atje. Pra, nuk e fut atë në tokë të shkretë. Nga kjo, mësojmë se ne duhet t'i rrisim fëmijët tanë në mjedise të bukura dhe me atmosferë shpirtërore.

Duke mos e zgjatur namazin, ai ﷺ, ishte mëshirë edhe për foshnjat që qanin pas nënave të tyre...

Ai ﷺ, ishte mëshirë edhe ndaj atyre që ishin armiq të tij... Ai i falte edhe ata që tentonin t'i merrnin jetën... Ai ﷺ, u lut edhe për ata që e gurëzuan në Taif... Ai ishte mëshirë edhe për armiqtë e vet në Mekë, të cilëve u dërgoi ushqim dhe ndihma në kohën e zisë... Ditën që çliroi Mekën, ai tregoi mëshirë ndaj armiqve të tij, të cilët kishin torturuar, vrrarë dhe plaçkitur myslimanët, duke u thënë, “...Sot s’ka qortim për ju!..” (Jusuf, 92.)...

Në saje të drejtësisë së tij edhe në luftë, ai ﷺ, ishte mëshirë për njerëzimin, robërit e luftës dhe skllëverit...

Ai ﷺ, ishte mëshirë për botët...

Ashtu siç ishte mëshirë për umetin e tij sa ishte gjallë, ai është mëshirë për ta edhe në botën tjetër... Mëshirë në këtë botë, duke iu përgjyruar Allahut, “Ummeti, Ummeti!..”, dhe mëshirë në ahiret, me shefatin e tij dhe mbledhjen e umetit të vet nën flamurin e falënderimit...

Çobani e mbron tufën e tij nga ujqërit dhe përbindëshat. Po kështu edhe ne duhet t'i mbrojmë fëmijët tanë nga filozofit e huaja helmuese. Po ashtu, çobani nuk ua lë ujqve as edhe një qengi të sëmurë apo të plagosur, por e merr në krahë dhe e bashkon me tufën.



Përfitimi prej mëshirës së tij, shtohet me përpjekjet që bëhen në rrugën e tij, sepse ëmbëlsia e besimit, gjendet tek mëshira dhe dhembshuria. Mëshira është një mirësi hyjnore që e afron robin me Zotin. Për rrjedhojë, edhe në pikën më kulmore të jetës fetare, duhet kërkuar mëshira. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar i lavdëron besimtarët duke thënë:

“...(Ata janë) të mëshirshëm midis tyre...” (shih. Fet’h, 29.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“*Rrahmani (Mëshiruesi), i mëshiron njerëzit mëshirues. Mëshirojini ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell!*” (Ebu Daud, Edeb, 58/4941.)

Por nuk duhet harruar se;

Mëshira, është ndjenja e dhembshurisë që ndjehet në zemër. Nëse kjo ndjenje nuk vë në lëvizje ndihmën, sakrificën, bujarinë dhe altruizmin, nuk vlen për asgjë. Sidomos ata që nuk u afrohen të vuajturve dhe nevojtarëve duke u justifikuar se janë shumë të ndjeshëm, janë edhe larg mëshirës së vërtetë, edhe larg Allahut...

Çobani e kontrollon gjithmonë tufën për të cilën është përgjegjës, duke i ardhur herë nga përpara, e herë nga prapa. Ndërsa ne nga kjo mësojmë se në shoqërinë tonë nuk duhet të lëmë askënd të privuar.



MËSHIRA E VËRTETË TREGOHET ME VEPRA

Në ditët tona, shohim pamje dhe raste të dhimbshme në mediat e përditshme, shprehim keqardhjen tonë për to dhe madje derdhim edhe lot, duke thënë “Allahu i ndihmoftë!”. Mirëpo, tek disa njerëz, për fat të keq nuk shihet edhe aq shumë përpjekja dhe dëshira për të shfaqur mëshirën me vepër, duke “u qarë hallin vëllezërve të tyre” apo duke menduar se, “çfarë mund të bëjë ai për t’u ardhur në ndihmë nevojtarëve”.

Mëshirë, nuk do të thotë vetëm të hidhërohesh apo të prekesh në shpirt. Mëshirë, do të thotë të ndash atë që ke, me

atë që nuk e ka. Mëshirë, do të thotë të jesh i gatshëm t'i thuasht një vëllai nevojtar, “ja shtëpia ime! ja pasuria ime! gjysma e saj është e jotja!”

Mëshirë;

Është sakrifica që bëri sahabiu, i cili, kur zbriti ajeti: “... **Kurrë nuk keni për ta arritur mirësinë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!..**” (Al-i Imran, 92), i fali një të varfri kopshtin e tij të hurmave që e donte shumë.

Mëshirë;

Është shfaqja madhështore e altruizmit të sahabëve të varfër të suffes, të cilët kur zbriti ajeti i dhurimi, nuk u justifikuan duke thënë, “unë s’kam asgjë, nuk e kam për detyrë!”, por u ngritën, shkuan në mal, bën dru dhe fitimet nga shitja e tyre i dhuruan për nevojtarët e tjerë.

Mëshira e vërtetë, tregohet bukur edhe në këtë ndodhi të përjetuar nga Profeti ynë ﷺ dhe sahabët e tij:

Xherir bin Abdullahu ﷺ, tregon:

“Një ditë ishim mbledhur pranë të Dërguarit të Allahut herët në mëngjes. Në një moment ia behu një grup të varfërish prej fisit Mudar. Në trupat e tyre gjendej një mbulesë e thjeshtë me vija, që i ngjante lëkurës së tigrit. Ata e kishin shpuar në mes këtë mbulesë dhe e kishin futur në kokë. Mirëpo, ishin pothuajse të zhveshur.

Kur i pa ata në një gjendje kaq të varfër, të Dërguarit të Allahut ﷺ, i ndryshoi

Aliu ﷺ: “Mos i shih njerëzit, siç i sheh egërsira kopetë! Ushqeje zemrën me dashuri, dhembshuri dhe mirësi ndaj tyre, sepse pa përjashtim, çdo njeri është ose vëllai yt në fe, ose i njëjtë me ty në krijim.”



ngjyra e fytyrës. Ai hyri menjëherë në shtëpinë e tij. Pastaj e urdhëroi Bilalin ﷺ, të thërrasë ezanin. Bilali ﷺ e thirri ezanin, e më pas ikametin. Pasi Profeti ﷺ, fali namazin, u ngjit në hutbe dhe këndoi këtë ajet fisnik:

«O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.» (Nisa, 1.)

Më pas këndoi këtë ajet:

«O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen!..» (Hashr, 18.)

Pas kësaj, ai tha:

«Të gjithë të japin sadaka prej arit, argjendit, veshjeve dhe sado pak qoftë, prej grurit dhe hurmave të tyre. Madje, të japë sadaka edhe në qoftë ajo një gjysmë hurme!»

Pa kaluar shumë, një person prej ensarëve, solli një çantë të rëndë, të cilën nuk e mbante dot. Të gjithë hynë në radhë njëri pas tjetrit për të dhënë sadaka. Në fund, pashë që u bën dy grumbuj me ushqime dhe veshje. Më pas, vura re se të Dërguarit të Allahut po i qeshte fytyra që i shndriste si flori...” (Muslim, Zekat, 69.)

“Njerëzit mund të gabojnë dhe mund t’u ndodhë ndonjë gjë. Kape prej dore atë që rrëzohet, Nëse dëshiron faljen e Allahut për veten, fali edhe ti njerëzit e tjerë, e lehtësoji ata! Asnjëherë mos kundërshtoj urdhrat e Allahut! Mos u pendoj për shkak të faljes së bërë, por edhe mos u gëzoj për shkak të dënimit të dhënë!”



Profeti ynë ﷺ, nuk zuri rehat, pa i rehatuar ata. Në fakt, edhe sahabët nuk ishin shumë të pasur. Por kishin zemër të madhe. Prandaj, ata ndanë me nevojtarët çdo gjë që kishin për t'u zgjidhur hallin atyre.

PËRFSHIRJA E MËSHIRËS

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Betohem tek Allahu, në duart e të cilit është shpirti im, se nuk keni për të hyrë në Xhenet, përderisa të mos mëshironi njëri-tjetrin.”

Sahabët, që i dëgjuan këto fjalë, thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne të gjithë jemi njerëz që kemi mëshirë për të tjerët.”

I Dërguari i Allahut tha:

“Mëshira për të cilën e kam fjalën unë, nuk është ajo lloj mëshire që kuptoni ju, pra (thjesht) të keni mëshirë për njëri-tjetrin. Unë flas për mëshirën që përfshin gjithë krijesat!” (Hakim, Mustedrek, IV, 185/7310.)

Mëshirë jo vetëm ndaj atyre që kërkojnë, por sidomos ndaj atyre që e fshehin gjendjen e tyre nga turpi... sepse kërkimi dhe gjetja e tyre është detyrë e çdo besimtari...

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të

Islami përfaqëson një shpirt që u afrohet njerëzve me dashuri të thellë. Ndjenja e përgjegjësisë që shpërthen prej farës së mëshirës që Islami ka vendosur në zemra, e çon njeriun drejt përsosmërisë së sjelljeve dhe në fund, në lumturinë e të dyja botëve.



cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273.)

Ajeti shprehet se, “**kush nuk i njeh, mendon se ata janë të kamur**”. Por, menjëherë më pas, thotë se “**ti do t'i njohësh ata nga pamja e tyre**”. Lidhur me këtë fjali, komentuesit thonë:

“Ty (Muhamed) dhe ndjekësve të tu, nuk ju shkon të jeni të pavëmendshëm ndaj vëllezërve tuaj nevojtarë, duke i konsideruar të panevojshëm për shkak se “nuk kërkojnë”. Zemra juaj, duhet të jetë si një skaner, e ndjeshme dhe e përpiktë, që i njeh në pamje të jashtme ata që janë me të vërtetë nevojtarë, edhe pse ata nuk e shprehin nevojën e tyre. E në fakt, kjo është urtësia e një besimtari larg-pamës.”

Ndërsa vetë i Dërguari i Allahut ﷺ, nisur nga ky ajet, ka thënë:

“I varfër nuk është ai që lyp një apo dy hurma, një apo dy kafshata. I varfër është ai i cili, edhe pse heq keq dhe ka nevojë, nuk kërkon gjë nga askush, për shkak të nderit dhe të edukatës së tij. Nëse kërkon, lexoni ajetin; «...Nuk kërkojnë gjë nga njerëzit me këmbëngulje...» (el-Bekare, 273)” (Muslim, Zekat, 102.)

Sa bukur shprehet shejh Sadi:

*Vakëfi, është forma
e institucionalizuar
e mëshirës,
dhembshurisë dhe
dashurisë ndaj
krijesave për hir të
Krijuesit.*



“Vëlla besimtar! Bëhu i mëshirshëm dhe i dhembshur! Ec në rrugën e njerëzve të mirë! Ti që je në këmbë, kape për dore dhe ngrije atë që ka rënë! Bëje zemrën si një kopsht lulesh! Dije se, miqtë e Allahut më shumë blejnë aty ku nuk blejnë të tjerët!”

ÇELËSI I KUMTIMIT

Mëshira, është edhe cilësia e pandashme e përfaqësimit dhe kumtimit, që janë dy prej detyrave më të rëndësishme të besimtarit. Zemra e bekuar e Profetit tonë ﷺ, u përgatit nga Allahu për detyrën e profetësisë, duke iu pastruar nga çdo gjë negative dhe duke iu mbushur me dhembshuri dhe mëshirë.

Pra;

Ai që do të marrë përsipër detyrën e kumtimit, pikësëpari duhet t’ia fillojë nga vetja, duke pastruar zemrën e vet nga çdo ndjenjë negative dhe duke e stolitur atë me dhembshuri dhe mëshirë.

*Qytetërimet e rreme,
të cilat janë larg
dhembshurisë dhe
mëshirës, ngrenë
monumentet e
pakuptimta dhe të
vdekshme të artit
dhe pandershmërisë,
krenarisë dhe
mendjemadhësisë,
duke qenë larg Artistit
Madhështor.*



Një shembull i bukur i atyre që kanë jetuar me këto kritere të morali të bukur, është edhe njëri prej të devotshmëve, Fudajl bin Ijadi:

Një ditë, Fudajl bin Ijadin e panë duke qarë dhe e pyetën:

Përse po qan?

“Qaj për shkak të një personi që më bëri padrejtësi. Kam frikë se ditën e gjyqimit ai do të poshtërohet!”

Ndikimi pozitiv i mëshirës në çështjen e kumtimit, mund të shpjegohet kështu:

Një farë e hedhur në tokë të thatë, nuk jep filiza përnjëherë. Por, nëse e ujisim pak atë tokë, për ta bërë atë të gatshme ta pranojë farën që keni hedhur në të, ajo nuk do të vonojë të japë lulet dhe frutat e saj.

Kështu, kur edhe zemra e atyre që kemi përballë gjatë kumtimit, të zbutet me dashuri, dhembshuri, mëshirë, gjuhë të ëmbël, fytyrë të qeshur dhe bujari, edhe këshillat dhe porositë do të jenë më të lehta për to.

Përndryshe, nëse i trajtojmë me vrazhdësi, njerëzit largohen, shoqëria përçahet dhe, mbase si pasojë e kësaj sjelljeje jo delikate, askush nuk të afrohet më.

Për rrjedhojë;

Besimtari, duhet të jetë i mprehtë si drita e hënës në një natë të errët e pa re, i ndjeshëm, altruist, mëshirues, i dhembshur dhe bujar.

Padyshim se, për ta arritur këtë gjendje në të gjitha sjelljet dhe veprimet tona dhe për ta harruar zemërimin, duke vepruar me dhembshuri dhe mëshirë, duhet ta ngremë mëshirën mbi të gjitha dashuritë. Kjo nuk është një punë e lehtë; por është një fitore e zemrës.

Aliu عليه السلام, në një ferman që i dërgon valiut/gubernatorit të Egjiptit, Malik bin Harisit عليه السلام, thotë:

“Mos i shih njerëzit, siç i sheh egërsira kopetë! Ushqeje zemrën me dashuri, dhembshuri dhe mirësi ndaj tyre, sepse, pa përjashtim, çdo njeri është ose vëllai yt në fe, ose i njëjtë me ty në

Në qytetërimin e të parëve tani, gjen gjithmonë xhami të ndërtuara me sinqeritet dhe devotshmëri, shkolla të dijes dhe kulturës, biblioteka dhe qendra të edukimit shpirtëror. E në mënyrë të veçantë, vepra që janë tregues të mëshirës, si mensa për të varfrit, çezma, spitale, karvansaraje, shtëpi për jetimet, shkolla me konvikte falas dhe strehimore për të pastrehët.



krijim. Njerëzit mund të gabojnë dhe mund t'u ndodhë ndonjë gjë. Kape për dore atë që rrezohet. Nëse dëshiron faljen e Allahut për veten, fali edhe ti njerëzit e tjerë, e lehtësoji ata! Asnjëherë mos kundërshtoj urdhrat e Allahut! Mos u pendoj për shkak të faljes së bërë, por edhe mos u gëzo për shkak të dënimit të dhënë!”

Islami përfaqëson një shpirt që u afrohet njerëzve me dashuri të thellë. Ndjenja e përgjegjësisë që shpërthen prej farës së mëshirës që Islami ka vendosur në zemra, e çon njeriun drejt përsosmërisë së sjelljeve, dhe në fund, në lumturinë e të dyja botëve.

Kështu, edhe të parët tanë, të cilët e pasuan me dashamirësi dhe bindje Profetin tonë ﷺ, dhe shokët e tij fisnik, përfaqësuan një nivel të lartë të mëshirës. Ja vakëfet që kanë gdhendur njëmijenjë kujtime në qytetet tona të vjetra dhe në siluetën e Stambollit:

“Allahu i Madhëruar është Rafik (i Butë) dhe i pëlqen që në çdo çështje të veprojë me butësi. Allahu i Madhëruar e do çdo zemër të mbushur me frikë-respekt ndaj Tij, të trishtuar, të mëshirshme, që u mëson njerëzve të mirën dhe që i fton ata t'i binden Allahut...”
(Dejlemi, Musned, I, 158.)



QYTETËRIMI I MËSHIRËS

Vakëfi, është forma e institucionalizuar e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit.

Vakëf, do të thotë të kapërcesh sproven e pasurisë dhe fëmijëve dhe t'ia kthesh Allahut amanetin e pronës. Krahas kësaj, do të thotë të institucionalizosh mirësinë dhe bamirësinë që është forma më konkrete e dhembshurisë dhe mëshirës, duke ndërtuar kështu monumentet e një qytetërimi mëshire.

Qytetërimet e rreme, të cilat janë larg dhembshurisë dhe mëshirës, ngrenë mon-

umentet e pakuptimta dhe të vdekshme të artit dhe pandershmërisë, krenarisë dhe mendjemadhësisë, duke qenë larg Artistit Madhështor. Ata ndërtojnë arena ku hedhin qeniet njerëzore në gojë të egërsirave. Ndërtojnë pallate ku argëtohen si të çmendur, në mënyrë egoiste dhe moskokëçarëse. Madje, për të shfaqur fuqinë dhe pushtetin e tyre, ata e lartësojnë padrejtësinë dhe mendjemadhësinë duke ngritur piramida nën forcën e dhunës dhe ndjehen të kënaqur nga lavdet që u thurin servilët dhe duartrokitjet e tyre të shëmtuara. Por, do të vijë dita që ata do të shkatërrohen, dhe në monumentet e tyre të mendjemadhësisë, do të shëtisin qentë.

“Allahu e urren zemrën e ngurtë, që merret me gjëra pa vlerë, që kalon gjithë natën në gjumë duke mos e ditur se, a do t'i kthehet më shpirti apo jo dhe që e përkujton shumë pak Allahun.” (Dejlemi, Musned, I, 158.)



Ndërsa në qytetërimin e të parëve tani, gjen gjithmonë xhami të ndërtuara me sinqeritet dhe devotshmëri, shkolla të dijes dhe kulturës, biblioteka dhe qendra të edukimit shpirtëror. E në mënyrë të veçantë, vepra që janë tregues të mëshirës, si mensa për të varfrit, çezma, spitale, karvansaraje, shtëpi për jetimët, shkolla me konvikte falas dhe strehimore për të pastrehët.

Populli që e kuptoi dhe e jetoi Islamit në mënyrën më të bukur dhe me ndjenja të thella, në këtë mënyrë ia shfaqti botës të gjithë dhembshurinë dhe mëshirën që ekziston në zemrën e myslimanit. Ata e thurën shoqërinë me qindra fondacione/vakëfe dhe nuk lanë thujse asnjë plagë pa kuruar.

Këto, ishin fondacione të atilla, që kishin marrë përsipër të shpaganin qoftë edhe një dëm të vogël që kishte shkaktuar padashje ndonjë shërbyes në shtëpinë ku shërbente, me qëllim që të mos qortohej apo dënohej nga pronari. Madje kishte

edhe fondacione që përgatisnin pajën e vajzave të varfra ose jetime dhe fondacione që kuronin zogjtë shtegtarë të cilët plagoseshin gjatë rrugës.

Ato ishin spitale që i kuronin të sëmurët mendor me melodinë e ujit dhe zëra harmonikë. Madje, ata nuk i quanin, “të çmendur”, por “të dobëtit e nderuar”.

Ato ishin karvansaraje që u shërbenin udhëtarëve tri ditë pa pagesë.

Ata kishin një horizont shërbimi të atillë, që në një anë u shuanin etjen haxhinjve në Hixhaz, në një anë siguronin lëndën djegëse të fukarenjve, në një anë tjetër shpërndanin sherbet prej çezmave, e në një anë tjetër caktonin punëtorë për të hedhur hi mbi pështymat e kalimtarëve në rrugë...

Një mëshirë dhe dhembshuri e pashoqe; një qytetërim madhështor i mëshirës...

*Në ditët tona,
virtuti që do ta bëjë
besimtarin të jetojë
me dashurinë dhe
pasionin e besimit
dhe do ta shpëtojë
prej tundimeve të
egos, duke ia thelluar
shpirtin, është vetëm
mëshira.*



Një shoqëri e tillë, ku nuk ka asnjë të pasur që nuk financon një vakëf apo vepërimtari bamirës... Një shoqëri e tillë, ku gratë e pasura garojnë me njëra-tjetrën për të bërë bamirësi me stolitë e tyre...

Një shoqëri e tillë, ku falë formulës së gurëve të sadakasë, sigurohej dinjiteti i atij që merrte sadaka dhe modestia e atij që jepte...

Një shoqëri e tillë, e cila, në një kohë kur në përfundim padrejtësia, mjerimi dhe të mjerët bëheshin romane, ajo merrej me shkrimin e historive të vërteta të lumturisë, mëshirës dhe dhembshurisë.

Kjo shoqëri mëshire, të cilën sot e përkujtojmë me admirim, ishte qytetërimi ynë i vërtetë, sepse çdo qytetërim, nxjerr në pah tipin e vet të njeriut. Dhe, lloji i njeriut që ka nxjerrë në pah qytetërimi ynë, përmbante këto cilësi që përmbliidhen në këtë hadith fisnik:

“Allahu i Madhëruar është Rafik (i Butë) dhe i pëlqen që në çdo çështje të veprojë me butësi. Allahu i Madhëruar e do çdo zemër të mbushur me frikë-respekt ndaj Tij, të trishtuar, të mëshirshme, që u mëson njerëzve të mirën dhe që i fton ata t’i binden Allahut. Po ashtu, Ai e urren zemrën e ngurtë, që merret me gjëra pa vlerë, që kalon gjithë natën në gjumë duke mos e ditur se, a do t’i kthehet më shpirti apo jo dhe që e përkujton shumë pak Allahun.” (Dejlemi, Musned, I, 158.)

*Frutat e mëshirës,
janë bujaria,
modestia,
shërbimi, falja
dhe shpëtimi nga
smira. Dhe burimi
i të gjitha këtyre,
është besimi.*



ZGJIDHJA ËSHTË MËSHIRA

Edhe sot në ditët tona, virtyti që do ta bëjë besimtarin të jetojë me dashurinë dhe pasionin e besimit dhe do ta shpëtojë prej tundimeve të egos, duke ia thelluar shpirtin, është vetëm mëshira. Ndërsa frutat e mëshirës, janë bujaria, modestia, shërbimi, falja dhe shpëtimi nga smira. E, burimi i të gjitha këtyre, është besimi.

Po ashtu, ajo që do t’i mbrojë familjet e sotme nga shkatërrimi dhe do t’i mbajë të bashkuara, është dashuria dhe mëshira.

Sekreti që do ta shpëtojë popullin Islam nga përçarjet, krimet dhe terrori, është vëllazëria dhe mëshira.

I lutemi Allahu të Madhëruar, të na bëjë njerëz të mëshirës në këtë botë, ku sot po garohet me tepër në punë të këqija; të na bëjë njerëz të mëshirës, të cilët në kundërshtim me egërsinë e qytetërimit perëndimor, të shfaqim dashurinë dhe pasionin besimit!

O Allah! Na bëj prej robërve të Tu të sinqertë, që me mëshirë dhe dashuri i shfaqin gjithë botës bukurinë dhe shpirtin e madh të Islamit!

O Zot!

Na rretho më mëshirën Tënde!.. Na mbyt në mëshirën Tënde!.. Na dhuro mëshirën Tënde!.. Na e bëj të mundur të shfaqim madhështi me moralin tonë!.. Na i zbukuro zemrat dhe mendjet tona me bukuritë e Tua!..

Amin!..



Krijimi ynë si qenie njerëzore, nderimi me mirësinë e besimit dhe me të qenët umeti i Kuranit dhe Profetit të fundit, janë të gjitha begati dhe dhurata të jashtëzakonshme hyjnore që na jepen pa asnjë mund e çmim.



أَرْحَمُوا مَنْ فِي الْأَرْضِ
يُرْحَمُكُمْ
مَنْ فِي السَّمَاءِ

BUJARIA

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i mëshiron ata që mëshirojnë.

Mëshirojini ata që janë në tokë, që të

mëshiroheni prej atyre në qiell!..” (Ebu Davud, Edeb,

58/4941; Tirmidhi, Birr, 16/1924; Ahmed ibn Hanbel, II, 160.)



BUJARIA

FARZET/OBLIGIMET FETARE

Një pjesë e detyrave tona të devotshmërisë, që Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh, janë adhurimet fizike, si pesë namazet ditore, agjërimi i Ramazanit, dhënia e zekatit dhe kryerja e haxhit. Por, vetëm kryerja e këtyre adhurimeve, nuk e plotëson ashtu siç duhet detyrën tonë të devotshmërisë ndaj Allahut. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, kur na ka bërë të ditur qëllimin e krijimit tonë, është shprehur «لِيَعْبُدُونِ» / “që të më adhurojnë Mua!”. Mirëpo, komentuesit e Kuranit, e kanë interpretuar këtë shprehje, si «لِيَعْرِفُونِ» / “që të më njohin Mua”. Dhe, njohja e Allahut bëhet me zemër, gjë që arrihet vetëm në saje të zhvillimit shpirtëror. Për rrjedhojë, krahas adhurimeve fizike, ne jemi të ngarkuar edhe me adhurimet që kanë të bëjnë me moralin, si edukata, mëshira, bujaria, drejtësia, modestia, sinqeriteti, dashamirësia, ndershmëria, turpi, frika ndaj Allahut, devotshmëria dhe durimi.

Të gjitha këto adhurime, si ato fizike e si ato që kanë të bëjnë me moralin, duhet të jenë të ndërthurura me njëra-tjetrën, me qëllim që robi të arrijë plotësisht kënaqësinë e Allahut.

Imam Rabbani ka thënë:

“Pasi të kemi zbukuruar anën tonë të jashtme sipas kriterëve sheriatike, duhet të orientohemi kah ana jonë shpirtërore me qëllim që veprat tona të mos përlayhen me indiferencë. Pa mbështetjen e anës sonë shpirtërore, përshtatja e anës sonë të jashtme me vendimet sheriatike është diçka shumë e vështirë.”

Pra, ashtu siç nuk mund të plotësohet devotshmëria vetëm duke kryer adhurimet fizike, ashtu nuk mund të plotësohet edhe vetëm duke thënë “zemra ime është e pastër”.

Dy nga adhurimet morale më të rëndësishme, janë mëshira dhe bujaria.

KËSHILLA HYJNORE

Allahu i Madhëruar, më së shumti i drejtohet njeriut duke u prezantuar me emrat **“Rrahman dhe Rrahim”**. Ai na ka bërë t’i përmendim këto dy emra vazhdimisht në çdo Bismilah dhe çdo Fatiha. Po ashtu, Ai, edhe Profetin tonë të nderuar ﷺ, e ka dërguar si “Mëshirë për botët”. Për këtë arsye, Allahu Teala dëshiron që çdo besimtar të jetë një njeri i mëshirshëm.

Mëshira është fruti i besimit!

Është e pamendueshme që një zemër e cila thotë “Allah”, të jetë larg mëshirës dhe bujarisë, që është edhe manifestimi i saj. Një besimtar i përkryer, nuk mund të qëndrojë moskokëçarës ndaj rënkimeve



Imam Rabbani: “Pasi të kemi zbukuruar anën tonë të jashtme sipas kriterëve sheriatike, duhet të orientohemi kah ana jonë shpirtërore me qëllim që veprat tona të mos përlayhen me indiferencë...”

me zë e pa zë të asnjërës prej krijesave të Allahut, por bën gjithçka që mundet për t'i ardhur në ndihmë.

Ashtu siç ishte vetë kulmi i mëshirës, Profeti ynë ﷺ, ia ka këshilluar mëshirën gjithëpërfshirëse edhe shokëve të tij. Mëshirën që tregohet ndaj fëmijës, e zotëron edhe kafsha më e egër. Ndërsa mysli mani, nuk duhet të ndjejë mëshirë vetëm për fëmijën apo të afërmin e vet, por duhet të zotërojë një mëshirë gjithëpërfshirëse për të gjithë besimtarët, njerëzimin dhe të gjitha krijesat.



Imam Rabbani:

“Pa mbështetjen e anës sonë shpirtërore, përshtatja e anës sonë të jashtme me vendimet shariatike është diçka shumë e vështirë.”

ÇERDHJA E MËSHIRËS...

Padyshim se, një nga elementët më kryesor të institucionit të familjes, është mëshira. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rum, 21.)

Ndërsa mëshira që duhet treguar ndaj fëmijës, nuk duhet të bëhet për të arritur thjesht mirëqenien në këtë botë, por duke marrë parasysh edhe lumturinë e tij në botën tjetër.

Edukimi i një fëmijë në aspektin fetar, është mëshira më e madhe që mund të tregojnë prindërit e tij për të, sepse qëllimi ardhjes sonë në këtë botë, është përgatitja për botën tjetër.

Me pak fjalë, në jetën e një besimtari, duhet të shfaqet gjithmonë mëshira. Fatmirësia më e madhe për një besimtar,

është zotërimi i cilësisë së mëshirës dhe përhapja e saj përgjatë gjithë jetës tek familja dhe shoqëria e tij.

Bujaria është manifestimi fizik i mëshirës.

Besimtari ka nevojë për mëshirën e Zotit të vet. Jo më kotë, në ajetet e fundi të sures Bekare, të cilat këshillohemi t'i lexojmë përditë, zë vend lutja « **وَارْحَمْنَا** : **na mëshiro** ». Po ashtu, shkak i arritjes së mëshirës hyjnore, është po mëshira.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i mëshiron ata që mëshirojnë. Mëshirojini ata që janë në tokë, që të mëshiroheni prej atyre në qiell!..” (Ebu Davud, Edeb, 58/4941; Tirmidhi, Birr, 16/1924; Ahmed ibn Hanbel, II, 160.)

Kjo histori që e transmeton Ebu Abdullah el-Harithu'r-Razi, është një shembull i bukur që tregon se si arrihet mëshira hyjnore në saje të mëshirës dhe bujarisë:

Allahu Teala i shpalli njërit prej profetëve:

“Unë kam vendosur që filan rob i Imi ta kalojë gjysmën e jetës me varfëri dhe gjysmën tjetër me pasuri. Cilën të kërkojë më parë, atë do t'i jap. Pyete, në mënyrë që ta shprehë dëshirën e tij!”

Ai profet e thirri personin që u përmend dhe e njoftoi për shpalljen që kishte ardhur.

Personi tha:

- Do të të jap përgjigje pasi të konsultohem me familjen.

Muajt Rexheb dhe Shaban, duhet të kalohen në atmosferën e adhurimeve, me qëllim që të arrijmë nivelin e duhur shpirtëror për Ramazanin e bekuar.



Pasi u konsultua, bashkëshortja e tij i tha:

- Zgjidh që të marrësh pasurinë së pari!

- Varfëria pas pasurisë është shumë e vështirë. Ndërsa pasuria pas varfërisë është shumë më e mirë. – ia ktheu burri.

- Vepro siç të thashë në lidhje me këtë çështje! – tha bashkëshortja me këmbëngulje.

Personi shkoi te Profeti dhe i tha:

- Po zgjedh të marr pasurinë në fillim!

Allahu i Madhëruar, ia hapi atij të gjitha dyert e pasurisë.

Atëherë, bashkëshortja i tha:

“Tani; nëse dëshiron që kjo mirësi të jetë e vazhdueshme deri në fund të jetës tënde, ji bujar kundrejt robërve të Allahut! Kur të marrësh një rrobë për vete, merre një rrobë edhe për një të varfër!”

Pasi e jetuan gjysmën e parë të jetës në bollëk, duke e falënderuar Zotin ashtu siç duhet, Allahu Teala iu drejtuar përsëri profetit dhe e urdhëroi:

“Unë pata caktuar që ai robi Im ta kalonte gjysmën e jetës me pasuri dhe gjysmën tjetër me varfëri. Por vura re se ai robi Im më falënderoi për të gjitha mirësitë. Falënderimi e bën të detyrueshëm shtimin dhe vazhdimësinë e mirësisë. Andaj përgëzoje se kam caktuar që edhe pjesën tjetër të jetës ta kalojë me pasuri!” (Ramazanogllu Mahmud Sami, Komentimi i sures Bekare, fq. 33-34.)

Ramazani duhet të kalohet i dendur me adhurime dhe devotshmëri, që Allahu i Madhëruar të na e bëjë të mundur përjetimin e Natës së Kadrit, e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj. Në këtë mënyrë, në mëngjesin e Ditës së Bajramit, besimtarët do të marrin përgëzimin dhe diplomën e faljes hyjnore.



Mirëpo, bujaria është me grada dhe, kulmi i saj është isari, pra, të mendosh për të tjerët, ndërkohë që je nevojtar për vete.

SAKRIFICË PREJ VETES

Ata që sakrifikojnë prej vetes dhe u japin të tjerëve duke qenë edhe vetë nevojtarë, janë lavdëruar kështu në Kuranin Fisnik:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: «Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.» Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim dhe, për durimin e tyre, Ai do t’i shpërblejë me Xhenet dhe petka të mëndafshta.” (Insan, 8-12.)

*Ndjenja më e bukur
njerëzore që e kënaq
më tepër Allahun,
është mëshira dhe
bujaria. E në mënyrë
të veçantë, isari,
bamirësia ndaj të
tjerëve kur je vetë
nevojtar...*



Transmetohet se këto ajete janë zbritur në lidhje me Aliun ﷺ dhe bashkëshorten e tij Fatime ﷺ, të cilët agjëruan tri ditë me radhë dhe ushqimin e vetëm që kishin për të bërë iftar, ua shpërndanë të varfërve, jetimëve dhe robërve që u vinin tek dera dhe u kërkonin diçka për hir të Allahut.

Sot, edhe ne e kemi për detyrë të ndihmojmë të varfrit, nevojtarët, jetimët apo emigrantët që mbeten rrugëve. Sa i përgjigjemi ne lutjes së tyre, “më jep për hir të Allahut”? Sa mëshirë dhe sa bujari kemi?

Ne kërkojmë gjithmonë prej Allahut, prej bujarisë, mëshirës dhe begatisë së Tij. Por sa japim ne për ata që kërkojnë prej nesh, për ata që na janë lënë amanet?

BEGATIA E TRE MUAJVE

Allahu i Madhëruar, me mirësinë e Tij, na ka falur ditë dhe muaj të veçantë, në të cilët begatia e Tij është më e madhe se në kohë të tjera. Këto kohë, nuk ndryshojnë shumë nga kohët e tjera në aspektin fizik dhe gjeografik. Por, Allahu i Madhëruar, në këto muaj ka vendosur begati të mëdha për robërit e Tij besimtarë, me qëllim që të shtojë motivimin dhe entuziazmin e tyre në përpjekjet për të kryer sa më shumë mirësi dhe adhurime.

Në dy muajt e parë të këtij sezoni begatie, na bëhet e mundur të përgatitemi për muajin e Ramazanit, rëndësinë e të cilit po e përshkruajmë me këtë shembull:

Namazi është qëndrimi i robit para Allahut, i Cili e pranon robin e vet pasi të ketë bërë disa përgatitje më parë. Pra, Allahu i Madhëruar, i ka kërkuar robin të pastrohet nga papastërtitë me anë të gusullit dhe abdesit. Ai i ka vënë kusht robin që të pastrojë trupin, veshjet dhe vendin ku do të falet. Po ashtu, e ka urdhëruar që të pastrojë edhe zemrën e vet, duke e përcaktuar mirë qëllimin/nijetin për adhurim. Para se të qëndrojë në namaz, Allahu dëshiron që robi të veshë rrobat më të bukura dhe të pastra, të largojë zemrën dhe mendjen nga çdo gjë e kësaj bote dhe të kthehet me trup e me zemër në drejtim të Qabes. Kështu, qetësia dhe përkushtimi që kërkohet

Edhe nëse nuk kemi mundësi për ndihmë materiale, buzëqeshja dhe fjalët e ëmbla janë mirësi që nuk duhet t'u kursehen njerëzve. Gjithsesi, një besimtar, duhet t'i ndihmojë të tjerët gjithmonë me ç'të ketë mundësi.



për namazin, shtohet në përputhje me kujdesin që tregohet ndaj këtyre përgatitjeve paraprake.

Pra, edhe për Ramazanin duhet të bëhen përgatitje të njëjta fizike dhe shpirtërore. Transmetohet se Dërguari i Allahut ﷺ, kur vinte muaji Rexheb, lutej kështu:

اللَّهُمَّ بَارِكْ لَنَا فِي رَجَبٍ وَسَعْبَانَ، وَبَلِّغْنَا رَمَضَانَ

“O Allah! Na begato Rexhebin e Shabanin dhe na mundëso Ramazanin!” (Taberani, el-Mu’xhemu’l-Eusat, IV, 189; shih. Ahmed, I, 259)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, na këshilluar të agjërojmë herë pas here gjatë muajve të shenjtë, brenda të cilëve gjendet edhe muaji Rexheb. (shih. Ebu Daud, Saum, 54.) Ndërsa vetë ai, disa vite e ka agjëruar thuajse të gjithë muajin Rexheb. (shih. Buhari, Saum, 53; Muslim, Sijam, 179; Ebu Daud, Saum, 55.) Krahas kësaj, transmetohet se muaji Shaban, është muaji në të cilin i Dërguari i Allahut ﷺ, ka agjëruar më tepër se në çdo muaj tjetër, jashtë Ramazanit. (shih. Buhari, Saum, 51.)

Nisur nga këto, kuptohet se i Dërguari i Allahut ﷺ, ka dëshiruar që edhe ne të përgatitemi shpirtërisht për muajin e Ramazanit, duke agjëruar, duke falur namaze vullnetare dhe duke bërë bamirësi për hir të Allahut.

Shembuj të një përgatitje të tillë shpirtërore dhe fizike para takimit me Allahun, e gjejmë edhe tek profetët e tjerë:

Para se Allahu i Madhëruar ta merrte në takim Musain ﷺ, në Malin Tur, e urdhëroi atë të agjëronte 30 ditë, duke i

Sahabët janë shoqëria shembullore që Allahu i Madhëruar na ka prezantuar si model për arritjen e kënaqësisë së Tij.



shtuar këtyre edhe 10 ditë tjera më vonë. Pra, gjithsej 40 ditë agjërime për t'u takuar me Allahun. E njëjta gjë ndodhi edhe me Isain ﷺ.

Për rrjedhojë, muajt Rexheb dhe Shaban, duhet të kalohen në atmosferën e adhurimeve, me qëllim që të arrijmë nivelin e duhur shpirtëror për Ramazanin e bekuar. Po ashtu, edhe Ramazani duhet të kalohet i dendur me adhurime dhe devotshmëri, që Allahu i Madhëruar të na e bëjë të mundur përjetimin e Natës së Kadrit, e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj. Në këtë mënyrë, në mëngjesin e Ditës së Bajramit, besimtarët do të marrin përgëzimin dhe diplomën e faljes hyjnore.

Lum ata besimtarë që do të arrijnë të gëzojnë lavdërimin e Allahut të Madhëruar në këto muaj të bekuar!

Ndjenja më e bukur njerëzore që e kënaq më tepër Allahun, është mëshira dhe bujaria. E në mënyrë të veçantë, isari, bamirësia ndaj të tjerëve kur je vetë nevojtar...

Isari është një cilësi e veçantë e myslimanëve të Medinës, Ensarëve, lidhur me të cilët Allahu i Madhëruar është shprehur:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Hashr, 9.)

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim...” (Teube, 100.)



Kjo ndodhi, e cila transmetohet si shkak i zbritjes së këtij ajeti, është shembull i bukur i vetëmohimit të ensarëve:

Ebu Hurejre رضي الله عنه, tregon:

“Njëherë, një person shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ, dhe i tha:

«Jam i uritur!»

I Dërguari i Allahut ﷺ, çoi fjalë te një nga gratë e veta që t’i sillnin për të ngrënë. Mirëpo, ajo, nëna jonë, tha:

«Betohem në Allahun që të ka dërguar si profet, se në shtëpi nuk ka asgjë tjetër përveç ujit!»

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut ﷺ, kërkoi për të ngrënë te një nga gratë e tjera. Por edhe ajo i dha të njëjtën përgjigje. Me të marrë të njëjtën përgjigje edhe nga gratë e tjera; pra, «Betohem në Allahun që të ka dërguar si profet, se në shtëpi nuk ka asgjë tjetër përveç ujit!», I Dërguari bujar ﷺ, u kthye nga sahabët e tij dhe i pyet:

«Cili nga ju dëshiron ta mikpres këtë person sot?»

Njëri nga Ensarët tha:

«E mikpres unë o i dërguar i Allahut.» E më pas, e merr të varfrin dhe e çon në shtëpinë e tij. Kur arritën në shtëpi, i thotë gruas:

Zekati është sasia minimale që duhet të jepet. Dhënia e zekatit, më tepër se shfaqje e një virtyti, është shlyerje e një borxhi, sepse zekati është e drejta e të varfrit në pasurinë e besimtarit të pasur. Për rrjedhojë, kush nuk e paguan atë, do të thotë se ka grabitur të drejtën e dikujt.



«Sot kemi mysafir mikun e Profetit ﷺ! A ka gjë për të ngrënë në shtëpi?»

Gruaja e tij i përgjigjet:

«Jo, ka vetëm aq sa mund të ushqej fëmijët e mi!»

Sahabi tha:

«Atëherë largoja vëmendjen fëmijëve dhe, nëse duan të afrohen në sofër, vëri në gjumë. Kur mysafiri të hyjë brenda shuaje llambën ndërsa ne të shtiremi sikur po hamë bashkë me të në sofër.»

U ulën në sofër. Mysafiri u ngop, ndërsa i zoti i shtëpisë fjeti i uritur. Në mëngjes, sahabi shkoi pranë Profetit ﷺ. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, e pa, urdhëroi e tha:

«*Allahu Teala është kënaqur me mikpritjen që i keni bërë këtë natë mysafirit!*» (Buhari, Menakibu'l Ensar, 10, Tefsir, 59/6; Muslim, Eshribe, 172-173.)

Sa fatlumturi e madhe!

Sepse;

«*..Kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh.*» (Teube, 72.)

Dhe, arritja e kënaqësisë së Allahut, bëhet e mundur me anë të mëshirës, bujarisë dhe isarit.

Ndërsa të kundërtat e këtyre; mizoria, koprracia dhe egoizmi, janë cilësi të këqija që Allahu i urren dhe që nuk i kanë hije asnjë besimtari.

*Musa Efendi:
"Vjedhja më e shëmtuar, është vjedhja e pasurisë së të varfërve nga ana e të pasurve duke mos e dhënë zekatin."*



Një shembull tjetër i sakrificës që ensarët treguan për vëllezërit e tyre muhaxhirë, është edhe ky:

Një ditë, kur donte të ndante tokat e Bahrejnit mes sahabëve, i Dërguari i Allahut ﷺ, thirri në fillim ensarët. Mirëpo, ensarët, duke treguar një sakrificë dhe tolerancë të paarritshme, thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Mos na jepni gjë ne, para se t’u jepni vëllezërve tanë muhaxhirë dy herë më tepër!”

Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“O Ensarë! Meqë nuk doni të merrni (duke u dhënë përparësi vëllezërve besimtarë), duroni derisa të më takoni te Burimi i Keutherit, sepse pas meje, së afërmi do të vijë një kohë që do t’ju jepet përparësi juve para të tjerëve.” (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 8)

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?..”

(Lukman, 20.)



Bujari, do të thotë të ndash me të tjerët mirësitë që zotëron. Në këtë aspekt, bujaria është pjesa më e rëndësishme e detyrës së falënderimit ndaj mirësive.

MIRËSI SHPIRTËRORE

Edhe pse njeriu e ka më tepër mendjen tek mirësitë materiale, në fakt edhe mirësitë shpirtërore të Allahut janë të shumta. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka

mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyesi dhe pa libër ndriçues.” (Lukman, 20.)

Për rrjedhojë, është shumë e domosdoshme që të meditohet edhe në lidhje mirësitë shpirtërore. Madje, duhet të ndihmohet edhe ata që nuk i zotërojnë këto mirësi, në mënyrë që edhe ata t'i arrijnë.

Ndihma për arritjen e mirësive si; udhëzimi, besimi, dija dhe kultura, bën pjesë në shërbimin e predikimit, urdhërimit për të mirë, arsimimit dhe edukimit.

Po ashtu, në saje të mirësisë së shëndetit, ne kemi mundësinë të ndihmojmë të dobëtit dhe të varfrit. Edhe nëse nuk kemi mundësi për ndihmë materiale, buzëqeshja dhe fjalët e ëmbla janë mirësi që nuk duhet t'u kursehen njerëzve. Gjithsesi, një besimtar, duhet t'i ndihmojë të tjerët gjithmonë me ç'të ketë mundësi.

Shpesh herë, Profetit tonë ﷺ, i vinin sahabë të varfër. Kur ai nuk gjente asgjë për t'u dhënë, i turpëruar dhe me keqardhje, ai mundohej të mos binte në kontakt të drejtpërdrejtë me shikimet e tyre. Për këtë arsye, u zbrit ky ajet fisnik:

وَأَمَّا تُعْرِضَنَّ عَنْهُمْ ابْتِغَاءَ رَحْمَةٍ
مِنْ رَبِّكَ تَرْجُوهَا فَقُلْ لَهُمْ قَوْلًا مَيْسُورًا

“(O i Dashuri Im!) Nëse shmangesh nga ata (kur nuk ke asgjë për të dhënë), duke shpresuar në mëshirën e Zotit tënd; Atëherë thuaju atyre ndonjë fjalë të butë.” (Isra, 28)

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ
رَجُلٌ يَشْفَعُ لَهُمْ
فَعَرِّضُوا قُلُوبَكُمْ
لَهُمْ يَوْمَئِذٍ
وَمَا يَشْفَعُونَ إِلَّا
لِأُولِي الْأَلْبَابِ

“Përpiqu të fitosh jetën e botës së ardhshme me atë që të ka dhënë Allahu, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty!..”

(Kasas, 77.)

Bujaria fiton grada të larta jo vetëm në saje të sasisë materiale që jepet, por edhe në saje të sinqeritetit dhe sakrificës me të cilën bëhet. Lidhur me këtë, transmetohet se një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Një dërhëm është më i madh sesa njëqind mijë dërhëm.”

Shokët e Profetit e pyetën:

“Si ka mundësi kjo, o Resulullah?” Përgjigja që dha Profeti ishte shumë kuptimplote:

“Një njeri kishte dy dërhëm. Më të mirin e tyre e dhuroi për hir të Zotit. (Pra dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.) Kurse një tjetër (që ishte shumë i pasur) dhuroi nga pasuria e tij njëqind mijë dërhëm.” (Nesai, Zekat, 49.)

Një shembull shumë i jashtëzakonshëm i isarit, është përjetuar edhe në betejën e Jermukut. Tre sahabë që kishin

marrë plagë vdekjeprurëse, gjendeshin të shtrirë mbi rërën e nxehtë në fushëbetejë, duke pritur vdekjen. Kur u sollën ujë për të shuar sadopak etjen, ata thoshin, “vëllai im besimtar që po rënkon ka më tepër nevojë për këtë ujë!”. Kështu, këta tre sahabë vetëmohues, duke e dërguar ujin tek njëri-tjetri, ia dorëzuan shpirtin Allahut me buzë të plasura nga etja. Ndërsa ena me ujë, mbeti ashtu, e mbushur plot mes këtyre tre dëshmorëve. (Shih. Hakim, III, 270.)

“Çdokush nga ju të japë sadaka nga floriri, argjendi, rrobat, qoftë edhe një masë nga gruri dhe hurmat! Le të japë sadaka qoftë edhe një hurmë!”

(Muslim, Zekat, 69.)



Sa sakrificë madhështore është të mendosh për vëllain tënd, duke mos e pirë ujin në momentet kur po jep shpirt

dhe buza të është plasur nga etja! Mbase një gotë ujë e dhënë në një moment të tillë, është më e vlefshme se ndërtimi i një xhamie madhështore.

Domethënë, ne duhet të japim në çdo situatë qofshim.

Mëshira dhe bujaria janë obligime morale. Por dikush mund të kundërshtojë e të thotë:

“Pasi një i pasur të ketë dhënë zekatin, e ka kryer detyrën e tij. Pjesa tjetër, është një adhurim vullnetar, që mund ta bësh ose jo!”

Shejh Sadi, në veprën e tij
Bostani, shprehet:

“Mirësitë që zotëron, jepi
vet sa je gjallë, sepse kur
të vdesësh, nuk do t'i
kesh më!.. Kush e çon vet
furnizimin në botën tjetër,
ka arritur një mirësi të
madhe, sepse askush nuk
ta kruan shpinën duke
menduar për ty... Atë
mund ta kruash vetëm
me thonjtë e tu!”



ZEKATI NUK ËSHTË I MJAFTUESHËM!

Mirëpo, kjo nuk është e drejtë, sepse siç e kemi thënë që në fillim, të mjaftohesh me këtë obligim fizik, është si të fluturosh me një krahë. Në hadithi fisnik thuhet:

“Islami është ngritur mbi pesë parime:

- *Dëshmimi se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij,*

- *Falja e namazit,*

- *Dhënia e zekatit,*

- *Kryerja e haxhi*

- *Agjërimi i ramazanit.”* (Buhari, Iman, 1, 2; Tefsir, 2/30; Muslim, Iman, 19-22.)

Mirëpo, këto janë vetëm kushtet minimale që duhet të plotësojë çdo njeri që deklaron se është mysliman. Mirëpo, në të njëjtën kohë, Allahu i Madhëruar dhe Profeti ynë ﷺ, na kanë njoftuar edhe për shumë obligime të tjera fetare, siç janë mirësia ndaj prindërve, kujdesi ndaj lidhjeve farefisnore, lufta në rrugën e Allahut, etj.

Pra, krahas farzeve ajn, myslimani është përgjegjës edhe për farzet kifaje. Çdo besimtar, është përgjegjës për besimtarët e tjerë. Ai është përgjegjës edhe për predikimin e Islamit me fjalë dhe vepra dhe për ndërtimin e institucioneve të nevojshme për shoqërinë Islame, si xhamitë, shkollat, spitalet, etj. Dhe të gjitha këto përgjegjësi, duhet të çohen në vend sipas mundësive.

Në Kuranin Fisnik, krahas zekatit, urdhërohet edhe bamirësia me sadaka dhe dhurime, sasia e të cilave nuk është kufizuar. Pra, zekati, i cili është një adhurim fizik, është i përcaktuar me rregulla dhe kushte. Ka pasuri për të cilën duhet të japësh zekat, por ka edhe pasuri për të cilën nuk jepet. Kjo është një fushë e kufizuar, një detyrë minimale.

Mirëpo, sadakaja nuk është e tillë. Ajo nuk është e përcaktuar me sasi dhe kushte. Kur fisi i varfër Mudar erdhën në Medinë, Profeti ﷺ, tha:

“Çdokush nga ju të japë sadaka nga floriri, argjendi, rrobat, qoftë edhe një masë nga gruri dhe hurmat! Le të japë sadaka qoftë edhe një hurmë!” (Muslim, Zekat, 69.) – Dhe, atij nuk i qeshi fytyra derisa i ngopi dhe i veshi ata.

Sadi: “Nëse të vjen ndonjë nevojtar në derë, mos kthe duarbosh. -Zoti mos e dhëntë-, mbase një ditë edhe ti mund bëhesh nevojtar dhe do shëtisësh derë më derë!.. Meqë sot nuk shkon në derën e askujt për të kërkuar diçka, si falënderim për këtë, ndihmoje nevojtarin që vjen në derën tënde!”



Ja pra, mëshira dhe bujaria, është detyra jonë për ta bërë Profetin tonë ﷺ, t'i qeshë fytyra. Ne nuk duhet ta mashtrojmë veten duke dhënë pako gjë dhe të mendojmë se jemi të mëshirshëm. Në këtë çështje, ne duhet të marrim si model mëshirën dhe bujarinë e sahabëve.

Sepse;

Sahabët janë shoqëria shembullore që Allahu i Madhëruar na ka prezantuar si model për arritjen e kënaqësisë së Tij. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Teube, 100)

KRITERI YNË JANË SAHABËT...

Mëshira dhe bujaria e sahabëve, janë shembull për ne.

Për shembull, sahabët e Suffes ishin mysafirët e islamit. Ata nuk kishin as familje, as pasuri, e as vend ku të strehoheshin. Kur Profetit ﷺ, i dërgonin ndonjë sadaka, ai menjëherë ua jepte banorëve të Suffes. Mirëpo, kur zbriti ajeti i infakut, këta sahabë të varfër nuk ndenjën duarkryq, por mblodhën dru nëpër male, i shitën dhe paratë ia dhanë të Profetit tonë ﷺ, si infak.

Bujari, nuk do të thotë të shpenzosh vend e pa vend, por t'u bësh bamirësi robërve të Allahut, me kujdes dhe duke qenë i vetëdijshëm për vlerën e mirësive. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron: “Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë!”

(Isra, 29.)



Edhe Ebu Dherri ﷺ, ishte prej sahabëve të varfër. Por Profeti ﷺ, e ka këshilluar duke i thënë:

“O Eba Dherr! Shtoji pak më tepër ujë supës tënde dhe kujdesu edhe për fqinjin tënd!” (Muslim, Birr, 142.)

Lidhur me këtë çështje, ka shumë shembuj. Mëshira dhe bujaria janë urdhra të fesë sonë dhe, në të njëjtën kohë, janë më të gjera dhe më përfshirëse se zekati, që është një prej parimeve të Islamit. Edhe pse në aspektin juridik veprat ndahen në farz, vaxhib, sunet, etj., sahabët që kanë jetuar bashkë me Profetin ﷺ dhe janë përpjekur ta imitojnë atë në çdo aspekt, nuk janë mbytur asnjëherë në pyetje të tilla si, “A është kusht? A mund të mos e bëjmë? etj...” Ata kanë vrapuar gjithmonë nga një mirësi në tjetrën.

Shkurtimisht;

Zekati është sasia minimale që duhet të jepet. Dhënia e zekatit, më tepër se shfaqje e një virtyti, është shlyerje e një borxhi, sepse zekati është e drejta e të varfrit në pasurinë e besimtarit të pasur. Për rrjedhojë, kush nuk e paguan atë, do të thotë se ka grabitur të drejtën e dikujt.

Babai im i ndjerë, Musa Efendia -Allahu e mëshiroftë-, thoshte:

“Vjedhja më e shëmtuar, është vjedhja e pasurisë së të varfërve nga ana e të pasurve duke mos e dhënë zekatin.”

Po ashtu, edhe dhënia e zekatit me mangësi, është grabitje e të drejtave të të varfrit. Prandaj, për ta dhënë ashtu siç

Treguesi më i qartë i dashurisë është sakrifica. Madhësia e dashurisë matet me madhësinë e sakrificës që bëhet për hir të dashurisë. Prandaj, besimtarët që ushqejnë dashuri ndaj Allahut dhe fesë së Tij, duhet të dhurojnë për hir të Allahut dhe të pranojnë disa vështirësi në mënyrë vullnetare.



duhet zekatin, është e nevojshme që, pasi të jetë llogaritur mirë, të jepet edhe pak më tepër se sasia minimale.

Po ashtu, babai im, hapte fletoren e shënimeve dhe shkruante:

“Ky është zekati im, ndërsa kjo është sadakaja...”

Pra, mirë është që ato të shkruhen, me qëllim që njeriu të mos mendojë se ka dhënë shumë. T’i shohë ato që ka dhënë dhe t’i krahasojë me mirësitë që i ka dhënë Allahu.

Me qëllim që ta arrijmë pjekurinë e moralit të bukur dhe të mirësisë që Allahu kërkon prej nesh, në çështjen e “mëshirës dhe bujarisë”, duhet të bëhet më tepër sesa dhënia e zekatit. Në një ajet fisnik urdhërohet:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

“Kurrë nuk keni për ta arritur mirësinë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!..” (Al-i Imran, 92)

Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që e arrijnë atë mirësi!..

Allahu na bëftë prej atyre që shpëtojnë nga grykësia e egos dhe koprracia dhe bëjnë një jetë të qetë falë mëshirës dhe bujarisë, duke arritur mëshirën dhe begatinë e Allahut Mëshirues e Bujar në të dyja botët!

Amin!..



Osmani ﷺ, ka thënë:
 “Nëse tregohesh indiferent ndaj vetes dhe nuk parapërgatitesh për të, padyshim se askush nuk bën përgatitje për ty. Mos e harro kurrë, se patjetër do të dalësh para Allahut. Prandaj, përgatite veten dhe furnizimin për të! Kujdes, mos bëj gabim që këtë punë t’ia lësh dikujt tjetër!”





VËLLAZËRIA

Nëse një besimtar ka marrëdhënie të ftohta me ndonjë besimtar tjetër, ai duhet ta eliminojë këtë ftohtësi për hir të Allahut. Ai duhet të nxjerrë flamurin e paqes, pa ushqyer asnjë pretendim, si "unë kam të drejtë e ai gabim!". Kështu, duke falur vazhdimisht, ai do të bëhet një rob i merituar për faljen hyjnore. Lidhur me faljen e gabimit të vëllait në fe, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

"...A nuk doni ju që t'ju falë Allahu?.." (Nur, 22.)



VËLLAZËRIA

KËSHILLIMI I TË VËRTETËS

Në suren el-Asr, pasi na njofton se njerëzimi është në humbje, Allahu i Madhëruar bën përjashtim për ata që bartin këto katër cilësi:

1. Janë besimtarë,
2. Bëjnë vepra të mira,
3. Këshillojnë të vërtetën,
4. Këshillojnë për durim.

Çështja e zbatimit të së vërtetës dhe këshillimit të saj, është gjëja më rëndësishme pas besimit dhe veprave të mira. Nëse meditojmë mbi detyrat tona, do të kuptojmë se gjendemi përballë një çështjeje shumë të gjerë dhe të thellë.

- 1) Detyra jonë kryesore, është ndaj Allahut të Madhëruar.

Allahu i Madhëruar na ka krijuar dhe na ka dërguar në këtë botë si njerëz, duke na nderuar, duke na dhënë shëndet dhe siguri. Ai na ka dhënë familje dhe fëmijë. Madje, krahas të

gjitha mirësive dhe furnizimeve të panumërta, ai na ka nderuar edhe me “udhëzimin” në rrugë të drejtë. Prandaj, ne duhet ta shpenzojmë të gjithë jetën tonë duke u përpjekur të falënderojmë sa të mundemi për të kryer detyrën tonë të mirënjohjes ndaj Allahut. Po ashtu, ne duhet ta zbukurojmë jetën tonë me besim, adhurim dhe shërbim ndaj fesë.

2) Pas Allahut, ai që ka më shumë të drejta mbi ne, është i Dërguari i Tij ﷺ.

Ai e ka kumtuar fenë e vërtetë duke kaluar njëmijënjë peripeci. Profeti ynë ﷺ, ka jetuar gjithmonë për popullin e vet, të cilin nuk do ta braktisë as në botën tjetër.

Detyrat që kemi ne ndaj tij, janë më të mëdha se detyrat që kemi ndaj prindërve tanë. Edhe pse është e vështirë ta shlyejmë borxhin që kemi ndaj Profetit tonë ﷺ, ne duhet të përpiqemi sa më shumë të lidhemi fort pas traditës/sunetit të tij, të bëjmë

vazhdimisht salavate për të dhe t’i edukojmë fëmijët tanë me dashurinë dhe respektin ndaj tij. Krahas këtyre, nuk duhet ta harrojmë kurrë këtë porosi të rëndësishme të Profetit tonë ﷺ, i cili ka thënë:

“Kujdes! Mos ma nxini fytyrën (duke bërë gjynahe)!..” (Ibn-i Maxhe, Menasik, 76.)

3) Të drejtat e njerëzve të tjerë ndaj nesh.

Në këtë kategori, do të përmbledhim në mënyrë të përgjithshme, të drejtën/hakun e njerëzve.

Nëse besimtarët nuk e kapërcejnë egon e tyre dhe të mendojnë për të tjerët, nuk mund të arrijnë përsosmërinë e besimit. Nëse nuk e ndiejmë në supet tona barrën e përgjegjësisë ndaj vëllezërve tanë të fesë, nuk duhet të harrojmë se nuk do ta kemi të lehtë as llogarinë tonë në botën tjetër.



HAKU I ROBIT

Jeta e njeriut është e mbushur plot me detyrime. Pa ardhur akoma në këtë botë lind detyrimi i përgjegjesisë. Sepse nëna atë e ka mbajtur nëntë muaj në bark. Prandaj menjëherë lind detyrimi ndaj nënës. Pastaj vjen detyrimi ndaj babait.

Njeriu gjatë jetës ka shumë detyrime dhe jeton me shumë detyrime. Madje, detyrimet vazhdojnë edhe pas vdekjes, siç janë të drejtat e atij që e lanë kur vdes, që e mbart dhe e varros, etj. Dhe, të drejtat dhe detyrimet ndaj njerëzve, duhet në shlyhen në këtë botë, sepse nëse mbetet gjykimi për në botën tjetër, ato fitojnë një rëndësi shumë të madhe.

Sa e drejtë është që dikush të mburret me numrin e njerëzve që punojnë për të, e të thotë: “Unë ushqej kaç njerëz!”? Në fakt, ai i paguan ata në këmbim të punës së tyre, sepse ata nuk punojnë pa pagesë. Furnizim vjen prej Allahut. Por, ashtu siç ka nevojë punëtori për pagesën, ashtu ka nevojë edhe pronari i një biznesi për punën e punëtorëve.

Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar të jemi delikat dhe të sjellshëm kur japim sadaka. Në të kundërtën, fjalët e rënda dhe cenuese, janë konsideruar si shkatërruese të sadakasë. Prandaj, është e pakuptimtë që dikush të mburret me pagesën që jep në këmbim të punës. Përkundrazi, punëdhënësi, duhet të ruhet nga shkelja e të drejtave të punëtorëve të tij dhe për këtë duhet t’u kërkoj hallallëk.

*Zemra e besimtarit
duhet të jetë aq
e ndjeshme dhe
vigjilente, sa të arrijë
ta kuptojë gjendjen
e vëllait të tij që
ka përballë, si një
radiografi shpirtërore,
dhe ta ndjejë veten
përgjegjës për
plotësimin e nevojave
të tij.*



Kur përfundoi ndërtimi i Xhamisë Sulejmanije bashkë me kompleksin e saj, Sulltan Sulejman Kanuni i mbloodhi të gjithë; që nga arkitekti deri tek punëtori më i thjeshtë dhe u tha:

“O vëllezër në fe! Kjo xhami u përfundua me lejen e Allahut. Nëse gabimisht, ndokush prej jush nuk e ka marr rrogën, le të vijë ta marrë! Mundet që ai të mos jetë i pranishëm. Prandaj ju lutem juve që jeni të pranishëm, t’i lajmëroni ata që nuk janë, që të vijnë ta marrin të drejtën e tyre prej nesh!”

Për këtë arsye, Xhamia Sulejmanije, është një monument shekullor, në ndërtimin e të cilës nuk gjendet qoftë edhe një shkelje e të drejtave të robit!..



“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër...”
(Al-i Imran, 103.)

Nga ana tjetër, edhe pala që paguhet për punën, duhet të jetë e kujdesshme që ta fitojë pagesën në mënyrë të ndershme/hallall. Në fund të fundit, të dyja palët kanë nevojë për njëra-tjetrën.

Ai që ka mbi supë të drejtën e dikujt, duhet t’ia dorëzojë menjëherë të zotit, ose trashëgimtarëve të tij. E, nëse nuk është e mundur t’ia kthejë, ai duhet të japë sado-ka në emër të tij. Ai që i hyn në hak të tjerëve, duhet të përpiqet t’i shlyejë padrejtësitë që ka bërë, duke kërkuar hallallëk dhe duke bërë istigfar.

Po ashtu, për faljen e padrejtësive shpirtërore ndaj robit, njeriu duhet të lutet shumë për ata që u ka hyrë në hak dhe të bëjë bamirësi, derisa Allahu i Madhëruar të jetë i kënaqur me të dhe në ditën e

kiametit, të jetë i kënaqur edhe ai të cilit i është hyrë në hak.

Haku i robit është një përgjegjësi shumë e rëndë. Prandaj është thënë:

Ki dhembshuri për të varfrit e të vetmuarit, por më tepër për zullumqarët. Veçanërisht, ki dhembshuri për kapitalistin që i ka dhënë lamtumirë ndjenjave njerëzore, për padronët e padrejtë të cilët shkelin të drejtat e punëtorëve të tyre dhe për zemrat e shurdhëta që nuk i dëgjojnë përgjërimet që thonë “Na mëshironi!”. Por mos harro se ajo që nënkuptohet me këtë dhembshuri, është; t’i kritikosh ata, t’i bësh të kuptojnë gabimin dhe t’i pengosh ata nga padrejtësitë duke u mësuar mëshirën!

Ashtu si për çdo çështje, i Dërguari i Allahut ﷺ, është shembulli më i mirë për ne edhe në lidhje me hakun e robit. Për këtë arsye, edhe në ditët e fundi të jetës së tij, ai ka thënë:

“Në fund të fundit, edhe unë jam një njeri. Disa prej jush mund të kenë ndonjë hak të tyre pa e marrë prej meje. Kujtdo që mund t’ia kem lënduar trupin, ja ku është trupi im! Le të vijë dhe ta godasë, në mënyrë që ta marrë hakun e vet. Kujtdo që i kam marrë gabimisht ndonjë gjë nga pasuria, ja ku është pasuria ime. Le të vijë dhe ta marrë...” (Ahmed, III, 400.)

Ndërsa neve, umetin e vet, na ka porositur me këto fjalë:

“O njerëz! Kushdo që ka një hak (të dikujt) mbi supe, le ta shlyejë menjëherë atë dhe të mos thotë se po turpërohet në këtë botë! Dijeni mirë, se turpërimi në këtë botë, është shumë më i

Vëllai është përgjegjës për vëllain e vet. Në këtë botë, vëllai i dobët dhe i varfër, është nevojtar ndaj vëllait të fortë dhe të pasur. Por, nëse e shohim nga dritarja e botës tjetër, edhe vëllai i fortë e i pasur, ka nevojë për duatë e vëllait të dobët e të varfër.



lehtë në krahasim me turpërimin në botën tjetër!” (Shih. Ibni Sa'd, II, 255; Taberi, Tarih, III, 191.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut, në ditët e fundit të jetës, i ka porositur besimtarët të bëjnë kujdes ndaj të drejtave të atyre që kanë nën vete. (shih. Bejhaki, Shuab, VII, 477.)

Përveç të drejtave personale, besimtarët kanë detyra të posaçme ndaj njëri-tjetrit edhe si vëllezër në fe:

TË DREJTAT NDËRMJET VËLLEZËRVE NË FE

Si rezultat i mirësisë së besimit që na ka falur Allahu i Madhëruar, ne bëhemi vëllezër feje me të gjithë besimtarët e tjerë. Lidhur me këtë, në një ajet urdhërohet:

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin)

dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Al-i Imran, 103.)

Kur përfundoi ndërtimi i Xhamisë Sulejmanije dhe kompleksit të saj, Sulltan Sulejman Kanuni i mbloodhi të gjithë dhe u tha: “Ju lutem juve që jeni të pranishëm, t’i lajmëroni ata që nuk janë, që të vijnë ta marrin të drejtën e tyre prej nesh!”



Vëllazëria fetare nxjerr në pah edhe disa të drejta ndërmjet vëllezërve, sepse vëllai është përgjegjës për vëllain e vet. Në këtë botë, vëllai i dobët dhe i varfër, është nevojtar ndaj vëllait të fortë dhe të pasur. Por, nëse e shohim nga dritarja e botës tjetër, edhe vëllai i fortë e i pasur, ka nevojë për duatë e vëllait të dobët e të varfër.

Vëllazëria nuk duhet të mbetet vetëm në fjalë. Vëllazëria e besimit kërkon sakrificë. Ky shembull në lidhje me këtë, është shumë domethënës:

Kur kolonizatorët evropianë pushtuan Afrikën, skllavëruan popujt e Afrikës, ndër të cilët kishte edhe shumë myslimanë. Më pas, ata morën me mijëra afrikanë të skllavëruar dhe i hipën nëpër anije me qëllim që t'i shfrytëzonin në vendet e tyre. Në këtë situatë, shumë dijetarë afrikanë, u përzierën mes atyre që do hipnin në anije, duke pranuar vullnetarisht të lidheshin me zinxhirë, vetëm e vetëm që populli i tyre të mos mbetej pa udhëzues dhe dijetarë feje në vendet ku do të shkonin.

Sa sakrificë e madhe!

Durimi ndaj vështirësive dhe vuajtjeve për hir të vëllazërisë fetare, ishte një cilësi që Profeti ynë ﷺ, e ka përjetuar personalisht, dhe të njëjtën gjë ia ka këshilluar edhe shokëve të tij. Një shembull i mirë i kësaj, është edhe kjo ndodhi:

Një ditë, Profeti ﷺ, po shkonte tek sahabët. Rrugës u takua me një Ensar, i cili i tha:

- O Resulullah! Të qofshin falë nëna dhe babai! Po më shqetëson shumë kjo çehre e fytyrës tënde... Cili është shkakku i kësaj?

Profeti ﷺ, e vështroi pak fytyrën e atij sahabi dhe i tha:

- “Uria!”

*Të gjitha adhurimet
dhe mirësitë,
duhet të bëhen
me pasuri hallall,
sepse përfitimi
shpirtëror prej këtyre
adhurimeve, arrihet
vetëm në saje të
ushqimit hallall me
të cilin ushqehet
trupi.*



Sahabi vrapoi menjëherë tek shtëpia e vet dhe kërkoi diçka për të ngrënë, por nuk gjeti asgjë. Pastaj shkoi menjëherë tek fisi Beni Kurejdha dhe bëri marrëveshje me ta, që të merrte nga një hurmë në këmbim të çdo kove uji që do të nxirrte nga pusi. Kur mblodhi një grusht me hurma, shkoi pranë Profetit të dashur dhe e gjeti në vendin ku e kishte lënë.

- O i Dërguar i Allahut! Urdhëroni, hajini këto!

Profeti ynë ﷺ, e pyeti se nga vinin këto hurma dhe ensaria ia shpjegoi. Më pas, Profeti ﷺ, i tha:

- *“Mendoj se ti e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij!”*

- Po, betohem në Atë që të ka dërguar ty me të vërtetën, se për mua ti je më i dashur se vetja, fëmijët, familja dhe pasuria ime! – i tha sahabi i emocionuar.

Kur dëgjoi këto fjalë, Profeti ﷺ, i tha:

Ebu Lejs Semerkandi ka thënë: “Për sa i përket dhurimit; personi i cili dhuron lëmoshën duhet ta falënderojë personin që i dhurohet.”



“Atëherë, bëj durim ndaj varfërisë dhe përgatit për veten një mburojë ndaj fat-keqësive! Betohem në Allahun, i Cili më ka dërguar me të vërtetën, se atij që më do mua, këto të dyja (varfëria dhe fat-keqësitë), do t’i vijnë më shpejt se rënia e ujit nga mali.” (Hejthemi, X, 313; Dhehebi, Sijer, III, 54; Ibn-i Haxher, el Isabe, III, 298.)

Në kohën e sulltan Abdulazizit, lindi nevoja për një dijetar që do t’u mëson-te fenë vëllezërve myslimanë në Kepin e Shpresës, në Afrikën e Jugut. Këtë detyrë e pranoi Ebu Bekir Efendia që banonte në Stamboll. Pasi shkoi në Londër, prej atje

udhëtoi me anije për 45 ditë dhe arriti në Cape Town. Aty u mësoi fenë vendasve, shoi mosmarrëveshjet midis tyre dhe i pastroi nga besëtytnitë që ishin përhapur, derisa ndërroi jetë në atë vend.

Ja pra, kjo është vëllazëria!..

Shkurtimisht;

Islami, kërkon që njeriu të përpiqet në falënderimin ndaj mirësive të Zotit. Për rrjedhojë, edhe sahabët e nderuar u përpoqën shumë për këtë. Ata bënë çdolloj sakrifice për të çuar udhëzimin e besimit në çdo cep të botës, me qëllim që të gjithë njerëzit të mësonin të vërtetën e Islamit.

Ndërsa ata që i shkelin të drejtat e vëllazërisë, e humbasin begatinë dhe mirësinë e Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, tregohet kjo ndodhi:

Një njeri bujar nga Jemeni, zotëronte vreshta me rrush, hurma dhe të mbjella të tjera diku në afërsi të qytetit Sana. Në kohën e vjeljes së prodhimit, ky njeri bujar ndante një pjesë të mirë të prodhimit për të varfrit, të dobëtit dhe të vetmuar-it. Pasi ndërroi jetë, fëmijët e tij i kaploi lakmia. Ata u morën vesh me njëri-tjetrin dhe thanë:

“Familja jonë është shumë e madhe dhe ne kemi pak pasuri. Prandaj nuk do të ndajmë asgjë për të varfrit dhe nevojtarët; prodhimin do ta mbledhim pa ardhur ende ata...”

Pa kaluar shumë, si pasojë e këtij vendimi të gabuar dhe qëllimkeq, Allahu i Madhëruar ua shkatërroi të mbjellat. Aq,

حَيْرَةُ الْمَالِكِ الْفَارُوقِ سُبْحَانَ اللَّهِ

Nëse gjatë dhënies së sadakasë bëhen veprime që e cenojnë dinjitetin e të varfrit, ajo bamireshi humbet. Allahu i Madhëruar urdhëron: “O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer!..” (Bekare, 264.)

sa tashmë kopshtet dhe vreshtat nuk njiheshin më. Kur pronarët u përballën me këtë tablo të zyrtë, u tronditën jashtë mase dhe thanë:

“Mos kemi ardhur në ndonjë vend të gabuar!?”

Ata u bënë shumë pishman për vendimin që kishin marrë, sepse ajo që nuk kishin kuptuar, ishte se:

Lutjet e të varfërve dhe nevojtarëve që përfitonin prej prodhimit të bollshëm që ndante babai i tyre, i jepte prodhimit begati dhe bollëk të madh. Kur ata vendosën ta ndërprisnin ndarjen e prodhimit për të varfrit, nuk u mbeti asgjë tjetër përveçse humbja! (shih. Kalem, 17-33.)

Kushti më i rëndësishëm i marrëdhënieve vëllazërore, është mbarëvajtja. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Enfal, 1.)

Allahu Teala do t'i strehojë nën hijen e vet (Arshit të Tij) shtatë kategori njerëzish, Një nga këto kategori, janë edhe: “Njerëzit që e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe që bashkohen vetëm në saje të kësaj dashurie.” (Buhari, Ezan, 36.)



Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Besimtari shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët shkojnë mirë me të. Nuk ka dobi prej atij që nuk shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët nuk shkojnë mirë me të.” (Ahmed, II, 400; V, 335; Hakim, I, 73/59.)

Një besimtar, nuk mund të qëndrojë më shumë se tri ditë i mërzitur me vëllain e vet dhe nuk i pret marrëdhëniet me të. Nëse një besimtar ka marrëdhënie të

ftohta me ndonjë besimtar tjetër, ai duhet ta eliminojë këtë ftohtësi për hir të Allahut. Ai duhet të nxjerrë flamurin e paqes, pa ushqyer asnjë pretendim si; “unë kam të drejtë e ai gabim!”. Kështu, duke falur vazhdimisht ai do të bëhet një rob i merituar për faljen hyjnore. Lidhur me faljen e gabimit të vëllait në fe, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...A nuk doni ju që t’ju falë Allahu?..” (Nur, 22.)

Sjelljet që i cenojnë marrëdhëniet vëllazërore, hyjnë në grupin e haramëve të aspektit moral. Këtu futen të gjitha veprimet që helmojnë vëllazërinë si; gënjeshtria, shpifja, përgojimi, thashethemnaja, etj.

Një nga këto helme, është edhe hetimi i të metave të vëllait, gjë e cila çon në përgojim. Fatkeqësisht, ky veprim i ulët është dobësi e madhe e të gjitha shoqërive. Hetimi i të metave dhe gjynaheve të njerëzve, është një sëmundje që shkatërron vëllazërinë dhe helmon zemrat e njerëzve.

Mirëpo, nëse marrëdhëniet vëllazërore nuk zhvillohen në drejtim pozitiv, cenohet edhe besimi, sepse në një hadith fisnik thuhet:

“Asnjëri prej jush nuk ka besuar me të vërtetë përderisa nuk dëshiron për vëllain e tij të fesë atë që dëshiron edhe për veten e tij.” (Buhari, Iman 7, Muslim, Iman 71-72.)

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që të gjithë besimtarët të mendojnë dhe të luten për mirë edhe në mungesë të vëllezërve të tyre besimtarë.

“Besimtari shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët shkojnë mirë me të. Nuk ka dobi prej atij që nuk shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët nuk shkojnë mirë me të.”

(Ahmed, II, 400; V, 335.)



LUTJA PËR UMETIN

Një prej miqve të Zotit, Marufi Kerhi, ka thënë:

“Kush thotë dhjetë herë në ditë:

اللَّهُمَّ أَصْلِحْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ
اللَّهُمَّ قَرِّبْ عَنَّا أُمَّةَ مُحَمَّدٍ
اللَّهُمَّ ارْحَمْ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ

O Zot! Rregulloje gjendjen e umetit të Muhamedit!

O Zot! Largoja vështirësitë umetit të Muhamedit!

O Zot! Mëshiroje umetin e Muhamedit!

Shkruhet ndërmjet miqve të Allahut Teala.” (Ebu Nuajm, Hilje, VIII, 366.)

Dashuria dhe uniteti i vërtetë, nuk nënkupton bashkimin dhe argëtimin me shoqërinë nëpër kafene apo klube. Ajo është dashuri dhe bashkim për hir të Allahut, ku realizohet detyra e urdhërimit në punë të mira dhe pengimi nga të këqijat.



Lutja dhe përpjekja për umetin, e gëzon Profetin tonë ﷺ, sepse ai e don-te shumë umetin e vet. Plotësimi i nevojave materiale dhe shpirtërore të umetit, ishte lumturia më e madhe e Profetit tonë ﷺ. Për rrjedhojë, një nga detyrat më të rëndësishme të një besimtari mysliman, është plotësimi i nevojave të vëllait të tij nevojtar.

Profeti ynë ﷺ, është shembulli më i mirë për ne, si në aspektin e adhurimeve fizike, ashtu edhe në aspektin e virtyteve morale. Ai nuk gjente rehati pa ndarë me sahabët e suffes, të varfrit, jetimët dhe nevojtarët, çdo mundësi materiale që i

binte në dorë. Mëshira dhe bujaria, i jepte atij një kënaqësi aq të madhe shpirtërore, sa që e bënte të harronte edhe urinë e vet.

Ky pra është horizonti i vërtetë i vëllazërisë!..

NËN HIJEN E ARSHIT...

Në një hadith fisnik, thuhet se janë shtatë kategori njerëzish, të cilët Allahu Teala do t'i strehojë nën hijen e vet (Arshit të Tij), në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç saj. Një nga këto kategori, janë edhe;

“Njerëzit që e duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe që bashkohen vetëm në saje të kësaj dashurie.” (shih. Buhari, Ezan, 36.)

Sigurisht që dashuria dhe uniteti që përmenden këtu, nuk nënkupton bashkimin dhe argëtimin me shoqërinë nëpër kafene apo klube. Ajo është dashuri dhe bashkim për hir të Allahut, ku realizohet detyra e urdhërimit në punë të mira dhe pengimi nga të këqijat.

Ruajtja e të drejtave vëllazërore, është farz. Pra, është edhe më e rëndësishme se adhurimet nafile. Këtë të vërtetë, e shpjegon shumë bukur kjo ndodhi e kohës së Profetit tonë ﷺ:

Një ditë të nxehtë, Profeti ynë ﷺ, kishte qëndruar për të pushuar në një vend të përshtatshëm. Një pjesë e sahabëve ishin me agjërim nafile. Për këtë arsye, ata ishin lodhur dhe i zuri gjumi. Kurse ata që nuk agjëronin, shkuan të bartnin ujë për

Sjelljet që i cenojnë marrëdhëniet vëllazërore, hyjnë në grupin e haramëve në aspektin moral. Këtu futen të gjitha veprimet që helmojnë vëllazërinë, si gënjeshtria, shpifja, përgojimi, thashethemnaja, etj.



abdest dhe ngritën çadrat për të krijuar hije. Kur erdhi koha e iftarit, Profeti ﷺ, tha:

“Ata që nuk agjëruan morën më shumë shpërblim se agjëruesit.” (Muslim, Sijam, 100-101.)

Edhe të parët tanë, të cilët e pasuan moralin profetik dhe shembullin e sahabëve, ishin shumë të kujdesshëm ndaj të drejtave vëllazërore:

RAMAZANI I TË PARËVE TANË

Në emër të vëllazërisë, të parët tanë themeluan vakëfe, ndërtuan komplekse, mensa dhe çezma publike. Ndërsa Ramazanet e bekuara, ishin kohë të veçanta ku shpalosej edhe më shumë vëllazëria fetare.

*Në të kaluarën,
besimtarët e pasur,
veçanërisht gjatë
muajit të Madhëruar
të Ramazanit,
shkonin nëpër
dyqane dhe lanin
borxhet e atyre që
kishin blerë veresie,
pa e marrë vesh vetë
borxhliu.*



- Besimtarët e pasur, veçanërisht gjatë muajit të Madhëruar të Ramazanit, shkonin nëpër dyqane dhe lanin borxhet e atyre që kishin blerë veresie, pa e marrë vesh vetë borxhliu. Njësoj si gurët e lëmoshës, ku vendoseshin para apo ushqime me qëllim që të mos përballej ai që jepte me atë që merrte.

- Të pasurit shkonin nëpër burgje dhe lironin ata që ishin burgosur për shkak të borxheve duke ua larë borxhet.

- Atë kohë nuk kishte ndarje mes të pasurve dhe të varfërve. Të gjithë besimtarë hapnin sofrën e iftarit për vëllazërit

e tyre. Tek ata nuk ekzistonte sëmundja e sotme e shtrimit të iftareve madhështorë në vende luksoze, ku nuk shkel dot këmba e asnjë të varfri. Ata shtronin iftare modestë dhe me zemër të pasur, ku mund të hanin të gjithë, si të pasur, ashtu edhe të varfër.

Gjatë Ramazanëve shtroheshin sofrat iftari të ndryshme. Një ditë, ftoheshin vetëm punonjësit e pastrimit. Një ditë tjetër, karrocierët. E njëherë tjetër shtrohej iftar për dijetarët. Padyshim se nuk anashkaloheshin as të afërmit dhe fqinjët. Arsyeja që njerëzit thirreshin në grupe të ndryshme, ishte që ata njiheshin më mirë me njëri-tjetrin dhe mes tyre të zhvillohej ndjenja e vëllazërisë dhe bashkëpunimit.

Në traditën tonë, kemi pasur një zakon të bukur, që quhej “qiraja e dhëmbët”, në bazë të së cilës, ata që jepnin iftar, jepnin “qira dhëmbësh”. Pra, ju i jeni përgjigjur ftesës sonë, keni përdorur dhëmbët dhe i keni lodhur me ushqimin që ju dhamë. Prandaj, si shpajmim për këtë, pranoni këtë gosti. Ky ishte një zakon i mirë në traditën Osmane.

Lidhur me këtë traditë të bukur, kam dëgjuar një histori të bukur nga babai im i ndjerë:

Tek Spitali Zejneb Kamil ka pas jetuar Jusuf Kamil Pasha dhe gruaja e tij Zejnebja. Në konakun e tij shtroheshin vazhdimisht iftare të hapur. Pra, mund të vinte kushdo, i varfër, e i pasur... Nuk bënin ndasi mes njerëzve. -Allahu na ruajt-

Gjatë Ramazanëve në të shkuarën, shtroheshin sofrat iftari të ndryshme.

Një ditë, ftoheshin vetëm punonjësit e pastrimit. Një ditë tjetër, karrocierët. E njëherë tjetër shtrohej iftar për dijetarët. Padyshim se nuk anashkaloheshin as të afërmit dhe fqinjët.



Kamil Pasha e fton edhe Sulltan Abdulazizin, i cili i përgjigjet ftesës. Pas iftarit, i zoti i iftarit, Kamil Pasha, i vendos të gjitha tapitë (e pronave) në një tepsi argjendi dhe ia japin Abdulazizit.

Abdulazizi preket nga ky veprim, i falënderon dhe thotë:

“Unë e pranoj dhuratën tuaj dhe këtë po jua dhuroj përsëri juve!”

Zejnebjja, e shoqja e Kamil Pashës, kishte një Kuran të shkruar me ar nga Shejh Hamidullahu. Ajo ia paraqet atë sultanit dhe i thotë:

“Zotëri, meqë nuk i pranuat tapitë, urdhëroni këtë Kuran të shkruar me ar, si qira dhëmbi!”

Abdulazizi e merr Kuranin, e puth, e vendos në ballë dhe e falënderon.

Krahas shumë bamirësive të kësaj familjeje tepër bamirëse, sot ekziston ende Spitali Zejneb Kamil, i cili ka mbetur si sadaka e pandërprerë për ta.


Një shembull tjetër shumë i bukur i vëllazërisë islame që shfaqet sidomos gjatë Ramazanit të Bekuar, është edhe kjo:

Një Ramazan, Sulltan Mustafai i III-të shkoi për iftar në konakun e Shejhu'l-Islamit, Mehmed Emin Efendisë. Gjatë bisedës, ndër të tjera i tha:

- Mehmed Emin Efendi, nganjëherë dëshiroj të vij te ju, por konaku juaj është shumë larg!

*Profeti ynë ﷺ,
ka thënë: “S’ka asnjë
dyshim që sadakaja
(lëmosha) kalon në
dorën e Allahut pa
kaluar ende në dorën
e nevojtarit.”*

*(Munavi, Kunudhul
Hakaik, fq. 34)*



Mehmed Emin Efendia, me mirësjellje dhe modesti, i bëri sulltanit një shpjegim indirekt duke u shprehur:

- Sulltan i nderuar! Falë jush mund të marr një shtëpi në ndonjë vend më afër, por siç e shikoni, asnjëra prej këtyre shtëpive nuk ka kuzhinë.

Padishahu, i habitur nga ky shpjegim, pyeti:

- E çuditshme! A nuk gatujmë ushqim në këto shtëpi?

Mehmed Emin Efendiu, me përvullje dhe thjeshtësi, i dha sulltanit këtë përgjigje që reflektonte ndjeshmërinë e botës së tij shpirtërore:

- Sulltan i nderuar! Të gjithëve pa përjashtim u shkon ushqimi i mëngjesit dhe i darkës nga shtëpia jonë modeste. Për këtë arsye, nuk dua që të largohem nga këtu.

I gjithë synimi i këtyre përpjekjeve, ka qenë hyrja në zemrën e një besimtari për të marrë duatë e tyre të sinqerta. Zemrat përqafonin të gjithë njerëzit, pa bërë dallim nëse është i pasur, apo i varfër. Madje, ndaj të varfërve dhe nevojtarëve bëhej edhe më tepër kujdes.

SADAKATË I MERR ALLAHUT!

Në një ajet fisnik, thuhet se:

“...Bamirësitë i pranon Allahu...” (shih. Teube, 104.)

Një besimtar vërtet i pjekur dhe i përkushtuar ndaj shërbimit, është një ushtar i zemrës që, i zhveshur nga ekzistenca e përkohshmërisë së vet, ka pranuar të qëndrojë në fund të karvanit të shërbimit. Ai është gjithmonë pranë hallexinjve, njerëzve të dobët, të varfër, jetimëve, të pashpresëve etj. Ai është një dritë që ndriçon në errësirë, një udhëzues i pashoq për atë që ka humbur rrugën.



Ndërsa Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“S’ka asnjë dyshim që sadakaja (lëmosha) kalon në dorën e Allahut pa kaluar ende në dorën e nevojtarit.” (Munavi, Kunudhul Hakaik, fq. 34)

Për shkak të këtyre të vërtetave, sadakatë dhe dhuratat, jepeshin duke falënderuar ata që i pranonin ato. Lidhur me këtë, Ebu Lejs Semerkandi ka thënë:

“Për sa i përket dhurimit; personi i cili dhuron lëmoshën, duhet ta falënderojë personin që e merr atë.” Kjo, sepse dhuruesi do të shpëtojë nga shumë shqetësime, fatkeqësi, vuajtje të kësaj bote dhe botës tjetër në saje të personit që i dhurohet. Dhe çështje më e rëndësishme do të fitojë kënaqësinë e Zotit (xh.sh.).

Në të kundërtën; nëse gjatë dhënies së sadakasë bëhen veprime që e cenojnë dinjitetin e të varfrit, ajo bamirësi humbet. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer!..” (Bekare, 264.)

Për këtë arsye, Sami Efendia dhe babai im i shtrenjtë, Musa Topbash, tregoheshin shumë të ndjeshëm ndaj rregullave të etikës së sadakasë dhe dhurimit. Aq, sa personave që u dhuronin diçka, u drejtoheshin me fjalët, “Zotëri i nderuar.., ju falënderoj që pranuat sadakanë time...”. Kjo, në mënyrë që ata të mos ndiheshin në borxh moral. Pra, ata i falënderonin

Zoti ynë, urdhëron që besimtarët të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Kuptimi i dy duarve që lajnë njëra-tjetrën, është plotësimi i mangësive materiale dhe shpirtërore të njërit-tjetrit, ndarja e gëzimeve dhe hidhërimeve, falja e gabimeve, qarja e halleve, këshillimi dhe konsiderimi i vëllait si më të mirë dhe më të pastër se vetja.



me sinqeritet për mundësinë që u kishin dhënë për të fituar kënaqësinë hyjnore.

Po ashtu, të sëmurëve u dërgohej ushqim në enë të mbyllura. Krahas kujdesit ndaj njerëzve, nuk anashkalohej edhe kujdesi ndaj kafshëve.

Shtëpia e të pasurit, dallonte nga shtëpia e të varfrit vetëm nga copa që përdorej për divanet. E në fakt, të pasurit dhe të varfrit ishin si dy duar që lanin zemrat e njëri-tjetrit në të njëjtën lagje.

Sepse;

Një manifestimi i rëndësishëm i vëllazërisë Islame, është edhe modestia. Besimtarët asnjëherë nuk e shihnin veten më lartë se vëllzërit e tyre. Sahabët e nderuar, edhe nëse ngriheshin në detyra të larta, si kalifë apo guvernatorë, ata nuk e braktisnin asnjëherë modestinë. Një shembull i bukur i kësaj të vërtete, tregohet kështu me gjuhën letrare të Mevlanës:

Njëherë, një përfaqësues i mbretit të Romës, erdhi tek Omeri ﷺ, në Medine, pasi kishte udhëtuar për ditë të tëra përmes shkretëtirës pa anë e pa fund. Kur mbërriti në Medinë, pyeti popullin:

- Ku ndodhej saraji i kalifit?

- Kalifi ynë nuk ka saraje ashtu si mendoni ju. Por ka një saraj shpirti dhe zemre shumë madhështor! Edhe pse në botë Omeri njihet si prijës dhe kalif, ai ka vetëm një shtëpi të vogël dhe të varfër. – Iu përgjigjën njerëzit.

Kur Omer Bin Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë), u zgjodh kalif, i kërkoi gruas t'ia dhuronte të gjitha xehvahiret e veta thesarit të shtetit.



Kur një grua e kuptoi se përfaqësuesi ishte i huaj dhe po kërkonte Omerin ﷺ, i tha:

- Ja ku është Omeri; nën atë pemën e hurmës!

Ja pra, kjo ishte modestia e sahabëve...

Lidhur me këtë, do të doja të tregoja edhe një kujtimin tim:

Njëherë, kur shkuam në Medine, ishim për vizitë tek Said Shamili, nipi i Shejh Shamilit. Me këtë rast, ai na dha një porosi/amanet që t'ia dorëzonim motrave të tij në Stamboll. Kur u kthyem në Stamboll, shkuam në adresën që na dha ai, e cila ndodhej në Fatih.

Derën na e hapi një shërbyese sudaneze dhe na ftoi brenda. Më pas, erdhën motrat e nderuara të Said Shamilit. Pa vonuar shumë, shërbyesja sudaneze na qerasi kafënë. Atë moment, motrat e Saidit, për ta nderuar shërbyesën e tyre, e prezantuan duke thënë:

“Kjo zonjë është motra jonë e qumështit!”

Ky prezantim na pëlqeu shumë, sepse tregonte edukatën dhe mirësjelljen në lidhje me vëllazërinë Islame. Ato jo vetëm na e prezantuan, por në vend që të thoshin “shërbyesja”, thanë “motra jonë e qumështit”, gjë që tregon moralin e bukur të besimtarit.

Qytetërimi ynë, është themeluar mbi modelin e njeriut modest, të mëshirshëm, bujar dhe të arsyeshëm që ndërtoi Profeti ynë ﷺ.

Dija e dobishme, në saje të një meditimi të shëndetshëm, përforcon besimin dhe vulos akiden me vepra të singerta dhe të mira. Nëse dija nuk i ka këto dobi, as besimi nuk zë vend në zemër.



Allahu na e mundësoftë përsëri të arrijmë nivelin e qytetërimit të të parëve tanë! O Allah!.. Na gjallëro me vetëdijen e vëllazërisë dhe të umetit që zotëron-te Profeti ynë ﷺ!.. Fali botës Islame shoqërinë e devotshme dhe të qetë, të stolisur me moralin e bukur profetik!..

Amin!..



Enes bin Malik رضي الله عنه, tregon: “Nëse i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk e shihte ndonjë prej vëllazërve të tij besimtar për tre ditë radhazi, pyeste për të. Nëse ndodhej larg lutej për të, nëse ishte në shtëpi i bënte vizitë, e nëse ishte sëmurë shkonte për t’i uruar shërim të shpejtë.” (Hejthemi, II, 295.)





PASTRIMI DHE EDUKIMI I SAHABËVE DHE UMMETIT TË TIJ

Në zemrat e shkretuara ku tashmë kishte filluar të behte pranvera, gjetën udhëzim armiq të paepur të Profetit ﷺ, si Vahshiu, Hindi, Ikrinja, etj. Në vend të Ikrimes, që therte njerëz në Uhud, erdhi një Ikrime që në Jermuk fërkonte faqet e Kuranit në fytyrë dhe derdhte lot duke thënë: "Këto janë ajetet e Zotit tim!..". Ky transformim ishte rezultat i edukimit dhe pastrimit shpirtëror që bëri i Dërguari i Allahut ﷺ.



PASTRIMI DHE EDUKIMI I SAHABËVE DHE UMMETIT TË TIJ

THEMELI I FESË DHE PERSONALITETIT

Allahu i Madhëruar, falë mëshirës së Tij të pafundme, i ka dërguar njerëzimit profetë, të cilët do ta udhëzojnë atë në rrugën e drejtë me qëllim që të gjejë shpëtimin në vendin e lumturisë në botën tjetër.

Allahu i Madhëruar, të dërguarit e Vet, i zgjodhi mes njerëzve më të devotshëm, më të pastër, më të moralshëm dhe me karakter e personalitetet më të plotë. Për rrjedhojë, feja është ndërtuar mbi moralin më të bukur dhe më madhështor.

Para se të ngarkohej me detyrën e profetësisë, pra, në periudhën 40 vjeçare të jetës së Profetit tonë ﷺ, Allahu e zbukuroi moralin e tij dhe e bëri të njohur tek njerëzit për atë moral të bukur. Madje, edhe vetë idhujtarët, të cilët ishin të zhytur në besime të kota dhe imoralitet, e vërtetuan me fjalët e tyre moralin e tij të pashoq. Aq, sa edhe vetë Ebu Xhehli, armi-

ku më i madh i Profetit tonë ﷺ, nuk i tha dot, “ti gënjen!”. Ai mundi t’i thotë vetëm se: “Ne nuk po të quajmë gënjeshtar. Ti je njeriu më i drejtë mes nesh. Mirëpo, ata që t’i sjellin këto mesazhe po të mashtrojnë. Ne nuk e duam atë që ke sjellë ti.” Ky fakt, është shprehur kështu në Kuranin Fisnik:

“Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut.” (En’ām, 33.)

Ja pra, pas këtij morali madhështor të shfaqur për dyzetë vite të jetës, bashkë me profetësinë, në fillim i vjen akaidi, besimi i drejtë i ndërtuar mbi teuhidin. Pas forcimit me këtë besim të vërtetë, erdhën adhurimet dhe ligjet fetare.


Morali është parimi më i rëndësishëm. Ai është themeli i personalitetit të një njeriu. Personaliteti i përsosur i një besimtari, ndërtohet në saje të besimit të vërtetë, veprës së sinqertë dhe sjelljeve të pastra. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

“Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.)

Nisur nga kjo, detyra jonë parësore, është t’i ngjajmë Profetit tonë ﷺ, në moral. Kjo, sepse tek Profeti ynë ﷺ, ishin mishëruar virtytet e bukura njerëzore.

Shkurtimisht, në thelbin e njeriut, qëndron morali. Ashtu siç është e domosdoshme të ndërtohen themele të



forta për një ndërtesë, ashtu është e domosdoshme që në themelin e personalitetit njerëzor, të ketë moral të bukur.

Moral, do të thotë përmirësim i ndjenjave. Dhe, qendra e ndjenjave është zemra. Prandaj, Allahu i Madhëruar kërkon që ne të përqendrohemi tek zemra. Ai dëshiron “kalb-i munib”, një zemër të orientuar drejt Allahut. Për të arritur shpëtimin, Ai vë kushtin e “kalb-i selim / zemrës së pastër”... Po ashtu, që zemra të arrijë paqen dhe kënaqësinë e vërtetë, Allahu na ka këshilluar “dhikrin”, sepse kjo është e mundur vetëm falë përkujtimit të vazhdueshëm të Tij, pa e harruar asnjë çast Atë.

Nëse zemra e njeriut arrin këtë pjekuri, ajo bëhet pasuria më e çmuar e tij... Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“...Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit...” (Isra, 70.)

Por, ky nderim është i lidhur fort me gradat që do të arrijë zemra... dhe, në këtë udhëtim të zemrës, udhërrëfyesit e saj janë të dërguarit e Zotit:

TRI DETYRA PROFETIKE:

Detyrat e profetëve ndaj popujve të tyre, mund të përmblihen në tri pjesë:

1. Kumtimi i ajeteve të Allahut.



Ashtu siç është e domosdoshme të ndërtohen themele të forta për një ndërtesë, ashtu është e domosdoshme që në themelin e personalitetit njerëzor, të ketë moral të bukur.

2. Pastrimi i tyre.

3. Edukimi me librin hyjnor dhe urtësinë.

Profeti ynë i nderuar ﷺ, pas marrjes së urdhrit hyjnor “Lexo!” në shpellën Hira, në fillim ftoi në fenë e vërtetë familjen e tij, pastaj të afërmit, fisin, banorët e qytetit dhe më në fund, të gjithë botën me anë të letrave diplomatike që u dërgoi mbretërve dhe sunduesve.

Ata që iu përgjigjën ftesës, i urdhëroi në bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Kështu, sahabët, të cilët kishin pranuar ftesën Islame, Profeti ynë ﷺ, i edukoi dhe i pastroi me shembullin dhe mësimet e tij. Në saje të përpjekjeve të tij dhe ndihmës së Allahut, doli në pah një brez myslimanësh të devotshëm, të cilët më pas ndërtuan civilizimin e madh Islam.

NDRYSHIM MADHËSHTOR

*Allahu i Madhëruar
kërkon që ne të
përqendrohemi tek
zemra. Ai dëshiron
“kalb-i munib”, një
zemër të orientuar drejt
Allahut. Për të arritur
shpëtimin, Ai vë kushtin
e “kalb-i selim / zemrës
së pastër”.*



Prej njerëzve që varrosnin të gjalla vajzat e tyre dhe kishin harruar domethënien e mëshirës, nxori një brez njerëzor të cilët ishin aq të ndjeshëm, sa nuk u bënte zemra të shqetësonin qoftë edhe një qen që ushqente këlyshët e vet buzë rrugës.

Njeriun e një periudhe, ku njeriu ishte egërsirë për njeriun, e shndërroi në një person me zemër delikate që shqetësohej për hallet e të tjerëve, qoftë edhe në vende më të largëta.

Si ndodhi ky transformim madhështor?

Si rezultat i pastrimit të egove dhe ndryshimit që ndodhi në botën e zemrës së tyre.


Tezkije, do të thotë “të pastrosh”. Njeriu zotëron një un/ego të mbushur me ndjenja primitive. Nëse uni/egoja nuk edukohet, ndjenjat dhe dëshirat e njeriut do të mbesin ashtu të pagdhendura, të papjekura dhe egoiste. Edhe pse njeriu, si rezultat i natyrshmërisë së krijimit, zotëron aftësinë e ndjenjave dhe dëshirave të bukura, nëse ai nuk edukohet siç duhet, është shumë e vështirë që ato ndjenja të zhvillohen në drejtimin e duhur.

Si rezultat i një pastrimi shpirtëror, njeriu fillon të njohë mirë veten, e për rrjedhojë, edhe Zotin e tij. Kjo do të thotë përparim në njohjen e Allahut dhe stolisje e zemrës me virtytet e bukura hyjnore. Njohja e vërtetë e Allahut, nuk arrihet thjeshtë me laps e letër, me të lexuar e shkruar; ajo arrihet duke ndjerë me zemër dhe duke përjetuar.

Mësimi i dijeve dhe urtësisë, mund të arrihet vetëm pas pastrimit të egos. Pikësëpari, njeriu duhet të pastrohet, pastaj zemra e tij do të fillojë të ndjejë thellësinë në Kuranin Fisnik, i cili, vetëm në një zemër të devotshme mund të shfaqet me gjithë madhësinë e tij. Në një ajet fisnik urdhërohet:

هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

“...(Ky Libër) është udhërrëfyes për të devotshmit!” (Bekare, 2)



EDUKIMI DHE TEZKIJA

Edukimi përkufizohet si procesi i “fitimit të sjelljeve të drejta dhe të bukura”. I pranuar, nuk është ndryshimi i çastit, thjesht ngjyrosja; por ai i qëndrueshmi në sjellje të bukura dhe moral të lartë.

Me ngritjen e gradëve shpirtërore, pra me rritjen e devotshmërisë, fillon miqësia me Allahun, lidhur me të cilin Allahu i Madhëruar urdhëron:

وَاتَّقُوا اللَّهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّهُ

“...Ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju!..” (Bekare, 282)

Në këtë aspekt, sahabët kanë arritur përparimin më të jashtëzakonshëm. Për shkak se në tezkije, pastrimin shpirtëror, elementi më i rëndësishëm është edukimi me shembull personal, mësuesi luan një rol të veçantë. Profeti ynë ﷺ, zotëronte veçorinë e jashtëzakonshme të ishte “shembulli më i bukur”, për të cilën ishte lavdëruar edhe me ajet Kuranor, si njeri me “moral madhështor”, në saje të të cilit do të jetë udhëzuesi më i mirë për të gjithë umetin, deri në ditën e kiametit.

Prej njerëzve që varrosnin të gjalla vajzat e tyre dhe kishin harruar domethënien e mëshirës, nxori një brez njerëzor të cilët ishin aq të ndjeshëm sa nuk u bënte zemra të shqetësonin qoftë edhe një qen që ushqente këlyshët e vet buzë rrugës.



Edhe Profeti ynë ﷺ, ishte njeri. Edhe ai ndjente uri kur nuk kishte për të ngrënë. Edhe ai lodhej dhe mërzhitej përballë sjelljeve të këqija me të cilat përballlej. Mirëpo, në saje të gradës së lartë që arriti në “njohjen e Allahut”, në zemrën tij, këto ndjenja ishin bërë të papërfillshme.

Si rezultat i natyrës së vet, njeriu mund të hidhërohet, ose mund të gëzohet me disa ndodhi. Por, një njeri që sheh të ardhmen në botën tjetër dhe mendon çdo çast jetën pas vdekjes, nuk mund të hidhërohet apo gëzohet tepër me gjëra të përkohshme të kësaj bote.

EDUKIMI I NDJENJAVE ME VETËDIJEN NDAJ BOTËS TJETËR

Ja pra, në ndjenjat e Profetit tonë ﷺ, gjendej vetëdija ndaj botës tjetër. Për rrjedhojë, për të; “ajo për të cilën njeriu duhet të hidhërohet me të vërtetë, është dështimi në botën tjetër”, ndërsa; “ajo për të cilën duhet të gëzohet, është shpëtimit në botën tjetër.”

Kështu, edhe sahabët i morën si model jete këto parime profetike. Frika dhe hidhërimi i tyre më i madh, ishte mos takimi me Profetin ﷺ, në botën tjetër. Dhe, një prej shembujve më sentimental të këtij shqetësimi, ishte Theubani ﷺ.

Ai e donte shumë të Dërguarin e Allahut. Aq, sa nuk duronte dot aspak të qëndronte larg tij. Një ditë, ai shkoi tek Profeti ﷺ, me trup të dobësuar dhe fytyrën të zverdhur. Në fytyrën e tij lexohej lehtë një hidhërim i thellë. I Dërguari i Allahut ﷺ, e pyeti:

“O Theuban! Çfarë ke? Çfarë të shqetëson kaq shumë?”

Theubani me zemrën e mbushur me dashuri përgjigjet:

Detyrat e profetëve ndaj popujve të tyre, mund të përmbliohen në tri pjesë:

1. Kumtimi i ajeteve të Allahut.
2. Pastrimi i tyre.
3. Edukimi me librin hyjnor dhe urtësinë.



“O i Dërguar i Allahut! Ju jeni më i dashur për mua se jeta ime, familja dhe fëmijët e mi. Kur ndodhem në shtëpi dhe më kujtoheni, nuk duroj dot dhe menjëherë vij të shoh fytyrën tuaj të bekuar. Mirëpo, kur mendoj se një ditë, edhe unë, edhe ju do të vdesim, mbytem nga një pikëllim i papërshkrueshëm. E di, se kur të hyni në Xhenet, do të ngriheni në një shkallë të lartë, bashkë me profetët e tjerë. Kurse unë, edhe sikur të hyj në Xhenet, kam frikë se nuk do të arrij t’ju shoh atje.”

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk i dha asnjë përgjigje. Por, pak më vonë erdhi Xhebraili dhe shpalli këtë ajet:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69.) (Uahidi, f. 170.)

Ndërsa vetë Profeti ynë ﷺ, ka dhënë këtë lajm të mirë për të gjithë ata besimtarë të sinqertë, të cilët ashtu si Theubani, vuajnë shqetësimin e ndarjes nga i Dërguari i Allahut në ditën e Kiametit:

Tezkije, do të thotë “të pastrosh”. Njeriu zotëron një un/ego të mbushur me ndjenja primitive. Nëse uni/egoja nuk edukohet, ndjenjat dhe dëshirat e njeriut do të mbesin ashtu të pagdhendura, të papjekura dhe egoiste.



“Njeriu është me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Enesi رضي الله عنه, ka thënë:

“Përveç hyrjes në islam, asgjë tjetër nuk na kishte gëzuar më shumë se fjala e të Dërguarit të Allahut: «Atëherë, ti do të jesh me atë që do»...” (Muslim, Birr, 163.)

Padyshim se;

Edhe gjërat që e gëzojnë më tepër Resulullahun ﷺ, janë gëzimet në lidhje me botën tjetër. Enesi رضي الله عنه tregon:

Profeti ﷺ, kishte një djalosh hebre që i shërbente. Një ditë, djaloshi u sëmur dhe Profeti ﷺ, shkoi për ta vizituar, iu ul tek koka dhe i tha:

“Bëhu mysliman!”

Djaloshi pa nga i ati për ta kuptuar se çmendonte. I ati i tha:

“Bëj siç të thotë Ebu’l Kasëmi!”

Më pas, djaloshi u bë mysliman. Atëherë, Profeti ﷺ tha:

“Lavdi Allahut që e shpëtoi këtë djalosh nga Xhehenemi!” Dhe doli jashtë. (Buhari, Xhenaiz, 80.)

Si rezultat i një pastrimi shpirtëror, njeriu fillon të njohë mirë veten, e për rrjedhojë edhe Zotin e tij. Kjo do të thotë përparim në njohjen e Allahut dhe stolisja e zemrës me virtytet e bukura hyjnore.



GËZIMI I UDHËZIMIT

Ishte viti i pikëllimit. S’kishte shumë që bashkëshortja e tij e dashur, Hadixhja ﷺ dhe kujdestari i tij që prej fëmijërisë, xhaxhai Ebu Talibi, kishin ndërruar jetë. Për të kërkuar një rrugëzgjdhje për vuajtjet që myslimanët po përjetonin në Mekë, Profeti ynë i dashur ﷺ, dëshiroi të shkonte në qytetin e Taifit dhe të ftonte në Islam fisin Thakif.

Pas një rruge të gjatë dhjetë ditore, ai arriti në Taif dhe filloi të ftonte popullin në Islam. Mirëpo, ata fatzinj, e pritën aq keq dhe me aq mosmirënjohje këtë mirësi që u erdhi tek këmbët për t’u sjellë lumturinë e të dyja botëve, saqë e refuzuan Profetin ﷺ dhe e dëbuan nga vendi duke e goditur me gurë.

I Dërguari i Allahut u prek jashtë mase nga kjo sjellje barbare. Ai, së bashku me ndihmësin e tij, Zejdin ﷺ, u munduan

t'i shpëtonin sulmeve të banorëve të Taifit dhe u strehuan në një kopsht. Aty, u takuan me një skllav nga Ninova, i quajtur Addas. Kur Addasi vuri re ndryshimin e Profetit tonë ﷺ, nga njerëzit e tjerë, si në sjellje, ashtu edhe në fjalë, i tha:

“Ju jeni ndryshe! Nuk u ngjani aspak njerëzve të këtyre anëve! Kush jeni?”

Pas një bisede të shkurtër dhe përgjigjeve që mori nga i Dërguari i Allahut ﷺ, Addasi pranoi Islam. Gëzimi që ndjeu Profeti ynë ﷺ, prej udhëzimit të atij skllavi, e bëri atë t'i harrojë të gjitha të këqijat që përjetoi atë ditë në Taif.

Sa mëshirë e madhe!.. Sa zemër madhështore!.. Të harrosh vuajtjet personale për shkak të lumturisë së tjetrit!..

Shembujt më të veçantë të këtij virtyti të lartë, u përjetuan pas çlirimit të Mekës.

Esvedi që kishte shkaktuar rrëzimin e vajzës së Profetit ﷺ, nga deveja, e për pasojë edhe vdekjen e saj më pas... Esvedi, i cili ishte dënuar me vdekje...

Pikërisht kur ai Esved erdhi para Profetit tonë ﷺ, duke shprehur shehadetin, kjo kënaqësi shpirtërore, e bëri Profetin ﷺ, të harronte dhimbjen e vajzës së tij. Ai nuk anoi qoftë edhe për një çast nga kënaqësia djegëse e hakmarrjes, por shijoi ëmbëlsinë e mëshirës që i jep qetësi shpirtit. Ai fali Esvedin, fali edhe shumë jetë të tjera... Ai i ujiti me shirat e mëshirës zemrat e shkretuara të armiqve të tij më të përbetuar dhe, në to kultivoi dashurinë hyjnore.

Njohja e vërtetë e Allahut, nuk arrihet thjeshtë me laps e letër, me të lexuar e shkruar... Ajo arrihet duke ndjerë me zemër dhe duke përjetuar.



Në zemrat e shkretuara ku tashmë kishte filluar të behte pranvera, gjetën udhëzim armiq të paepur të Profetit ﷺ, si Vahshiu, Hindi, Ikrimja, etj. Në vend të Ikrimes, që therte njerëz në Uhud, erdhi një Ikrime që në Jermuk fërkonte faqet e Kuranit në fytyrë dhe derdhte lot duke thënë: “Këto janë ajetet e Zotit tim!..”. Ky transformim ishte rezultat i edukimit dhe pastrimit shpirtëror që bëri i Dërguari i Allahut ﷺ.

ËMBËLSIA SHPIRTËRORE QË TË BËN TË HARROSH URINË

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk e ka pasur kurrë hallin e ushqimit dhe urisë. Përgjegjësia ndaj detyrës profetike dhe shqetësimi për popullin e vet, i tejkalonin nevojat e tij fiziologjike, duke e bërë kështu, të harronte edhe urinë. Kur ishte aq i uritur sa të lidhte edhe gur në bark, ai ngopej me ëmbëlsinë e mësimit të Kuranit që u jepet sahabëve të suffes.

Po ashtu edhe në betejën e Hendekut, kishte ditë pa vënë gjë në gojë. Xhabiri ﷺ, e vërejti gjendjen e Profetit ﷺ dhe i erdhi keq. Prandaj, ai mendoi ta gostiste Profetin ﷺ dhe disa sahabë të tjerë me një keq dhe pak bukë. Përveç këtyre, ai nuk kishte asgjë tjetër.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, e dëgjoi ftesën e Xhabirit ﷺ, e harroi urinë e vet dhe mendoi për sahabët. Kështu, ai i mori me vete të gjithë sahabët dhe falë begatisë së mrekullisë hyjnore, me një keq e pak bukë, u ngopën me ushqim dhjetëra njerëz. Vetë Profeti ﷺ, hëngri i fundit. Dhe, sikur të mos

Mësimi i dijeve dhe urtësisë, mund të arrihet vetëm pas pastrimit të egos. Pikësëpari, njeriu duhet të pastrohet, pastaj zemra e tij do të fillojë të ndjejë thellësinë në Kuranin Fisnik, i cili, vetëm në një zemër të devotshme mund të shfaqet me gjithë madhësinë e tij.



mjaftonte e gjithë kjo, ai mendoi edhe për fqinjët përreth, duke urdhëruar t'u dërgohej edhe atyre.

Kjo gjendje e mbushur me ëmbëlsi shpirtërore, që e bënte të harronte edhe urinë e vet, nuk ishte e kufizuar vetëm në kohët e skamjes. Siç tregon nëna jonë Aisha رضي الله عنها; në periudhën pas betejës së Hajberit, erdhën fitore të tjera njëra pas tjetrës dhe në Medinë, rrodhi pasuria nga plaçka e luftës dhe dhuratat e ndryshme. Mirëpo, edhe në këtë gjendje, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk u ngop me bukë elbi as tri ditë me radhë, sepse ai e shpërndante gjithçka që vinte; sepse ëmbëlsia që i jepte dhurimi, e kishte kaluar nevojën e largimit të urisë. Sa më shumë dhuronte, aq më shumë ngopej shpirtërisht, sepse po të kishte qoftë edhe një person të uritur, ai nuk shijonte asgjë nga ushqimi që hante.

*Enesi رضي الله عنه, ka thënë:
“Përveç hyrjes
në islam, asgjë
tjetër nuk na
kishte gëzuar më
shumë se fjala e
të Dërguarit të
Allahut: «Atëherë,
ti do të jesh me
atë që do»...”*

(Muslim, Birr, 163.)



Njeriu; kur i pakësohet pasuria mër-zitet; kur i shtohet, gëzohet. Por, kur ndjenjat transformohen në saje të njohjes së Allahut dhe pastrimit të egos, qendra e zemrës nuk janë më interesat e ngush-ta të kësaj bote. Një zemër e tillë gëzohet vetëm me arritjen e kënaqësisë së Allahut.

Një ditë, familja e Profetit ﷺ, kishte prerë një dele. Pasi kishin dhuruar një pjesë të mirë të saj, i Dërguari i Allahut ﷺ, pyeti familjarët se çfarë kishte mbetur nga delja që kishin prerë. Aisha رضي الله عنها, u përgjigj:

“Ka mbetur vetëm një shpatull.”

Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Pse nuk thua; neve na paska mbetur e gjitha, me përjashtim të një shpatulle.” (Tirmidhi, Kiamet, 33/2470.)

Profeti ynë ﷺ, dëshironte çdo çast që t'i injektonte umetit të tij ndjenjën e shqetësimit me hallet e të tjerëve. Këtë të vërtetë e tregon shumë bukur edhe ky shembull:

DIELL SHËRBIMI

Një ditë pas namazit të sabahut, Profeti ﷺ, u kthye nga shokët dhe i pyeti:

“A është kush agjërueshëm sot?”

- O i Dërguari i Allahut! Mbrëmë nuk e bëra nijetin për të agjëruar sot, prandaj nuk jam agjërueshëm. – tha Omeri ﷺ.

Kurse Ebu Bekri ﷺ, tha:

- Unë e bëra nijet mbrëmë për të agjëruar dhe sot jam agjërueshëm.

Pyetja e lartpërmendur e Profetit ﷺ, ishte individuale. Ai pas kësaj filloi të bëjë disa pyetje që kishin lidhje me veprimtarinë shoqërore.

- *“A ka vizituar kush ndonjë të sëmurë sot?”*

- Ne ende nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut... Si mund të kishim vizituar të sëmurë?! - tha Omeri ﷺ.



Njeriu; kur i pakësohet pasuria mërzitet, e kur i shtohet, gëzohet. Por kur ndjenja transformohen në saje të njohjes së Allahut dhe pastrimit të egos, qendra e zemrës nuk janë më interesat e ngushta të kësaj bote. Një zemër e tillë gëzohet vetëm me arritjen e kënaqësisë së Allahut.

Kurse Ebu Bekri ﷺ, tha:

- Dëgjova se Abdurrahman ibn Auf ishte sëmurë dhe rrugës për në xhami i bëra një vizitë dhe u luta për shërimin e tij sa më të shpejtë.

Profeti ﷺ, vazhdoi me një pyetje tjetër:

- *“A ka ndihmuar kush prej jush ndonjë sot?”*

- Ne tani sapo falëm namazin dhe akoma nuk kemi dalë nga xhamia, o i Dërguari i Allahut!..

Kurse Ebu Bekri tha:

- Në hyrje të xhamisë na doli një i vobektë, i cili kërkoi diçka për të ngrënë. Unë ia mora djalit tim Abdurrahman-it bukën që kishte në dorë dhe ia dhashë atij.

Mbas kësaj Profeti ﷺ, tha:

- *“Të përgëzoj me Xhenet ty, o Ebu Bekr!”*


Omeri ﷺ, mori frymë thellë dhe tha:

“Ah Xheneti!”

Profeti ﷺ, për t'i fituar zemrën Omer-it tha:

- *“Allahu e mëshiroftë Omerin, Allahu e mëshiroftë Omerin! Sa herë që dëshiron të bëjë një të mirë, Ebu Bekri ia kalon gjithmonë!”* (Hejthemi, III, 163-164.)

Pra, një mysliman, duhet të bartë



gjithmonë dëshirën për të shërbyer. Ai duhet të jetojë gjithmonë me pyetjen: “Çfarë të shërbejë në rrugën e Allahut që të jem i dobishëm për të tjerët?”

Profeti ynë ﷺ, këto pyetje i bënte që në namazin e sabahut, me qëllim që ndër-gjegjet të pastrohen dhe ashtu ta fillojnë ditën. Në këtë mënyrë, dita do të vazh-donte e mbushur me këto shërbime e bamirësi. Një besimtar që e fillon ditën me këtë vetëdije, duhet ta shfrytëzojë çdo mundësi që i del para dhe të mos e kon-siderojë të mjaftueshme asgjë që ka bërë deri atëherë. Por, çdo ditë të re, ta filloj me një entuziazëm të ri shërbimi.

Ngjarja e përmendur më sipër, tregon se;

Mes të gjithë sahabëve, Ebu Bekri ﷺ, kishte një pozitë të veçantë tek Profeti ﷺ. Ai ishte gati për çdo gjë. Ai i kishte kryer të gjitha këto shërbime pa i thënë ende i Dërguari i Allahut ﷺ. Ishte sikur në zemrën e tij gjendej gjithçka që kishte në zemrën e Profetit ﷺ. Dukej sikur ai ishte bërë njësh me shpirtin e Resulullahut ﷺ.

Për këtë arsye, në ditë e fundit të jetës, kur Profetit ﷺ, nuk i kishte mbetur fuqi për të prirë në namaze, ai ia ngarkoi këtë detyrë Ebu Bekrit ﷺ. Ky sahab i madh, kishte arritur mirësinë hyjnore që të përmendej në Kuranin Fisnik si “i dyti i të dyve”.

Nisur nga ky fakt, mund të thuhet se Ebu Bekri ﷺ, është një shembull shumë i bukur për të gjithë besimtarët që dëshirojnë t'i afrohen moralit dhe bukurisë shpirtërore të Profetit tonë ﷺ.



Ebu Bekri ﷺ, është një shembull shumë i bukur për të gjithë besimtarët që dëshirojnë t'i afrohen moralit dhe bukurisë shpirtërore të Profetit tonë ﷺ.

Pasioni për t'i shërbyer shoqërisë, është aq i rëndësishëm, saqë i Dërguari i Allahut ﷺ, i ka pyetur sahabët për këto detyra që në namazin e sabahut, pa lindur ende dielli. Siç u shpreh edhe vetë Omeri ﷺ, “dita nuk kishte lindur ende”. Mirëpo, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka insistuar që dielli i shërbimit duhet të lindi edhe më herët në zemrat e besimtarëve.

Sepse;

Gëzimi i tij ishte për popullin. Halli i tij ishte vetë populli. Madje, edhe buzëqeshjen më të bukur të tij, ai e shfaqti mbase në ditët më të vështira të shëndetit të vet. Ishin ditën e fundit të jetës së tij të bekuar në këtë botë. Trupi i tij nuk kishte takat të merrte pjesë në namazet me xhemat. Pavarësisht se i hidhej vazhdimisht ujë, ai nuk mundi të shkonte në namazin me xhemat. Kështu, Profeti ﷺ, e urdhëroi Ebu Bekrin ﷺ, të printe në namaz.

Një radhë, kur kishte marrë pak fuqi, ai doli në mesin e sahabëve të përmalluar, duke qëndruar në krahët e Abbasit dhe Aliut ﷺ. Pastaj, u ul pranë Ebu Bekrit ﷺ, që ishte gati për të prirë në namaz dhe e fali namazin ashtu ulur. (shih. Buhari, Istihlaf-i Imam, 687.)

Ndërsa ditën e fundit, në namazin e sabahut i ngritën perden e derës dhe ai pa për herë të fundit sahabët e tij të dashur tek falnin namaz të prirë nga Ebu Bekri ﷺ. Kështu, ai buzëqeshi i lumtur duke parë i kënaqur sahabët e vet që faleshin të rreshtuar në xhemat. (shih. Buhari, Megazi, 83.)



*Një mysliman
duhet të bartë
gjithmonë dëshirën
për të shërbyer.
Ai duhet të jetojë
gjithmonë me
pyetjen: “Çfarë të
shërbejë në rrugën
e Allahut që të jem
i dobishëm për të
tjerët?”*

Nëna jonë Aisha رضي الله عنها, që na e ka treguar këtë ngjarje, thotë:

“I Dërguari i Allahut ﷺ, e sodiste me buzëqeshje faljen e namazit nga sahabët. Kurrë nuk e kisha parë të Dërguarin e Allahut kaq të gëzuar!” (Ibni Hisham, IV, 331.)

Profeti ynë ﷺ, përgjatë gjithë periudhës së profetësisë, ka jetuar duke ia kushtuar jetën dhe çdo gjë që kishte popullit të vet, sepse kjo i jepte atij një kënaqësi të jashtëzakonshme. Këtë sakrificë, këmbëngulje dhe altruizëm që shfaqti ai, e jetonte, e zbatonte edhe familja e tij. Këtë e tregon më së miri edhe gjendja që përjetonte vajza e tij Fatma me burrin e saj Aliun رضي الله عنه:

Gëzimi i Profetit tonë ﷺ, ishte për popullin. Halli i tij ishte vetë populli. Madje, edhe buzëqeshjen më të bukur të tij, ai e shfaqti mbase në ditën më të vështira të shëndetit të vet.



VETËM PËR HIR TË ALLAHUT

Në një transmetim të Ibn Abbasit رضي الله عنه, thuhet:

Një herë, Aliu ujiti për tërë natën një bahçe me hurma, për të fituar një sasi të caktuar elbi. Kur gdhiu, mori atë sasi elbi që ishte haku i punës së tij dhe shkoi në shtëpi. Një të tretën e sasisë së elbit që fitoi Aliu atë natë, e bluan të gjithë së bashku si familje, me qëllim që të gatuanin një ushqim të veçantë që quhej “hazira”. Pasi përgatitën hazirën, në derë ia behu një i varfër që kërkonte ushqim. Kështu, ata i dhanë ushqim nga ai që e kishin bërë gati. Më pas, morën një të tretën e dytë të elbit që Aliu kishte fituar duke punuar tërë natën, e bluan dhe e gatuan për ta ngrënë. Atë çast ia behu një jetim, që kërkoi diçka për të ngrënë. Ata ia dhanë menjëherë jetimit atë që kish-

in përgatitur për të ngrënë vetë. Pastaj, filluan të bluanin e të përgatisnin pjesën e mbetur të elbit. Kur ushqimi u bë gati, u shfaq në derë një idhujtar i zënë rob, i cili u kërkoi diçka për të ngrënë. Kështu, edhe sasinë e fundit të ushqimit ia dhanë atij, duke e kaluar të uritur atë ditë. Sipas një transmetimi tjetër, kjo histori ka ndodhur kur Aliu së bashku me familjen e tij kanë qenë agjërueshëm. Tre nevojtarët, pra i varfri, jetimi dhe skllavi kanë ardhur në prag iftari. Ushqimi u është dhënë këtyre të varfërve të sipërpërmendur, ndërsa pjesëtarët e kësaj familjeje të nderuar e kanë bërë iftarin vetëm me ujë. Kjo ngjarje u bë shkak për shpalljen e këtyre ajeteve:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura. Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.”

(Insan, 8-11) (Vahidi, Esbabu Nuzul, s. 470; Zemahsheri, el-Keshshaf, VI, 191-192; Razi, XXX, 244.)

Aisha ؓ, tregon: “I Dërguari i Allahut ﷺ, e sodiste me buzëqeshje faljen e namazit nga sahabët. Kurrë nuk e kisha parë të Dërguarin e Allahut kaq të gëzuar!”

(Ibni Hisham, IV, 331.)



Si rezultat i pastrimit të zemrës, shqetësimi për botën tjetër ishte aq i fortë tek ata, saqë e harronin urinë e tyre dhe ua dhuronin atë që kishin nevojtarëve që u kërkonin për hir të Allahut, edhe pse ishin nevojtarë për vete.

Po ashtu, edhe kjo tablo madhështore e altruizmit që shfaqën tre sahabët e plagosur në betejën e Jermukut dhe gjendeshin të shtrirë mbi rërën e nxehtë në fushëbetejë duke pritur vdekjen, është një

shembull i jashtëzakonshëm i kënaqësisë shpirtërore që të jep ndjenja e sakrificës për hir të Allahut:

Hudhejfe ﷺ, tregon:

“Ishim në betejën e Jermukut, e cila u zhvillua shumë e ashpër. Myslimanët e plagosur nga shigjetat dhe heshtat, po jepnin shpirt mbi rërën e nxehtë ku kishin rënë. Në këtë kohë, unë mbledha gjithë fuqitë dhe fillova të kërkoja djalin e xhaxhait. Pasi kërkoja mes të plagosurve, të cilët po përjetonin çastet e fundit të jetës, më në fund e gjeta, por pa dobi; djali i xhaxhait qëndronte i shtrirë mbi një lumë gjaku dhe nuk mund të fliste përveçse duke lëvizur sytë. I tregova enën e ujit që e kisha përgatitur më parë dhe e pyeta:

- A do ujë?

Dukej që donte, sepse buzët i ishin tharë nga të nxehtët, por nuk kishte fuqi të jepte përgjigje. Vetëm se, me lëvizjet e syve, dukej sikur aludonte për gjendjen e mjeruar në të cilën ndodhej.

Unë hapa grykën e enës dhe teksa po i zgjasja ujin, mes të plagosurve që ishin aty pranë u dëgjua një zë, “Ah!”

Me ta dëgjuar këtë, djali i xhaxhait ma bëri me shenjë që t’ia çoja atij ujin. Vrapova mes rërës së nxehtë ku shtriheshin të vrarët, arrita tek ai dhe e pyeta:

*Profeti ynë ﷺ,
përgjatë gjithë
periudhës së
profetësisë, ka jetuar
duke ia kushtuar
jetën dhe çdo gjë
që kishte popullit të
vet, sepse kjo i jepte
atij një kënaqësi të
jashtëzakonshme.*



- A do ujë?

“Po!” - Tha ai duke bërë shenjë me sy. Por, në çastin që do të pinte ujin, u dëgjua një rënkim nga një tjetër i plagosur. Edhe ky burrë fisnik bëri me shenjë që t’ia çoja ujin atij që rënkonte.

Vrapova, po kur shkova tek ai, pashë se kishte ndërruar jetë. Atëherë u ktheva me të shpejtë pranë të plagosurit të dytë. Teksa po i zgjasja enën e ujit, pashë se edhe ai kishte ndërruar jetë.

«Të paktën të arrij djalin e xhaxhait», thashë me vete. Shkova me një frymë tek ai. Por pa dobi, sepse edhe ai e kishte dorëzuar shpirtin duke u përpëlitur mbi rërën që të përvëlonte. Ena që mbaja në dorë më mbeti e mbushur mes tre dësh-

morëve.” (Shih. Kurtubi, xv II, 28, Zejlai, Nasbu’r-Raje, II, 318, Hakim, III, 270/5058.)

Si rezultat i pastrimit të zemrës, shqetësimi për botën tjetër tek sahabët ishte aq i fortë, saqë e harronin urinë e tyre dhe ua dhuronin atë që kishin nevojtarëve që u kërkonin për hir të Allahut, edhe pse ishin nevojtarë për vete.



Isari, është shkalla e katërt dhe më e mrekullueshme e bujarisë.

Në bujari;

Shkalla e parë, është t’i japësh atij që të kërkon. Edhe nëse nuk kemi asgjë për t’i dhënë, Allahu na urdhëron t’i themi fjalë që do t’i ngrohë zemrën:

“قَوْلًا مَّيْسُورًا / Kaulen mejsura”.

Pra, nuk refuzohet ai që kërkon, por i jepet qoftë edhe pako gjë. Po ashtu, kurrë nuk duhet qortuar apo poshtëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ

“Dhe lypësin mos e shty me ashpërsi!” (Duha, 10.)

KUSH NA JEP NEVE?

Babai im i ndjerë, Musa Efendia, hi-dhërohej shumë me ata që u thoshin lypësve; “Zoti të dhëntë, Zoti të dhëntë!” - dhe thoshte:

“Vallë po neve kush na jep? Përse na jep neve Allahu? Vetëm për veten tonë? Pra, duhet të mendojmë:

Edhe ne kërkojmë vazhdimisht nga Zoti ynë, e prapë kërkojmë!.. Pasuria është e gjitha e Allahut. Prandaj robi nuk duhet ta harrojë se ai është vetëm përdoruesi i asaj pasurie, që është sprovë e jetës së kësaj bote. Po ashtu, nuk duhet të harrojë kurrë, se të pasurit kanë gjithmonë përgjegjësi ndaj nevojtarëve.

Shkalla e dytë e bujarisë, është t'i kërkojë dhe t'i gjesh nevojtarët që nuk e shfaqin gjendjen e tyre për shkak të dinjitetit. Madje, edhe nëse ata e fshehin veten, duhet t'i njohësh nga pamja e tyre, ashtu siç shprehet edhe ajeti fisnik:

“...Do t'i njohësh nga pamja e tyre...” (Bekare, 273.)

Shkalla e tretë e bujarisë dhe dhurimit, është të ndash me nevojtarët atë që ke mundësi, duke marrë shembull ensarët, të cilët ndanë me muhaxhirët gjithçka që kishin. Duke filluar prej shtëpisë, vreshtave, kopshteve, etj., ata u ofruan atyre çdo gjë duke u thënë; “*gjysma është e juaja!*”. Më vonë, kur Pro-

Shkalla e parë e bujarisë, është t'i japësh atij që të kërkon. Edhe nëse nuk kemi asgjë për t'i dhënë, Allahu na urdhëron t'i themi fjalë do t'i ngrohë zemrën.



feti ﷺ, nuk u dha gjë ensarëve prej plaçkës së luftës, por i dha vetëm muhaxhirëve që nuk kishin asgjë, ata (ensarët) e pranuan me gjithë zemër këtë ndarje. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Hashr, 9.)

Shkalla e katërt dhe më e mrekullueshme, është “isari”, që do të thotë; të preferosh t’i japësh vëllait tënd, edhe pse je nevojtar për vete. Pra, ta këpusësh prej shpirtit tënd dhe ta japësh pa pishman e pa qeder. Njësoj si tre dëshmorët e luftës së Jerimukut...

Një tjetër shembull i këtij altruizmi tregohet në lidhje me Davud-i Tain:

Një ditë, nxënësi që i shërbente, i tha:

- Kam pjekur pak mish. A dëshironi të hani?

Mësuesi heshti dhe kjo nënkuptoi miratim për nxënësin. Mirëpo, Davud-i Tai, tek po shikonte mishin që nxënësi i solli, e pyeti atë:

- Kemi ndonjë gjë të re për gjendjen ekonomike të filan jetimëve, bir?

Nxënësi iu përgjigj:

- Nuk ka asnjë gjë të re në lidhje me ta, vetëm të vjetra; ato që i dini edhe ju.

Musa Efendia, hidhërohej shumë me ata që u thoshin lypësve; “Zoti të dhëntë, Zoti të dhëntë!” - dhe thoshte: “Vallë po neve kush na jep? Përse na jep neve Allahu? Vetëm për veten tonë?”



Pas kësaj përgjigjeje, Davud-i Tai tha:

- Atëherë këtë drekë dërgojua atyre, menjëherë!

Nxënësi i tij i sinqertë, që dëshironte ta ndante këtë ushqim me mësuesin e tij, këmbënguli duke i thënë:

- Mësues i nderuar, ka kohë që ju nuk keni ngrënë aspak mish!..

Mirëpo, Davud-i Tai ia ktheu:


“O bir! Nëse unë do ta ha këtë mish që ke sjellë dhe përgatitur enkas për mua, pa kaluar shumë ai do të dalë jashtë. Por, nëse mishin në fjalë do ta hanë jetimët, ai do të ngjitet deri në Arshi Ala, ku do të na paraqitet si sevap në botën tjetër!..”

Teksa Serijji Sakati po u shtjellonte nxënësve të tij kuptimin e hadithit: “*Kush nuk shqetësohet për hallet e besimtarëve, nuk është prej tyre.*” (Hakim, Mustedrek, IV, 352; Hejthemi, Mexhmau’z-Zevaid, I, 87.), njëri nga nxënësit e tij vjen i tronditur dhe i thotë:

- Mësues! Lagjja juaj është djegur; është bërë shkrumb. Vetëm shtëpia juaj ka shpëtuar!..

I gëzuar nga ajo që dëgjoji, Serijji Sakati falënderoi Zotin dhe tha:

“Elhamdulillah!”



Shkalla e dytë e bujarisë, është t'i kërkosh dhe t'i gjesh nevojtarët që nuk e shfaqin gjendjen e tyre për shkak të dinjitetit. Madje, edhe nëse ata e fshehin veten, duhet t'i njohësh nga pamja e tyre.

Mirëpo, menjëherë i erdhi në mendje hadithi që po u mësonte nxënësve të tij dhe, duke u zhytur thellë në fshehtësinë e urtësisë së këtij hadithi, bëri teube të madhe. Kjo, sepse për një çast pakujdesie që tregoi, nuk i erdhi ndërmend fatkeqësia e besimtarëve të tjerë dhe si pasojë, në atë moment, nuk e zbatoi urdhrin profetik në lidhje me qarjen e halleve të besimtarëve. Ai u mërziq shumë për këtë, sa që nuk e harroi këtë ndodhi për shumë vite. Madje, edhe pas tridhjetë viteve, pendesën që kishte në zemër ia shpreh një mikut të tij duke i thënë:

“Kam tridhjetë vjet që po bëj teube për një çast kur u tregova i pakujdesshëm ndaj fatkeqësisë së vëllezërve të mi besimtarë...”

Shumë njerëzve as që nuk u bie ndërmend të bëjnë teube për neglizhencën që tregojnë në marrëdhëniet me vëllezërit e tyre besimtarë, për indiferencën dhe për padrejtësitë që bëjnë. Kurse një i dashur i Allahut me zemër të ndjeshme, për një “elhamdulillah” që tha në një çast pa menduar të tjerët, kërkon falje prej Allahut që tridhjetë vjet. Pra, ndryshimi i horizontit të shpirtit, ndryshon edhe botëkuptimet, edhe konceptet.

Po ashtu, këta miq të Allahut, nxitonin në mirësi dhe nuk e vononin atë. Një shembull i bukur i kësaj, është edhe kjo ndodhi e Hasan Basriut -Allahu e Mëshiroftë:-

Një nxënës kërkon diçka prej Hasan Basriut dhe ai ngrihet menjëherë e i jep

Shkalla e tretë e bujarisë dhe dhurimit, është të ndash me nevojtarët atë që ke mundësi, duke marrë shembull ensarët, të cilët ndanë me muhaxhirët gjithçka që kishin.



këmishën e vet. Ata që ndodheshin aty thanë:

“O Hasan, do të ishte më mirë të shkoje dhe t’i jepje diçka prej shtëpisë!”

Hasan Basriu tha:

“Një herë, një i varfër erdhi në mesxhid dhe tha: «Kam uri». Ne u treguam të pakujdesshëm dhe nuk i sollëm menjëherë diçka për të ngrënë. E lamë atë në mesxhid dhe shkuam në shtëpitë tona. Kur erdhëm në namazin e sabahut, pamë se ai kishte vdekur. E qefinosëm dhe e varrosëm. Ditën tjetër, në një aspekt shpirtëror, tek mihrabi pashë qefinin me të cilin kishim qefinosur njeriun e varfër dhe mbi të shkruhej: «Merreni qefinin tuaj. Allahu nuk e pranoi!»

Atë ditë u betova: «*Këtej e tutje, nëse shoh ndonjë nevojtar, nuk do t’ia vonoj ndihmën.*»” (Sujuti, Tarihu’l-Hulefa, fq. 103.)

Të gjitha këto, janë vetëm disa prej shembujve të shumtë që përshkruajnë qytetërimin e virtyteve që ka ndërtuar i Dërguari i Allahut ﷺ. Ky qytetërim, nuk ka mbetur vetëm nëpër rreshtat e librave, por është përjetuar me paqe dhe lumturi për shekuj me radhë. Për rrjedhojë, edhe sot, kur njerëzimi është përfshirë përsëri nga sëmundja e injorancës, Islami është i vetmi qytetërim që mund të sjelli shërim.

Sot, ideologjitë dhe sistemet njerëzore u premtojnë njerëzve lumturi të rreme në një mënyrë të maskuar. Por, edhe në mesin e myslimanëve shfaqen disa të pavetëdijshëm që pre-

*Shkalla e katërt
dhe më e
mrekullueshme,
është “isari”,
që do të thotë;
të preferosh t’i
japësh vëllait
tënd, edhe pse je
nevojtar për vete.
Pra, ta këpusësh
prej shpirtit tënd
dhe ta japësh pa
pishman e pa
qeder.*



tendojnë se problemet dhe vuajtjet e botës Islame mund të lehtësohen duke ndjekur këto sisteme.

Mirëpo;

Sistemet njerëzore nuk mund të dhurojnë kurrë lumturi. Ato nuk mund të ndërtojnë një sistem moral që do t'u sjellë paqe njerëzve. Gjatë historisë, të gjitha sistemet njerëzore kanë ardhur e shkuar, por vetëm sistemet që kanë sjellë profetët kanë vazhduar.

Karakteristikat dalluese mes njeriut dhe krijesave të tjera, janë të drejtat, ligji dhe morali. Islami predikon moralin më të bukur. Ndërsa Profeti ynë ﷺ, e përfaqëson atë moral.

Në asnjë sistem njerëzor, nuk gjendet ndonjë parim apo sistem moral që i fal virtyte njerëzimit.

Për shembull;

Në të drejtën e lashtë Greke dhe Romake, disa vjedhje nuk konsideroheshin krime, por ishin të lejueshme. Në disa sisteme të tjera, tradhtia bashkëshortore, homoseksualiteti dhe aborti konsiderohen të ligjshme. Po ashtu, në disa sisteme, edhe abuzimi tregtar nuk përbën krim.

Kjo, sepse parimi i tyre është fjalia; "Le të bëjnë ç'të duan!". Përveç kësaj, ata mendojnë se, "Pavarësisht se si shfrytëzohet, kapitali nuk duhet të pengohet!"

Përsëri; në disa sisteme, të këqijat si alkooli, droga dhe bixhozi nuk konsiderohen krime. Pas maskave të praruara të këtyre sistemeve, qëndron mjerimi to-


Davud-i Tai i thotë nxënësit të vet: "O bir! Nëse unë do ta ha këtë mish që ke sjellë dhe përgatitur enkas për mua, pa kaluar shumë ai do të dalë jashtë. Por, nëse mishin në fjalë do ta hanë jetimët, ai do të ngjitet deri në Arshi Ala, ku do të na paraqitet si sevap në botën tjetër!"



tal. Kurse Islami, ndalon çdo gjë që do të dëmtonte dinjitetin njerëzor. Ai e refuzon njeriun egoist dhe kërkon njeriun altruist. Nuk e do njeriun shterp, por njeriun që ngjall. Ai ndërton njeriun që përhap virtyte. Robi duhet të pajiset me moralin e Allahut të Madhërishëm. E ky moral përfaqësohet nga Profeti ynë i nderuar ﷺ. Si rezultat i edukimit dhe pastrimit, robi i afrohet moralit të Profetit ﷺ. Po ashtu, edhe sahabët dhe të devotshmit janë përfaqësues dinjitozë të këtij morali.

Allahu i Madhëruar na dhëntë mundësinë për të qenë së bashku në botën tjetër, e veçanërisht me të Dërguarin e Allahut ﷺ, sahabët dhe miqtë e Allahut, të cilët janë shembujt më të bukur të këtij morali të bukur të fesë tonë, bukurive, delikatesës dhe mirësive të Islami!

Amin!..



*Ebu'l Hasan
Harakani, thotë:
"Nëse një shkëndijë
zjarri bie mbi rrobën
tënde, përpigesh ta
shuash menjëherë!
Po zjarrin që do
të të djegë fenë,
pra qëndrimin në
zembrën tënde të
cilësive të këqija, si
mendjemadhësinë,
smirën dhe
dyfytirësinë, si arrin
t'i durosh?!"*



CIVILIZIMI QË THEMELOI AI

Qytetërimi Islam, është një kulm i arritur njëherë në historinë e njerëzimit. Arsyeja e kësaj, është se natyra njerëzore, është e pajisur me dije hyjnore, mençuri dhe urtësi. Me fjalë të tjera, njerëzit e shquar të asaj shoqërie, eliminuan problemet e tyre shpirtërore dhe i shkrinë zemrat e tyre me dijen dhe urtësinë e vërtetë. Themeli i qytetërimit Islam, janë Kurani, Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ, jeta e tij shpirtërore dhe morali i tij madhështor.



CIVILIZIMI QË THEMLOI AI

THEMELI MË I FUQISHËM

Allahu i Plotfuqishëm e mësoi Profetin tonë ﷺ me moralin më të lartë për dyzet vjet. Për rrjedhojë, Profeti ynë ﷺ, jetoi dhe shfaqti një moral të mrekullueshëm nën edukimin dhe kujdesin hyjnor. Në vitin e tij të dyzetë të jetës së tij, u ndërtua akaidi/sistemi i besimit me urdhrin hyjnor,

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka).” (Alak, 1) Këtu filloi ndërtimi i besimit dhe teuhidit. Në themel qëndronte morali madhështor dhe mbi të një besim i pa kompromis, i fortë dhe i qëndrueshëm.

Përjetimi në mënyrë të palëkundur i besimit të vërtetë, ishte pjesa më e vështirë e fesë. Pra, përjetimi dhe mbrojtja pa kompromis e teuhidit ishte çështja më e rëndësishme dhe më e vështirë në fe. I Dërguari i Allahut ﷺ, i edukoi sahabët e tij

në Mekë për 13 vjet në akide dhe teuhid. Gjatë këtyre vite plot vështirësi, besimi i tyre u sprovua nëpërmjet shumë testeve si; tallja, fyerja, tortura, persekutimi, uria dhe bojkoti.

Sidoqoftë, pasi besimi në zemër arriti një nivel që mund të përballonte të gjitha këto prova, ndodhi hixhreti. Kështu, edhe adhurimi dhe rregullat në Medinë u ndërtuan mbi këtë themel të fortë. Besimi në zemrat e muhaxhirëve ishte aq i fortë, sa ata që morën pjesë në ekspeditat ushtarake deri në Betejën e Bedrit, ishin plotësisht prej tyre. E në fakt, ensarët nuk ishin ende në atë nivel. Madje, për këtë arsye, gjatë rrugës për në Bedër, i Dërguari i Allahut ﷺ, mori tri herë besën prej ensarëve, duke e përforcuar kështu fuqinë e tyre shpirtërore.

Ndërkohë që po jepej besa dhe po bëheshin konsultime, Mikdad bin Esved رضي الله عنه, që ishte prej muhaxhirëve, u ngrit në këmbë për të inkurajuar shokët e tij në xhihad dhe mbajti këtë fjalim të fuqishëm:

*Qytetërimi ynë,
është themeluar
mbi modelin e
njeriut modest, të
mëshirshëm, bujar
dhe të arsyeshëm
që ndërtoi Profeti
ynë ﷺ.*



BINDJE E PLOTË

“O i Dërguari i Allahut! Bëj atë që të është urdhëruar! Ne jemi me ty. Beto hem në Allahun se ne nuk do të themi ty, atë që i thanë Musait رضي الله عنه, bijtë e Izraelit! Ata i patën thënë Musait: “Shkoni ti dhe Zoti yt dhe luftoni! Ne do të rrimë këtu.” (Maide, 24.)

“Betohem në Allahun i cili të ka dërguar Ty si Profet të vërtetë se; nëse urdhëron të ecim deri në Birku’l-Gimad (Birku’l-Gimad: është emër i një vendi afër Detit të

Kuq dhe pesë ditë larg Mekke Mukerreme. Transmetohet se është edhe emri i një qyteti në Jemen.), nëse do të jemi me ty, durojmë edhe ndaj vështirësive më të mëdha! Çdo çast jemi gati të përleshemi me armikun në të djathtë, në të majtë, para dhe pas teje, deri në fund!...” (Buhari, Megazi 4, Tefsir 5/4; Vakidi, I, 48.)

Pas Mikdadit ﷺ, u ngrit në këmbë Sa'd bin Muadhi ﷺ dhe tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ne të kemi besuar dhe të kemi dëshmuar ty. Dëshmuam se Kurani dhe suneti që ke sjellë, janë të vërtetë. Po ashtu, të kemi dhënë edhe fjalë të prerë, se do ta dëgjojmë fjalën tënde dhe do të të bindemi ty në këtë rrugë!

O i Dërguari i Allahut! Bëj si të duash. Beto hem në Allahun i cili të ka dërguar si Profet të vërtetë se, nëse na tregon një det dhe futesh në të, edhe ne do të hyjmë bashkë me ty, dhe askush nga ne nuk mbetet pas. Ne nuk ndjejmë keqardhje edhe nëse nesër na nxjerr ballë për ballë me armikun. Durimi dhe qëndrueshmëria në luftë, ruajta e besnikërisë edhe kur të përballimi me armikun, është nga virtytet tona. Shpresojmë se Allahu do të tregojë për ne gjëra që do të gëzojnë sytë! Eja o i Dërguari i Allahut na çoj drejt begatisë së Allahut!”

Pas këtyre fjalëve të mbushura me besnikëri dhe bindje, fytyra e bekuar e të Dërguarit të Allahut ﷺ, shkëlqeu me buzëqeshje, u lut për mirësi dhe i përgëzoi me fitore. (Muslim, Xhihad, 83; Vakidi, I, 48-49; Ibn Hisham, II, 253-254.)

Qytetërimi Islam, largoi shtypjen dhe errësirën e injorancës, shkatërroi idhujt dhe ndriçoi zemrat me dritën e besimit dhe krijoi një ekspozitë të virtyteve si individë dhe bashkësi.



Allahu i Madhëruar, rëndësinë e forcimit të besimit, e tregoi në Kuran me shembullin e magjistarëve që besuan Musain عليه السلام. Ata u kërcënuan me vdekje brutale nga Faraoni, për shkak të besimit të tyre. Por, ata ecën drejt vdekjes heroike pa bërë lëshimin më të vogël. Edhe Habibi Nexhar, i cili u vra sepse i tregoi të vërtetën dhe të drejtën popullit të tij, duke shkuar me dëshirë drejt martirizimit, u bë shembull i Kuranit në lidhje me mbrojtjen e teuhidit. Po ashtu, edhe njerëzit e Uhdudit, të cilët u hodhën në zjarr për shkak të besimit të tyre, u bënë shembull për sahabët dhe ne.

Ja pra, kështu edhe muhaxhirët e jetuan për 13 vjet këtë luftë. Me këtë besim, ata duruan shumë vuajtje. Fuqia më e madhe shpirtërore tek e cila mbështeteshin ishte morali madhështor i të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe besimi i madh në kauzën e tij, që i ndriçoi ata ditë e natë.

KANDILI QË SHPËRNDAN DRITË

Në Kuranin Fisnik, lidhur me diellin urdhërohet:

وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَاجًا

“Dhe kemi vënë kandil (diell) të shndritshëm!” (Nebe’, 13) Ndërsa në lidhje me hënën urdhërohet:

تَبَارَكَ الَّذِي جَعَلَ فِي السَّمَاءِ بُرُوجًا وَجَعَلَ فِيهَا
سِرَاجًا وَقَمَرًا مُنِيرًا

“Qoftë i lartësuar Ai, i Cili e ka stolisur qiellin me yjësi dhe ka vënë në të një Kandil të ndritshëm dhe një Hënë që ndriçon.” (Furkan, 61)

*Çdo qytetërim
formon modelin
e vet njerëzor.
Në Islam, tiparet
dalluese të këtij
modeli njerëzor,
janë bujaria dhe
sakrifica.*



Po ashtu, duke bashkuar cilësitë e diellit dhe të hënës, në lidhje me Profetin tonë ﷺ, është urdhëruar:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ
شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا
وَدَاعِيًا إِلَى اللَّهِ بِإِذْنِهِ
وَسِرَاجًا مُنِيرًا

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” (Ahzab, 45-46.)

Pra, ashtu siç ndriçon hëna natën dhe dielli ditën, edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, përshkruhet si një kandil i veçantë që ndriçon natën dhe ditën e sahabëve të tij dhe umetit të tij; një diell i mrekullueshëm udhëzimi dhe një hënë e mrekullueshme që rrezaton dritë. Për rrjedhojë, Allahu në Kuran urdhëron:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“Dhe Ne, nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107.)

Nga kjo kuptohet se Profeti ynë ﷺ, është dërguar si mëshirë për të gjitha botët e krijesave deri në ditën e kiametit.

Sahabët fisnikë, e kanë ndriçuar natën dhe ditën e tyre me dritën e Profetit të Allahut ﷺ. Dhe, të motivuar nga fjala e tij;

Sa'd bin Muadh: “... O Resulullah! Beto hem në Allahun i cili të ka dërguar si Profet të vërtetë se, nëse na tregon një det dhe futesh në të, edhe ne do të hyjmë bashkë me ty dhe askush nga ne nuk mbetet pas...”



الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

“Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96.), ata janë munduar t’i ngjajnë Profetit ﷺ, në çdo vepër dhe gjendje.

Ata jetuan dhe e mbajtën gjallë sunetin e tij në çdo situatë; natën, ditën, në çdo hap dhe çdo frymë që merrnin. Momentet më të ëmbla dhe më të këndshme të jetës së tyre ishin kur qëndronin dhe jetonin bashkë me të.

Profeti ynë i nderuar ﷺ, lutej në çdo rast. Sahabët gjithashtu bënë përpjekje të mëdha për të mësuar, dëgjuar dhe praktikuar këto lutje. Duaja tij e zakonshme ishte:

اللَّهُمَّ لَا عَيْشَ إِلَّا عَيْشُ الْآخِرَةِ

“O Allah! Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!” (Buhari, Rikak, 1.)

Ai gjithmonë ia kujtonte vetes dhe shokëve të tij këtë të vërtetë, sepse shqetësimi i tij i vetëm ishte të mos harronte ahiretin, qoftë edhe për një çast.

E GJITHË JETA E TIJ ISHTE LUTJE

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, zgjohej nga gjumi, ai menjëherë e kujtonte dhe e falënderonte Allahun:

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا وَإِلَيْهِ النُّشُورُ

“Falënderimi i takon Allahut, i Cili na ringjall pasi të vdesim! Kthimi është vetëm tek Ai!” (Buhari, Deauat, 8.)

Ashtu si hëna ndriçon natën dhe dielli ndriçon ditën, edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, përkruhet si një kandil i veçantë që ndriçon natën dhe ditën e sahabëve të tij dhe umetit të tij; një diell i mrekullueshëm udhëzimi dhe një hënë e mrekullueshme që rrezaton dritë.



Sipas transmetimit të Ummu Selemes رضي الله عنها, sa herë që i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, dilte nga shtëpia, e ngrinte gjithnjë fytyrën nga qielli dhe lutej me këto fjalë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَضِلَّ أَوْ أُضَلَّ أَوْ أَزِلَّ أَوْ أُزَلَ
أَوْ أَظْلِمَ أَوْ أُظْلَمَ أَوْ أَجْهَلَ أَوْ يُجْهَلَ عَلَيَّ

“O Allah! Mbështetem tek Ty që të mos devijoj nga rruga e drejtë dhe të mos më devijojnë; që të mos rrëshqas dhe të mos më bëjnë të rrëshqas; që të mos bëj padrejtësi dhe të mos më bëhet padrejtësi; që të mos sillem me injorancë dhe të mos sillen ndaj meje me injorancë.” (Ebu Davud, Edeb, 102-103/5094; Tirmidhi, Deauat, 35.)

Po ashtu, ai ka këshilluar të bëhet kjo dua kur dilet nga shtëpia:

بِسْمِ اللَّهِ ؛ حَسْبِيَ اللَّهُ ؛ تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ ؛
لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

“Me emrin e Allahut! Allahu më mjafton! Mbështetem tek Allahu! Përveç Tij forcë dhe fuqi tjetër s’ka.” (Ebu Davud, Edeb, 102-103; Taberani, Mu’xhemu’l-Kebir, XXII, 396.)

Siç tregon nëna jonë Aisha رضي الله عنها, i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, e përmendte Allahun e Madhëruar përherë me dua:

- Kur merrte abdes,
- Kur hynte në xhami,
- Kur këndohej ezani,
- Kur fillonte namazin,
- Kur përfundonte namazin,
- Kur përfundonte namazin,
- Kur dilte nga xhamia,
- Kur fillonte ushqimin,
- Kur përfundonte ushqimin,

Profeti ynë صلى الله عليه وسلم,
shikonte qiellin e
gjerë, lavdëronte dhe
falënderonte Allahun.
Po ashtu shikonte
tokën, lavdëronte dhe
falënderonte përsëri. Ai
jetonte gjithmonë me
Allahun dhe vazhdimisht
meditonte mbi
madhësitinë hyjnore.



- Kur pinte diçka,
- Kur vishte një rrobë,
- Kur ulej,
- Kur ngrihej,
- Kur hipte në kafshë,
- Kur hynte në treg,
- Kur dilte për udhëtim,
- Kur kthehej nga udhëtimi,
- Kur hynte në shtëpi,
- Kur dilte nga shtëpia,
- Kur shtrihej për të fjetur,
- Kur zgjohej nga gjumi,
- Kur hidhërohej,
- Kur gëzohej,
- Kur përballej me një punë të vështirë,
- Kur kishte sukses në një punë,
- Kur sëmurej,
- Kur shërohej,
- Kur teshtinte,
- Kur përballej me armikun,
- Kur merrte një lajm vdekjeje,
- Kur shkonte në varreza...

Me pak fjalë, Profeti ynë ﷺ, shikonte qiellin e gjerë, lavdëronte dhe falënderonte Allahun. Po ashtu shikonte tokën, lavdëronte dhe falënderonte përsëri. Ai jetonte gjithmonë me Allahun dhe vazhdimisht meditoonte mbi madhësinë hyjnore. I Dërguari i Allahut ﷺ, ishte gjithmonë i zënë me dhikr dhe lutje në çdo veprim. Në çdo moment jetonte sikur e shihte Allahun dhe fliste me Të. Kështu, ai arrinte të përjetonte shpirtërisht ajetin fisnik:

“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...” (Hadid, 4.)

Duaja e rrit vlerën e robit tek Allahu i Madhëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Thuaj: «Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...» (Furkan, 77.)



Kur Allahu i Madhëruar përshkruan Hënë në Kuran, thotë: “hënë që ndriçon”, kur përshkruan Diellin, thotë: “pishtar që flakëron”, ndërsa kur përshkruan Resulullahun ﷺ, thotë: “pishtar ndriçues”.



Për këtë arsye, Profeti ynë ﷺ, e ka porositur gjithmonë umetin e tij që të jetonte në një gjendje lutjeje. Sahabët gjithashtu, përpiqeshin të pasonin të Dërguarin e Allahut ﷺ, -gjithsecili sipas pjekurisë së zemrës- dhe të vlerësonin çdo moment të jetës së tyre me lutje dhe adhurim.

Një shembull:

PROVA E BESIMIT!

Një sahab i quajtur Harith bin Malik ndjente kënaqësi shpirtërore sa herë bëhej pjesë e bisedave pranë të Dërguarit të Allahut. Një ditë, Profeti ﷺ, i tha:

- “O Harith, si u gdhive?”

- Si një besimtar i vërtetë! - U përgjigj ai.

Këtë herë, Profeti ﷺ, tha:

- “O Harith! Çdo e vërtetë kërkon dëshmi. Cili është argumenti i besimit tënd të sinqertë?”

Harithi ﷺ, u përgjigj:

- O i Dërguar i Allahut! Kur hoqa dorë nga kënaqësitë e kësaj bote, i kalova ditët e etur dhe netët pa gjumë. Kjo gjendje, me afroi më shumë pranë madhësisë së Zotit. Aq sa më duket sikur i shoh banorët e xhenetit teksa vizitojnë njëri-tjetrin dhe banorët e xhehenemit të armiqësuar mes tyre.

Pas kësaj i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:



*Nëse zemra ka
arritur kënaqësinë,
justifikimet
avullojnë. Plagët
shërohen, dhimbja
qetësohet, rrugët
shkurtohen dhe i
nxehti freskohet.*

- “Në rregull o Harith! Ruaje këtë gjendje. Ti je prej atyre që Allahu ua ka ndriçuar zemrën.” (Hajthemi, Mexhmau’z-Zevaid, I, 57.)

Pra;

Nëse këto dhe gjendje të ngjashme nuk ruhen, ato do të zhduken. Grada e arritur në përparimin shpirtëror, nuk është një e drejtë e fituar si pozita dhe gradat e arritura në botë. Nëse humbet konsistenca, fillon humbja. Ajo që ka vlerë, është maturia dhe orientimi.

Po ashtu, prej kësaj ndodhie mësojmë se;

Kur ndriçohet zemra, ndryshon ndjeshmëria...

Natën, lehtësohet adhurimi, sepse shija e “përmendjes së Allahut” e tejkalon gjumin. Gjatë ditës, lehtësohet agjërimi dhe pakësimi i ushqimit, sepse në ndjenjat e një zemre që mediton çdo çast rreth Allahut të Madhëruar, dëshira për të ngrënë dhe pirë mbetet në hije. Kur në zemër arrihet kënaqësia, dhimbja e plagëve nuk ndihet dhe vështirësitë bëhen më të lehta:



Mëshira është identiteti i myslimanit; kartëvizita e tij. Dhe, njeriu që e ka zemrën të mbushur me mëshirë, është edhe shërbyes i zellshëm në rrugën e Allahut.

NUK DUAM TA HUMBASIM!..

Abdullah bin Sehl رضي الله عنه, bashkë me vëllain e tij Rafi رضي الله عنه, luftuan kundër jobesimtarëve në Luftën e Uhudit përkrah Profetit صلى الله عليه وسلم dhe u kthyen të plagosur në Medine. Mirëpo, kur dëgjuan se Profeti صلى الله عليه وسلم, u kishte bërë thirrje myslimanëve të ndiqnin armikun, ata thanë:

“Për Allahun, ne s’kemi kafshë udhëtimi dhe plagët tona janë të rënda. Mirëpo, nuk dëshirojmë të humbasim një luftë në të cilën gjendet i Dërguari i Zotit!”

Me këtë mendim, dy vëllezërit morën edhe një herë rrugën. Ai i cili ishte plagosur më lehtë, ndonjëherë e ndihmonte në ecje vëllain e tij të plagosur më rëndë, e ndonjëherë e mbante në shpinë. Kështu, ata nuk u ndanë nga Profeti ﷺ, as në këtë gjendje të vështirë. (Ibn Hisham, III, 53.)

Nëse zemra ka arritur kënaqësinë, justifikimet avullojnë; plagët shërohen, dhimbja qetësohet, rrugët shkurtohen dhe i nxehti freskohet, sepse në zemrat e tyre, asnjë dhimbje fizike nuk ishte aq e rëndë sa dhimbja e ndarjes nga ai. Nëse ishin bashkë me të dhe nëse ai u buzëqeshte, vuajtjet shndërroheshin në trëndafila dhe vështirësitë në mëshirë.

Në Bedr u kapën shumë robër, të cilët gjatë kohës që qëndruan pran myslimanëve, dëshmuuan bukurinë e moralit të Islamit, që iu shfaq atyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Profeti ynë ﷺ, e theksoi aq shumë trajtimin e mirë të robërve, sa që sahabët që morën pjesë në Bedr, të cilët tashmë kishin shumë pak kafshë për të hipur, i vendosnin robërit herë pas here në kafshët e tyre dhe vetë ecnin në këmbë nën nxehtësinë e shkretëtirës. Si rezultat i këtij trajtimi të virtytshëm, gjatë viteve në vijim, shumë prej atyre robërve hynë në Islam në mënyrë paqësore.

Shumë mendimtarë që kanë studiuar historinë e njerëzimit, civilizimet, luftërat e kombeve me njëri-tjetrin, shtypjen dhe

Ashtu si dielli që vazhdon të ndriçojë dhe të ngrohë pareshtur që prej krijimit të tij, ashtu edhe shërbimi në rrugën e Allahut, është një nga cilësitë dalluese të besimtarët të devotshëm.



shkatërrimin, kanë shkruar mendime negative (pesimiste) në lidhje me natyrën e keqe, egoiste dhe mizore të njeriut. Prandaj, sipas tyre, gjithçka që ai bën, do të shkaktojë të keqen. Mirëpo, në qytetërimin Islam, vëmë re shpesh herë kulminacione të ndjenjave të larta njerëzore.

Besimtarët që vepruan kështu me robërit e tyre, në mënyrë që të respektonin urdhrin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, bënë sakrifica edhe më të mëdha për vëllezërit e tyre në fe. Aq, sa kur ishte e nevojshme, ata hoqën dorë nga ëndrrat e tyre për një vëlla në nevojë. Një shembull unik i këtij fakti, është edhe kjo ndodhi:

O ALLAH MA PRANO QËLLIMIN!

Një prej dijetarëve të brezit të tabiinëve, Abdullah bin Mubarekun, e kishte zënë gjumi në Qabe, pasi kishte kryer detyrimet e tij të haxhit. Në gjumë, sheh një ëndërr sikur dy melekë zbritën nga qielli dhe po bisedonin me njëri-tjetrin:

- Këtë vit kanë kryer haxhin 600 mijë njerëz, dhe të gjithëve u është pranuar vetëm për hatër të veprës së një këpucëtari nga Shami, të quajtur Ali bin Muvaffak.

Abdullah bin Mubarek u zgjua i habitur dhe vendosi të shkonte menjëherë tek Ali bin Muvaffaku për t'u njohur me të. Pa humbur kohë, shkoi në Sham. Kur e gjeti atë, e pyeti:

M. Akif:

*S'depërton armiku
në një popull, pa
hyrë përçarja mes
tyre,
Kur zemrat godasin
së bashku, as topi s'u
bën dëm atyre.*



- Si e bëre haxhin ti, sepse Allahu (xh. sh.), ua pranoi haxhin të gjithë njerëzve të tjerë vetëm për hatrin tënd?

Ali bin Muvaffak iu përgjigj:

- Këtu ka një gabim. Unë bëra nje-tin për të shkuar në haxh, por nuk pata mundësi të shkoja.

Kur dëgjoji këtë përgjigje, Abdullah bin Mubarek u habit edhe më shumë. Prandaj, kërkoi ta mësonte të vërtetën e kësaj historie. Ali bin Muvaffak filloi t'i shpjegonte:

- Prej tridhjetë vitesh ëndërroj të shkoj në haxh. Gjatë kësaj periudhe, në saje të zanatit tim, kam mbledhur 300 dirhem dhe bëra nijet për t'u nisur në haxh. Pak ditë para nisjes për haxh, në shtëpi-në tonë erdhi një erë mishi. Gruaja ime që ishte shtatzënë në atë periudhë më tha:

- Nga komshinjtë po vjen erë mishi, a mund t'u kërkosh atyre një copë mishi?

Unë shkova tek komshiu im. Kur i tregova atij si ishte puna ai filloi të qante:

- Ky mish që jam duke gatuar është prej një kafshe të ngordhur që kam gjetur në rrugë. Ngrënia e një pjese të këtij mishi (sa për të mos vdekur) nga fëmijët e mi që kanë shtatë ditë pa ngrënë është hallall, kurse për ju është haram. Nëse nuk gjej dot ushqim hallall, do të detyrohem t'u jap këtë mish.

*Gjatë periudhës
Osmane, vendet
Islame jetuan
për shekuj me
radhë në unitet e
bashkim brenda
paqes së vëllazërisë
Islame, të sigurt
nga pushtimet dhe
sulmet e armikut.*



Ali bin Muvaffak vazhdoi:

- Fjalët e komshiut ma këputën shpirtin. Kështu që, me lot në sy, ia dhashë atij 300 dirhemët që i kisha mbledhur me aq vështirësi dhe i thashë: Ma bëj hallall sepse ti paske qenë i uritur dhe unë nuk kam ditur asgjë. Pas kësaj, iu luta Allahu duke thënë: “O Allah! Ma prano qëllimin e haxhit!”

Kur dëgjoi këtë histori, Abdullah ibn Mubarek tha:

“Allahu ma ka treguar këtë të vërtetë në ëndërr.”

Ndërsa Xhelaledin Rumi, e shpreh kështu butësinë e zemrës, mirësjelljen dhe afrimin me Allahun e Madhëruar:

“Kush shkon në haxh, le të përpiqet të takohet me Zotin e Qabes. Nëse ia arrin kësaj, për të, çdo vend është i mbushur me mirësitë e Qabes.”

“Kërko dhe gjej një zemër të atillë, që hyrja jote në atë zemër dhe fitimi i saj, të jetë një haxh i pranueshëm!”

Emir Kulal: “Shih të fitosh një zemër, shërbeju të pafuqishmëve! Mbroji të dobëtit, zemërthyerit. Ata janë njerëz të tillë që nuk kanë asnjë të ardhur nga njerëzit. Megjithatë, shumë prej tyre ikin me zemër plotësisht të qetë, të thjeshtë dhe të shtypur! Kërkoji dhe gjeji njerëz të tillë dhe shërbeju!”



Ja pra, kjo ishte gjendja shpirtërore dhe urtësia që kishte arritur edhe Ali bin Muvaffaku.

E në fakt;

Një nga cilësitë më të spikatura të robërve të devotshëm të Allahut, është se janë të mbushur me mëshirë.

MËSHIRË DHE SHËRBIM

Mëshira është identiteti i myslimanit; kartëvizita e tij. Dhe, njeriu që e ka zem-

rën të mbushur me mëshirë, është edhe shërbyes i zellshëm në rrugën e Allahut. Ashtu si dielli që vazhdon të ndriçojë dhe të ngrohë pareshtur që prej krijimit të tij, ashtu edhe shërbimi në rrugën e Allahut, është një nga cilësitë dalluese të besimtarit të devotshëm.

Shah Nakshibendi, i cili ishte një njeri shumë i devotshëm, e tregon kështu udhëtimin e vet shpirtëror në rrugën e shërbimit:

Mësuesi im Emir Kulal, më ka thënë:

“Shih të fitosh një zemër, shërbeju të pafuqishmëve! Mbroji të dobëtit, zemërthyerit. Ata janë njerëz të tillë, që nuk kanë asnjë të ardhur nga njerëzit. Megjithëkëtë, shumë prej tyre ikin me zemër plotësisht të qetë, të thjeshtë dhe të përulur! Kërkoji, gjeji këta njerëz dhe shërbeju!”

Unë e mbajta fjalën e këtij njeriu të lartë. U mundova shumë në atë rrugë që më tregoi. Më pas, ky mik i Allahut më urdhëroi që të kujdesem për kafshët. Më rekomandoi që t’ua lidhja plagët dhe t’i pastroja i vetëm. Madje, të gjitha këto, duhet t’i bëja me nijet të mirë dhe sinqeritet.

Edhe këtë shërbim e bëra. E kreuva ashtu si më rekomandoi. Në këtë kohë, personaliteti im arriti në një gjendje të atillë, sa që kur shikoja një qen që ecte në rrugë, ndaloja në vend dhe prisja që ai të kalonte. Nuk hidhja asnjë hap para tij.

Pastaj, ai më urdhëroi që të kujdesesha për qentë, me dashuri dhe respekt. Kjo, me qëllim që përmes këtyre shërbimeve, të fitoja mirësinë e Allahut. Ai tha:

Mevlana: “Kërko dhe gjej një zemër të atillë, që hyrja jote në atë zemër dhe fitimi i saj, të jetë një haxh i pranueshëm!”



“Merru me shërbimin ndaj qeneve me dashamirësi dhe kërkko mes tyre ndonjë që do të të hapë horizontin e lumturisë!”

Këtë urdhër të tij e konsiderova si pasuri. U mundova shumë. E zbulova kuptimin e kësaj urtësie, e prita përgëzimin që më dha dhe shkova pranë njërit prej qenve. Në mua lindi një ndjenjë e madhe. Ndalova përpara tij dhe fillova të qaj. Kur unë po qaja, ai u shtri përdhe dhe i ngriti këmbët nga qielli. Pastaj nxori disa zëra, qau dhe filloi të rënkojë. Edhe unë hapa duart dhe me modesti e me zemër të lënduar thashë: “Amin!” Ai pushoi dhe i uli këmbët.

Njëherë tjetër, mësuesi im më tha:

“Merru me mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave! Nëse sheh në rrugë diçka që shqetëson njerëzit, largoje atë me qëllim që të mos dëmtohen kalimtarët!”

Prandaj, unë fillova të angazhohej me këto shërbime. Gjatë këtyre shtatë viteve që përmenda, isha gjithnjë i mbuluar me dhe e pluhur. Kështu e kam kryer me besnikëri çdo punë që më urdhëroi ai rob i devotshëm i Allahut dhe ndjeva në vetvete të gjitha rezultatet e secilës prej atyre punëve.

Nga ana tjetër, një prej cilësive dalluese të robërve të devotshëm, është “modestia” që buron prej mëshirës...

SHËRBIM DHE MODESTI

I nderuari Hudaji, shqetësohej shumë se; pozita e lartë e gjykatësit, mund ta

“Biri im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

(Lukman, 17.)



dëmtonte shpirtin e tij duke e shtyrë në mendjemadhësi dhe krenari. Prandaj, për të thyer egon e tij, filloi të shiste mëlçi në pazar dhe të pastronte tualete i veshur me mantelin e gjykatësit.

Kurse Junus Emre, u vu në sprovën e egos dhe krenarisë. Ai vendosi kokën në pragun e derës së teqesë ku shkelnin të gjithë, duke kaluar me sukses testin e modestisë. Kështu, pasi tregoi se kishte kuptuar “pafuqinë e tij si rob”, mësuesi i tij shpirtëror Taptuk Emre e ngriti atë nga pragu dhe e pranoi në teqe. Junus Emre, gjithashtu kuptoi rëndësinë e kësaj rruge dhe, prej asaj dite mbarti dru në teqe. Madje, për shkak të edukatës së lartë që kishte fituar, ai gjente dhe sillte gjithmonë vetëm dru të drejta, duke thënë:

“Në këtë derë nuk duhet të hyjë asnjë dru i shtrembër!”

Junusi vuri kokën e vet në pragun e bekuar që përbuzet nga injorantët, sepse ai prag ishte shumë i vyer në sytë e të devotshmëve; sepse për Allahun, modestia ndaj robërve të Tij është një pozitë më sublime.

Natyrisht; në këtë botë s’kemi ardhur për të ekspozuar huret e trupit, por huret e shpirtit.

Poeti i nderuar Nabiu, pragun e Profetit tonë të dashur ﷺ, e ka shprehur me këto fjalë:

“Ky (Ravza-i Mutahara) vend është pragu i bekuar që vizitojnë qeniet e shenjta dhe kanë puthur profetët!.. Prandaj, është kusht që në këtë derë të hysh me respekt.”

*Ne duhet t'i japim vlerë
edukimit kuranor të
fëmijëve tanë po aq
sa edukimit të tyre
me dijet e tjera, sepse
kjo teston sinqeritetin
tonë ndaj Allahut
të Madhëruar dhe
Profetit ﷺ.*



Për shkak të rëndësisë që ka, po e përmendim edhe njëherë fjalën e Mevlanës:

“Shpata pret qafën e kryelartit. Ndërsa hijen nuk është e zonja ta presë asnjë shpatë, sepse ajo është e shtrirë përtokë dhe është bërë njësh me të. Prandaj, edhe ti bëhu si hije, që të mos të presë shpata!”

Allahu i Madhëruar, u përgjigjet me sprova të rënda në këtë botë atyre që tregohen tepër kryelartë e mendjemëdhenj dhe,

në botën tjetër, i hedh në zjarrin e Xhehenemit. Kurse ata që tregohen modestë e të përlulur, janë të ruajtur nga këto sprova. Sa bukur e ka thënë poeti Nabi:

Kryelartësia dhe madhështia i takojnë Zotit

Ç’i duhen këto atij që është në pozitën e robit?!..

Historitë kanë të përbashkët faktin se përherë duhet treguar sakrificë dhe duhet paguar një çmim. E në fakt, shfaqja më e qartë e ndryshimeve në ndjenja, shihej tek ambicia. Në saje të edukimit shpirtëror, eliminoheshin lakmitë e kësaj bote dhe vendin e tyre e zinin ëmbëlsitë e jetës tjetër. Kjo kishte dobi të madhe edhe në çështjet e përgjithshme të myslimanëve, sepse në historinë botërore, shumë luftëra janë zhvilluar si pasojë e lakmisë për pozitë dhe pushtet.

*Junusi vuri kokën
e vet në pragun e
bekuar që përbuzet
nga injorantët,
sepse ai prag ishte
shumë i vyer në sytë
e të devotshmëve,
sepse për Allahun,
modestia ndaj
robërve të Tij është
një pozitë më
sublime.*



VIRTYTI I HEQJES DORË NGA TË DREJTAT

Hasani, nipi i dashur i Profetit ﷺ, pasi qëndroi vetëm gjashtë muaj në detyrën e Kalifit, ia dorëzoi atë Muavijes vetëm e vetëm që të mos përçahej populli. Kështu, ai u përpoq të parandalonte përplasjet politike mes besimtarëve dhe gjakderdhjen.

Në kohën tonë, gjendja e përçarë e myslimanëve si pasojë e provokacioneve dhe intrigave të armiqve, i ka shndërruar vendet Islame në pëllgje gjaku. Siç shprehet edhe poeti i njohur, M. Akif:

*S'depërton armiku në një popull, pa hyrë
përçarja mes tyre,*

Kur zemrat godasin së bashku, as topi s'u bën dëm atyre.

Që nga rënia e Perandorisë Osmane, e cila mbronte botën Islame prej Afrikës Veriore në Kaukaz, prej Ballkanit në Jemen dhe përfaqësonte myslimanët në unitet dhe dinjitet, bota Islame nuk ka qenë kurrë në gjendje të arrijë paqe.

E në fakt, gjatë periudhës Osmane, vendet Islame jetuan për shekuj me radhë në unitet e bashkim brenda paqes së vëllazërisë Islame, të sigurt nga pushtimet dhe sulmet e armikut.

OSMANËT

Perandoria Osmane ishte një qytetërim që filloi me Kurainin dhe vazhdoi me kujdesin e treguar ndaj amaneteve të



Nabiu: "Ky (Ravza-i Mutahara) vend është pragu i bekuar që vizitojnë qeniet e shenjta dhe kanë puthur profetët!.. Prandaj është kusht që nga kjo derë të hysh me respekt."

shenjtja. Perandoria Osmane ishte kulmi më e përsosur i qytetërimit që u shfaq në histori si rezultat i aftësisë së natyrshe dhe prosperitetit shpirtëror të popullit.

Çdo qytetërim prodhon një tip të vet njerëzor. Ky lloj njerëzor është në harmoni me atributet dhe karakterin e qytetërimit të cilit i përket. Qytetërimi Islam është një kulm i arritur një herë në historinë e njerëzimit. Arsyeja për këtë, është se natyra njerëzore, është e pajisur me dije hyjnore, kulturë dhe urtësi. Me fjalë të tjera, njerëzit e shquar të asaj shoqërie, i eliminuan problemet e tyre shpirtërore dhe i bashkuan zemrat me dijen dhe urtësinë e vërtetë. Themeli i qytetërimit Islam, është Kurani dhe Suneti, gjendja shpirtërore dhe morali madhështor i të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Ky qytetërim, me tipin njerëzor që ka ndërtuar, ka përhapur pastërtinë, moralin, ndershmërinë, dhembshurinë, vetëmohimin, modestinë dhe drejtësinë në të gjithë botën.



*"...Edhe nëse
përpiqeni t'i
numëroni dhuntitë
e Allahut, nuk
do të mund t'i
numëroni dot..."*

(Ibrahim, 34.)

Ky qytetërim, largoi shtypjen dhe erërsirën e injorancës, shkatërroi idhujt dhe ndriçoi zemrat me dritën e besimit. Ai krijoi një ekspozitë të virtyteve si individë dhe bashkësi. Për shkak të rëndësisë së tyre, le t'i përmendim edhe njëherë këto dy sakrifica të mëdha në historinë tonë:

- Sulltan Javuz Selimi filloi një fushatë ushtarake drejt lindjes me qëllim që të siguronte unitetin Islam dhe të merrte flamurin e Kalifatit Islam në mënyrë të pakontestueshme. Gjatë kësaj fushate, u

detyrua të eliminonte ata që nuk e kuptonin idealin e bashkimit dhe përhapnin përçarje. Ndërkohë, Idris Bitlisi, me origjinë kurde, së bashku me fiset që kryesonte, iu bashkuan pa kundërshtim Perandorisë Osmane, duke deklaruar bindjen ndaj kalifatit. Në këtë mënyrë, duke hequr dorë nga administrimi i pavarur, iu bashkuan Osmanëve në luftën kundër Safevive, të cilët ndiznin fitnet e përçarjeve medhhebore, dhe u bënë forcë e idealit të unitetit Islam.

Për këtë arsye, Sulltan Javuz Selimi, tregoi respekt të madh për këtë personalitet të veçantë. Këtë e tregon edhe fakti se, sulltani i dha atij fermanë me vulën e vet por të paplotësuar, me qëllim që ai t'i përdorte për t'i dhënë titullin "bej" atyre që dëshironte. Mirëpo, duke treguar një shembull tjetër të virtytit të veçantë lidhur me unitetin dhe bashkimin, ai asnjëherë nuk i plotësojë këto fermanë pa lejen e Sulltanit.

- Në të njëjtën mënyrë, edhe Barbaros Hajreddin Pasha, i cili zotëronte Afrikën e Veriut, e bashkoi atë me Shtetin Osman me idenë "Unitetit islam".

Në këmbim të kësaj, Sulltan Sulejman Kanuni i dha atij postin e komandantit të Forcave Detare Osmane. Pas kësaj, brenda një kohe të shkurtër Mesdheu u bë një liqen i vogël Osman. Krahas kësaj, u dërgua flotë detare edhe në Oqeanin Indian për të ndihmuar myslimanët e atij vendi.

Fakti që, Barbaros Hajreddin Pasha sakrifikoi mundësinë për të mbretëruar në tërë Algjerinë, duke ia bashkuar atë



*I Dërguari i Allahut ﷺ,
ishite gjithmonë i zënë me
dhikr dhe lutje në çdo
veprim. në Çdo moment
jetonte sikur e shihte
Allahun dhe të fliste me
Të. Kështu, ai arrinte të
përjetonte shpirtërisht
ajetin fisnik: "...Ai është me
ju kudo që të gjendeni..."*

(Hadid, 4.)

Shtetit Osman për të siguruar unitetin Islam, është një tablo virtytesh më vete.

Ky është virtyti i heqjes dorë nga e drejta, që është rezultat i pjekurisë së zemrës. Nëse zemra nuk do të kthehej tek Allahu, dëshira e egos për të kryesuar, patjetër do të mbizotëronte, ndjenja e vetëpëlqimit do të ishte më dominante, dhe si rezultat, do të shfaqej gjendja e shkatërruar dhe e përçarë që mbizotëron sot botën Islame.

Ashtu si ata që hoqën dorë, edhe sulltanët të cilëve iu dhuruan toka, vendosën zemrat e tyre në rrugën e Allahut. Për ta, lidhshipi nuk ishte një pozicion për tu shijuar, por një këmishë zjarri, vuajtjet dhe përgjegjësia e të cilit u ndjenë thellë. Ata nuk ishin kryelartë për fitoret e tyre, por ranë menjëherë në sexhde mirënjohjeje ndaj Allahut. Ata nuk rendën pas një jete qejfi për të kënaqur trupin e tyre, por pas vështirësive, për të kënaqur zemrat të tyre.

Duaja e rrit vlerën e robit tek Allahu i Madhëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet: "Thuaj: «Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...» (Furkan, 77.)



Në nivelin e ndjeshmërisë së zemrës së tyre, ata arritën të përballonin të gjitha llojet e sakrificave për vendosjen e drejtësisë dhe përhapjen e mëshirës. Ja një tablo unike e drejtësisë në histori:

SULLTANI PËRBALLË DREJTËSISË

Pas marrjes së Stambollit, sulltan Mehmeti II pati urdhëruar t'i pritej dora një arkitekti të krishterë, i cili e kishte kryer detyrën në kundërshtim me urdhrin e tij. Arkitekti u ankua në gjykatë dhe në

përfundim të seancës, gjykatësi e shpalli sulltanin fajtor, ndërsa arkitektin e krishterë, të pafajshëm. Më pas, gjykatësi këndoi ajetin kuranor mbi ndëshkimin e njëvlershëm (kisas). Duke u mbështetur mbi konkluzionin e ajetit në fjalë, gjykatësi vendosi që sulltani të dënohej po me atë mënyrë që kishte kryer faj; pra, t'i pritej dora!

Duke u prekur jashtëzakonisht nga kjo drejtësi e lartë, arkitekti i krishterë tha me sytë tërë lot:

“Heq dorë nga e drejta ime, kërkoj vetëm dëmshpërblim!”

Mirëpo, përveç dëmshpërblimit, sulltan Mehmeti II i dhuroi arkitektit të krishterë një shtëpi nga pasuria e vet personale. Për këtë arsye, arkitekti i krishterë tha:

“Nuk ka në botë drejtësi të tillë! Nga ky çast e tutje, unë jam mysliman!” - Dhe u bë mysliman duke thënë Fjalën e Dëshmisë Islame!

Pas kësaj, sulltani i tha kështu gjykatësit:

“Të përgëzoj që u frikësove nga Allahu, e jo nga unë!”

Kjo pra është gjendja e një sulltani, sundues i dy kontinenteve, përballë gjykimit të drejtësisë. Ky është rezultati i përparimit shpirtëror dhe ndryshimit të ndjenjave.

“Qafa jonë është më e hollë se qimja para vendimit të Zotit!”

Sulltanesha Bezmi Alem, ndër shumë vakëfe, ka themeluar një vakëf të veçantë në Damask, kushtet e të cilit, janë shumë të mahnitshme. Një prej kushteve është: “Të dëmshpërblehen gotat që thyhen apo sendet që dëmtohen (pa dashje) nga shërbyesit që punonin pranë pronarëve të ashpër e të paedukatë, me qëllim që pronarët të mos i qortonin duke ua thyer zemrat.”



“Gishti që pret ligji i Zotit nuk dhemb!”

Kjo, sepse ata kishin marrë edukimin më të bukur në familjen Osmane, që ishte një shkollë e jashtëzakonshme.

Ja një shembull tjetër:

MODESTIA E SULLTAN AHMEDIT

Koha e sulltan Ahmedit të I. është periudha më kulmore e zgjerimit të tokave të Shtetit Osman. Edhe ai, si të parët e vet, ndërtoi një xhami me kompleks në shenjë falënderimi ndaj Allahut. Me pasurinë e tij personale, ai ndërtoi Xhaminë Sulltan Ahmed, e cila ende sot mbushet nga turistët dhe përfaqëson fuqinë dhe hirin e Islamit. Sidoqoftë, me dashurinë për të arritur pëlqimin hyjnor në zemrën e tij, ai nuk u mjaftua me kaq, por punoi si punëtor në ndërtimin e xhamisë pa u vënë re nga të tjerët.

*“Kush nuk
shqetësohet për hallet
e besimtarëve, nuk
është prej tyre.”*

(Hakim, Mustedrek, IV, 352.)



Tregohet se;

Pas vdekjes së Ahmedit të I. në moshë të re, e bija, Zonja Gevher, e pati parë të atin në ëndërr në Xhenet, në një mjedis jashtëzakonisht të shkëlqyer. Ajo e pati pyetur me kureshtje:

- Baba, me çpunë arrite në këtë vend të bukur?

I ati i qe përgjigjur:

- Mojt bijë, kur po e ndërtoja këtë xhami, pata mbajtur gurë! Prandaj ndodhem në këtë pozitë!

Kjo, sepse ata ishin nxënësit shpirtëror të Profetit tonë ﷺ, i cili barti gurë në ndërtimin e xhamisë në Kuba dhe në Medinë.

Një tjetër ndodhi në lidhje me këtë çështje, është edhe kjo:

ZEMRA E NËNËS

Kur vdiq Nëna Sulltaneshë Pertevnija, e cila pati ndërtuar Xhaminë Valide në Aksaraj të Stambollit, një person i mirë e pa në ëndërr në një pozitë të mirë dhe e pyeti:

- A të ngriti Allahu në këtë pozitë për shkak të xhamisë që ndërtove?

- Jo! – Iu përgjigj nëna sulltaneshë.

I habitur, personi e pyeti përsëri:

- Atëherë, me ç'punë arrite në këtë gradë?

Nëna sulltaneshë i dha këtë përgjigje tejet mësimdhënëse:

“Ishte një ditë me shi të dendur. Ne po shkonim për vizitë në xhaminë Ejub Sulltan. Pranë rrugës pashë një mace të vogël e të dobët që po përpëlitej në një pellg me ujë të formuar në skaj të kalldrëmit. E ndala pajtonin dhe i thashë motrës shoqëruese që kisha pranë:

- Shko e merre këtë mace të vogël se, ndryshe, ka për t'u mbytur!

*Për fat të keq, sot,
në qytetërimin
perëndimor, të cilin
poeti Mehmet Akif
Ersoj e quan “egërsirë
të mbetur me një
dhëmb”, mburrja,
mendjemadhësia,
egoizmi dhe
vetëpëlqimi, po e
çon njerëzimin drejt
humbjes.*



Kurse motra më kundërshtoi:

- Aman, nëna sulltaneshë, do të ndyhem i edhe ti, edhe unë!

Për të mos i thyer zemrën asaj, unë zbrita vetë nga pajtoni, u futa nëpër baltë dhe e shpëtova macen. Ajo dridhej. Mu dhimbs, e mora në prehër dhe e ngroha mirë e mirë. Pa kaluar shumë, e mjera u gjallërua!

Ja, për mëshirën që tregova për atë mace të vogël ma fali Allahu këtë pozitë të lartë!”

Sulltanët osmanë nuk u mashtruan nga pasuria dhe mundësitë e tyre të mëdha. Ata nuk ranë në pakujdesi dhe shthurje. Përkundrazi, ata u bënë njerëz të mëshirës me gjithë forcën e tyre. Ata lanë pas si vakëf, xhami, medrese, spitale, shatërvanë dhe vepra të tjera të panumërta. Ata u bënë krahët

e dhembshurisë për vëllezërit e tyre besimtarë, njerëzimin dhe të gjitha krijesat. Ata kombinuan bujarinë me hirin dhe mirësinë me mirësjelljen. Vakëfet e kanë thurur shoqërinë me një rrjet dashurie dhe janë bërë shkak paqeje dhe qetësie. Këto rreshta që zënë vend në dokumentin e vakëfit të Sulltan Mehmed Fatihut, janë kulmi i delikatesës dhe zemërbutësisë:

Cilësia më e dallueshme e tiranëve që kanë përgjakur botën, është arroganca që ua ka bërë zemrat më të forta se guri.

بشنوا زنی چون حکایت میکند
از جدا بچایش حکایت میکند

“Në ndërtesën që kam ndërtuar, të hanë ushqim të varfrit e Stambollit! Ndërsa familjeve të dëshmorëve që ranë në çlirimin e Stambollit, t’u dërgohet ushqim në enë të mbyllura kur të errësohet, me qëllim që të mos vërehen nga fqinjët dhe t’u ruhet nderi e dinjitetit!..”

Kurse sulltaneshë Bezmi Alem, ndër shumë vakëfe, ka themeluar një vakëf të veçantë në Damask, kushtet e të cilit, janë shumë të mahnitshme. Një prej atyre kushteve është edhe ky:

“Të dëmshpërblehen gotat që thyhen apo sendet që dëmtohen (pa dashje) nga shërbyesit që punojnë pranë pronarëve të ashpër e të paedukatë, me qëllim që pronarët të mos i qortojnë duke ua thyer zemrat.”

Sa delikatesë dhe zemërbutësi e madhe!.. Si mund të shqetësohet një zemër kaq shumë me hallin e tjetrit? Padyshim se, me ndryshimin e ndjenjave, si rezultat i edukimit shpirtëror.

Prandaj, të lutemi që Allahu të na falë një zemër të pastër, të mbushur me mëshirë:

“O rrotullues i zemrave! Forcoje zemrën time në fenë Tënde.”
(Tirmidhi, Kader, 7.)

O Allah! Na ruaj nga rënia në vorbullën e dëshirave të egos dhe përputhi ndjenjat në zemrat tona me kënaqësinë Tënde!..

Na e bëj të mundur të gjithëve të pajisemi me moralin shpirtëror të të Dashurit Tënd, Muhammedit ﷺ!..

Amin!..

Shpërdorimi dhe shkapërderdhja, janë sëmundje njësoj si mburrja me pasurinë; janë përpjekje të kota për të zëvendësuar dobësitë e personalitetit dhe për të shtypur ndjenjën e inferioritetit.





VETËDIJA NDAJ PËRGJEGJËSISË

Omer bin Abdulazizi ka thënë:

“Kam marrë mbi vete barrën më të madhe të këtij umeti. Ka shumë njerëz që janë të uritur, të varfër, të sëmurë, nevojtar, jetimë, gra të veja, njerëz që iu është bërë padrejtësi, robër luftime në vendet armike, të moshuar dhe të tjerë, të cilët kur i mendoj, më shtyp presioni i barrës së madhe që kam mbi vete. Ndërgjegjja nuk më gjen qetësi. Si do të përgjigjem unë nëse Allahu më merr në llogari në ditën e gjykitimit dhe nëse Profeti ﷺ, më qorton për këtë?! »” (Ibn-i Kethir, el-Bidaje, IX, 208.)



VETËDIJA NDAJ PËRGJEGJËSISË

NUK ËSHTË KOT!

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun për sprovën e devotshmërisë. Edhe këtë botë e krijoi për të qenë një dekorim dhe shkollë për këtë provë. Në ajetet fisnike thuhet:

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!” (Duhan, 38.)

أَفَحَسِبْتُمْ أَنَّمَا خَلَقْنَاكُمْ عَبَثًا وَأَنَّكُمْ إِلَيْنَا لَا تُرْجَعُونَ

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115)

أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يُتْرَكُوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë «Ne besojmë», pa u vënë në provë?!” (Ankebut, 2)

Atëherë, çdokush që zotëron mendje, duhet të kuptojë se:

Njeriu nuk ka ardhur në këtë botë për të humbur kohë si të dojë. Ai ka përgjegjësi dhe detyra hyjnore. Ai duhet të vlerësojë kapitalin e tij jetësor nën dritën e kriterëve hyjnore me një qëllim serioz.

Përgjegjësi, do të thotë të jesh i ngarkuar me detyrë; të pyetesh dhe të japësh llogari. Edhe profetët, të cilët kanë qenë të ruajtur nga gjynahet, kanë pasur përgjegjësi të madhe për shkak të detyrave të tyre. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar, e patjetër që do t’i pyesim edhe të dërguarit.” (Araf, 6)

Një emër tjetër i ditës së tmerrshme të mahsherit, është Dita e Llogarisë. Atë ditë, njerëzit do të japin llogari për atë që kanë bërë dhe nuk kanë bërë, si për Zotin e tyre ashtu edhe për krijesat.

Nga hadithi i mëposhtëm, kuptojmë se njeriu, i cili ka një borxh besimi, nderi, adhurimi dhe mirënjohjeje ndaj Zotit të tij, gjithashtu ka edhe shumë përgjegjësi të ndërthurura ndaj njerëzve:

“Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete).

► *Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij.*

► *Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij.*

*Gjëja më e keqe sot,
janë ndërgjegjet e
ashpërsuara me
padrejtësi të padronëve
tiranë që udhëheqin
botën. Ato ndërgjegje të
errëta, ku mëshira s'ka
fuqi, po i kthejnë njerëzit
në skllëvër moderne
dhe vendet e varfra në
plehërishte njerëzore.*



➤ *Gruaja është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj.*

➤ *Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.”* (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20.)

ÇDO DREJTUES ËSHTË PËRGJEGJËS...

Njerëzit jetojnë në bashkësi. Për të siguruar rendin e këtyre bashkësive, disa prej tyre duhet të jenë drejtues. Në fakt, shumica e njerëzve dëshirojnë të jenë drejtues. Por sidoqoftë, drejtuesi duhet të marrë përsipër përgjegjësinë e atyre që ka nën drejtimin e tij. Prandaj, është e nevojshme që këto detyra, t'i marrin përsipër personat kompetent, meritore, të ndershëm dhe vetëmohues, për t'i kryer ato me vetëdijen e përgjegjësisë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Allahu ju urdhëron që t’ua ktheni amanetet atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi...” (Nisa, 58.)

Vetëdija e përgjegjësisë që duhet të bartë një drejtues, është shprehur në mënyrën më të bukur në këtë dëshirë të Omerit رضي الله عنه, gjatë kohës kur ishte Kalif:

“Nëse do të jem gjallë do të shëtis midis njerëzve për një vit. E di që njerëzit kanë nevoja që nuk mund të m’i paraqesin, e guvernatorët nuk m’i tregojnë. Madje, as vetë nuk vijnë tek unë. Por;

Historia është dëshmitare se, vendet, në tokën e të cilave nuk mbillet më fara e mëshirës dhe padronët e tyre me shpirt të mjerë, gjithmonë e kanë kthyer botën në një moçal padrejtësis.



- Do të shkoj në Sham dhe do të qëndroj dy muaj.
- Pastaj do të shkoj Xhezire dhe atje do të qëndroj dy muaj.
- Pastaj do të shkoj në Egjipt ku do të qëndroj përsëri dy muaj.
- Do të shkoj në Bahrejn e do të qëndroj po dy muaj.
- Do të shkoj në Kufe dhe do të qëndroj dy muaj.
- Po ashtu edhe në Basra do të qëndroj dy muaj.

Për Allahun! Ai vit do të jetë një vit shumë i mirë!” (Taberi, Tarih, Bejrut: Daru't-Turas, 1387, IV, 201-202.)

Edhe kjo këshillë që, Shakik Belhi i dha Kalifit së asaj kohe, Harun Reshidit, është shumë mësimdhënëse:

“Mblidhe mendjen! Ti po qëndron në vendin e Siddikut, prandaj Allahu Teala kërkon besnikëri edhe prej teje.

Ty të është dhënë posti i Omer Farukut, prandaj të kërkohet që të bësh dallimin mes të drejtës dhe të gabuarës.


Ti je ulur në fronin Osmanit, zotëru-
esit të dy dritave, prandaj duhet të jesh
modest dhe i turpshëm.

Ti je ulur në fronin e Aliut, prandaj të
kërkohet të jesh i ditur dhe i drejtë...”

Kur Harun Reshidi i tha:

“Vazhdo edhe pak...”. Shakiku vazhdoi
fjalën e vet:

“Ti je burimi i ujit, ndërsa guver-
natorët e tu janë uji që rrjedh pas. Nëse
burimi i ujit është i pastër, ashtu do të jetë
edhe uji që rrjedh prej tij.” (Feriduddin Attar,
Tezkiretu'l-Evlja, përktheu: Prof. Dr. Sulejman Uludag, Is-
tanbul 2002, I, 236.)



Në mënyrë të veçantë, Fudajl Bin Ijadi, i cili e ka kuptuar shumë më mirë këtë të vërtetë, ka thënë:

“Unë e kuptoj që nuk i jam bindur Allahut, kur nuk më bindet gomari dhe shërbëtori.” (Ibnul Xhevzi, Sifat-us-Safve, II, 238.)

Ndërsa M. Akif Ersoj, botëkuptimin e Omerit ﷺ, për drejtësinë, e shprehu me vargjet e mëposhtme në veprën e tij Safahat:

“Një dele po të hajë ujku buzë Dixhles, Drejtësia hyjnore vjen dhe Omerit llogari i kërkon!..”

Kurse pasardhësi i Omerit ﷺ, Omer bin Abdulazizi, i shqetësuar tej mase për përgjegjësinë që kishte mbi supe, është shprehur:


“Kam marrë mbi vete barrën më të madhe të këtij umeti. (...) Si do të përgjigjem unë nëse Allahu më merr në llogari në ditën e gjykimit?!..” (Ibn-i Kethir, el-Bidaje, IX, 208.)

Qoftë drejtues ose jo; i gjithë umeti Islam ka përsipër një detyrë të shenjtë, që është urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat. Në një ajet fisnik urdhërohet:

TË JESH UMETI MË I MIRË

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” (Al-i Imran, 110)

Urdhërimi i të mirës dhe ndalimit nga e keqja, kumtimi i fesë dhe përpjeka për të lartësuar emrin e Allahut, janë prej



*Jeta e njeriut
vazhdon me
njëmijënjë borxhe
në formë të
drejtash, të cilat
fillojnë pa ardhur
ende në jetë, e
vazhdojnë edhe
pas vdekjes.*

detyrave shoqërore më të rëndësishme të një besimtari. Në 11 ajete të Kuranit Fisnik, është urdhëruar qartë urdhërimi në punë të mira.

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

“Kush sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Por nëse edhe për këtë nuk ka mundësi, le ta urrejë me zemër. Mirëpo, kjo është shkalla më e ulët e besimit.” (Muslim, Iman, 78.)

Në këtë drejtim, nuk duhet harruar se; për të përmbushur detyrën e urdhërimit në të mirë, individi së pari duhet të ringjallë veten. Ai duhet të pastrojë egon dhe zemrën e tij, sepse nuk mjafton thjesht pohimi me gojë. Ndikimi kryesor realizohet me reflektimin nga zemra në zemër. Leximi dhe përcjellja e të njëjtave ajeteve nga një person i devotshëm dhe një tjetër jo i devotshëm, nuk do të japë të njëjtin rezultat.

E në fakt, kumtimi i ajeteve pa i zbatuar ato në jetën e vet, nuk do t'i sjellë dobi as vetë atij që i përcjell, e as të tjerëve. Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar, gjendjen e pseudo dijetarëve që nuk punojnë me diturinë e tyre, i ka ngjasuar me “gomarë të ngarkuar me libra”. (shih. Xhum'a, 5.)

Për fat të keq, në kohën tonë, përgjegjësia ndaj “urdhërimit në të mirë”, është dobësuar qëllimisht me justifikimin e “lirisë dhe të drejtave njerëzore”. Sipas kësaj, “askush nuk ka të drejtë të përzihet në mënyrën e jetesës së askujt”. Ky parim, -në dukje i drejtë-, në të vërtetë funksionon me standarde të shumëfishta dhe syn-

*Fudajl Bin Ijad:
“Unë e kuptoj që
nuk i jam bindur
Allahut, kur nuk
më bindet gomari
dhe shërbëtori.”*



on më tepër lirinë e shturjes si në planin individual, ashtu edhe në atë shoqëror.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Shembulli i atyre që nuk i kalojnë kufijtë e vendosur nga Allahu dhe mjaftohen të qëndrojnë brenda tyre, në krahasim me ata që i thyejnë kufijtë e vendosur nga Zoti dhe i tejkalojnë ato, ngjason me njerëzit që janë mbledhur dhe hedhin short mes tyre, se kush do të hip në anije. Një pjesë e tyre u vendosën në pjesën e poshtme të anijes, ndërsa pjesa tjetër sipër. Kur ata që gjendeshin poshtë dëshironin të merrnin ujë, kalonin afër atyre që ishin lart (duke i shqetësuar). Prandaj thanë:

- Po sikur të hapim një vrimë këtu poshtë aq sa të marrim ujë për veten tonë dhe të mos i shqetësojmë ata që janë lart!

Nëse ata që janë lart do ti lënë të lirë ata që janë poshtë që të përmbushin këtë dëshirë të tyre, ata do të fundosen që të gjithë. E, nëse i pengojnë, do të shpëtojnë edhe vet, edhe ata që gjenden poshtë.” (Buhari, Shirket 6, Shehadat 30, Tirmidhi, Fiten 12.)

Po ashtu, kjo ngjarje që tregohet të ketë ndodhur mes Sulltan Sulejmanit dhe vëllait të tij të qumështit Jahja Efendisë, na bën të kuptojmë se interesimi dhe shqetësimi për njëri-tjetrin, bën të mundur qëndrimin në këmbë të një shoqërie:

Ç’MË DUHET MUA!

Sulltan Sulejman Kanuni filloi të shqetësohej për të ardhmen e shtetit Osman, i cili në kohën e tij kishte arritur majat

*Shakik Belhi e
këshillon Harun
Reshidin me këto fjalë:
“Ti je burimi i ujit,
ndërsa guvernatorët
e tu janë uji që rrjedh
pas. Nëse burimi i ujit
është i pastër, ashtu
do të jetë edhe uji që
rrjedh prej tij.”*



e madhështisë. Për këtë arsye, ai i dërgon një letër Shejhu'l Islam Jahja Efendisë, ku e pyet:

“Si do të jetë e ardhmja e Osmanëve? A do të shkatërrohen edhe ata një ditë?”

Përgjigja e Jahja Efendisë, ishte tejet koncize:

“Ç’më duhet mua, sulltani im!”

Sulltani u habit dhe nuk mundi t’i japë kuptim kësaj përgjigjeje. Prandaj, vendosi të shkonte vetë tek Jahja Efendi, i cili ia shpjegoi kuptimin e vërtetë:

“Sulltani im! Nëse në një shtet shtohet shtypja e padrejtësia dhe ata që e shohin thonë “ç’më duhet mua!”, e largohen;

nëse në vend të ujçërve, delet i hanë barinj-të dhe ata që e dinë nuk flasin por heshtin; nëse klithmat e të varfërve, nevojtarëve, të vobektëve dhe jetimëve ngrihen në qiell dhe këtë nuk e dëgjon tjetër veç gurëve, atëherë vjen edhe fundi i shtetit. Në situata të tilla, zbrazet thesari i shtetit dhe tron-ditet besimi dhe respekti i njerëzve. Ndjen-ja e bindjes ndaj rendit publik dhe respekti midis njerëzve zhduket, dhe kështu vjen rë-nia e shkatërrimi... “

Daudi ﷺ, bënte shpesh këtë dua: “Zoti im! Prej Teje kërkoj dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty dhe mundësinë për të bërë veprat të mira që më shpien në dashurinë Tënde! Zoti im! Bëma dashurinë ndaj Teje më të dashur se dashurinë ndaj vetes, familjes, pasurisë dhe ujit të ftohtë!” (Tirmidhi, Deauat, 72.)



Një besimtar e konsideron veten përgjegjës për rrjedhën e ngjarjeve. Ai nuk mund të shikojë me sy pa emocione teksa njerëzit rrokullisen në Xhehenem si trungjet në një përmbytje. Për shkak të dhembshurisë dhe mëshirës së tij, ai dig-jet, shqetësohet dhe përpiqet me dëshirën për të shpëtuar të ardhmen e njerëzve në

botën e përtejme. Ndërsa Allahu i Plotfuqishëm, i fal atij udhëzimin si shpërblim i këtyre përpjekjeve.


Në periudhën e Mekës, e cila ishte plot vuajtje dhe vështirësi, edhe Profeti ynë ﷺ, digjej nga dëshira për të kumtuar fjalën e Allahu. Ai përpiquej të përcillte mesazhin e Zotit kudo dhe në çdo rast; në panairët e letërsisë, gjatë sezoneve të pelegrinazhit, në oborrin e Qabesë, etj., duke i përballuar të gjitha llojet e vuajtjeve me buzëqeshje.

Po kështu, edhe sahabët, të cilët u edukuan me të njëjtat ndjesi, udhëtuan dhe shkuan në të katër anët botës, në Kinë, Semerkand, Afrikë, etj., vetëm e vetëm për t'i takuar njerëzit me dritën e Islamit.

Por, rëndësinë e detyrës sonë për t'u përpjekur me pasurinë dhe jetën tonë në rrugë të Allahut, na e tregon më së miri ky kujtim i Halid bin Zejd Ebu Ejjub el-Ensarit:

CILI ËSHTË RREZIKU MË I MADH?

Në periudhën Emevite, ushtria Islame erdhi deri në Kostandinopojë me dëshirën që të bëhej pjesë e përgëzimit të Profetit ﷺ, për çlirimin e saj. Në këtë ushtri, bënte pjesë edhe sahabiu Ebu Ejjub el-Ensari ؓ. Ndërkohë që bizantinët luftonin duke lënë muret e qytetit pas shpine, një sahab prej ensarëve u fut me kalin e tij deri në mes të ushtrisë bizantine. Kur një prej ushtarëve myslimanë e pa këtë, duke marrë shkas prej ajetit fisnik i cili urdhëron: *“Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!”*, tha me qortim:



Qoftë drejtues ose jo, i gjithë umeti Islam ka përsipër një detyrë të shenjtë, që është urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat.

“La ilahe il-lallah! Shikojeni atë! Ai po e hedh veten në rrezik me vetëdije!”

Ndërsa Ebu Ejub el-Ensari رضي الله عنه, tha:

“O besimtarë! Ky ajet ka zbritur për ne ensarët. Kur Allahu e ndihmoi të Dërguarin e Tij ﷺ dhe e bëri triumfuese fenë e Tij, ne thamë: «Tashmë do të qëndrojmë pranë pasurisë sonë dhe do të merremi vetëm me shtimin e saj!» Për këtë arsye, u zbrit edhe ajeti fisnik: “Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (Bekare, 195.) Qëllimi i shprehjes “mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja”, në këtë ajet, është që ne të mos zhytemi në çështjet e kësaj bote dhe të merremi vetëm me vreshtari e kopshtari, duke braktisur apo neglizhuar përpjekjet në rrugën e Allahut.” (shih. Ebu Daud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhi, Tefsir, 2/2972.)

Një tjetër dëshmi e rëndësisë së madhe që ka përgjegjësia e përpjekjes në rrugën e Allahut, është gjendja e tre sahabëve të cilët u përballën me ndëshkimin

e bojkotit nga shoqëria Islame për shkak të mospjesëmarrjes së tyre në betejën e Tebukut. Pavarësisht faktit se këta tre sahabë kishin marrë pjesë në të gjitha betejat që ishin zhvilluar deri atëherë, ata vuanjtën një dënim të rëndë për shpirtin e tyre, sepse askush nuk i pa në fytyrë për 50 ditë rresht, vetëm sepse ata përtuan të bashkoheshin me të tjerët në rrugën e Allahut.

Nuk ekziston një lloj kufiri, që ne mund të themi; “Unë kam shërbyer mjaft! Kjo më mjafton!”... Ne e dimë sasinë dhe përqindjen e zekatit që duhet dhënë. Kur ai që zotëron pasuri të mjaftueshme, e jep një të



“Kush sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi, le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Por nëse edhe për këtë nuk ka mundësi, le ta urrejë me zemër. Mirëpo kjo, është shkalla më e ulët e besimit.”

(Muslim, Iman, 78.)

dyzetën e asaj pasurie, ai e ka shlyer borxhin e zekatit. Por, si do ta paguajë ai çmimin e mirësisë së besimit që i ka falur Allahu? Kjo mirësi nuk ka një kufi të poshtëm, por kërkon përpjekje deri në frymën e fundit dhe përdorimin e çdo mundësie, sepse çdo rob, që prej atij më të thjeshtit, e deri tek profetët, kanë përgjegjësinë e kumtimit të fjalës së Allahut...


Të parët tanë, të cilët e kuptuan shumë mirë këtë ndjenjë të përgjegjësisë, kur morën vende të tilla si Bosnja dhe Kosova, vendosën familje që do të përfaqësonin Islamin në mënyrën më të mirë, duke ndihmuar kështu popujt e tjerë që të nderoheshin me Islamin. Sot, është detyrë e çdo besimtari të dëgjojë thirrjet e heshtura të njerëzve që janë në uri dhe mjerim shpirtëror në vendin tonë dhe në të gjithë botën.

Rezultatet e një sondazhi të shpallura pak kohë më parë, tregojnë qartë se sa e madhe është përgjegjësia jonë në këtë çështje. Ata që pohojnë se mund ta lexojnë Kuranin nga origjinali, janë vetëm 32 përqind. Ndërsa ata pohojnë nuk kanë marrë mësim Kurani, janë 65 përqind. Pra, këtu ka humbje serioze në bazat e besimit.

Përgjegjësia është e madhe... Mirëpo, padyshim, duke filluar prej më të afërtit;

PËRGJEGJËSIA NDAJ FËMIJËVE

Kumtimi dhe urdhërimi në të punë të mira janë detyrat tona që duhet të përmbushen ndaj gjithë umetit dhe gjithë



Dashuria, është fillimi i përparimit shpirtëror. Në fakt, kjo pikë është filli i gjithçkaje. Vetëm kur shijon dashurinë e vërtetë, zemra fillon të hapet dhe të manifestojë bukuritë shpirtërore.

njerëzimit. Sidoqoftë, përgjegjësia jonë ndaj familjes dhe fëmijëve tanë është shumë më gjithëpërfshirëse dhe më e rëndë se kjo, sepse fëmijët tanë na janë besuar ne. Mbrojtja e tyre nga zjarri i Xhehenemit, është një urdhër i nivelit më të lartë. Në Kuran urdhërohet:

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6)

Ashtu siç prindërit kanë të drejta mbi fëmijët e tyre, ashtu edhe fëmijët kanë të drejta mbi prindërit e tyre. Trashëgimia më e veshme që prindërit mund t’u lënë fëmijëve, është personaliteti Islam dhe morali i bukur, që në të njëjtën kohë është edhe një prej detyrave më të shenjta.

Kundërshtimi i parë ndaj Islamit në kohën e injorancës, kaq qenë në lidhje me besimin në ekzistencën e botës tjetër. Ata thoshin:

“O Muhammed! Hiq dorë nga ligjërimi për botën tjetër dhe mos i prek idhujt tanë! Atëherë ne do të të ndjekim ty!..”

I gjithë halli i tyre ishte çështja e ahiretit. Po kështu edhe sot, një rrymë e asaj injorance që do të na bëjë të harrojmë ahiretin po kërcënon fëmijët tanë. Disa programe në internet dhe televizion, disa modele dhe reklama negative po përpiqen t’i bëjnë brezat tanë të harrojnë ahiretin. Në këtë drejtim, është përgjegjësia jonë më e madhe të bëjmë përpjekje për të mbrojtur fëmijët dhe brezat tanë nga këto rryma toksike.

*Ukbe bin Nafi
shkoi deri në
Kajravan dhe tha:
“O Zoti im! Po
të mos ishte ky
det i madh, do të
vazhdoja rrugën e
xihadit në vendet
e tjera.”*



Shprehja e të ndjerit Nexhip Fazllit: “Pema që nuk mendon për sythin, është thjesht dru!”, është një paralajmërim për përgjegjësinë tonë në këtë pikë.

Për shkak se fëmijët janë vazhdueshmëria e prindërve të tyre, mëshira ndaj fëmijës shpesh ia kalon kujdesit të njeriut ndaj vetvetes. Për këtë arsye M. Akif Ersoj shprehet:

*Ta zëmë se për veten mëshirë s’ke,
Po për fëmijën tënd mëshirë a ke?*

Fëmijët i imitojnë prindërit e tyre dhe, më shumë se këshillat, ata marrin shembull veprat e tyre. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“..Urdhëro familjen tënde të falë namaz, edhe ti vetë zbatoje atë!..” (Ta-Ha, 132.)

Pra, prindërit duhet të jenë të devotshëm, qoftë për veten, qoftë për fëmijët e tyre.

Ata që nuk mund t’i përmbushin përgjegjësitë e tyre ndaj familjes dhe fëmijëve të tyre në këtë botë, do të duan të ikin prej tyre në ahiret. Mirëpo, atë ditë të ashpër dhe të vështirë nuk ka vend për të shpëtuar! Zgjidhja është që, të gjithë së bashku, baba-fëmijë, burrë-grua, individ dhe shoqëri të kapen fort pas litarit të Allahut që në këtë botë, dhe të ndjekin urdhrin hyjnor, **“Ikni drejt Allahut!..”**. (Dharijat, 50)

PËRGJEGJËSIA MATERIALE

Allahu i Madhëruar nuk ka marrë për bazë barazinë gjatë dhënies së furnizimit për robërit e Tij. Disave u dha më shumë,

*Çdo mysliman
duhet ta shohë
veten përgjegjës
për mbarëvajtjen
e kohës në të cilën
jeton. Ai duhet ta
konsiderojë veten
përgjegjës për
udhëzimin e të
gjithë njerëzve.*



e disave më pak. Por që dyja janë sprova. Në Kuran, Allahu i Madhëruar na jep shembuj edhe të profetëve që u ka dhënë në pak pasuri, edhe të profetëve që u ka dhënë shumë pasuri. Duke na prezantuar me profetin Sulejman عليه السلام, mirësitë dhe mundësitë e jashtëzakonshme që i kishte falur atij, faktin se ai i përdori ato si një amanet në rrugën e Allahut dhe se sa mirënjohës ishte ai, Allahu i Madhëruar e lavdëron atë me këto fjalë:

نَعْمَ الْعَبْدُ

“...Një rob i mrekullueshëm...” (shih. Sad, 30-40)

Po ashtu, edhe në lidhje me Profetin Ejjub عليه السلام, të cilin e kishte sprovuar vështirësi ekonomike dhe sëmundje, urdhëron:

نَعْمَ الْعَبْدُ

“...Një rob i mrekullueshëm...” (shih. Sad, 41-44)

Gjithashtu, edhe Profeti ynë صلى الله عليه وسلم, ka qenë shembulli më i bukur për ne në çdo gjendje të tij, si në kamje edhe në skamje.

Allahu është pronari i vërtetë i gjithçkaje. Ndërsa pasuria

Sulltanët Osmanë kishin i urdhëruar ushtarët e tyre me pagesë që gjatë ceremonisë përshëndetëse të xhumasë, të thoshin në kor: “Mos u mburr o padishah, Allahu është më i madh se ti!”



në dorën e robërve të Tij, është një amanet që u është dhënë përkohësisht. E, kujt i është dhënë furnizim i bollshëm, i është dhënë edhe përgjegjësi e madhe. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.” (Dharijat, 19.)

Me fjalë të tjera, për sa i përket të drejtave të tyre të

zekatit, në një farë mënyre të varfrit janë ortakë me një të dyzetat në kapitalin e të pasurve. Në fusha të ndryshme, si bujqësi, blegtori, etj., përqindjet janë të ndryshme. Prandaj, çdokush që zotëron një pronë, duhet të mësojë rregullat e zekatit që lidhen me pasurinë e tij dhe, duke llogaritur mirë pasurinë e tij çdo vit hixhri, duhet të ndajë prej saj të drejtën e të varfrit.

Ata që nuk japin zekatin, tek Allahu i Madhëruar llogariten si vjedhës që kanë grabitur pjesën e ortakut të tyre. Për më tepër, zekati është niveli minimal i përgjegjësisë që kanë të pasurit. Në Kur'anin Fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron edhe dhurimin, që mund të jetë një sasi më e madhe se zekati. E në fakt, për dhurimin nuk ka kufi të caktuar si për zekatin, sepse dhurimi është një rrugë e drejtë që të çon tek Allahu dhe udhërrëfyesi i kësaj rruge është i Dërguari i Allahut ﷺ. Profeti ynë ﷺ, ka jetuar deri në frymën e fundit edhe me kryerjen e adhurimeve, edhe me kryerjen e detyrës së kumtimit dhe urdhërimit në punë të mira. Kështu, Profeti ynë ﷺ, është shembulli më i qartë dhe më i zgjedhur i një jete të mbushur me dhurim në rrugën e Allahut.

Zekati jepet prej pasurisë, ndërsa dhurimi jepet edhe në kamje, edhe në skamje!..

Kur u zbritën ajetet e dhurimit, sahabët e varfër që jetonin në një pjesë të Xhamisë së Profetit ﷺ, sepse s'kishin as shtëpi as katandi, dëshiruan të bëheshin pjesë e atyre që Zoti ynë i lavdëroi për dhurimin. Prandaj, ata dolën maleve, bënë dru dhe paratë që fituan nga shitja e tyre, ia sollën të Dërguarit të Allahut ﷺ.

*Allahu i Madhëruar,
atyre që tregohen
tepër kryelartë e
mendjemëdhenj, u
përgjigjet me sprovë
të rënda në këtë botë,
e në botën tjetër, i
hedh në zjarrin e
Xhehenemit. Kurse ata
që tregohen modestë
e të përlulur, janë
të ruajtur nga këto
sprova.*



Allahu i Madhëruar, me emrin e Tij “el-Uedud”, ka shpërndarë dashuri tek të gjithë. Por, nëse dashuria për fëmijët, pasurinë dhe çdo të mirë tjetër, nuk bëhet shkallë për dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, nuk ka ndonjë vlerë dhe përfundon bashkë me frymën e fundit. Kjo sepse udhëtimi i përjetshëm mund të realizohet vetëm me Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ. Prandaj, dashuritë e kësaj bote, duhet të shërbejnë si shkallë për të arritur lumturinë e përjetshme në botën tjetër.

Nuk duhet harruar se, çdo mirësi, prej së cilës përfitohet në këtë botë, ka përgjegjësinë e vet dhe për to do të jepet llogari. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8.)

Komentuesi i njohur i Kuranit, Elmallëllë, lidhur me këtë ajet, na përcjell një ndodhi shumë domethënëse. Kur u zbrit ky ajet fisnik, një sahab shumë i varfër e nevojtar, u ngrit në këmbë dhe pyeti:

- (O i Dërguar i Allahut!) A kam unë ndonjë mirësi (për të cilën do të jap llogari)?

Profeti ﷺ, iu përgjigj shkurtimisht:

- *“Hija, dy nallanet dhe uji i ftohtë.”*

(shih. Sujuti, VIII, 619.)

Dhe me të vërtetë që, nëse Allahu nuk do të na kishte dhuruar mundësi për të bërë shtëpi ku të fusim kokën, jeta jonë do të ishte e pamundur nën kushtet e vështira të klimës. Mirëpo, në saje të mirësive të ndryshme, aftësive dhe mendjes që i ka

Lafajet, për Profetin tonë ﷺ, ka thënë: “O njeri i madh! Askush nuk ka mundur ta përhapë të vërtetën dhe drejtësinë siç i ke përhapur ti!”



dhuruar Allahu, njeriu arrin të bëjë shtëpi, veshje dhe mjete të tjera për t'u mbrojtur nga i nxehti dhe i ftohti.

Po kështu, është edhe mirësia e ujit, i cili ngrihet në qiell dhe, pasi pastrohet e filtrohet nga të gjitha papastërtitë, kthehet përsëri tek ne si mëshirë!..

Pra, a do të mund të japim llogari qoftë edhe vetëm për këto tri mirësi?..

GJITHÇKA NA ËSHTË LËNË NEVE AMANET


Një besimtar ka përgjegjësi edhe ndaj krijesave të tjera, bimëve dhe natyrës...

Besimtari e ka për detyrë t'i shikojë krijesat me syrin e dhembshur të Krijuesit, t'i trajtojë ato me mëshirë dhe të jetë i drejtë gjatë përdorimit të tyre, sepse edhe krijesat e tjera na janë besuar neve.

Profeti ynë ﷺ, dëgjoi ankesat e deveve që ishin të ngarkuara me ngarkesa të rënda; nuk e pëlqeu aspak as shkundjen fort të një peme; ai gjithmonë sugjeroi mëshirë.

Allahu i Madhëruar na bëftë prej robërve të Tij të ndër-gjegjshëm ndaj përgjegjësive, prej atyre që do të mund të japin llogari me lehtësi ditën e gjykimit dhe që do ta marrin librin e veprave të tyre nga e djathta!..

Amin!..



Drita e udhëzimit që mund ta eliminojë botëkuptimin e injorancës së ditëve tona, mund të shfaqet vetëm nëse ndjekim moralin dhe drejtësinë profetike.

MORALI I TIJ MADHËSHTOR



NDËRTIMI I NJERIUT QË ELIMINON INJORANCËN

Tre lloj njerëzish janë larg Allahut:

- Ata që i ikin shërbimit në rrugën e Tij duke llogaritur rehatinë e vet...*
- Ata të cilët qëndrojnë larg të vuajturve dhe skamnorëve duke u justifikuar se janë të ndjeshëm...*
- Ata të cilët shoqërohen me njerëzit zullumqarë...*



NDËRTIMI I NJERIUT QË ELIMINON INJORANCËN

PREJ ERRËSIRËS NË DRITË

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun me qëllim që ai ta adhurojë Atë. Ndërsa botën, e ka krijuar si një shkollë të njohjes së Allahut, që njeriu ta kryejë sa më mirë këtë detyrë. Ai gjithashtu e pajisi njeriun me aftësitë për të qenë mik me Allahun e Madhëruar.

Në të njëjtën kohë, si domosdoshmëri e sprovës së njeriut, Allahu i Madhëruar ka krijuar edhe disa pengesa dhe vështirësi, të cilat përpiqen ta largojnë atë nga qëllimi i tij, si egoja, shejtani dhe mirësitë e kësaj bote. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.” (Al-i Imran, 14.)

Në mënyrë që njerëzimi të mos bjerë në errësirën e injorancës dhe të shkujdesjes duke u mashtruar nga këto pengesa të

egos, Allahu i Plotfuqishëm e ndihmoi atë me mëshirën e Tij, duke dërguar libra dhe profetë. Kështu, umetit të fundkohës, Zoti ynë i ka dërguar Librin e tij më madhështor dhe Profetin e Tij më të virtytshëm. Në Kuran urdhërohet:

“Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”
(Ibrahim, 1)

Profeti ynë i nderuar ﷺ, gjatë gjithë detyrë së tij 23 vjeçare të kumtimit, është përpjekur me të gjitha forca që ta nxirrte popullin nga errësira e injorancës drejt dritës së Islamit.

Profeti ynë ﷺ, si profeti i fundit, është vula e të gjithë profetëve dhe profeti i të gjithë shekujve deri në ditën e Kiametit.

Mirëpo, biri i njeriut është larguar nga drita e Kuranit dhe e Sunetit. Dhe, duke u mposhtur nga iluzionet e egos, ka rënë

përsëri në errësirën e injorancës. Por, pas Profetit ﷺ, detyra e përcjelljes së të vërtetës dhe dritës së udhëzimit tek ata, i takon umetit të tij, sepse profetët nuk kanë trashëgimi materiale. Trashëgimtarët e Profetit janë dijetarët që kanë përsosur cilësitë e tyre të jashtme dhe të brendshme për të përmbushur detyrën e përcjelljes së mesazhit. Për këtë arsye, në Kuran urdhërohet:

وَلَتَكُنَّ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ
وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ
وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për



Edukimi i një fëmijë në aspektin fetar, është mëshira më e madhe që mund të tregojë prindërit e tij për të, sepse qëllimi ardhjes sonë në këtë botë, është përgatitja për botën tjetër.

vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” (Al-i Imran, 104)

Po ashtu, në Kuranin Fisnik, ndër cilësitë më të spikatura të besimtarëve, është konsideruar urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat:

“Besimtarët dhe besimtares janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.” (Teube, 71.)

Sot, ne jemi përsëri në një epokë të injorancës. Përsëri, njerëzimi është në një gjendje të mjerueshme në errësirën e mosbesimit, hipokrizisë, gjynahut, pakujdesisë dhe injorancës. Në një situatë të tillë, çdo besimtar, si umet i të Dërguarit të Allahut, ka për detyrë të përcjellë mesazhin Islam.

Çfarë duhet bërë sot?

NDËRTIMI I NJERIUT

Detyra më e rëndësishme që duhet bërë për të eliminuar injorancën në kohën tonë, është edukimi dhe ndërtimi i njerëzve me personalitet. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përpiqemi me vendosmëri dhe entuziazëm, qoftë edhe nga e para, pa u ankuar për situatën shterpë dhe negative që mbi-zotëron sot.

Fatmirësia më e madhe për një besimtar, është zotërimi i cilësisë së mëshirës dhe përhapja e saj përgjatë gjithë jetës tek familja dhe shoqëria e tij.



Si shembull për këtë;

Një prej shejhëve Shazeli, Derkavi, Tregon:

“Shehu im më dërgonte vazhdimisht tek një fis. Një ditë i thashë:

- Atje ku shkoj unë, nuk ka asnjë rob të Allahut me të cilin mund të bisedoj për fe. Kështu që do të ngel vetëm...

Mirëpo, shehu më tha:

- Njeriun për të cilin ke nevojë, do ta lindësh vetë! (Do ta kërkos, do ta gjesh dhe do ta edukosh vetë).

Kur shqyrtojmë shërbimet në të gjithë botën, shohim se; nëse nuk ka njerëz të aftë, nuk realizohet asgjë, edhe nëse ka para për të shpenzuar. Po ashtu, në mungesë të parave, njerëzit e aftë privohen nga kryerja e shumë shërbimeve që mund të bëjnë.

Besimtari ka nevojë për mëshirën e Zotit të vet. Jo më kotë, në ajetet e fundi të sures Bekare, të cilat këshillohemi t'i lexojmë përditë, zë vend lutja “na mëshiro”.



Çdo besimtar, duhet të mobilizohet për të ndihmuar fenë e tij. Ai duhet të shërbejë si materialisht ashtu edhe shpirtërisht, sipas mundësive, me pasurinë, jetën, fuqinë dhe kohën e tij. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8.)

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...” (Bekare, 286.)

Prandaj, është e domosdoshme të shpenzojmë të gjitha burimet tona materiale dhe shpirtërore në rrugën e Allahut. Kështu, për të qenë mirënjohës ndaj

mirësisë së udhëzimit, sahabët fisnikë përdorën në maksimum mundësitë e tyre në rrugën e Allahut. Ata shkuan në Semerkand, Kajravan, në Kinë, etj., për të përhapur Islamin në të gjithë botën.

Në fakt, realizimi i një qëllimi të lartë, siç është fitimi i zemrave dhe të qenit mjet udhëzimi, varet nga tri kushte:

1. Një ide mbizotëruese.
2. Njerëz të aftë dhe vetëmohues që do ta ndjekin atë ide.
3. Mundësi financiare.

Ideja mbizotëruese është përmbajtja e Islamit; Kurani dhe Suneti, që janë thelbi i kumtimit dhe urdhërimit në punë të mira. Por, për fat të keq, në kohën tonë, në fushën e kumtimit Islam kanë zbritur grupe ekstremiste fetare dhe po përhapin në masë gabimet e tyre.

Prandaj, e përsërisim edhe njëherë se, Ebu'l Hasan Harakani, në lidhje me këtë çështje ka thënë:

“Fitnen që shkaktojnë dy lloj njerëzish, nuk e shkakton as shejtani! (prandaj ik prej tyre):

1. Sufisti i paditur dhe i papjekur:

Sufisti i paditur, nuk i njeh mirë parimet e Kuranit dhe Sunetit dhe, si pasojë e mungesës së edukimit të duhur, ai bën veprime të pahijshme. E, për shkak se nuk njeh as metodat e duhura, ai është i privuar edhe nga urtësia që kërkohet në kumtimin e fesë. Për këtë arsye, në vend të dobisë, ai i sjell dëm kësaj rruge.

*Allahu i
Madhëruar, me
mirësinë e Tij, na
ka falur ditë dhe
muaj të veçantë,
në të cilët begatia
e Tij është më
e madhe se në
kohë të tjera.*



2. Dijetari i mposhtur nga lakmia për këtë botë (që nuk e ka pastruar egon nga lakmia dhe kryelartësia):

Allahu i Madhëruar, në suren Xhuma, lidhur me dijetarët që nuk punojnë me dijen e tyre, ka thënë se; ata janë si “**gomarë të ngarkuar me libra.**” (shih. Xhum’a, 5)

Ndërsa në ajete të tjera, Allahu i kërcënon rëndë “ata që i shesin ajetet e Allahu për ndonjë dobi të vogël (materiale).” (shih. Bekare, 79, 174; Al-i Imran, 77, 187; Teube, 9)

Dijetarë të tillë, i interpretojnë ajetet e Allahu sipas interesave personale dhe janë të gatshëm t’i shtrembërojnë të vërtetat hyjnore vetëm për pak përfitim të kësaj bote.

Për këtë arsye, hapi i parë në kumtimin e fesë dhe urdhërimin në punë të mira, është që njeriu të pastrojë egon e tij në mënyrë të saktë, e më pas të dedikohet shpirtërisht në fitimin e zemrave të njerëzve.

- Një tjetër çështje e rëndësishme, është edukimi i njerëzve të aftë. Këto shembuj na e tregojnë më së miri vlerën e njeriut të aftë:

NJË NJERI, NJË ATDHE!

Xhaferr Tajari qëndroi për 13 vjet në Abisini, ku shkoi me urdhër të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Atje, ai arriti sukses të madh në përhapjen e Islamit. Madje, ndikimi i tij arriti deri tek kreu i shtetit.

Pasi kishte përmbushur detyrën e tij atje, ai u kthye në vendin e vet, ku mësoi

*Nëse dëshirojmë
fëmijë të mbarë e
të devotshëm, është
e domosdoshme
të jemi prindër
të mbarë e të
devotshëm.
Prindërit që ia
arrijnë kësaj,
meritojnë
falënderim të
përjetshëm.*



se Profeti dhe shokët e tij kishin shkuar në betejën e Hajberit. Ai vrapoi menjëherë atje, por kur mbërriti, tashmë beteja kishte mbaruar. Sapo i Dërguari i Allahut ﷺ, e pa, e shprehu lumturinë e vet me këto fjalë:

“Nuk e di, a të gëzohem për fitoren e Hajberit apo për ardhjen e Xhaferrit!..” (Ibni Hisham, III, 414)

Gëzimi për marrjen e një qyteze të rëndësishme në njërën anë dhe për ardhjen e një njeriu të aftë në anën tjetër... I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk shprehet se cili është më i rëndësishëm, por i sheh të barabartë.

Detyra më e rëndësishme e misionit 23-vjeçar të Profetit tonë ﷺ, ishte të trajnonte stafin që do të mbante flamurin e davetit Islam pas tij. Ai u largua nga kjo botë me një buzëqeshje paqeje duke parë deri në ditët e tij të fundit atë brez që kishte edukuar..

BUZËQESHJA MË E BUKUR

Në namazin e sabahut të ditës kur i Dërguari i Allahut ﷺ, emigroi në botën tjetër, ia ngritën perden e derës, dhe ai pa për herë të fundit sahabët e tij të dashur tek falnin namaz, të prirë nga Ebu Bekri ﷺ. Kështu, ai buzëqeshi i lumtur duke parë i kënaqur sahabët e vet që faleshin të rreshtuar në xhemat. (shih. Buhari, Megazi, 83.)

Nëna jonë Aisha ﷺ, që na e ka treguar këtë ngjarje, thotë:

Një nga treguesit e kujdesit ndaj hallallit, është edhe përmbajtja nga ushqimi. Pra të mos e lejosh veten të biesh në grykësi, të mendosh për të tjerët dhe të dhurosh për hir të Allahut...



“I Dërguari i Allahut ﷺ, e sodiste me buzëqeshje faljen e namazit nga sahabët. Kurrë nuk e kisha parë të Dërguarin e Allahut kaq të gëzuar!” (Ibni Hisham, IV, 331.)

Në të njëjtën mënyrë, edhe ata që e morën detyrën pas Profetit ﷺ, ndjenë dëshirën për të edukuar njerëz të kualifikuar dhe, në të njëjtën kohë edhe dhimbjen e shqetësimin e mungesës së këtyre njerëzve.

DËSHIRA MË E MADHE

Një ditë, Omeri ﷺ, ishte ulur së bashku me miqtë e tij dhe u tha atyre që t’i luteshin Allahut për diçka që dëshironin. Njëri prej tyre tha:

- Do të doja të kisha një dhomë si kjo plot me para, që t’i shpenzoja në rrugën e Allahut!

Një tjetër tha:

- Do të doja të kisha një dhomë si kjo plot me flori, që t’i shpenzoja për hir të Allahut!

Disa të tjerë thanë:

- Do të doja të kisha një dhomë si kjo plot me xhevahire, që t’i shpenzoja për hir të Allahut!

- Kërkoni më shumë, më shumë! - u tha Omeri ﷺ.

- E çfarë mund të kërkohet më tjetër nga Allahu i Lartësuar?! - thanë ata.

Atëherë Omeri ﷺ, tha:



“O njerëz! Frikësojuni Allahut ashtu siç i ka hije Atij dhe kërkoni furnizimin/ rrizkun në rrugë hallall! Askush nuk do të vdesë pa e marrë rrizkun (që i ka caktuar Allahu). Prandaj frikësojuni Allahut ashtu siç i ka hije Atij dhe kërkoni furnizimin/ rrizkun në rrugë hallall! Merrni atë që është hallall dhe lëreni atë që është haram!” (Ibn Maxhe, Tixharet, 2.)

- “Unë dëshiroj që kjo dhomë në të cilën gjendemi, të jetë plot me njerëz (të zgjedhur dhe me karakter), si Ebu Ubejde bin Xherrah, Muadh bin Xhebel dhe Hudhejjetu’l-Jemani, që t’i përdor ata në rrugën e bindjes ndaj Allahut, pra në shërbim të Islamit dhe përparimit.” (Buhariu, Tarihu’s-Sagir, I, 54)

Duke kuptuar rëndësinë e një njeriu të aftë dhe ideal, lidhur me Sinan Pashën, i cili ra dëshmor gjatë marrjes së Egjiptit, Sulltan Javuz Selimi tha:

“Ne morëm Egjiptin, por për fat të keq humbëm Sinan Pashën!”

Kështu, ai shprehu se; dhimbja e humbjes së një personi të vetëm të arsimuar, ishte e mjaftueshme për të errësuar gëzimin e asaj fitoreje të jashtëzakonshme.

Gjetja dhe edukimi i njerëzve të aftë, kërkon një përpjekje të gjatë dhe të mundimshme. Pashpresa dhe lodhja i pengojnë njerëzit e paduruar në këtë rrugë. Mevlana, shprehet se gjithmonë ka ndjerë mall për njeriun ideal, cilësor, të thellë dhe delikat. Këtë mall që ndjente, konkretisht e tregon me këto fjalë:

“Ishte natë. Dola prej shtëpisë sime dhe po shëtitja në lëndinë. Papritur, pashë një burrë që po vinte vërdallë me fener në dorë.

- Çfarë kërkon në këtë errësirë? - E pyeta unë.

- Po kërkoj njeriun! - U përgjigj burri.

- I mjeri ti! Po lodhesh kot... Unë braktisa vendlindjen dhe përsëri nuk munda ta gjej. Shko në shtëpi... shtrihu dhe reha-



Respektimi i të drejtave njerëzore, edhe nëse është kundër interesit personale, është një nga virtytet e larta që e bëjnë të admirueshëm personalitetin njerëzor.

tohu. Po kërkon kot, sepse atë nuk do ta gjesh asgjëkund! - i thashë unë.

Burri i shkretë, vështroi me hidhërim dhe tha:

- Edhe unë e di se nuk do ta gjej. Por përsëri më pëlqen të kërkoj! Mundohem të kënaqem me mallin që ndjej për të...

Me pak fjalë, njeriu i edukuar dhe i aftë, është nevoja jonë kryesore.

Këto këshilla të Lukmanit për djalin e tij, e shprehin më së miri faktin se urdhërimi në punë të mira, është një detyrë që duhet të përcillet nga brezi në brez:

“Biri im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” (Lukman, 17.)

Mirëpo, është e domosdoshme që koncepti i “njeriut të edukuar” të kuptohet drejtë:

TË KUPTOSH DREJTË

Për cilin njeri e kemi fjalën, me çfarë është edukuar, mbi ç’baza dhe ku është arsimuar?

Sigurisht; një person i edukuar në boshtin e Kuranit dhe Sunetit, me udhëzimet e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, i cili ndërtoi qytetërimin tonë...

Prandaj;



Zgjidhja e të gjitha problemeve tona në kohën e sotme, është t'i ngjajmë Profetit ﷺ, në çdo fushë të jetës; në kujdesin ndaj haramit dhe hallallit, në vetëmjaftueshmëri, në dhurim, në solidaritet, në moral dhe bindje ndaj Allahut...

Ne duhet t'i japim vlerë edukimit kuranor të fëmijëve tanë, po aq sa edukimit të tyre me dijet e tjera, sepse kjo teston sinqeritetin tonë ndaj Allahut të Madhëruar dhe Profetit ﷺ. Po ashtu, ne duhet t'i kushtojmë vëmendje mësim-it të gjuhës së Kuranit, po aq sa mësimi një gjuhe të huaj, sepse kjo është motoja e devotshmërisë sonë.

E në fakt;

Kurani Fisnik është një letër që Allahu i Madhëruar ua ka dërguar robërve të Tij. Kurani është një udhëzues i rrugës së drejtë. Asnjë lloj edukimi nuk krahasohet me atë të Kuranit. Edukimi në të gjitha fushat e tjera, jep fryte vetëm në saje të edukimit Kuranor.

Në kohën tonë, është bërë e zakonshme të bëhen përpjekje të mëdha dhe të shpenzohen kohë dhe para të shumta për arsimin në dijet e kësaj bote. E ndërkohë, në rastin më të mirë, arsimi fetar i kushtohet shumë pak interes dhe kohë. Më pas, për të ngushëlluar ndërgjegjen nga kjo neglizhencë e madhe, themi: “Ne duam që të edukohen inxhinierë dhe mjekë që njohin fenë e tyre.”

Mirëpo, rëndësia që i jepet arsimit fetar është shumë më e vogël se ajo që i jepet arsimimit në fusha të tjera, gjë e cila tregon se sa shumë nënvleftësohet arsimi fetar.

Profeti ynë ﷺ, i edukoi shokët e tij për 23 vjet rresht, duke u mësuar atyre besim, adhurim, edukatë dhe drejtësi... Ai ua mësoi të gjitha këto parime një nga një brenda një periudhe të

Nata e Kadrit është treguesi më i bukur i vlerës së lartë që gëzon Profeti ynë ﷺ, tek Allahu i Madhëruar. Pra, Allahu e do aq shumë Profetin tonë ﷺ, sa që i ka falur shpërblimin e njëmijë muajve brenda një nate.



gjatë kohore. Prandaj, të besosh se fëmijët tanë mund të marrin një edukim të tillë brenda pak muajsh, do të thotë të nënvlerësosh fenë dhe edukimin fetar.

Sot, për një profesion që do të shfrytëzohet më së shumti 30-40 vjet, midis moshës madhore dhe pensionit, konsiderohet e nevojshme të merresh me arsimim për 10-15 vjet. Sipas këtij krahasimi, sa kohë kërkohet për t'u përgatitur për jetën e përjetshme?

Padyshim, e gjithë jeta... Pra, duhet një edukim i ndërthurur me Kuran dhe Sunet prej djepit në varr. Për këtë arsye, arsimit duhet konsideruar si një tërësi dhe, në çdo fazë të këtij arsimit, duhet të përpiqemi që fëmijët tanë të ruajnë vijën e Kuranit dhe Sunetit.

Ndarja dhe shpëputja e arsimit fetar nga arsimit tjetër; dedikimi i tij një fushe apo një grupi të ngushtë, është një sëmundje e periudhës së Tanzimatit. Gjatë periudhës së përmendur të Tanzimatit, të rinjtë u dërguan në Evropë, në mënyrë që ata të mund të merrnin një arsim evropian që do t'i shërbente përparimit ekonomik të Perandorisë Osmane.

Mirëpo, fatkeqësisht, ata u kthyen si "osmanë në grada, por francezë në zemër". Këto breza të tjetërsuar sollën fundin e Perandorisë Osmane. Siç pohon edhe njërit prej tyre, Fuad Pasha: Armiku nga jashtë, e këta të rinj të shturur nga brenda, e shkatërruan, e bënë gërmadhë atë shtet të madh.

Lidhur me edukimin e fëmijëve, nuk duhet harruar as fakti se:

*Nëse Kurani zbret
në zemrën dhe jetën
tënde, bëhesh më i
miri prej njerëzve.
Bëhesh një "njeri i
mëshirës" nga dora,
gjuha dhe zemra
e të cilit përhapet
vetëm mëshirë.*



Është e natyrshme që jo çdo fëmijë mund të bëhet një dijetar Islam. Mirëpo, edukimi i njerëzve të dijes dhe udhëzimit për vazhdimin e detyrës së urdhërimit në punë të mira dhe kumtimit të Islamit, është gjithashtu një farz kifaje për umetin.

Për shkak se arsimit është një fushë me firo të mëdha, mund të jetë e nevojshme të investohet në 100 fëmijë në mënyrë që të dalë një dijetar i mirëfilltë.

CILI ËSHTË EDUKIMI MË I MIRË?

Meqenëse edukimi më i mirë është njo-hja e Allahut dhe Librit të Tij, atëherë çdo besimtar e ka për detyrë t'i japi vlerën e duhur edukimit dhe arsimimit në këtë fushë. Ky edukim është edhe kushti i kryerjes së detyrës së kumtimit të fesë, sepse kumtimi është një shërbim aq i madh, saqë i Dërguari i Allahut ﷺ, i thotë kështu Aliut ﷺ:

“O Ali! Nëse Allahu e udhëzon dikë përmes teje, kjo është më e vyer për ty sesa gjithçka mbi të cilën lind dielli!” (Hakim, Mustedrek, III, 690.)

Mirëpo, ta lësh këtë mirësi dhe të mendosh që;

“Nëse fëmija im nuk arrin në disa profesione dhe pozicione të kësaj bote, atëherë le të bëhet hoxhë”, tregon jo vetëm një përçmim të detyrës së udhëzimit dhe kumtimit të fesë, por edhe moskuptimin e vlerës së vërtetë të kësaj detyre.

Ky gabim, më së shumti buron prej shqetësimit më tepër për jetën e fëmijës në këtë botë, sesa për atë të botës tjetër. Mirëpo, kjo nuk e ndihmon aspak fëmijën, por përkundrazi e dëmton atë në të dyja botët.

خيركم من تعلم القرآن وعلمه

“Më i miri prej jush, është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve!” (Buhari, Fedailu'l-Kuran, 21.) *Ky përgëzim, nuk është vetëm një lavdërim, por në të njëjtën kohë, është edhe një motivim; është synimi për të qenë udhëzues dhe prijës të të devotshmëve.*

Detyra e një nëne, është të ushqejë fëmijën e vet. Por, nëse aty ku gjendet ka shpërthyer zjarri, detyra më urgjente e saj, është të marrë një kovë ujë dhe të shuajë zjarrin. Përndryshe, zjarri do të përfshijë edhe atë, edhe fëmijën e saj. Dhe, ushqyerja e atij fëmije nuk do të kishte më kuptim!..

E në fakt, sot shohim zjarrin e injorancës në çdo anë...

KUSH DO TA FIKË?

Çfarë budallallëku i trishtë është të injorosh këto zjarre, të mos përpiqesh t'i shuash, por prapë të mbytesh në shqetësimet e thjeshta për të ardhmen në këtë botë! Ky budallallëk djeg edhe prindërit, edhe fëmijët!

Çfarë është shuarja e këtij zjarri? Është pajisja e fëmijëve tanë me edukimin Islam që do t'i shpëtojë ata nga zjarri.

Me pak fjalë, është e detyrueshme që të gjithë të bëjnë përpjekje për të pëmbushur detyrën e urdhërimit në punë të mira dhe pengimit nga e keqja deri në frymën e tyre të fundit, deri në varr.

Këtë domosdoshmëri; pra, faktin se sa krim i rëndë është të braktisësh detyrën e urdhërimit në të mirë, e shpreh më qartë përfundimi që pësuan Sahabët e Sebtit (populli i të shtunës), që ishin një bashkësi hebreje.

Populli i të shtunës, ishte një bashkësi hebreje, të cilëve të shtunave u ishte ndaluar peshkimi. Mirëpo, ndërkohë që një pjesë e tyre e respektonin këtë ligj,

*Tre lloj njerëzish
janë larg Allahut:*

- Ata që i ikin shërbimit në rrugën e Tij duke llogaritur rehatinë e vet.
- Ata të cilët qëndrojnë larg të vuajturve dhe skamnorëve duke u justifikuar se janë të ndjeshëm.
- Ata të cilët shoqërohen me njerëzit zullumqarë.



një pjesë tjetër e shkelën këtë ligj duke u mashtruar nga shejtani i cili u thoshte se: “Juve nuk ju është ndaluar gjuetia, por ngrënia!”. E në fakt, si domosdoshmëri e sprovës, të shtunave peshku shtohet në masë të madhe. Për këtë arsye, populli i nda në tri grupe:

Grupi i parë, nuk iu bind urdhrin të Allahut dhe vazhduan të gjuajnë peshk. Më pas, ata edhe hëngrën vetë, edhe shitën. Këta e hidhnin rrjetën të shtunën dhe e nxirrnin të dielën.

Grupi i dytë, nuk u treguan të pabindur dhe nuk peshkuan ditën e shtunë, por gjithsesi heshtën përballë atyre që e thyen urdhrin hyjnor, duke mos i këshilluar e qortuar.

Grupi i tretë, e zbatuan urdhrin hyjnor që u erdhi dhe i këshilluan e qortuan ata që nuk u treguan të bindur. Ndërsa atyre që heshtnin, u thanë se nuk po vepronin drejtë. Pra, ata u përpoqën të urdhëronin në të mirë.

Ata që heshtnin, këtyre që urdhëronin për mirë, u thoshin:

“Përse e këshilloni popullin që Allahu do ta zhdukë ose do ta ndëshkojë ashpër?!”

Kurse ata që urdhëronin për të mirë, u përgjigjeshin:

“Për t’u arsyetuar para Zotit tuaj dhe për t’i ruajtur ata nga gjynahet!”

Më vonë, këta që heshtën ndaj gjynaheve të tyre, ngritën një mur ndarës ndërmjet pjesës së pabindur, me qëllim që të

Një nga cilësitë e popujve të mallkuar nga Allahu, është edhe kjo:

“(Ata) nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!”

(Maide, 79.)



mos i prekte fatkeqësia e cila do t'u binte atyre. Pas një farë kohe, zërat e njerëzve në anën tjetër të murit, u prenë. Kur ç'të shohin, pjesa e pabindur qenë kthyer të gjithë në majmunë brenda një nate! Ata filluan të vijnë vërdallë me pamje majmuni, të zymtë e të pashpresë dhe, pas tri ditësh vdiqën të gjithë. Të njëjtin përfundim pësuan edhe ata që heshtën dhe nuk i qortuan të pabindurit.

Kjo ngjarje, në Kuranin Fisnik, tregohet në këtë mënyrë:

“Pyeti ata për qytetin që gjendej në bregdet dhe për çfarë i gjeti banorët e tij kur thyen urdhëresën e Sabatit (së sh-tunës)! Atë ditë u vinin peshqit me shumicë, ndërsa ditëve tjera që nuk i kremtonin, nuk u vinin. Kështu, Ne i vumë në provë, sepse bënin punë të mbrapshta.

Kur disa prej tyre thanë: «Përse e këshilloni popullin që Allahu do ta zhdukë ose do ta ndëshkojë ashpër?!» Këshilltarët u përgjigjën: «Për t'u arsyetuar para Zotit tuaj dhe që ju të mund të ruheni nga gjynahet!».

Detyra më e rëndësishme që duhet bërë për të eliminuar injorancën në kohën tonë, është edukimi dhe ndërtimi i njerëzve me personalitet.



Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuam ata që këshillonin, kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre. Kur ata ngulmuan me mendjemadhësi, të bënin atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: «Bëhuni majmunë të përbuzur!» (Araf, 163-166.)

Allahu i Madhëruar, thotë se kjo ndodhi, është një mësim për njerëzit:

“Këtë dënim e bëmë paralajmërim për bashkëkohësit dhe për brezat e tyre

pasardhës, si dhe këshillë për ata që i frikësohen Allahut.” (Bekare, 66.)

Ndërsa në një ajet tjetër, lidhur me cilësitë e popujve të mallkuar nga Allahu, urdhërohet:

“(Ata) nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!” (Maide, 79.)

Përkundër këtyre, njerëzit e devotshëm të popujve të hershëm, janë njohur me cilësinë e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja dhe kanë gëzuar lëvdatat hyjnore:

“Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit, e urdhërojnë të mirën, e ndalojnë të keqen dhe nxi-tojnë për të bërë punë të mira. Këta janë ndër të drejtët.” (Ali Imran, 114.)

Edhe sot ka shumë elementë në shoqërinë tonë që duhet të korrigjohen. Ka shumë që privohen nga arsimi Islam dhe kanë mbetur në duart e injorancës. Ne nuk mund të qëndrojmë indiferentë ndaj këtyre. Nëse qëndrojmë, do të jemi përgjegjës.

PËR ÇDO MIRËSI DO TË JEPET LLOGARI!

Ne jemi të detyruar të paguajmë çmimin e dhuntive që na janë dhënë, sepse ditën e kiametit do të na thuhet:

“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra, 14.)

Sidomos sot, nuk është e lejueshme për njerëzit të cilëve Allahu i Madhëruar i ka bekuar dhe u ka dhënë njohuri dhe



Gjatë kryerjes së detyrës së kumtimit, është e nevojshme të përpiqemi me vendosmëri dhe entuziazëm, qoftë edhe nga e para, pa u ankuar për situatën shterpë dhe negative që mbizotëron sot.

aftësi, të qëndrojnë mënjanë si të ngratët dhe të moshuarit e dobët. Nuk është e drejtë që një person i arsimuar të qëndrojë i mbyllur në shtëpinë e tij, qoftë edhe për agjërime apo adhurim.

Tre lloj njerëzish janë larg Allahut:

- Ata që i ikin shërbimit në rrugën e Tij duke llogaritur rehatinë e vet...

- Ata të cilët qëndrojnë larg të vuajturve dhe skamnorëve duke u justifikuar se janë të ndjeshëm...

- Ata të cilët shoqërohen me njerëzit zullumqarë...

Përpyekjet në rrugën e kumtimit të fesë dhe urdhërimit në punë të mira, janë një lloj pagese e çmimit të dhuntive. Është një përpjekje për të shprehur mirënjohjen për udhëzimin e dhënë nga Allahu i Madhëruar, sepse, mirënjohja për çdo bekim vjen nga lloji i vet. Çmimi i bekimit të udhëzimit,

është përcjellja e asaj drite udhëzimi për ata që janë të privuar nga ajo. Kandili i udhëzimit duhet të qarkullojë nga dora në dorë, duke ndezur dritën e besimit në zemrat e mira, por të privuara. Është gjynah të ndërpresësh këtë zinxhir, domethënë, të mos e çosh udhëzimin më tej.

Edhe individi, edhe shoqëria që e pagan këtë çmim, mbushet me paqe. Në të kundërtën, nëse nuk realizohet udhëzimi, shoqëria mbushet me përbindësia, sepse nëse nuk edukohet shpirtërisht, njeriu rrokulliset në “esfel-i safilin”/më të ulët in e të ulëtëve. Bie në një pozitë më të ulët se kafshët dhe egërsohet.

*Çobani nuk ua lë
ujqve as edhe një
qengj të sëmurë apo
të plagosur, por e
merr në krahë dhe e
bashkon me tufën. Ai
e kontrollon gjithmonë
tufën për të cilën
është përgjegjës, duke
i ardhur herë nga
përpara, e herë nga
prapa.*



Përpjekja në rrugën e urdhërimit në punë të mira, nëse nuk mund ta ulë në zero, të paktën e zvogëlon këtë të keqe. Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve tanë nga përbindëshat; pra prej mohimit dhe gjynaheve, Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Të gjithë jeni çobanë; të gjithë jenë përgjegjës për tufën tuaj...” (Buhari, Istikradh, 20.)

PËRGJEGJËSIA JONË SI ÇOBANË

Çfarë pune bën çobani?

Çobani e lëshon tufën e tij në kullotë, e mban të pushojë dhe e ushqen atje. Pra, nuk e fut atë në tokë të shkretë. Nga kjo, mësojmë se; ne duhet t'i rrisim fëmijët tanë në mjedise të bukura dhe me atmosferë shpirtërore; pra t'i edukojmë me dije dhe moral Islam, me qëllim që ta bëjmë jetën e tyre të përtejme një kopsht xheneti.

Çobani e mbron tufën e tij nga ujqërit dhe përbindëshat. Po kështu, edhe ne duhet t'i mbrojmë fëmijët tanë nga filozofit e huaja helmuese. Po ashtu, çobani nuk ua lë ujqve as edhe një qengj të sëmurë apo të plagosur, por e merr në krahë dhe e bashkon me tufën. Ai e kontrollon gjithmonë tufën për të cilën është përgjegjës, duke i ardhur herë nga përpara, e herë nga prapa. Ndërsa ne, nga kjo mësojmë se; në shoqërinë tonë nuk duhet të lëmë askënd të privuar.

Ne duhet të jemi në gjendje t'i kthejmë zemrat tona në një strehë që do t'i përfshijë të gjithë. Ne gjithashtu, duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe brezit tonë dhe të meditojmë për arsytet

Ne duhet të jemi në gjendje t'i kthejmë zemrat tona në një strehë që do t'i përfshijë të gjithë. Ne gjithashtu, duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe brezit tonë dhe të meditojmë për arsytet e gabimeve që shohim tek ata.



e gabimeve që shohim tek ata. Po ashtu, si umeti i Profetit tonë ﷺ, i cili është “mëshirë për botët”, ne duhet të jemi plot mëshirë në zemrat tona. Qytetërimi i Epokës së Lumturisë u mbush në mënyrë të pakrahasueshme me këtë mëshirë. Çdo individ, i varfër apo i pasur, bëri një jetë të lumtur atë kohë. Në të njëjtën mënyrë, edhe periudha e Hulefa-i Rashidin ishte një klimë e përsosur e paqes shpirtërore.

Gjatë sundimit të Emevitëve dhe Abasidëve që pasuan, herë pas here, shohim figura të tilla si Omer bin Abdulazizi, të cilët shfaqën një nivel të lartë të përpjekjes në kumtimin e fesë dhe urdhërimit në punë të mira. Po ashtu, herë pas here, ka pasur periudha të njerëzve që u dhanë pas kësaj bote dhe u bënë robër të pasioneve të tyre. Fatkeqësisht, në kohë të tilla, kur është jetuar

për egon, edhe fatkeqësitë ndiqnin njëra tjetrën. Më pas, si rezultat i ndjekjes së modelit të sahabëve të Profetit ﷺ, tre shekujt e parë të Perandorisë Osmane ishin një periudhë suksesi dhe paqeje, në aspektin e ndjenjës së luftës në rrugën e Allahut dhe të ngritjes lartë fjalës së Allahut.

Në këtë periudhë, vendet e edukimit shpirtëror u bënë më të njohura. Këto shtëpi të shërimit të shpirtit, u bënë si qendra rehabilitimi. Zemrat gjetën paqe, të mbushura me entuziazmin e besimit dhe shërbimit. Me këtë entuziazëm, u krijuan edhe vakëfe të shumta me mendimin: “Si mund ta fitoj kënaqësinë e Allahut?” “Si mund t’ia zgjidh problemet vëllait tim mysliman?” “Si mund t’i shërbej Islamit në rrugën e Allahut?”, etj.

Një ditë të nxehtë, Profeti ynë ﷺ, kishte qëndruar për të pushuar në një vend të përshtatshëm. Një pjesë e sahabëve ishin me agjërim nafile dhe për këtë arsye ishin lodhur dhe i zuri gjumi. Kurse ata që nuk agjëronin shkuan të bartnin ujë për abdest dhe ngritën çadrat për të krijuar hije. Kur erdhi koha e iftarit Profeti ﷺ, tha:

“Ata që nuk agjëruan morën më shumë shpërblim se agjëruesit.” (Muslim, Sijam, 100-101.)



QYTETËRIMI I VAKËFEVE

Këto vakëfe kujdeseshin për të varfrit, të sëmurët, shërbyesit, të moshuarit dhe të pafuqishmit. Madje, duke tejkaluar qenien njerëzore, u shërbenin edhe krijesave të tjera; zogjve të dëmtuar, kafshëve të rrugës dhe pemëve të thara. Testamenti i mëposhtëm, është i mjaftueshëm për të dhënë një përmbledhje të botëkuptimit Osman në lidhje me kumtimin e fesë dhe ngritjen e fjalës së Allahut:

Orhan Gazi i dha këtë këshillë birit të tij, Muratit:

“Perandorisë osmane nuk i mjafton sundimi mbi dy kontinente, sepse kauza për lartësimin e fesë së Allahut është një kauzë aq e madhe, sa që nuk mund ta nxënë dy kontinente!”

Nisur nga kjo, Sulltan Murati kaloi në Evropë dhe përparoi deri në Kosovë.

Përse Murati i I. e prishi qetësinë e tij dhe shkoi deri në Kosovë, ndërkohë që kishte kaq shumë mirësi në Bursa? Për çfarë synimi e sakrifikoi veten e tij?

Sigurisht;

- Për të vazhduar me sinqeritet detyrën e kumtimit të fesë që na është lënë amanet nga i Dërguari i Allahut ﷺ.
- Sepse ai ndjente ankthin e zemrave të privuara nga udhëzimi.

Për rrjedhojë, edhe Allahu i Madhëruar i dha këtij sinqeriteti begatinë e frymëzimit shpirtëror dhe jetëgjatësi.



Sot, detyra e kumtimit të fesë, është më e rëndësishëm sesa adhurimi vullnetar. Mirëpo, pavarësisht këtij fakti, nëse është e mundur, është e nevojshme të mos neglizhohet as adhurimi vullnetar. Kjo, sepse energjia shpirtërore e shërbimit krijohet përmes adhurimit.

Kështu, tre shekuj më vonë, nga një tokë të vogël fisi, që zotëronte 400 kalorës në Iznik/Nikea, sundimi Osman u zgjerua në 24 milion kilometra katrorë. Kështu, Osmanët u bënë dinastia më jetëgjatë dhe më e pandërprerë në histori. Allahu i Madhëruar i begatoi ata me fitore dhe pëlqimin e vet për shkak se ata zbatuan ajetin fisnik ku përshkruhen cilësitë e besimtarëve:

“(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.” (Haxhxh, 41.)

Por, kur ajo vetëdije, ato sakrifica dhe ato përpjekje u braktisën, ndihma e Allahut u ndërpre, begatitë u zhdukën dhe uniteti e forca humbën. Kështu, bota Islame ra në situatën e mjerueshme që është sot. Për rrjedhojë, sot, ne kemi nevojë për ndihmën e Allahut më shumë se kurrë. Por, nuk ka asnjë arsye për t’u kapluar nga dëshpërimi, sepse në Kuran urdhërohet:

“...Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe!..” (Bekare, 249.)

Ne e kemi përjetuar këtë edhe më parë në historinë tonë:

Ndërkohë që numri i myslimanëve në Mekë arriti vetëm në dyzet vetë në gjashtë vjet, më pas numri i tyre arriti në 120,000 persona që mundën të vinin atje (në Mekë) vetëm në Haxhin e Lamtumirës. Ndi-hma dhe begatia e Allahut shfaqet atëherë kur zbatohet siç duhet ajeti në suren Fatiha:



*Osman Gazi, i drejtohet
me këto fjalët birit të tij,
Orhan Gazit:*

*“Kauza jonë nuk është
një çështje e zbrazët dhe
thjesht pushtim i botës,
por lartësimi i Fjalës
(fesë) së Allahut! Pra,
gëzoma shpirtin duke
mos e braktisur xhihadin,
luftën në rrugën e
Allahut!”*

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!” (Fatih, 5)

Pra, aq sa ne i bindemi Allahut të Madhëruar, aq do të jetë edhe ndihma e Tij ndaj nesh.

Kushti i parë për përmirësimin e shoqërisë, është që individët të cilët do të udhëzojnë shoqërinë, së pari duhet të ndërtojnë veten e tyre.

PAQJA NË BOTËN E BRENDSHME

Sepse personi që nuk mund të zgjidhë problemin e egos së vetë, është plot vesvese, iluzione dhe shqetësime. Hafiz Shirazi, në një poezi, e ka përkufizuar njeriun me këto fjalë:

“Njeriu; një pikë gjak, mijëra shqetësime”

Struktura materiale e njeriut; ajo që del nga toka; është pak gjak, mish, lëkurë, etj. Mirëpo, struktura kryesore që e bën atë të quhet njeri, është karakteristika e zemrës së tij. Njeriu i papërpunuar është plot shqetësime. Por, nëse i largon ato shqetësime, i është nënshtruar Allahut të Madhëruar. Prandaj, një besimtar duhet të jetë gjithmonë altruist, një njeri i dorëzuar ndaj Allahut. Ai duhet të ruhet prej problemeve me të cilat ballafaqohet, me anë të përpjekjes për të urdhëruar në punë të mira dhe për të ndaluar nga të këqijat. Kështu, forca e tij shpirtërore do të vazhdojë në rrugën e drejtë pa u tronditur dhe pa devijuar. Përndryshe, ai do të mposhtet nga iluzionet e botës së tij të brendshme dhe do të humbasë ekuilibrin.

Orhan Gazi i dha këtë këshillë birit të tij, Muratit:

“Perandorisë osmane nuk i mjafton sundimi mbi dy kontinente, sepse kauza për lartësimin e fesë së Allahut është një kauzë aq e madhe, sa që nuk mund ta nxënë dy kontinente!”



Shërbimet ndaj shoqërisë, janë gjithashtu të dobishme për të siguruar ekuilibrin në botën e brendshme të njeriut. Besimtarët, të cilët janë të shqetësuar nga trishtimi dhe zymtësia e injorancës së sotme, dhe që ndjejnë thellë besimin dhe devotshmërinë në zemrat e tyre, mund të kaplohen nga ndjenja e tërheqjes në një cep dhe të merren vetëm me adhurim. Mirëpo, në fenë tonë, adhurimet individuale dhe shoqërore urdhërohen veç e veç. Prandaj, plotësimi i njërit nuk na liron nga përgjegjësia e tjetrit. Le të kujtojmë edhe njëherë këtë ndodhi:

Një ditë të nxehtë, Profeti ynë ﷺ, kishte qëndruar për të pushuar në një vend të përshtatshëm. Një pjesë e sahabëve ishin me agjërim nafile dhe për këtë arsye ishin lodhur dhe i zuri gjumi. Kurse ata që nuk agjëronin shkuan të bartnin ujë për abdest dhe ngritën çadrat për të krijuar hije. Kur erdhi koha e iftarit Profeti ﷺ, tha:

“Ata që nuk agjëruan morën më shumë shpërblim se agjëruarit.” (Muslim, Sijam, 100-101.)

Nëse ruhet orientimi në rrugë të drejtë, pas një vdekjeje të bukur dhe të mirë, gëzohet një jetë e re, e lumtur dhe fatlume. Dhe ky është bajrami më i bukur.



Në ditët tona, po përjetohet sërish periudha e injorancës. Për rrjedhojë, sot, detyra e kumtimit të fesë, është më e rëndësishëm sesa adhurimi vullnetar. Mirëpo, pavarësisht këtij fakti, nëse është e mundur, është e nevojshme të mos neglizhohet as adhurimi vullnetar. Kjo, sepse energjia shpirtërore e shërbimit krijohet përmes adhurimit. Në fakt, kushti i parë për kumtimin, është pastrimi i botës së brendshme. Ajo që duhet bërë e qartë këtu, është se besimtari nuk duhet të jetë introvert dhe nuk duhet të mbetet larg shoqërisë.

Një nga parimet themelore të tasavufit, është që zemra të jetë vigjilente brenda shoqërisë dhe të kumtojë të vërtetën duke qenë bashkë me Allahun. Nga ana tjetër, adhurimet e kryera me sinqeritet përbushin detyrën e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat në botën e brendshme të njeriut. Në një ajet urdhërohet:

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.” (Ankebut, 45.)


Allahu i Plotfuqishëm na përmirësoftë leximin e Kuranit, duatë dhe dhikrin tonë. Zoti ynë na dhëntë mundësinë të pajisemi me virtytet shpirtërore të Profetit tonë ﷺ dhe të ndërtojmë veten me moralin e tij shembullor. Po ashtu, na dhëntë sukses në ndërtimin e personalitetit të fëmijëve tanë dhe mbarë njerëzimit...

Amin!..



Bajrami që vjen pas një Ramazani të bekuar, të kaluar në devotshmëri dhe në përputhje me kënaqësinë e Allahut, është si gëzimi i marrjes së një diplome.





UDHËZIMI dhe KUMTIMI

Kur Lumi Sakarja bashkohet me Detin e Zi, shkrihet tërësisht në të. Tashmë, ky lum nuk bart më vetitë e tij brenda detit, sepse karakteristikat e Sakarjas janë shkrire dhe ai është bërë njësh me Detin e Zi. E vërteta që tregon ky shembull, i ngjan sahabëve të cilët u bënë njësh me të Dërguarin e Allahut ﷺ. Tashmë, kënaqësia më madhe e jetës së tyre, ishte përjetimi dhe përcjellja e gjendjes shpirtërore të Profetit tonë ﷺ.



UDHËZIMI dhe KUMTIMI

KA NJË ÇMIM!

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun për ta adhuruar Atë. E, në mënyrë që njeriu ta përmbushë siç duhet këtë detyrë, Allahu i dhuroi atij shumë begati. Pra, asnjë njeri nuk i mori këto begati, të cilat janë mirësi hyjnore, duke paguar ndonjë çmim. Asnjëri prej nesh nuk arriti begatinë e krijimit duke paguar një çmim. Krijimi ynë si qenie njerëzore, nderimi me mirësinë e besimit dhe me të qenët umeti i Kuranit dhe Profetit të fundit, janë të gjitha begati dhe dhurata të jashtëzakonshme hyjnore që na jepen pa asnjë mund e çmim. Dhe, për këtë arsye ne do të mbajmë përgjegjësi në Ditën e Gjykimit për të gjitha begatitë që kemi përfituar, edhe pse i kemi marrë falas. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8.)

Shfaqja e Atributit hyjnor “el-Hadi” mbi ne, është një bekim i madh, sepse falë Tij ne arrijmë udhëzimin dhe bekohe mi me mirësinë e besimit. Mirëpo, në botën tjetër do të japim llogari në lidhje me mirënjohjen apo mosmirënjohjen që kemi treguar për këtë mirësi. Sa është sasia e këtij çmimi? Kufijtë minimalë të disa prej detyrave tona fetare janë të qarta. Për shembull, ne e njohim sasinë e zekatit që duhet të japim. Mirëpo, Zoti ynë nuk ka vendosur një kufi minimal për falënderimin ndaj begatave të panumërta materiale dhe shpirtërore që kemi. Prandaj, është thelbësore që ne të jetojmë fenë e Allahut dhe të përpiqemi ta përcjellim atë me sa fuqi dhe mundësi të kemi. Në një ajet fisnik urdhërohet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن تَنْصُرُوا اللَّهَ
يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.” (Muhammed, 7)

Realizimi i këtij ajeti, ka dy shkallë:

SË PARI PASTRIMI SHPIRTËROR:

a. Pastrimi i botës sonë të brendshme, sepse Allahu i Madhëruar urdhëron:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë!” (Shems, 9.)

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى

“I shpëtuar është ai që pastrohet.”

(A’la, 14.)

Allahu i madhëruar urdhëron; «أَحْسِنُوا».

Domethënë;

- Çdo punë që bën myslimani, duhet të jetë në mënyrën më të mirë.

- Myslimani duhet të jetë gjithmonë “muhsin”, duhet të dhurojë dhe të bëjë gjithmonë bamirësi.



Shembullin më të bukur të këtij pastrimi, e shohim tek sahabët dhe njerëzit e devotshëm. Kjo ngjarje e Epokës së Lumturisë, e shpreh shumë mirë rëndësinë e pastrimit të botës së brendshme:

Fushata e Tebukut ishte një fushatë ushtarake plot vështirësi dhe mundime. Ushtria Islame kishte përshkuar njëmijë kilometra vajtje-ardhje. Kur po afroheshin në Medinë, njerëzit dukeshin sikur ishin transformuar. Ata ishin dobësuar shumë dhe flokët e mjekrat u ishin ngatërruar me njëra-tjetrën. Në një situatë të tillë, Profeti ﷺ u tha:

“Tani po kthehemi nga xihadi i vogël në xihadin e madh!..”

Shokët e pyetën me habi:

- O i Dërguari i Allahut! Gjendja jonë duket sheshit! A mund të ketë xihad më të madh se ky?

Profeti ﷺ, u tha:

“Tani po kthehemi në xihadin e madh, në luftën e robit me veten!” (Munavi, Fejdu'l-Kadir, III, 141/2873; Ali el-Muttaki, IV, 430/11260.)

Një besimtar, i cili është një udhëtar i përjetësisë, duhet të kryejë hapat e mëposhtëm të pastrimit dhe edukimit të zemrës dhe të sjelljeve që reflektohen prej saj:

Në këtë botë të përkohshme, besimtari e ka për detyrë të eliminojë;

- Sëmundjet dhe fatkeqësitë me durim,
- Harresën me dhikr,


Myslimani duhet të jetojë me vetëdijen e mirësisë. Gjithë jetën duhet të jetë i vetëdijshëm se është nën vëzhgimin e pandërprerë të Allahut të Madhëruar.



- Mosmirënjohjen me falënderim,
- Pabindshmërinë me bindje,
- Koprracinë me bujari,
- Egoizmin me altruizëm dhe vetëmohim,
- Dyshimin me siguri,
- Hipokrizinë me sinqeritet dhe modesti,
- Gjynahet me teube dhe
- Shkujdesjen me meditim.

Hapi i dytë për të jetuar dhe përcjellë fenë e Allahut, me qëllim që të arrihet ndihma e Tij, është që; pasi të kesh ndërtuar botën e brendshme, të bëhesh njeri i mëshirshëm ndaj botës së jashtme:

KUMTIMI I FESË ME ZEMËR TË PASTËR:



b. Të bëhesh shembull i bukur për njerëzit me fjalë dhe me vepra:

Kështu, për sa kohë që besimtari tregon devotshmëri ndaj Allahut, siç shprehet edhe Allahu në Kuran;

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!” (Fatiha, 5), ai do të meritojë ndihmën dhe mirësitë e Tij.

Sahabët e pastruan veten, dhe me këtë ego të pastruar, ata udhëtuan në një të tretën e botës në atë kohë, duke përcjellë Islamin në ato vise. Kështu, ata merituan ndihmën dhe suksesin e Allahut në këtë botë dhe kënaqësinë e Tij dhe Xhenetin

në botën tjetër. Përpjekja për ta mbajtur gjallë fenë e Allahut është ndër detyrat tona më të rëndësishme, shpërblimi i së cilës është Xheneti. Në suren Teube urdhërohet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.

(Këta janë) ata që pendohen, e adhurojnë Allahun, e falënderojnë Atë, agjërojnë, përkulen (në namaz), bien në sexhde (gjatë namazit), urdhërojnë vepra të mira, pengojnë të këqijat dhe u përmbahen kufijve të caktuar nga Allahu. Jepu lajmin e mirë besimtarëve!” (Teube, 111-112.)

Allahu i Madhëruar, pronën dhe jetën na e ka lënë neve amanet. Mirëpo, në frymën e fundit, Ai do t’i marrë që të dyja këto prej nesh. Prandaj, është e nevojshme që këto amanete të vlerësohen si një test besimi dhe të përdoren në rrugën e Allahut. Mirëpo, njerëzit e shkujdesur dhe dorështrënguar, nuk e shpenzojnë pasurinë në rrugën e Allahut, por bëhen robër të saj. Ndërkohë që me pasurinë që zotëron mund të fitojë Xhenetin në botën tjetër, ai e shndërron atë në një vështirësi që do t’ia komplikojë llogaridhënien Ditën e Gjykimit.

Ja si e shpreh Ebu Dherri ﷺ, këtë fakt:

“Një mall ka tre ortakë:

I pari, është i zoti i mallit, pra, ti.

Prandaj, zgjidhja e duhur për të parandaluar rrëshqitjen e këmbës në frymën e fundit, është të jetoni dhe të mbani gjallë fenë e Allahut për një jetë të tërë, domethënë; të bëni përpjekje vetëmohuese gjatë gjithë jetës për të pastruar botën e brendshme dhe për të kryer detyrën e kumtimit të fesë.



I dyti, është kaderi (caktimi). Se çfarë do të të sjelli (ai mall), mirësi apo fatkeqësi, nuk të pyet ty.

Ndërsa i treti, është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh) dhe, pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të.

Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!..” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163.)

Për këtë arsye, një nga kushtet më të rëndësishme për të qenë mik i Allahut është bujaria, domethënë shtimi i dhurimeve në rrugën e Allahut.

SHTIMI I DHURIMEVE NË RRUGËN E ALLAHUT

Ibrahimi عليه السلام, është shembulli ynë më i bukur në lidhje me sprovën e jetës, pasurisë dhe fëmijës.

Ibrahimi عليه السلام;

- Ishte gjithmonë i gatshëm të sakrifikojë pasurinë dhe sofra e tij u begatua,

- Ishte gjithmonë i gatshëm të sakrifikojë jetën dhe zjarri u shndërrua në trëndafilishte,

- Ishte gjithmonë i gatshëm të sakrifikojë fëmijën dhe Allahu i bëri profetë të dy fëmijët e tij. Prej gjakut të Ishakut عليه السلام, erdhën shumë profetë për Beni israilët dhe prej gjakut të Ismailit erdhi Muhamedi صلى الله عليه وسلم, si profet për gjithë njerëzimin.

Ja pra, kujtimi më i bukur i Allahut për mikun e Tij!

Urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat, është një vepër e nderuar e kryer nga Vetë Allahu i Madhëruar. “Në të vërtetë Allahu; Urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” (Nahl, 90.)



Edhe vetë Profeti ynë ﷺ, ka dëshiruar që Ibrahimin ﷺ, ta kujtojmë në çdo namaz.

Ka'b bin Uxhre رضى الله عنه tregon:

Një ditë, i thamë të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“O i Dërguari i Allahut! Ne e mësua se si të të japim selam, por nuk e dimë se si të të dërgojmë salavate?” Ai tha kështu:

“O Zoti im! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e Muhammedit ashtu siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Padyshim që Ti e meriton të lavdërohesh dhe je i lartë. O Zoti im! Begatoje Muhamedin dhe familjen e Muhammedit siç ke begatuar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Padyshim që Ti e meriton të lavdërohesh dhe je i lartë.” (Buhari, Deauat, 32; Tirmidhi, Vitri, 20; Ibn Maxhe, Ikame, 25.)

Profeti ynë ﷺ, dëshiron që ne të mendojmë dhe të kërkojmë mëshirën dhe bekimet që Allahu i Madhëruar i dha Ibrahimit ﷺ dhe pasardhësve të tij. Po ashtu, ai i tregon si ideal për ne, profetët, të devotshmit, dëshmorët dhe njerëzit e drejtë.

Duhet të mendojmë:

- Çështë ajo që duam më shumë në këtë botë?
- Si kush dëshirojmë të bëhemi?

Në fund të ajetit 7 në suren Muhammed, urdhërohet: “do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja”...

“Mjerë për njerëzit, për trazirat që po afrohen me furi. Njerëzit do të gdhihen si besimtar në mëngjes dhe do të ngrysen si mohues në mbrëmje. Njerëzit do ta ndryshojnë fenë e tyre në këmbim të një përfitimit të vogël të kësaj bote. Ata që mund të qëndrojnë të patundur në fenë e tyre në një kohë të tillë, janë si ata që mbajnë prush në duart e tyre.”

(Ahmed, II, 390.)



Kjo nënkupton se; kjo jetë, afatin e së cilës nuk e njohim, duhet të jetohet me një kujdes të jashtëzakonshëm, sikur të ishim duke kaluar mbi një fushë të minuar. Një vepër e gabuar, mund ta tronditë besimin sikur të kishe shkëlur mbi ndonjë minë në atë fushë. E për pasojë, do ta shkatërronte jetën e njeriut. Shembull i kësaj janë zgjedhjet që bënë Karuni dhe Bel'am bin Baura. Këtë gjendje, e cila do të shtohet edhe më tepër në kohën afër kiametit, Profeti ynë ﷺ, e ka shprehur me këto fjalë:

“Mjerë për njerëzit, për trazirat që po afrohen me furi. Njerëzit do të gdhihen si besimtar në mëngjes dhe do të ngrysen si mohues në mbrëmje. Njerëzit do ta ndryshojnë fenë e tyre në këmbim të një përfitimit të vogël të kësaj bote. Ata që mund të qëndrojnë të patundur në fenë e tyre në një kohë të tillë, janë si ata që mbajnë prush në duart e tyre.” (Ahmed, II, 390; shih. Muslim, Iman 186; Tirmidhi, Fiten 30, [2196])

Hilali, Ka'bi dhe Murare ﷺ, ishin që të tre sahabë të cilët kishin marrë pjesë në të gjitha betejat para asaj të Tebukut. Por, pavarësisht kësaj, ata u përballën me një qëndrim të tillë nga ana e myslimanëve vetëm sepse e neglizhuan njëherë pjesëmarrjen në luftë.



Në këtë botë, kemi ardhur të udhëzuar në saje të atributit hyjnor “el-Hadi”. Mirëpo, askush nuk e ka të garantuar nëse edhe frymën e fundit do ta japë i udhëzuar në saje të këtij atributi madhështor të Allahut, i Cili na urdhëron:

وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ

“...Mos vdisni vetëm se duke qenë myslimanë!” (Al-i Imran, 102)

Prandaj, zgjidhja e duhur për të parandaluar rrëshqitjen e këmbës në frymën e fundit, është të jetoni dhe të mbani gjallë fenë e Allahut për një jetë të tërë, domethënë; të bëni përpjekje vetëmohuese gjatë gjithë jetës për të pastruar botën e brendshme dhe për të kryer detyrën e

kuntimit të fesë. Urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat, është një vepër e nderuar e kryer nga Vetë Allahu i Madhëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Në të vërtetë Allahu;

- Urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit,
- si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën.

Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” (Nahl, 90.)

CILËSI PROFETIKE

Kuntimi i fesë, është një nga cilësitë dhe detyrat profetike. Lidhur me këtë cilësi të Profetit tonë ﷺ, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (Araf, 157.)

Profeti ynë ﷺ, e kreu detyrën e kuntimit me vetëmohim, me dashuri dhe entuziazëm gjatë gjithë jetës së tij, duke duruar të gjitha llojet e vuajtjeve, talljeve, fyerjeve, kërcënimeve, shtypjeve dhe torturave të ngjashme nga politeistët.

Ne nuk duhet të harrojmë se, secili prej nesh ndodhet në një lloj beteje të Tebukut. Prandaj, ato që bëjmë në rrugën e Allahut nuk duhet t’i konsiderojmë të mjaftueshme, por duhet të vazhdojmë të shërbejmë deri në frymën e fundit.



Ky kujtim i Tarik bin Abdullahut ﷺ, është një shembull domethënës i vuajtjeve të shumta që ka kaluar Profeti ynë ﷺ, në rrugën e kumtimit të fesë:

E pata parë të Dërguarin e Allahut ﷺ, në panairin e Dhulmexhazit, të veshur me një rrobe të kuqe, tek po u fliste njerëzve me zë të lartë:

“O njerëz! Thoni “La ilahe il-lallah (Nuk ka zot tjetër veç Allahut) dhe shpëtoni!”

Një burrë që mbante një gur në dorë, e ndiqte dhe bërtiste me të madhe:

“O njerëz! Kurrë mos iu bindni atij, sepse ai është gënjeshhtar!”

Profetit ﷺ, i ishin përgjakur këmbët nga gurët që kishte hedhur ai.

I pyeta të pranishmit:

- Kush është ky person?

- Është një i ri nga bijtë e Abdulmutalibit. – Më thanë.

- Mirë, po ai që e ndjek dhe e qëllon me gurë, kush është? – i pyeta.

- Është i xhaxhai i tij, Ebu Lehebi! – Më thanë. (Hakim, II, 668; Ibni Ethir, Usdu'l-Gabe, III, 71)

Ndërsa një tjetër ngjarje që ka të bëjë me vështirësitë që përballoi Profeti ynë ﷺ, në kumtimin e Islamit, e tregon Mudrik el-Ezdiu ﷺ:

Lidhur me ata që nuk shkuan nga luftë, Allahu urdhëron: “...

Largohuni prej tyre! Ata janë të ndyrë...”

(Teube, 95) Kurse

Profeti ﷺ, ka thënë: “Mos qëndroni pranë tyre!”



Po bëja haxh së bashku me tim atë. Kur bujtëm në Mina, pamë një grup njerëzish dhe e pyeta tim atë:

- Pse është mbledhur ky grup njerëzish?

- Për atë personin i cili e ka braktisur fenë e fisit! – më tha babai.

Pashë në atë anë që më bëri me shenjë im atë, dhe dallova të Dërguarin e Allahut ﷺ, i cili u bënte zë njerëzve:

“O njerëz! Thoni “La ilahe il-lallah” dhe shpëtoni!”

Mirëpo, nga të pranishmit, dikush e pështynte në fytyrë, dikush i hidhte dhë në kokë, e dikush tjetër e fyente. Kjo gjendje vazhdoi gjer në drekë. Në atë mes, erdhi një vajzë me jakë të hapur që mbante një enë me ujë dhe një shami në duar. Ajo po qante. I Dërguari i Allahut ﷺ, e mori enën dhe piu ujë, pastaj lau duart dhe fytyrën. E ngriti kokën dhe i tha vajzës:

“Bija ime, mbuloje qafën me shaminë e kokës! Dhe mos ki frikë për tët atë se mos bjerë në kurth, vritet a turpërohet!”

Pyeta se kush ishte ajo vajza që kishte ardhur.

- Është e bija, Zejnebja! – Më thanë.

Profeti ynë ﷺ, u gurëzua në Taif, ku shkoi të predikonte. Këmbët e tij të bekuara u mbuluan me gjak. Por, ai nuk i mallkoi njerëzit që e goditën me gurë. Përkundrazi, ai tregoi mëshirë për ta, u lut për njerëzit e atij qyteti dhe për udhëzimin e brezave që do të vinin pas tyre.

Ata që u justifikuan me nxehtësinë e motit gjatë fushatës së Tebukut, Allahu u përgjigjet: “Xhehenemi është më i nxehtë!”

(Teube, 81.)



Profeti ﷺ, u godit me gurë në rrugën e Allahut, u dëbua nga atdheu i tij dhe herë herë ka lidhur gur në barkun e tij të bekuar për shkak të urisë. Por, ai vazhdoi të predikonte pa shfaqur dëshpërim ose lodhje. Ai nuk tha kurrë, “Të pushoj pak; të marr një pushim të shkurtër për një javë, dhjetë ditë...” Ai nuk bëri asnjë ditë pushimi, sepse pushimi i vërtetë fillon në varr.

ÇLODHJA DO TË BËHET NË VARR!

Edhe sahabët e Profetit ﷺ, vepruan me të njëjtin botëkuptim. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, u tha: “Kush do t’ia çojë këtë letër mbretit të Bizantit, Herakliut?”, sahabët, të rinj e të moshuar, u ngritën në këmbë dhe thanë: “O i Dërguar i Allahut! Ma jepni mua këtë nder!”

Ata nuk u shqetësuan asnjëherë duke menduar: “Si t’i kapërcejmë këto shkretëtira të paana dhe këto male të thepisur? Si do t’ia lexojmë letrën mbretërve pranë xhelatëve të tyre që u rrinë gati?”

Dashuria dhe entuziazmi për të bartur letrat Profetit të Allahut ﷺ dhe për të kumtuar fenë e Allahut, i bënte ata të mos e mendonin fare vdekjen. Dëshira e tyre e vetme, ishte të arrinin dashurinë dhe pëlqimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Për më tepër, Profeti ynë ﷺ, i porosiste përherë sahabët në lidhje me botën tjetër, duke thënë:

“Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!”

(Buhari, Xhihad, 110.)

Namazet farz kanë një numër dhe kohë të caktuar. Edhe agjërimi ka një kohë të caktuar. Po ashtu, edhe Haxhi që është farz, bëhet një herë në jetë. Nëse e bën më tepër, është thjesht sevap. Mirëpo, në përmbushjen e detyrës së urdhërimit në punë të mira, ndalimit nga të këqijat dhe udhëzimit të zemrave, nuk ka kohë specifike dhe të kufizuara. Pavarësisht për sa kohë mund të kryhet, asnjëherë nuk mund të thuhet; “Mjaft tani!”



Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka treguar shqetësimin në lidhje me botën e varrit, duke i bërë shpesh këto dua:

اللَّهُمَّ لَا عَيْشَ إِلَّا عَيْشُ الْآخِرَةِ

“O Allah! Strehohem tek Ty nga dënimi i varrit dhe i zjarrit (xhehenemit)!” (Buhari, Ezan, 149.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ashtu siç e kumtoi Islamin përgjatë gjithë jetës së tij profetike, i dha rëndësi të madhe edhe veprimtarisë së edukimit dhe përgatitjes së kuadrove që do të kumtonin Islamin.

Profeti ﷺ, i donte shumë edhe muhaxhirët, edhe ensarët. Mirëpo, ai u angazhua më tepër me sahabët e suffes, duke i edukuar ata në çdo aspekt. Kjo, sepse ata do të bëheshin kuadrot e kualifikuar, të cilët do të kumtonin Islamin në katër anët e botës.

Sahabët e suffes përbëheshin prej njerëzve të varfër pa shtëpi e katandi. Ata nuk morën dije me laps e me letër, por me zemër e shpirt. Sinqeriteti dhe devotshmëria e tyre, i bëri që, çdo ajet ta zbatonin me përpikëri dhe entuziazëm të madh. Për shembull, kur zbriti ajeti për të dhuruar në rrugën e Allahut, ata shkuan në mal për dru dhe, paratë që fituan nga shitja e tyre ia dorëzuan të Dërguarit të Allahut ﷺ. E ndërkohë, vetë ishin gjysmë të zhveshur. Mirëpo, pavarësisht kësaj, ata nuk thanë asnjëherë, “unë jam i justifikuar”, por, u munduan me të gjitha forcat që të bëheshin pjesë e lavdërimeve dhe shpërblimeve që premtonte Allahu në Kuran.

Sahabët shpëtuan nga errësira e injorancës falë Kuranit, Dritës që zbriti në shkretëtirë, i cili është dhurata e Allahut dhe në saje të Profetit tonë ﷺ, i cili ishte Mëshirë për të gjithë botën. Ata, gjithashtu, iu përkushtuan çrrënjësjes së errësirës së injorancës në vendet e tjera, duke u përhapur nëpër botë.



Ai që i bëri ata të fitojnë këtë vetëdije, ishte i Dërguari i Allahut ﷺ. Në Kuran urdhërohet:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun!..” (Al-i Imran, 110.)


Profeti ynë ﷺ, i pajisi me dije dhe frymëzim shpirtëror njerëzit që do ta përmbushnin këtë detyrë. Më pas, ai i dërgoi ata si përfaqësues tek mbretërit e kohës. Ata ishin aq të ndërgjegjshëm dhe entuziastë, sa që detyrën e urdhërimit në punë të mira, e perceptuan gjithmonë si mirësinë më të madhe të jetës së tyre.

Kur Lumi Sakarja bashkohet me Detin e Zi, shkrihet tërësisht në të. Tashmë, ky lum nuk bart më vetitë e tij brenda detit, sepse karakteristikat e Sakarjas janë shkrirë dhe ai është bërë njësh me Detin e Zi. E vërteta që tregon ky shembull, i ngjan sahabëve të cilët u bënë njësh me të Dërguarin e Allahut ﷺ. Tashmë, kënaqësia më madhe e jetës së tyre, ishte përjetimi dhe përcjellja e gjendjes shpirtërore të Profetit tonë ﷺ.

Ata gjithmonë thanë;

“Urdhëro o i Dërguar i Allahut! Të qofshin falë jeta, pasuria dhe çdo gjë që kemi!”

Si arriti i dërguari i Allahut ﷺ, t'i edukonte sahabët e vet me këtë vetëdije?



KUJTIME NGA TEBUKU

Fushata ushtarake e Tebukut kishte filluar të organizohej në stinën më të nxehtë, në kohën kur vileshin hurmat. Armiku me të cilin do të përballleshin, ishte Bizanti, një prej superfuqive të kohës. Ndërsa udhëtimi për në fushën e betejës zgjaste tre muaj. Ndërkohë, një prej vështirësive të tjera, ishte edhe dezinformimi që përhapnin hipokritët. Si rezultat i të gjitha këtyre vështirësive, kjo betejë u quajt “Gazvetu’l-Usra / Beteja e vështirësive”.

Sahabët si; Ebu Bekri dhe Osmani رضي الله عنهما, kishin shpenzuar pasuritë e tyre në përgatitjen e ushtrisë për këtë betejë. Ndërsa sahabët me pamundësi ekonomike, shkuan duke qarë tek Profeti صلى الله عليه وسلم, me qëllim që t’i ndihmonte të siguronin pajimet e duhura, e të mos mbeteshin pas të tjerëve.

Nga ana tjetër, hipokritët, treguan fytyrën e tyre të pacipë duke nxjerrë lloj-lloj justifikimesh me qëllim që të mos merrnin pjesë në luftë. Ndërkohë, në këtë situatë, u sprovuan edhe disa besimtarë të sinqertë. Njëri prej këtyre, ishte Ebu Hajthema رضي الله عنه, i cili për shkak të neglizhencës, fillimisht qëndroi në Medinë dhe nuk iu bashkua ushtrisë.

Në një nga ditët pasi ushtria Islame ishte nisur, atë e thirri familja në verandën e oborrit, që të hante një ushqim të zgjedhur. Kur Ebu Hajthema رضي الله عنه, pa ushqimin që ishte përgatitur për të, menjëherë i vajti mendja tek i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم dhe sahabët në shkretëtirën e nxehtë. Zemra e tij u drithërua dhe i tha vetes:

Njerëzit e shkujdesur dhe dorështrënguar, nuk e shpenzojnë pasurinë në rrugën e Allahut, por bëhen robër të saj. Ndërkohë që me pasurinë që zotëron mund të fitojë Xhenetin në botën tjetër, ai e shndërron atë në një vështirësi që do t’ia komplikojë llogaridhënien Ditën e Gjykimit.



“A është e drejtë kjo që po bëj unë, ndërkohë që ata po vuajnë në rrugën e Allahut në këtë të nxehtë?!”

Aty u vetëdijesua plotësisht për gabimin që kishte bërë. Pa e prekur fare ushqimin, doli menjëherë për udhë dhe u bashkua me ushtrinë në Tebuk. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, e pa që kishte ardhur, u gëzua dhe i tha:

“O Ebu Hajthema! Për pak sa nuk je shkatërruar!..”

Më pas, Profeti ﷺ, iu lut Allahut që ta falte Ebu Hajthemen رضي الله عنه. (Ibn-i Hisham, IV, 174; Vakidi, III, 998.)

Kur ushtria u kthye nga Tebuku, i erdhi radha qëndrimit që do të mbahej ndaj atyre të cilët nuk kishin marrë pjesë në luftë. Këta ndaheshin në tre grupe:

Grupi i parë përbëhej nga myslimanë të sinqertë me arsyetime të drejta.

Grupi i dytë ishin hipokritët, të cilët u justifikuan me gënjeshtër. Lidhur me këta, Allahu i Madhëruar ka përdorur fjalë shumë të ashpra:

“**..Largohuni prej tyre! Ata janë të ndyrë...**” (Teube, 95)

Grupi i tretë, ishin besimtarët neglizhentë që ndoqën egon e tyre. Ata u penduan shumë para se Profeti ﷺ, të kthehej nga Tebuku. Madje, ata e lidhën veten në shtyllat e xhamisë dhe kërkuan falje. Më vonë, lidhur me ta u shpall një ajet dhe u falën.

Mirëpo, ishin edhe tre sahabë të tjerë, të cilët edhe pse ishin besimtarë të

Prej 120 mijë sahabëve që morën pjesë në Haxhin e Lamtumirës, vetëm një e pesta është varrosur në vendlindje. Pjesa tjetër shkuan dhe mbetën në vende të panjohura për ta më parë, vetëm e vetëm për të prezantuar fytyrën e qeshur të Islamit dhe për të kryer detyrën e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat.



mirë, nuk iu bashkuan ushtrisë, duke e shtyrë punën; jo sot po nesër. Pra, pa ndonjë arsye të vlefshme, ata nuk morën pjesë në betejën e Tebukut. Megjithatë, ata nuk gënjyen si hipokritët, por thanë të vërtetën: “Ne nuk morëm pjesë për shkak të neglizhencës sonë.”

Mirëpo, Profeti ynë ﷺ, nuk i fali këta sahabë, por u tha:

“Prisni derisa të zbresë ndonjë ajet!”

NDËSHKIMI I LARGIMIT NGA PËRPJEKJA NË RRUGËN E ALLAHUT

Këta tre sahabë u dënuan me bojkot shoqëror. Domethënë; me ta u ndërpre në të gjitha marrëdhëniet njerëzore, duke filluar që nga përshëndetja me selam. Përballë këtij trajtimi, atyre iu ngushtua toka. Aq, sa edhe gratë e tyre ishin si të huaja për ta. Nuk kishte mbetur më asgjë për të bërë. Për këtë arsye ata qanë ditë e natë dhe u bënë si qiri i shkrirë. Ata gabuan rëndë, por nuk u larguan nga sinqeriteti, drejtësia, besnikëria, dashamirësia, nënshtrimi, pendimi dhe teubeja. Kështu, kaluan në vuajtje pesëdhjetë ditë.

Më në fund, si shpërblim i thënies së të vërtetës dhe teubes së sinqertë, ata u falën nga Allahu dhe për ta u zbrit një ajet. Ndërsa lexonte ajetin, fytyra e bekuar e Profetit tonë ﷺ, shkëlqeu nga gëzimi si hëna katërmëdhjeshë. Më pas, i Dërguari i Allahut ﷺ, i dha lajmin e mirë Ka’b bin Malikut ﷺ, me këto fjalë:

Bijtë e Osmanit dhe Abasit ﷺ, shkuan në Semerkand. Vehb bin Keshhe ﷺ, shkoi në Kinë. Ukbe bin Nafi, shkoi në Kajravan. Kurse Ejub el-Ensariu shkoi deri në Stamboll dhe aty ra dëshmor.



“Urime për ditën më të bekuar që ke përjetuar që kur ke ardhur në këtë botë!”

Kur dëgjoji këto fjalë; në shenjë falënderimi për faljen hyjnore, Ka’b bin Maliku رضي الله عنه, tha:

“O i Dërguar i Allahut! Si falënderim për pranimin e teubes sime, dëshiroj ta ndaj pasurinë time për të varfrit për hir të Allahut dhe të Dërguari të Tij.”

Mirëpo, Profeti ﷺ, i tha:

“Është më mirë për ty që një pjesë të pasurisë të mos e shpërndash, por ta mbash për vete.”

Të gjitha imoralitetet që shkaktuan shkatërrimin e popujve të hershëm, mbizotërojnë sërish edhe sot; gjithë marrëzia e gjynaheve po shkatërrojnë tokën. Sot, po favorizohen të gjitha llojet e imoralitetit. Me fjalë të tjera, hapat e kiametit janë duke u shtuar. Megjithatë, është për shkak të lutjes së Profetit tonë ﷺ, që Zoti i Plotfuqishëm nuk e shkatërron plotësisht këtë umet.



Kjo ndodhi, e shpreh shumë bukur përgjegjësinë tonë të shërbimit në rrugën e Allahut. Në të njëjtën kohë, është një paralajmërim i madh për ata që neglizhojnë pa asnjë arsye përpjekjet e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga e keqja.

Ç’është e drejta;

Hilali, Ka’bi dhe Murare رضي الله عنه, ishin që të tre sahabë të cilët kishin marrë pjesë në të gjitha betejat para asaj të Tebukut. Por, pavarësisht kësaj, ata u përballën me një qëndrim të tillë nga ana e myslimanëve vetëm sepse e neglizhuan njëherë pjesëmarrjen në luftë.

Atëherë, si do të jetë halli ynë tek Allahu i Madhëruar nëse e neglizhojmë shërbimin dhe përpjekjen në rrugën e Tij?

Ne nuk duhet të harrojmë se, secili prej nesh ndodhet në një lloj beteje të Tebukut. Prandaj, ato që bëjmë në rrugën e Allahut nuk duhet t'i konsiderojmë të mjaftueshme, por duhet të vazhdojmë të shërbejmë deri në frymën e fundit.

RËNKIME TË HESHTURA

Veçanërisht, në kohën kur njerëzit bien në mosbesim dhe devijim nën rënkimet e heshtura si trungjet që vihen para nga përmbytjet, detyra e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga e keqja, është shumë e rëndësishme. Sahabët kaluan pikërisht nga këto sprova dhe e kuptuan thellësisht rëndësinë e kuntimit në rrugën e Allahut.

Me këtë vetëdije, ata lanë hurmat e ëmbla të Medinës dhe u shpërndanë në vende të ndryshme të botës. Për t'ia prezantuar fenë e vërtetë, Islamin, të gjithë njerëzimin, ata realizuan udhëtime të gjata dhe të vështira, pa e shfaqur lodhjen apo frikën.

Gjithashtu, nga ajeti i mëposhtëm, ata mësuan se devotshmëria ndaj Allahut dhe shërbimi ndaj fesë së Tij, duhet të vazhdohet deri në frymën e fundit:

وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 99)

Namazet farz kanë një numër dhe kohë të caktuar. Edhe agjërimi ka një kohë të caktuar. Po ashtu, edhe Haxhi që është farz, bëhet një herë në jetë. Nëse e bën më tepër, është



Edhe sot po përjetohet një epokë e re e injorancës në aspektin e njohjes së Allahut... Jemi në një periudhë ku po manifestohet plotësisht gjendja e prishur e shoqërisë, e cila konsiderohet ndër shenjat e vogla të kiametit. Në një situatë të tillë, shërbimi ndaj fesë së Allahut ka shumë herë më tepër shpërblime.

thjesht sevap. Mirëpo, në përmbushjen e detyrës së urdhërimit në punë të mira, ndalimit nga të këqijat dhe udhëzimit të zemrave, nuk ka kohë specifike dhe të kufizuar. Pavarësisht për sa kohë mund të kryhet, asnjëherë nuk mund të thuhet; “Mjaft tani!”. Kjo detyrë duhet vazhduar gjatë gjithë jetës deri në frymën e fundit.

“AHSINU!..” أَحْسِنُوا

Në fund të ajetit ku urdhërohet dhurimi për hir të Allahut dhe tërhiqet vëmendja prej rrezikut nga dhënia pas kësaj bote, Allahu i madhëruar urdhëron: «أَحْسِنُوا».

Domethënë;

- Çdo punë që bën myslimani, duhet të jetë në mënyrën më të mirë.

Ashtu si “vështirësia e punës” që i shtohet pagës së atyre që punojnë në vende të vështira dhe të rrezikshme, edhe Allahu i Madhëruar do t’u japë shpërblime më të mëdha atyre që i shërbejnë fesë në kohë të vështira.



- Myslmani duhet të jetë gjithmonë “muhsin”, duhet të dhurojë dhe të bëjë gjithmonë bamirësi.

- Myslmani duhet të jetojë me vetëdijen e mirësisë. Gjithë jetën duhet të jetë i vetëdijshëm se është nën vëzhgimin e pandërprerë të Allahut të Madhëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...” (Hadid, 4.)

Ja pra, kjo është harta e rrugës së myslimanit!..

Një mysliman me cilësi të tilla, është një personalitet të cilin çdokush do ta ad-

mirojë dhe, në këtë mënyrë do ta kumtojë edhe Islamin me moralin e tij.

Lidhur me këto përpjekje vetëmohuese në rrugën e kumtimit të Islamit, ka shembuj të panumërt:

Bijtë e Osmanit dhe Abasit رضي الله عنهما, shkuan në Semerkand. Vehb bin Kabshe رضي الله عنه, shkoi në Kinë. Ukbe bin Nafi, shkoi në Kajravan. Për më tepër, prej 120 mijë sahabëve që morën pjesë në Haxhin e Lamtumirës, vetëm një e pesta është varrosur në vendlindje. Pjesa tjetër shkuan dhe mbetën në vende të panjohura për ta më parë, vetëm e vetëm për të prezantuar fytyrën e qeshur të Islamit dhe për të kryer detyrën e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat.

Të qenit sahab, është mirësia më e madhe pas profetësisë... Prandaj, edhe ata e paguan me jetë dhe pasuri çmimin e kësaj mirësie të madhe.

Ata shpëtuan nga errësira e injorancës falë Kuranit, Dritës që zbriti në shkretëtirë, i cili është dhurata e Allahut dhe në saje të Profetit tonë ﷺ, i cili ishte Mëshirë për të gjithë botën. Ata, gjithashtu, iu përkushtuan çrrënjësjes së errësirës së injorancës në vendet e tjera, duke u përhapur nëpër botë.

Sepse kjo ishte porosia e Profetit tonë ﷺ...

Çdo mysliman duhet ta shohë veten përgjegjës për mbarëvajtjen e kohës në të cilën jeton. Ai duhet ta konsiderojë veten përgjegjës për udhëzimin e të gjithë njerëzve. Si Profeti ﷺ, ashtu edhe shokët e tij janë shembuj të kësaj vetëdije.

Kur një automobil priset duke ngjitur një malore, ndihma më e madhe për të zotin e automobilin, është t'i jepni një dorë për ta ngjitur. Kurse ndihma në rrugë të drejtë, ose në pjerrësi, mbetet një ndihmë e thjeshtë, mbase edhe e panevojshme, sepse mjeti mund të ecë edhe vet.



Edhe sot po përjetohet një epokë e re e injorancës në aspektin e njohjes së Allahut... Jemi në një periudhë ku po manifestohet plotësisht gjendja e prishur e shoqërisë, e cila konsiderohet ndër shenjat e vogla të kiametit. Në një situatë të tillë, shërbimi ndaj fesë së Allahut ka shumë herë më tepër shpërblime:

SHPËRBLIM MË I MADH

Një besimtar që dëshiron të jetë mik i Allahut të Madhëruar, duhet të dijë se është një bekim dhe lumturi e madhe të bësh përpjekje vetëmohuese për Allahun në kohë të vështira, kur feja e Allahut është nën presion e shtypje dhe myslimanët janë të dhunuar e të dobët. Kjo, sepse shërbimet dhe përpjekjet e bëra në kohë dhe vende të tilla, Allahu i vlerëson me shpërblime të veçanta. E në fakt, Allahu i Lartësuar i ngriti robërit e Tij që treguan bujari dhe vetëmohim në kohë të tilla të vështira, kur nevojat e tyre materiale e shpirtërore ishin në nivelin më të lartë, dhe u dha atyre një gradë të madhe virtyti duke i përmendur në Kuran si; “ata që dhuruan para çlirimit”.

Në Kuran urdhërohet:

“Atëherë, çfarë keni që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut, ndërkohë që vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e Tokës? Nuk janë të barabartë ata që kanë dhuruar dhe kanë luftuar para çlirimit; ata kanë shkallë më të lartë në krahasim me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Mirëpo, Allahu u premton të gjithëve më të mirën (Xhenetin). Allahu e di mirë atë që bëni ju.” (Hadid, 10.)

“Atëherë, çfarë keni që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut, ndërkohë që vetëm Atij i përket trashëgimia e qiejve dhe e Tokës?..”

(Hadid, 10.)



Le ta konkretizojmë këtë me një shembull:

Kur një automobil priset duke ngjitur një malore, ndihma më e madhe për të zotin e automobilin, është t'i jepni një dorë për ta ngjitur. Kurse ndihma në rrugë të drejtë, ose në pjerrësi, mbetet një ndihmë e thjeshtë, mbase edhe e panevojshme, sepse mjeti mund të ecë edhe vet.

Njëjtë me këtë; në kohët kur mendësia e injorancës është përhapur më tepër dhe shërbimi ndaj fesë nuk preferohet më, ndihma e fesë së Allahut duke jetuar dhe mbajtur gjallë Islamin, është shkak i një shpërblimi shumë të madh.

Ashtu si “vështirësia e punës” që i shtohet pagës së atyre që punojnë në vende të vështira dhe të rrezikshme, edhe Allahu i Madhëruar do t'u japë shpërblime më të mëdha atyre që i shërbejnë fesë në kohë të vështira.

Allahu i Madhëruar na dhëntë sukses dhe aftësi për të ta udhëhequr veten, brezin e ri, umetin dhe gjithë njerëzimin me vetëdijen e detyrës së urdhërimit në punë të mira dhe ndalimit nga të këqijat. Allahu na faltë prej entuziazmit që zotëronin Profeti ynë ﷺ dhe shokët tij në kryerjen e detyrës së kumtimit të fesë. O Allah! Begatoji përpjekjet tona me frymëzim dhe sukses!

Amin!..





VLERËSIMI I DITËS DHE JETËS

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Kur të çlirohesh (nga një punë), përpiqu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

Pra, kur të përfundojë njëri prej adhurimeve dhe veprave të mira, është e nevojshme të nxitonit menjëherë për tek tjetri dhe të mos lejoni që të kalojë asnjë moment pa adhurim dhe mirësi, sepse jeta është një bekim që na është dhënë për të fituar lumturinë e botës tjetër. Kurse vdekja, nga ana tjetër, është si data e pagesës që tregon kohën e shlyerjes së një borxhi.



VLERËSIMI I DITËS DHE JETËS

ÇDO GJË ËSHTË PËR MËSIM

Allahu i Plotfuqishëm e ka krijuar universin si një ekspozitë të shenjave të madhështisë hyjnore dhe në të njëjtën kohë, si një shkollë provimi për qeniet njerëzore. Për ata që mund të thellojnë meditimin brenda shpalljes, ka shenja, sekrete, urtësi dhe argumente të qarta nga shfaqjet e fuqisë dhe qëndisjet hyjnore, si në botën e brendshme të njeriut, ashtu edhe në çdo cep të universit.

Këto shenja, e bëjnë njeriun:

- Të sodisë madhësinë dhe fuqinë hyjnore.
- Të kujtojë dobësinë, pafuqinë e vet dhe sprovën e devotshmërisë përballë Allahu të Madhëruar.
- Dhe në fund të kësaj sprove, i kujton vdekjen, ditën e kiametit, ringjalljen, llogaritjen dhe fundin e tij.

Çdo gjë është një argument për të zotët e mendjes dhe zemrës. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të zotët e mendjes!”

(Al-i Imran, 190.)

Çfarë thellësie tmerruese shpreh tabloja e një perëndimi për një person me mendje të shëndoshë!

Mirëpo;

Një person indiferent, nga ana tjetër, nuk ka të njëjtën ndjenjë vlerësimi para universit dhe Krijuesit të tij ndërsa sodit pikturat që krijojnë një artist duke imituar natyrën. Ai, të gjitha mrekullitë dhe shfaqjet madhështisë hyjnore i konsideron si gjëra të zakonshme.

Ndërkohë;

Miqtë e Allahut, të cilët kanë arritur njohurinë e vërtetë, në vend që të mahniten pas këtyre tablove që artistit i ka pikturuar për të siguruar vazhdimësinë e famës së vet, jetojnë me një zemër entuziaste dhe të emocionuar përballë mrekullive

të fuqisë së Allahut të Madhëruar, i Cili është Artisti i vërtetë i gjithçkaje. Ata arrijnë kënaqësinë e artit hyjnor në mrekullitë e pafundme të krijuara në natyrë nga fuqia hyjnore. Ata meditojnë mbi gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve, të cilat burojnë nga e njëjta tokë, frutat e pemëve që ndryshojnë në ngjyrë, erë, shije dhe formë, formimin e një peme të madhe nga një farë e vogël, formimin e një pule nga një vezë e vogël, formimin e një njeriu nga një qelizë e vetme, modelet e mrekullueshme në krahët e fluturës, edhe pse ajo ka një jetëgjatësi prej një ose dy javësh, natyrën e mrekullueshme të krijimit njerëzor dhe



*“Kujtdo, që i japim
jetë të gjatë, Ne e
bëjmë sërish krijesë
të dobët. Vallë, a nuk
kuptojnë ata?”*

(Jasin, 68.)

mahniten përballë mrekullive të pafundme hyjnore si: shikimi i syrit dhe perceptimi i trurit...

Ata mendojnë:

A nuk është çdo mëngjes dhe çdo ditë që lind një faqe e re e librit të punëve, e cila nuk dihet se me çfarë do të mbushet?

Ashtu si dita dhe nata ndjekin njëra-tjetrën, edhe stinët ndjekin njëra-tjetrën gjatë gjithë vitit. Natyra që ringjallet dhe bëhet e gjelbër në pranverë fillon të zverdhet në vjeshtë dhe pothuajse vdes në dimër. Ky tranzicion sezonal, i cili përsëritet çdo vit në natyrë, përjetohet vetëm një herë në jetën e njeriut. Pranvera e rinisë nuk do të kthehet më.

Njeriu vjen në këtë botë si fëmijë, si një filiz i freskët, dhe gradualisht rritet e bëhet një djalë i ri dhe energjik. Por kjo ndryshon me moshën e mesme dhe procesi kthehet në të kundërtën. Tashmë trupi, pasi ka përfunduar stinën e pranverës dhe të verës, fillon të përjetojë vjeshtën dhe dimrin... Ashtu si gjethet jeshile e të gjalla të pemëve që thahen, zverdhen dhe bien në tokë nga një fllad i lehtë, edhe flokët e njeriut fillojnë të thinjen gradualisht, lëkura e tij rrudhet, trupi i tij fillon të humbasë fuqinë dhe të këputet. Ndërkohë, shfaqen sëmundje të ndryshme, beli kërruset gradualisht dhe gjunjët nuk i mbajnë më. Pra, vetë jeta e njeriut është një mësim për veten e tij.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

وَمَنْ نُعَمِّرْهُ نُنَكِّسْهُ فِي الْخَلْقِ أَفَلَا يَعْقِلُونَ

“Kujtdo, që i japim jetë të gjatë, Ne e bëjmë sërish krijesë të dobët. Vallë, a nuk kuptojnë ata?” (Jasin, 68.)

*“Janë dy mirësi,
vlerën e të cilave
shumica e njerëzve
nuk e çmon:
Shëndeti dhe
koha e lirë.”*

(Buhari, Rikak, 1.)



Përparimi i jetës së njeriut drejt një dimri, duhet ta bëjë njeriun të mendojë, apo jo?

PËR KU KY UDHËTIM?

A nuk është mplaçka e trupit të përkohshëm një shenjë se, shërbimit të tij si veshje për shpirtin në këtë botë i ka ardhur fundi? Kjo veshje kalimtare do të shkojë në varr, kurse shpirti do të vazhdojë rrugën e tij deri kur të rikrijohet trupi në Ditën e Ringjalljes. Mirëpo, fati që e pret njeriun Ditën e Ringjalljes, atë ditë të gjatë, varet nga mënyra se si ai jeton në këtë botë. Pra, nëse ai do të shpëtojë apo jo nga tmerret e Ditës së Gjykimit, do të jetë apo jo në mesin e faqebardhëve dhe të atyre që do të hyjnë në Xhenet, do të varet nga mënyra se si ai e vlerëson kapitalin e kësaj jete.

Prandaj, ashtu si në këtë botë, ku begatia e stinëve të pranverës dhe verës shfrytëzohet duke punuar dhe siguruar ushqimin për dimër, kur nuk mund të punohet, ashtu duhet vlerësuar edhe pranvera e rinisë.



*Ashtu siç
besimtarët luten
për njëri-tjetrin
me selam kur
takohen, ashtu
luten për njëri-
tjetrin dhe i
dëshirojnë paqen
e Allahut me
selam edhe kur
ndahen.*

Njeriu nuk mund t'i kuptojë begatitë prej të cilave nuk është privuar asnjëherë. Ashtu si peshqit në ujë, që nuk e dinë çdo të thotë të mbetesh pa ujë, pasi nuk e kuptojnë siç duhet këtë mirësi, ashtu edhe njerëzit nuk mund ta kuptojnë siç duhet mirësinë e jetës që jetojnë.

Profeti ynë ﷺ, i cili është shembulli ynë më i bukur në çdo gjë, lidhur me përdorimin e frytshëm të jetës, na porosit:

“Janë dy mirësi, vlerën e të cilave shumica e njerëzve nuk e çmon: Shëndeti dhe koha e lirë.” (Buhari, Rikak, 1.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar, duke u betuar në disa gjëra të cilat Ai i çmon shumë dhe që janë shumë të rëndësishme për ne, na tërheq vëmendjen tek to në Kur'anin Fisnik. Një betim të tillë, Allahu i Madhëruar e bën edhe për kohën:

“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Asr, 1-3.)

Një ditë, Xhunejd Bagdadi dëgjoi një shitës akulli duke thirrur:

“Ndihmojeni njeriun, të cilit po i shkrihet kapitali!”

Atë moment, ra menjëherë në tokë pandjenja. Kjo, sepse siç kuptohet edhe nga surja el-Asr, njeriu është një udhëtar përjetësie, të cilit i konsumohet kapitali i jetës në çdo moment. E, nëse kapitali i kësaj bote nuk shkëmbehet me kapitalin e botës tjetër, përpjekjet në këtë botë, kthehen në mundësi që do të ndahen mes shejtanëve. Si përfundim, mbetet vetëm një humbje dhe mashtrim i hidhur.

Koha është një kapital jashtëzakonisht i vlefshëm dhe humbja e saj për gjëra boshe dhe të padobishme, do të thotë të rrezikosh jetën e ahiretit. Prandaj, koha është një mirësi e pakrahasueshme dhe e çmuar për ata që janë vigjilentë. Allahu i Plotfuqishëm jep këshillat e mëposhtme në mënyrë që

Selam është lutja e një besimtari ndaj vëllait të tij. Po ashtu, edhe vëllai i tij i përgjigjet atij me të njëjtën lutje. Jashtë kësaj, fjalët e tjera boshe të përdorura për përshëndetje janë larg kësaj përmbajtje dhe të pakuptimta.



robërit e Tij të shpëtojnë prej humbjes në përdorimin e kohës dhe të fitojnë mirësitë hyjnore:

فَاِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ

“Kur të çlirohesh (nga një punë), përpiqu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

Pra, kur të përfundojë njëri prej adhurimeve dhe veprave të mira, është e nevojshme të nxitonit menjëherë për tek tjetri dhe të mos lejoni që të kalojë asnjë moment pa adhurim dhe mirësi, sepse jeta është një bekim që na është dhënë për të fituar lumturinë e botës tjetër. Kurse vdekja, nga ana tjetër, është si data e pagesës që tregon kohën e shlyerjes së një borxhi.

24 ORËSHI I PROFETIT TONË ﷺ

Një ditë, Xhunejd Bagdadi dëgjoi një shitës akulli duke thirrur: “Ndihmojeni njeriun, të cilit po i shkrihet kapitali!”, dhe i ra në tokë pa ndjenja.



Vlerësimi i jetës së përditshme të Profetit tonë ﷺ, i cili zotëronte moralin e Kuranit, ishte në bazë të ajeteve. Në jetën e tij, asnjëherë nuk kishte vend për angazhim padobi, pushim të gjatë dhe kohë të kaluar kot.

Gjatë njëzet e katër orëve në ditë dhe natë, ka angazhime të panumërta dhe të mira me të cilat mund të merret një besimtar. Jeta e përditshme e Profetit tonë ﷺ, është udhëzuesi më i vlefshëm për ne në këtë drejtim.

Dita e tij ishte e mbushur me adhurime, aktivitete individuale dhe shoqërore.

Natën, ai qëndronte vetëm për vetëm me Zotin e tij. Edhe pse Profeti ﷺ, nuk kish-te gjynahe, ai falej natën derisa i ënjteshin këmbët dhe lexonte Kuran për orë të tëra, derisa binte i lodhur. Ai ishte njeriu që e donte më shumë Allahun, e kujtonte dhe i frikësohej më së shumti Atij.

Ai ishte gjithmonë i etur për të kërkuar ndihmë nga Zoti i tij me anë të namazit. Përveç pesë namazeve ditore farz me xhemat, ai e zbukuronte ditën e tij me frymën e namazit, duke falur edhe namaze të tjera vullnetare. Profeti ynë ﷺ, lutej në çdo rast:

Ai lutej kur shkonte në shtrat dhe kur zgjohej, kur hynte dhe dilte nga shtëpia, para dhe pas shkuarjes në tualet, kur merrte abdes, kur dëgjonte ezanin, kur hynte në xhami, kur shkonte në treg, pasi ushqimit, etj. Për rrjedhojë, edhe praktikimi i këtyre nga ne, do të jenë begatitë më të bukura të ditëve tona.

Po ashtu, ndër veprat e virtytshme që rekomandohet të bëni, me qëllim që t'u japin paqe shpirtërore zemrës, janë këndimi i sures Feth në mëngjes për të shmangur problemet e ditës, i sures Uakia për bekimin e furnizimit dhe i sures Mulk pas namazit të jaxisë për mbrojtje nga dënimi i varrit.

Në mënyrë të veçantë, gjallërimi i netëve është shumë i rëndësishëm.

Zoti ynë betohet në natën, mbulimin e tokës nga errësira. E treta e fundit e natës ka një vlerë të jashtëzakonshme, si koha

Njeriu është një udhëtar përjetësie, të cilit i konsumohet kapitali i jetës në çdo moment. E, nëse kapitali i kësaj bote nuk shkëmbehet me kapitalin e botës tjetër, përpjekjet në këtë botë, kthehen në mundësi që do të ndahen mes shejtanëve.



para agimit. Kjo është koha për kërkimin e faljes; koha e qëndrimit në këmbë dhe sexhdes para Allahu; koha e tehexhudit, namazit më të vlefshëm pas namazeve farz. Po ashtu, kjo është koha e meditimit lidhur me vdekjen, kiametin dhe llogarinë; koha e pendimi dhe keqardhjes për gjynahet e bëra; koha për salavate, dhikr dhe lexim Kurani; koha për t'iu përgjyruar Allahut të Madhëruar me lot në sy...

Në një familje që mbledhet mbrëmjeve, duhet të përjetojnë paqja dhe lumturia në bazë të sinqeritetit dhe devotshmërisë. Në mbrëmje, njeriu duhet të pushojë herët dhe të bëhet gati për natën, pa iu nënshtruar tundimit të televizionit, internetit, etj., të cilat helmojnë kohën dhe shpirtin.

Për një besimtar është humbje e madhe nëse privohet nga frymëzimi shpirtëror duke i kaluar të gjitha netët e tij në gjumë dhe duke i sakrifikuar ato për të fjetur gjatë gjithë natës,

i ftohtë si një statujë, sepse ne jemi udhëtarët e ahiretit. Dhe një ditë, kënaqësitë kalimtare do të merren prej nesh. Nëse jeta e kësaj bote, e cila kalon si një re verore, jetohej pa u shqetësuar për ahiretin, kjo është njësoj sikur ta konsiderosh ditën pa mbrëmje. Më e rëndësishmja e adhurimeve individuale, është namazi. Dhe, më e rëndësishmja e adhurimeve shoqërore, është shërbimi.

Zoti ynë betohet në natën, mbulimin e tokës nga errësira. E treta e fundit e natës ka një vlerë të jashtëzakonshme, si koha para agimit. Kjo është koha për kërkimin e faljes; koha e qëndrimit në këmbë dhe sexhdes para Allahu; koha e tehexhudit, namazit më të vlefshëm pas namazeve farz.



DETYRAT SHOQËRORE

Allahu i Plotfuqishëm ka dhënë paralajmërime të ashpra për ata që lënë pas dore detyrat e tyre shoqërore, për ata që

nuk mendojnë për të vetmuarit dhe jetimët në shoqëri dhe janë lakmitarë e egoistë ndaj pasurisë:

“Jo, nuk është ashtu! Por ju nuk e përfillni jetimin, nuk nxitni njëri-tjetrin për të ushqyer të varfrin. Ju e hani trashëgiminë (padrejtësisht). Dhe pasurinë e doni së tepërmi.” (Fexhr, 17-20.)

Është e qartë se Allahu i Madhëruar, jo vetëm që urdhëron bujarinë, por gjithashtu dëshiron që besimtarët të inkurajojnë njëri-tjetrin për të qenë bujarë. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, e paralajmëroi umetin e tij në lidhje me egoizmin dhe lakminë për pasuri duke thënë:

“..Betohem në Allahun se, unë nuk kam frikë nga varfëria për ju. Unë kam frikë se bota do t’ju shtrohet para, ashtu siç u është shtruar atyre përpara jush, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe, bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.” (Buhari, Rikak, 7, Xhizje, 1; Muslim, Zuhd, 6.)

“..Betohem në Allahun se; për ju nuk kam frikë se mos bini në shirk (idhujtari)! Por kam frikë se mos jepeni pas kësaj bote dhe vrisni njëri-tjetrin!..” (Buhari, Megazi, 17.)

E, për të qenë të sigurt kundër këtij shkatërrimi;

Ndër veprimtaritë ditore të një myslimani, duhet të zënë vend të rëndësishëm edhe adhurimet me dobi shoqërore, sepse Profeti ynë ﷺ, ishte shumë bujar dhe dhuronte në mënyrë të vazhdueshme. Ai dhuronte vazhdimisht me të gjitha mundësitë në dispozicion të tij; me fjalët e bukura dhe

Agimi është koha e meditimit lidhur me vdekjen, kiametin dhe llogarinë; koha e pendimi dhe keqardhjes për gjynahet e bëra; koha për salavate, dhikr dhe lexim Kurani; koha për t’iu përgjëruar Allahut të Madhëruar me lot në sy.



të ëmblla, me ndihmë materiale dhe mbështetjen e tij. Ai interesohej për shokët e tij, vizitonte të sëmurët, ngushëllonte njerëzit dhe kujdesej për problemet e të gjithëve.

Siç transmeton Abdullah bin Amr bin As-i رضي الله عنه, një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut ﷺ:

- Cila është sjellja më e mirë dhe më e dobishme në Islam?

- “Të ushqesh njerëzit dhe t’i japësh selam çdokujt që njeh e që nuk njeh!” – tha Profeti ﷺ. (Buhari, Iman, 20.)

Të japësh selam, do të thotë të lutesh për tjetrin. Me anë të selamit, dëshiron paqen, mëshirën dhe begatinë e Allahut. Kështu, përhapet dashuria dhe mëshira mes zemrave. Ka pasur nga sahabët që dilnin nga shtëpitë e tyre dhe bënë udhëtime të shkurtra vetëm për të përbushur sunetin e selamit.



Për një besimtar është humbje e madhe nëse privohet nga frymëzimi shpirtëror duke i kaluar të gjitha netët e tij në gjumë dhe duke i sakrifikuar ato për të fjetur gjatë gjithë natës, i ftohtë si një statujë, sepse ne jemi udhëtarët e ahiretit.

Selam është lutja e një besimtari ndaj vëllait të tij. Po ashtu, edhe vëllai i tij i përgjigjet atij me të njëjtën lutje. Jashtë kësaj, fjalët e tjera boshe të përdorura për përshëndetje janë larg kësaj përmbajtje dhe të pakuptimita. Në përgjithësi, ato janë dëshira të thjeshta që nuk të kujtojnë Allahun e Madhëruar.

Ashtu siç besimtarët luten për njëritjetrin me selam kur takohen, ashtu luten për njëritjetrin dhe i dëshirojnë paqen e Allahut me selam edhe kur ndahen. Sa e bukur është gjendja e çdo myslimani të ndërgjegjshëm në bukurinë e një personaliteti të krijuar nga selami i Allahut:

Myslimanët, kur ndahen me njëritjetrit, thonë;

“Paqja e Allahut qoftë me ty!”

Kur dalin për udhëtim, thonë;

“Allahu të ruajt!” “Allahu ta priftë mbarë!”

Kur martohen;

“Allahu ju begatofte!”

Gjatë tregtisë;

“Allahu ta shtoftë bereqetin!”, “I pafshi hajrin!”

Kur sëmuren;

“Allahu të shëroftë!”

Kur u lind fëmija;

“Allahu i dhëntë jetë të gjatë e të hajrit!”

Kur u vdes dikush;

“Allahu e mëshiroftë, qoftë i Xhenetit!”

Ky pra është morali i bukur Islam që ndërton dhe rinon zemrat. Këto lloj lutjesh dhe dëshirash, të cilat realizohen në këtë mënyrë besimi, metode dhe motoje, e mbajnë gjallë vëllazërinë Islame.

Me pak fjalë, jeta e një myslimani bëhet brenda një jete shoqërore e cila mbështetet përherë në mëshirën e Allahut me lutje të tilla të bukura.

Krahas kësaj, ka edhe shumë veprimtari të tjera shoqërore që e begatojnë ditën e një myslimani:

Nëse jeta e kësaj bote, e cila kalon si një re verore, jetohet pa u shqetësuar për ahiretin, kjo është njësoj sikur ta konsiderosh ditën pa mbrëmje.



Të fitojë në rrugë hallall të ardhurat për familjen dhe t'u mësojë familjarëve Islamin me dashuri dhe butësi...

Të vizitojë prindërit dhe të afërmit, të interesohet për ta dhe t'u shkojë në ndihmë... T'u përgjigjet ftesave për gëzime e hidhërime dhe t'u japë dhurata që u gëzojnë zemrat...

Të vizitojë të moshuarit në azile ose të sëmurët në spitale; t'i ngushëllojë dhe t'u japë zemër e shpresë për jetën...

Të marrë pjesë në xhenazen e atyre që vdesin prej të afërmeve, të njohurve, miqve dhe fqinjëve dhe të ngushëllojë familjarët e tyre... Të vizitojë varret e të afërmeve dhe të njohurve...

Një tjetër detyrë e rëndësishme e myslimanit në kuadër të adhurimeve dhe veprimtarive, është përpjekja për brezat e rinj, që janë e ardhmja e umetit Islam.



Pyete veten: Ti shpenzon kohë dhe pasuri për një periudhë të gjatë në arsimimin e fëmijëve të tu në këtë botë. Po për arsimin në lidhje me Ahiretin e tyre çfarë ke bërë? Apo mos vallë i ke konsideruar të mjaftueshme disa ditë mësimi fetar në kurset e verës, për një arsimim që ka të bëjë me botën tjetër?

PËRPIEKJET PËR BREZIN E RI

Të bësh përpjekje me jetën, pasurinë dhe gjithçka që është e mundur për të kryer detyrën e urdhërimit në punë të mira dhe ndalimin nga të këqijat, për të kumtuar Islamin, për ta mbrojtur atë dhe për ta bërë fitimtar. Me fjalë të tjera, të mos jesh i pakujdesshëm ndaj rrjedhës së jetës dhe njerëzve të tjerë, të varfërve, nevojtarëve dhe të vobektëve; të ndiesh në zemër përgjegjësinë e fatkeqëve, të cilët tërhiqen drejt xhehenemit si trungjet gjatë përmbytjeve; të jesh në gjendje të tregosh të gjitha sakrificat që mund të bëhen për të ndaluar këtë ecure të keqe.

Angazhimi më i madh i Profetit tonë ﷺ, përveç adhurimeve dhe aktiviteteve të tij shoqërore, ishte edukimi i brezit të ri. Pra, përpjekja për të edukuar brezat e rinj që do t'i përcillnin Islamin njerëzimit. Kështu, në kohë urie, ai lidhte një gur në bark dhe u mësonte Kuranin shokëve të tij. Ai interesohej veçanërisht për të rinjtë e talentuar si Muadhi, Enesi, Bilali, Xhabiri, Ebu Hurejre dhe Abdullah bin Omeri ﷺ dhe u tregoi atyre horizonte që ishin në përputhje me talentet e tyre. Ai i edukoi shokët e tij me aftësi të ndryshme veç e veç për nevojat e ndryshme të umetit. Disa prej tyre u bënë mësues, disa komandantë, disa administratorë, disa ambasadorë dhe disa të tjerë u bënë udhëheqës.

Kështu, pas një periudhe edukimi prej 23 vjetësh, që nuk ishte shumë e gjatë, Profeti ynë ﷺ, shkoi me zemër të qetë tek Zoti i tij, pasi i kishte edukuar sahabët me aftësi të tilla, në sajë të cilave mund t'ia përcillnin Islamin njerëzimit pas tij. Për rrjedhojë, në një kohë shumë të shkurtër, drita e Islamit ka ndriçuar shumë vende dhe ka shpëtuar shumë zemra nga errësira e mosbesimit, që prej Kinës, deri në Semerkand e Kaj-ravan.

Edhe sot po përjetohet një periudhë e injorancës. Për shkak të teknologjisë së krijuar për t'i shërbyer së keqes, po preken dhe po ndikohen tepër familjet dhe fëmijët tanë.

Sot, mashtrimi më i madh në lidhje me eliminimin e kësaj injorance dhe mbrojtjen e brezave tanë nga helmet e saj është shpërdorimi i kohës. Nëse orët e humbura para ekraneve dhe

Pyete veten: A nxitove të takoheshe me Zotin tënd në kohën para agimit, kur Ai të fton për t'i kërkuar falje? Sa arrite të përfitoje prej mëshirës dhe faljes hyjnore që gufon në atë kohë? Apo mos ndoshta i ke humbur në gjumë këto mundësi të vyera?



telefonave të pakontrolluar do të shpenzoheshin për ringjalljen e brezit, sigurisht që do të ishte e dobishme për shumë zemra të humbura. Nëse në vend të angazhimeve padobi, sigurohet vazhdimi i shërbimit dhe veprave të mira që begatojnë ditën; e thënë ndryshe; nëse zemra është e angazhuar me të vërtetën, ajo do të mbrohet nga pushtimi së kotës.

Kur mbrëmjet e mbushura me fjalë e punë të kota ndiqen nga agimet dhe mëngjeset e fjetura, ditët bëhen të zymta dhe pa ndjesi shpirtërore... E, kur gjatë ditëve të tilla përballeni me gjynahe, harame dhe vepra të dyshimta, nuk mbetet forcë në shpirt dhe trup për ringjalljen e agimeve. Kështu krijohet një rreth vicioz ...

Prandaj, gjatë ditës duhet të shoqërohemi me të drejtët dhe besimtarët. Nuk duhet bredhur në vendet e gabuara dhe nuk duhen parë gjëra të shëmtuara. Dora, gjuha, sytë dhe zemra

duhet të ruhen. Vetëm nëse e arrijmë natën në këtë gjendje, është e mundur ta ringjallim edhe agimin. Kur begatia e fituar nga agimi përhapet gjatë gjithë ditës, ky bëhet një rreth i virtytshëm që mbush peshoren e mirësive të njeriut me shpërblime të pafundme. Për rrjedhojë, ajo që e shndërron kapitalin e përkohshëm të kësaj jete në një xhenet të përjetshëm është “Tixhareten len tebur”, pra, një tregti që nuk dëmtohet kurrë.

Myslimani është i detyruar ta organizojë 24 orëshin e tij si Profeti i tij ﷺ. Islami nuk duhet harruar në asnjë çast të jetës.

Pyete veten: Duke filluar prej familjes; a ke marrë masa mbrojtjeje për njerëzit që ke nën përgjegjësi, kundër të këqijave dhe problemeve të kohës, ndërkohë që sot breza të tërë po humbasin si trungjet në përrënjt?



LLOGARIA PËR ÇDO NATË

Një mysliman duhet që çdo natë të bëjë llogarinë e ditës së shkuar dhe t'i drejtojë vetes këto pyetje:

- Si e hape librin e jetës këtë mëngjes? A e falënderove Zotin tënd që të fali një ditë të re?

- A nxitove të takoheshe me Zotin tënd në kohën para agimit, kur Ai të fton për t'i kërkuar falje? Sa arrite të përfitoje prej mëshirës dhe faljes hyjnore që gufon në atë kohë? Apo mos ndoshta i ke humbur në gjumë këto mundësi të vyera?

- A ke mundur ta bartësh gjatë gjithë ditës frymëzimin e kohës para agimit? Sa kohë ke kaluar sot në atmosferën e përmendjes së Allahut? Sa kohë qëndrove në frymëzimin shpirtëror të përmendjes së Zotit tënd?

- A meditove sot në lidhje me vdekjen, e cila t'i asgjëson kënaqësitë e egos?

- Sa i je drejtuar Zotit sot duke u zhveshur nga shqetësimet e panevojshme të jetës? Sa thellë të kanë bërë të meditosh manifestimet dhe shfaqjet hyjnore të cilat ke hasur?

- Sa kohë namazi ke falur me xhemat, duke iu përgjigjur ftesës hyjnore që ngrihej prej minareve? A munde t'i falje namazet me përkushtimin e duhur dhe harmoninë zemër-trup me të cilën kënaqet Allahu?

Pyete veten: A ke mundur ta marrësh përdore një fëmijë apo një të ri, e të shkoni bashkë ne xhami? A je përpjekur të mbledhësh rreth vetes disa të rinj për t'i qerasur materialisht e shpirtërisht, duke ua bërë të dashur të vërtetën?



- A ke bërë kujdes nëse fitimi yt i sotëm, ushqimi, pija dhe veshja jote janë hallall, të dyshimta apo haram? A të ka shoqëruar ndjenja e ruajtjes prej harameve në çdo veprim?

- A je kujdesur sot për të drejtat e njerëzve të tjerë? A mund të thuash, “unë s’i kam hyrë në hak asnjë robi dhe nuk kam lënduar askënd!”?

- A ke mundur sot t’i shohësh krijesat me syrin e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë së Krijuesit?

- A je kujdesur ndaj të drejtave të maces apo të qenit, që ke gjetur tek dera jote? A je sjellë me mëshirë ndaj krijesave duke kujtuar faktin se një person meritoi ndëshkimin hyjnor për shkak se e la macen të ngordhte nga uria, kurse një tjetër gëzoi faljen hyjnore për shkak se i dha ujë një qeni të etur për vdekje?



Pyete veten: Sa faqe ke lexuar sot prej Kuranit Fisnik, i cili është mrekullia më e madhe që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit? A ke mundur të punosh siç duhet me të duke medituuar mbi mesazhet që jep ai? A je prej atyre që ia kanë mësuar të tjerëve Kuranin, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ndihmuar atë për t’u bërë prej robërve më të mirë?

- A i ke pyetur sot prindërit apo të afërmit e tu për hallet e tyre, a ua ke gëzuar zemrat? Nëse ata kanë ndërruar jetë, a je lutur për ta dhe i ke kujtuar me mirësi? Sa besnik ke qenë ndaj miqve të tyre të vjetër?

- A ke mundur ta shohësh sot familjen tënde me syrin e zemrës, si kopshtin tënd të Xhenetit, duke u përpjekur ta mbrosh atë nga ndikimet negative të rrugës, tregjeve, modës, reklamave, televizionit dhe internetit?

- Nëse je zonjë shtëpie, a e ke përcjellë burrin tënd me fytyrë të qeshur e dashuri,

duke u lutur që të sjellë furnizim hallall në shtëpi? Po ashtu, a e ke pritur me fjalë të ëmbla në mbrëmje, duke u përpjekur t'i largosh lodhjen dhe të bëheni një familje e pastër e shembullore?

- Nëse je zot shtëpie, me sa butësi dhe mëshirë je sjellë ndaj gruas dhe fëmijëve të tu? A e ke menduar se trashëgimia më e madhe që mund t'u lësh atyre është ajo e botës tjetër dhe, a je përpjekur aq sa duhet për zhvillimin e tyre fetar, moral e shpirtëror?

- Çfarë u mësove sot nga edukata fëmijëve të tu, të cilët Allahu i Madhëruar t'i ka lënë amanet? A ke mundur të fusësh në zemrat e tyre dashurinë për të Dërguarin e Allahut ﷺ, profetët e tjerë dhe robërit e mirë të Allahut?

- Fëmijët e tu, janë ata që nesër do të të përfaqësojnë dhe do të jenë një pjesë e vazhdimësisë tënde! Për rrjedhojë, çfarë ke bërë ti sot që ata të fitojnë personalitetin Islam?

- Çfarë virtytesh ke mbjellë sot në kopshtin e zemrave të fëmijëve të tu, që ata të jenë drita e syve të tu dhe krenaria jote në ditën e Kiametit?

- A ke mundur t'i vetëdijësosh fëmijët e tu se feja, besimi, atdheu dhe të gjitha gjërat e shenjta janë amanete që duhen mbrojtur? A ia ke kujtuar fëmijëve të tu dëshmorët që kanë rënë në mbrojtje të atdheut? A i ke mësuar ata se Kurani që është mirësia më e madhe e Allahut, ezani që jehon në qiejt tanë dhe flamuri ynë që valëvitet i lirë në këtë vend, janë nderi dhe krenaria jonë më e madhe?

Pyete veten: Si e ke mbyllur ditarin e jetës sot? Çfarë janë shkruar në librin tënd të punëve në lidhje me ditën e sotme? A do të mund të japësh llogari në ditën e gjykimit për faqen e kësaj dite?



- Ti shpenzon kohë dhe pasuri për një periudhë të gjatë në arsimimin e fëmijëve të tu në këtë botë. Po për arsimin në lidhje me Ahiretin e tyre çfarë ke bërë? Apo mos vallë i ke konsideruar të mjaftueshme disa ditë mësimi fetar në kurset e verës, për një arsimim që ka të bëjë me botën tjetër?

- A ke mundur që sot, atyre që kanë nevojë për udhëzim t'u afrosh me gjuhë të ëmbël dhe me një zemër që shpërndan mëshirë? A i ke urdhëruar ata për të mirë dhe i ke ndaluar nga e keqja? A je lutur për udhëzimin e tyre? A ke mundur të bëhesh shembull "i një personaliteti mysliman" për ta?

- Duke filluar prej familjes, a ke marrë masa mbrojtjeje për njerëzit që ke nën përgjegjësi, kundër të këqijave dhe problemeve të kohës, ndërkohë që sot breza të tërë po humbasin si trungjet në përrenj?

Pyete veten: A e ke menduar se sot je duke u regjistruar nga kamerat hyjnore në çdo lëvizje dhe çdo veprim tëndin për të mbushur kasetën e jetës tënde? A e ke bërë llogarinë e 24 orëve të fundit që ke kaluar dhe a e ke kontrolluar veten?



- A ke mundur ta marrësh përdore një fëmijë apo një të ri, e të shkoni bashkë ne xhami? A je përpjekur të mbledhësh rreth vetes disa të rinj për t'i qerasur materialisht e shpirtërisht, duke ua bërë të dashur të vërtetën? Çfarë dhurate i ke dhënë një personi të cilin e do për hir të Allahut?

- Me kë dhe sa prej të mirave që të ka dhuruar Allahu i Madhëruar i ke ndarë sot? A ke mundur të bëhesh bamirës sot?

- A e ke përjetuar sot kënaqësinë shpirtërore që të jep gëzimi i një besimtari?

- A e ke përkëdhelur sot kokën e një jetimi? A e ke vizituar ndonjë të sëmurë? A e ke përcjellë ndonjë xhenaze?

- A je interesuar sot për fqinjët dhe nevojtarët përreth teje? A ta ka drithëruar zemrën një fqinj që ka mbetur i uritur apo ndonjë i pastrehë që dridhet në të ftohtë?

- A të kanë hidhëruar sot hallet e myslimanëve që vuajnë qoftë edhe në anën tjetër të botës?

- A ke bërë ndonjë përpjekje sot për ngopjen e të uriturve, shërimin e të sëmurëve dhe për lehtësimin e atyre që janë të shtypur nën barrën e borxheve? A je lutur për këtë çështje me fjalë, me zemër, dhe çështë më e rëndësishme, me vepra?

- A ke përshëndetur sot me selam të gjithë njerëzit që i njeh dhe nuk i njeh? A i ke pritur njerëzit me fytyrë të qeshur duke e ditur se buzëqeshja është sadaka?

- A je sjellë me mirësi dhe a e ke falur sot ndonjë që të ka bërë keq ose është sjell keq me ty?

- A ke fituar sot ndonjë mik dhe me sa miq e ke freskuar miqësinë?

- A je përpjekur sot të qëndrosh me ndonjë njeri të mirë? A ke bërë miqësi me ndonjë besimtar të sinqertë që do t'i thotë të vërtetat për hir të Allahut edhe pse nuk do t'i pëlqenin egos tënde? A ke bartur ndopak shqetësim në zemrën tënde për t'u ruajtur nga qëndrimi me gjynahqarët dhe njerëzit e këqij?

- A ke hequr sot nga rruga ndonjë pengesë që i bezdis kalimtarët?

Pyete veten: A e ke ruajtur gjuhën tënde sot nga fjalët e kota e të padobishme, nga gënjeshttrat dhe thashethemet, nga përgojimet dhe debatet dhe nga shpimi i ndonjë zemre me fjalë helmuese?



- A je marrë sot me ndonjë shërbim apo veprimtari që të ka shtuar diturinë dhe të ka zhvilluar kulturën?

- A ke mundur që sot, nëpërmjet bisedave fetare që janë si farmaci zemre, të marrësh prej ilaçeve shpirtërore që të shërojnë zemrën e shpirtin dhe të shtojnë frymëzimin?

- Sa faqe ke lexuar sot prej Kuranit Fisnik, i cili është mrekullia më e madhe që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit? A ke mundur të punosh siç duhet me të duke medituuar mbi mesazhet që jep ai? A je prej atyre që ia kanë mësuar të tjerëve Kuranin, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ndihmuar atë për t'u bërë prej robërve më të mirë?

- A ke treguar vullnet të fortë për t'iu vënë kundër zakoneve të këqija që përpiqen të hyjnë në jetën tënde?

- A e ke ruajtur gjuhën tënde sot nga fjalët e kota e të padobishme, nga gënjeshttrat dhe thashethemet, nga përgojimet dhe debatet dhe nga shpimi i ndonjë zemre me fjalë helmuese?

Pyete veten: A je sjellë me mirësi dhe a e ke falur sot ndonjë që të ka bërë keq ose është sjell keq me ty? A ke fituar sot ndonjë mik dhe me sa miq e ke freskuar miqësinë?



- Si e ke mbyllur ditarin e jetës sot? Çfarë janë shkruar në librin tënd të punëve në lidhje me ditën e sotme? A do të mund të japësh llogari në ditën e gjykimit për faqen e kësaj dite?

- Shkurtimisht, a e ke menduar se sot je duke u regjistruar nga kamerat hyjnore në çdo lëvizje dhe çdo veprim tëndin për të mbushur kasetën e jetës tënde? A e ke bërë llogarinë e 24 orëve të fundit që ke kaluar dhe a e ke kontrolluar veten?

Me fjalë të tjera, sot;

- A e ke zbatuar urdhrin: “Llogariteni veten para se t’ju kërkojnë llogari!”

- A ke mundur ta përjetosh urtësinë e shprehjes: “Vdisni para se t’ju vijë vdekja!”? Pra, a shpëtuan prej dëshirave të ulëta të egos duke i zhvilluar aftësitë shpirtërore?

Pyetje që presin përgjigjet...

Edhe nëse e bëjmë apo jo këtë llogari sot, këto janë pyetjet që do të na dalin para në botën tjetër ... Allahu i Madhëruar na bëftë nga ata që mund llogarisin veten e tyre para se të dalin para përgjegjësive...


O Allah! Na jep mundësinë të kalojmë ditët dhe jetën tonë në një mënyrë që t’u përgjigjet pozitivisht këtyre pyetjeve!..

Mos na lërë në dorën e vetes sonë qoftë edhe për një moment, na e bëjë të mundur që çdo moment i jetës sonë t’i ngjajë jetës së Profetit tonë ﷺ dhe të përfitojmë prej frymëzimit të tij shpirtëror!..

Amin!..



Pyete veten: A ke mundur ta përjetosh urtësinë e shprehjes: “Vdisni para se t’ju vijë vdekja!”? Pra, a shpëtuan prej dëshirave të ulëta të egos duke i zhvilluar aftësitë shpirtërore?



SHËRBIMI NDAJ ZOTTIT dhe JETA E QETË

Kemi një zjarr, brenda të cilit kanë mbetur fëmijë, njerëz të mjerë dhe breza të shkretë. Prandaj duhet shkuar për t'i ndihmuar ata. A është e mundur që përballë kësaj tabloje njeriu ta braktisë ndihmën dhe të tërhiqet duke thënë: "Tani kam orarin e pushimit!"? Apo pritet që ai të bëjë sakrificë me aq sa ka mundësi si domosdoshmëri e besimit dhe ndërgjegjes së tij? E në fakt, sahabët zotëronin gjithmonë këtë thellësi dhe botëkuptim. Ata shkuan në të katër anët e botës me këtë vetëdije me qëllim që të përhapnin udhëzimin, sepse myslimani duhet ta konsiderojë veten përgjegjës për mbarëvajtjen e kohës në të cilën jeton.



SHËRBIMI NDAJ ZOTTIT dhe JETA E QETË

AMANETI I MADH

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Po ju lë (amanet) dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni. Ato janë:

- *Libri i Allahut, Kurani Fisnik*
- *Dhe Suneti i të Dërguarit të Tij...”* (Shih. Muvatta, Kader, 3.)

Ruajtja e këtyre dy amaneteve, është e mundur me anë të këtyre dy gjërave:

- Ta jetojmë vet dhe ta mbajmë gjallë...

Jeta e një besimtari duhet të jetë e mbushur me të gjitha përpjekjet për të jetuar dhe mbajtur Islamin gjallë. Ruajtja e amaneteve të Islamit është një borxh që një besimtar duhet ta përjetojë dhe ta mbajë gjallë deri në fund të jetës së tij duke respektuar ekuilibrin hyjnor. Kjo është një e drejtë e Allahut të Madhëruar. Është një çmim që duhet paguar për mirësinë e besimit.

Por ka edhe disa të drejta të tjera që besimtari duhet t'i respektojë. Para së gjithash, njeriu duhet të respektojë të drejtat e vetes së tij. Më pas, duhen respektuar të drejtat e njerëzve të tjerë, ku përfshihen prindërit, familja, fëmijët, fqinjët, shoqëria ku ata jetojnë dhe njerëzit që ka nën vete. Kështu, një besimtar duhet të bëjë një jetë të ekuilibruar, duke respektuar të drejtat e Allahut dhe të drejtat e njerëzve.

E DREJTA MË E RËNDËSISHME: E DREJTA E ALLAHUT


Njeriu nuk mund të shmangë përmbushjen e të drejtës së Allahut duke thënë: “Unë do të respektoj të drejtat e prindërve, bashkëshortit/es, fëmijëve, njerëzve, shoqërisë dhe ato të vetes të sime”. Për shembull;

Ai nuk mund të thotë: “S’mund ta fal namazin, të kumtoj Islamin dhe të kryej detyrën e urdhërimit në punë të mira e ndalimit nga e keqja, sepse punoj për të siguruar të ardhurat për familjen!” Kjo, sepse në lidhje me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na paralajmëron:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (Munafikun, 9.)

PËRPIEKJE PAKUFI

Përpijekjet për të jetuar dhe mbajtur Islamin gjallë, me fjalë të tjera, për të shër-



byer në rrugën e Allahut me jetën dhe pasurinë, nuk është një detyrë e cila ka një kufi të caktuar si disa forma të tjera adhurimi.

Për shembull, ne i dimë kohët e namazit dhe agjërimet. Po ashtu, edhe kushtet dhe sasia e zekatit janë të njohura. Mirëpo, detyrat si: Shërbimi ndaj Islamit, xhihadi dhe predikimi i fesë, janë një urdhra për të cilat nuk është caktuar kufi. Kufiri i këtyre detyrave është vetëm aftësia dhe mundësia e personit, sepse Allahu i Madhëruar nuk urdhëron askënd përtej mundësisë së tij. Sidoqoftë, kjo do të thotë se Ai urdhëron të përdoret edhe mundësia më e vogël që zotërohet. Në Kuranin Fisnik urdhërohet që ne të lutemi me këto fjalë:

لَا تُحْمِلُنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ

“...Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim!...” (Bekare, 286.)

Pra, Allahu i Madhëruar na bën përgjegjës sipas mundësive që kemi.

- Si mund ta përcaktojë njeriu kufirin e mundësisë së vet?
- Duke zbatuar këtë urdhër hyjnor:

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ

“Kur të çlirohesh (nga një punë), përpigu fort (në një punë tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

Kështu, nëse robi e mbush çdo ditë dhe çdo pjesë të kohës së tij, që i ka falur Allahu, me adhurime dhe shërbime të mira

*Allahu i Madhëruar
kërkon prej nesh që
të marrim shembull
sahabët, në mënyrë që
të arrijmë kënaqësinë e
Tij. (Shih. Teube, 100.) Pra,
ne jemi të detyruar të
peshojmë çdo gjendje
tonën me atë të
sahabëve.*



që përfshihen në kuadrin përjetimit dhe mbajtjes së Islamit gjallë, ai mund ta ndjejë lehtë qetësinë shpirtërore të bërjes aq sa ka mundësi. Kjo detyrë është aq e rëndësishme sa:

Konceptet e zekatit, bamirësisë dhe dhurimit janë përmendur në 125 vende të Kuranit. E në fakt, dhurimi mund të kryhet jo vetëm nga mirësitë materiale, por nga të gjitha llojet e tyre. Për rrjedhojë, dikush mund shpenzojë në rrugën e Allahut me përpjekje fizike, dikush me dije, e dikush tjetër me laps.

Këto porosi të vazhdueshme janë udhëzime që na inkurajojnë drejt mëshirës, e për rrjedhojë drejt shërbimit dhe sakrificës, sepse Allahu i Madhëruar, nga Emrat e Tij të Bukur, na njofton dhe përsërit më tepër emrat, “Rahman dhe Rrahim”. Po kështu, edhe Profetin tonë ﷺ, Allahu na e prezanton si “Rauf dhe Rrahim”.

Profeti ynë ﷺ, është maja e mëshirës dhe dhembshurisë njerëzore. Ai angazhohej me problemet e umetit të tij ditë e natë dhe kumtonte vazhdimisht fenë. Për këtë arsye, ai nuk u mposht nga asnjë sprovë dhe vuajtje. Ai kurrë nuk e ndërpreu punën e tij për të pushuar. Kurrë nuk tha: “Do ta bëj më vonë!”. Ai nuk u ndikua nga lodhja, mërzia apo stresi i detyrës së tij. Profeti ynë ﷺ, mbante personalisht gurë në shpinë gjatë ndërtimit të Xhamive në Kuba dhe Medinë. Ai gjithashtu punoi së bashku me ata që gërmonin hendekun gjatë përgatitjeve për Betejën e Hendekut. Gjatë rrugës për në luftë, ai qëndronte gjithmonë në krye dhe inkurajonte ushtrinë. Kurse në

*Mahmud Sami
Ramazanoglu,
ka shëtitur fshat
më fshat me
karrocë me kalë,
duke u përpjekur
vazhdimisht të
mbante gjallë fenë
e Allahut.*



rrugën e kthimit, ai ecte në fund për të ndihmuar të dobët të kishin vështirësi, i hipte në kafshën e vet dhe lutej për ta. (Kështu që ai ishte ngushëllimi më i mirë për ta.) (shih. Ebu Daud, Xhihad, 94/2639)

Çdo gjë që bënte ishte sakrificë, gjë të cilën e shpreh më së miri fjala e nënës sonë Aishes رضي الله عنها, e cila tregon:

“Që prej ditës kur erdhën në Medinë e deri kur ai ndërroi jetë (Profeti), familja e Muhamedit صلى الله عليه وسلم, nuk është ngopur asnjëherë me bukë gruri tri net me radhë.” (Muslim, Zuhd, 20.)

“Po të donim, mund të ngopeshim.”

(Pra kjo uri nuk ishte nga skamja. Neve na vinin dhurata dhe plaçkë lufte.)

Por i Dërguari i Allahut përmbushte fillimisht nevojat e vëllezërve të tij besimtarë. (Kështu, sa herë na dhurohej diçka e ndanim për vëllezërit tanë.)” (Bejhaki, Shuab, III/62 [1396].)

E në fakt, mirësitë që i vinin, Profeti ynë صلى الله عليه وسلم, ua dërgonte sahabëve të suffes, të cilët për të kishin rëndësi të madhe sa i përket të ardhmes së Islamit. Aq, sa kënaqësia që ai ndjente kur u jepte atyre, e bënte të harronte edhe urinë e vet.

Ebu Talha رضي الله عنه, tregon:

“Një ditë, kur shkova tek Profeti صلى الله عليه وسلم, e pashë që ishte kër-rusur dhe për ta mbajtur belin drejt, kishte lidhur dy gurë në bark. Në këtë gjendje, ai u jepte mësim Kurani sahabëve të suffes.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 342.)

Musa Efendi, i cili ishte në shërbim të Sami Efendisë për shumë vite, bëri shumë udhëtime në Anadoll. Në ato kohë kur mjetet e udhëtimit dhe rrugët nuk ishin aq të përshtatshme sa sot, këto udhëtime dhe përpjekje zgjasnin 20 ditë larg shtëpive të tyre.



E gjithë kjo, sepse ai ﷺ, e shihte njerëzimin e zhytur në injorancë dhe mohim të Zotit, të digjej mes flakëve të botës shpirtërore. Dhe përballë këtyre flakëve, ai nuk mendoi as për veten dhe as për rehatinë. Le ta përfytyrojmë pak:

PËRBALLË ZJARRIT

Kemi një zjarr, brenda të cilit kanë mbetur fëmijë, njerëz të mjerë dhe breza të shkretë. Prandaj duhet shkuar për t'i ndihmuar ata.

A është e mundur që përballë kësaj tabloje njeriu ta braktisë ndihmën dhe të tërhiqet duke thënë: “Tani kam orarin e pushimit!”? Apo pritet që ai të bëjë sakrificë me aq sa ka mundësi si domosdoshmëri e besimit dhe ndërgjegjes së tij?

E në fakt, sahabët zotëronin gjithmonë këtë thellësi dhe botëkuptim. Ata shkuan në të katër anët e botës me këtë vetëdije me qëllim që të përhapnin udhëzimin.

Profeti ynë ﷺ, i cili u dha atyre këtë vetëdije, e kumtoi personalisht Islamin, fis më fis, qytet më qytet gjatë gjithë jetës së tij. Në vendet ku nuk mund të shkonte vet, ai dërgoi letra. Pas tij, sahabët e sufes, të cilët ai i edukoi me shumë kujdes, vazhduan misionin e tij gjatë gjithë jetës së tyre dhe e përhapën Islamin në gjeografi shumë të gjera.

Sahabët shkuan në Semerkand, Kinë, Kajravan dhe Afrikë për të paguar çmim-

Në momentet më të rënda të sëmundjes së tij, i nderuari Musa Efendi i lutej Allahut: “O Zoti im! Më jep shëndet e forcë dhe mundësinë të udhëtoj fshat më fshat për t’u shërbyer vëllezërve të mi!”



in e mirësisë së besimit që u dha Allahu dhe hynë në çdo vend ku jetonin njerëz. Me përpjekjet dhe sakrificat e tyre të begata, qindra mijëra njerëz u larguan nga politeizmi, injoranca dhe zjarri. Dhe të gjitha shpërblimet iu shkruan edhe atyre, që e bënë të mundur këtë mirësi, sepse në një hadith fisnik thuhet:

أَلَدَّالُ عَلَى الْخَيْرِ كَفَاعِلِهِ

“Kush hap rrugën e një mirësie, shpërblehet si ai që e bën atë mirësi!” (Muslim, Imare, 133; Ebu Daud, Edeb, 115; Tirmidhi, Ilm, 14.)

Njerëzit që nxitojnë në mirësi dhe shërbim, kur është nevoja sakrifikojnë edhe të dashurit e zemrës së tyre, duke marrë rrugët e mërgimit. Anëtarët e familjes që i mbështesin ata në kohë të tilla, bëhen gjithashtu ortakë në shpërblimet e tyre. Gratë e devotshme duhet të jenë gjithmonë pranë burrave të tyre në shërbimin ndaj fesë, besimit dhe Kuranit. Po ashtu edhe burrat ndaj grave të tyre; ata nuk duhet t’i pengojnë gratë që dëshirojnë të shërbejnë në rrugën e Kuranit.

Vetë i Dërguari i Allahut ﷺ, e kishte edukuar gruan e tij, Aishen رضي الله عنها, në fushën e fesë si njohëse të mirë të fikhut dhe në lidhje me të ka thënë:

“Një të tretën e fesë mësojeni nga shtëpia e Aishes!” (Dejlemi, II, 165/2828.)

Kështu, nëna jonë Aisha رضي الله عنها, kishte rreth 300 nxënës, të cilëve u jepte mësim me ndihmën e nipërve të saj. Siç shprehet

Omerit رضي الله عنه, gjatë kohës kur ishte Kalif tha: “Nëse do të jem gjallë do të shëtis midis njerëzve për një vit. Për Allahun! Ai vit do të jetë një vit shumë i mirë!”



Ibn Abbasi رضي الله عنه: Nuk ka asnjë muxhtehid që nuk ka përfituar prej ixhtihadit të Aishes رضي الله عنها.

Bashkëshortët nuk duhet të harrojnë kurrë se ata janë partnerë të jetës së njëri-tjetrit si në këtë botë ashtu edhe në ahiret. Ndërkohë që më parë, secili prej tyre kishte jetën e vet private, me anë të martesës ata bëhen ortakë të një fati të përbashkët. Në këtë jetë të përbashkët, ata duhet ta mbështesin njëri-tjetrin në vepra dhe shërbime të mira. Shembulli më i mirë i kësaj, është Profeti ynë ﷺ dhe bashkëshortja e tij, Hadixhja رضي الله عنها.

FAMILJA E SHENJTË

Nëna jonë Hadixhja رضي الله عنها, e pa natyrën e jashtëzakonshme të Profetit tonë ﷺ, 15 vjet para se t'i vinte profetësia dhe e vlerësoi lart personalitetin e tij. Ajo ishte një grua aq e mençur, e mirë dhe me personalitet kaq unik sa që u bë shembulli i vetëm për të gjitha gratë dhe një nënë e jashtëzakonshme për të gjithë umetin.

*Profeti ynë ﷺ,
mbante personalisht
gurë në shpinë gjatë
ndërtimit të Xhamive
në Kuba dhe Medinë.
Ai gjithashtu punoi
së bashku me ata që
gërmonin hendekun
gjatë përgatitjeve për
Betejën e Hendekut.*



Rreth moshës 40 vjeçare, Profeti ynë ﷺ, filloi të tërhiqej në vetmi, duke medituuar me ditë të tëra në shpellën Hira. Gjatë këtyre ditëve, nëna jonë Hadixhja رضي الله عنها, ia çonte ushqimin burrit të saj deri në Hira.

Kur filloi shpallja, ajo ishte e para që i besoi dhe e mbështeti. Po ashtu, vitet e para të shpalljes, ajo ishte burimi më i madh i kurajës për Profetin ﷺ. Ndërsa gjatë viteve të bojkotit, ajo e shpenzoi gjithçka kishte e nuk kishte për mysli-

manët e mbetur pa furnizime. Ajo nuk u ankua asnjëherë për gjendjen e vet. Në këmbim të këtyre sakrificave të saj, Allahu i Madhëruar dërgoi apostafat për të selam dhe myzhde.

Një ditë, meleku Xhibril عليه السلام, po bisedonte me të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe e lajmëroi atë se Hadixhja ishte duke ardhur me një enë me ushqim në duar. Më pas i tha:

“Kur Hadixhja të vijë pranë teje, jepi selamin e Zotit dhe selamin tim! Përgëzoje atë me një pallat prej perlash në xhenet! Aty nuk ka as zhurmë e as lodhje.” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 20.)

Të gëzosh nderin e selamit të Allahut, është mirësia më e madhe për një njeri!.. Nëna jonë, Hadixhja رضي الله عنها, i është përgjigjur kështu këtij selami hyjnor:

“Ai (Allahu) është Vetë Selami dhe selami është prej Tij. Edhe Xhibrilit i qoftë selam. O i Dërguar i Allahut selami, mëshira dhe begatia e Allahut qoftë edhe mbi ty!” (Ibn-i Hisham, I, 259-260; Ibn-i Asakir, Tarihu Dimeshk, V. 70, fq. 118.)

Hadixhja رضي الله عنها, emigroi tek Allahu menjëherë pas viteve të bojkotit. Vdekja e saj e hidhëroi shumë Profetin tonë ﷺ. Po atë kohë ndërroi jetë edhe kreu i fisit Beni Hashim, xhaxhai i Profetit tonë ﷺ, Ebu Talibi, i cili e mbronte atë nga sulmet e politeistëve. Me këtë rast, i Dërguari i Allahut ﷺ, u shpreh:

“Nuk di se cilës prej këtyre dy fatkeqësive, që i kanë rënë këtij umeti, t'i hidhërohem më tepër!” (Taberi, Tarih, II, 229.)

Gjatë rrugës për në luftë, Profeti ynë ﷺ, qëndronte gjithmonë në krye dhe inkurajonte ushtrinë. Kurse në rrugën e kthimit, ai ecte në fund për të ndihmuar të dobëtit që kishin vështirësi, i hipte në kafshën e vet dhe lutej për ta.



Atë vit, sahabët e quajtën, “Viti i Pikëllimit”. Në fakt, në jetën e Profetit ﷺ, ka pasur kohë edhe më të hidhura; sidomos kur ai varrosi fëmijët e tij me duart e veta, ose kur xhaxhai i tij i dashur, Hamzai ؓ dhe nxënësi i tij Mus’abi ؓ, u martirizuan brutalisht. Mirëpo ato vite nuk u quajtën “Vite pikëllimit”, por u quajt viti i vdekjes së nënës sonë Hadixhe ؓ. Ky fakt, e shpreh më së miri rëndësinë e “gruas së devotshme”.

Për rrjedhojë, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk e harroi kurrë atë dhe e përkujtoi gjithmonë me besnikëri. I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe pjesëtarët e tjerë të familjes së vet i porositi vazhdimisht të kryejnë adhurimet dhe të përpiqen në rrugën e fesë. Shembull i kësaj, janë edhe këto fjalë drejtuar vajzës së vet Fatimes ؓ:

Anadulli dhe Rumelia u nderuan me Islam falë personaliteteve shpirtërore si Ahmed Jesevi dhe nxënësve të tyre, të cilët me qëllim të predikimit të fesë, morën udhë të gjata dhe filluan të japin mësim në vende plot rreziqe, që nuk i kishin njohur kurrë më parë.



“Oj Fatime! Ruaje veten nga zjarri i xhehenemit! Unë nuk kam fuqi t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut, por, për shkak të lidhjes farefisnore që kemi, as nuk do ti pres marrëdhëniet që kam me ju!” (Muslim, Iman, 348, 351.)

Në Epokën e Lumturisë, myslimanët emigruan për hir të besimit, duke lënë pas shtëpitë, pasurinë, fisin dhe vendin ku kishin lindur e rritur. Mirëpo, të afërmit jomysliman të disa prej myslimanëve, u përpoqën t’i pengonin ata nga emigrimi (hixhreti). Si rezultat i ankimeve dhe qarjeve, disa prej tyre arritën t’i pengonin burrat apo baballarët e tyre besimtarë nga detyra e shenjtë e hixhretit. Lidhur me këtë, u zbrit ky ajet paralajmërues:

**“O besimtarë! Në të vërtetë, ju ke-
ni armiq në radhët e grave tuaja dhe të
fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre!..”**

(Tegabun, 14.)

Transmetohet edhe se, ky ajet është
zbritur në lidhje me disa familje që i
penguan kryefamiljarët e tyre të mer-
rnin pjesë në luftë në periudhën Medi-
nase. (shih. Taberi, Tefsir, XXVIII, 160-161)

Muhaxhirët bënë shumë sakrifica
në çështjen e emigrimit. Ndërsa ensarët
sakrifikuan gjithçka kishin duke ndarë
me ta çdo gjë, duke filluar nga prodhi-
met, pasuria e deri tek shtëpitë.

U zhvilluan shumë beteja; Bedr,
Uhud, Hendek, Hajber dhe Mute...
Nënat flijuan fëmijët e tyre të dashur... Në shumë beteja
morën pjesë edhe vetë gratë... Bartën ujë dhe mjekuan plagët
e të afërmve të plagosur.

Madje, në një betejë të rëndësishme kundër Bizantit, në
Jermuk; kur filluan të shfaqeshin shenja të ikjes nga lufta,
gratë myslimane si Hindi, u dhanë kurajë ushtarëve duke
thënë:

*“Ne gratë nuk ikim! Ju mund të ikni nga lufta vetëm nëse
shkelsni sipër kufomave tona!” Nëse nuk na mbroni, nuk jeni
burrat tanë!..”*

Edhe kur ata që treguan një vetëmohim të tillë dëshiru-
an të tërhiqeshin mënjanë me mendimin: “Mjaft me kaq;
pjesën tjetër ta bëjnë të tjerët!”, atyre iu refuzua kjo dëshirë.
Këtë na e tregon vetë Halid bin Zejdi رضي الله عنه, të cilin e njohim si
Ejub Sulltani:



Ebu Talha رضي الله عنه, tregon:

*“Një ditë, kur shkova
tek Profeti ﷺ, e pashë
që ishte kërrusur dhe
për ta mbajtur belin
drejt, kishte lidhur
dy gurë në bark. Në
këtë gjendje, ai u
jepte mësim Kurani
sahabëve të suffes.”*

(Ebu Nuajm, Hilje, I, 342.)

KY RREZIK, ËSHTË TJETËR!

Në periudhën Emevite, ushtria Islame erdhi deri në Kostandinopojë me dëshirën që të bëhej pjesë e përgëzimit të Profetit ﷺ, për çlirimin e saj. Në këtë ushtri bënte pjesë edhe sahabiu Ebu Ejjub el-Ensari رضي الله عنه. Ndërkohë që bizantinët luftonin duke lënë muret e qytetit pas shpine, një sahab prej ensarëve u fut me kalin e tij deri në mes të ushtrisë bizantine. Kur një prej ushtarëve myslimanë e pa këtë, duke marrë shkas prej ajetit fisnik i cili urdhëron: **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!”**, tha me qortim:

“La ilahe il-lallah! Shikojeni atë! Ai po e hedh veten në rrezik me vetëdije!”

Ndërsa Ebu Ejjub el-Ensari رضي الله عنه, tha:

*“O besimtarë! Ky ajet ka zbritur për ne ensarët. Kur Allahu e ndihmoi të Dërguarin e Tij ﷺ dhe e bëri triumfuese fenë e Tij, ne thamë: «Tashmë do të qëndrojmë pranë pasurisë sonë dhe do të merremi vetëm me shtimin e saj!» Për këtë arsye, u zbrit edhe ajeti fisnik: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** (Bekare, 195) Qëllimi i shprehjes “mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja”, në këtë ajet, është që ne të mos zhytemi në çështjet e kësaj bote dhe të merremi vetëm me vresh-tari e kopshtari, duke braktisur apo neglizhuar përpjekjet në rrugën e Allahut.” (shih. Ebu Daud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhi, Tefsir, 2/2972)*

Profeti ynë ﷺ, e kumtoi personalisht Islamin, fis më fis, qytet më qytet gjatë gjithë jetës së tij. Në vendet ku nuk mund të shkante vet, ai dërgoi letra. Pas tij, sahabët e suffes, të cilët ai i edukoi me shumë kujdes, vazhduan misionin e tij gjatë gjithë jetës së tyre dhe e përhapën Islamin në gjeografi shumë të gjera.



Kështu, në rrugën e kumtimit të Islamit dhe vendosjen e drejtësisë mbi tokë, janë bërë sakrifica të shumta.

Për shembull, Iraku, Siria dhe zonat përreth Egjiptit u bënë qytete Islame falë brezave të sahabëve dhe tabiinëve që i morën dhe u vendosën në ato toka për herë të parë dhe vazhduan kumtimin dhe udhëzimin në Islam. Nga 120,000 sahabët që morën pjesë në Haxhin e Lamtumarës, vetëm 20,000 janë të varrosur në vendet e tyre. Pjesa më e madhe e sahabëve vdiqën në qytetet ku ata shkuan për të kumtuar Islamin, për të luftuar në rrugën e Allahut dhe për të ndërtuar shoqëritë e reja Islame, me ç'rast u dhanë jetë atyre qyteteve.

Anadulli dhe Rumelia u nderuan me Islam falë personaliteteve shpirtërore si Ahmed Jesevi dhe nxënësve të tyre, të cilët me qëllim të predikimit të fesë, morën udhë të gjata dhe filluan të japin mësim në vende plot rreziqe, që nuk i kishin njohur kurrë më parë. Madje, jo vetëm liderët shpirtërorë dhe nxënësit e tyre, por edhe sulltanët më të fuqishëm do të dujonin të gjitha llojet e vështirësive në rrugën e përhapjes dhe mbajtjes gjallë të Islamit.

SAKRIFICA E SULLTANIT

Sulltan Fatihu, kishte nisur fushatën ushtarake ndaj Perandorisë Romake të Trabzonit. Për t'iu afruar qytetit nga pas, duhej kaluar përmes një terreni malor dhe me pyll. Ndonjëherë

Njerëzit që nxitojnë në mirësi dhe shërbim, kur është nevoja sakrifikojnë edhe të dashurit e zemrës së tyre, duke marrë rrugët e mërgimit. Anëtarët e familjes që i mbështesin ata në kohë të tilla, bëhen gjithashtu ortakë në shpërblimet e tyre.



grupit të druvarëve u duhej të hapnin rrugën përpara. Në një vend ku rruga nuk ishte e përshtatshme, Fatihut i rrëshqiti kali. Ndërkohë që Fatihu po përpiqej të mbahej në një shkëmb, iu gjakosën duart. Kur e ëma e Uzun Hasanit, zonja Sara e vuri re këtë, mendoi se ishte momenti i duhur dhe i tha:

“Bir! Ti je sulltan, bir sulltani! Je një sundues i fuqishëm! A ia vlejnë gjithë këto vuajtje për një kështjellë të vogël si ajo e Trabzonit?”

Në fakt, Uzun Hasani, kishte krijuar lidhje farefisnore me Perandorinë Romake të Trabzonit dhe, për këtë arsye e kishte dërguar të ëmën që t'i lutej Fatihut të hiqte dorë nga kjo fushatë. Fatihu, ashtu si ishte me duar të gërvishtura, u drejtua dhe i jep asaj një përgjigje të mrekullueshme:

“Oj nënë e moçme! A s'ë di ti, se kjo që mbajmë në duar është shpata e fesë Islame? Mos pandeh se të gjitha këto mundime që po heqim janë vetëm për një copë

toke të thjeshtë! Dije, se të gjitha përpjekjet tona janë në shërbim të fesë së Allahut! Për t'i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë! Që nesër, kur të dalim para Allahut, të mos na nxihet fytyra! Nëse kemi në dorë mundësitë e kumtimit dhe lartësimit të Islamit dhe, parapëlqejmë rehatinë e trupit, duke iu shmangur disa vuajtjeve, a do mund ta meritojmë titullin veteranë lufte? Nëse nuk ua çojmë Islamit jomyslimanëve, nëse nuk bëhemi pengesë e harbimit të tyre, me ç'fytyrë do të dalim në audiencën hyjnore?” (Shih. Kınalızade Ali Efendi, Dev-

let ve Aile Ahlaki, përk. Ahmed Kahraman, red, 191 - 192; Mustafa Nuri Paşa, Netaixhu'l-Vukuat, I - II, 45)

*Gratë e devotshme
duhet të jenë
gjithmonë pranë
burrave të tyre në
shërbimin ndaj fesë,
besimit dhe Kuranit.
Po ashtu edhe burrat
ndaj grave të tyre; ata
nuk duhet t'i pengojnë
gratë që dëshirojnë të
shërbejnë në rrugën e
Kuranit.*



Jashtëzakonisht mësimdhënëse është

edhe kjo ngjarje që tregon vetë Barbaros Hajredin Pasha lidhur me përpjekjet në rrugën e Allahut:

“Një radhë, për shkak të lodhjes nga fitoret luftarake të mëdha që kisha bërë, desha të çlodhesha, prandaj në fushatën e re nuk shkova vetë, por dërgova Sinan Pashën. Atë natë, në ëndërr, më thanë:

«O Hajredin! Nuk ka prehje në këtë botë të rreme! Prehja është vetëm në xhenetin e lartë! Ngrihu menjëherë dhe dije se ndihma e Allahut është me ty!»

Kur më doli gjumi, thashë me vete:

«Falënderuar qoftë Allahu që më shpëtuan nga një gabim i madh!»

Më pas, ndava shumë sadaka dhe ushqeva e veshja shumë të varfër!”

Ndërsa poeti i njohur Mehmed Akif Ersoj, i shpreh me këto vargje përpjekjet e jashtëzakonshme të atyre kohëve:

Mos pandeh se gjyshërit e tu për shekuj kanë fjetur,
Ku do ta gjeje atëherë vendin që sot zotëron?
Në tre kontinente gjurmët e përgjakura këtë e dëshmojnë,
Ai luftëtar i madh me famë një ditë nuk u çlodh!..

PLOGËSHTIA ËSHTË HUMBJE

Kur u bënë përpjekje vetëmohuese, erdhën fitoret dhe zgjerimet. Por, kur u shfaq dhënia pas rehatisë si në Epokën e Tulipanëve, pasuan humbje të mëdha. Vazhdimësia e shër-

Nëna jonë Aisha
ﷺ, kishte rreth 300
nxënës, të cilëve u
jepte mësim me
ndihmën e nipërve të
saj. Siç shprehet Ibn
Abbasi ﷺ: Nuk ka
asnjë muxhtehid që
nuk ka përfituar prej
ixhtihadit të Aishes ﷺ.



bimit dhe përpjekjeve është e detyrueshme për një besimtar që dëshiron të mbrojë veten nga rreziqet e së ardhmes. Gradat dhe titujt që merren në këtë botë, mbeten të vlefshme në këtë botë. Kurse gradat që arrihen në jetën shpirtërore, janë të ekspozuara ndaj rrezikut të humbjes nëse nuk u dilet për zot. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 99.)

Shfaqja e kësaj devotshmërie nuk është e posaçme vetëm në adhurimet individuale.

Një besimtar duhet së pari të ringjallë veten, dhe pastaj, me mëshirën që është fryt i besimit në zemër, ai duhet të përpiqet të bëhet një person i mëshirës ndaj të tjerëve. Në fakt, urdhërimi në punë të mira dhe ndalimin nga të këqijat, përmenden në 11 vende në Kuran. Ata që si sahabët, të cilët qëndruan vazhdimisht rreth të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe shërbyen me vetëmohim si ai, dhe brezat që pasuan e u kapën pas Islamit me gjithë zemrën e tyre, merituan lavdërime hyjnore. Profeti ynë ﷺ, thotë:

“Umeti im i ngjan shiut, që nuk dihet se cila pjesë është më e mirë, fillimi apo fundi i tij.” (Tirmidhi, Edeb, 81/2869; Ahmed, III, 130.)

Çdo besimtar duhet të përpiqet ta arrijë këtë përgëzim. Anëtarët e familjes gjithashtu duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin për këtë ideal, dhe të gjithë duhet të bëjnë sakrifica në mënyrë që t'i japin të drejtën e Vet Allahut dhe t'i dalin zot amanetit të Profetit ﷺ.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Kush hap rrugën e një mirësie, shpërblehet si ai që e bën atë mirësi!”

(Muslim, Imare, 133;
Ebu Daud, Edeb, 115;
Tirmidhi, Ilm, 14.)



Sepse përgjegjësia është e madhe. Ebu Hurejre رضي الله عنه, e shpjegon kështu këtë përgjegjësi:

“Dëgjonim (që ndër sahabë thuhej):

Ditën e kiametit, dikush do të kapet për jake nga një njeri që ai nuk e njeh fare. I habitur, thotë:


«Çfarë do prej meje në këtë kohë dhe në këtë çast kaq të vështirë? Unë nuk të njoh fare!» Ai që e ka kapur për jake i thotë:

«Kur ishim në jetën e dynjasë, më pe në punë të këqija dhe nuk më qortove, nuk më ndalove nga e keqja.»” (Mundhiri, et-Tergib ue't-Terhib, III, 164/3506; Rudani, Xhem'u'l-Feuaid, V, 384)

Këtë përgjegjësi e kanë kuptuar më së miri edhe njerëzit e devotshëm gjatë gjithë historisë:

PREDIKIMI I FESË DUKE SHËTITUR FSHAT MË FSHAT

Me dobësimin e përpjekjeve fizike dhe shpirtërore të myslimanëve, erdhi dita kur të thuash Allah dhe të flasësh për Islamin konsiderohej krim. Mirëpo, falë hoxhallarëve dhe njerëzve të urtë, të devotshëm, të guximshëm dhe të zellshëm, ky trend i jo fetarisë, i cili zgjati me vite dhe në disa vende u bë aq i rëndë saqë nuk mund të gjendej asnjë hoxhë për të falur një xhenaze, nuk mundi ta çrrënjoste Islamin në vendin tonë. Ata i mësonin fëmijët fshehurazi në hambarë, male dhe ara dhe nuk e linin këtë vend pa Kuran.



Bashkëshortët nuk duhet të harrojnë kurrë se ata janë partnerë të jetës së njëri-tjetrit si në këtë botë ashtu edhe në ahiret. Ndërkohë që më parë, secili prej tyre kishte jetën e vet private, me anë të martesës ata bëhen ortakë të një fati të përbashkët. Në këtë jetë të përbashkët, ata duhet ta mbështesin njëri-tjetrin në vepra dhe shërbime të mira.

Një nga këta personalitet të shquar ishte edhe Mahmud Sami Ramazanoglu, i cili duke shëtitur fshat më fshat me karrocë me kalë, u përpoq vazhdimisht të mbante gjallë fenë e Allahut.

Babai im i ndjerë Musa Efendi, i cili ishte në shërbim të Sami Efendisë për shumë vite, bëri shumë udhëtime në Anadoll. Në ato kohë kur mjetet e udhëtimit dhe rrugët nuk ishin aq të përshtatshme sa sot, këto udhëtime dhe përpjekje zgjasnin 20 ditë larg shtëpive të tyre.

Tregohet se:

Kur shkonin në ndonjë qytet, ku nuk kishin vend për të qëndruar, për shkak se nuk do të gjenin hotele me ndjeshmëri Islame, ata nuk qëndronin nëpër hotele, por shkonin në ndonjë xhami, i kërkonin myezinit batanije dhe e kalonin natën aty.

*Nëna jonë Hadixhja
ﷺ e pa natyrën e
jashtëzakonshme të
Profetit tonë ﷺ, 15
vjet para se t'i vinte
profetësia dhe e vlerësoi
lart personalitetin e tij.
Ajo ishte një grua aq e
mençur, e mirë dhe me
personalitet kaq unik
saqë u bë shembulli
i vetëm për të gjitha
gratë dhe një nënë e
jashtëzakonshme për të
gjithë umetin.*



Edhe në momentet më të rënda të sëmundjes së tij, i nderuari Musa Efendi i lutej Allahut: “O Zoti im! Më jep shëndet e forcë dhe mundësinë të udhëtoj fshat më fshat për t’u shërbyer vëllezërve të mi!”.

Pasioni dhe përpjekja e tij për shërbimin, i ngjan kësaj dëshire të Omerit رضي الله عنه, gjatë kohës kur ishte Kalif:

“Nëse do të jem gjallë do të shëtis midis njerëzve për një vit. E di që njerëzi kanë nevoja që nuk mund të m’i paraqesin. Kurse guvernatorët nuk m’i informojnë dhe as vetë nuk vijnë tek unë.

- Do të shkoj në Sham dhe do të qëndroj dy muaj.

- Pastaj do të shkoj Xhezire dhe atje do të qëndroj dy muaj.
- Pastaj do të shkoj në Egjipt ku do të qëndroj përsëri dy muaj.
- Do të shkoj në Bahrejn e do të qëndroj po dy muaj.
- Do të shkoj në Kufe dhe do të qëndroj dy muaj.
- Po ashtu edhe në Basra do të qëndroj dy muaj.

Për Allahun! Ai vit do të jetë një vit shumë i mirë!” (Taberi, Tarih, Bejrut: Daru't-Turas, 1387, IV, 201-202)

Sot, një tjetër dobi i të jetuarit të jetës plot me përpjekje për të zbatuar dhe mbajtur Islamin gjallë, është ruajtja nga telashtet dhe fatkeqësitë e kohës.

NË INJORANCËN E DITËVE TONA

Sot, me mundësitë në zhvillim, edhe rrugët e së mirës, edhe ato të së keqes janë bërë më të lehta. Nëse këto lehtësira nuk përdoren për bamirësi, dhurim dhe shërbim, dikush mund të bjerë shumë lehtë pre e dëshirave të ulët ta egos, egoizmit dhe haremeve të shumta.

Televizioni dhe Interneti janë si kurthe që kapin njerëzit që rrinë kot. Shumë biznese dhe mjedise pune janë plot fenomene negative që nuk përputhen me Islamin.

Prandaj, në një situatë të tillë, njeriu që ka fëmijë, bashkëshort/e ose prindër që kryejnë shërbime në rrugë të hajrit, duhet të falënderojë dy herë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, e porositi vazhdimisht familjen e tij, të kryejnë adhurimet dhe të përpiqen në rrugën e fesë. Ja si i drejtohet ai vajzës së tij Fatimes ﷺ:

“Oj Fatime! Ruaje veten nga zjarri i xhehenemit! Unë nuk kam fuqi t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut, por, për shkak të lidhjes farefisnore që kemi, as nuk do ti pres marrëdhëniet që kam me ju!”

(Muslim, Iman, 348, 351.)



Islami i ka dhënë një disiplinë jetës, duke sistemuar dhe organizuar më së miri jetën individuale, familjare dhe shoqërore të besimtarit. Mirëpo, zbatimi i këtij sistemi herë pas here shfaq edhe ndryshime.

Ne nuk jetojmë në epokën e Sulltan Mehmed Fatihut. Kur krahasojmë atë epokë me të sotmen, shihet se të dyja epokat kanë anët e vështira dhe të lehta në krahasim me njëra-tjetrën. Por, në çdo epokë, besimtari do të veprojë në përputhje me detyrat që i takojnë.

Sa i përket shërbimit dhe përpjekjeve, nuk do të ishte e drejtë që ne të krahasohemi me njerëzit e paditur dhe të paedukuar të shoqërisë. Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh që të marrim shembull sahabët, në mënyrë që të arrijmë kënaqësinë e Tij. (Shih. Teube, 100) Pra, ne jemi të detyruar të peshojmë çdo gjendje tonën me atë të sahabëve.

Sot, Islami sulmohet nga të gjitha anët, sepse Islami është e vërteta e vetme që na kujton ahiretin dhe thërret në drejtësi. Prandaj, është e detyrueshme që edhe besimtarët të përpiqen për triumfin e Islamit.

Sot, Islami sulmohet nga të gjitha anët, sepse Islami është e vërteta e vetme që na kujton ahiretin dhe thërret në drejtësi. Prandaj, është e detyrueshme që edhe besimtarët të përpiqen për triumfin e Islamit.

Jeta e kësaj bote është e përkohshme, jeta e vërtetë është jeta e ahiretit. Lumturinë e jep vetëm Allahu i Madhëruar. Prandaj, familjet duhet të kapen për litarin e Allahut, Kuranit dhe Islamit së bashku, në mënyrë që të mos detyrohen të ndahen në Ditën e Gjykimit, që është edhe dita e



ndarjeve më të tmerrshme. Ata duhet të inkurajojnë njëri-tjetrin në adhurime dhe shërbime në rrugë të Allahut.

Atë ditë të vështirë, do të kemi shumë nevojë qoftë edhe për një sadaka të vogël. Burrat dhe gratë, të cilët e kanë mbështetur njëri-tjetrin në shërbime, vepra të mira dhe bamirësi, do të zotërojnë sadaka të shumta në vendin e gjykimit. Ajo është një ditë e atillë, kur edhe njerëzit e mirë do të pendohen duke thënë: “Ah sikur të kishim bërë më shumë vepra të mira!..”.

Kjo i ngjan këtij shembulli:

PARA SE TË THEMI “AH SIKUR” ...

Ata që njihnin çmimin e tokës para se t’i ngrihej vlera, i thonë njëri-tjetrit:


“Ah sikur të kisha blerë edhe unë kur ishte më lirë. Tani do të kisha fituar shumë!..”

Mirëpo, edhe ata që kanë blerë tokë në kohën kur ka qenë lirë, do të thonë:

“Ah sikur të kisha blerë më shumë!”

Ja pra, ne jemi të detyruar të mendojmë për keqardhjen që do të përjetojmë në botën tjetër, e cila do të jetë shumëfish më e madhe se kjo.

I vetëdijshëm për këtë, besimtari duhet të përpiqet shumë të mos bjerë në kthetrat e justifikimeve të kësaj bote, në mënyrë që keqardhja që do të përjetojë Ditën e Gjykimit të mos jetë e



shumëfishtë. Gjithashtu, ai duhet të mbështesë ata që përpiqen në këtë rrugë, t'u japë forcë dhe krahë, duke u bërë ortakë me ta në punët e tyre të mira. Nuk duhet harruar, se pushimi i vërtetë do të fillojë në varr dhe do të zgjasë deri në ditën e ringjalljes.

Po ashtu, duhet të mendojmë se:

Ka njerëz që shpenzojnë gjithë kohën dhe mundësitë e tyre në disa kënaqësi dhe hobe të çuditshme si: kalimi i oqeanit me një varkë me vela, ngjitja në male, etj., Dhe për këtë, ata nuk kritikohen nga të afërmit e tyre, por përkundrazi përgëzohen për këto nisma.

Po ashtu, ka njerëz që bëjnë kampe për gara sportive, njerëz që mbyllen në biblioteka për një tezë dhe nuk shohin askënd, dhe të tjerë që dërgohet në një vend të huaj për një mision të caktuar. Këta njerëz, e rregullon jetën e tyre në përputhje me këto aktivitete dhe të gjithë i përgëzojnë ata. Mirëpo, edhe pse janë pjesë e jetës së kësaj bote, këto janë dëshira dhe pasione që vijnë e ikin. Në një ajet fisnik urdhërohet:

عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ

“...që kanë punuar e janë rraskapitur (e kanë çuar jetën dëm në punë të padobishme).” (Gashije, 3.)

Përkundër kësaj, ndaj atyre që shpenzojnë kohën dhe mundësitë e tyre në rrugën e Allahut, nuk tregohet kaq interes dhe mbështetje. Mirëpo, këta janë ata të cilët duhen ndihmuar, e jo penguar.

Elementi më i rëndësishëm që përcakton se ku do t'i shpenzojë mundësitë e veta një person, është rrethi i tij. Në këtë

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”
(Tahrim, 6.) *Fëmijët tanë na janë lënë amanet nga Zoti dhe ne kemi përgjegjësi për ta!*

عَالِيَةَ

kontekst, kjo këshillë e Aliut ﷺ, është shumë domethënëse:

“Ndërpritini lidhjet me këta tre persona:


- **Frikacakun** (sepse ju dobëson guximin dhe vullnetin për punë të mëdha.)

- **Koprracin** (sepse ju largon nga bamirësia, duke ju frikësuar me vështirësitë dhe problemet që mund të shfaqen në të ardhmen.

- **Lakmitarin** (sepse jua zbukuron lakminë dhe ju nxit në padrejtësi. Ai ju zhyt në dëshirat dhe pasionet e kësaj bote, që do t’ju bëjnë të lini mënjane botën tjetër. Ai e sheh jetën e kësaj bote të gjatë e të pafund me dëshirat e tij të pafundme dhe, për përpjekjet në lidhje me botën tjetër, thotë: “Keni ende kohë!”. Kështu ai bëhet i shkujdesur, nuk mendon për të ardhmen e ahiretit, pëson disfatë dhe të njëjtën fatkeqësi do t’jua shkaktojë edhe juve.)”

Kur shikojmë historinë tonë, vërejmë se burrat garuan me njëri-tjetrin në rrugën e xhihadit, kumtimit të fesë, diturisë, kulturës dhe shërbimit, ndërsa gratë në themelimin e vakëfeve, në bërjen e bamirësive dhe lënien e veprave të shumta si sadaka xharije.

Për shembull, shumica e xhamive madhështore historike në lagjen Uskudar të Stambollit, janë vepra të zonjave sulltane-sha. Trashëgimitë që ato lanë pas, ishin vepra dhe institucione si: Xhami, çezma, spitale dhe shkolla të Kuranit, të cilat pasuruan shoqëritë si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.



*Shoqëritë përjetësohen
në duart e grave të
mira dhe shkatërrohen
në duart e grave të
këqija. Si pasojë e
nënave indiferente,
shoqëritë mbushen
me xhama të thyer,
të cilat shkatërrojnë
brezat e rinj.*

Një grua e devotshme, është mbështetësja më e madhe e burrit të saj, mësuesja dhe edukuesja e parë dhe më e rëndësishme e fëmijëve të mbarë. Nëna të tilla të virtytshme meritojnë mirënjohjeje gjatë gjithë jetës.

Profeti ynë ﷺ, ka thënë:

“Nga bota juaj më janë bërë të dashura tre gjëra:

- 1. Namazi, që është drita e syve të mi.*
- 2. Era e mirë (parfumi).*
- 3. Bashkëshortja e devotshme.”* (Nesai, Ishretu'n-Nisa, 10.)

“Xheneti është nën këmbët e nënave!” (Sujuti, Xhamiu's-Sagir, I, 125.)

Shpërblimi më i madh për prindërit në këtë botë, është të arrijnë edukimin e pasardhësve të tyre në rrugën e Zotit. Për këtë, ata duhet të mendojë për nënshtrimin dhe dorëzimin ndaj Allahut, të Ibrahimit ﷺ, bashkëshortes së tij, Haxheres dhe djalit të tij Ismailit ﷺ.



Shoqëritë përjetësohen në duart e grave të mira dhe shkatërrohen në duart e grave të këqija. Si pasojë e nënave indiferente, shoqëritë mbushen me xhama të thyer, të cilat shkatërrojnë brezat e rinj. Lidhur me gra të tilla, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“...(Gjatë miraxhit) Mu tregua xhehenimi dhe pashë se shumica e banorëve të tij, ishin femra.” (Buhari, Nikah 88, Rikak 16, 51, Bed'u'l-halk 8; Muslim, Dhikr 94. shih. Tirmidhi, Xhehenem 11)

Shpërblimi më i madh për prindërit në këtë botë, është të arrijnë edukimin e pasardhësve të tyre në rrugën e Zotit. Për këtë, ata duhet të mendojë për nënshtrimin dhe dorëzimin ndaj Allahut, të Ibrahimit ﷺ, bashkëshortes së tij, Haxheres

dhe djalit të tij Ismailit ﷺ. Po ashtu, duhen kujtuar sahabët dhe të parët tanë dhe nuk duhet harruar se përveç sakrificës nuk ka zgjidhje tjetër.

SI DO TË FITOSH?

Beshir bin Hasasijje ﷺ, rrëfen:

“Shkova tek Resulullahu ﷺ, për t’i dhënë besën. Ai më vuri kusht që të dëshmoja se përveç Allahut s’ka Zot tjetër dhe se ai ishte i Dërguari i Tij, të falja namazin, të jepja zekatin, të kryeja haxhin, të agjëroja Ramazanin dhe të luftoja në rrugë të Allahut. Ndërsa unë i thashë:

«O i Dërguar i Allahut! Pasha Allahun, dy prej këtyre nuk i bëj dot. Ato është lufta në rrugë të Zotit dhe sadakaja. Njerëzit thonë se Allahu e dënon atë që i shmanget xhihadit. Mirëpo, unë kam hall se kur të dal në fushëbetejë, do më kaplojë frika nga vdekja dhe do të iki nga lufta. Sa i përket sadakasë, unë kam vetëm disa dhen dhe nja katër a pesë deve. Ato janë buri mi i jetesës së familjes sime dhe kafshë udhëtimi.»

Resulullahu ﷺ, më kapi dorën, e tundi dhe tha:

«Xhihad s’bën, sadaka s’jep! Po mirë, me çfarë do të hysh në Xhenet?»

Pas kësaj, i thashë:

«O Resulullah! Ta japë besën!», dhe u betova për të gjitha kushtet që më vuri i Dërguari i Allahut ﷺ.” (Ahmed, V, 224.)

Shejh Sadi:
“Nëse dëshiron
të shpëtosh prej
halleve, bëhu
ilaç për hallet e
hallexhinjve!..”



Justifikime të tilla si: “Pasurinë dhe jetën e kam të çmuar.”, “Duhet të ndaj më shumë kohë për veten.” dhe “Më prishet rehatia”, nuk kanë asnjë vlerë tek Allahu dhe i Dërguari i Tij ﷺ.

Sigurisht që, në këtë garë shërbimi dhe përpjekjeje, bashkëshortët duhet t’i afrohen njëri-tjetrit me butësi dhe pa u zemëruar. Ata duhet të shprehin fjalë të buta ndaj njëri-tjetrit. Nëse gruaja mbështet burrin e saj dhe burri gruan e tij, ata bëhen si sadaka xharije ndaj njëri-tjetrit dhe marrin një pjesë të shpërblimeve nga shërbimet dhe përpjekjet e njëri-tjetrit.

Siç e kemi shprehur që në fillim;

Njeriu duhet të kujdeset ndaj të drejtave të familjes së vet. Mirëpo, edhe familja e tij nuk duhet të harrojë se, e drejta e parë që duhet respektuar, është ajo e Allahut të Madhëruar.

Gratë dhe fëmijët janë amanete të Zotit dhe respektimi i këtyre amaneteve është kusht. Mirëpo, besimtari e ka për detyrë të respektojë edhe amanetin që ka lënë i Dërguari i Allahut ﷺ.

Prandaj, duhet që ne të bëjmë një jetë të qetë adhurimi dhe shërbimi në përputhje me parimet Islame. Brenda mundësive, brenda ekuilibrit të jetës...


Allahu i Madhëruar na bëftë prej robërve të cilët ndihmojnë fenë e Tij, duke e përjetuar dhe duke e mbajtur gjallë atë; ashtu që të arrijmë ndihmën hyjnore dhe të bëhemi prej atyre që janë të ruajtur nga rrëshqitja e këmbës në frymën e fundit!

*Shejh Sadi Shirazi thotë:
“Në shikimin e njerëzve të mençur, çdo gjethë peme është një poezi e mrekullueshme që dëfton Allahun. Ndërkohë që për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethë.”*



Allahu i Madhëruar na bëftë njerëz të mëshirës si individë, familje dhe shoqëri dhe prej robërve fatlumë, për të cilët Profeti ﷺ, ka thënë: “Më ka marrë malli për vëllezërit e mi”!

Amin!..



Përmbajtja

PREZANTIM	05
PARAFJALË.....	13

DIJA E DOBISHME23

Ndjekja e rrugës së drejtë, është e vetmja derë shpëtimi, paqeje, lumturie dhe mëshire për birin e njeriut. Pasimi i rrugës së ndritur të Profetit tonë (a.s.), na shpie drejt një jete të mbushur me virtyte të larta dhe na bën të kuptojmë më mirë enigmën e të qenit një Kuran i gjallë. Një dije dhe arsim, të cilin e lexon zemra, e jo vetëm syri dhe mendja... Ky është arsimimi më madhështor dhe më cilësor.



DIJA E DOBISHME	25	ARSIMIMI I VËRTETË.....	35
MËSUESI UMMI	25	MISTERI QË I JEP VLERË NJERIUT:	
LIDERI MË I MADH.....	27	DEVOTSHMËRIA	36
DIJA E DOBISHME	28	DITURIA DHE DEVOTSHMËRIA ISLAME... ..	40
KUR BËHET FJALË PËR ARSIMIM	31	E ARDHMJA JONË	41

MEDITIMI45

Besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se prej nga dhe si ka ardhur, si vazhdon të jetojë, kush ia ka dhënë fytyrën dhe pamjen, kush ia ka caktuar jetëgjatësinë, për ku është duke shkuar, se jeta dhe gjithësia nuk janë pa urtësi dhe se asgjë nuk është krijuar kot dhe pa kuptim. Ai duhet të mendojë se nuk është lënë pa përgjegjësi dhe të njohë gjithmonë fuqinë dhe madhësitinë hyjnore.



MEDITIMI	47	TË NDJESH PROFETIN (A.S.)!	57
BINDJA NDAJ TIJ,		NXËNËS TË VEÇANTË	59
ËSHTË BINDJE NDAJ ALLAHUT	47	MEDITIMI; ÇELËSI I BESIMIT	61
ZEMRA JONË DUHET TË MBUSHET		BOTA E PËRBËRË PREJ FJALËVE: KURANI	62
ME DASHURINË NDAJ TIJ	49	A NUK LOGJIKONI?	64
SI FLUTURA E NATËS.....	51	SHKOLLA E UNIVERSIT	67
ME DASHURINË PËR PROFETIN (A.S.)	54	UDHËZUESI YNË NË MEDITIM.....	68

FETANET, FIRASET DHE BASIRET 71

Allahu i Madhëruar, çdo cilësi të Profetit tonë (a.s.), e ka bërë udhëzim dhe shembull të përkryer për të gjithë umetin Islam. Ai e ka lavdëruar sinqeritetin, besnikërinë, pastërtinë shpirtërore, orientimin dhe moralin e tij të lartë.



FETANET, FIRASET DHE BASIRET	73	GJENIALITETI I FATIHUT.....	82
AFTËSIA PERCEPTUESE		PROJEKTET E SË ARDHMES.....	83
DHE INTELIGJENCA PROFETIKE	73	LARGPAMËSIA NË ABDIKIM	85
MENDJEMPREHTËSIA		MENDJA E SHËNDOSHË	87
E PROFETIT IBRAHIM (A.S.).....	74	ME DORËZIMIN NUK DUHET ABUZUAR	89
ZGJIDHJA QË NDALOI LUFTËN.....	75	BESIMTARI NUK MASHTROHET	90
FIRASETI/INTUITA E BESIMTARIT	77	RRUGA E KURANIT DHE SUNETIT	90
METODA E KUMTIMIT	78	KËSHILLA TË URTA	91
MENDJA NËN EDUKIMIN E SHPALLJES.....	80		

SIDK, EMANET DHE ISMET 95

Në suren Fatiha, Allahu ka vendosur një ajet, të cilin saherë që ne e këndojmë, i lutemi Atij për orientimin në rrugë të drejtë. Ky orientim duhet të jetë besimi i shëndosh, vepra e sinqertë dhe morali i bukur.



SIDK, EMANET DHE ISMET.....	97	EDUKIMI HYJNOR	110
MIRËSIA E MADHE.....	97	GJUHA E SË VËRTETËS	112
INDIFERENCA NDAJ TIJ ËSHTË HUMBJE	98	MËSHIRË E PASHOQE.....	113
ZGJERIMI I KRAHARORIT	100	I PALËKUNDSHËM NË RRUGË TË DREJTË	115
SHSEMBULLI MË I VEÇANTË		RUAJTJA E PJEKURISË SHPIRTËRORE	
I ZEMRËS SË PASTËR.....	103	TË FITUAR GJATË RAMAZANIT.....	117

BOTËKËPTIMI ISLAM 123

Ajetet e Kuranit të përkujtojnë mirësitë e Allahut dhe nxisin në meditim rreth tyre. Po ashtu, të vetëdijesojnë ndaj artit të Allahut në botën tonë të brendshme dhe të jashtme, duke na ndihmuar të arrijmë tek Artisti nëpërmjet artit, tek Shkaktari nëpërmjet pasojës.



BOTËKËPTIMI ISLAM.....	125	KERIM, MARIF, LEJJIN.....	133
MBROJTJA E IDENTITETIT	125	HISTORIA	135
KULTURA E KURANIT.....	126	KY ËSHTË ARSIMIMI I VËRTETË!.....	138
RËNDËSIA E GJUHËS	129		

MORALI I BESIMIT DHE RAMAZANI I BEKUAR 141

Në çgjendje jemi në garën e virtyteve? Sa pikë mund t'i japim vetes në çështjen e të qenit të kënaqur me Allahun? A lutemi vazhdimisht?



MORALI I BESIMIT DHE RAMAZANI I BEKUAR.....	143	ATA DALLOHEN NGA SHENJA E SEXHDES	155
NJERËZIT PRANË PROFETIT (A.S.)	143	SI DRITHI	156
HERONJTË E MONOTEIZMIT.....	145	PO GJENDJA JONË?.....	162
SOLIDARITETI	147	ÇFARË NIVELI KANË RAMAZANET TONA?	163
NAMAZI.....	151	NATA E KADRIT.....	166
TË DORËZUAR SHPIRTËRISHT	153		

LAVDI DHE FALËNDERIMI 169

Për t'u bërë një rob që falënderon ashtu siç duhet, nuk mjafton vetëm të dish se mirësitë që të jepen janë nga Allahu dhe ta shprehësh këtë me gojë. Por, është e domosdoshme t'i kryejmë siç duhet adhurimet dhe sjelljet e mira ndaj Zotit tonë.



LAVDI DHE FALËNDERIMI	171	LAVDI DHE FALËNDERIMI I TIJ	178
KRITERI I PRANIMIT	171	ABD-I SHEKUR.....	179
VAZHDIMI I GJENDJES SË RAMAZANIT.....	174	EDHE PËR HALLALLIN KA LLOGARI!	181
ÇFARË NA MBETI PREJ RAMAZANIT?	176	MIRËSITË SHPIRTËRORE.....	183

DURIMI DHE ORIENTIMI 189

Durimi, është aftësia për të qenë përherë mik me Allahun, duke treguar pëlqim ndaj çdo caktimi hyjnor. Është ruajtja e qetësisë ndaj ndodhive që shkaktojnë dhimbje, duke u strehuar tek Allahu...



DURIMI DHE ORIENTIMI.....	191	S'MUND TË GJEJË QETËSI PA E PARË ATË!	200
DITURIA EKZOTERIKE/DHAHIRI		MUNDËSI SHPËRBLIMI	202
DHE EZOTERIKE/BATINI	191	PASION SHPIRTËROR	204
ORIENTIMI	194	ZBUKURIMI I VDEKJES	206
DURIMI	197	MBUROJA PROFETIKE.....	208
DORËZIMI NDAJ KAKTIMIT HYJNOR	199		

MODESTIA DHE PËRULJA 211

Në fakt, vlerën e tij të vërtetë, njeriut ia fal vetëm devotshmëria dhe modestia ndaj Allahut të Madhëruar. Në një hadith fisnik thuhet: "Allahu e lartëson atë që tregohet modest dhe i përlulur për hir të Tij." (Muslim, Birr, 69.)



MODESTIA DHE PËRULJA	213	BUJARI E PASHOQE.....	220
MORALI I TIJ ISHTE MORALI I KURANIT	213	NJË POPULL QË NUK E NJEH MBURRJEN	
GJITHÇKA DUHET T'IA ATRIBUOJMË ATIJ	216	DHE MENDJEMADHËSINË	223
TË NJOHËSH VETEN	218	BËHU DHE!.....	225

BESNIKËRIA 229

Të mos e harrosh Allahun, do të thotë ta përmendësh Atë dhe t'i përgjrohesh Atij përherë, të jesh i vetëdijsëm që ndodhesh nën vëzhgimin e pandërprerë të kamerave hyjnore dhe të jetosh me ndjenjën e mirënjohjes dhe falënderimit ndaj Tij për gjithçka që të ka falur.



BESNIKËRIA	231	BESNIKËRIA NDAJ ALLAHUT TË MADHËRUAR	238
PËRKRYEJA E BESIMIT ARRIHET ME MORAL	231	BESNIKËRIA NDAJ TË AFËRMVE	
BESNIKËRIA: NJË VIRTYT I LARTË	232	NGA NËNA E QUMËSHITIT	243
CILËSIA DALLUESE E MIQËSISË.....	233	BESNIKËRI E PASHOQE	245
KURBANI: BESNIKËRIA MË E BUKUR.....	235	BESNIKËRIA NDAJ ENSARËVE.....	245
TË DREJTAT MBI NE.....	237	BESNIKËRIA NDAJ UMETIT	246

PËRHAPJA E DREJTËSISË DHE SË VËRTETËS 251

Filozofi i shquar i Revolucionit Francez, Lafajet, edhe pse ishte jomysliman, pohoi me ndërgjegje të pastër madhështinë e Profetit tonë (a.s.), duke thënë: "O njeri i madh! Askush nuk ka mundur ta përhapë të vërtetën dhe drejtësinë siç i ke përhapur ti!"



PËRHAPJA E DREJTËSISË DHE SË VËRTETËS	253	BOTA TJETËR DO TË THOTË "DREJTËSI".....	261
LAJMI I MADH	253	DREJTËSI E PASHOQE	262
BOTA TJETËR: JETA E VËRTETË	256	NJË SULLTAN NË GJYKATË	264
BOTA TJETËR, DO TË THOTË "PESHORE".....	257	PO SOT?	268
BOTA TJETËR DO TË THOTË "LLOGARI".....	259		

FAMILJA IDEALE DHE SHOQËRIA E DEVOTSHME 271

Ne duhet të përpiqemi të vendosim në zemrat e fëmijëve tanë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.).



FAMILJA IDEALE	SHOQËRIMI ME BESNIKËT	283
DHE SHOQËRIA E DEVOTSHME	PËRMIRËSIMI I SHOQËRISË ARRIHET	
TRASHËGIMIA SHOQËRORE.....	ME ANË TË INDIVIDËVE TË DEVOTSHËM	287
POTHUAJSE!.....	ARSIMIMI I VËRTETË	289
MOS QËNDRONI BASHKË!.....	ME KË SHOQËROHEN FËMIJËT TANË?	291
EDHE PAS SHUMË SHEKUJSH!	UNITETI I ZEMRAVE ËSHTË KUSHT	294

KAFSHATA HALLALL 299

Në shtëpitë ku hyjnë produkte të kultivuara pa hile, të ble-ra me para hallall, të peshuara me sinqeritet, të përgatitu-ra me bismillah, me dua dhe zemër të qetë, u japin frymë-zim dhe energji shpirtërore atyre që i konsumojnë.



KAFSHATA HALLALL	ËSHTË KUSHT	315
DY ÇËSHTJE QË NDIKOJNË	ËSHTË E DETYRUESHME TË LARGOHEMI	
NË PERSONALITETIN E NJERIUT	EDHE PREJ TË DYSHIMTAVE	322
EDHE SIKUR TA DI QË DO TË VDESI!	KOHA AFËR KIAMETIT	324
UDHËZIMI FALË KUJDESIT NDAJ HALLALLIT	RRUGËZGJIDHJA: KAPJA PAS SUNETIT TË TIJ	326

MBËSHTETJA TEK ALLAHU DHE VETËMJAFUESHMËRIA 327

"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!" (Ankebut, 64.)



MBËSHTETJA TEK ALLAHU	ALLAHU TË DASHTË!	337
DHE VETËMJAFUESHMËRIA	ZEMRAT E NGOPURA ME DYNJANË	339
KËRKO VETËM PREJ ALLAHUT!.....	MADJE EDHE SULLTANËT	340
SHEMBULLI MË I LARTË.....	THESARI PAZOT	342
DJERSA E BALLIT	NJË SHOQËRI E MBUSHUR ME QETËSI	347
NGA NJË KRITER PËR TË DYJA PALËT		335

DHEMBSHURIA DHE MËSHIRA 351

Besimtari, duhet të jetë i mprehtë si drita e hënës në një natë të errët e pa re, i ndjeshëm, altruist, mëshirues, i dhembshur dhe bujar.



DHEMBSHURIA DHE MËSHIRA 353	PËRFSHIRJA E MËSHIRËS 362
أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ 353	ÇELËSI I KUMTIMIT 364
AI ﷺ, ËSHTË MËSHIRË PËR BOTËT 354	QYTETËRIMI I MËSHIRËS 366
MËSHIRË PËR TË GJITHË 356	ZGJIDHJA ËSHTË MËSHIRA 369
MËSHIRA E VËRTETË TREGOHET ME VEPRA 359	

BUJARIA 371

Profeti ynë (a.s.), përgjatë gjithë periudhës së profetësisë, ka jetuar duke ia kushtuar jetën dhe çdo gjë që kishte popullit të vet, sepse kjo i jepte atij një kënaqësi të jashtëzakonshme.



BUJARIA 373	BEGATIA E TRE MUAJVE 379
FARZET/OBLIGIMET FETARE 373	MIRËSI SHPIRTËRORE 384
KËSHILLA HYJNORE 374	ZEKATI NUK ËSHTË I MJAFTUESHËM! 387
ÇERDHJA E MËSHIRËS... 375	KRITERI YNË JANË SAHABËT... 389
SAKRIFICË PREJ VETES 378	

VËLLAZËRIA 393

“Asnjëri prej jush nuk ka besuar me të vërtetë përderisa nuk dëshiron për vëllain e tij të fesë atë që dëshiron edhe për veten e tij.”

(Buhari, Iman 7, Muslim, Iman 71-72.)



VËLLAZËRIA 395	LUTJA PËR UMETIN 406
KËSHILLIMI I TË VËRTETËS 395	NËN HIJEN E ARSHIT... 407
HAKU I ROBIT 397	RAMAZANI I TË PARËVE TANË 408
TË DREJTAT NDËRMJET	SADAKATË I MERR ALLAHUT! 411
VËLLEZËRVE NË FE 400	

PASTRIMI DHE EDUKIMI I SAHABËVE DHE UMMETIT TË TIJ417

Shpërdorimi dhe koprracia, ishte një stil jete që sahabët nuk e njihnin fare. Ata ishin të vetëdijshëm për faktin se, kjo botë është kalimtare dhe se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër.



PASTRIMI DHE EDUKIMI I SAHABËVE DHE UMMETIT TË TIJ	419	GËZIMI I UDHËZIMIT	427
THEMELI I FESË DHE PERSONALITETIT	419	ËMBËLSIA SHPIRTËRORE	
TRI DETYRA PROFETIKE	421	QË TË BËN TË HARROSH URINË.....	429
NDRYSHIM MADHËSHTOR	422	DIELL SHËRBIMI	431
EDUKIMI DHE TEZKIJA	424	VETËM PËR HIR TË ALLAHUT	435
EDUKIMI I NDJENJAVE ME VETËDIJEN		KUSH NA JEP NEVE?	439
NDAJ BOTËS TJETËR	425		

CIVILIZIMI QË THEMELOI AI447

Qytetërimi Islam, është një kulm i arritur njëherë në historinë e njerëzimit. Arsyeja e kësaj, është se natyra njerëzore, është e pajisur me dije hyjnore, mençuri dhe urtësi.



CIVILIZIMI QË THEMELOI AI	449	MËSHIRË DHE SHËRBIM	462
THEMELI MË I FUQISHËM	449	SHËRBIM DHE MODESTI	464
BINDJE E PLOTË	450	VIRTYTI I HEQJES DORË NGA TË DREJTAT	467
KANDILI QË SHPËRNDAN DRITË	452	OSMANËT	467
E GJITHË JETA E TIJ ISHTE LUTJE.....	454	SULTANI PËRBALLË DREJTËSISË!.....	470
PROVA E BESIMIT!	457	MODESTIA E SULTAN AHMEDIT	472
NUK DUAM TA HUMBASIM!.....	458	ZEMRA E NËNËS.....	473
O ALLAH MA PRANO QËLLIMIN!.....	460		

VETËDIJA NDAJ PËRGJEGJËSISË477

“(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.” (el-Haxhxh, 41.)



VETËDIJA NDAJ PËRGJEGJËSISË.....	479	CILI ËSHTË RREZIKU MË I MADH?.....	487
NUK ËSHTË KOT!	479	PËRGJEGJËSIA NDAJ FËMIJËVE	489
ÇDO DREJTUES ËSHTË PËRGJEGJËS.....	481	PËRGJEGJËSIA MATERIALE.....	491
TË JESH UMETI MË I MIRË.....	483	GJITHÇKA NA ËSHTË LËNË NEVE AMANET	495
Ç’MË DUHET MUA!.....	485		

NDËRTIMI I NJERIUT QË ELIMINON INJORANCËN

497

Detyra më e rëndësishme që duhet bërë për të eliminuar injorancën në kohën tonë, është edukimi dhe ndërtimi i njerëzve me personalitet.



NDËRTIMI I NJERIUT QË ELIMINON INJORANCËN.....	499	CILI ËSHTË EDUKIMI MË I MIRË?	511
PREJ ERRËSIRËS NË DRITË.....	499	KUSH DO TA FIKË?	512
NDËRTIMI I NJERIUT	501	PËR ÇDO MIRËSI DO TË JEPET LLOGARI!	515
NJË NJERI, NJË ATDHE!	504	PËRGJEGJËSIA JONË SI ÇOBANË	517
BUZËQESHJA MË E BUKUR	505	QYTETËRIMI I VAKËFEVE.....	519
DËSHIRA MË E MADHE	506	PAQJA NË BOTËN E BRENDSHME	521
TË KUPTOSH DREJTË.....	508		

UDHËZIMI DHE KUMTIMI

525

Një besimtar që dëshiron të jetë mik i Allahut të Madhëruar, duhet të dijë se është një bekim dhe lumturi e madhe të bësh përpjekje vetëmohuese për Allahun në kohë të vështira, kur feja e Allahut është nën presion e shtypje dhe myslimanët janë të dhunuar e të dobët.



UDHËZIMI DHE KUMTIMI	527	ÇLODHJA DO TË BËHET NË VARRI!.....	538
KA NJË ÇMIMI!.....	527	KUJTIME NGA TEBUKU	541
SË PARI PASTRIMI SHPIRTËROR	528	NDËSHKIMI I LARGIMIT	
KUMTIMI I FESË ME ZEMËR TË PASTËR.....	530	NGA PËRPJËKJA NË RRUGËN E ALLAHUT	543
SHTIMI I DHURIMEVE		RËNKIME TË HESHTURA	545
NË RRUGËN E ALLAHUT	532	«AHSINU!» أَحْسِنُوا.....	546
CILËSI PROFETIKE.....	535	SHPËRBLIM MË I MADH	548

VLERËSIMI I DITËS DHE JETËS

551

Nëse në vend të angazhimeve padobi, sigurohet vazhdimi i shërbimit dhe veprave të mira që begatojnë ditën; e thënë ndryshe; nëse zemra është e angazhuar me të vërtetën, ajo do të mbrohet nga pushtimi së kotës.



VLERËSIMI I DITËS DHE JETËS	553	DETYRAT SHOQËRORE	560
ÇDO GJË ËSHTË PËR MËSIM	553	PËRPJËKJET PËR BREZIN E RI	564
PËR KU KY UDHËTIM?	556	LLOGARIA PËR ÇDO NATË	567
24 ORËSHI I PROFETIT TONË (A.S.)	558		

Jeta e një besimtarit duhet të jetë e mbushur me të gjitha përpjekjet për të jetuar dhe mbajtur Islamin gjallë. Ruajtja e amaneteve të Islamit është një borxh që një besimtar duhet ta përjetojë dhe ta mbajë gjallë deri në fund të jetës së tij duke respektuar ekuilibrin hyjnor.



SHËRBIMI NDAJ ZOTIT DHE JETA E QETË	577	SAKRIFICA E SULLTANIT	589
AMANETI I MADH	577	PLOGËSHTIA ËSHTË HUMBJE.....	5912
E DREJTA MË E RËNDËSISHME:		PREDIKIMI I FESË DUKE SHËTITUR	
E DREJTA E ALLAHUT	578	FSHAT MË FSHAT	593
PËRPJEKJE PAKUFI.....	578	NË INJORANCËN E DITËVE TONA.....	595
PËRBALLË ZJARRIT	582	PARA SE TË THEMË "AH SIKUR".....	597
FAMILJA E SHENJTË.....	584	SI DO TË FITOSH?	601
KY RREZIK, ËSHTË TJETËR!.....	588		

